PROKURORIA E PËRGJITHSHME

PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT PËR SHQIPËRINË

LIDHUR ME ÇËSHTJET PENALE

PASQYRA E LËNDËS

1. Çështja “Rrapo kundër Shqipërisë”- shkelje e neneve 2 dhe 3 të Konventës ...….……...2

2. Çështja “Cani kundër Shqipërisë”- shkelje e nenit 6 të Konventës…….…..……..…….28

3. Çështja “Shkalla kundër Shqipërisë”- shkelje e nenit 6 të Konventës ……44

4. Çështja “Laska dhe Lika kundër Shqipërisë” – shkelje e neneve 3 dhe 6 të Konventës……....59

5. Çështja “Caka kundër Shqipërisë” - shkelje e neneve 3,5 dhe 6 të Konventës……74

6. Çështja “Grori kundër Shqipërisë” – shkelje e neneve 3,5,6,7 dhe nenit 2 të protokollit 7 të Konventës…….…….……...94

7. Çështja “Xheraj kundër Shqipërisë” - shkelje e neneve 6,3,10 dhe nenit 4 të protokollit 7 të Konventës.....125

8. Çështja “Dybeku kundër Shqipërisë” – shkelje e neneve 3 dhe 6 të Konventës……..….…139

9. Çështja “Balliu kundër Shqipërisë” – shkelje e neneve 3 dhe 6 të Konventës……...155

10. Çështja “Pihoni kundër Shqipërisë” – shkelje e nenit 3 të Konventës……...163

11. Çështja “Prizreni kundër Shqipërisë” – shkelje e neneve 2, 3 e 13 të Konventës……..181

12. Çështja “Tërshana kundër Shqipërisë” – shkelje e nenit 2 të Konventës ……194

ÇËSHTJA “RRAPO KUNDËR SHQIPËRISË”

(Aplikimi nr. 58555/10)

VENDIM

STRASBURG

25 Shtator 2012

Ky vendim bëhet i formës së prerë në përputhje me rrethanat e përcaktuara në Nenin 44§2 të Konventës. Ai mund të bëhet objekt për redaktime të mëtejshme.

Në çështjen Rrapo kundër Shqipërisë,

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Katërt), e mbledhur në një Dhomë të përbërë nga:

Lech Garlicki, President
David Thór Björgvinsson,
Päivi Hirvelä,
George Nicolaou,
Ledi Bianku,
Nebojša Vučinić,
Vincent A. De Gaetano, gjyqtarë
dhe Fatoş Aracı, Zëvendës Sekretar i Seksionit,

Pasi ka diskutuar me dyer të mbyllura më 4 Shtator 2012,

Lëshon vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në po atë ditë:

PROCEDURA:

Çështja nisi me një aplikim (nr. 58555/10) kundër Republikës së Shqipërisë në marrëveshje me Gjykatën sipas Nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”) nga një shtetas shqiptar dhe amerikan, Z. Almir Rrapo (“ankuesi”), më 11 Tetor 2010.

2. Ankuesi u përfaqësua nga Messrs A. Visha dhe A. Ibro, gjykatës të cilët e ushtrojnë aktivitetin në Tiranë. Qeveria shqiptare (“Qeveria”) u përfaqësua nga Agjenti i saj, Znj. E. Hajro, dhe në vijim nga Znj. L. Mandia e Zyrës së Avokatit të Shtetit.

3. Ankuesi pretendonte se kishte ndodhur një shkelje e Neneve 2 dhe 3 të Konventës si rezultat i ekstradimit të tij në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ("Shtetet e Bashkuara"). Më tej ai shpjegonte se kishte patur shkelje të Nenit 34 të Konventës, për sa kishte të bënte me këtë mospërputhje të vendimeve me këtë masë të përkohshme të Gjykatës.

4. Më 16 Dhjetor 2010, kërkesa iu komunikua Qeverisë. Gjithashtu, u vendos që të merrej një vendim mbi pranueshmërinë dhe vlerat e kërkesës në të njëjtën kohë (Neni 29 § 1).

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

A. Arrestimi dhe paraburgimi i ankuesit

5. Më 2 Korrik 2010, ankuesi bëri kërkesë pranë Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Tiranë për rinovim të pasaportës së tij amerikane. Në pasditen e po të njëjtës ditë ai u arrestua nga policia shqiptare me kërkesë të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara.

6. Në po të njëjtën ditë, Ambasada e Shteteve të Bashkuara dërgoi shënimin diplomatik nr. 55, me anë të të cilit kërkonte arrestimin paraprak të ankuesit, me qëllim ekstradimin e tij në përputhje me Nenin XI të Traktatit të Ekstradimit. Sipas shënimit diplomatik, më 28 Maj 2010, nga një Gjykatë e Shteteve të Bashkuara ishte lëshuar një urdhër arresti për ankuesin.

Prokurori kërkoi konfirmimin e ndalimit paraprak të ankuesit me synim ekstradimin e tij drejt Shteteve të Bashkuara.

7. Më 4 Korrik 2010, Gjykata e Rrethit Tiranë ("Gjykata e Rrethit") autorizoi ndalimin e ankuesit për një periudhe prej dyzetë ditësh, bazuar në një shënim të lëshuar nga Shtetet e Bashkuara me anë të Interpolit, kundër ankuesit, i cili rezltonte të ishte në kërkim. Ankuesi dhe prokurori apeluan kundër vendimit.

8. Më 22 Korrik 2010, vlefshmëria e ndalimit të ankuesit u miratua nga Gjykata e Apelit Tiranë ("Gjykata e Apelit"), e cila e zgjati periudhën e ndalimit të ankuesit në gjashtëdhjetë ditë, që nga data 2 Korrik deri më 2 Shtator 2010. Në mbështetje të vednimit të saj, Gjykata e Apelit u mbështet inter alia në Nenin XI të Traktatit të Ekstradimit midis Shteteve të Bashkuara dhe Shqipërisë.

9. Ankuesi apeloi në Gjykatën e Lartë, e cila e kundërshtoi apelimin më 12 Nëntor 2010.

10. Midis Gushtit dhe Nëntorit 2010, ankuesi bëri kërkesë kundër ndalimit të tij në vazhdimësi tri herë, më konkretisht në Gusht, në Shtator dhe në Nëntor 2010. Çdo herë gjykatat vendase i kundërshtuan veprimet e ankuesit dhe e zgjatën më tej ndalimin e tij deri më 2 Nëntor 2010, sipas Nenit 493 të Kodit të Procedurës Penale ("KPP").

B. Procedurat e ekstradimit

11. Më 30 Gusht 2010, Ambasada e Shteteve të Bashkuara i dërgoi Ministrisë Shqiptare të Punëve të Jashtme, shënimin diplomatik nr. 071, duke i kërkuar ekstradimin e ankuesit. Sipas shënimit diplomatik, ankuesi ishte akuzuar, së bashku me të pandehur të tjerë, me tetë akuzat e mëposhtme: 1) antarësi në një organizatë kriminale e përfshirë në vrasje, rrëmbim personi, shpërndarje droge, zjarrvënie të qëllimshme, vjedhje, grabitje dhe transportimi brenda përbrenda shtetit të mallrave të vjedhura; 2) komplot pët t'u përfshirë në një organizatë kriminale; 3) komplot për të shpërndarë dhe zotërim me qëllim shpërndarjen e 100 kilogramëve dhe më shumë marihuanë; 4) komplot për shpërndarjen dhe zotërim me qëllim shpërndarjen e subsatncave të ndaluar; 5) komplotim për të bërë një grabitje; 6) zotërimin, përdorimin, mbajtjen dhe kërcënimin me armë zjarri, duke përfshirë një armë zjarri të pajisur me silenciator, gjatë dhe në lidhje me një krim që ka të bëjë me lëndë narkotike; 7) rrëmbim personi në favor të organizatës kriminale; 8) zotërimi, përdorimi, mbajtja dhe kërcënimi me armë zjarri gjatë dhe në lidhje me rrëmbimin e një personi të përmendur në akuzën e gjashtë; dhe 9) vrasjen e E. S. në favor të organizatës kriminale.

Më tej shënimi diplomatik pohonte se pesë akuza mbanin dënimin maksimal me burgim të përjetshëm (nr. 1-2 dhe 6-8); dy akuza mbanin një dënim maksimal me dyzetë vjet burg (nr. 3 dhe 4); një akuzë mbante dënim maksimal me njëzet vjet burg (nr. 5); dhe një tjetër akuzë mbante një dënim me vdekje ose me burgim të përjetshëm (nr. 9). Më tej shënimi diplomatik pohonte se më 19 Gusht 2010, kundër ankuesit ishte lëshuar një urdhër arresti nga Gjykata e Rrethit të Shteteve të Bashkuara për Rrethin Jugor të Nju Jorkut.

12. Më 31 Gusht 2010, prokuroria i kërkoi Gjykatës së Rrethit të autorizonte ekstradimin e ankuesit drejt Shteteve të Bashkuara.

13. Më 30 Shtator 2010, Gjykata e Rrethit miratoi kërkesën e prokurorit. Gjykata e Rrethit e hodhi poshtë kundërshtimin e ankuesit i cili pretendonte se autoritetet e Shteteve të Bashkuara nuk kishin parashtruar ndonjë siguri kundër dënimit me vdekje me justifikimin se kjo siguri nuk kërkohej me ligj.

14. Më 13 Tetor 2010, Zyra e Avokatit të Shtetit informoi Gjykatën e Apelit për këtë masë të përkohshme të Gjykatës së datës 12 Tetor 2010 (shiko paragrafin 31 më poshtë).

15. Më 27 Tetor 2010, Ambasada e Shteteve të Bashkuara i dërgoi Ministrisë Shqiptare të Punëve të Jashtme shënimin diplomatik nr. 88, i cili për sa ka të bëjë me çështjen, lexonte si më poshtë (i shkëputur nga origjinali në anglisht):

"Shtetet e Bashkuara e kuptojnë se sipas vendimit të marrë Rrapo është i ekstradueshëm dhe se vendimi është apeluar në një gjykatë shqiptare apelimi dhe se një ankesë është paraqitur përpara Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Shtetet e Bashkuara kërkojnë që ndërsa këto procedura janë në vazhdimësi, Qeveria shqiptare të kërkojë informacion shtesë për sa ka të bëjë me procedurat e mundshme për t'u ndërmarrë në të ardhmen në Shtetet e Bashkuara.

Ky informacion të kërkohet në rrugë diplomatike dhe duhet të përcaktojë një hark të arsyeshëm kohor për përgjigje, si edhe për udhëzimet në lidhje me prezantimin e këtij informacioni. Shtetet e Bashkuara do t'i përgjigjen cilësdo kërkese të tillë brenda një harku kohor të arsyeshëm.

Gjithashtu, Ambasada kërkon që sa ka të bëjë me procedurat e ekstradimit të Almir Rrapos, Qeveria shqiptare të marrë në konsideratë rrezikun e mundshëm gjatë fluturimit në të cilin do të gjendet i pandehuri, dhe bën kërkesën që Rrapo të vazhdojë të mbahet në gjendje arresti në pritje të zgjidhjes së të gjitha procedurave në lidhje me kërkesën për ekstradim të Rrapos, duke përfshirë edhe procedurat në Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut si edhe procedurat e gjykatës kombëtare."

16. Më 1 Nëntor 2010, Gjykata e Apelit Tiranë, duke shqyrtuar apelimin e ankuesit, doli në favor të ekstradimit të ankuesit. Gjykata vendosi se nuk ekzistonte asnjë detyrim ligjor që të kërkonte sigurinë nga autoritetet e Shteteve të Bashkuara kundër ushtrimit të dënimit me vdekje.

17. Më 1 Nëntor 2010, Ministri i Drejtësisë urdhëroi se ekstradimi i ankuesit duhej të zbatohej më 16 Nëntor 2010.

18. Më 3 Nëntor 2010, Ministri i Drejtësisë i dërgoi Ambasadës së Shteteve të Bashkuara një shënim verbal ku i kërkonte të dinte nëse aplikuesi do t'i nënshtrohej dënimit kapital për aktet kriminale për të cilat ai ishte akuzuar.

19. Më 8 Nëntor 2010, Ambasada e Shteteve të Bashkuara i dërgoi Ministrisë Shqiptare të Punëve të Jashtme shënimin diplomatik nr. 91, në të cilin, për sa ka të bëjë më çështjen, shkruhet si më poshtë:

"Departamenti i Drejtësisë i Shteteve të Bashkuara ka autorizuar dhe orientuar Avokatin e Shteteve të Bashkuara për Rajonin Jugor të Nju Jorkut të mos kërkojë dënimin me vdekje kundër Almir Rrapos. Për këtë arsye, Qeveria e Shteteve të Bashkuara siguron Qeverinë Shqiptare se nëse Z. Rrapo ekstradohet për t'u përballur me procesin gjyqsor në lidhje me akuzat për të cilat është kërkuar ekstardimi, dënimi me vdekje as nuk do të kërkohet dhe as nuk do të zbatohet kundër Almir Rrapos pasi ai të jetë ekstraduar në Shtetet e Bashkuara."

20. Më 9 Nëntor 2010, ankuesi apeloi në Gjykatën e Lartë. Ai dha argumentin inter alia se autoritetet e Shteteve të Bashkuara nuk i ofronin asnjë siguri për mos zbatimin e dënimit me vdekje, duke shkelur në këtë mënyrë Nenin 21 të Kushtetutës.

21. Më 9 Nëntor 2010, ankuesi bëri një kërkesë tjetër në Gjykatën e Lartë në të cilën kërkonte pezullimin e ekstradimit të tij, duke nxjerrë në dukje udhëzimin e Gjykatës në përputhje me Vendimin 39 të Vendimeve të Gjykatës.

22. Më 10 Nëntor 2010, Zyra e Avokatit të Shtetit informoi Gjykatën e Lartë për këtë masë të përkohshme të Gjykatës të datës 2 Nëntor 2010 (shiko paragrafin 32 më poshtë).

23. Më 15 Nëntor 2010, Ministri i Drejtësisë e shtyu në datën 1 Dhjetor 2010 limitin kohor gjatë së cilit do të realizohej ekstradimi i ankuesit.

24. Më 24 Nëntor 2010, ankuesi u ekstradua në Shtetet e Bashkuara.

25. Më 26 Nëntor 2010, Gjykata e Lartë i shfuqizoi të dyja vendimet e gjykatave më të ulta dhe e ktheu çështjen në Gjykatën e Rrethit. Gjykata e lartë arriti në përfundimin se gjykatat e ulta nuk duhet të kishin urdhëruar ekstradimin e ankuesit bazuar në dy pika kryesore. Pikë së pari, gjykatat e ulta nuk kishin marrë asnjë garanci nga autoritetet e Shteteve të Bashkuara se dënimi kapital nuk do të ushtrohej mbi ankuesin. Ky vendim binte ndesh me një sërë parashikimesh kushtetuese dhe parashikimesh të statuteve të Shqipërisë. Së dyti, gjykatat e ulta nuk kanë ndonjë fakt për të vërtetuar fajësinë e ankuesit siç kërkohet nga Traktati i Ekstradimit. Ekzistenca e një pohimi me shkrim nga një oficer policie i Shteteve të Bashkuara, në cilësinë e të dhënave, nuk do të konsiderohej si i tillë bazuar në parashikimet e procedurës penale vendase.

26. Në procedurat e seancave gjyqsore, duke iu përgjigjur kërkesës së Gjykatës së Rrethit, të datës 16 Shkurt 2011, në lidhje me sigurinë për të mos aplikuar dënimin me vdekje ndaj ankuesit, më 17 Shkurt 2011, Ministri i Drejtësisë i kërkoi Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të jepte sigurinë e plotë se ankuesi nuk do t'i nënshtrohej dënimit kapital në lidhje me akuzat për të cilat ai u ekstradua.

27. Më 24 Shkurt 2011, Ambasada e Shteteve të Bashkuara i dërgoi Ministrit shqiptar të Punëve të Jashtme shënimin diplomatik nr. 22, i cili për sa ka të bëjë me çështjen, pohon si më poshtë:

"… Shtetet e Bashkuara i drejtohen Shqipërisë me shënimin diplomatik 91, të datës 8 Nëntor 2010, në të cilin Shtetet e Bashkuara sigurojnë se dënimi me vdekje as nuk do të kërkohet dhe as nuk do të ushtrohet kundër Z. Rrapo për akuzat për të cilat ai u ekstradua. Një siguri e tillë transmetohet nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara në formën e një shënimi diplomatik, i cili është komunikim formal midis qeverive tona. Siç rezulton edhe në shënimin diplomatik nr. 91, në bazë të një vendimi të marrë nga Departamenti i Drejtësisë së Shteteve të Bashkuara, jepet siguria e plotë se as nuk do të kërkohet dhe as nuk do të ushtrohet dënimi me vdekje ndaj Z. Rrapo, dhe se kjo siguri bëhet e formës së prerë sipas Departamentit të Drejtësisë së Shteteve të Bashkuara."

28. Duke iu përgjigjur një tjetre kërkese të Gjykatës së Rrethit për të patur shpjegime rreth pozicionit të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara në lidhje me shënimet diplomatike dhe sigurinë e ofruar, më 18 Maj 2012, Ambasada e Shteteve të Bashkuara i dërgoi Ministrisë shqiptare të Punëve të Jashtme shënimin diplomatik nr. 44, i cili për sa ka të bëjë me çështjen pohon si më poshtë:

“Shtetet e Bashkuara e vlerësojnë lidhjen dhe bashkëpunimin e ngushtë me Republikën e Shqipërisë në luftën kundër terrorizmit dhe krimeve të tjera. Në vijim të këtij bashkëpunimi, Shtetet e Bashkuara dërgojnë përgjigjen e mëposhtme në lidhje me çështjet e ngritura më herët për sa ka të bëjë me ekstradimin e Z. Rrapo […]. Në lidhje me kërkesën për të dhëna të tjera mbi fajësinë e Z. Rrapo, Shtetet e Bashkuara vërejnë se Z. Rrapo është vetshpallur fajtor ndaj akuzave.
…
Për sa ka të bëjë me natyrën dhe statusin e shënimeve diplomatike, ky shënim diplomatik (nr. 44) shpjegonte se:

[…] Shtetet e Bashkuara vërejnë se shënimi diplomatik nga Ambasada Amerikane në Tiranë është një komunikim formal i Qeverisë së Shtetve të Bashkuara drejtuar Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, i cili përcakton pozicionin zyrtar dhe autoritar të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara në lidhje me sigurinë për dënimin me vdekje në këtë çështje. Komunikimi i sigurisë me anë të shënimit diplomatik është praktikë standarde e Qeverisë së Shteteve të Bashkuara, dhe në fakt e të gjithë qeverive anembanë botës. Një siguri e tillë është e detyrueshme për të gjithë qeverinë e Shteteve të Bashkuara, duke përfshirë Departamentin e Drejtësisë dhe autoritetet paditëse. Në rastin kur ambasada paraqet një komunikatë zyrtare në emër të Shteteve të Bashkuara, ajo përfaqëson me autoritet të plotë Shtetet e Bashkuara për këtë çështje dhe për ndonjë çështje tjetër dhe për pasojë është “organi kompetent” i Shtetit të cilit i kërkohet të përcjellë një siguri të tillë. Kjo siguri, ashtu siç parashtrohet në shënimin diplomatik 91, të datës 8 Nëntor 2010, është tërësisht e aplikueshme dhe autoritare.”

29. Qeveria pohon se më 28 Nëntor 2011 Gjykata e Rrethit mori vendimin në favor të ekstradimit të ankuesit, edhe pse nuk është paraqitur asnjë kopje e atij vendimi.

30. Apelimi i ankuesit mbetet pezull përpara Gjykatës së Apelit.

C. Procedurat përpara Gjykatës

31. Më 12 Tetor 2010, ndërsa procedurat e apelimit ishin pezull përpara Gjykatës së Apelit, Presidenti i Seksionit të Katërt të Gjykatës, së cilës i ishte ngarkuar çështja vendosi, për interesat e palëve dhe të drejtimit të duhur të procedurave përpara Gjykatës, t’i pohojë Qeverisë së Shqipërisë, se në përputhje me Rregullin 39 të Rregullores së Gjykatës, ankuesi nuk duhej të ekstradohej në Shtetet e Bashkuara. Kjo masë do të mbetej në fuqi “deri në harkun kohor të dhjetë ditëve pas deklarimit të vendimit të Gjykatës së Apelit për Gjykatën.” Palët u njoftuan për vendimin në po të njëjtën ditë me anë të një faksi dhe të postës.

32. Më 2 Nëntor 2010, në zbatim të vendimit të Gjykatës së Apelit në favor të ekstradimit të ankuesit, si dhe në vijim të apelimit të ankuesit kundër vendimit të Gjykatës së Lartë, Presidenti i Seksionit të Katërt të Gjykatës vendosi ta zgjaste më tej masën e përkohshme të ndalimit, e cila fillimisht iu bë e ditur Qeverisë përgjegjëse bazuar në Vendimit 39të Vendimeve të Gjykatës, “deri në haspirën kohore të pesëmbëdhjetë ditëve pasi vendimi i

Gjykatës së Lartë iu bë i ditur Gjykatës.” Palët u informuan për këtë vendim në pot ë njëjtën ditë me anë të faksit dhe postës.

33. Më 4 Nëntor 2010, Sekretari i Seksionit të Katërt i shkroi inter alia Zyrës së Avokatit të Shtetit, në pozicionin e saj si Agjenti i Qeverisë përpara Gjykatës, rreth kushteve të mëposhtme.

“Nën kushtet e masës së përkohshme, siç është vendosur dhe shtyrë më tej nga Presidenti i Seksionit të Katërt, ankuesi nuk duhet të ekstradohet në Shtetet e Bashkuara derisa të kenë kaluar pesëmbëdhjetë ditë nga data e shpalljes së vendimit të Gjykatës së Lartë për
këtë Gjykatë. Kjo periudhe do t’i bëjë të mundur Gjykatës që të reflektojë më tej mbi çështjen bazuar edhe në faktet e mbledhura nga gjykata vendase.

Në lidhje me sa mësipër, unë mund të përsëris vetëm atë ç’ka thashë në takimin tonë, se nëse Shteti kontraktues nuk bie dakort me një masë të Vendimit 39, mund të kemi një shkelje të Nenit 34 të Konventës, i cili i referohet Qeverisë suaj si nënshkruese (shiko Grori kundër Shqipërisë, nr. 25336/04, §§ 172-195, 7 Korrik 2009). Ndoshta do të dëshironi ta theksoni këtë pikë në diskutimet tuaja me autoritetet kompetente.”

34. Më 10 Nëntor 2010, Ministri i Drejtësisë informoi Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm dhe Zyrën Vendase të Interpolit se ankuesi nuk duhej ekstraduar në Shtetet e Bashkuara bazuar në masën e përkoshshme të Gjykatës sipas Vendimit 39.

35. Më 15 Nëntor 2010, Presidenti i Seksionit të Katërt të Gjykatës vendosi se edhe pse do të merrej parasysh siguria diplomatike e ofruar nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara kundër ushtrimit të dënimit me vdekje, udhëzimi i Vendimit 39 do të mbetej në fuqi dhe do të vazhdonte të aplikohej. Palët u informuan në lidhje me vendimin më 18 Nëntor 2010, me anë të një faksi dhe postës.

36. Më 24 Nëntor 2010, avokati i ankuesit informoi Gjykatën se ankuesi ishte ekstraduar në Shtetet e Bashkuara atë mëngjes, pa njoftuar paraprakisht as ankuesin dhe as përfaqësuesin e tij. Me anë të një letre, në po atë ditë, kjo Gjykatë ftoi Qeverinë të konfirmonte këtë informacion.

37. Më 25 Nëntor 2010, Qeveria, i konfirmoi Sekretarit të Seksionit të Katërt të Gjykatës, me anë të një telefonate, se ankuesi ishte ekstarduar nga Shqipëria më 24 Nëntor 2010. Konfirmimi u mor me shkrim më 26 Nëntor 2010.

38. Më 25 Nëntor 2010, Sekretari i Gjykatës i dërgoi Qeverisë letrën e mëposhtme:

“Presidenti i Gjykatës … më ka udhëzuar t'iu shpreh në emrin e tij keqardhjen e tij të thellë për vendimin e marrë nga autoritetet tona për të ekstraduar Z. Almir Rrapo në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në kundërshtim me masën e përkohshme të Gjykatës në përputhje me Vendimin 39 të Vendimeve të Gjykatës.”

Kështu, Presidenti ka vërejtur se më 3 Nëntor 2010, Sekretari i Seksionit të Katërt i ka rikujtuar qartë autoriteteve tuaja se masa e Vendimit 39, e vënë në zbatim për herë të parë më 12 Tetor 2010, vazhdonte të ishte në fuqi. Vëmendja e Qeverisë suaj ishte përqendruar në faktin se nëse Qeveria Kontraktuese nuk binte dakort me një masë të Vendimitit 39, mund të shkaktohej një shkelje e Nenit 34 të Konventës. Për më tepër, në letrën më të fundit të Gjykatës, të datës 18 Nëntor 2010, Qeveria juaj u informua se Presidenti i Seksionit të Katërt kishte vendosur të vazhdonte të aplikonte masën e përkohshme. Gjithësesi, Qeveria juaj e ekstradoi ankuesin në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, më 24 Nëntor 2010.

Presidenti më ka udhëzuar t'i kërkoj Qeverisë suaj që të informojë Gjykatën në lidhje me rrethanat në të cilat ndodhi ekstradimi dhe arsyet se përse nuk u përmbush masa e Vendimit 39. Qeveria juaj duhet të dorëzojë kopje të çfarëdo dokumenti që ka lidhje me çështjen.

Presidenti është jashtëzakonisht i shqetësuar për këtë çështje dhe veçanërisht për ndërlikimet që ajo i ka shkaktuar autoritetit të Gjykatës si edhe për mesazhin e gabuar që ajo dërgon tek Shtetet e tjera Kontraktuese të përballura me masën e Vendimit 39 dhe tek ankuesit e tjerë të cilët mund të ekstradohen ose të largohen drejt shteteve ku mund të jenë të ekspozuar ndaj rrezikut për dhunimin e të drejtave të tyre sipas Neneve 2 dhe 3 të Konventës. Si tregues i seriozitetit me të cilin ai e konsideron këtë linjë ngjarjesh, Presidenti ka bërë kërkesën që të informohen mënjëherë Kryetari i Këshillit të Ministrave, Presidenti i Asamblesë Parlamentare, Komisioneri për të Drejtat e Njeriut dhe Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Europës.

39. Në përgjigjen e datës 30 Nëntor 2010, Qeveria deklaroi se ekstradimi i ankuesit ishte nxitur bazuar në sigurinë e dhënë nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara se dënimi me vdekje as nuk do të kërkohej dhe as nuk do të ushtrohej. Më tej në letër cilësohej se autoritetet shqiptare proceduan me ekstradimin e ankuesit më 24 Nëntor 2010, për arsye se ndalimi i tij do të përfundonte më 1 Dhjetor 2010, dhe me t'u liruar rreziku për t'u larguar e më pas për t'u fshehur do të ishte i afërt.

40. Më 10 Janar 2011, Përfaqësia e Përhershme Shqiptare në Këshillin Europian i dëgoi Gjykatës një letër të Ministrit shqiptar të Drejtësisë, të datës 27 Dhjetor 2010. Në letrën e tij Ministri siguronte Gjykatën se Qeveria nuk kishte si objektiv të shkelte urdhrin e Vendimit 39. Rrethanat komplekse dhe përjashtuese të çështjes së ankuesit e kishin shtyrë Qeverinë të merrte një vendim, e cili, sipas këndvështrimit të saj mendonte se i kishte ofruar një zgjidhje të drejtë çështjes. Më tej Ministri deklaronte se (i shkëputur nga varianti origjinal në anglisht):
"… Do të doja të sqaroja se nëse urdhri i Gjykatës Europiane do të [synohej që të] zbatohej plotësisht, atëherë… Almir Rrapo, [apelimi i të cilit ishte] i pezulluar … përpara Gjykatës së Lartë, do lihej i lirë prej datës 1 Dhjetor 2010. [Do të ndodhte kështu] sepse, sipas legjislacionit shqiptar, një vendim gjykate merr karakter ekzekutiv dhe juridik pas përfundimit të gjyqit [përpara] Gjykatës së Apelit dhe jo pas ërfundimit të gjyqit [përpara] Gjykatës së Lartë. Në datën e gjyqit të organizuar nga kjo e fundit, … bazuar në Nenin 499 § 1 të KPP, lirimi i Armir Rrapos do të jetë i domosdoshëm…

Në varësi të këtyre kushteve, një person i cili përbën rrezik të lartë jo vetëm për…. Qytetarët shqiptarë, por gjithashtu edhe për … qytetarët europianë dhe amerikanë [do të] lihej i lirë.

Për pasojë, Ministri i Drejtësisë gjendej në disa rrethana objektive të cilat e bënë të pamundur përmbushjen e plotë … të urdhrit të Gjykatës Europiane. Nën këto rrethana, ai vendosi ta riprogramonte datën e ekstradmit, deri në [përfundimin e] afatin kohor kur …

Almir Rrapo mund të mbahej nën masën e sigurisë "arrest në burg", i cili përfundonte ... më 1 Dhjetor 2010. Zbatimi i plotë i [urdhrit] të Gjykatës Europiane dhe, në vijim, shtyrja e afatit të ekstradimit pas datës 1 Dhjetor 2010" me urdhër të Gjykatës, do ta kishin çuar shtetin shqiptar drejt një situate [në të cilën do të përfundonte] afati kohor [prej 30 ditësh] siç përcaktohet në parashikimin ligjor të mësipërm. Për këtë arsye, shteti shqiptar do të kishte [patur] detyrimin ligjor të linte në gjendje të lirë … Almir Rrapon. Më tej do të doja të sqaroja se sipas Nenit 500 të KPP, Ministri i Drejtësisë nuk mundi të pezullojë ekzekutimin e vendimit për ekstradimin e Almir Rrapos, si rezultat i urdhrit të Gjykatës Europiane, sepse ai parashikim nuk e përmban një klauzolë të tillë, dhe për pasojë nuk siguron korigjimin e pasojave.

Më tej, do të donim të bënim të qartë se legjislacioni shqiptar nuk parashikon se çfarë ndodh me masën e sigurisë "arrest me burgim", nëse Gjykata e Lartë vendos [ta heq] rigjykimin e çështjes, gjë e cila ndodhi. Për pasojë, për aq kohë sa nuk ka asnjë parashikim ligjor i cili kushtëzon mundësinë për ta mbajtur këtë masë në fuqi, në një çështje të tillë, interpretimi ligjor do të kishte favorizuar …. Almir Rrapon. Kështu, në një rast të tillë, ky i fundit do të [ishte liruar] lirohej. Qëllimi i palës shqiptare ishte të shmangte lënien në gjendje të lirë … Almir Rrapon për arsye se ai përbën rrezik të lartë për shoqërinë, për akuzat e rënda e ngritura kundër tij dhe mundësinë e madhe që ai të largohej në drejtim të paditur. Në një situatë të tillë, do të donim të shtonim, se më 27 Tetor 2010, pala amerikane i kërkoi palës shqiptare të ndërmerrte çdo masë ligjore për t'u siguruar se qytetari Almir Rrapo nuk do të arratisej. Në rast se ai do të largohej, do të thyheshin parashikimet e Traktatit të Ekstradimit. Kështu, shteti shqiptar nuk do të përmbushte detyrimet bilaterale ndërkombëtare për arsye se nuk kishte administruar mirë drejtësinë."

D. Ngjarjet që vijojnë pasi çështja i është komunikuar Qeverisë

41. Më 19 Korrik 2011, ndërsa avokatët e ankuesit pretendonin se informacioni ishte marrë nën presion, dorëzuan përpara një gjykatësi të Shteteve të Bashkuara, një procesverbal të seancës gjyqsore të datës 11 Prill 2011. Pasi ankuesi kishte marrë këshillim ligjor nga avokati i tij në Shtetet e Bashkuara, me dëshirën e tij hyri në një marrëveshje lutjeje për falje me Zyrën e Avokatit të Shteteve të Bashkuara, sipas së cilës ai u vetdeklarua fajtor dhe hoqi dorë nga e drejta për ta paraqitur çështjen përpara një Jurie të Madhe, duke bërë që të mos kishte asnjë proces gjyqsor dhe që hapat në vijim të konsistonin në raportin e para dënimit dhe dënimit i cili do të jepej nga gjykatësi i procesit gjyqsor. Në procesverbal, ai siguronte gjithashtu se do të ofronte asistencën e tij të kërkuar nga Shtetet e Bashkuara.

42. Gjykatësi i shpjegoi ankuesit se dënimi maksimal në total mbi të gjitha akuzat ishte burgimi i përjetshëm dhe dënimi minimal i detyruar në total mbi të gjitha akuzat ishte burgimi i përjetshëm. Ai gjithashtu i komunikoi ankuesit se lirimi me kusht ishte hequr dhe nëse ai dënohej, do t'i duhej ta vuante të gjithë dënimin. Më tej procesverbali përmendte mundësinë e një lirimi nën mbikqyrje në favor të ankuesit. Gjithashtu, gjykatësi i kujtoi ankuesit se nën rrethana të caktuara, ai kishte të drejtën të apelonte dënimin e dhënë kundër tij.

43. Gjykatësi e pranoi vetdeklarimin për fajësi të ankuesit dhe kërkoi që të përgatitej një raport para dënimit, në përputhje me udhëzimet federale për dënimin, duke marrë parasysh një sërë faktorësh në të cilët përfshihej dhe sjellja e tij aktuale, viktima të ndonjë krimi, roli që ai kishte patur në krim, nëse e kishte pranuar përgjegjësinë për aktet etij, nëse kishte histori kriminale dhe nëse ishte përpjekur të pengonte drejtësinë. Gjykatësi i seancës gjyqsore mbajti të fshehtë dënimin që pritej të jepej.

44. Më 26 Korrik 2012, ankuesi u deklarua si i pandehur nga gjykata e Shteteve të Bashkuara (shiko paragrafin 11 mësipër). Ai u dënua me 80 muaj burgim. Me të dalë në gjendje të lirë ai do të ishte nën mbikqyrje për një periudhë tre vjeçare sipas kushteve të lirimit të mbikqyrur.

II. LIGJI DHE PRAKTIKA PËRKATËSE VENDASE

A. Kushtetuta e Shqipërisë

45. Kushtetuta e Shqipërisë, në pjesët të lidhura me çështjen, parashikon si mëposhtë.

Neni 4

"1. Ligji përbën bazat dhe limitet e aktivitetit të Shtetit.

2. Kushtetuta është ligji suprem në Republikën e Shqipërisë.

Parashikimet e paraqitura në Kushtetutë hyjnë në fuqi menjëherë, ashtu siç parashikohen nga Kushtetuta."

Neni 5

"Republika e Shqipërisë zbaton ligjin ndërkombëtar që ndikon mbi të."

Neni 17

"1. Kufizimet e të drejatve dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë, mund të shfuqizohen vetëm me anë të ligjit në interes të publikut ose për mbrojtjen e interesave e të tjerëve. Kufizimi do të ishte në proporcion me situatën e cila e diktonte atë.

2. Këto kufizime mund të mos e shkelin esencën e të drejtave dhe lirive dhe në asnjë mënyrë nuk duhet të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut."

Neni 21

"Jeta e individit mbrohet me ligj."

Neni 116

"1. Aktet normative të cilat ushtrohen në Republikën e Shqipërisë janë:

a) Kushtetuta;
b) Marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare;
c) Ligjet;
ç) Aktet normative të Këshillit të Ministrave.

(...)

Neni 122

1. Çdo marrëveshje e ratifikuar ndërkombëtare është pjesë përbërëse e sistemit juridik vendas, menjëherë pas publikimit të tij në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo hyn menjëherë në fuqi, me përjashtim të rasteve kur nuk është e vet-zbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon përfshirjen e një ligji. (...)"

Ligji i Gjykatës Kushtetuese për çështjen

46. Me një vendim kyç, nr. 65 të datës 10 Dhjetor 1999, Gjykata Kushtetuese, e mbështetur në Konventë, vendosi të heq dënimin me vdekje në kohë paqeje në të gjitha parashikimet e Kodit Penal dhe në dy parashikimet e Kodit Penal Ushtarak.

B. Kodi i Procedurës Penale ("KPP")

47. Nenet 232-239 parashikojnë ndërmarrjen e masave të mëposhtme të detyrueshme të sigurisë: ndalohet largimi jashtë territorit të shtetit (Neni 233); detyrimi për t'i raportuar policisë juridike (Neni 234); ndalimi dhe detyrimi për të qëndruar në një vend të caktuar (Neni 235); garanci (Neni 236); arrest shtëpie (Neni 237); ndalim me burgim (Neni 238); dhe ndalim në një institucion psikiatrik (Neni 239).

48. Neni 266 § 1 parashikon, se nëse periudha e ndalimit mbaron, dhe nëse motivet për të cilat është dhënë ndalimi ekzistojnë ende, gjykata mund të lëshojë një tjetër masë sigurie nëse mbështetet nga rrethanat e çështjes.

49. Nenet 488-503 janë rregullatori për procedurën e ekstardimit në një vend të huaj. Sipas Nenit 489 kërkesa për ekstradim duhet t'i adresohet Ministrit të Drejtësisë dhe të shoqërohet me dokumentacionin mbështetës. Kërkesa për ekstradim duhet të përfshijë, inter ali, parashikimet e zbatueshme ligjore të huaja, të pohojë nëse ligji i huaj parashikon zbatimin e dënimit me vdekje në lidhje me aktin kriminal për të cilin është kërkuar ekstradimi.

50. Ministri i Drejtësisë ia kalon kërkesën prokurorit të rrethit, i cili brenda tre muajve nga momenti i dorëzimit të kërkesës për ekstradim nga Shteti që bën kërkesën, dorëzon një aplikim në Gjykatën e Rrethit sipas Nenit 492.

51. Neni 439 parashikon lëshimin e një urdhri për siguri të detyruar kundër personit që do të ekstradohet për të shmangur fshehjen e tij nga drejtësia. Urdhri i sigurisë lëshohet në përputhje me parashikimet e përgjithshme për urdhrat e sigurisë dhe do të revokohet brenda tre muajve nga ekzekutimi i tij nëse procedurat janë ende pezull përpara gjyqit. Kjo periudhë mund të shtyhet ndoshta edhe për një muaj më shumë sipas kërkesës së prokurorit (Neni 439 §§ 2 dhe 4).

52. Në përputhje me Nenin 494, Gjykata e rrethit mund të lëshojë një urdhër paraprak sigurie me kërkesën e prokurorit në mungesë të kërkesës për ekstradim. Një urdhër i tillë sigurie mund të lëshohet nëse: a) Shteti që ka bërë kërkesën ka lëshuar një urdhër që privon lirinë, ose një dënim me burgim kundër personit në fjalë, me kusht që Shteti që bën kërkesën të ketë si objektiv që më pas të lëshojë një kërkesë për ekstradim; b) Shteti që ka bërë kërkesën ka dorëzuar informacion të detajuar rreth aktit kriminal dhe ka ofruar elementë të mjaftueshëm për identifikim e personit; c) ka rrezik fshehje. Një urdhër ndalimi do të revokohet nëse brenda tetëmbëdhjetë ditëve, dhe në çfarëdo rasti, brenda një periudhe për maksimumin dyzet ditë, asnjë kërkesë ekstradimi nuk depozitohet në Ministrinë e Drejtësisë.

53. Arrestimi ose ndalimi duhet të vihet në zbatim nga Gjykata e Rrethit brenda dyzet e tetë orëve (Neni 495 §§ 2 dhe 3).

54. Ministria e Drejtësisë do të procedojë me ekstradimin brenda 30 ditëve nga data në të cilën vendimi i gjykatës bëhet përfundimtar. Me mbarimin e këtij limit kohor, personi do të lirohet nëse Ministria nuk procedon me ekstradimin e tij (Neni 499 §§ 1).

C. Juridiksioni në Aktin e çështjeve penale (Ligji nr. 10193 i datës3 Dhjetor 2009 mbi juridiksionin e çështjeve penale me autoritetet e huaja)

55. Përveç kushteve të parashikuar në Kodin Penal dhe në Kodin e Procedurës Penale, seksioni 32 pohon se nëse ekstradimi i një personi në një vend të huaj është i lejueshëm, inter alia, kur (d) Shteti që bën kërkesën siguron se nuk do të ushtrojë dënimin me vdekje, ose në rastin kur ky dënim është i aplikueshëm, Shteti që bën kërkesën nuk do ta ekzekutojë atë.

D. Traktati i Ekstardimit midis Shteteve të Bashkuara dhe Mbretërisë së Shqipërisë ("Traktati i Ekstradimit")

56. Traktati bilateral i ekstardimit midis Shtetve të Bashkuara dhe Mbretërisë së atëhershme të Shqipërisë u nënshkrua më 1 Mars 1933. Ai hyri në fuqi më 14 Nëntor 1935 dhe është ende në fuqi. Në parashikimet e tij, të cilat kanë lidhje me çështjen, thuhet se.

Neni II

"Personat , të cilët akuzohen ose do të dënohen me një nga krimet e mëposhtme, do të dorëzohen sipas parashikimeve të Traktatit aktual:

1. Vrasje (duke përfshirë këtu edhe krimet në rrethanat e atëvrasjes, helmit apo vrasjes së fëmijëve); vrasje në mënyrë të vetdijshme;

   (...) "

Neni VIII

"Nën dispozitat e këtij Traktati, asnjë nga Palët e Larta Kontraktuese nuk do të jetë e detyruar t'i dorëzojë qytetarët e saj, me përjashtim të rasteve kur një kombësi e tillë është marrë pas kryerjes së krimit për të cilin është kërkuar ekstradimi. Shteti tek i cili është paraqitur apelimi do të vendosë nëse personi i deklaruar është qytetari i tij."

Neni XI

"(...)

Arrestimi i te arartisurit do të realizohet në përputhje me ligjet e shtetve përkatëse (...)

Personi i arrestuar paraprakisht, do të lirohet, nëse brenda dy muajve nga data e arrestimit në Shqipëri, apo nga data e zotimit në Shtetet e Bashkuara nuk realizohet kërkesa formale për dorëzim së bashku me provat e dokumentuara, siç është kërkuar paraprakisht nga agjenti diplomatik i Qeverisë që bën kërkesën, ose në mungesë të tij, nga një oficer konsullor. (...)

III. LIGJI DHE PRAKTIKA PËRKATËSE NDËRKOMBËTARE

Ligji dhe praktika e Shtetit të Nju Jorkut

57. Qeveria parashtron se seksioni 400.27 i Ligjit të Procedurës Penale të Nju Jorkut ("LPP") e programon procedurën për përcaktimin e dënimit sipas provës kundër krimit të vrasjes së shkallës së parë. Paragrafi 10 i seksionit të mësipërm, i përcaktuar si udhëzimi i jurisë, i cili është bërë pengesë, përcakton si më poshtë:
"Në përfundim të të gjithë të dhënave, njerëzit dhe i padituri mund të paraqesin argumenta pro dhe kundër dënimit të kërkuar nga njerëzit. Njerëzit mund të dorëzojnë përmbledhjen e parë dhe më pas i akuzuari mund të paraqesë përmbledhjen përfundimtare. Pas kësaj, gjykata

i dorëzon akuzën jurisë mbi çdo çështje në përputhje me rrethanat. Në akuzën e saj, gjykata duhet të udhëzojë jurinë se për sa ka të bëjë me çdo rast vrasje të shkallës së parë, juria duhet të marrë parasysh nëse duhet të praktikohet ose jo dënimi me vdekje, dhe se juria duhet të jetë unanime me secilin dënim. Gjithashtu, gjykata duhet të udhëzojë jurinë se në rast se juria nuk arrin marrëveshje unanime në lidhje me dënimin, gjykata do ta dënojë të akuzuarin me një periudhë burgimi, me minimumin e hapsirës kohore, midis 20-25 viteve dhe me maksimumin me burgim të përjetshëm. Sipas akuzës së gjykatës, juria do të tërhiqet për të diskutuar dënimin që do të ushtrohet. (...)"

58. Në çështjen Njerëzit kundër LaValle [3 NY 3d88 (2004)] Gjykata e Apelit të Nju Jorkut e anashkalon statutin e dënimit me vdekje (seksioni 400.27 (10) mësipër) duke e deklaruar udhëzimin pengesë për jurisë si jo kushtetues me Kushtetutën e Shtetit. Gjykata e hedh poshtë udhëzimin pengesë sepse "ai krijon rrezikun e madh që të detyrojë antarët e jurisë të dënojnë të akuzuarin me dënim me vdekje, duke thyer ... Klausolën Në Proces e Sipër".

59. Në çështjen Njerëzit kundër Taylor [9 Nyrd 129 (2007)] Gjykata e Apelit e Nju Jorkut rikonfirmoi se statuti për dënimin me vdekje ishte jo kushtetues siç ishte përcaktuar në çështjen LaValle. Ajo përcaktonte, inter alia, se:

"Ashtu si në çështjen LaValle, jemi mbledhur sot nisur nga natyra e parevokueshme e dënimit kapital, si edhe për "nevojën tjetër për siguri më të madhe për pasojën e dënimeve kapitale të jurisë (referenca është e hequr). Ne nuk biem dakort me pretendimin se Gjykata bëri gabim në çështjen LaValle, apo që takimet tona ishin dicta, dhe kështu mbesim saktësisht aty ku ishim tre vjetë më parë: statuti i dënimit me vdekje nuk është kushtetues dhe nuk është brenda kompetencës sonë që të shpëtojmë statutin. Kështu, LaValle ngarkohet me precedentë të plotë. Legjislacioni, i kujdesshëm në mbrojtjen e procesit të Shtetit tonë, që është ende në zhvillim, mund të risjellë një statut dënues, i cili është i lirë nga detyrimi dhe vetdija për nevojat e një jurie që të mësojë pasojat e zgjedhjes së saj".

60. Sot, do të dukej sikur legjislacioni i Shtetit nuk ka nxjerrë ndonjë statut mbi ushtrimin e dënimit me vdekje. Për më tepër do të dukej sikur dënimi me vdekje nuk është ushtruar mbi asnjë të pandehur.

LIGJI

1. PRETENDIMET PËR THYERJEN E NENEVE 2 DHE 3 TË KUSHTETUTËS DHE TË NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR. 13 TË CILAT DALIN NË PAH NGA RREZIKU PËR USHTRIMIN E DËNIMIT ME VDEKJE

61. Ankuesi shprehu pakënaqsinë se ekstradimi i tij në Shtetet e Bashkuara dhe rreziku për t'iu nënshtruar dënimit me vdekje, thyejnë Nenet 2 dhe 3 të Konventës dhe Nenin 1 i Protokollit Nr. 13, të cilët pohojnë si më poshtë:

"Neni 2: E drejta e jetës

“1. E drejta e jetës e çdonjërit do të mbrohet me ligj. Asnjërit nuk do t’i privohet mbrojtja e jetës së tij gjatë ekzekutimit të një dënimi të gjykatës, pasi ai ka bërë një krim , për të cilin ky dënim parashikohet nga ligji.

2. Privimi i jetës nuk do të konsiderohet si shkaktar për shkeljen e këtij neni kur ai vjen si rezulatat i përdorimit të forcës, i cili është absolutisht i nevojshëm:

(a) Në mbrojtje të çdo personi për dhunë të paligjshme;”

(b) Për të patur ndikim mbi arrestin e ligjshëm ose për të ndaluar arratisjen e një personi i ndaluar në mënyrë ligjore;

(c) Në një akt të ndërmarrë në mënyrë të ligjshme për të ndaluar një protestë ose kryengritje.

Neni 3: Ndalimi i torturave

“Asnjë person nuk do të bëhet objekt i torturave, i trajtimit çnjerëzor apo degradues; apo i dënimit.”

Neni 1 i Protokollit 13: Heqja e dënimit me vdekje

“Dënimi me vdekje do të hiqet. Asnjë nuk do të dënohet apo ekzekutohet me këtë dënim. ”

A. Pranueshmëria

62. Qeveria parashtroi idenë se ankuesi nuk duhet të konsiderohet viktimë e dhunimit të Konventës, referuar vendimit të Gjykatës së Lartë, datë 26 Nëntor 2010, i cili kishte shfuqizuar vendimin e gjykatave të ulta dhe e kishte parashtruar çështjen për rishikim në Gjykatën e Rrethit.

63. Gjykata thekson se një vendim ose masë në favor të ankuesit , në parim, nuk është e mjaftueshme për të privuar individin nga statusi i tij/isaj si “viktimë”, në qoftë se autoritetet vendase nuk e kanë njohur shkeljen e Konventës as shprehimisht dhe as në përmbajtje, dhe më pas nuk e kanë korrigjuar situatën (shiko, mutatis mutandis, Mishgjoni kundër Shqipërisë, nr. 18381/05, § 42, 7 Dhjetor 2010).

64. Në çështjen konkrete, Gjykata vëren se vendimi i Gjykatës së Lartë u vu në zbatim menjëherë pas ekstradimit të ankuesit. Edhe pse ajo i pranoi thyerjet e një sërë parashikimeve ligjore nga gjykatat e ulta dhe e paraqiti çështjen për rishikim, përsëri nuk qe në gjendje të anullonte ekstradimin e ankuesit, i cili kishte ndodhur tashmë. Nën të tilla rrethana, ankuesi mund të vazhdojë të pretendojë se është “viktimë” e një shkelje të të drejtave të tij sipas Konventës për sa ka të bëjë me ekstradimin. Për këtë arsye, Gjykata e refuzon kundërshtimin e tij.

65. Gjykata mendon se kjo ankesë nuk është krejt e pa bazuar në fakte, nëse i referohemi Nenit 35 § 3 (a) të Konventës. Më tej ajo pohon se nëse bazohemi në të dhëna, ajo nuk është e papranueshme. Kështu, ajo duhet të deklarohet e pranueshme.

B. Cilësitë

1. Materialet e dorëzuara nga palët

66. Ankuesi deklaron se në bazë të dokumentave të dorëzuara nga autoritetet e Shteteve të Bashkuara, ekzistonte rreziku që mbi të të ushtrohej dënimi kapital. Ai argumenton se kjo alternativë nuk u mor aspak në konsideratë nga Gjykata e Rrethit dhe Gjykata e Apelit të cilat urdhëruan ekstradimin e tij. Ai u përforcua më tej nga vendimi i Gjykatës së Lartë i datës 26 Nëntor 2010. Gjithashtu, ai bëri kërkesë për cilësinë e sigurisë së ofruar nga autoritetet e Shteteve e Bashkuara me anë të shënimeve diplomatike: i vetmi autoritet përgjegjës për dhënien e kësaj sigurie duhej të ishte Avokati i Përgjithshëm. Aplikuesi ftoi Gjykatën të shpërfillte vendimet e Gjykatës së Apelit të Nju Jorkut, për arsye se krimet me të cilat ai ishte akuzuar ishin krime federale dhe ligji i bazuar në vendimet e mëparshme nuk zbatohej. Avokati i ankuesit i kërkoi Gjykatës të mos e merrte parasysh procesverbalin e seancës gjyqsore të datës 19 Korrik 2011, për arsye se ishte lëshuar në rrethana dhune dhe keqtrajtimi (shiko paragrafin 41 mësipër).

67. Qeveria deklaroi se gjykatat vendase i kishin shqyrtuar objektivisht dhe i kishin kundërshtuar argumentat e ankuesit në lidhje me dënimin me vdekje. Shtete e Bashkuara më anë të shënimeve diplomatike nr. 91 të datës 8 Nëntor 2010 dhe nr. 22 të datës 24 Shkurt 2011, i kishin ofruar siguri autoriteteve shqiptare se dënimi me vdekje as nuk do të kërkohej dhe as nuk do të ushtrohej mbi ankuesin. Më tej, Qeveria u mbështet në ligjin e nxjerrë nga vendimet më të hershme nga Gjykata e Apelit të Nju Jorkut, i cili e shpallte dënimin me vdekje anti kushtetues. Për më tepër, sipas Qeverisë, dënimi me vdekje nuk ushtrohej në Nju Jork që prej vitit 1977.

68. Gjithshtu, Qeveria mbështetej në dorëheqjen nga akuza, të cilën ankuesi e kishte firmosur me vullnetin e tij, nën asistencën e avokatit (shiko paragrafin 41 mësipër). Sipas Qeverisë, mundësia për t'iu nënshtruar dënimit me vdekje nuk u përmend në seancën gjyqsore dhe kështu, nuk ekzistonte asnjë mundësi për ushtrimin e dënimit me vdekje në këtë çështje.

2. Përcaktimi i Gjykatës

(a) Parimet e përgjithshme

69. Gjykata i referohet parimeve të përgjithshme të parashtruara në vendimin e saj për çështjen Al-Saadoon dhe Mufdhi kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 61498/08, §§ 115-127, GJEDNJ 2010 (ekstrakte), veçanërisht:

“118. (...) për sa ka të bëjë me të gjithë ato shtete të cilët janë të varur prej tij, e drejta sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 13 për të mos iu nënshtruar dënimit me vdekje, i cili nuk pranon asnjë anashkalim dhe ushtrohet në të gjitha rrethanat, vendoset përkrah të drejtave në Nenet 2 dhe 3 si një e drejtë themelore, duke respektuar një nga vlerat bazë të shoqërive demokratike, antare të Këshillit të Europës. Si i tillë, parashikimet e tij duhen përcaktuar në mënyrë strikte (referencat janë hequr).

...

120. (...) Këto përshkrime, sëbashku me praktikën e vazhdueshme të Shtetit për vëzhgimin e moratoriumit për dënimin kapital, janë tregues të fortë se Neni 2 është amenduar për të ndaluar dënimin me vdekje në të gjitha rrethanat. Në kundërshtim me këtë situatë, Gjykata nuk merr parasysh se shprehja në fjalinë e dytë të Nenit 2 § 1 vazhdon të jetë në mbrojtjen e të akuzuarit me interpretin e saj të fjalëve “trajtim apo dënim degradues ose çnjerëzor” në Nenin 3, duke përfshirë edhe dënimin me vdekje (është hequr referenca).

...

122. Neni 3, i cili ndalon kategorikisht torturën dhe trajtimin apo dënimin çnjerëzor apo degradues, respekton një nga vlerat themelore të shoqërive demokratike. Ai nuk përmban asnjë parashikim për përjashtime dhe sipas Nenit 15, nuk lejohet asnjë shkelje e tij, madje as në rastin e një emergjence publike që kërcënon jetën e kombit. Duke qenë se ndalimi i torturës dhe i trajtimit apo i dënimit çnjerëzor ose degradues është absolut, pavarësisht qëndrimit të viktimës, natyra e çdo krimi të kryer që supozohet të jetë kryer nga ankuesi nuk ka lidhje me qëllimet e Nenit 3 (referenca është hequr).

123. Më tej, Gjykata përsërit se dëbimi nga një Shtet Kontraktues mund të ngrejë një çështje sipas Nenit 3, dhe sipas Konventës të bëjë përgjegjës Shtetin tek i cili janë paraqitur mjaftueshëm të dhëna të rëndësishme për të besuar se personi në fjalë, në rast largimi nga vendi i vet, përballet me rrezikun real për t’iu nënshtruar një mënyre trajtimi që bie ndesh me Nenin 3. Në një rast të tillë, Neni 3 parashtron detyrimin për të mos e larguar personin në fjalë në atë shtet (referenca është hequr).

124. Në një rast të tillë, Gjykata mblidhet për të vlerësuar situatën në shtetin pritës sipas kërkesave të Neneve të mësipërm. Megjithatë, asnjëherë nuk shtrohet çështja për të gjykuar apo për të bërë përgjegjes shtetin pritës, si nga ligji i përgjithshëm ndërkombëtar, nga Konventa apo nga ndonjë formë tjetër. Megjithatë, pavarësisht detyrimeve të vendosura ose që mund të vendosen sipas Konventës, janë detyrimet e vendosura nga Shteti Kontraktues (i cili ka ndërmarrë edhe veprimin) ato të cilat kanë pasojë të drejtëpërdrejtë ndaj individit për ta ekspozuar atë kundrejt rrezikut për t’u larguar nga vendi i tij dhe për t’u keqtrajtuar (referenca është hequr).

...

127. Gjykata duhet të ketë parasysh karakterin e veçantë të Konventës si një traktat për zbatimin e përbashkët të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ajo duhet të udhëhiqet nga fakti se synimi i Konventës, si një instrument për mbrojtjen e qënieve njerëzore, kërkon që parashikimet e saj të interpretohen dhe të zbatohen në mënyrë të tillë që ta bëjnë mbrojtjen e saj në vlera praktike dhe të efektshme (referncat janë hequr).

128. Sipas Nenit 1 të Konventës, është pranuar që një Palë Kontraktuese është përgjegjëse për të gjitha aktet dhe pakujdesitë e organeve të saj, pavarësisht faktit nëse akti ose pakujdesia në fjalë erdhi si rezultat i ligjit vendas apo nevojës për t'u pajtuar me detyrimet ligjore ndërkombëtare. Neni 1 nuk bën dallime për llojin e vendimit apo masës në fjalë dhe nuk përjashton asnjë pjesë të "juridiksionit" të Palës Kontraktuese nga një hetim i hollësishëm në përputhje me Konventën (referenca është hequr). Supozohet që Shteti mban detyrimet e vendosura nga Konventa në përputhje me zotimet e traktatit, sapo Konventa hyn në forcë (referenca është hequr). Për shembull, në rastin e Soering (referenca është hequr) ... sipas Nenit 3 të Konventës, u bë e detyrueshme që një i arratisur të mos dorëzohej në një Shtet tjetër, ku ka mjaftueshëm të dhëna për të besuar se ekziston rreziku që ai mund të bëhet objekt i torturave apo i trajtimit ose i dënimit çnjerëzor dhe degradues. Ky detyrim u vendos për t'i dhënë përparësi detyrimevë të Mbretërisë së Bashkuar bazuar në Traktatin e Ekstradimit për të cilin kishte rënë dakort me Shtetet e Bashkuara, në vitin 1972".

(b) Zbatimi i parimeve të mësipërme në çështjen konkrete

70. Në rastin konkret, ankuesi u arrestua me synimin për t'u ekstraduar në Shtete e Bashkuara. Më 30 Gusht 2010, autoritetet e Shteteve të Bashkuara kërkuan në mënyrë zyrtare ekstradimin e tij, intera lia, mbi një akuzë kapitale. Më 30 Shtator 2010 dhe 1 Nëntor 2010, Gjykata e Rrethit dhe Gjykata e Apelit respektivisht, morën vendimin në favor të ekstradimit të ankuesit. Është për të ardhur keq që gjykatat e ulta ranë dakort që të lejonin ekstradimin e ankuesit pa ekzaminuar mundësinë e rrezikut të pretenduar nga ai. Është shokues fakti se gjykatat e ulta nuk kërkuan kurrë siguri nga Qeveria që bënte kërkesën, se dënimi me vdekje nuk do të jepej nëse ankuesi dënohej (shiko paragrafët 13 dhe 16 më sipër). Kjo problematikë u ngrit si çështje gjatë procedurave përpara Gjykatës së Lartë, fazë në të cilën, me keqardhje, ankuesi ishte ekstraduar (shiko paragrafët 24 dhe 25 më sipër). Në lidhje me këtë situatë, Gjykata kujton se Protokolli Nr. 13, i cili në Shqipëri hyri në fuqi më 1 Qershor 2007, së bashku me detyrimet e Shtetit përgjegjës bazuar në Nenet 1, 2 dhe 3 të Konventës, pohonte se, për çfarëdo arsye, ai nuk do t'i ndalonte individët me synimin për t'i ekstraduar ata dhe më pas të gjykoheshin me akuza kapitale. Gjithshtu, Shteti përgjegjës brenda juridiksionit të tij, nuk duhet t'i bënte në asnjë mënyrë individët subjekt të një rreziku real për t'u dënuar me dënim me vdekje dhe më pas të ekzekutoheshin (shiko, mutatis mutandis, Al-Saadoon dhe Mufdhi, cituar më sipër §§ 137), nëse nuk kërkohej dhe ofrohej siguri e mjaftueshme dhe e detyrueshme nga autoritetet përgjegjëse të Shtetit që bënte kërkesën.

71. Megjithatë, përpara ekstradimit të ankuesit më 24 Nëntor 2010, dhe në përgjigje të kërkesës së Ministrit shqiptar të Drejtësisë për siguri kundër dënimit me vdekje, më 8 Nëntor

2001, Ambasada e Shteteve të Bashkuara, me anë të një shënimi diplomatik, pohon se "dënimi me vdekje as nuk do të kërkohet dhe as nuk do të ushtrohet kundër [ankuesit] pas ekstradimit të tij në Shtetet e Bashkuara."

72. Gjykata pohon se në çështjet e ekstradimit, shënimet diplomatike janë mjete standarde për Shtetin që bën kërkesën për të dhënë çdo siguri, të cilën, Shteti të cilit i është paraqitur kërkesa, e konsideron të nevojshme për të dhënë miratimin e tij për ekstradim. Gjithashtu, ajo pohon se në marrëdhëniet ndërkombëtare, shënimet diplomatike japin idenë e mirëbesimit. Gjykata mendon se në çështjet e ekstradimit, është me vend që të ketë hamendësime dhe jo siguri të plotë rreth një Shteti i cili ka paraqitur kërkesën dhe i cili gjithësesi ka një histori të gjatë respekti për demokracinë, të drejtat e njeriut dhe fuqinë e ligjit, dhe i cili ka marrëveshje të gjata ekstradimi me Shtetet Kontraktuese (shiko Babar Ahmad dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar (vendim) nr. 24027/07, 11949/08 dhe 36742/08, § 105, 6 Korrik 2010). Për këtë arsye, Gjykata do të vlerësojë cilësinë e sigurisë së dhënë dhe nëse ajo mund ta besojë atë bazuar në praktikat e Shtetit i cili ka paraqitur kërkesën.

73. Gjykata nuk gjen asnjë fakt në materialet e paraqitura përpara saj që mund të ngjallë dyshime mbi sigurinë që dënimi kapital nuk do të kërkohet apo të ushtrohet mbi ankuesin nga Shteti i cili ka paraqitur kërkesën. Siguria e dhënë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës ishte specifike, e qartë dhe aspak ekuivoke. Siç u konfirmua më vonë në një tjetër shënim diplomatik të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara, më 24 Shkurt 2001, "kjo siguri është e detyrueshme për Departamentin e Drejtësisë së Shteteve të Bshkuara". Më tej, Gjykata duhet t'i japë rëndësi faktit se nën kontekstin e një kërkese për ekstradim, asnjëherë nuk janë raportuar shkelje të sigurisë së dhënë nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara kundrejt një Shteti Kontraktues. Vetëm interesi afatgjatë i Shteteve të Bashkuara për të respektuar angazhimet e veta mbi ekstradimet do të ishte i mjaftueshëm për të dhënë mirëbesimin dhe heqjen e çdo dyshimi për të mundësinë e rrezikut që kjo siguri të shkelej (shiko Babar Ahmad dhe të Tjerët (vendim), cituar mësipër, §§ 107-8). Së fundmi, siç evidentohet edhe nga procesverbali i datës 19 Korrik 2011, në të cilin ankuesi pranon fajësinë ndaj akuzave, Shtetet e Bashkuara nuk kanë përmendur asnjë rrezik që mund të përballë ankuesin me dënimin me vdekje.

74. Nën rrethanat e paraqitura më sipër, Gjykata mendon se ekstradimi i ankuesit në Shtetet e Bashkuara nuk përbën shkelje të Neneve 2 dhe 3 të Konventës dhe të Nenit 1 të Protokollit Nr. 13 për sa ka të bëjë me rrezikun për ushtrimin e dënimit me vdekje.

II. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 34 TË KONVENTËS

75. Ankuesi paraqiti ankesën se ekstradimi i tij në Shtetet e Bashkuara, i cili ishte shkelje e udhëzimit të Gjykatës bazuar në Venidimin 39 të Vendimeve të Gjykatës, nuk respektonte Nenin 34 të Konventës, i cili parashikon:

"Gjykata mund të marrë ankesa nga çdo person, organizatë jo qeveritare ose grup individësh të cilët pretendojnë se janë viktima të një dhunimi të kryer nga një nga Palët e Larta Kontraktuese, në lidhje me të drejtat e përcaktuara në Konventë ose në Protokolle. Palët e

Larta Kontraktuese ndërmarrin të mos pengojnë në asnjë lloj mënyre ushtrimin e efektshëm të kësaj të drejte."

A. Pranueshmëria

76. Gjykata pohon se kjo ankesë nuk është e pabazuar në fakte, nëse i referohemi Nenit 35 § 3 (a) të Konventës. Më tej ajo pohon se ajo nuk është e papranueshme bazuar në disa të dhëna. Për këtë arsye, ajo duhet të deklarohet e pranueshme.

B. Cilësitë

1. Materialet e dorëzuara nga palët

77. Ankuesi pretendonte se ka patur shkelje të Nenit 34 të Konventës si rezultat i moszbatimit të masës së përkohshme të Gjykatës nga autoritetet Shqiptare. Ai argumenton se përkrahja e dëshirave të një ambasade të huaj bie ndësh me shpirtin e supremacisë së Konventës në rendin ligjor vendas.

78. Në lidhje me pengesat objektive për të respektuar masën paraprake të Vendimit 39, ankuesi argumentoi se, në përputhje me Nenin 266 § 1 të KPP, përveç masës së ndalimit, për autoritetet kishte edhe masa të tjera të disponueshme. Për më tepër, Qeveria nuk bëri përpjekje për të informuar Gjykatën për ekzistencën e ndonjë pengese objektive përpara ekstradimit të ankuesit.

79. Qeveria u shpreh se autoritetet nuk kishin si synim të mos respektonin detyrimet që dilnin nga masa paraprake e Vendimit 39 të Gjykatës. Duke patur parasysh natyrën komplekse të çështjes së ankuesit, rrezikun shoqëror që ai përbënte dhe detyrimet që dilnin nga zotime të tjera ndërkombëtare, autoritetet u përpoqën që të gjenin zgjidhjen më të mirë. Duke iu referuar rrethanave përjashtuese të çështjes, Qeveria i kërkoi Gjykatës të ishte fleksibël në vlerësimin e fakteve të cilat sollën ekstradimin e ankuesit.

80. Qeveria shpjegoi se ekstardimi i ankuesit u urdhërua nga vendimi i Gjykatës së Apelit, i datës 1 Nëntor 2010, i cili ishte përfundimtar dhe kishte kërkuar zbatimin e res judicata. Sipas saj, Neni 499 §§ 1 i KPP i parashikonte lirimin e ankuesit nëse Ministria e Drejtësisë nuk urdhëronte ekstradimin e tij brenda një muaji nga data e vendimit të Gjykatës së Apelit, pavarësisht faktit se apelimi i ankuesit ishte ende pezull përpara Gjykatës së Lartë. Qeveria sqaroi se ligji vendas nuk parashikonte vazhdimin e masës së ndalimit me burg nëse Gjykata e Lartë vendoste që ta falte një çështje. Për pasojë, duke qenë se ligji nuk detyronte vazhdimin e gjendjes së arrestit për ankuesin, interpretimi ligjor ishte në favor të të akuzuarit, i cili në fund do të përfundonte me lirimin e tij. Në rastin konkret, nëse autoritetet do ta kishin liruar ankuesin, Qeveria do të gjendej përpara situatës së shkeljes së parashikimeve të Traktatit të Ekstradimit. Nëse autoritetet nuk do ta kishin ekstraduar ankuesin më 1 Dhjetor 2010, atyre do t'iu ishte dashur da linin atë në gjendje të lirë në mbështetje të Nenit 499 §§ 1

të KPP. Për pasojë, Ministri i Drejtësisë u përballë me një pengesë objektive për të realizuar përmbushjen e masës së përkohshme të Gjykatës.

2. Përcaktimi i Gjykatës

(a) Parimet e përgjithshme

81. Masat e përkoshme në përputhje me Vendimin 39 të Vendimeve të Gjykatës përdoren vetëm në sfera të kufizuara. Në praktikë, Gjykata e përdor një masë të tillë vetëm nëse ka rrezik të shkaktohen dëme të pariparueshme. Duke qenë se në Konventë nuk ka asnjë parashikim specifik në lidhje me fushat në të cilat do të aplikohet Vendimi 39, kërkezat për zbatimin e tij zakonisht kanë të bëjnë me të drejtën e jetës (Neni 2), të drejtën për të mos u bërë objekt dhunimi apo trajtimi çnjerëzor (Neni 3) dhe veçanërisht, të drejtën për të respektuar jetën private dhe atë familjare (Neni 8) ose të drejta të tjera të garantuara nga Konventa (shiko Mamatkulov dhe Askarov kundër Turqisë, nr/ 46827/99 dhe 46951/99, § 104, GJEDNJ 2005-I). Sipas sistemit të Konventës, masat e përkohshme luajnë një rol thelbësor në shmangien e sitauatave të pakthyeshme të cilat do ta pengonin Gjykatën të ekzaminonte saktë aplikimin dhe ku të ishte e mundur, t'i siguronte ankuesit përfitimin praktik dhe efikas të të drejtave të Konventës që ai kërkonte. Në këto kushte, nëse shteti përgjegjës nuk përmbushte masat paraprake, do të kishte efikasitet të të drejtës së ankimit të individit, e garantuar nga Neni 34 dhe nga sipërmarrja formale e Shtetit në Nenin 1 për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Konventë (Mamatkulov, cituar më sipër, § 125).

82. Neni 34 do të shkelej nëse autoritetet e Shtetit Kontraktues nuk do të arrijnë të ndërmarrin të gjitha hapat të cilat do të duhej të ishin ndërmarrë për të përmbushur masën e përkohshme të përdorur nga Gjykata (Paladi kundër Moldavisë, nr. 39806/05), § 88, 10 Mars 2009). Gjatë ekzaminimit të një kërkese kundër Nenit 34 në lidhje me pretendimin se Shteti Kontraktues nuk përmbushi masën e përkohshme, Gjykata nuk do të rikthehet të shqytojë nëse vendimi i saj për zbatimin e masave të përkohshme ishte i saktë. I takon Qeverisë përgjegjëse t'i demonstrojë Gjykatës nëse masa e përkohshme u përmbush. Ose në një rast përjashtues, ajo duhet të demonstrojë se pati një pengesë reale e cila ndaloi përmbushjen e masës së përkohshme, dhe se Qeveria mori të gjitha hapat e nevojshme për ta hequr këtë pengesë dhe për ta mbajtur Gjykatën të informuar rreth situatës (Paladi, cituar mësipër, § 92; Grori kundër Shqipërisë, nr. 25336/04, § 184, 7 Korrik 2009; dhe Al-Saadoon dhe Mufdhi, cituar mësipër, § 161).

(b) Aplikimi i parimeve të mësipërme për çështjen në fjalë

83. Gjykata pohon se fillimisht Qeveria përgjegjëse u informua në lidhje me masën e përkohshme sipas Vendimit 39, të datës 12 Tetor 2010, me anë të një faksi dhe poste. Sipas kësaj mase ankuesi nuk do të ekstradohej "deri sa të plotësohej harku kohor prej dhjetë ditësh pasi vendimi i Gjykatës së Apelit iu bë i njohur Gjykatës". Zgjatja e aplikimit të masës së përkohshme "deri në pesëmbëdhjetë ditë pasi Gjykata e Lartë i bëri të njohur Gjykatës vendimin e saj", dhe iu komunikua me anë të faksit dhe postës Qeverisë përgjegjëse më 2

Nëntor 2010. Pavarësisht sigurisë së ofruar nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara, më 18 Nëntor 2010, Qeveria u informua se masa e përkohshme vazhdonte të zbatohej. Megjithatë, ankuesi u ekstradua më 24 Nëntor 2010. Ishte e qartë se masa e përkohshme nuk u zbatua.

84. Gjykata do të përcaktojë nëse kishte pengesa të dukshme të cilat e penguan Qeverinë të përmbushte masën, dhe nëse ajo mori të gjitha masat e arsyeshme për të hequr pengesën dhe për ta mbajtur Gjykatën të informuar rreth situatës (shiko Grori, cituar mësipër, § 188).

85. Fillimisht, Gjykata nuk e pranon argumentin e Qeverisë se me ekstradimin e ankuesit, ata përmbushnin vendimin final të Gjykatës së Apelit, të datës 1 Nëntor 2010. Për qëllime të Konventës, një vendim final , i cili është bërë res judicata, është një vendim i cili nuk bëhet objekt kontrolli nga një gjykatë më e lartë, dhe përfundimisht, shfuqizohet (shiko mutatis mutandis, Gjyli kundër Shqipërisë, nr. 32907/07, §§ 33-34, 29 Shtator 2009). Ndërsa vendimi konkret i Gjykatës së Apelit u shfuqizua në mënyrë të ligjshme nga vendimi i Gjykatës së Lartë, i datës 26 Nëntor 2010 dhe ato procedura janë ende pezull.

86. Gjykata nuk mund ta pranojë argumentin e Qeverisë se mos ekstradimi i ankuesit do të kishte ndërhyrë në detyrimet ndërkombëtare të Shqipërisë, duke iu referuar Traktatit të Ekstradimit të vitit 1935. Në këto rrethana, Gjykata i referohet ligjit të saj të nxjerrë bazuar në vendime të çështjeve të mëparshme, dhe të përmbledhur në vendimin Al-Saadoon dhe Mufdhi për të treguar se Konventa synon të ruajë të drejtat që janë "praktike dhe të efektshme" dhe se një Shtet përgjegjës supozohet se e respekton detyrimin e Konventës, për sa ka të bëjë me angazhimin ndaj traktatit përpara ose menjëherë sapo Konventa hyn në fuqi (shiko, për shembull, paragrafin 69 mësipër). Për më tepër, në vendimin Al-Saadoon dhe Mufdhi, Gjykata pohon se "nuk është e mundur për një Shtet Kontraktues të hyjë në marrëveshje me një Shtet tjetër, i cili bie në kundërshtim me detyrimet e tij bazuar në Konventë. Ky parim mban të gjithë fuqinë .... duke iu referuar natyrës absolute dhe themelore të së drejtës për të mos u bërë objekt i dënimit me vdekje dhe i një dëmtimi të rëndë dhe të pakthyeshëm" i cili i kanoset ankuesit (shiko paragrafin 138 e vendimit të përmendur). Fakti se dëmtimi, të cilin ka për qëllim ta parandalojë një masë e përhershme, nuk materializohet, pavarësisht pamundësisë së Shtetit për të vepruar në përputhje të plotë me masën e përkohshme, nuk ndihmon në vlerësimin nëse Shteti përgjegjës i ka përmbushur detyrimet e tij bazuar në Nenin 34 (shiko Grori, cituar mësipër, § 194; dhe, Paladi, cituar mësipër, § 89).

87. Në përfundim, Gjykata e kundërshton agumentin e Qeverisë se ekstradimi i ankuesit ishte i pashmangshëm, duke iu referuar përfundimit të afërt të periudhës së tij të ndalimit dhe mungesës së çdo alternative për të shmangur lirimin e tij. Pikë së pari, nuk kishte asnjë bazë ligjore për ekstradimin e ankuesit pas vendimit të Gjykatës së Lartë më 26 Nëntor 2010. Më tej, Gjykata vëren se edhe pse limiti kohor për ekstradimin e ankuesit u shty deri më 1 Dhjetor 2010 (shiko paragrafin 23 mësipër), ai u largua fizikisht më 24 Nëntor 2010, lëvizje e bërë dy ditë përpara vendimit të Gjykatës së Lartë. Së dyti, as gjendja ekzistuese e ligjit kombëtar e interpretuar nga Qeveria, veçanërisht pamundësia ligjore për vijimësinë e ndalimit përtej limitit kohor të parashikuar në Nenin 499 të KPP, dhe as defiçencat e hasura nga autoritetet në përpjekje për të arritur objektivat e tyre legjislative dhe ligjvënëse, nuk

mund të ndikonin në ndalimin e ankuesit, në mungesë të një vendimi gjykate final, i cili autorizonte ekstradimin e tij, ose shmangte apo mohonte detyrimet e Shtetit përgjegjës bazuar në Konventë (shiko, mutatis mutandis, M.S.S kundër Belgjikës dhe Greqisë, nr. 30696/09, § 321, GJEDNJ 2011); Abdolkhani dhe Karimnia kundër Turqisë, nr. 30471/08, §§ 113-117, 22 Shtator 2009; Čonka kundër Belgjikës, nr. 51564/99, § 84, GJEDNJ 2002-I; Jabari kundër Turqisë, nr. 40035/98, §§ 49-50, GJEDNJ 2000-VIII . Së treti nuk ka asnjë tregues se autoritetet patën parasysh mundësinë për ndërmarrjen e hapave për heqjen e rrezikut të fluturimit me të cilin do të udhëtonte ankuesi nëse ai do të lihej i lirë, për shembull ushtrimi i formave të tjera kërcënuese të masave të sigurisë, siç parashikohet në KPP (shiko paragrafët 47 dhe 48 mësipër). Së katërti, autoritetet nuk e informuan paraprakisht Gjykatën për ekstradimin, për vështirësitë e hasura prej tyre për përmbushjen e masës së përkohshme.

88. Në këto rrethana, Gjykata del në përfundimin se mospërmbushja e masës së përkohshme nga ana e autoriteteve vendase, në mungesë të një justifikimi abjektiv, përbën dhunim të Nenit 34 të Konventës.

IV. PRETENDIME PËR SHKELJE TË TJERA TË KONVENTËS

89. Ankuesi shprehu pakënaqsinë e tij duke pretenduar për një thyerje të Nenit 3 të Konventës në lidhje me ushtrimin e një dënimi me burgim të përjetshëm pa lirim me kusht nga gjykatat e Shteteve të Bashkuara. Qeveria pohoi se ankuesi nuk e kishte ngritur ankesën e tij përpara gjykatave vendase.

90. Gjykata kujton se ushtrimi i dënimit me burgim të përjetshëm tek një i pandehur i rritur, as nuk është i ndaluar nga Neni 3 apo nga ndonjë parashikim tjetër i Konventës, dhe as nuk është i pa aplikueshëm (shiko, midis shumë urdhrave të tjerë, Bamber kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 13183/87, vendim i Komisionit, datë 14 Dhjetor 1988, dhe Saëoniuk kundër Mbretërisë së Bashkuar (vendim), nr. 63716/00, GJEDNJ 2001-VI). Nuk ndodh në çdo çështje përjashtuese që ankuesi të jetë në gjendje të demonstrojë se dënimi me të cilin ai/ajo do të përballet në një Shtet jo kontraktues, do të ishte jashtëzakonisht në dispropocion dhe gjithashtu do të ishte në kundërshtim me Nenin 3, në momentin e ushtrimit të tij (shiko Harkins dhe Edëards kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 9146/07 dhe 32650/07, § 134, i datës 17 Janar 2012). Në mungesë të një disproporcioni kaq të madh, do të ngrihet një çështje e Nenit 3 për një dënim të detyrueshëm me burgim të përjetshëm, pa mundësi lirimi me kusht në po të njëjtën mënyrë si për një dënim të arsyeshëm me vdekje, kur ai të mund të tregohet se: (i) burgimi i vazhdueshëm i ankuesit nuk mund të justifikohet më, me asnjë të dhënë legjitime ; dhe (ii) dënimi është i pareduktueshëm de facto dhe de iure (shiko Harkins dhe Edëards, cituar mësipër, § 138; dhe, Kafkaris kundër Qipros, nr. 21906/04, § 98, GJEDNJ 2008).

91. Në rrethanat e çështjes aktuale, Gjykata mendon, sepse mendohet se kjo kërkesë nuk është e bazuar në fakte për arsyet e mëposhtme. Në kohën kur ankuesi dorëzoi ankesën e tij,

ai nuk ishte dënuar ende, dhe as nuk kishte filluar të vuante dënimin e tij. Gjykata mendon se nëse ankuesi do të kishte qenë i dënuar, dënimi i mundshëm që do t'i jepej atij nuk do të kishte qënë kaq në disproporcion, duke marrë në konsideratë akuzat për të cilat ai akuzohej dhe marrëveshjen për falje që ai kishte bërë në mënyrë të vullnetshme dhe me vetdije. Për më tepër ankuesi nuk tregoi se, pasi të ekstradohej burgimi i tij në Shtetet e Bashkuara nuk do të shërbente për ndonjë qëllim legjitim. Në të vërtetë, nëse atij do t'i ishte dhënë dënimi i detyruar me vdekje, në këtë pikë do të ndodhte që burgimi i tij nuk do të shërbente për ndonjë qëllim dhe në fakt nuk do të kishte arsye që ai të jepej si alternativë. Në përfundim, Gjykata pohoi se ankuesi, në fakt, ishte dënuar nga Gjykata e Shteteve të Bashkuara me 80 muaj burgim (shiko paragrafin 44 mësipër). Kështu, Gjykata mendon se kjo ankesë nuk është e bazuar në fakte dhe duhet hedhur poshtë në përputhje me Nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

92. Më tej ankuesi u ankua se arresti i tij dhe më pas ndalimi me burgim përbënin thyerje të Nenit 5 § 1 të Konventës. Qeveria pohoi se arrestimi dhe më pas ndalimi me burgim ishin bërë mbi një bazë ligjore sipas ligjit vendas.

93. Gjykata pohon se ankuesi u ndalua si një person "kundër së cilit është ndëmarrë masa me objektiv ... ekstradimin" dhe ky ndalim ishte bërë në mbështetje me Nenin 5 § 1 (f). Megjithatë, palët debatuan nëse ky ndalim ishte "i ligjshëm" sipas Nenit 5§ 1 të Konventës.

94. Në rastet kur "ligjshmëria" e ndalimit me burgim vihet në dyshim, Konventa i referohet kryesisht ligjit vendas dhe vendos detyrimin për t'u përballur me rregullat ekzistuese dhe proceduriale. Vetëm përmbushja e ligjit kombëtar nuk është e mjaftueshme. Neni 5 § 1 kërkon që çdo privim i lirisë duhet të ketë parasysh që të mbrojë individin nga arbitrariteti (shiko, për shembull, Saadi kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 13229/03, § 67, GJEDNJ 2008).

95. Në çështjen konkrete, ankuesi u arrestua më 2 Korrik 2010. Arrestimi i tij u bë i vlefshëm në përputhje me ligjin e gjykatave vendase, i cili mbështetej me udhëzimin ndërkombëtar për individët në kërkim dhe Neni XI i Traktatit të Ekstradimit. Gjykata pohon se Traktati i Ekstradimit lejon arrestin me burgim për dy muaj në pritje për kërkesën zyrtare për ekstradim nga Shteti i cili ka bërë kërkesën. Kjo periudhë e cila shtrihet midis datës së arrestimit të ankuesit dhe datës në të cilën Shtetet e Bashkuara bënë kërkesën për ekstradim (2 Korrik dhe 30 Gusht 2010), shënon më pak se dy muaj. Gjykata nuk ka fakte mbi të cilat të konkludojë se ndalimi me burgim i ankuesit, përpara marrjes së kërkesës zyrtare të Shteteve të Bashkuara për ekstradim, ishte e "paligjshme" vetëm sepse mungonte një kërkesë zyrtare për ekstradim (shiko Khodzhayev kundër Rusisë, nr. 52466/08, § 137, 12 Maj 2010).

96. Për sa ka të bëjë me zbatimin e ndalimit me burgim në përputhje me ligjin vendas, Gjykata vëren se gjykatat vendase, në momentin kur vendosën zgjatjen e ndalimit të tij, vepruan në përputhje me Nenin 493 të KPP. Zgjatja e ndalimit të tij u bazua në vendimet juridike. Më tej, kohëzgjatja e të gjithë ndalimit, e cila është katër muaj dhe njëzet e dy ditë, nuk ishte jashtësakonisht e gjatë dhe justifikohej me rregullat e proceduart e ekstradimit. Për

më tepër, Gjykata nuk pranon që gjykatave vendase ju mungonte kujdesi gjatë ekzaminimit të çështjes së ankuesit (shiko Quinn kundër Francës, 22 Mars 1995, § 48, Seria A nr. 311).

97. Në këtë mënyrë, Gjykata mendon se kjo ankesë nuk është e bazuar në fakte dhe nuk duhet pranuar, sipas Nenit 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

IV.ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

98. Neni 41 i Konventës parashikon:

"Nëse Gjykata vërteton se ka patur dhunim të Konventës ose të Protokollit, dhe nëse ligji i brendshëm i Palës së Lartë Kontraktuese e lidhur më çështjen, lejon vetëm riparimin e pjesshëm, nëse është e nevojshme, Gjykata do të japë kompensim për palën e dëmtuar".

A. Dëmi

99. Ankuesi deklaroi se ndërsa është e vështirë që dëmi i tij të llogaritet në mënyrë preçize në vlerë monetare, kjo e fundit nuk duhet të jetë më pak se 18, 000 (EUR). Kjo shumë përfshinte rrogën e tij, tarifat e studimit të tij and shuma që kompensonte privimin e lirisë të ashtëquajtur të padrejtë. Më tej, ai kërkoi Eur 30,000 për sa ka të bëjë me dëmin jo monetar.

100. Qeveria i kundërshtoi kërkesat e ankuesit duke argumentuar se ato janë të ekzagjeruara dhe të paarsyeshme.

101. Në çështjen në fjalë, Gjykata pohon se ka patur thyerje të Nenit 34 të Konventës. Gjykata nuk mund të bëjë ndonjë lidhje midis dhunimit të konstatuar dhe dëmit monetar të kërkuar. Për sa ka të bëjë me çmimin për dëmin jo monetar, Gjykata mendon se fakti i pranuar për shkelje të Nenit 34 të Konventës përbën në vetvete kompensim të mjaftueshëm (shiko, për shembull, Al-Saadoon dhe Mufdhi, cituar mësipër, § 174).

B. Kostot dhe shpenzimet

102. Gjithashtu, ankuesi kërkoi 2,465,743 lekë shqiptarë (TË GJITHA) për kostot dhe shpenzimet e bëra përpara gjykatave vendase dhe ato të bëra përpara kësaj Gjykate. Më tej, ai kërkon 238,498.1 dollarë amerikanë (USD) për kostot dhe shpenzimet e bëra përpara gjykatave të Shteteve të Bashkuara. Ai paraqiti fatura të detajuara.

103. Qeveria i kundërshtoi kërkesat e ankuesit.

104. Gjykata pohon se vetëm kostot dhe shpenzimet ligjore që janë shpenzuar realisht dhe për nevoja të vërteta (në rastin e procedurave vendase, në rastin e kërkimit të kompensimit për shkeljen e Konventës ose për parandalimin e dhunimeve) dhe të cilat janë të arsyeshme në sasi, janë të mbulueshme në përputhje me Nenin 41 të Konventës (shiko, për shembull, Nikolova kundër Bullgarisë, nr. 31195/96, §§ 79, GJEDNJ 1999-II; Smith and Grady kundër

Mbretërisë së Bashkuar, nr. 33985/96 dhe 33986/96, § 28, GJEDNJ 1999-VI; dhe Roche kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 32555/96, § 182, GJEDNJ 2005-X).

105. Gjykata mendon se tarifat e avokatëve të ankuesit të domosdoshme për procedurat vendase, nuk përbëjnë shpenzime të nevojshme gjatë procesit për kërkimin e kompensimit për shkeljet e Konventës të konstatuara në çështjen konkrete. Megjithatë, duke patur paraysh dokumentet e detajuar mbështetës që janë dorëzuar, dhe duke bërë vlerësimin mbi baza të arsyeshme, Gjykata i akordon ankuesit EUR 1,500 në përputhje me procedurat e Strasburgut.

C. Mungesë interesi

106. Gjykata mendon se është e përshtatshme që shkalla e mungesës së interesit duhet të bazohet në shkallën marxhinale huadhënëse të Bankës Qendrore Europiane, së cilës i duhen shtuar pikë tre përqindëshe.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA NË MËNYRË UNANIME

1. Deklaron ankesën bazuar në Nenet 2 dhe 3 të Konventës dhe Nenin 1 të Protokollit Nr. 13 të ngritur nga rreziku për ushtrimin e dënimit me vdekje dhe ankesën bazuar në Nenin 34 të pranueshme; dhe pjesën tjetër të aplikimit të papranueshme;
2. Deklaron se ka patur shkelje të Neneve 2 dhe 3 të Konventës dhe të Nenit 1 të Protokollit Nr. 13 në rastin e ekstradimit të ankuesit në Shtetet e Bashkuara ;
3. Deklaron se ka patur shkelje të Nenit 34 të Konventës;
4. Deklaron

(a) Se pranimi për ekzistencën e një shkelje është kompensim i mjaftueshëm për dëmin jo monetar të vuajtur nga ankuesi;

(b) Se Shteti përgjegjës duhet ta paguaj ankuesin brenda tre muajve nga data në të cilën vendimi bëhet i formës së prerë, në përputhje me Nenin 44 § 2 të konventës, EUR 1,500 (një mijë e pesë qind euro), plus çdo taksë që mund të jetë e taksueshme në lidhje me kostot dhe shpenzimet, të konvertuar në vlerën monetare vendase sipas vlerës së shkëmbimit që është në fuqi datën kur bëhet shkëmbimi;

(c) Se nga data e përfundimit të tre muajve të përmendur mësipër deri në kompensim, interesi i thjeshtë do të jetë i pagueshëm mbi shumën e mësipërme me një shkallë të barabartë me shkallën marxhinale huadhënëse të Bankës Qendrore Europiane gjatë periudhës së mungesës plus pikë tre përqindëshe;

5. Në mënyrë unanime nuk pranon pjesën tjetër të kërkesës së ankuesit për kompensim.

E hartuar në anglisht dhe e paraqitur me shkrim më 25 Shtator 2012, në përputhje me Vendimin 77 §§ 2 dhe 3 të Vendimeve të Gjykatës.

Fatoş Aracı	Lech Garlicki
Zëvendës Sekretar	President

ÇËSHTJA "CANI KUNDËR SHQIPËRISË"

(Ankimi nr. 11006/06)

VENDIM

STRASBURG

6 mars 2012

Ky vendim do të marrë formë të prerë në rrethanat e përcaktuara në Nenin 44 § 2 të Konventës. Ai mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktues.

Në çështjen Cani kundër Shqipërisë,

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Katërt), duke gjykuar si Dhomë e përbërë nga:

Lech Garlicki, *President,*
David Thór Bjőrgvinsson,
Päivi Hirvelä,
George Nicolaou,
Ledi Bianku
Nebojŝa Vućinic, *gjykatës,*
dhe Fatoş Araci, *Zëvendës Regjistrues,*

Pas shqyrtimit me dyer të mbyllura më 8 nëntor 2011 dhe 14 janar 2012,

Shpall vendimin e mëposhtëm të miratuar në datën e përmendur së fundi:

PROCEDURA

1. Çështja e ka zanafillën në ankimin (nr. 11006/06) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar pranë Gjykatës sipas Nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ("Konventa") nga shtetasi shqiptar, Z. Besnik Cani ("ankuesi"), më 11 mars 2006.

2. Ankuesi u përfaqësua nga Z. V. Cano, avokat që ushtron aktivitetin e tij në Tiranë. Qeveria shqiptare ("Qeveria") u përfaqësua nga Agjentja e atëhershme e saj, Znj. S. Meneri dhe më pas nga Znj. E. Hajro.

3. Ankuesi pretendoi se procedimet e brendshme që përcaktonin dënimin e tij ishin të padrejta.

4. Më 1 shkurt 2008 Presidenti i Seksionit të Katërt të cilit iu caktua çështja, vendosi të njoftonte Qeverinë e paditur në lidhje me kërkesën. U vendos gjithashtu të merrej vendim mbi pranueshmërinë dhe themelin e kërkesës në të njëjtën kohë (Neni 29 § 1).

5. Ankuesi dhe Qeveria paraqitën individualisht vërejtjet me shkrim mbi pranushmërinë dhe themelin e kërkesës (Neni 59 § 1).

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

6. Ankuesi ka lindur në vitin 1969 dhe aktualisht po vuan dënimin me burgim në Lushnjë, Shqipëri.

Procedimet gjyqësore kundër ankuesit

7. Pas disa ridërgimesh të çështjes kundër ankuesit dhe dy bashkë të pandehurve të tjerë, më 4 mars 2004 Gjykata e Rrethit Berat ("Gjykata e Rrethit") dënoi ankuesin për disa akuza penale të kryera në bashkëpunim me të bashkë të pandehurit. Gjykata e Rrethit konstatoi se ankuesi kishte vepruar në rrethana rënduese për faktin se kishte qenë autori i një prej veprave penale që kishin çuar në vdekjen e një personi ndërsa bashkë të pandehurit kishin ndihmuar për kryerjen e asaj vepre. Në lidhje me veprat e tjera penale, Gjykata e Rrethit e shpalli secilin bashkë të pandehur fajtor sipas akuzave. Gjykata e Rrethit e dënoi ankuesin me burgim të përjetshëm në bazë të një bashkimi dënimesh. Meqë Gjykata e Rrethit kishte aplikuar gjykimin e shkurtuar sipas Kodit të Procedurës Penale (KPP), dënimi i ankuesit u ul në njëzet e pesë vjet burgim.

8. Gjatë procedimeve të Gjykatës së Rrethit, ankuesi u përfaqësua kryesisht nga avokatë të caktuar nga gjykata. Në fazën përfundimtare të këtyre procedimeve, ankuesi caktoi avokat mbrojtës sipas zgjedhjes së vet, në bazë të një prokure të nënshkruar më 18 shkurt 2004, e cila, për aq sa ka lidhje, përmban tekstin e mëposhtëm:

"...

Me anë të kësaj prokure autorizoj S.S si avokat mbrojtës dhe përfaqësues të posaçëm për të më mbrojtur dhe përfaqësuar para Gjykatës së Rrethit, Berat, Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës së Lartë në gjykimin e çështjes penale në lidhje me akuzat e parashikuara në Nenet...të Kodit Penal. Kjo çështje është gjykuar më parë dhe nga një Gjykatë Apeli vendimi është ridërguar për rishqyrtim.

Në pajtim me Nenin 352 të Kodit të Procedurës Penale, kërkoj që çështja të gjykohet në mungesën time.

Unë pranoj akuzat e ngritura kundër meje dhe autorizoj avokatin mbrojtës të kërkojë aplikimin e gjykimit të shkurtuar sipas Nenit 403 të Kodit të Procedurës Penale.

Avokati mbrojtës ka të drejtë të paraqesë apele ndaj vendimeve të gjykatës që janë kundër interesave të mia.

...."

9. Më 12 mars 2004 ankuesi paraqiti një apel në Gjykatën e Apelit, Vlorë ("Gjykata e Apelit"). Megjithëse pranoi se kishte kryer veprat penale, ai kundërshtoi dënimin e dhënë. Ai argumentoi se gjykata nuk kishte marrë në konsideratë disa prej rrethanave lehtësuese në favor të tij, si për shembull pendimi që kishte treguar pas kryerjes së krimit dhe dorëzimin pranë autoriteteve, situatën e vështirë financiare të familjes së tij dhe faktin se ai kishte një fëmijë të mitur, mospasjen e precedentëve penalë dhe nivelin e tij të ulët arsimor.
10. Më 4 maj 2004 u zhvillua një seancë e cila u shty për në datën 26 maj 2004, me qëllim thirrjen e ankuesit për t'u paraqitur në gjykatë. Në po atë datë Gjykata e Apelit i dërgoi një shkresë Komisariatit të Policisë dhe autoriteteve vendore të burgjeve, duke u kërkuar atyre ta shoqëronin ankuesin në seancën e parashikuar për t'u zhvilluar më 26 maj 2004.
11. Ankuesi nuk mori pjesë në seancën e datës 26 maj 2004. Gjykata urdhëroi një shtyrje afati deri më 4 qershor 2004. Përfaqësuesi i ankuesit ishte i pranishëm në gjykim. Pjesët përkatëse të procesverbalit të procesit gjyqësor parashikojnë si më poshtë:

> "I pandehuri Besnik Cani u thirr dhe nuk u paraqit. Nga aktet rezulton se ka dijeni dhe do të marrë pjesë në gjykim".

12. Më 27 maj 2004 Gjykata e Apelit i dërgoi një shkresë Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe autoriteteve vendore të burgjeve, duke kërkuar që ankuesi të shoqërohej në gjykim më 4 qershor 2004, siç kishte shprehur dëshirën për të marrë pjesë.
13. Ankuesi nuk u paraqit në seancën e 4 qershorit 2004. Gjykata urdhëroi një shtyrje afati deri më 18 qershor 2004. Pjesët përkatëse të procesverbalit të procesit gjyqësor parashikojnë si më poshtë:

> "Nga aktet rezulton se ka dijeni Komisariati për ta sjellë dhe nuk e solli. Avokati i tij u thirr dhe ishte i pranishëm"

14. Më 7 qershor 2004 Gjykata e Apelit i dërgoi një shkresë Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe autoriteteve vendore të burgjeve, duke kërkuar që ankuesi të shoqërohej në gjykim më 18 qershor 2004, siç kishte shprehur dëshirën për të qenë i pranishëm në gjykim. Një shënim me shkrim dore në fund të shkresës kishte tekstin e mëposhtëm:

> "[ata] refuzuan të nënshkruanin, duke thënë se nuk janë përgjegjës ndaj Gjykatës së Apelit. Ne nuk shoqërojmë të burgosurit. Gjykata nuk ka asnjë punë me ne. Dërgojani shkresën Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Tiranë."

15. Ankuesi nuk ishte i pranishëm në seancën e 18 qershorit 2004 por avokati i tij nuk mori pjesë. Pjesët përkatëse të procesverbalit të procesit gjyqësor parashikojnë si më poshtë:

> "avokati [S.S] tha "Unë përfaqësova të pandehurin [Besnik Cani] me anë të një prokure gjatë [proceseve gjyqësore] në [gjykatën] e shkallës së parë. Kështu, më lejoni të procedoj me seancën."

16. Gjykata e Apelit vendosi të procedonte me seancën në mungesë të ankuesit ndërsa ai përfaqësohej nga avokati i tij.
17. Më 23 qershor 2004 Gjykata e Apelit Vlorë e dënoi ankuesin njëzet e pesë vjet burgim në bazë të një bashkimi dënimesh, ulur me një të tretën si rezultat i aplikimit të gjykimit të shkurtuar. Pjesët përkatëse të vendimit parashikojnë si më poshtë:

> "...Gjykata [e Apelit] çmon se Gjykata e Rrethit i cilësoi si duhet veprat penale por dënimi [me burgim] duhet të ndryshohet, duke marrë parasysh ndryshimet e dukshme në dënimet e vendosura për çdo të pandehur. Të gjithë bashkë të pandehurit janë pothuajse në të njëjtën pozitë për sa i përket bashkëpunimit dhe rolit të tyre përkatës në kryerjen e veprave penale. Pavarësisht nga fakti se i pandehuri ishte autor i një prej veprave penale, nuk duhet të ketë një ndryshim kaq të madh në dënimet e vendosura. Duke marrë në konsideratë Nenin 141 të Kodit Penal që synon përjashtimin e aplikimit të burgimit të përjetshëm të ankuesit, duke marrë parasysh pendimin e treguar nga i pandehuri gjatë proceseve gjyqësore, dorëzimin e tij pranë autoriteteve pas kryerjes së krimit dhe rolin e tij si autor në kryerjen e veprës penale, gjykata çmon se ai duhet të dënohet me njëzet e pesë vjet burgim në bazë të një bashkimi dënimesh. Në këto rrethana, duke marrë në konsideratë apelin e paraqitur nga ankuesi, vendimi i Gjykatës së Rrethit duhet të ndryshohet për sa i përket dënimit të vendosur ndaj të pandehurit."

Dispozitat përkatëse të pjesës vepruese të vendimit parashikojnë si më poshtë:

> "...
> Sipas Nenit 55 të Kodit Penal, i pandehuri Besnik Cani është dënuar me 25 vjet burgim në bazë të një bashkimi dënimesh.
>
> Sipas Nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale është ulur një e treta e dënimit të vendosur ndaj shtetasit Besnik Cani."

18. Në një datë të papërcaktuar prokurori paraqiti një apel pranë Gjykatës së Lartë me arsyetimin e një zbatimi të gabuar të të drejtës penale. Ai deklaroi, *ndër të tjera*, se dënimi i vendosur nga Gjykata e Apelit që nuk kishte urdhëruar burgimin e përjetshëm për ankuesin si autor i krimit që kishte çuar në vdekjen e një personi, nuk i korrespondonin rrezikut të lartë ndaj shoqërisë të paraqitur nga ankuesi dhe pasojave të rënda kriminale të asaj vepre.
19. Rezultoi se ankuesi nuk kishte bërë parashtrime me shkrim pranë Gjykatës së Lartë, në përgjigje të apelit të prokurorit. Më 15 qershor 2005, vëllai i ankuesit caktoi A.K të përfaqësonte ankuesin para Gjykatës së Lartë.
20. Në seancën e 15 qershorit 2005 para Gjykatës së Lartë, ankuesi u përfaqësua nga A.K, i cili i kërkoi gjykatës të rrëzonte apelin e prokurorit. Më 15 qershor 2005 Gjykata e Lartë e rrëzoi vendimin e Gjykatës së Apelit dhe la në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit. Procesverbali i seancës përcakton se ankuesi u përfaqësua nga avokati i tij. Pjesët përkatëse të vendimit të Gjykatës së Lartë parashikojnë si më poshtë:

"Pas shqyrtimit të dokumenteve në dosjen hetimore dhe dosjen gjyqësore, pas shqyrtimit të arsyetimit të apelit të paraqitur nga prokurori, Gjykata e Lartë çmon se vendimi i Gjykatës së Apelit që ndryshoi vendimin e Gjykatës së Rrethit duke ndryshuar dënimin e të pandehurit [ankuesit] u mor mbi bazën e një zbatimi të gabuar të të drejtës penale, veçanërisht Nenit 37 etj të Kodit Penal, që përcaktojnë mënyrën e vendosjes së një dënimi.

Gjykata e Lartë nxjerr këtë përfundim pasi Gjykata e Apelit nuk e shqyrtoi si duhet rëndësinë e veprave penale të kryera nga i pandehuri, rrezikun serioz ndaj shoqërisë të paraqitur nga i pandehuri duke vazhduar kryerjen e veprave penale, shkallën e lartë të fajësisë, pasojat e rënda kriminale, dhe kryerjen e veprës penale më shumë se një herë, duke përdorur armë dhe duke vepruar në bashkëpunim me persona të tjerë.

Ulja e dënimit nga Gjykata e Apelit për shkak se i pandehuri kishte ndihmuar drejtësinë duke treguar pendim për veprat penale që kishte kryer dhe duke kërkuar aplikimin e gjykimit të shkurtuar, nuk është e bazuar në ligj. Pranimi i akuzave nga i pandehuri dhe kërkesa e tij për aplikimin e gjykimit të shkurtuar ndihmojnë në përshpejtimin e dhënies së drejtësisë. Ligji e merr këtë në konsideratë duke ulur dënimin në masën e një të tretës, në pajtim me Nenin 406 të Kodit të Procedurës Penale. Një ulje e mëtejshme e dënimit të të pandehurit mbi uljen e lejuar në bazë të zbatimit të Nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, ka çuar në ulje të dyfishtë të dënimit për të njëjtat rrethana."

21. Ankuesi paraqiti një ankim kushtetues pranë Gjykatës Kushtetuese, duke pretenduar shkeljet e të drejtës së tij për të marrë pjesë në seancat e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës së Lartë.
22. Më 10 shkurt 2006 Gjykata Kushtetuese shpalli ankimin të papranueshëm, duke konstatuar se pretendimet e paraqitura prej ankuesit nuk përfshihen në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.

II. LIGJI DHE PRAKTIKA E BRENDSHME PËRKATËSE

A. Kushtetuta

23. Dispozitat përkatëse të Kushtetutës shqiptare parashikojnë si më poshtë.

Neni 31

"Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë:

a) të vihet në dijeni menjëherë dhe hollësisht për akuzën që i bëhet, për të drejtat e tij, si dhe t'i krijohet mundësia për të njoftuar familjen ose të afërmit e tij;

b) të ketë kohën dhe lehtësitë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet;

c) të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën shqipe;

ç) të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij; të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe t'i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme;

d) t'u bëjë pyetje dëshmitarëve të pranishëm dhe të kërkojë paraqitjen e dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet".

Neni 42 § 2
"Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

Neni 131

"Gjykata Kushtetuese vendos për:...(f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave."

B. Kodi i Procedurës Penale ("KPP")

24. Neni 48 § 3 parashikon se "zgjedhja e mbrojtësit për personin e ndaluar, të arrestuar ose të dënuar me burgim, derisa ky person nuk e ka bërë vetë zgjedhjen, mund të bëhet nga një i afërm i tij, në format e parashikuara nga paragrafi 2 më lart".
25. Neni 350 parashikon se "kur i pandehuri, qoftë edhe i paraburgosur, ose personi ndaj të cilit ka bërë kërkesë për gjykim i dëmtuari akuzues, nuk paraqitet në seancë dhe del se mungesa është shkaktuar nga forca madhore ose ndonjë pengesë tjetër që e përjashton nga përgjegjësia, gjykata, edhe kryesisht, shtyn ose pezullon shqyrtimin gjyqësor, cakton datën e seancës së re dhe urdhëron që të përsëritet thirrja."
26. Neni 352 deklaron se i pandehuri duhet të përfaqësohet nga mbrojtësi kur ai kërkon ose jep pëlqimin e tij për vazhdimin e shqyrtimit gjyqësor në mungesën e tij.

1. *Procedimet e apelit*

27. Neni 422 parashikon se çdo palë mund të apelojë kundër një vendimi të gjykatës së shkallës së parë, që është vendimi i Gjykatës së Rrethit.
28. Neni 425 §1 përcakton objektin e shqyrtimit të një apeli nga Gjykata e Apelit. Ai parashikon se shqyrtimi i një çështjeje nga Gjykata e Apelit nuk kufizohet në arsyetimin e apelit por shtrihet në të gjithë çështjen, dmth në shqyrtimin si të fakteve edhe të ligjit. Neni 425§3 dënon me ligj *reformatio in peius*, duke deklaruar se "në një apel të paraqitur vetëm nga i pandehuri, gjykata nuk mund të vendosë një sanksion më të rëndë penal, urdhër ose masë më të rëndë kufizuese ose të cilësojë pafajësinë në nivel më pak të favorshëm sesa arsyet e bazuara në vendimin e kundërshtuar."

29. Gjykata e Apelit mund të kryejë një rivlerësim të plotë të provave të marra dhe të shqyrtuara nga gjykata e shkallës së parë, dhe në këtë rast vendos rishtas për fajësinë ose pafajësinë e ankuesit. Sipas Nenit 427, Gjykata e Apelit mund të përsërisë shqyrtimin gjyqësor. Në rast se një prej palëve kërkon rishqyrtimin e provave të administruara gjatë procedimeve në gjykatën e shkallës së parë ose kërkon mbledhjen e provave të reja shtesë, Gjykata e Apelit, kur e çmon të nevojshme, mund të vendosë rifillimin e procedimit gjyqësor, pjesërisht ose plotësisht (Neni 427 § 1). Në masën që provat janë zbuluar pas vendimit të gjykatës së shkallës së parë, ose në masën që provat janë zbuluar gjatë procedimeve të apelit, Gjykata e Apelit vendos rast pas rasti rreth pranimit të saj (Neni 427§2). Rifillimi i një çështjeje mund të vendoset edhe *kryesisht*, kur çmohet e nevojshme (Neni 427§3). Gjithashtu, Gjykata e Apelit mund të rishqyrtojë provat, me kusht që i pandehuri të mos marrë pjesë në procedimet gjyqësore të shkallës së parë, ose për shkak se ai nuk ishte njoftuar, ose se nuk kishte patur mundësi për të marrë pjesë në atë proces për arsye të përligjura (Neni 427§4).

30. Neni 428 përcakton se cilat vendime mund të merren nga Gjykata e Apelit. Ai parashikon se Gjykata e Apelit mund të vendosë të rrëzojë apelin dhe të lërë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, për të ndryshuar vendimin e gjykatës shkallës së parë, për të rrëzuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe për t'i dhënë fund procedimeve gjyqësore, ose për të rrëzuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe për të ridërguar çështjen për rigjykim.

2. Procesi në Gjykatën e Lartë

31. Vendimet e Gjykatës së Apelit mund të apelohen në Gjykatën e Lartë në pajtim me një prej kërkesave të mëposhtme të Nenit 432: a) ligji penal nuk është respektuar ose është zbatuar në mënyrë të gabuar; b) ka patur shkelje që kanë çuar në shpalljen e pavlefshmërisë së vendimit të gjykatës, në pajtim me Nenin 128 të këtij Kodi; c) ka patur shkelje të rregullave procedurale që kanë ndikuar në marrjen e vendimit.

32. Neni 434 parashikon se Gjykata e Lartë shqyrton apelin në masën që çështjet ligjore janë ngritur në të. Ajo ka të drejtën për të shqyrtuar dhe vendosur, me mocionin e vet, dhe në çdo fazë ose shkallë të procedimit, çështjet ligjore që nuk janë shqyrtuar më parë. Seksioni 437 parashikon se i pandehuri dhe palët private duhet të përfaqësohen nga një avokat mbrojtës. Në lidhje me procedurën, paragrafi 5 i seksionit të mësipërm përcakton se relatori paraqet çështjen ndjekur nga parashtrimet verbale të prokurorit dhe dokumentet e mbrojtjes të avokatit mbrojtës. Nuk lejohen kundërpadi.

33. Sipas Nenit 441, Gjykata e Lartë mund të vendosë: a) të lërë në fuqi vendimin e gjykatës më të ulët; b) të ndryshojë cilësimin e veprës penale për sa i përket llojit, dënimit dhe pasojave civile; c) të prishë vendimin [e gjykatës më të ulët] dhe të marrë një vendim pa ridërguar çështjen për rigjykim në gjykatën më të ulët; d) të prishë vendimin [e gjykatës më të ulët] dhe të ridërgojë çështjen për rigjykim; e) të prishë vendimin e Gjykatës së Apelit dhe të lërë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit.

3. Gjykimi i shkurtuar

34. Gjykimi i shkurtuar rregullohet nga Nenet 403-406 të Kodit të Procedurës Penale ("KPP"). I pandehuri ose përfaqësuesi i tij duhet të paraqesin një kërkesë me shkrim për aplikimin e gjykimit të shkurtuar, që bazohet në supozimin se çështja mund të vendoset mbi bazën e dosjes aktuale të çështjes, pa e paraqitur atë për shqyrtim gjyqësor. Nëse gjykata miraton kërkesën e të pandehurit për gjykim të shkurtuar, kur jep vendimin e saj në themel, ajo e ul dënimin në masën e një të tretës. Burgimi i përjetshëm ulet në njëzet e pesë vjet burgim. Si prokurori, ashtu edhe i pandehuri mund të apelojnë kundër vendimit të gjykatës.
35. Për sa i përket gjykimit të shkurtuar, vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë Nr. 2 i datës 29 janar 2003 përcaktonte si më poshtë:

> "...Gjykimi i shkurtuar është i rëndësishëm për hir të efektivitetit gjyqësor sepse ai thjeshton dhe shkurton procedurën, rrit shpejtësinë dhe efektivitetin e një shqyrtimi gjyqësor dhe për rrjedhojë, sjell përfitim për të pandehurin duke ulur dënimin e tij me një të tretën dhe duke mos vendosur një dënim me burgim të përjetshëm.
>
> Është e rëndësishme të theksohet se ky përfitim nuk duhet të jetë në dëm të drejtësisë. Për këtë qëllim, gjykata pranon kërkesën e të pandehurit vetëm kur ajo bindet se mund ta zgjidhte çështjen mbi bazën e dosjes aktuale të çështjes, pa e paraqitur atë për shqyrtim gjyqësor...Thelbi i gjykimit të shkurtuar është pranimi i dokumenteve të grumbulluara gjatë hetimit penal dhe shmangia e shqyrtimit të provave të tjera në një gjykim dhe argumentet në lidhje me të.
> ...
> Mbledhja e provave dhe kërkesave të tjera në lidhje me pavlefshmërinë e tyre nuk janë pjesë e gjykimit të shkurtuar.
>
> Ligji parashikon që çështja do të zgjidhet mbi bazën e dosjes aktuale të çështjes që nënkupton një pranim të ndërsjellë të akteve dhe dokumenteve nga palët. Është detyrimi i gjykatës të vlerësojë nëse një vendim mund të merrej mbi bazën e dosjes aktuale të çështjes, pa dëmtuar drejtësinë dhe pa ndërhyrë në interesat e ligjshme të të pandehurit. Gjykimi vazhdon me parashtrimin e konkluzioneve përfundimtare të palëve, që i referohet dosjes aktuale të çështjes...dhe mbi këtë bazë gjykata merr një vendim.
>
> Nëse palët ankohen se aktet ose dokumentet janë të pavlefshme, gjykata duhet të shfuqizojë vendimin e saj për aplikimin e një gjykimi të shkurtuar dhe urdhëron vazhdimin e një shqyrtimi normal gjyqësor."

Praktika gjyqësore e Gjykatës së Lartë në lidhje me aplikimin e gjykimit të shkurtuar

36. Në tre vendime (nr. 764 i 9 shtatorit 2005, nr. 720 i 20 tetorit 2005 dhe nr. 224 i 19 prillit 2006), Gjykata e Lartë la në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit që ulte më tej dënimet e të pandehurve, pavarësisht se ata kishin përfituar ulje me anë të aplikimit të gjykimit të

shkurtuar nga Gjykatat e Rretheve. Në uljen e mëtejshme të dënimeve, Gjykata e Apelit kishte marrë në konsideratë pranimin nga të pandehurit të fajit dhe shenjat e pendimit.
37. Në tre vendime të tjera (nr. 2 i 12 janarit 2011, nr. 11 i 10 janarit 2011 dhe nr. 26 i 9 shkurtit 2011), Gjykata e Lartë uli më tej dënimet e të pandehurve që ishin vendosur dhe ulur në bazë të aplikimit të gjykimit të shkurtuar nga Gjykata e Rrethit dhe të lëna në fuqi në shkallën e apelit. Në uljen e dënimeve Gjykata e Lartë kishte marrë parasysh rrethanat lehtësuese, si për shembull dorëzimi i të pandehurve pranë autoriteteve dhe pendimi i tyre i thellë për kryerjen e krimit.

LIGJI

I. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 6 TË KONVENTËS

38. Ankuesi u ankua se kishte patur një shkelje të Nenit 6 §1 të Konventës në lidhje me Nenin 6§§3 (c) për faktin se atij i ishte mohuar e drejta për t'u mbrojtur në një seancë publike para Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës së Lartë.

Neni 6§§1 dhe 3 (c) i Konventës, për aq sa ka lidhje, parashikon si më poshtë.

> "1. Në përcaktimin e..çdo akuze penale kundër tij, çdokush ka të drejtën e një gjykimi...të drejtë...nga një gjykatë...
> ...
> 3. Çdokush që akuzohet për një vepër penale ka të drejtat e mëposhtme minimale:
> (c) të mbrohet personalisht ose nëpërmjet ndihmës ligjore sipas zgjedhjes së vet, ose, nëse ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të paguar ndihmën ligjore, t'i sigurohet falas kur kërkohet nga interesat e drejtësisë;
> ....."

A. Pranueshmëria

39. Qeveria nuk ngriti kundërshtime në lidhje me pranueshmërinë e këtij ankimi. Gjykata konstaton se ky ankim ishte paraqitur brenda afatit gjashtë mujor, duke filluar nga vendimi i formës së prerë i gjykatës së brendshme i 10 shkurtit 2006 (shihni Caka kundër Shqipërisë, nr. 44023/02, §74, 8 dhjetor 2009). Më tej, ajo çmon se ky ankim nuk është haptazi i pabazuar. Nuk është konstatuar asnjë arsye tjetër për ta shpallur atë të papranueshëm. Rrjedhimisht, ajo e shpall ankimin të pranueshëm.

B. Themeli

1. *Vërejtjet e palëve*

(a) Ankuesi

40. Ankuesi parashtroi se ai nuk kishte hequr dorë asnjëherë nga e drejta e tij për të marrë pjesë në seancat e zhvilluara para Gjykatës së Apelit. Në fakt, ai kishte shprehur dëshirën për

të qënë i pranishëm në seanca, një fakt që sipas mendimit të tij, ishte përmendur në shkresat që Gjykata e Apelit i kishte dërguar autoriteteve kombëtare, me synim garantimin e pjesëmarrjes së tij.
41. Ankuesi parashtroi më tej se megjithë dëshirën e tij për të marrë pjesë në seanca para Gjykatës së Apelit, në burg atij nuk i ishte dërguar asnjë njoftim gjykate. Ai deklaroi se autoritetet e burgjeve e kishin penguar të merrte pjesë në seancat gjyqësore, duke vepruar në kundërshtim të hapur me urdhrat e gjykatës.
42. Ankuesi argumentoi se Gjykata e Apelit ishte e autorizuar për të shqyrtuar plotësisht një çështje, pavarësisht nga arsyet e apelit të paraqitura pranë saj. Duke marrë parasysh këtë fakt, dhe duke çmuar se ai ishte dënuar me burgim të përjetshëm nga Gjykata e Rrethit, ai gjykoi se prania e tij kërkohej në seancat para Gjykatës së Apelit.
43. Ankuesi pohoi se çështja e tij ishte e ngjashme me *Kremzoë kundër Austrisë*, 21 shtator 1993, Seria A. Nr. 268-B. Në çështjen në fjalë, si në Kremzoë, Gjykata e Lartë kishte vendosur në favor të apelit të prokurorit dhe kishte rënduar pozicionin e ankuesit duke rivendosur dënimin me burgim të përjetshëm. Ky konkluzion, argumentoi ankuesi, nuk mund të ishte arritur vetëm mbi bazën e dosjes së çështjes. Gjykata e Lartë duhet t'i kishte dhënë atij mundësinë të dëgjohej personalisht, me qëllim që të vendoste në lidhje me nivelin e përfshirjes së tij në krimet për të cilat ishte akuzuar. Më tej ankuesi parashtroi se as ai, as avokati i tij nuk i kishin paraqitur parashtrime Gjykatës së Lartë.

(b) Qeveria

44. Qeveria parashtroi se praktika e Gjykatës lejonte kufizime të të drejtës së të pandehurit për të marrë pjesë në gjykim në apel, për shembull, kur i pandehuri kishte marrë pjesë në procedimet e gjykatës së shkallës së parë (shihni *Ekbatani kundër Suedisë*, 26 maj 1988, Seria A nr. 134).
45. Qeveria deklaroi se ankuesi kishte kërkuar aplikimin e gjykimit të shkurtuar që ishte miratuar nga Gjykata e Rrethit. Gjykimi i shkurtuar vazhdonte të aplikohej edhe në apel. Rrjedhimisht, juridiksioni i Gjykatës së Apelit kufizohej në faktin se nuk lejohej asnjë shqyrtim gjyqësor. Meqë ankuesi kishte apeluar kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit, kjo nënkuptonte se pozicioni i tij nuk do të rëndohej dhe Gjykata e Apelit nuk do të vendoste një dënim më të rëndë.
46. Qeveria iu drejtua më tej prokurës së 18 shkurtit 2004 që ishte nënshkruar nga ankuesi dhe sipas të cilës ai kishte pranuar të gjitha akuzat kundër tij dhe kishte kërkuar shprehimisht, në përputhje me Nenin 352 të KPP-së, që të gjykohej në mungesë.
47. Qeveria pohoi se Gjykata kishte vendosur se prania e një të pandehuri nuk kërkohej në seancat para gjykatave që shqyrtonin apele mbi çështjet ligjore. Ata shpjeguan se procedura para Gjykatës së Lartë kërkonte që palët të përfaqësoheshin nga avokatët e tyre, të cilët bënin parashtrime me shkrim dhe verbalisht në një seancë publike. Ata parashtruan se ankuesi ishte përfaqësuar sipas rregullave para Gjykatës së Lartë nga një avokat mbrojtës, siç kërkohet me ligj. Gjykata e Lartë nuk kishte shqyrtuar çështje ose prova që do të kishin nevojë për praninë e tij në gjykim. Në fund të procedimeve, Gjykata e Lartë, duke vërejtur se Gjykata e Apelit kishte keqinterpretuar dispozitat në lidhje me aplikimin e gjykimit të shkurtuar, kishte vendosur të linte në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit. Sipas pikëpamjes së Qeverisë, kjo

tregonte ndryshimin midis kësaj kërkese dhe vendimit të Gjykatës në çështjen *Kremzoë kundër Austrisë*, të cituar më lart.

2. Vlerësimi i Gjykatës

(a) Parime të përgjithshme

48. Gjykata rithekson se garancitë në Nenin 6§3(c) të Konventës janë aspekte të veçanta të të drejtës për gjykim të drejtë, të përcaktuar në paragrafin e parë të këtij Neni. Rrjedhimisht, ankimi i ankuesit do të shqyrtohet sipas kërkesave të përgjithshme të drejtësisë të parashikuara në Nenin 6 të Konventës.
49. Në interes të një procesi të drejtë dhe të ndershëm penal, është e një rëndësie themelore që i pandehuri duhet të paraqitet në gjykimin e tij (shihni *Lala kundër Holandës*, 22 shtator 1994, §33, Seria A nr. 297-A; *Poitrimol kundër Francës*, 23 nëntor 1993, §35, Seria A nr. 277-A; dhe *De Lorenzo kundër Italisë* (dhjet.), nr. 69264/01, 12 shkurt 2004), si për shkak të të drejtës së tij për gjykim, edhe për shkak të nevojës për të verifikuar saktësinë e deklaratave të tij dhe për t'i krahasuar me ato të viktimës-interesat e të cilit duhet të mbrohen-dhe të dëshmitarëve (shihni *Sejdovic kundër Italisë* [GC], nr. 56581/00, § 92, KEDNJ 2006-II).
50. Paraqitja e të pandehurit personalisht nuk merrte të njëjtën rëndësi thelbësore për një seancë apeli, siç ka për gjykimin (shihni *Kamasinski kundër Austrisë*, 19 dhjetor 1989, §106, Seria A nr. 168). Megjithatë, mënyra e zbatimit të Nenit 6 për procedimet para gjykatës së apelit varet nga karakteristika të veçanta të procedimeve përkatëse; duhet të merret parasysh tërësia e procedimeve në rendin e brendshëm juridik dhe e rolit të gjykatës së apelit në të (shihni *Ekbatani kundër Suedisë*, cituar më lart; dhe *Monnell dhe Morris kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 2 mars 1987, §56, Seria A nr. 115).
51. Procedimet për lejimin e apelit dhe procedimet që përfshijnë vetëm çështjet ligjore, ndryshe nga çështjet e faktit, mund të pajtohen me kërkesat e Nenit 6 megjithëse ankuesit nuk i ishte dhënë mundësia të dëgjohej personalisht nga gjykata e apelit ose kasacionit, me kusht që të kishte patur një seancë me dyer të hapura në shkallën e parë (shihni, ndër të tjera, *Monnel dhe Morris*, cituar më lart, §58 (lejimi i apelit); dhe *Sutter kundër Suedisë*, 22 shkurt 1984, §30, Seria A nr. 74 (Gjykata e Kasacionit). Megjithatë, në këtë rast arsyeja kryesore është se gjykata në fjalë nuk ka detyrën e konstatimit të fakteve të çështjes, por vetëm të interpretimit të rregullave ligjore përkatëse (shihni *Ekbatani*, cituar më lart, § 31).
52. Në të vërtetë, edhe kur një gjykatë apeli ka juridiksion të plotë për të rishikuar çështjen si mbi çështjet e faktit dhe ato ligjore, Neni 6 nuk kërkon gjithmonë një të drejtë për seancë me dyer të hapura dhe një të drejtë *a fortiori* për të qenë i pranishëm personalisht (shihni *Fejde kundër Suedisë*, 29 tetor 1991, §31, Seria A nr. 212-C). Në vlerësimin e kësaj çështjeje, ndër të tjera duhet të merren parasysh karakteristikat e veçanta të procedimeve përkatëse dhe mënyra në të cilën interesat e mbrojtjes ishin paraqitur dhe mbrojtur para gjykatës së apelit, veçanërisht duke marrë parasysh çështjet që ajo do të vendosë (shihni *Helmers kundër Suedisë*, 29 tetor 1991, §§ 31-32, Seria A nr. 212-A) dhe rëndësisë së tyre për ankuesin (shihni *Kremzoë*, cituar më lart § 59; *Kamasinski*, cituar më lart §106 *in fine*; dhe Ekbatani, cituar më lart, §§ 27-28).

53. Në sistemet ligjore ku një gjykatë apeli vepron jo thjesht si gjykatë rishikuese por kur duhet të shqyrtojë një çështje në lidhje me faktet dhe ligjin dhe të kryejë një rivlerësim të çështjes së fajësisë ose pafajësisë, ajo nuk mund të përcaktojë çështjen pa një vlerësim të drejtpërdrejtë të provave të dhëna personalisht nga i pandehuri me qëllim që të provojë se ai nuk ka kryer veprën që dyshohej të përbënte vepër penale (shihni *Dondarini kundër San Marinos*, nr. 50545/99, § 27, 6 korrik 2004; *Strzalkoëski kundër Polonisë*, nr. 31509/02, § 41, 9 qershor 2009; dhe *Soboleëski kundër Polonisë* (nr. 2), nr. 19847/07, § 35, 9 qershor 2009).
54. As formulimi i saktë, as fryma e Nenit 6 të Konventës nuk pengon një person që të heqë dorë, me vullnetin e tij të lirë, ose shprehimisht ose në mënyrë të heshtur, nga e drejta e tij për garancitë e një gjykimi të drejtë. Megjithatë, kjo heqje dorë, duhet të jetë efektive për qëllimet e Konventës, duhet të vendoset përfundimisht dhe të shoqërohet me garanci minimale në përputhje me rëndësinë e saj (shihni *Hermi kundër Italisë* [GC], nr. 18114/02, §73, KEDNJ 2006-XII).

(b) Zbatimi i këtyre parimeve në çështjen në fjalë

55. Gjykata fillimisht vëren se i është nënshtruar cilësimit që duhet t'i jepet në ligj fakteve të çështjes. Ajo nuk konsideron të jetë e lidhur nga detyrimi ligjor i cilësimit të dhënë nga ankuesi ose një qeveri (shihni *Berhani kundër Shqipërisë*, nr. 847/05, § 46, 27 maj 2010; dhe Scoppola kundër Italisë (nr. 2) [GC], nr. 10249/03, § 54, KEDNJ 2009..). Gjykata vëren se çështja në fjalë lidhet me çështjet e dënimit që përfshijnë përcaktimin e një akuze penale, pavarësisht se çështja e fajësisë së ankuesit është përcaktuar dhe përfshin garancitë e parashikuara në Nenin 6 (shihni *Scoppola kundër Italisë* (nr. 2) [GC], cituar më lart §§48-57 dhe §§ 132-145). Ndërsa i takon autoriteteve të caktojnë dënimin që do të vendoset, detyra e Gjykatës është të shqyrtojë nëse ankuesit i ishin dhënë garancitë e drejtësisë së procedimeve në tërësi.
56. Në rrethanat e kësaj çështjeje, ankuesi nuk kishte paraqitur ankime në lidhje me procedimet para Gjykatës së Rrethit. Fillimisht ai u përfaqësua nga avokatë të caktuar nga gjykata dhe në fazën përfundimtare të procedimeve ai u mbrojt nga një avokat i zgjedhur prej tij, i cili bëri parashtrimet në emër të tij pas konsultimit të dosjes së çështjes.
57. Gjykata vëren se më 18 shkurt 2004, në bazë të prokurës së tij dhe ndërsa procedimet ishin ende duke u zhvilluar para Gjykatës së Rrethit, ankuesi kërkoi me dëshirën e tij, aplikimin e gjykimit të shkurtuar. Gjykimi i shkurtuar përfshin padyshim avantazhe për të pandehurin, i cili, sipas formulimit të Gjykatës së Lartë është "i rëndësishëm për hir të efektiviteti gjyqësor sepse thjeshton dhe shkurton procedurën, rrit shpejtësinë dhe efektivitetin e shqyrtimit gjyqësor dhe për rrjedhojë, sjell përfitim për të pandehurin duke ulur dënimin e tij në masën e një të tretës dhe duke mos vendosur burgim të përjetshëm." Nga ana tjetër, gjykimi i shkurtuar përfshin një pakësim të garancive procedurale të dhëna nga ligji i brendshëm, në veçanti mundësinë e kërkimit të pranimit të provave të reja që nuk ndodhen në dosjen e çështjes ose argumenteve të lidhura me provat tashmë të mbledhura.
58. Gjykata çmon se ankuesi i cili ishte ndihmuar nga një avokat, ishte padyshim i aftë të kuptonte pasojat e kërkesës së tij për aplikimin e gjykimit të shkurtuar. Ankuesi nuk kërkoi në apelet e tij ndërprerjen e aplikimit të gjykimit të shkurtuar. Megjithatë, sipas Kodit shqiptar të Procedurës Penale, miratimi i gjykimit të shkurtuar nuk përfshin një pakësim të të

gjitha garancive procedurale, kryesisht e drejta e të pandehurit për apel kundër dënimit të vendosur nga gjykata më të ulëta dhe e drejta e të pandehurit për të marrë pjesë në seanca (shihni paragrafët 36-37 më lart). As vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë i 29 janarit 2003 nuk mbështet një interpretim të tillë.

59. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se ajo ishte e hapur për apelin e ankuesit kundër dënimit të vendosur nga Gjykata e Rrethit. Në të vërtetë, ai paraqiti një apel kundër dënimit të tij në Gjykatën e Apelit, duke argumentuar se dënimi i tij duhet të ulet për shkak të ekzistencës së rrethanave lehtësuese. Në atë rast, duke marrë parasysh arsyetimin e apelit të tij, ankuesit iu caktua një dënim më i lehtë.

Gjykata vëren se sipas dispozitave përkatëse të kodit shqiptar të procedurës penale, juridiksioni i një gjykate apeli shtrihet në çështje si të fakteve dhe ato ligjore (shihni paragrafët 28 dhe 29 më lart). Në arsyetimin për vendimin e saj, Gjykata e Apelit nxori përfundime që lidheshin me fajësinë e ankuesit. Në procedimet e apelit, siç vërtetohet dhe dokumentohet nga vetë Gjykata e Apelit, ankuesi përsëriti dëshirën e tij për të marrë pjesë në seancën e apelit të tij. Gjykata e Apelit reagoi duke e shtyrë seancën tre herë, me qëllim që të garantonte praninë e ankuesit. Është për të ardhur keq që shërbimi penitenciar nuk arriti të zbatonte urdhrat e Gjykatës së Apelit. Më 18 qershor 2004, avokati i ankuesit i kërkoi gjykatës të vazhdonte me procedimet. Në atë rast dhe duke marrë parasysh rrethanat e veçanta të çështjes, Gjykata nuk çmon se deklarata e avokatit të ankuesit përbën heqje dorë nga dëshira e përsëritur dhe përfundimtare e ankuesit për të marrë pjesë në gjykim.

60. Megjithatë, prokurori çmoi se ankuesi nuk ishte trajtuar në mënyrë aq favorizuese dhe i kërkoi Gjykatës së Lartë të ricaktonte dënimin e Gjykatës së Rrethit. Ankuesi u përfaqësua nga avokati mbrojtës para Gjykatës së Lartë. Sipas ligjit të brendshëm, ai nuk kishte të drejtë të merrte pjesë në seancë personalisht dhe, si çështje e të drejtës së Konventës, Neni 6 nuk i garantonte atij këto të drejta para Gjykatës së Lartë, juridiksioni i të cilës kufizohej vetëm në çështjen e interpretimit ligjor, dmth objektin e kompetencave për rishikim të Gjykatës së Apelit sipas Kodit të Procedurës Penale. Në atë rast, Gjykata e Lartë konstatoi se Gjykata e Apelit kishte tejkaluar kompetencën e saj dhe la në fuqi dënimin e Gjykatës së Rrethit.

61. Gjykata nuk konstaton asgjë në konkluzionet e Gjykatës së Lartë që të sugjerojë se Gjykata e Apelit nuk mund të kishte ulur më tej dënimin e ankuesit. Në të vërtetë, në pajtim me Nenin 428 të Kodit të Procedurës Penale, Gjykata e Apelit kishte mundësinë të ndryshonte dënimin e vendosur nga Gjykata e Rrethit. Qeveria nuk paraqiti ndonjë statut ose praktikë gjyqësore të brendshme me qëllim që aplikimi i gjykimit të shkurtuar ta zhvishte Gjykatën e Apelit nga kompetenca e saj për të ulur dënimin e vendosur nga gjykata e shkallës së parë. Vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë i 29 janarit 2003 nuk ofroi asnjë lloj mbështetjeje për një interpretim të tillë.

62. Në të kundërt, sipas praktikës së brendshme gjyqësore dhe veçanërisht gjatë periudhës kur ankimi kushtetues i ankuesit po shqyrtohej nga Gjykata Kushtetuese, Gjykata e Lartë la në fuqi dy vendime të Gjykatës së Apelit, përkatësisht të 9 shtatorit 2005 dhe 20 tetorit 2005, të cilat kishin ulur më tej dënimet e caktuara nga Gjykatat e Rrethit me anë të aplikimit të gjykimit të shkurtuar (shihni paragrafin 36 më lart). Së fundi, në vitin 2011 vetë Gjykata e Lartë caktoi dënime më të lehta, pavarësisht nëse i pandehuri kishte përfituar ulje me anë të aplikimit të gjykimit të shkurtuar nga gjykata më të ulta (shihni paragrafin 37 më lart).

Rrjedhimisht, rezultoi se vazhdon të mbizotërojë kjo linjë e praktikës gjyqësore dhe interpretimit të dispozitave të procedurës penale.
63. Gjykata vëren më tej se në asnjë fazë të procedimeve të apelit, qoftë në procedimet para Gjykatës së Apelit ose para Gjykatës së Lartë, ankuesi nuk kishte mundësi të argumentonte personalisht se ekzistonin faktorë lehtësues, si për shembull pendimi i tij pas krimit, mospasja e dënimeve penale të mëparshme, formimi i tij dhe vështirësitë ekonomike të familjes së tij, të cilat do të kishin favorizuar caktimin e një dënimi më të ulët sesa ai i dhënë nga Gjykata e Rrethit. Për Gjykatën, të gjitha këto janë çështje mbi të cilat, për arsye të drejtësisë, ai duhet të ishte dëgjuar personalisht. Rrjedhimisht, ka patur një shkelje të Nenit 6§1 të Konventës.

II. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

64. Neni 41 i Konventës parashikon:

> "Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe, nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i jep shpërblim të drejtë palës së dëmtuar."

A. Dëmi
65. Ankuesi pretendoi 10,000 Euro në lidhje me dëmin jomonetar të shkaktuar si rezultat i shkeljes së të drejtave të tij sipas Konventës.
66. Qeveria nuk bëri komente.
67. Duke marrë parasysh shkeljen e konstatuar në këtë rast, Gjykata çmon se një kompensim për dëmin jomonetar është i justifikuar. Në kryerjen e një vlerësimi mbi baza të barabarta, Gjykata i jep ankuesit 3,200 EURO.

B. Kostot dhe shpenzimet
68. Ankuesi gjithashtu pretendoi 15,290 EURO për kostot dhe shpenzimet e kryera para kësaj Gjykate dhe Gjykatës Kushtetuese. Ai paraqiti dy fatura që dokumentonin kostot ligjore, kostot e përkthimit dhe tarifat postare.
69. Qeveria nuk bëri komente.
70. Në çështjen në fjalë, duke marrë parasysh informacionin e zotëruar prej saj, Gjykata e çmon të arsyeshme t'i kompensojë ankuesit shumën prej 3,500 EURO për kostot dhe shpenzimet.

C. Kamatëvonesa

71. Gjykata çmon të arsyeshme se kamatëvonesa duhet të bazohet në normën marzhinale të huadhënies të Bankës Qendrore Europiane të cilës duhet t'i shtohen tre pikë për qind.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA NJËZËRI

1. *Shpall* ankimin të pranueshëm;

2. *Vendos* se ka patur një shkelje të Nenit 6§1 të Konventës;

3. *Vendos*

(a) se Shteti i paditur duhet t'i paguajë ankuesit, brenda tre muajve nga data në të cilën vendimi merr formë të prerë, në përputhje me Nenin 44 § 2 të Konventës, shumat e mëposhtme që duhet të konvertohen në monedhën e saj kombëtare, në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes:

(i) 3,200 (tre mijë e dyqind Euro) EURO plus çdo taksë që mund të jetë e kërkueshme, në lidhje me dëmin jomonetar;

(ii) 3,500 (tre mijë e pesëqind Euro) EURO plus çdo taksë që mund të jetë e kërkueshme për ankuesin, në lidhje me kostot dhe shpenzimet;

(b) se nga mbarimi i afatit të lartpërmendur prej tre muaj deri në shlyerje, interesi i thjeshtë do të jetë i pagueshëm për shumat e mësipërme në një normë të barabartë me normën marzhinale të huadhënies të Bankës Qendrore Europiane gjatë periudhës së mospagimit plus tre pikë për qind;

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 6 mars 2012, sipas Nenit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Fatos Araci
Zëvendës Regjistrues

Lech Garlicki
President

Në përputhje me Nenin 45 § 2 të Konventës dhe Nenin 74 § 2 të Rregullores së Gjykatës, opinioni pajtues i Gjykatësit De Gaetano i bashkëlidhet këtij vendimi.

L.G.
F.A.

OPINIONI PAJTUES I GJYKATËSIT DE GAETANO

Kam votuar me shumicën në këtë çështje vetëm për shkak të rrethanës tejet rënduese, pra refuzimit të vazhdueshëm, pothuajse sfidues të autoritete të burgjeve për ta sjellë ankuesin në gjykatë në seancën e apelit (§§ 9-14). Në çështjen në fjalë rezultoi se prania e ankuesit para Gjykatës së Apelit ishte e një rëndësie thelbësore për vendimin e asaj gjykate dhe të çdo gjykate tjetër në lidhje me dënimin që do të vendosej. Megjithëse Gjykata e Apelit e uli dënimin, mungesa e ankuesit në gjykim nënkuptonte se nuk u morën asnjëherë provat e tij në lidhje me faktorët lehtësues të parashtruar në kërkesën e tij të apelit, dhe si rezultat, nuk ishin vënë në dispozicion para Gjykatës së Lartë. Për mendimin tim, kjo cenoi drejtësinë e procedimeve në tërësi.

ÇËSHTJA "SHKALLA KUNDËR SHQIPËRISË"

(ANKIMI NR.26866/05)

VENDIM

(THEMELI)

STRASBURG

10 MAJ 2011

Ky vendim do të marrë formë të prerë në rrethanat e përcaktuara në nenin 44 § 2 të Konventës. Ai mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktues.

Në çështjen "Shkalla kundër Shqipërisë",

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i katërt), në cilësinë e një dhome të përbërë nga:

Nikolas Bratza, *Kryetar,*
Lech Garlicki,
Ljiljana Mijović,
Sverre Erik Jebens,
Päivi Hirvelä,
Ledi Bianku,
Vincent A. de Gaetano, *gjyqtarë,*
dhe Laërence Early, *regjistrues i seksionit,*
Pas shqyrtimit me dyer të mbyllura, më 12 prill 2011,
Shpall vendimin e mëposhtëm, të miratuar po në atë datë.

PROCEDURA

6. Çështja e ka zanafillën në ankimin (nr.26866/05) kundër Republikës së Shqipërisë e depozituar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore (Konventa) nga një shtetas shqiptar, z.Ardian Shkalla (ankuesi), më 13 korrik 2005.

2. Ankuesi u përfaqësua nga z.A. Kasapi, avokat që ushtron profesionin e tij në Tiranë. Qeveria Shqiptare (Qeveria) u përfaqësua nga agjentja e saj në atë kohë, znj.S. Meneri, dhe më pas, nga znj.E. Hajro.

3. Ankuesi pretendoi se ka patur shkelje të së drejtës së tij për akses në gjykatë sipas nenit 6 § 1 të Konventës dhe se procedurat penale ndaj tij mbajtur in absentia kanë qenë të padrejta.

4. Më 16 qershor 2008, kryetari i seksionit të katërt të Gjykatës, të cilit i ishte caktuar çështja, vendosi ta njoftojë Qeverinë për ankimin. Gjithashtu, u vendos që themeli i çështjes të shqyrtohej në të njëjtën kohë me pranueshmërinë e tij (neni 29 § 1).

5. Secila nga palët, ankuesi dhe Qeveria, depozituan vëzhgimet e tyre me shkrim mbi pranueshmërinë dhe themelin e çështjes (rregulli 59 § 1).

FAKTET

RRETHANAT E ÇËSHTJES

6. Ankuesi ka lindur në Tiranë në vitin 1978 dhe aktualisht vuan dënimin me burgim të përjetshëm.

A. Hetimi penal

7. Më 6 qershor 2001 u vranë dy njerëz. K-ja ishte dëshmitar okular i ngjarjes.

8. Më 9 qershor 2001 prokurori vendosi të procedonte me identifikimin e autorit të krimit dhe ftoi K-në të merrte pjesë. K-së iu dhanë tetë fotografi dhe ai tregoi ankuesin si autor të krimit, pasi bëri përshkrimin e tij fizik. Avokati i ankuesit nuk ishte i pranishëm.

9. Më 9 qershor 2001, policia kontrolloi në mënyrë të pasuksesshme shtëpinë e ankuesit. Vendndodhja e tij nuk dihej.

10. Më 9 korrik 2001, prokurori akuzoi ankuesin për vrasje në rrethana rënduese dhe armëmbajtje pa leje. Njoftimi i akuzave të prokurorit u bë i ditur nga nënshkrimi i avokatit të caktuar kryesisht për të përfaqësuar ankuesin.

11. Më 21 korrik 2001, Gjykata e Rrethit Tiranë (Gjykata e Rrethit) urdhëroi arrestimin e ankuesit. Megjithatë urdhri nuk mund të zbatohej meqenëse ankuesi nuk mund të gjendej.

12. Më 3 tetor 2001, policia kreu një kontroll të mëtejshëm të shtëpisë së ankuesit në mënyrë të pasuksesshme. Vendndodhja e tij mbeti e panjohur.

13. Më 11 tetor 2001, ankuesi u deklarua i fshehur nga drejtësia sipas nenit 247 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

B. Procedurat gjyqësore

14. Më 12 tetor 2001, prokurori vendosi të dërgojë ankuesin për gjykim. Avokati i ankuesit i caktuar kryesisht u informua në kohën e duhur.

15. Më 21 dhjetor 2001, prokurori parashtroi konkluzionet e tij përfundimtare, në të cilat ai kërkoi që ankuesi të dënohej me burgim të përjetshëm. Në të njëjtën ditë avokati i ankuesit i caktuar kryesisht parashtroi konkluzionet e tij përfundimtare, në të cilat ai kundërshtonte paligjshmërinë e procedurës së identifikimit, e cila ishte kryer në mungesë të avokatit të ankuesit. Ai kërkoi që dënimi me burgim të jetë më pak se 25 vjet, duke marrë parasysh faktin se ankuesi nuk ishte përsëritës dhe se ai ishte i ri dhe kishte nivel të ulët arsimimi.

16. Në të njëjtën ditë Gjykata e Rrethit e shpalli ankuesin fajtor sipas akuzës dhe e dënoi atë me burgim të përjetshëm. Dukej se ankuesi jetonte në Greqi në kohë materiale.

17. Më 28 dhjetor 2001, sipas nenit 43 § 3 i KPP-së, babai i ankuesit autorizoi një avokat për të përfaqësuar ankuesin dhe depozitoi të gjitha ankimet e nevojshme.

18. Më 31 dhjetor 2001, avokati depozitoi një ankim kundër dënimit të ankuesit. Ankimi, i cili, gjithashtu, kishte nënshkrimin e ankuesit, bazohej në pika të faktit dhe të ligjit.

19. Më 26 prill 2002, pas procedurave *in absentia*, Gjykata e Apelit Tiranë (Gjykata e Apelit) la në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit. Ajo konstatoi se ankuesi ishte deklaruar i fshehur pas përpjekjeve të pasuksesshme për të zbuluar vendndodhjen e tij dhe se njoftimet e gjykatës së shkallës së parë i ishin dërguar avokatit të tij të caktuar kryesisht në përputhje me ligjin.

20. Më 17 maj 2002, ankuesi apeloi nëpërmjet avokatit të zgjedhur nga familja, para Gjykatës së Lartë. Ai u ankua *inter alia* se mungesa e tij gjatë procedurave të gjykatave më të ulëta kishte ndikuar negativisht ndaj tij dhe se ai nuk ishte njoftuar për procedurat sipas ligjit. Ankuesi pohoi se ai nuk i mohonte akuzat kundër tij, por rrethanat e çështjes ishin unike dhe

kërkonin një këndvështrim të ndryshëm të themelit të çështjes. Ankimi kishte nënshkrimin e ankuesit dhe të avokatit të zgjedhur nga familja e tij.

21. Më 15 janar 2003, Gjykata e Lartë rrëzoi apelimin e ankuesit. Ajo argumentoi se Gjykata e Rrethit e kishte njoftuar në mënyrë të saktë ankuesin në adresën e shtëpisë së tij. Për më tepër, vëllezërit dhe nëna e tij ishin thirrur si dëshmitarë në një nga seancat dëgjimore të gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e Lartë konsideroi se mospjesëmarrja e ankuesit në gjykim pasqyronte zgjedhjen e tij, siç dëshmohej në apelimet e tij, dhe jo mungesën e mundësisë ofruar nga gjykatat më të ulëta për t'u paraqitur në gjykimin e tij, dhe për të kundërshtuar akuzat. Gjykata e Lartë hodhi poshtë, si të pabazuar, argumentin e ankuesit se dënimi me burgim do të kishte qenë më pak i ashpër nëse ai do të kishte ndjekur procedurat.

22. Duke jetuar akoma në Greqi, ankuesi u informua më 14 qershor 2003, mbi rezultatin e procedurave të mësipërme, pra që ai ishte dënuar me burgim të përjetshëm në Shqipëri. Në të njëjtën ditë, ai iu dorëzua policisë shqiptare me qëllim që të kërkonte drejtësi në lidhje me dënimin e tij dhe gjykimin e pretenduar të padrejtë *in absentia*.

23. Më 12 janar 2005, ankuesi autorizoi një avokat për të paraqitur një ankim kushtetues.

24. Më 15 janar 2005, ankuesi depozitoi një ankim kushtetues. Ai pohoi se ishte gjykuar *in absentia* dhe interesat e tij nuk ishin mbrojtur siç duhet pranë gjykatës së shkallës së parë. Avokati i caktuar kryesisht ishte caktuar nga prokurori në vend që të caktohej nga gjykata. Ankuesi nuk ishte njoftuar asnjëherë për asnjë dokument në lidhje me çështjen e tij. Për më tepër, ankuesi pretendonte se ai ishte deklaruar i fshehur mbi bazën e dëshmisë jobindëse. Fakti që ai u dorëzua pas përfundimit të gjykimit të tij ishte një shenjë e mëtejshme se ai nuk ishte njoftuar në kohën e duhur për procedurat. Ai, gjithashtu, pretendoi se ishte falsifikuar nënshkrimi i tij në ankimet para Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës së Lartë.

25. Më 1 shkurt 2005, Gjykata Kushtetuese, pasi vërejti se ankimi i ankuesit ishte parashtruar në një zarf të vulosur më 17 janar 2005, e deklaroi ankimin të papranueshëm, si të depozituar jashtë afatit.

26. Në një letër të datës 15 shkurt 2005, avokati i ankuesit informoi Gjykatën Kushtetuese *inter alia*, se, meqenëse afati kishte mbaruar në ditë pushimi (një të shtunë), ndërkohë që të gjithë rregullat procedurale vendase parashikonin një shtyrje automatike të afatit ligjor në ditën vijuese të punës, ai kishte postuar ankimin e tij kushtetues në ditën vijuese të punës, pra të hënën më 17 janar 2005.

27. Më 24 shkurt 2005, Gjykata Kushtetuese u përgjigj se ankuesi ishte informuar mbi argumentet e vendimit të saj të datës 1 shkurt 2005. Ankesa e tij ishte depozituar jashtë afatit duke u bazuar në vulën në zarfin në të cilin ishte dërguar ankesa pranë Gjykatës Kushtetuese.

I. E DREJTA E BRENDSHME PËRKATËSE

A. Kushtetuta

28. Kushtetuta e Shqipërisë, në pjesët e saj përkatëse, parashikon:

Neni 31

“Gjatë procesit penal çdo njeri ka të drejtë:

a) të njoftohet menjëherë dhe në hollësi mbi akuzën që i bëhet për të drejtat e tij dhe mundësinë për të njoftuar familjen e tij apo të afërmit;

b) të ketë kohën dhe mjetet e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e tij;

c) t’i ofrohet ndihma e përkthyesit pa pagesë, kur nuk flet apo nuk kupton gjuhën shqiptare;

ç) të prezantojë çështjen e tij apo të mbrojë veten nëpërmjet një avokati që ai e ka zgjedhur vetë; të komunikojë lirshëm dhe privatisht me të, si dhe t’i sigurohet avokat ligjor pa pagesë kur ai nuk ka mundësi ta përballojë vetë;

d) t’i pyesë dëshmitarët që janë prezent dhe të kërkojë paraqitjen e dëshmitarëve, ekspertëve dhe personave të tjerë që mund të sqarojnë faktet.”.

Neni 32

“1. Askush nuk mund të detyrohet të dëshmojë kundër vetvetes ose familjes së vet dhe as të pohojë fajësinë e tij.

2. Askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme.”

Neni 33

“1. Kushdo ka të drejtë të dëgjohet para se të gjykohet.

2. Nga kjo e drejtë nuk mund të përfitojë personi që i fshihet drejtësisë.”

Neni 42 § 2

“Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave të lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj”.

Neni 131

“Gjykata Kushtetuese vendos për: ... f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.”

B. Akti i Gjykatës Kushtetuese (ligji për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, nr.8577 datë 10 shkurt 2000)

29. Akti i Gjykatës Kushtetuese në pjesët e tij përkatëse, parashikon si më poshtë:

Neni 1 - Qëllimi

“...

2. Për çështje që lidhen me procedura që nuk rregullohen nga ky ligj, Gjykata Kushtetuese
merr parasysh edhe dispozitat ligjore që rregullojnë procedurat e tjera, duke marrë në konsideratë natyrën ligjore të çështjes.”

Neni 30

"1. Për paraqitjen e kërkesës para Gjykatës Kushtetuese zbatohen afatet e përcaktuara në këtë ligj.

2. Kërkesat e individit për shkeljen e të drejtave kushtetuese paraqiten jo më vonë se 2 vjet nga konstatimi i shkeljes. Kur në bazë të ligjit individi mund t'i drejtohet një organi tjetër, ai mund të paraqesë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, pasi të jenë shterur të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Në këtë rast, afati i paraqitjes së kërkesës është 2 vjet nga data e njoftimit të vendimit të organit përkatës shtetëror."

Neni 31

"1. Kërkesa shqyrtohet paraprakisht nga kolegji i përbërë nga 3 gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, ku bën pjesë dhe relatori.

2. Kur kërkesa, megjithëse është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese dhe është paraqitur nga subjekti që legjitimohet, nuk është e plotë, kolegji ia kthen kërkuesit për plotësim, duke treguar shkaqet e kthimit dhe afatin e plotësimit të saj. Pas kësaj, kur kërkesa paraqitet e plotësuar, kalon përsëri për shqyrtim paraprak në kolegj. Kërkesa e paplotësuar nuk merret në shqyrtim.

3. Kur kërkesa është paraqitur nga subjekti që legjitimohet dhe çështja është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese, kolegji vendos kalimin e çështjes në seancë plenare, ndërsa kur ajo nuk është paraqitur nga subjekti që legjitimohet ose çështja nuk është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese, kolegji vendos moskalimin e çështjes në seancë plenare. Në të gjitha rastet, kur ndonjë nga gjyqtarët e kolegjit nuk është i një mendimi me të tjerët, kërkesa i kalon për shqyrtim paraprak mbledhjes së gjyqtarëve, e cila vendos me shumicë votash për kalimin ose jo të çështjes në seancë plenare.

4. Në të gjitha rastet e mësipërme, kolegji ose mbledhja e gjyqtarëve nuk shqyrton zgjidhjen në themel të çështjes."

Praktika ligjore e Gjykatës Kushtetuese

30. Në vendimin e saj nr.8 të datës 12 mars 2009 (nr.8/09), Gjykata Kushtetuese, duke marrë parasysh dispozitat e Kodit të Procedurës Civile dhe faktin që akti i Gjykatës Kushtetuese nuk parashikonte ndjekjen e procedurave në rastet kur ankuesi heq dorë nga e drejta e tij për të ndjekur ankimin, vendosi të mos pranojë çështjen në përputhje me nenin 1 § 2 të aktit të Gjykatës Kushtetuese.

31. Në vendimin e saj nr.30 të datës 26 nëntor 2009 (nr.30/09), Gjykata Kushtetuese shqyrtoi kërkesën e ankuesit në lidhje me padrejtësinë e procedurave dhe dënimin e tij *in absentia*, pasi kërkesa për rivendosje në afat ishte rrëzuar si jashtë afatit nga Gjykata e Rrethit Tiranë, meqenëse ankuesi nuk kishte apeluar kundër vendimit te gjykatës. Në vendimin e saj, Gjykata Kushtetuese nuk shqyrtoi çështjen e llogaritjes së periudhës 2-vjeçare për depozitimin e ankimit kushtetues në lidhje me padrejtësinë e procedurave. Dukej se dita e fillimit ishte dita në të cilën ankuesi ishte njoftuar për dënimin e tij *in absentia*, pra më 4 qershor 2008. Ankuesi ishte dënuar *in absentia* nga një vendim gjykate të formës së prerë i datës 24 mars 2000.

C. Kodi i Procedurës Penale (KPP)

32. Akti i Gjykatës Kushtetuese në pjesët e tij përkatëse, parashikon si më poshtë:

Neni 48 - Mbrojtësi i zgjedhur nga i pandehuri

"1. I pandehuri ka të drejtë të zgjedhë jo më shumë se dy mbrojtës.

2. Zgjedhja bëhet me deklarim të bërë para organit procedues ose me akt të dhënë mbrojtësit ose të dërguar atij rekomande.

3. Zgjedhja e mbrojtësit për personin e ndaluar, të arrestuar ose të dënuar me burgim, derisa ky person nuk e ka bërë vetë zgjedhjen, mund të bëhet nga një i afërm i tij, në format e parashikuara nga paragrafi 2."

Neni 144 - Rregulla të përgjithshme

1. Afatet procedurale caktohen në orë, në ditë, në muaj ose në vite.

2. Afatet llogariten sipas kalendarit të zakonshëm.

3. Afati i caktuar në ditë, kur ai mbaron në ditë pushimi ose feste, shtyhet deri në ditën pasardhëse të punës jofestive.

4. Me përjashtim të rasteve kur ligji disponon ndryshe, në afatin e caktuar nuk llogaritet ora ose dita, në të cilën fillon të ecë afati. Llogariten ora e fundi ose dita e fundit.

5. Afati për përbërjen e deklaratave, depozitimin e dokumenteve ose për kryerjen e veprimeve të tjera në gjykatë konsiderohet i mbaruar në momentin kur, sipas rregullit, zyrat mbyllen për publikun.

Neni 147 - Rivendosja ne afat

1. Prokurori, i pandehuri, palët private dhe mbrojtësit rivendosen në afatin e caktuar kur provojnë se nuk kanë pasur mundësi ta respektojnë afatin për shkak të rastit fator ose të forcës madhore.

2. Në qoftë se është dhënë vendimi në mungesë, i pandehuri mund të kërkojë rivendosjen në afat për të bërë ankim kur provon se nuk ka marrë dijeni për vendimin.

3. Kërkesa për rivendosjen në afat paraqitet brenda dhjetë ditëve nga zhdukja e faktit që përbënte rast ose forcë madhore [në paragrafin 1] dhe në paragrafin 2 [brenda dhjetë ditëve] nga dita kur i pandehuri ka marrë dijeni efektivisht për aktin. (...)

4. .....

5. Vendimi që lejon rivendosjen në afat për bërjen e ankimit mund të ankimohet vetëm bashkë me vendimin përfundimtar.

6. Kundër vendimit që refuzon kërkesën për rivendosjen në afat, mund të bëhet ankim në gjykatën e apelit.

Neni 410 - Ankimi i të pandehurit

" ...

2. Kundër vendimit të dhënë *in absentia*, mbrojtësi mund të bëjë ankim, vetëm kur është i pajisur me një akt përfaqësimi të lëshuar në format e parashikuara nga ligji

... "

33. Nenet 449-461 të KPP-së rregullojnë zbatimin e rishqyrtimit të vendimit përfundimtar. Sipas nenit 451, i akuzuari ose prokurori mund të depozitojnë një kërkesë për

rishqyrtim në përputhje me argumentet e kufizuara të rishqyrtimit përmendur në nenin 450. Kërkesa i parashtrohet Gjykatës Kushtetuese, e cila vendos ta rrëzojë ose pranojë atë (neni 453).

Praktika ligjore e gjykatave vendase

34. Më 24 mars 2008, 11 nëntor 2008, 19 janar dhe 8 tetor 2009, Gjykata e Rrethit, Gjykata e Apelit, Gjykata e Lartë dhe Gjykata Kushtetuese, respektivisht, rrëzuan kërkesën e të pandehurit për rivendosje në afat, duke argumentuar se dënimi i tij *in absentia* kishte marrë forcën e *res judicata* dhe se i pandehuri ishte mbrojtur në mënyrë efektive nga një mbrojtës i caktuar nga anëtarët e familjes (shih Sulejmani kundër Shqipërisë, nr.16114/10, komunikuar Qeverisë së paditur më 31 maj 2010 dhe në pritje para Gjykatës).

35. Në përgjigje të një kërkese referimi nga Gjykata e Lartë mbi kushtetutshmërinë e neneve 48 § 3 dhe 410 § 2 të KPP-së, nëpërmjet vendimit nr.30 të datës 17 qershor 2010 (nr.30/10), Gjykata Kushtetuese vendosi se caktimi i një mbrojtësi nga anëtari i familjes duhej të pranohej nga gjykatat vendase, në rastet kur përcaktohej se përbënte një manifestim të qartë të synimit të të pandehurit për të mos ndjekur procedurat. I njëjti arsyetim u zbatua për kërkesën për rivendosje në afat bërë nga avokati mbrojtës i caktuar nga anëtarët e familjes së të pandehurit. Autoritetet duhej të përcaktonin se i pandehuri nuk kishte dijeni efektive të dënimit të tij *in absentia* dhe nëse i pandehuri kishte dijeni efektive të caktimit të mbrojtësit nga anëtarët e familjes së tij.

D. Legjislacioni tjetër përkatës vendas

36. Neni 148 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se kur afati ligjor mbaron në një ditë pushimi apo festive, ky afat shtyhet në ditën pasardhëse të punës.

37. Neni 62 (b) i Kodit të Procedurës të ligjit administrativ parashikon se llogaritja e afateve do të pezullohet të shtunën, të dielën dhe në ditë festive.

38. Neni 2 § 1 i vendimit të Këshillit të Ministrave mbi kohëzgjatjen e orëve të punës dhe pushimeve në institucionet shtetërore (vendimi nr.511, datë 24 tetor 2002), përcakton se të shtunat dhe të dielat janë "ditë pushimi".

E DREJTA

I. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

39. Ankuesi u ankua sipas nenit 6 § 1 të Konventës se vendimi i Gjykatës Kushtetuese e kishte privuar atë nga e drejta e tij për akses në gjykatë. Më tej, ai pretendoi se procedurat penale *in absentia* nuk kishin garancitë e drejtësisë siç kërkohet nga neni 6 §§ 1 dhe 3 i Konventës, pjesët përkatëse të të cilit parashikojnë:

"1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë ..., e cila do të vendosë qoftë për mosmarrëveshjet mbi të drejtat dhe detyrimet e tij me karakter civil, ... ".

...

3. Çdo i akuzuar ka, së paku, të drejtat e mëposhtme:

a) të informohet menjëherë në një gjuhë që e kupton dhe në detaje, për natyrën dhe

shkakun e akuzës kundër tij;

b) të ketë kohën dhe mjetet e mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes së tij;

c) të mbrohet personalisht ose nëpërmjet ndihmës ligjore të përzgjedhur prej tij, nëse nuk ka mjete të mjaftueshme për të paguar për ndihmën ligjore t'i ofrohet kjo ndihmë pa pagesë kur kërkohet nga interesat e drejtësisë.

d) të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe te ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes së dëshmitarëve ne favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;

e) të ketë ndihmë pa pagesë të një përkthyesi nëse ai nuk kupton apo flet gjuhën e përdorur në gjyq."

A. Objekti i çështjes

40. Gjykata përsërit se ajo është zotëruese e karakterizimit që jepet në ligj mbi faktet e çështjes. Ajo nuk e konsideron veten të detyruar nga karakterizimi i dhënë nga një ankues apo qeveri (shih Berhani kundër Shqipërisë, nr.847/05, § 46, 27 maj 2010 dhe Scoppola kundër Italisë (nr.2) [GC], nr.10249/03, § 54, GJEDNJ 2009-...). Pavarësisht faktit se ankesat e ankuesit janë të lidhura për shkak të kundërshtimit të Qeverisë ndaj mosshterrimit të mjeteve ligjore vendase nga ankuesi (shih paragrafët 55-63 më poshtë), Gjykata vlerëson se, duke marrë parasysh rrethanat e çështjes, është me vend që ankesat të trajtohen veçmas.

B. E drejta për akses në gjykatë

1. Pranueshmëria

41. Asnjë nga palët nuk ka ngritur argumente të papranueshmërisë në lidhje me këtë ankim.

42. Gjykata vlerëson se ky ankim nuk është haptazi i pabazuar në kuptim të nenit 35 § 3 të Konventës. Më tej, ajo konstaton se nuk është i papranueshëm bazuar në argumente të tjera. Prandaj duhet të deklarohet i pranueshëm.

2. Meritat (themeli)

a) Parashtrimet e palëve

43. Qeveria parashtroi se grupi prej 3 gjyqtarësh i Gjykatës Kushtetuese e rrëzoi ankimin kushtetues të ankuesit, duke e konsideruar atë jashtë afatit. Afati filloi nga data e vendimit përfundimtar. Sipas Qeverisë, meqenëse neni 30 i aktit të Gjykatës Kushtetuese përcaktonte afatin për depozitimin e ankimit kushtetues, pa parashikuar procedurat që duhet të ndiqen në rastet kur afati skadon në ditë pushimi apo festive, Gjykata Kushtetuese iu referua nenit 144 të Kodit të Procedurës Penale. Vendimi i përfshirë në këtë nen nuk zbatohej për afatet e llogaritura në muaj dhe vite, por vetëm për afatet e llogaritura në ditë.

44. Qeveria shtoi se ankuesi nuk kishte provuar pretendimin e tij se ai nuk kishte mjetet financiare për të paraqitur ankimin kushtetues në një fazë më të hershme. Gjithsesi, ajo argumentoi se ligji parashikonte ndihmë ligjore pa pagesë për një çështje të tillë, të cilën ankuesi nuk e kërkoi.

45. Megjithatë, në komentet e tyre të mëtejshme, Qeveria pranoi se ishte shkelur e drejta

e ankuesit për akses ne gjykatë për shkak të mospranimit të ankimit kushtetues të tij nga Gjykata Kushtetuese. Ato pohuan se Gjykata Kushtetuese kishte gabuar në llogaritjen e afatit.

46. Ankuesi parashtroi se çështja në fjalë nuk kishte lidhje me afatet sipas ligjit të procedurës penale, por me afatet kushtetuese, të cilat kërkonin interpretim nga Gjykata Kushtetuese. Gjithsesi, ai pretendoi se afatet sipas ligjit të procedurës penale ishin llogaritur vetëm në ditë dhe jo në muaj dhe vite, siç argumentohej nga Qeveria. Nëse Kodi i Procedurës Penale do të zbatonte llogaritjen e afateve, afati për paraqitjen e një ankimi kushtetues do të shtyhej në ditën pasardhëse të punës në rastet kur afati binte në ditë pushimi apo festive.

47. Ankuesi e konsideronte abuziv argumentin e Qeverisë se ishte ofruar ndihmë ligjore për t'i mundësuar ankuesit depozitimin e ankimit kushtetues: nuk ekzistonte asnjë akt ligjor që të parashikonte ndihmë ligjore pa pagesë për depozitimin e këtij ankimi para Gjykatës Kushtetuese. Qeveria nuk paraqiti asnjë provë për të kundërtën.

b) Vlerësimi i Gjykatës

48. Gjykata përsërit se janë së pari autoritet kombëtare dhe veçanërisht gjykatat, ato të cilat interpretojnë të drejtën vendase dhe se Gjykata nuk zëvendëson interpretimin e saj me interpretimin e tyre në mungesë të arbitraritetit. Kjo zbatohet veçanërisht në rastin e interpretimit nga ana e gjykatave të vendimeve me natyrë procedurale, si afatet, duke rregulluar paraqitjen e dokumenteve apo depozitimin e ankesave (shih Tejedor Garcia kundër Spanjës, 16 dhjetor 1997, § 31, Raportet e vendimeve përfundimtare dhe vendimeve 1997-VIII; dhe Miragall Escolano dhe të tjerë kundër Spanjës, nr.38366/97, 38688/97, 40777/98, 40843/98, 41015/98, 41400/98, 41446/98, 41484/98, 41487/98 dhe 41509/98, § 33, GJEDNJ 2000-I).

49. "E drejta për t'iu drejtuar gjykatës ", nga e cila e drejta për akses është njëri aspekt, nuk është absolute; ajo u nënshtrohet kufizimeve që rrjedhin heshturazi veçanërisht në lidhje me kushtet e pranueshmërisë së një ankimi, meqenëse nga vetë natyra kërkon rregullimin nga Shteti, i cili gëzon një kufi të caktuar vlerësimi në këtë drejtim. Megjithatë, këto kufizime nuk duhet të kufizojnë apo pakësojnë aksesin e një personi në një mënyrë apo shtrirje të tillë që dëmton vetë thelbin e së drejtës. Së fundi, kufizime të tilla nuk janë në përputhje me nenin 6 § 1, nëse ato nuk ndjekin qëllimin e legjitimuar ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme e proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit të ndjekur (...).

50. Duke iu kthyer fakteve të çështjes në fjalë, Gjykata Kushtetuese rrëzoi ankimin kushtetues të ankuesit meqenëse ishte depozituar jashtë afatit. Palët kundërshtojnë mënyrën e llogaritjes së afatit nga Gjykata Kushtetuese.

51. Gjykata vëren se akti i Gjykatës Kushtetuese parashikon një afat 2-vjeçar për depozitimin e një ankimi kushtetues. Afati fillon nga data e njoftimit të vendimit të gjykatës së shkallës së fundit. Më tej, ajo vërejti se akti i Gjykatës Kushtetuese nuk përmban asnjë vendim procedural për llogaritjen e afatit 2-vjeçar dhe veçanërisht, në rastet kur mbarimi i afatit bie në ditë pushimi apo festive. Megjithatë, ajo parashikon se, kur përballet me çështje procedurale, Gjykata Kushtetuese duhet t'u referohet vendimeve të tjera procedurale duke marrë parasysh natyrën ligjore të çështjes (shih paragrafët 1 dhe 30 të aktit të Gjykatës Kushtetuese në paragrafin 29 më lart, si dhe paragrafin 30 më lart).

52. Në çështjen në fjalë, Gjykata Kushtetuese llogariti ecjen e afatit 2-vjeçar nga data e shpalljes së vendimit të Gjykatës së Lartë më 15 janar 2003. Edhe duke supozuar se data e

fillimit për llogaritjen e periudhës 2-vjeçare ishte me të vërtetë 15 janar 2003, Gjykata nuk është e bindur se ankuesi depozitoi ankimin e tij kushtetues jashtë afatit.

Gjykata vëren se afati ligjor mbaroi më 15 janar 2005 që binte të shtunën. Duke marrë parasysh faktin se e shtuna është ditë pushimi (shih paragrafin 38 më lart) dhe duke marrë në konsideratë mënyrën e llogaritjes së afatit sipas nenit 144 § 3 të KPP-së (shih paragrafin 32 më lart), Gjykata vlerëson se afati duhej të ishte shtyrë automatikisht në ditën pasardhëse të punës, që në rastin konkret ishte 17 janar 2005. Ankimi kushtetues i ankuesit, në të vërtetë, është vulosur më 17 janar 2005 dhe rrjedhimisht ankimi i tij duhej të konsiderohej në përputhje me afatin ligjor. Qeveria e pranoi këtë fakt në komentet e saj të mëtejshme.

53. Për më tepër, Gjykata vëren se procedurat e ankuesit dhe dënimi ishin kryer *in absentia*. Nga informacioni në dosjen e çështjes rezulton se ankuesi u njoh me dënimin e tij *in absentia* vetëm më 14 qershor 2003, datë në të cilën ai iu dorëzua autoriteteve. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se data e fillimit për ecjen e afatit të fundit që ankuesi të depozitonte një ankim kushtetues duhet të ishte 14 qershor 2005 (shih, gjithashtu, praktikën ligjore të Gjykatës Kushtetuese përmendur në paragrafin 31 më lart).

54. Gjykata vlerëson se vendimi i kundërshtuar do të thotë mohim i pajustifikuar i së drejtës së ankuesit për akses në Gjykatën Kushtetuese. Për rrjedhojë, ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

C. Padrejtësia e procedurave penale *in absentia*.

1. Pranueshmëria

a) Parashtrimet e palëve

55. Qeveria parashtroi se ankuesi nuk kishte shteruar mjetet ligjore vendase. Ai mund të depozitonte një kërkesë për rivendosje në afat në përputhje me nenin 147 të KPP-së ose të paraqiste një kërkesë për rishqyrtimin e vendimit përfundimtar në përputhje me nenin 450 të KPP-së.

56. Ankuesi argumentoi se veprimi për rivendosje në afat nuk ishte një mjet i zakonshëm ankimi. Më tej, ai argumentoi se padrejtësia e procedurave penale ndaj tij nuk mund të rregullohej nga një kërkesë për rishqyrtim të vendimit përfundimtar. Në vend të saj, ai kishte bërë rekurs para Gjykatës Kushtetuese, sipas nenit 131 (f) të Kushtetutës, pasi gjykatat vendase kishin vendosur përfundimisht mbi themelin e çështje së tij.

b) Vlerësimi i Gjykatës

57. Gjykata përsërit se vendimi për shterimin e mjeteve ligjore vendase përmendur në nenin 35 të Konventës detyron të gjithë ata që paraqesin çështjen kundër Shtetit para Gjykatës të përdorin së pari mjetet ligjore të parashikuara nga sistemi ligjor kombëtar. Ankesat duhej t'i ishin bërë organit vendas të duhur, të paktën në themel dhe në përputhje me kërkesat formale dhe afatet e paraqitura në të drejtën vendase dhe, më tej, se duhej të përdorej çdo mjet procedural që mund të pengonte shkeljen e Konventës (shih, ndërmjet të tjerash, Laska dhe Lika kundër Shqipërisë, nr.12315/04 dhe 17605/04, § 41, 20 prill 2010).

58. Duke iu kthyer çështjes në fjalë, Gjykata rithekson se ajo ka vendosur që kërkesa për rishqyrtimin e një vendimi përfundimtar është një mjet ligjor i jashtëzakonshëm, i cili, si rregull i përgjithshëm, nuk mund të merret në konsideratë për qëllime të zbatimit të nenit 35 § 1 të

Konventës (shih Laska dhe Lika, cituar më lart, §§ 50-51).

59. Gjykata, më tej, vëren se neni 147 i KPP-së parashikon mundësinë që i akuzuari të kërkojë rivendosje në afat. Megjithatë, Qeveria nuk i siguroi Gjykatës praktikën ligjore vendase mbi interpretimin në praktikë të dispozitave të këtij neni. Gjykata përsërit se është detyrë e Qeverisë, e cila pretendon mosshterimin të bindë Gjykatën se mjeti ligjor ishte efektiv si në teori, ashtu edhe në praktikë në kohën përkatëse, që do të thotë se ishte i arritshëm, i aftë të siguronte zgjidhje në lidhje me ankesat e ankuesit dhe të ofronte perspektivën e arsyeshme të përfitimit (shih Akdivar dhe të tjerë kundër Turqisë, 16 shtator 1996, § 68, raporte të vendimeve përfundimtare dhe vendimeve 1996-IV; dhe më vonë, Demopoulos dhe të tjerë kundër Turqisë (dec.) [GC], nr.46113/99, 3843/02, 13751/02, 13466/03, 10200/04, 14163/04, 19993/04 dhe 21819/04, § 70..., GJEDNJ 2010-...).

60. Përveç kësaj, Gjykata vëren se, në apel ankuesi është mbrojtur nga një avokat i caktuar nga anëtarët e familjes së tij. Gjykata vlerëson se nëse ankuesi do të kishte depozituar kërkesën për rivendosje në afat, efektiviteti i një kërkese të tillë duhet të mendohet se lë vend për dyshime, duke marrë parasysh vendimet e gjykatave vendase në çështje të tjera ku kërkesa e të akuzuarit për rivendosje në afat është rrëzuar inter alia, me argumentin se ai është përfaqësuar në procedurat gjyqësore *in absentia* nga një avokat i caktuar nga familja e tij (shih paragrafin 34 më lart). Prandaj, Gjykata nuk është e bindur se kërkesa për rivendosje në afat do të kishte perspektivën reale të përfitimit në rastin kur ankuesi ishte përfaqësuar në apel nga një avokat i caktuar nga familja e tij.

61. Me të gjitha vëzhgimet e mësipërme, Gjykata do të shqyrtojë nëse ankuesit i është kërkuar vërtet të bëjë rekurs me ndonjë mjet tjetër ligjor vendas. Në këtë drejtim, Gjykata përsërit, se në rastet kur ka një numër të caktuar mjetesh ligjore që një individ mund të ndjekë, ky person ka të drejtë të zgjedhë mjetin ligjor, i cili trajton ankesat e tij thelbësore (shih Croke kund Irlandës (dec), nr.3367/96, 15 qershor 1999). Me fjalë të tjera, kur një mjet ligjor është ndjekur, nuk kërkohet përdorimi i një mjeti tjetër ligjor, i cili në thelb ka të njëjtin objektiv (shih Moreira Barbosa kundër Portugalisë (dec), nr.65681/01, GJEDNJ 2004-V).

62. Dukej se apelimi para Gjykatës Kushtetuese është një mjet ligjor efektiv për të kundërshtuar një dënim in absentia (shih paragrafin 31 më lart). Megjithatë, në çështjen në fjalë, Gjykata Kushtetuese e rrëzoi apelin e ankuesit me argumentin se Gjykata ka konstatuar mospërputhje me nenin 6 § 1, siç shihet në paragrafët 48-54 më lart.

63. Prandaj, Gjykata rrëzon kundërshtimet e Qeverisë. Gjykata vëren se kjo ankesë nuk është haptazi e pabazuar. Më tej, ajo konstaton se nuk është e papranueshme dhe për rrjedhojë e deklaron të pranueshme.

2. Meritat (themeli)

a) Parashtrimet e palëve

64. Qeveria parashtroi se ankuesi nuk gjendej askund. Si rezultat, njoftimet i dërgoheshin avokatit të tij të caktuar kryesisht në përputhje me ligjin. Gjykatat vendase e deklaruan atë si person që i fshihet drejtësisë dhe vazhduan procedurat *in absentia* pas përpjekjeve të pasuksesshme për ta gjetur atë. Ankuesi është ndihmuar nga një avokat i caktuar kryesisht, i cili është njoftuar për të gjitha akuzat dhe ka marrë pjesë dhe përfaqësuar atë gjatë hetimit penal dhe procedurave të gjykatës.

65. Ankuesi parashtroi se autoritetet e kanë gjykuar atë qëllimisht *in absentia* pa kryer një kërkim të plotë të vendndodhjes së tij. Ai pretendonte se avokati i caktuar kryesisht ishte caktuar nga prokurori dhe jo nga gjykatat vendase. Ai pretendonte se nuk ishte njoftuar personalisht për asnjë akuzë, të paktën deri në momentin kur Gjykata e Rrethit ka urdhëruar ndalimin e tij, kur presupozohej se ai ishte akoma i lirë.

b) Vlerësimi i Gjykatës

66. Gjykata vëren se parimet e përgjithshme, për sa u përket procedurave *in absentia* janë përshkruar në Sejdovic kundër Italisë [GC], nr.56581/00, §§ 81-95, GJEDNJ 2006-II.

67. Gjykata, më tej rithekson se, garancitë në paragrafin 3 të nenit 6 janë drejtime specifike të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor përcaktuar në paragrafin 1 (shih Edëards kundër Mbretërisë së Bashkuar, 16 dhjetor 1992, § 33, seria A nr.247-B). Në rrethanat e çështjes ajo konstaton të domosdoshme shqyrtimin e lidhjes së paragrafit 3 me çështjen, meqenëse pretendimet e ankuesit, gjithsesi, arrijnë në ankimin se procedimet kanë qenë të padrejta. Prandaj ajo do të kufizojë shqyrtimin e saj në këtë pikë.

68. Në çështjen në fjalë, Gjykata vëren se pas të paktën dy kontrolleve të pasuksesshme të shtëpisë së ankuesit, ankuesi është deklaruar që i fshihet drejtësisë nga gjykatat vendase më 11 tetor 2001. Një avokat është caktuar ta përfaqësojë atë dhe është njoftuar për akuzat ndaj ankuesit. Nuk është kundërshtuar që ankuesi nuk kishte marrë asnjë informacion zyrtar për akuzat apo datën e gjykimit të tij.

69. Gjykata, më tej do të shqyrtojë nëse në mungesë të njoftimit zyrtar, ankuesi mund të konsiderohet se ka pasur dijeni për procedimin penal dhe gjykimin e tij, aq sa mund të konsiderohet se ai ka hequr dorë nga e drejta e tij për t'u paraqitur në gjyq.

70. Në çështjet e mëparshme në lidhje me dënimet *in absentia*, Gjykata ka argumentuar se informimi i një personi mbi procedimin penal filluar ndaj tij është një akt ligjor me një rëndësi të tillë që duhet të zbatohet në përputhje me kërkesat procedurale dhe të mirëfillta të afta për të siguruar ushtrimin efektiv të të drejtave të akuzuarit. Dijenitë e paqarta dhe të parregullta nuk mjaftojnë (shih T. kundër Italisë, cituar më lart § 28, dhe Somogyi kundër Italisë, nr. 67972/01, § 75, GJEDNJ 2004-IV). Megjithatë, Gjykata nuk mund të përjashtojë mundësinë se disa fakte të përcaktuara mund të përbëjnë një tregues të qartë se i akuzuari është në dijeni të ekzistencës së procedimeve penale kundër tij, si dhe të natyrës dhe shkakut të akuzës dhe nuk ka ndërmend të marrë pjesë në gjykim apo dëshiron t'i shmanget procedimit penal. Kjo mund të ndodhë, për shembull në rastet kur i akuzuari deklaron publikisht ose me shkrim se ai nuk ka ndërmend t'u përgjigjet kërkesave për t'u paraqitur, për të cilat ai është vënë në dijeni nëpërmjet burimeve të ndryshme nga autoritetet, ose vijon t'i shmanget përpjekjes për arrestimin e tij (shih, ndërmjet autoriteteve të tjera, Ivarazzo kundër Italisë (dec.), nr.50489/99, 4 dhjetor 2001), apo kur autoriteteve u paraqiten materiale të cilat tregojnë qartë se ai është në dijeni të procedurave në pritje ndaj tij dhe të akuzave me të cilat përballet.

71. Në çështjen në fjalë, Gjykata vëren se apelimet para Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës së Lartë kishin nënshkrimin e ankuesit. Megjithatë, në apelin e tij kushtetues, ankuesi kundërshtoi vërtetësinë e nënshkrimit. Meqenëse apeli kushtetues është deklaruar i papranueshëm, ankuesit i është privuar mundësia që të paraqesë çështjen e tij në Gjykatën Kushtetuese, pasi nënshkrimi nuk ishte i tij dhe se, për rrjedhojë ai nuk kishte dijeni efektive të procedurave ndaj tij.

72. Fakti që ankuesi është mbrojtur në apel nga një avokat i caktuar nga babai i tij nuk do të thotë se ai kishte dijeni të mëparshme reale të procedurave ndaj tij. Gjykatat vendase nuk e shqyrtuan fare këtë çështje dhe Qeveria nuk parashtroi ndonjë provë për të kundërtën.

73. Së fundi, thjesht mungesa e ankuesit në shtëpi nuk mjafton për të konsideruar se ai kishte dijeni për procedurat dhe, për rrjedhojë kishte ikur. Më tej, nuk duket se është kryer ndonjë kërkim tjetër në vend apo jashtë shtetit (shih Ay Ali kundër Italisë, nr.24691/04, § 44, 14 dhjetor 2006; dhe Zunic kundër Italisë, nr.14405/05, § 60, 21 dhjetor 2006). Për më tepër, kuptohet nga dosja e çështjes se ankuesi iu dorëzua autoriteteve me qëllim që të kundërshtojë dënimin e tij in absentia sapo u njoftua për dënimin e caktuar ndaj tij.

74. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se nuk është treguar që ankuesi kishte dijeni të mjaftueshme të procedurave ligjore ndaj tij, që ai në mënyrë të qartë dhe të plotë autorizoi veprimet e anëtarëve të familjes së tij në apel, apo në mënyrë të qartë ka hequr dorë nga e drejta e tij për t'u paraqitur në gjykatë duke iu shmangur me paramendim drejtësisë.

75. Për sa i përket faktit nëse e drejta vendase i siguroi ankuesit në mënyrë të mjaftueshme mundësinë për një gjykim të ri, Gjykata rithekson konkluzionet e saj në lidhje me mungesën e mjeteve ligjore efektive në dispozicion të ankuesit, si dhe mungesën e përfitimit në përdorimin e këtyre mjeteve ligjore (shih paragrafët 57-63 më lart).

76. Prandaj ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në çështjen në fjalë për shkak të padrejtësisë së procedurave dhe të dënimit të ankuesit in absentia.

ZBATIMI I NENEVE 46 DHE 41 TË KONVENTËS

A. Neni 46 i Konventës

77. Neni 46 parashikon:

"Neni 46

1. Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër që t'i përmbahen vendimit përfundimtar të Gjykatës në çdo rast ku ata janë palë.

2. Vendimi përfundimtar i Gjykatës do t'i njoftohet Komitetit të Ministrave, i cili do të mbikëqyrë ekzekutimin e tij."

78. Gjykata përsërit më poshtë konstatimet e saj në Laska dhe Lika, cituar më lart.

"3. Në çështjen në fjalë, Gjykata konstatoi se ishte shkelur rëndë nga autoritetet vendase e drejta e ankuesve për një gjykim të drejtë. Gjykata vëren se kur një ankues është dënuar për shkelje të të drejtave të tij të garantuara në nenin 6 të Konventës, ai duhet, sa të jetë e mundur, të vendoset në pozicionin në të cilin ai do të kishte qenë nëse kushtet e asaj dispozite nuk do të shkeleshin, dhe që në parim, forma më e duhur shqyrtimit, do të gjykohej *de novo* apo rihapja e procedimeve, nëse kërkohej (shih Caka k. Shqipërisë, nr. 44023/02, § 122, 8 dhjetor 2009; Salduz, cituar më lart, § 72; Xheraj k. Shqipërisë, nr.37959/02, § 82, 29 korrik 2008; Öcalan k. Turqisë [GC], nr. 46221/99, § 210 in fine, GJEDNJ 2005-IV).

4. Gjykata konsideron se, në çështjen në fjalë, një rigjykim ose rihapje e çështjes, nëse kërkohet nga ankuesi, në parim përfaqëson mënyrën e duhur të rregullimit të shkeljes. Kjo është në përputhje me udhëzimet e Komitetit të Ministrave, që në rekomandimin nr. R (2000) 2 i kërkonte Shteteve anëtare të Konventës futjen e mekanizmave për rishqyrtimin e çështjes dhe rihapjen e procedurave gjyqësore në nivelin vendas, duke konstatuar që masa të tilla

përfaqësonin "mjetin më efikas, nëse jo të vetmin për arritjen e dëmshpërblimit *in integrum*" (shih paragrafin më lart).

5. Gjykata vëren se sistemi ligjor penal i Shtetit të paditur nuk parashikon mundësinë e rishqyrtimit të çështjeve, duke përfshirë rihapjen e procedurave vendase, në rast se kjo Gjykatë konstaton shkelje të rëndë të së drejtës së ankuesit për gjykim të drejtë. Nuk është detyrë e Gjykatës të tregojë se si mund të sigurohet një mundësi e tillë dhe çfarë forme duhet të marrë ajo. Shteti i paditur mbetet i lirë, nën monitorimin e Komitetit të Ministrave, për të zgjedhur mjetet me të cilat do të kryejë detyrimin e tij për të vendosur ankuesin, sa është e mundur, në pozicionin që ai do të kishte qenë nëse kërkesat e Konventës nuk do të ishin shkelur (shih Piersack k. Belgjikës (neni 50), 26 tetor 1984, § 12, seria A nr.85), me kusht që mjete të tilla të jenë në përputhje me konkluzionet e përcaktuara në vendimin e Gjykatës, si dhe me të drejtat e mbrojtjes (shih Lyons dhe të tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar (dec.), nr.15227/03, GJEDNJ 2003-IX).

(...)"

79. Gjykata vlerëson se nuk ka arsye për t'iu shmangur këtyre konkluzioneve.

B. Neni 41 i Konventës

80. Neni 41 i Konventës parashikon si më poshtë:

"Neni 41

Kur Gjykata konstaton shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese mundëson vetëm ndreqje të pjesshme të pasojave që kanë rrjedhur nga kjo shkelje, Gjykata, nëse është e nevojshme, i jep palës së dëmtuar një shpërblim të drejtë."

1. Dëmi

81. Ankuesi pretendoi 7,000 euro në lidhje me dëmet materiale dhe 30,000 euro në lidhje me dëmet jomateriale. Ai parashtroi se dëmet materiale lidheshin me shpenzimet e tij në burg, si: ushqime, ilaçe dhe karta telefoni.

82. Qeveria nuk parashtroi asnjë koment.

83. Gjykata përsërit se do të caktojë shuma për shpërblim të drejtë sipas nenit 41 në rastet kur humbja apo dëmi i pretenduar është shkaktuar nga shkelja që ajo ka konstatuar (shih Sejdovic, cituar më lart, § 131).

84. Në çështjen në fjalë, Gjykata nuk cakton shpërblim në lidhje me dëmin material, meqenëse nuk ka lidhje shkakore ndërmjet shkeljes që ajo ka konstatuar dhe pretendimeve të ngritura nga ankuesi.

85. Për sa i përket dëmit jomaterial, Gjykata konsideron se, në rrethanat e çështjes, vetë konstatimi i shkeljes përbën një shpërblim të drejtë të mjaftueshëm (shih, ndërmjet të tjerash, Popovitsi kundër Greqisë, nr. 53451/07, § 36, 14 janar 2010; Zunic, cituar më lart, § 72; Ay Ali, cituar më lart, § 57; dhe Sejdovic, cituar më lart, § 134). Gjykata rithekson në këtë drejtim vëzhgimet e saj në paragrafët 78 dhe 79 për sa i përket formës së duhur të zgjidhjes për shkeljen që ajo ka konstatuar.

2. Kosto dhe shpenzime

86. Ankuesi pretendoi 7,000 euro për kostot dhe shpenzimet e bëra në procedurat e Strasburgut, të cilat u ndanë në 2,000 euro për koston e përkthimit dhe 5,000 euro për tarifën ligjore.

87. Qeveria nuk bëri asnjë koment.

88. Duke marrë parasysh informacionin që ajo ka dhe praktikën përkatëse, Gjykata e çmon të arsyeshme t'i caktojë ankuesit shumën 4,000 euro.

3. Interesi i munguar

89. Gjykata e mendon të arsyeshme se interesi i munguar duhet të bazohet në kursin margjinal të huas së Bankës Qendrore Europiane, mbi të cilën duhet të shtohen 3 për qind.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NJËZËRI:

1. Deklaron ankimin të pranueshëm.

2. Vendos se ka shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës, për shkak të mohimit të pajustifikuar të së drejtës së ankuesit për akses në Gjykatën Kushtetuese.

3. Vendos se ka shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës, për shkak të padrejtësisë së procedurave dhe të dënimit të ankuesit in absentia.

4. Vendos se vetë konstatimi i shkeljes përbën një shpërblim të drejtë të mjaftueshëm për çdo dëm jomaterial të përballuar nga ankuesi.

5. Vendos:

a) se Shteti i paditur duhet të paguajë ankuesin, brenda tre muajve nga data në të cilën vendimi bëhet përfundimtar, në përputhje me nenin 44 § 2 të Konventës, 4,000 euro në lidhje me kostot dhe shpenzimet, të konvertuar në monedhën e Shtetit të paditur, me normë të aplikueshme në datën e pagimit, plus çdo tatim që mund të vendoset;

b) se që prej skadimit të periudhës prej tre muajsh të përmendur më lart deri në pagim, mbi shumën e mësipërme paguhen interesa të thjeshta të barabarta me kursin margjinal të huas së Bankës Qendrore Europiane gjatë periudhës së mospagimit, plus tre për qind.

6. Rrëzon pjesën tjetër të pretendimit të ankuesit për shpërblim të drejtë.

Bërë në anglisht, dhe njoftuar me shkrim më datën 10 maj 2011, në përputhje me nenin 77 §§ 2 dhe 3 të rregullores së Gjykatës.

Laërence Early — Nikolas Bratza

Sekretar — President

ÇËSHTJA “LASKA DHE LIKA KUNDËR SHQIPËRISË”

(Ankimet nr. 12315/04 dhe 17605/04)

VENDIM

STRASBURG
2O prill 2010

Ky vendim do të marrë formë të prerë në rrethanat e përcaktuara në nenin 44 § 2 të Konventës. Ai mund t’i nënshtrohet rishikimit redaktues.

Në çështjen Laska dhe Lika kundër Shqipërisë,

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Katërt), duke gjykuar si dhomë e përbërë nga:

Nicolas Bratza, president
Lech Garlicki,
Giovanni Bonello,
Ljiljana Mijović,
Päivi Hirvelä,
Ledi Bianku,
Nebojša Vučinić, gjyqtarë,
dhe Fatoş Aracı, zëvendësregjistrues i Seksionit,
pas shqyrtimit me dyer të mbyllura, më 12 janar 2010 dhe 23 mars 2010,
shpall vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në datën e fundit të përmendur:

PROCEDURA

7. Çështja e ka zanafillën në dy ankime (nr. 12315/04 dhe 17605/04) kundër Republikës së Shqipërisë, depozituar pranë Gjykatës sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) nga dy shtetas shqiptarë, z. Vladimir Laska dhe z. Artur Lika (ankuesit), më 8 mars 2004.

8. Ankuesit u përfaqësuan nga z. A. Dobrushi i Qendrës Europiane për të Drejtat e Romëve dhe më pas u bashkëpërfaqësuan nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit. Qeveria Shqiptare (Qeveria) u përfaqësua nga agjentja e asaj kohe, znj. S. Meneri, dhe, në vijim të parashtrimit të komenteve të saj mbi pretendimin e ankuesit për një dëmshpërblim të drejtë, nga agjentja e saj, znj. E. Hajro.

9. Ankuesit u ankuan sipas nenit 3 të Konventës se ata i ishin nënshtruar keqtrajtimit gjatë marrjes në pyetje nga ana e policisë për t’i detyruar të pranonin shkeljet e supozuara. Gjithashtu bazuar në nenin 6 § 1 të Konventës ata u ankuan për padrejtësi të procedimeve gjyqësore.

10. Më 10 tetor 2007 zëvendëspresidenti i Seksionit, të cilit i ishte caktuar çështja, vendosi ta njoftojë Qeverinë për ankimet. Sipas dispozitave të nenit 29 § 3 të Konventës, u vendos të shqyrtohej themeli i ankimeve në të njëjtën kohë me pranueshmërinë e tyre.

11. Secila nga palët, ankuesit dhe Qeveria, parashtruan vërejtjet e tyre me shkrim (rregulli 59 § 1).

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

12. Të dy ankuesit kanë lindur në vitin 1980 dhe aktualisht vuajnë dënimin me burgim në burgun e Burrelit, në Shqipëri.

A. Arrestimi i ankuesve

13. Më 31 mars 2001 në mëngjes, tre persona të veshur me kapuça me ngjyrë blu dhe të bardhë, grabitën një mikrobus në linjën ndërmjet Tiranës dhe Kukësit. Ata ishin të armatosur me dy kallashnikovë dhe një thikë. Pasi kanë marrë paratë dhe stolitë e pasagjerëve, ata janë larguar nga vendi i ngjarjes pa shkaktuar viktima.

14. Disa orë pas ngjarjes, policia kontrolloi shtëpitë pranë vendngjarjes, duke përfshirë edhe atë të z. Lika (ankuesi i dytë), ku ai po hante drekë me babain e tij, vëllain e tij, B.L., dhe shokun e tij, z. Laska (ankuesi i parë).

15. Oficerët e policisë kanë kryer kontrollin e mësipërm në mungesë të avokatit të ankuesve.

16. Sipas raportit të kontrollit të policisë, policia gjeti në xhepin e xhaketës së ankuesit të parë dy bluza pambuku dhe një cohë ngjyrë blu, të bëra në kapuça. Për më tepër, në afërsi të shtëpisë ata gjetën disa granata, por nuk arritën të gjejnë mallra të vjedhura apo armë që kishin qenë në posedim të agresorëve.

17. Ankuesit, B.L, dhe babai u shoqëruan në polici për t'u pyetur. Ankuesi i parë kërkoi, por iu refuzua prania e avokatit të tij (H.B). Ai kundërshtoi të ketë pasur në zotërim të tij një kapuç apo lloj tjetër maske, si dhe akuzoi policinë për manipulimin e provave.

18. Në të njëjtën ditë, oficerët e policisë të ngarkuar me hetimin vazhduan me identifikimin e personave dhe sendeve të viktimave të grabitjes, sipas neneve 171 dhe 172 të Kodit të Procedurës Penale (KPP). Avokati i ankuesve nuk ishte i pranishëm.

19. Në lidhje me identifikimin e personave, ankuesit dhe B.L., të veshur me kapuça blu dhe të bardhë të bëra në shtëpi, dhe dy persona të tjerë të veshur me kapuça të zinj, janë vendosur në rresht në të njëjtën dhomë në mënyrë që të identifikoheshin. Pavarësisht nga fakti se policia ndryshoi pozicionin e personave në dhomë, viktimat identifikuan vazhdimisht personat me kapuça blu dhe të bardhë si agresorë, që do të thotë ankuesit dhe B.L.

20. Në lidhje me identifikimin e objekteve, viktimave iu kërkua të identifikojnë kapuçat e përdorur nga agresorët, duke zgjedhur ndërmjet dy kapuçave të zinj, dy kapuçave të bardhë dhe një blu. Viktimat identifikuan kapuçat e bardhë dhe blu njëlloj me ato të veshur nga agresorët.

21. Në orën 21.30 në të njëjtën ditë, ankuesit dhe B.L. u arrestuan me dyshimin për grabitje të armatosur. Ata u pyetën nga policia në mungesë të një avokati, pavarësisht nga fakti se B.L. ishte i mitur në atë periudhë dhe se ankuesit kishin kërkuar haptazi praninë e një avokati. Ankuesi i parë pranoi se kishte në zotërim të tij një bluzë pambuku të bardhë, të shndërruar nga F.N, një oficer policie i ngarkuar me hetimet, në një kapuç të bërë në shtëpi.

Ankuesi i dytë deklaroi se bluza prej pambuku e bardhë që ishte gjetur në posedim të ankuesit të parë nuk ishte e tij.

22. Më 2 prill 2001 ankuesit dhe B.L. u akuzuan për grabitje të armatosur dhe për armëmbajtje pa leje. Ata u pyetën nga prokurori në të njëjtën ditë. Ankuesi i parë kërkoi të përfaqësohej nga H.B. Ankuesi i dytë kërkoi të mbrohej nga një avokat.

B. Procedimet gjyqësore kundër ankuesve

23. Më 29 qershor 2001 Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm (ZPP) kërkoi të inspektojë dosjen penale të hetimit në lidhje me ankuesin e dytë. Më 10 shtator 2001 ZPP pranoi çështjen duke u angazhuar për gjykimin e saj.

24. Më 11 shtator 2001, prokurori dërgoi ankuesit dhe B.L. për gjykim me akuzën e grabitjes së armatosur dhe armëmbajtje pa leje.

25. Gjatë seancës gjyqësore të datës 26 nëntor 2001 pranë Gjykatës së Rrethit Pukë, (Gjykata e Rrethit), ankuesit kundërshtuan akuzat kundër tyre dhe i kërkuan gjykatës vendase ta deklaronte të pavlefshëm identifikimin e kryer nga policia të personave dhe objekteve, meqenëse përbënte shkelje të dispozitave përkatëse të KPP. Për më tepër, ata akuzonin oficerët e policisë të ngarkuar me hetimin për manipulimin e provave kundër tyre, për këtë arsye ankuesit i kërkuan gjykatës të thërrasë oficerët e policisë si dëshmitarë dhe të paraqesin në gjyq sendet e konsideruara nga policia si kapuça, por të cilat ishin, sipas mendimit të tyre, bluza pambuku të thjeshta. Ankuesit i kërkuan gjykatës vendase për të përjashtuar provat e paligjshme kundër tyre. Në lidhje me akuzën për armëmbajtje pa leje, ankuesit pohuan se hetimi nuk kishte arritur të gjente armët e përdorura nga shkelësit e ligjit gjatë grabitjes, si dhe nuk ishte provuar që granatat e gjetura ishin në posedim të tyre. Të dy ankuesit u përfaqësuan nga i njëjti mbrojtës, P.Gj.

26. Më 24 maj 2002 gjykata e rrethit rrëzoi kërkesën e ankuesve për të thirrur si dëshmitarë oficerët e policisë, pa dhënë arsyet. Pavarësisht faktit që gjykata konstatoi disa parregullsi gjatë fazës së hetimeve (si mungesa e avokatit gjatë pyetjes së ankuesve dhe gjatë identifikimit të personave dhe objekteve), gjykata i shpalli ankuesit fajtorë për grabitje të armatosur bazuar në identifikimin e dëshmitarëve okularë të ankuesve si shkelës të ligjit. Për më tepër, gjykata i shpalli ankuesit fajtorë për armëmbajtje pa leje të dy kallashnikovëve, si dhe B.L. fajtor për posedim të një thike. Meqenëse nuk janë gjetur armë, dënimi i ankuesve është bazuar në deklaratat e dëshmitarëve okularë. Gjykata i dënoi ankuesit me trembëdhjetë vjet burg dhe B.L. me pesë vjet burg. Ankuesit janë urdhëruar të vuajnë dënimin e tyre në një burg të sigurisë së lartë.

27. Më 29 maj 2002 ankuesit iu drejtuan Gjykatës së Apelit Shkodër (Gjykata e Apelit), për arsye se vendimi i gjykatës së rrethit ishte rezultat i procedurave të padrejta. Ata argumentuan që identifikimi është kryer në shkelje flagrante të neneve 171-175 të KPP meqenëse ata mbanin veshur të njëjtët kapuça gjatë paradës së identifikimit. Kërkesa e avokatëve të tyre mbi pavlefshmërinë e veprimeve në lidhje me identifikimin, ishte refuzuar nga gjykata. Gjithashtu ata deklaruan që asnjë nga provat materiale (kapuçat), siç u kërkua nga ata vetë, nuk u paraqitën në procedimet gjyqësore. Për më tepër, autoritetet nuk kanë arritur të gjejnë paratë dhe armët që janë përdorur gjatë grabitjes.

28. Më 9 shtator 2002, gjykata e apelit la në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit.

29. Më 7 tetor 2002 ankuesit apeluan pranë Gjykatës së Lartë. Ata u bazuan në të

njëjtat argumente të ankimit si para gjykatës së apelit. Gjithashtu ata pretenduan që të dy janë përfaqësuar nga i njëjti mbrojtës para gjykatave më të ulëta, në një kohë kur në dëshmitë e tyre kishte mospërputhje gjatë hetimeve penale.

30. Më 26 dhjetor 2002 Gjykata e Lartë e shpalli ankimin të papranueshëm meqenëse argumentet e tij ishin jashtë fushës së veprimit të nenit 432 të KPP.

31. Në një datë të pacaktuar ankuesi i parë depozitoi një ankesë pranë Gjykatës Kushtetuese mbi padrejtësinë e procedimeve gjyqësore. Ai u bazua në të njëjtat argumente të ngritura pranë gjykatës së apelit dhe Gjykatës së Lartë.

32. Më 17 shtator 2004 Gjykata Kushtetuese, me trup gjykues prej tre gjyqtarësh, e deklaroi ankimin të papranueshëm. Ajo vendosi që ankimet e ankuesve nuk ngrinin çështje që lidhen me gjykimin e drejtë, por kryesisht kishin të bënin me vlerësimin e provave, gjë që ishte funksion i gjykatave më të ulëta.

C. Pretendimi për keqtrajtim nga policia

33. Ankuesit pretenduan që janë keqtrajtuar nga F.N. dhe oficerë të tjerë të policisë gjatë marrjes në pyetje. Ata pretendonin se janë lidhur me litarë, rrahur dhe lagur me ujë të ftohtë gjatë hetimeve.

34. Në seancën gjyqësore të datës 26 nëntor 2001 pranë gjykatës së rrethit, ankuesit pretenduan se janë keqtrajtuar nga oficerët e policisë të ngarkuar me hetimet, në atë që ky i fundit ishte përpjekur të detyronte ata të pranonin grabitjen dhe të tregonin vendndodhjen e mallrave të vjedhura dhe armëve të përdorura. B.L. dhe ankuesit kanë dhënë të njëjtin përshkrim për keqtrajtimin e pretenduar.

35. Më 24 maj 2002 Gjykata e Rrethit rrëzoi kërkesat e ankuesve duke argumentuar që ato janë parashtruar përtej afatit gjashtëmujor. Në vendim nuk është përmendur asnjë bazë ligjore.

II. E DREJTA NDËRKOMBËTARE DHE E BRENDSHME PËRKATËSE DHE PRAKTIKA

A. E drejta e brendshme përkatëse dhe praktika

1. Kodi i Procedurës Penale

36. Kodi shqiptar i Procedurës Penale (KPP) në pjesët përkatëse vijon si më poshtë:

Neni 171: Identifikimi i personave

1. Kur lind e drejta për identifikimin e një personi, autoriteti procedues fton personin që duhet të bëjë identifikimin që të përshkruajë personin (që do të identifikohet), në lidhje me të gjitha shenjat që ai/ajo kujton dhe personi pyetet nëse ai/ajo është thirrur më parë për të bërë identifikimin dhe për rrethana të tjera, të cilat mund të ndihmojnë në saktësinë e identifikimit.

2. Veprimet e parashikuara në paragrafin 1 dhe deklaratat e bëra nga personi që bën identifikimin shënohen në regjistër.

3. Moszbatimi në përputhje me dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 përbën shkak për pavlefshmërinë e identifikimit.

Neni 172: Kryerja e identifikimit

1. Autoriteti procedues, pasi largon personin që do të bëjë identifikimin, siguron praninë e të paktën dy personave, të cilët të duken mundësisht sa më të ngjashëm, me

personin që do të identifikohet. Më pas fton këtë të fundit për të zgjedhur vendin e tij/saj në lidhje me të tjerët, duke u kujdesur që t'i duket portreti, sa më shumë që të jetë e mundur, në të njëjtat rrethana në të cilat ai/ajo do të ishte parë nga personi i thirrur për të bërë identifikimin. Pasi shfaqet personi që do të bëjë identifikimin, gjykata e pyet këtë të fundit nëse ai/ajo njeh ndonjërin prej personave të pranishëm për identifikim, dhe nëse po, të tregojë personin që ai/ajo njeh, si dhe të përcaktojë nëse ai/ajo është i sigurtë.

2. Kur ka arsye të besohet se personi i thirrur për të bërë identifikimin mund të jetë i frikësuar ose i ndikuar nga prania e personit që do identifikohet, autoriteti procedues urdhëron kryerjen e veprimit pa e parë ky i fundit të parin.

3. Regjistrimi duhet të përshkruajë mënyrën e kryerjes së identifikimit. Nëse kjo gjë nuk mundësohet, identifikimi bëhet i pavlefshëm. Për qëllime regjistrimi, autoriteti procedues mund të urdhërojë që kryerja e identifikimit të fotografohet apo filmohet.

Neni 173: Identifikimi i objekteve

1. Kur duhet të kryhet identifikimi i provave materiale apo objekteve të tjera në lidhje me veprën penale, autoriteti procedues vepron në përputhje me rregullat për identifikimin e personave në masën që ato janë të zbatueshme.

2. Pas zbulimit, nëse është e mundur, e të paktën dy objekteve të ngjashme me atë që do të identifikohet, autoriteti procedues pyet personin e thirrur për të identifikuar nëse ai/ajo njeh ndonjë prej tyre dhe, nëse përgjigja është po, e fton atë të deklarojë cilin prej objekteve ai/ajo njeh, si dhe të përcaktojë nëse është i/e sigurt.

3. Regjistrimi duhet të përshkruajë mënyrën e kryerjes së identifikimit. Nëse kjo gjë nuk mundësohet, identifikimi bëhet i pavlefshëm.

Neni 175: Identifikimi nga disa persona

1. Kur disa persona thirren për të dëshmuar për të njëjtin person apo objekt, autoriteti procedues e kryen atë duke i marrë një nga një në veçanti, duke ndaluar komunikimin ndërmjet personit që ka bërë identifikimin dhe atyre që do të bëjnë identifikimin më vonë.

2. Kur një person duhet të identifikojë disa persona ose objekte, autoriteti procedues urdhëron që personi apo objekti që do identifikohet të vendoset ndërmjet personave apo objekteve të tjera.

3. Dispozitat e neneve 171, 172 dhe 173 të KPP janë të zbatueshme.

Neni 205: Kontrolli i ambientit

1. Të pandehurit, kur është i pranishëm, dhe personit i cili posedon ambientet që do t'i nënshtrohen kontrollit, i jepet një kopje e urdhërkontrollit, duke i informuar ata për të drejtën për të kërkuar praninë e një personi tek i cili kanë besim.

2. Kur personat e përcaktuar në paragrafin 1 mungojnë, një kopje i jepet të afërmit, komshiut ose kolegut.

3. Autoriteti procedues mund të kontrollojë personat e pranishëm nëse gjykon që ata mund të fshehin prova materiale ose objekte në lidhje me veprën penale. Ai mund të urdhërojë që personat e pranishëm nuk mund të largohen përpara përfundimit të kontrollit dhe mund të përdorë forcën për t'i mbajtur ata që largohen.

Neni 256: Pyetja e të arrestuarit ose të ndaluarit

Prokurori pyet personin e arrestuar ose të ndaluar në prani të avokatit të zgjedhur apo të caktuar. Ai njofton personin e arrestuar apo të ndaluar mbi faktet për të cilat ai po ndiqet

dhe arsyet e hetimit, duke i bërë të njohur informacionin në dispozicion për akuzën dhe, kur hetimi nuk dëmtohet, edhe burimet.

Neni 380: Provat e përdorura nga gjykata

Në marrjen e vendimit gjykata nuk përdor prova të ndryshme nga ato që janë marrë ose konfirmuar gjatë gjykimit.

37. Nenet 449–461 të KPP rregullojnë zbatimin për rishqyrtim të vendimit përfundimtar. Sipas nenit 451, i akuzuari ose prokurori mund të depozitojë një kërkesë për rishqyrtim në përputhje me argumentet e kufizuara për rishqyrtim që gjenden në nenin 450. Kërkesa i parashtrohet Gjykatës së Lartë, e cila mund të vendosë refuzimin ose pranimin e saj (neni 453).

Vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 6 i datës 11 tetor 2002

38. Në përpjekje për të harmonizuar praktikën ligjore, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë filluan shqyrtimin gjyqësor të vendimit nr. 6 të datës 11 tetor 2002. Pjesët përkatëse të vendimit vijojnë:

"(...) Është e ditur që rishqyrtimi i vendimeve përfundimtare është një mjet ligjor i jashtëzakonshëm, i vetmi, që është parashikuar nga ligjvënësit në KPP për të ndrequr gabimet gjyqësore (në lidhje me vendimet përfundimtare të gjykatës).

Gjykimi i zhvilluar, si rezultat i rishqyrtimit [procedurave], nuk kufizohet me një shqyrtim të thjeshtë (në kuptimin më të ngushtë të fjalës) të gjykimit të mëparshëm. Në përfundimin e saj, gjykata pasi shqyrton faktet, rrethanat dhe provat e parashtruara nga palët, të marra së bashku dhe në bashkërendim me provat, rrethanat dhe faktet e administruara dhe shqyrtuara gjatë gjykimit të mëparshëm, mund të arrijë në një përfundim të ndryshëm, aq sa të shpallë një vendim në kundërshtim të plotë me të mëparshmin. (...).

Kjo është arsyeja pse ligjvënësi lejoi shqyrtimin në raste të përcaktuara qartë, të cilat përcaktohen qartë në një dispozitë të veçantë të KPP, veçanërisht në nenin 450 (…). Sipas kësaj dispozite, shqyrtimi mund të kërkohet nga palët vetëm nëse ekziston një nga kushtet të parashikuara qartë në të.".

B. E drejta ndërkombëtare përkatëse

1. Rekomandimi nr. R (2000) 2 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës për shtetet anëtare mbi rishqyrtimin apo rihapjen e çështjeve të caktuara në nivel vendi pas vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

39. Më 19 janar 2000, në takimin e 694 të zëvendësministrave, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës miratoi Rekomandimin nr. R (2000) 2 mbi rishqyrtimin dhe rihapjen e çështjeve të caktuara në nivel vendi pas vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut:

"Komiteti i Ministrave, sipas kushteve të nenit 15.b të Statutit të Këshillit të Europës;

Duke pasur parasysh se qëllimi i Këshillit të Europës është që të sjellë një bashkim më të ngushtë ndërmjet anëtarëve të saj;

Duke pasur parasysh Konventën për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (e njohur më tej Konventa);

Duke vënë në dukje se në bazë të nenit 46 të Konventës për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore (Konventa) Palët Kontraktuese kanë pranuar detyrimin që t'i përmbahen vendimit përfundimtar të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore

në çdo çështje në të cilën ata janë palë dhe që Komiteti i Ministrave mbikëqyr zbatimin e tij;

Duke sjellë në mendje se në rrethana të caktuara detyrimi i lartpërmendur mund të sjellë miratimin e masave, të ndryshme nga dëmshpërblimi i drejtë dhënë nga Gjykata në përputhje me nenin 41 të Konventës dhe/ose masa të përgjithshme, të cilat sigurojnë që pala e dëmtuar është vënë sa është e mundur në të njëjtën situatë që ishte para shkeljes së Konventës (*restitutio in integrum*);

Duke vënë në dukje se i takon autoriteteve kompetente të Shtetit të paditur që të vendosë se çfarë masash janë më të përshtatshme për të arritur *restitutio in integrum*, duke marrë parasysh mjetet në dispozicion sipas sistemit ligjor kombëtar;

Duke sjellë në mendje, megjithatë, që praktika e Komitetit të Ministrave në mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës tregon që në rrethana të veçanta rishqyrtimi i çështjes apo rihapja e procedurave ka provuar të jetë më efikas, nëse jo, i vetmi mjet për arritjen e *restitutio in integrum*;

I. Fton, Palët Kontraktuese që në dritën e këtyre konsideratave të sigurojnë ekzistencën në nivel kombëtar të mundësive të mjaftueshme për të arritur, sa më shumë të jetë e mundur, *restitutio in integrum*;

II. Nxit Palët Kontraktuese, në veçanti, që të shqyrtojnë sistemet e tyre kombëtare ligjore me qëllim që të sigurojnë ekzistencën e mundësive të mjaftueshme për rishqyrtimin e çështjes, duke përfshirë rihapjen e procedimeve, në rastet ku Gjykata ka konstatuar shkelje të Konventës, veçanërisht ku:

i) pala e dëmtuar vazhdon të vuajë pasoja shumë të rënda negative si pasojë e rezultatit të vendimit vendas për çështjen, të cilat nuk rregullohen në mënyrë të mjaftueshme nga shpërblimi í drejtë dhe nuk mund të korrigjohen përveçse me rishqyrtim apo rihapje; dhe

ii) vendimi i Gjykatës të çon në përfundimin se

a) vendimi vendas i kundërshtuar është në themel në kundërshtim me Konventën; ose

b) shkelja e konstatuar bazohet në gabime procedurale ose mangësi të një rëndësie të tillë saqë hidhet dyshim serioz mbi rezultatin e procedimeve vendase të ankimuara.”.

40. Memorandumi shpjegues mbi Rekomandimin R (2000) 2 në lidhje me këtë çështje parashikon, se:

“...Paragrafi 1 përcakton parimin bazë sipas rekomandimit që të gjitha viktimave të shkeljeve të Konventës duhet t’u njihet e drejta, sa të jetë e mundur, për një *restitutio in integrum* efektiv. Për rrjedhojë, Palët Kontraktuese duhet të shqyrtojnë sistemet e tyre ligjore me qëllim që të sigurojnë ekzistencën e mundësive të duhura...”.

2. Detyrimet e shteteve sipas të drejtës ndërkombëtare të përgjithshme

41. Neni 35 i projekt neneve të Komisionit të së Drejtës Ndërkombëtare mbi Përgjegjësinë e Shteteve për Akte të Paligjshme Ndërkombëtare (miratuar nga Asambleja e Përgjithshme në sesionin e saj të 53-të (2001), dhe paraqitur në të dhënat zyrtare të Asamblesë së Përgjithshme, Sesioni i 56-të, shtojca nr. 10 (A/56/10)) formulohet si më poshtë:

Neni 35: Dëmshpërblimi

“Një shtet përgjegjës për një akt të paligjshëm ndërkombëtar ka detyrimin të dëmshpërblejë, pra, të ripërcaktojë situatën që ekzistonte përpara kryerjes së aktit të paligjshëm ndërkombëtar, me kusht dhe në masën që dëmshpërblimi:

a) nuk është materialisht i pamundur;

b) nuk përfshin një barrë nga e gjithë pjesa e përfituar që rrjedh nga dëmshpërblimi në vend të kompensimit.”.

E DREJTA

42. Ankuesit u ankuan sipas nenit 3 të Konventës se i janë nënshtruar keqtrajtimit gjatë marrjes në pyetje nga policia për t’i detyruar ata të pranojnë shkeljet e pretenduara.

Neni 3 i Konventës parashikon:

“Askush nuk duhet t’i nënshtrohet torturës ose trajtimit çnjerëzor ose degradues ose dënimit.”.

43. Gjithashtu, ata u ankuan për padrejtësi të procedimeve gjyqësore kundër tyre sipas nenit 6 § 1 të Konventës.

Neni 6 § 1 i Konventës, në lidhje me këtë çështje, vijon:

“Në përcaktimin e ... çdo akuze penale kundrejt tij, çdo person ka të drejtën e një procesi ... të drejtë ligjor ... nga [një] ... gjykatë ...”.

I. BASHKIMI I ANKIMEVE

44. Duke pasur parasysh se dy ankimet kanë të bëjnë me të njëjtat fakte, ankesa dhe procedime gjyqësore, Gjykata vendos që ato duhet të bashkohen sipas rregullit 42 § 1 të rregullores së Gjykatës.

II. PRANUESHMËRIA E ANKESAVE

A. Ankesa për keqtrajtim të pretenduar nga oficerët e policisë

45. Pala Shqiptare parashtroi që ankuesit nuk i kanë raportuar autoriteteve pretendimet e tyre për keqtrajtim gjatë hetimit penal. Ata nuk kanë shprehur këtë ankesë as gjatë apelimeve të tyre në Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën e Lartë.

46. Ankuesit pohuan që, në rrethanat e çështjes, një referencë e thjeshtë e mosshterimit nuk mund të lirojë Qeverinë Shqiptare nga detyrimi i saj sipas Konventës apo të paraqitet si një argument i besueshëm para kësaj Gjykate.

47. Gjykata thekson se rregulli i shterimit të mjeteve ligjore vendase sipas nenit 35 të Konventës detyron ata që kërkojnë të paraqesin çështjen e tyre kundër shtetit para Gjykatës, të përdorin së pari mjetet ligjore të parashikuara nga sistemi ligjor kombëtar (shih Handyside k. Mbretërisë së Bashkuar, 7 dhjetor 1976, § 48, seria A nr. 24). Ankesat duhej t’i ishin bërë organeve vendase të duhura, të paktën në thelb dhe në përputhje me kushtet formale dhe afatet e përcaktuara në të drejtën vendase dhe, më tej, mund të përdorej çdo mjet procedural që mund të pengonte shkeljen e Konventës (shih Cardot k. Francës, 19 mars 1991, § 34, seria A nr. 200).

48. Gjykata konstaton se më 24 maj 2002 gjykata e rrethit rrëzoi kërkesën e ankuesve për keqtrajtim të pretenduar duke argumentuar se ishte e ndaluar në atë periudhë. Nga dosja e çështjes nënkuptohet që ankuesit nuk apeluan kundër këtij vendimi. Gjithashtu ata nuk e ngritën këtë ankesë, të paktën në thelb, në apelimet e tyre pranë gjykatës së apelit dhe Gjykatës së Lartë. Gjykata arrin në përfundimin që ankuesit nuk shteruan mjetet ligjore vendase të ofruara nga sistemi ligjor vendas. Si rrjedhim, ajo rrëzon ankesën e ankuesve në përputhje me nenin 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

B. Ankesa për padrejtësinë e procedimeve gjyqësore

1. Mosshterimi i mjeteve ligjore vendase

a. Për sa i përket mosparaqitjes nga ankuesi i dytë të një apeli kushtetues.

49. Qeveria parashtroi që ankuesi i dytë nuk ka apeluar pranë Gjykatës Kushtetuese në lidhje me ankesën e tij për padrejtësi të procedimeve gjyqësore. Ajo i kërkoi Gjykatës të deklarojë ankesën e tij të papranueshme për mosshterim të mjeteve ligjore vendase.

50. Ankuesi i dytë parashtroi që nuk kishte mundësi të arsyeshme për sukses pranë Gjykatës Kushtetuese duke pasur parasysh faktin që apeli i ankuesit të parë ishte rrëzuar.

51. Gjykata konstaton që sipas nenit 35 një ankues duhet të bëjë rekurs normal për mjete ligjore, të cilat janë të vlefshme dhe të mjaftueshme për të siguruar rishqyrtimin në lidhje me shkeljet e pretenduara. Ekzistenca e mjeteve ligjore në fjalë duhet të jetë mjaft e sigurt, jo vetëm në teori por edhe në praktikë, mungesa e të cilave sjell edhe mungesën e aksesit dhe efektivitetit të domosdoshëm (shih Aksoy k. Turqisë, 18 dhjetor 1996, § 51, raporte të gjykimeve dhe vendimeve1996-VI). Një ankues nuk mund të konsiderohet se nuk ka shteruar mjetet ligjore vendase nëse ai ose ajo mund të tregojë, duke paraqitur praktikën ligjore vendase përkatëse ose çdo dëshmi tjetër përkatëse, se një mjet ligjor i vlefshëm të cilin ai ose ajo nuk e ka përdorur, ishte i detyruar të dështojë (shih Kleyn dhe të tjerë k. Holandës [GC], nr. 39343/98, 39651/98, 43147/98 dhe 46664/99, § 156, GJEDNJ 2003-VI).

52. Gjykata vëren që ankuesi i parë depozitoi një ankesë pranë Gjykatës Kushtetuese. Ai u bazua në të njëjtat argumente apelimi që të dy ankuesit kishin depozituar pranë gjykatës së apelit dhe Gjykatës së Lartë. Ankesa e ankuesit të parë u deklarua e papranueshme nga Gjykata Kushtetuese (shih paragrafët 31–32 më lart).

53. Duke pasur parasysh përfundimin e apelimit të ankuesit të parë në Gjykatën Kushtetuese, Gjykata konsideron se çdo apel i depozituar nga ankuesi i dytë në Gjykatën Kushtetuese, i cili do të bazohej në të njëjtat argumente apelimi si ato të ngritura nga ankuesi i parë, do të kishin pak ose asnjë perspektivë të arsyeshme për sukses. Si rrjedhim, ankesa e ankuesit të dytë nuk mund të refuzohet për mosdepozitim të saj në Gjykatën Kushtetuese në kuptim të nenit 35 § 1 të Konventës.

54. Për rrjedhojë Gjykata rrëzon kundërshtimin e Qeverisë.

b) Për sa i përket mundësisë që ankuesit të kërkojnë rishqyrtim të vendimit të tyre përfundimtar.

55. Në komentet e tyre të mëtejshme për vërejtjet e ankuesve, Qeveria paraqiti një shkresë të GPO të datës 16 prill 2008 duke deklaruar që “pas verifikimeve të dosjes hetimore penale të [ankuesve], janë konstatuar parregullsi procedurale në kryerjen e disa veprimeve hetimore.” Qeveria pretendonte që ankuesit duhej të kërkonin rishqyrtim të vendimit të tyre përfundimtar në përputhje me nenin 450 të KPP, sipas shkresës së prokurorit.

56. Gjykata thekson se një ankesë për rigjykim ose mjet ligjor të jashtëzakonshëm të ngjashëm, si rregull, nuk mund të merret në konsideratë me qëllim zbatimin e nenit 35 § 1 të Konventës (shih gjithashtu, Ëilliams k. Mbretërisë së Bashkuar (dec.), nr. 32567/06, 17 shkurt 2009).

57. Gjykata vëren se shqyrtimi i vendimit përfundimtar të gjykatës sipas nenit 450 të KPP përbën një mjet ligjor të jashtëzakonshëm (shih paragrafin 38 më lart). Në këto rrethana, Gjykata konsideron që ankuesve nuk u është kërkuar të shterojnë këtë mjet ligjor.

58. Nëse parashtrimi i Qeverisë do të interpretohej me efektin se ankuesit nuk kishin statusin e "viktimës", Gjykata konstaton se një vendim ose masë në favor të një ankuesi, në parim, nuk është e mjaftueshme për të privuar atë nga statusi i tij si një "viktimë" në qoftë se autoritetet shqiptare nuk e kanë njohur, shprehimisht ose në thelb, dhe pastaj kanë ofruar rishqyrtim për shkelje të Konventës (shih, për shembull, Eckle k. Gjermanisë, vendimi i datës 15 korrik 1982, seria A nr. 51, p. 32, §§ 69 e në vazhdim; dhe Dalban k. Rumanisë [GC], nr. 28114/95, § 44, GJEDNJ 1999-VI). Në çështjen në fjalë, Qeveria nuk parashtroi asnjë deklaratë për të njohur ndonjë shkelje të Konventës. Po kështu shkresa e autoriteteve e datës 16 prill 2008, për shkaqet e përmendura në paragrafët e mësipërm, nuk mund të caktojë rishqyrtimin e duhur dhe të kërkuar.

59. Si rrjedhim, Gjykata rrëzon kundërshtimin e Qeverisë.

c) Përfundimi

60. Gjykata konsideron se ankesat e ankuesve sipas nenit 6 të Konventës ngrejnë çështjet e faktit dhe të drejtës të cilat janë mjaft serioze që përcaktimi i tyre të varet në shqyrtimin e themelit. Nuk janë përcaktuar argumente të tjera për t'i deklaruar ato të papranueshme. Si rrjedhim Gjykata i deklaron ato të pranueshme. Në përputhje me vendimin e saj për të zbatuar nenin 29 § 3 të Konventës (shih paragrafin 10 më lart), Gjykata do të shqyrtojë menjëherë themelin e këtyre ankesave.

III. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

A. Parashtrimet e palëve

61. Ankuesit përsëritën pozicionin e tyre që procedurat e ndjekura nga gjykatat vendase përbënin një mohim të së drejtës së tyre për gjykim të drejtë. Ata deklaruan se refuzimi nga ana e gjykatave për të paraqitur prova, mbi bazën e të cilave ata ishin dënuar (kapuça), përbënte shkelje të dispozitave vendase. Gjithashtu ata kundërshtuan rregullsinë e procedurës së identifikimit që është përdorur nga autoritetet vendase.

62. Qeveria parashtroi që procedura e identifikimit është kryer në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligj dhe që gjykatat vendase kanë vlerësuar saktë të gjitha provat.

B. Vlerësimi i Gjykatës

1. Parimet e përgjithshme të aplikueshme në këtë çështje

63. Si rregull i përgjithshëm i takon gjykatave vendase të vlerësojnë provat para tyre, si dhe lidhjen e provave që i akuzuari kërkon të paraqesë. Megjithatë, Gjykata duhet të përcaktojë nëse procedimet gjyqësore të konsideruara si një e tërë, duke përfshirë edhe mënyrën në të cilën janë marrë provat, kanë qenë të drejta sipas nenit 6 § 1 të Konventës (shih Balliu k. Shqipërisë, nr. 74727/01, § 42, 16 qershor 2005).

64. Një aspekt themelore të së drejtës për gjykim të drejtë është që procedimet gjyqësore penale, duke përfshirë elementë të procedimeve të tilla që lidhen me procedurën, duhet të jenë kundërshtuese dhe që duhet të ketë barazi të krahëve ndërmjet prokurorisë dhe mbrojtjes (shih Jasper k. Mbretërisë së Bashkuar [GC], nr. 27052/95, § 51, 16 shkurt 2000).

65. E drejta për gjykim kundërshtues nënkupton në parim mundësinë që palët në gjykimin penal të kenë njohuri dhe të komentojnë të gjitha provat e paraqitura ose vëzhgimet e depozituara për të influencuar në vendimin e gjykatave (shih Vermeulen k. Belgjikës, 20 shkurt 1996, § 33, raportet e gjykimeve dhe vendimeve 1996-I).

66. Parimi i barazisë së krahëve kërkon “një balancë të drejtë ndërmjet palëve”, ku secilës palë duhet t’i jepet mundësia e arsyeshme për të paraqitur çështjen e saj në kushte që nuk e vendosin atë në disavantazh të konsiderueshëm *vis-à-vis* kundërshtarit të saj (shih Batsanina k. Rusisë, nr. 3932/02, § 22, 26 maj 2009).

67. Përveç sa përmendur në nenin 6 § 2 të Konventës, e drejta e personit në një çështje penale për t’u konsideruar i pafajshëm dhe për t’i kërkuar prokurorisë se i takon asaj të provojë pretendimet kundër tij ose saj, formon pjesë të nocionit të përgjithshëm për një seancë gjyqësore të drejtë sipas nenit 6 § 1 (shih Phillips k. Mbretërisë së Bashkuar, nr. 41087/98, § 40, GJEDNJ 2001-VII).

68. Edhe nëse qëllimi kryesor i nenit 6, në lidhje me procedimet gjyqësore penale, është të sigurojë një gjykim të drejtë nga një “gjykatë” kompetente për të përcaktuar “çdo akuzë penale”, kjo nuk do të thotë që neni nuk zbatohet në procedimet para-gjyqësore (shih Imbrioscia k. Zvicrës, 24 nëntor 1993, § 36, Seria A nr. 275). Me qëllim që e drejta për një gjykim të drejtë të qëndrojë sa duhet “praktike dhe efektive” neni 6 § 1 kërkon që, si rregull, avokatit t’i jepet akses që në hetimin e parë të të dyshuarit nga policia, përveç nëse është e demonstruar nën dritën e rrethanave të veçanta të çdo çështjeje që ka arsye bindëse për të kufizuar këtë të drejtë (shih Salduz k. Turqisë [GC], nr. 36391/02, §§ 50 dhe 55, 27 nëntor 2008).

2. Zbatimi i parimeve të mësipërme në çështjen aktuale

69. Në çështjen aktuale, ankuesit u ankuan se mënyra në të cilën është bërë rreshtimi i identifikimit ishte e padrejtë. Më tej ata pretenduan që gjykatat vendase nuk kanë pranuar asnjëherë kërkesat e tyre për të paraqitur për shqyrtim provat materiale (kapuçat) në seancat gjyqësore publike në çështjet e tyre. Gjykata do të shqyrtojë sipas radhës dy arsyet e kërkesës para saj.

70. Gjykata konstaton se ankuesit u shpallën fajtorë kryesisht në bazë të parashtrimeve të dëshmitarëve okularë të marra gjatë paradës së identifikimit. Ajo vëren se dëshmia e dëshmitarëve okularë që rezultoi nga identifikimi ishte prova kryesore që mbështeste çështjen e prokurorit kundër ankuesve.

71. KPP i Shqipërisë rregullon qartë organizimin e paradës së identifikimit. Gjykata do të shqyrtojë nëse mënyra në të cilën është kryer parada e identifikimit në çështjen e ankuesve është në përputhje me kushtet e drejtësisë së nenit 6.

72. Në fillim, ankuesve dhe B.L. iu kërkuan të qëndronin në rresht duke mbajtur veshur kapuça të bardhë dhe blu, të ngjashëm në ngjyrë me ato të veshur nga autorët e krimit. Dy personat e tjerë në rresht mbanin kapuça të zinj, në kontrast të qartë me kapuçat bardhë e blu të veshur nga ankuesit dhe B.L. të cilët akuzoheshin për kryerjen e krimit. Ndryshimi i pozicionit të personave në rresht nuk rezultoi në ndonjë rezultat të ndryshëm për ankuesit, meqenëse atyre vazhdimisht u kërkohej të vishnin të njëjtën ngjyrë kapuçi (bardhë dhe blu) (shih paragrafin 19 më lart). Gjykata konstaton se parada e identifikimit ishte e barasvlershme me një ftesë të hapur për dëshmitarë për të vënë gishtin e fajit mbi të dy ankuesit dhe B.L. si autorë të krimit.

73. Për më tepër, parada e identifikimit u mbajt në mungesë të avokatëve të ankuesve. Nga dosja e çështjes nuk kuptohet që ankuesit kanë hequr dorë me vullnetin e tyre të lirë, shprehimisht ose heshturazi, nga e drejta për asistencë ligjore në momentin e paradës së

identifikimit (shih, në kontrast, Këiatkoëska k. Italisë (dec.), nr. 52868/99, 30 nëntor 2000).

74. Gjykata vëren në këtë lidhje se megjithëse gjykata e rrethit pranoi që ka pasur parregullsi në fazën e hetimit, në dënimin e ankuesve ajo u bazua në identifikimin pozitiv të ankuesve bërë nga dëshmitarët okularë në paradën e identifikimit. Megjithatë, as ndihma e siguruar më tej nga avokati, as natyra kundërshtuese e procedimeve gjyqësore të rezultuara nuk mund të kuronin defektet që kishin ndodhur gjatë hetimit penal (shih Salduz, cituar më lart, § 58).

75. Nuk kishte mbikëqyrje të pavarur të drejtësisë së procedurës ose mundësisë për të protestuar kundër parregullsive të qarta. Gjykata konstaton se mosrespektimi i dukshëm i të drejtave të mbrojtjes në këtë fazë, gjithmonë do të paragjykonte drejtësinë e gjykimeve penale të mëvonshme.

76. Përfundimisht, Gjykata vëren që asaj nuk i është shpjeguar se përse janë refuzuar kërkesat e ankuesve për të paraqitur në gjyq kapuçat e përdorur gjatë paradës së identifikimit. Ndërsa është e vërtetë se e drejta për zbulimin e provave përkatëse nuk është absolute. Gjykata duhet të shqyrtojë procedurën e vendimmarrjes për të siguruar që, sa është e mundur, procedura t'i përmbahej kushteve për të siguruar procedime kundërshtuese, barazi të palëve, si dhe mbrojtje të mjaftueshme për të mbrojtur interesin e të akuzuarit (shih Jasper, cituar më lart, §§ 52-53).

77. Gjykata konsideron se në rrethanat e çështjes së ankuesve, drejtësia kërkonte që ata të mund të argumentonin se kapuçat që u ishin kërkuar atyre të vishnin në paradën e identifikimit, të cilët përbënin provën vendimtare për dënimin e ankuesve, ishin krejtësisht të ndryshëm nga ato të veshur nga grabitësit. Megjithatë, në gjyq atyre iu mohua mundësia të rivendosnin parregullsitë që kishin ndodhur në paradën e identifikimit. Në këtë drejtim, Qeveria nuk iu referua ndonjë arsyeje të interesit publik për të fshehur prova të tilla, dhe arsye të tilla nuk janë të dukshme nga procedimet gjyqësore vendase.

78. Në përfundim, duke pasur parasysh konstatimet e mësipërme, Gjykata arrin në përfundimin që procedimet gjyqësore në fjalë nuk përmbushnin kushtet e një gjykimi të drejtë. Për rrjedhojë, ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 në çështjen aktuale.

IV. ZBATIMET E NENEVE 46 DHE 41 TË KONVENTËS

A. Neni 46 i Konventës

79. Neni 46 parashikon se:

"1. Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër që t'i përmbahen vendimit përfundimtar të Gjykatës në çdo rast ku ata janë palë.

2. Vendimi përfundimtar i Gjykatës do t'i njoftohet Komitetit të Ministrave, i cili do të mbikëqyrë ekzekutimin e tij.".

80. Në çështjen në fjalë, Gjykata konstatoi se ishte shkelur rëndë nga autoritetet vendase e drejta e ankuesve për një gjykim të drejtë. Gjykata vëren se kur një ankues është dënuar në shkelje të të drejtave të tij të garantuara në nenin 6 të Konventës, ai duhet, sa të jetë e mundur, të vendoset në pozicionin në të cilin ai do të kishte qenë nëse kushtet e asaj dispozite nuk do të shkeleshin, dhe që në parim, forma më e duhur e rishqyrtimit, do të gjykohej *de novo* apo rihapja e procedimeve, nëse kërkohej (shih Caka k. Shqipërisë, nr. 44023/02, § 122, 8 Dhjetor 2009; Salduz, cituar më lart, § 72; Xheraj k. Shqipërisë,

nr. 37959/02, § 82, 29 Korrik 2008; Öcalan k. Turqisë [GC], nr. 46221/99, § 210 me gjobë, GJEDNJ 2005-IV).

81. Gjykata konsideron se, në çështjen në fjalë, një rigjykim ose rihapje e çështjes, nëse kërkohet nga ankuesi, në parim përfaqëson mënyrën e duhur të rregullimit të shkeljes. Kjo është në përputhje me udhëzimet e Komitetit të Ministrave, që në Rekomandimin nr. R (2000) 2 i kërkonte Shteteve anëtare të Konventës futjen e mekanizmave për rishqyrtimin e çështjes dhe rihapjen e procedimeve gjyqësore në nivelin e brendshëm, duke zbuluar që masa të tilla përfaqësonin "mjetin më efikas, nëse jo të vetmin për arritjen e dëmshpërblimit *in integrum*" (shih paragrafin 39 më lart). Gjithashtu kjo reflekton parimet e së drejtës ndërkombëtare ku një shtet përgjegjës për një akt të paligjshëm është i detyruar të bëjë dëmshpërblimin, që konsiston në rivendosjen e situatës që ekzistonte para se të kryhej akti i paligjshëm (neni 35 i projektneneve të Komisionit të së Drejtës Ndërkombëtare mbi Përgjegjësitë e Shteteve për Aktet e Paligjshme Ndërkombëtare – shih paragrafin 41 më lart, dhe, mutatis mutandis, Verein gegen Tierfabriken Schëeiz (VgT) k. Zvicrës (nr. 2) [GC], nr. 32772/02, §§ 85-86, GJEDNJ 2009-...).

82. Gjykata vëren se sistemi ligjor penal i shtetit të paditur nuk parashikon mundësinë e rishqyrtimit të çështjeve, duke përfshirë rihapjen e procedimeve të brendshme, në rast se kjo Gjykatë konstaton shkelje të rëndë të së drejtës së ankuesit për gjykim të drejtë. Nuk është detyrë e Gjykatës të tregojë se si mund të sigurohet një mundësi e tillë dhe çfarë forme duhet të marrë ajo. Shteti i paditur mbetet i lirë, nën monitorimin e Komitetit të Ministrave, për të zgjedhur mjetet me të cilat do të kryejë detyrimin e tij për të vendosur ankuesin, sa është e mundur, në pozicionin që ai do të kishte qenë nëse kërkesat e Konventës nuk do të ishin shkelur (shih Piersack k. Belgjikës (neni 50), 26 tetor 1984, § 12, seria A nr. 85), me kusht që mjete të tilla të jenë në përputhje me përfundimet e përcaktuara në vendimin e Gjykatës, si dhe me të drejtat e mbrojtjes (shih Lyons dhe të tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar (dec.), nr. 15227/03, GJEDNJ 2003-IX).

83. Megjithatë, Gjykata konsideron që është detyrë e shtetit të paditur që në sistemin e tij ligjor të brendshëm të heqë pengesat që mund të pengojnë rregullimin e mjaftueshëm të situatës së ankuesit (shih, ndërmjet autoriteteve të tjera, Karanović k. Bosnjës dhe Herzegovinës, nr. 39462/03, § 28, 20 nëntor 2007) ose të propozojë një mjet të ri ligjor, i cili do t'i mundësonte ankuesit të rregullote situatën. Për më tepër, shtetet kontraktuese janë të detyruara të organizojnë sistemet e tyre gjyqësore në mënyrë të tillë që gjykatat e tyre të plotësojnë kërkesat e Konventës. Gjithashtu ky parim zbatohet për rihapjen e procedimeve gjyqësore dhe rishqyrtimin e çështjeve të ankuesve. (shih, mutatis mutandis, Verein gegen Tierfabriken Schëeiz (VgT) (nr. 2), cituar më lart, § 97.)

B. Neni 41 i Konventës

84. Neni 41 i Konventës parashikon se:

"Nëse Gjykata konstaton se ka pasur shkelje të Konventës dhe të protokolleve të saj, dhe nëse legjislacioni i brendshëm i Palëve të Larta Kontraktuese lejon vetëm riparim të pjesshëm, Gjykata, nëse është e nevojshme, akordon dëmshpërblim të drejtë për palën e dëmtuar.".

85. Ankuesit kërkuan secili një pagesë prej 12 000 eurosh në lidhje me dëmin pasuror që ata pretendonin. Kjo shumë është llogaritur duke u bazuar në fitimet e humbura në

përputhje me pagën minimale në Shqipëri. Ata kërkuan secili 20 000 euro në lidhje me dëmin jopasuror.

86. Qeveria i kërkoi Gjykatës të rrëzojë pretendimin e ankuesve për shpërblim të drejtë.

A. Dëmi

87. Përsa i përket dëmit pasuror të pretenduar se është shkaktuar, Gjykata ritheksoi se duhet të ketë një lidhje shkakësore të dukshme ndërmjet dëmit të pretenduar nga ankuesi dhe shkeljes së Konventës (shih, ndërmjet të tjerash, Dybeku k. Shqipërisë, nr. 41153/06, § 65, 18 dhjetor 2007).

88. Gjykata, duke pasur parasysh konstatimet e saj në lidhje me ankimet e ankuesit sipas nenit 6 § 1, vlerëson se nuk ka lidhje shkakësore ndërmjet dëmit të pretenduar dhe shkeljes së konstatuar. Gjykata nuk mund të spekulojë me faktin se cili mund të ishte rezultati i procedimit penal kundër ankuesit nëse shkelja e Konventës nuk do të kishte ndodhur (shih Polufakin dhe Chernyshev k. Rusisë, nr. 30997/02, § 216, 25 shtator 2008). Prandaj, Gjykata e sheh të papërshtatshme për t'i dhënë ankuesit kompensim për dëmin pasuror të pretenduar.

89. Përsa i përket dëmit jopasuror, duke vendosur mbi baza të arsyeshme, Gjykata i cakton secilit ankues 4 800 euro, plus ndonjë taksë që mund të jetë në ngarkim të këtyre shumave.

B. Kosto dhe shpenzime

90. Ankuesit nuk parashtruan pretendim për kostot dhe shpenzimet. Si rrjedhim, Gjykata vlerëson se nuk ka arsye për t'i caktuar atyre ndonjë shumë për këtë qëllim.

C. Interesi i munguar

91. Gjykata e mendon të arsyeshme se interesi i munguar duhet të bazohet në kursin marxhinal të huasë së Bankës Qendrore Europiane, mbi të cilën duhet të shtohen 3 për qind.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NJËZËRI:

1. Vendos të bashkojë ankimet;

2. Deklaron ankimin e ankuesve sipas nenit 3 të Konventës të papranueshëm dhe pjesën tjetër të ankimit të pranueshëm;

3. Vendos se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës;

4. Vendos

a) që shteti i paditur duhet të paguajë secilin ankues, brenda tre muajve nga data kur vendimi bëhet përfundimtar në përputhje me nenin 44 § 2 të Konventës, 4 800 euro (katër mijë e tetëqind euro) në lidhje me dëmin jopasuror, të konvertuar në monedhën e shtetit të paditur, me normë të aplikueshme në datën e pagimit, plus çdo tatim që mund të vendoset;

b) që prej skadimit të periudhës prej tre muajsh të përmendur më lart deri në pagim, mbi shumën e mësipërme paguhet interes i thjeshtë i barabartë me kursin marxhinal të huasë së Bankës Qendrore Europiane gjatë periudhës së mospagimit, plus tre për qind;

5. Rrëzon pjesën tjetër të pretendimit të ankuesit për shpërblim të drejtë.

Bërë në anglisht, dhe njoftuar me shkrim më 20 prill 2010, në përputhje me nenet 77 §§ 2 dhe 3 të rregullores së Gjykatës.

Fatoş Aracı
Zëvendësregjistrues

Nicolas Bratza
Kryetar

ÇËSHTJA “CAKA KUNDËR SHQIPËRISË”

(Ankimi nr. 44023/02)

VENDIMI STRASBOURG 8 Dhjetor 2009

Ky vendim merr formë përfundimtare në rrethanat e parashikuara në nenin 44§ 2 të Konventës. Vendimi mund të jetë objekt rishikimesh redaktimi.

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni Katërt), me trup gjykues të përbërë nga:

Nicolas Bratza, Kryetar,
Lech Garlicki,
Giovanni Bonello,
Ljiljana Mijović,
Päivi Hirvelä,
Ledi Bianku,
Nebojša Vučinić,gjyqtarë,
and Lawrence Early, Sekretar i Seksionit,

Pas shqyrtimit me dyer të mbyllura më 17 Nëntor 2009,

Merr në këtë datë vendimin e mëposhtëm:

PROCEDURA

1. Çështja e ka zanafillën në një ankim (nr.44023/02) kundër Republikës së Shqipërisë depozituar pranë Gjykatës sipas Nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”) nga nënshtetasi Shqiptar, z. Lulzim Caka (“ankuesi”), më 28 Nëntor 2002.
2. Ankuesi i cili kishte përfituar ndihmë ligjore u përfaqësua nga z. P. Rama dhe z. B. Rusi, avokatë që ushtrojnë profesionin e tyre në Tiranë. Qeveria Shqiptare (“Qeveria”) u përfaqësua nga Agjentët e atëhershëm të saj znj. B. Bulica dhe znj. S. Meneri.
3. Ankuesi pretendonte shkelje të Nenit 3 të Konventës për mungesë të ndihmës mjekësore të domosdoshme dhe të mjaftueshme në kohën që ai ishte i arrestuar, duke patur parasysh dëmtimet serioze që ai kishte pësuar. Ai gjithashtu është ankuar sipas Nenit 5 § 3 të Konventës, për kohëzgjatjen e periudhës së tij të paraburgimit. Sipas Nenit 6 § 3 (c) dhe (d) të Konventës, ai është ankuar se i ishte mohuar e drejta e një proçesi të rregullt gjyqësor.
4. Më 9 Shkurt 2006, Kryetari i Seksionit të Katërt të Gjykatës vendosi ta njoftojë Qeverinë për ankimin. Sipas dispozitave të Nenit 29 § 3 të Konventës, u vendos që meritat e ankimit të shqyrtoheshin në të njëjtën kohë me pranueshmërinë e tij.
5. Secila nga palët, ankuesi dhe Qeveria paraqitën vëzhgimet e tyre me shkrim (Rregulli 59 § 1).

FAKTET

1. RRETHANAT E ÇËSHTJES

6. Ankuesi, z. Lulzim Caka, ka lindur në 1970 dhe aktualisht vuan dënimin në një burg në Tiranë, Shqipëri.

A. Ngjarjet që i paraprijnë arrestimit të ankuesit

1. Vrasja e P.

7. P. u vra më 21 Korrik 1997. Në një datë të pacaktuar në 1997 kundër ankuesit u filluan hetimet penale. Gjatë këtyre hetimeve motra e viktimës, A., megjithëse nuk kishte qenë e pranishme në vendin e ngjarjes, ka deklaruar se ankuesi kishte vrarë vëllanë e saj. Ajo e bazonte dëshminë e saj në shpjegimet e tre dëshmitarëve, B., C. Dhe D., të cilët rezultuan, se u pyetën në një datë të pacaktuar.

8. Më 6 Tetor 1998 policia gjyqësore, organi përgjegjës për drejtimin e hetimeve penale dhe identifikimin e autorit, propozoi që të pezulloheshin hetimet penale, meqënëse autori i krimit nuk mund të identifikohej. Megjithatë, më 15 Tetor 1998 prokurori depozitoi një padi kundër ankuesit pranë Gjykatës së Rrethit Berat (shiko paragrafin 17 më poshtë).

2. Vrasja e mbetur në tentative e punonjësve të policisë

9. Në 1997 Shqipëria u godit nga trazirat civile si rezultat i rënies së skemave piramidale. Depot e armëve u plaçkitën dhe një numër i konsiderueshëm armësh ranë në duart e popullsisë civile. Rivendosja graduale e ordre public bënë të domosdoshme kontrolle të vazhdueshme të policisë. Rrjedhimisht, më 18 Mars 1998 forcat policore të Beratit ngritën pika kontrolli për të ushtruar kontrolle për armëmbajtje pa leje. Pasdite herët në të njëjtën ditë, nëpunësit e policisë në detyrë, në pikën ë kontrollit të vendosur në rrugën kryesore ndërmjet qyteteve Berat dhe Fier qëlluan me armë ankuesin dhe X., një tjetër person që po ngiste motoçikletën bashkë me të. Si rezultat, X. vdiq dhe ankuesi u plagos rëndë.

10. Sipas të dhënave të policisë mbi incidentin, dy personat që po ngisnin një motoçikletë (të identifikuar më vonë si ankuesi dhe X.), nuk ndaluan kur në pikën e parë të kontrollit policia i urdhëroi të ndalonin. Policia në pikën e dytë të kontrollit, dëshmoi se ankuesi, i cili kishte qenë duke ngarë motoçikletën, ka qëlluar në drejtim të punonjësve të policisë me automatik dhe revolver njëkohësisht. Policia i është përgjigjur zjarrit dhe ka qëlluar për vdekje X.,-in, pasagjerin në ndenjësen e pasme të motoçikletës. Pavarësisht faktit që ankuesi ishte plagosur, ai ka vazhduar të qëllojë derisa është dorëzuar. Policia raportoi se ka mbledhur në vendngjarje dy automatikë Kalashnikov, dy pistoleta, plumba dhe gëzhoja, motoçikletën, një maskë, një kapele, një palë këpucë tenisi, dhe gjëra të tjera që mendohet të jenë përdorur nga ankuesi dhe X. Rezulton që armët automatike, pistoletat, plumbat dhe gëzhojat janë dërguar për ekzaminim balistik.

B. Arrestimi i ankuesit

11. Më 18 Mars 1998 ankuesi dhe një tjetër i dyshuar, E., u arrestuan në lidhje me ngjarjen e mësipërme (shih paragrafin 9-10 me lart).

12. Ankuesi u dërgua në spital, ku ai qëndroi për disa orë për trajtim mjekësor meqënëse ishte plagosur. Pas lirimit nga spitali në të njëjtën ditë ai u mbajt në arrest në Berat. Më 19 Mars

1998 ankuesi u ekzaminua nga një mjek, i cili e vlerësoi gjendjen e tij shëndetësore përgjithësisht të kënaqshme. U konkludua se plagët që kishte marrë ankuesi ishin nën nivelin e plagëve të lehta të trupit që kërkonin jo më shumë se 9 ditë pushim.
13. Më 19 Mars 1998 prokurori akuzoi ankuesin për vrasje të mbetur në tentativë në bashkëpunim me të tjerë dhe armëmbajtje pa leje. Gjatë marrjes në pyetje në të njëjtën ditë, ankuesi nuk ka dhënë asnjë të dhënë në lidhje me akuzat kundër tij. Ankuesi ka kërkuar prezencën e avokatit të tij, F.
14. Më 20 Mars 1998 Gjykata e Rrethit Berat konfirmoi ligjshmërinë e arrestimit të ankuesit.
15. Më 8 Prill 1998 prokurori vendosi të ndërpriste hetimet penale kundër E., duke vlerësuar që ai nuk kishte kryer anjë vepër penale.
16. Më 9 Qershor 1998, 22 Shtator 1998 dhe 15 Tetor 1998 , i pyetur nga prokurori , ankuesi është mbrojtur dhe përfaqësuar nga G., një tjetër avokat i zgjedhur nga ai vetë.
17. Më 15 Tetor 1998 prokuroria e Beratit depozitoi akt akuzën pranë Gjykatë së Rrethit Berat, duke e akuzuar ankuesin për vrasjen me paramendim të P. dhe vrasjen e mbetur në tentativë të punonjësve të policisë më 18 Mars 1998. Rezultoi që u bashkuan të dy proçedimet penale kundër ankuesit.

C. Proçedurat e gjykimit

1. Proçesi gjyqësor pranë Gjykatë së Rrethit Berat

18. Gjykata e Rrethit Berat filloi gjykimin kundër ankuesit më 17 Nëntor 1998. Trembëdhjetë seanca gjyqësore janë mbajtur ndërmjet datave 17 Nëntor 1998 dhe 13 Prill 1999, datë në të cilën proçesi gjyqësor iu kalua Gjykatës së Rrethit Fier (shih transferimi i proçesit gjyqësor seksioni më poshtë). Shtatë seanca gjyqësore janë shtyrë për shkak të mungesës së prokurorit, ankuesit apo avokatit të tij mbrojtës. Në gjashtë seancat gjyqësore të mbetura, ankuesi është përfaqësuar nga avokati i tij, G.
19. Ankuesi ka kontestuar faktet e paraqitura nga prokuroria. Ai ka dëshmuar se ka qenë i paarmatosur duke ngarë motoçikletën kur forcat e policisë në pikën e dytë të kotrollit kanë hapur zjarr, pa e urdhëruar atë të ndalojë. Gjithashtu ai i ka kërkuar gjykatës të thërrasë dëshmitarët që, në momentin e incidentit, kanë qënë duke udhëtuar në të njëjtën rrugë.
20. Në seancat gjyqësore më 23 Dhjetor 1998 dhe 6 Janar 1999, katër dëshmitarë të cilët kanë qenë duke udhëtuar në të njëjtën rrugë dhe e kanë parë ankuesin kur po ngiste motoçikletën kanë dëshmuar se ankuesi nuk kishte asnjë armë me vete.

2. Transferimi i proçesit gjyqësor

21. Më 15 Shkurt 1999 prokurori depozitoi një kërkesë pranë Gjykatës së Lartë për transferimin e proçesit gjyqësor nga Gjykata e Rrethit Berat kundër ankuesit. Ai argumentoi se për arsye të gjendjes së pasigurisë në Berat dëshmitarët nguronin për të dëshmuar në gjyq. Gjithashtu ai përmendi ekzistencën e presionit të formave të ndryshme, madje edhe kërcënime për jetë të prokurorit në lidhje me rezultatin e proçesit gjyqësor.
22. Më 5 Mars 1999 Gjykata e Lartë lejoi transferimin e proçesit gjyqësor nga Gjykata e Rrethit Berat në Gjykatën e Rrethit Fier, në përputhje me Nenin 94 të Kodit të Proçedurës Penale (KPP).

23. Sipas Nenit 97 § 3 të KPP Gjykatës së Rrethit Fier iu kërkua të merrte një vendim në lidhje me vlefshmërinë e veprimeve të kryera nga Gjykata e Rrethit Berat. Një vendim i tillë nuk është përfshirë në dosjen e çështjes. Qeveria ka parashtruar se dosja e çështjes dhe veprimet e kryera nga Gjykata e Rrethit Berat janë konsideruar të vlefshme mbi bazën e një vërtetimi të datës 9 Mars 1999 të nxjerrë nga sekretarja e Gjykatës së Rrethit Fier.

3. Proçesi gjyqësor pranë Gjykatës së Rrethit Fier

24. Më 25 Maj 1999 ankuesi caktoi një tjetër avokat mbrojtës me zgjedhjen e tij, H.-në.

25. Më 26 Maj 1999 Gjykata e Rrethit Fier filloi gjykimin e ankuesit. Njëzet e katër seanca gjyqësore janë kryer ndërmjet datave 26 Maj 1999 dhe 11 Maj 2000, datë në të cilën ankuesi u shpall fajtor për veprat penale dhe u dënua me burgim.

26. Nga data 26 Maj deri më 27 Nëntor 1999 janë planifikuar dhjetë seanca gjyqësore por janë shtyrë për arsye të mungesës së ankuesit apo përfaqësuesit të tij. Asnjë dëshmitar nuk u dëgjua dhe asnjë masë tjetër proçeduriale nuk është marrë. Më 9 Nëntor 1999 gjykata njoftoi ankuesin që ai mund të caktonte një avokat tjetër mbrojtës duke patur parasysh mungesën e përsëritur të avokatit tij H.

27. Më 8 Dhjetor 1999 ankuesi revokoi prokurën e H.-së. Nga 8 Dhjetor 1999 deri më 7 Shkurt 2000 periudhë gjatë së cilës u mbajtën pesë seanca gjyqësore ankuesi u përfaqësua vetë. Asnjë dëshmitar nuk u paraqit apo nuk u pyet në këto seanca gjyqësore, si rezultat i të cilave ato u shtynë. Më 7 Shkurt 2000 prokuroria lexoi dëshmitë e dëshmitarëve që ishin marrë gjatë hetimeve penale. Ankuesi kundërshtoi deklaratat e dëshmitarëve B. dhe D. Në të njëtën ditë ankuesi ricaktoi avokatin e tij mbrojtes të mëparshëm H. Gjykata vendosi të pyesë dëshmitarin A. në seancën tjetër gjyqësore më 21 Shkurt 2000 në prani të avokatit të ankuesit.

28. Më 21 Shkurt 2000 gjyqi dëgjoi dëshminë e A., e cila deklaroi që ankuesi ishte vrasësi i vëllat të saj P. Ajo u bazua në deponimin e dëshmitarëve B., C. dhe D. Ajo nuk ka qënë dëshmitare në vendin e ngjarjes. As ankuesi dhe as avokati i tij, H., nuk e kanë pyetur A. Më tej me kërkesë të ankuesit, Gjykata e Rrethit Fier ka lëshuar disa fletë thirrje për paraqitjen e B., C. dhe D. Megjithatë dëshmitarët nuk u paraqitën asnjëherë në gjyq.

29. Në seancën gjyqësore më 23 Shkurt 2000 ankuesi caktoi I. si avokatin e tij mbrojtës bashkë më H.-në. Tre punonjës të policisë K., L. dhe M. dëshmuan në gjyq. Bazuar në mospërputhjen nga dëshmia e M.-së në fazën hetimore dhe proçesin gjyqësor, prokurori kërkoi leje për të kundërshtuar dëshminë në përputhje me Nenin 362 të KPP duke lexuar deklaratën e tij bërë gjatë hetimeve penale.

Ndërsa ankuesi dhe avokati I. nuk pyetën fillimisht M., ato kërkuan që ai të pyetej pas leximit të dëshmisë tij. Gjykata e Rrethit refuzoi kërkesën e tyre meqënëse ato fillimisht kishin hequr dorë nga e drejta e tyre për të pyetur dëshmitarin.

30. Më 1 Mars 2000 avokati I. i ankuesit kërkoi gjykatës të thërriste M. për ta pyetur. Ai e përsëriti kërkesën në seancën gjyqësore më 6 Mars. Në të njëjtën datë gjykata refuzoi kërkesën si të pabazuar. Megjithatë ajo lejoi kërkesën e avokatit për të thirrur katër punonjës të tjerë policie N., O., Q. dhe S.

31. Më 15 dhe 21 Mars avokati i ankuesit ka përsëritur kërkesën e tij për të thirrur dhe pyetur M.-në. Më 21 Mars gjykata ka refuzuar kërkesën si të pabazuar. Ajo gjykoi që M. ka ndjekur një seancë gjyqësore në të cilën i akuzuari dhe avokati i tij kanë patur mundësinë t'i bënin pyetje atij. Në të njëjtën datë, gjykata ka dëgjuar punonjësin e policisë N. Ankuesi është

përfaqësuar nga avokati i tij I. Dëshmitarët O., Q. dhe S. nuk janë paraqitur si dhe nuk janë pyetur asnjëherë në gjyq, megjithë thirrjet e përsëritura dhe njoftimin dërguar nga gjykata autoriteteve përkatëse, si Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Brendshme dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë.
32. Më 18 Prill 2000 avokati mbrojtës I. i ankuesit u tërhoq nga përfaqësimi i tij. Avokati tjetër mbrojtës H. i ankuesit, mungonte. Gjykata vendosi të shtyjë seancën gjyqësore më 3 Maj 2000.
33. Më 26 Prill 2000 avokati mbrojtës H. i ankuesit u tërhoq nga përfaqësimi i ankuesit. Arsyet kishin të bënin me përfshirjen e tij në çështje të tjera penale. Ai gjithashtu përmendi parregullsitë proçeduriale të kryera nga Gjykata e Rrethit Fier, e cila nuk i kishte dërguar thirrje me shkrim atij për t'u paraqitur në seancat gjyqësore. Ai ka pretenduar se gjykata nuk ka shfaqur paanshmëri. Ai i ka kërkuar gjykatës të proçedojë në përputhje me seksionin 49 § 5i KPP.
34. Më 3 Maj 2000 ankuesi ka caktuar një tjetër avokat mbrojtës me zgjedhjen e tij, J. Gjykata vendosi të shtyjë proçesin gjyqësor deri më 11 Maj 2000.
35. Më 11 Maj 2000 gjykata ka lexuar një faks të marrë nga avokati mbrojtës J., i ankuesit, i cili deklaronte se përfshirja e tij në biznese të tjera nuk mundësonte mbrojtjen nga ana e tij të ankuesit. J. ka deklaruar se ai nuk kishte marrë asnjë kërkesë për të përfaqësuar ankuesin. Bazuar në proçesverbalin e seancës gjyqësore, ankuesi dëshironte të bënte vetë mbrojtjen e tij. Ai ka deklaruar se ai nuk ka patur asnjë armë më 18 Mars 1998. Ai ka rënë dakord që të lexohen dëshmitë e dëshmitarëve Q., R. dhe S. të marra gjatë hetimeve penale si dhe ka hequr dorë nga e drejta për të pyetur dëshmitarin O. Prokurori ka proçeduar me leximin e dëshmive të dëshmitarëve të sipër përmendur. Më tej ai ka konkluduar me parashtrimet e tij përfundimtare. Ankuesi për rrjedhojë ka deklaruar se ai nuk i pranonte akuzat meqënënëse as nuk kishte vrarë P.-në, dhe as nuk kishte qëlluar punonjësit e policisë.
36. Në të njëjtën ditë Gjykata e Rrethit Fier ka dhënë dënimin duke e shpallur ankuesin fajtor sipas akuzave dhe e dënoi me njëzet e pesë vjet vjet burgim.
37. Në lidhje me akuzën e vrasjes së mbetur në tentativë të punonjësve të policisë, Gjykata e Rrethit Fier e ka bazuar vendimin e saj në dëshmitë e katër punonjësve të policisë K., L., M. dhe N. dhënë në seancat gjyqësore më 23 Shkurt dhe 6 Mars 2000 (shih 29 dhe 31 më lart) si dhe në deklaratat e dy dëshmitarëve të dhëna gjatë hetimeve penale. Gjykata mori parasysh raportin hetimor të vendit të ngjarjes, raportin e arrestimit të ankuesit si dhe raportin balistik.
38. Në lidhje me këtë, gjykata gjithashtu shpalli ankuesin fajtor për armëmbajtje pa leje mbi bazën e raportit balistik, duke shtuar që gëzhojat e gjetura në vendin e ngjarjes janë qëlluar nga armët e gjetura pranë të akuzuarit. Megjithatë, në vendimin e marrë nuk është përmendur nëse armët ishin në posedimin aktual të ankuesit.
39. Në lidhje me vrasjen e P.-së, Më 21 Korrik 1997, Gjykata e Rrethit Fier e bazoi arsyetimin e saj në dëshminë e A.-së dhënë në gjyq si dhe në deklaratat e dëshmitarëve B., C., dhe D. dhënë gjatë hetimeve penale (shih paragrafët 7, 27 dhe 28 më lart).

D. Proçedimet e apelimit

40. Më 16 Maj 2000 ankuesi bëri apel kundër dënimit tij pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, duke pertenduar shkelje të së drejtës së tij për një proçes të rregullt gjyqësor. Në veçanti, ai ka argumentuar se mungesa e ndihmës ligjore gjatë gjykimit dhe fakti që gjykata e shkallës së

parë ka pranuar deklaratat e dëshmitarëve pa dhënë mundësinë e pyetjeve nga pala kundërshtare përbënte shkelje të së drejtës së proçedurave kundërshtuese. Për më tepër, atij i është privuar e drejta për të pyetur dëshmitarin M. i cili ka dëshmuar në seancën gjyqësore më 23 Shkurt 2000. Gjithashtu ai ka argumentuar se, gjatë fazës kur palët kanë bërë parashtrimet e tyre përfundimtare, ai nuk është ndihmuar nga avokati mbrojtës. Ankuesi është përfaqësuar në Gjykatën e Apelit nga I., i cili më parë ishte tërhequr nga çështja më 18 Pril 2000 (shih paragrafin 32 më lart).

41. Më 20 Tetor 2000 Gjykata e Apelit Vlorë hodhi poshtë kërkesën e ankuesit dhe miratoi vendimin e Gjykatës së Rrethit Fier. Meqënëse apelimi drejtohej kundër refuzimit të Gjykatës së Rrethit për të lejuar ankuesin të pyesë dëshmitarin M., Gjykata e Apelit vërejti që gjatë seancës gjyqësore më 23 Shkurt 2000 avokati mbrojtës i ankuesit ka dëshmuar se nuk kishte pyetje për të bërë. Ankuesi i ka bërë dëshmitarit vetëm një pyetje, së cilës ky i fundit i është përgjigjur. Gjykata e Apelit ka rrëzuar ankesën e ankuesit për mungesë të ndihmës ligjore në seancën gjyqësore përfundimtare, bazuar në deklaratën e tij se ai dëshironte të bënte vetë mbrojtjen e vet.

42. Më 6 Mars 2001 ankuesi i bëri apel Gjykatës së Lartë bazuar në të njëjtat argumente që kishte bërë pranë Gjykatës së Apelit. Ai shtoi se proçesverbali i seancës gjyqësore datë 11 Maj 2000 ishte falsifikuar nga Gjykata e Rrethit Fier duke argumentuar se kërkesa e tij për t'u mbrojtur nga një avokat ishte shtrembëruar për t'u lexuar se ai dëshironte të mbrohej vetë.

43. Më 16 Tetor 2001 Gjykata e Lartë deklaroi ankimimin e tij të papranueshëm meqënëse argumentet e tij ishin jashtë fushës së Nenit 432 të KPP.

44. Më 22 Tetor 2003 ankuesi depozitoi një ankesë pranë Gjykatës Kushtetuese për parregullsinë e proçedimeve. Ai u ankua për kohëzgjatjen e periudhës së paraburgimit tij dhe u bazua në Nenin 6§ 3 (b) dhe (c) dhe (d) të Konventës.

45. Më 18 Nëntor 2003 Gjykata Kushtetuese, mbledhur në trup gjykues e përbërë nga tre gjyqtarë, deklaroi ankimin të papranueshëm. Ajo argumentoi se ankimi i ankuesit nuk ngrinte çështje të një proçesi të rregullt ligjor, por lidhej me vlerësimin e provave gjë që kishte të bënte me gjykatat më të ulta.

E. Parashtrime të mëtejshme

46. Më 6 Janar 2003 ankuesi depozitoi pranë Gjykatës një deklaratë të noterizuar nga B.H., gjyqtari që kishte kryesuar trupin gjykues në Gjykatën e Rrethit Berat në proçesin gjyqësor. Sipas B.H., proçedimet janë transferuar në Gjykatën e Rrethit Fier, në dëm të ankuesit, në një kohë kur Gjykata e Rrethit Berat ishte pranë mbylljes së shqyrtimit të çështjes dhe dukej se po arrinte në përfundimin se nuk kishte prova të mjaftueshme kundër tij. Për më tepër, B.H. mbronte mendimin se Gjykata e Rrethit Fier kishte pranuar deklaratat e dëshmitarëve të marra në komisariatin e policisë më shumë se deklaratat e marra gjatë gjykimit pranë Gjykatës së Rrethit Berat. Gjithashtu ai argumentonte se Gjykata e Rrethit Fier nuk kishte marrë në konsideratë raportin balistik të paraqitur gjatë gjykimit pranë Gjykatës së Rrethit Berat, nga ku vërtetohej që armët automatike që pretendohej se ishin përdorur nga ankuesi, në fakt i përkisnin Forcave të Policisë Berat. Për më tepër, ai deklaroi se avokatët mbrojtës të ankuesit ishin tërhequr nga mbrojtja e tij gjatë gjykimit pranë Gjykatës së Rrethit Fier për shkak të kërcënimeve të jetëve të tyre si dhe familjeve të tyre.

47. Gjithashtu ankuesi depozitoi katër deklarata të noterizuara bërë nga dëshmitarë okularë që kishin qenë prezent disa minuta para incidentit dhe kishin parë ankuesin të paarmatosur duke ngarë motoçikletën dhe kishin dëgjuar të shtënat e policisë. Të njëjtët dëshmitarë okularë dëshmuan pranë Gjykatës së Rrethit Berat më 23 Dhjetor 1998 dhe 6 Janar 1999 (shih paragrafin 20 më lart).
48. Më 28 Prill 2008 Gjykata i kërkoi Qeverisë të paraqiste të gjithë dosjen hetimore dhe raportet e lexueshëm të të gjitha seancave gjyqësore pranë Gjykatave të Rretheve. Më 31 Korrik 2008 Qeveria paraqiti raportet e të gjitha seancave gjyqësore të mbajtura pranë Gjykatave të Rretheve. Asnjë dokument nga dosja hetimore nuk është paraqitur.

II. E DREJTA E BRENDSHME PËRKATËSE

A. Kushtetuta

49. Dispozitat përkatëse të Kushtetutës Shqiptare parashikojnë:

Neni 31
Gjatë proçedimit penal, kushdo ka të drejtë:

a. të vihet në dijeni menjëherë dhe hollësisht për akuzat e ngritura kundër tij, të drejtat e tij, si dhe t'i krijohet mundësia për të njoftuar familjen ose të afërmit;

b. të ketë kohën dhe mjetet e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet;

c. të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën Shqipe;

ç. të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij, të komunikojë lirshëm dhe privatisht me të; si dhe t'i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme;
d. t'u bëjë pyetje dëshmitarëve të pranishëm dhe të kërkojë paraqitjen e dëshmitarëve, ekspertëve dhe personave të tjerë të cilët mund të sqarojnë faktet.

Neni 32
1. Askush nuk mund të detyrohet të dëshmojë kundër vetvetes ose familjes së vet dhe as të pohojë fajësinë e tij.
2. Askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme.

Neni 33
1. Kushdo ka të drejtë të dëgjohet para se të gjykohet.

2. Nga kjo e drejtë nuk mund të përfitojë personi që i fshihet drejtesisë.

Neni 42 § 2
Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave ligjore dhe kushtetuese, lirive dhe interesave ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe public brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

Neni 131
Gjykata Kushtetuese vendos:…

(f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proçes të rregullt gjyqësor, pasi të jenë ezauruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

B. Kodi i Procedurës Penale
50. Kur kërkohet prania e mbrojtësit ligjor dhe mbrojtësi i zgjedhur ose i caktuar nuk është i siguruar, nuk është paraqitur ose ka lënë mbrojtjen, gjykata ose prokurori cakton si zëvendësues një mbrojtës tjetër, i cili ushtron të drejtat dhe merr përsipër detyrimet e mbrojtësit.
51. Nenet 94 deri 97 përcaktojnë transferimin e proçedimeve. Sipas formulimit të Nenit 94, në fuqi në kohë materiale, në ç'do fazë dhe nivel gjatë gjykimit, kur siguria publike apo vullneti i lirë i njerëzve për të marrë pjesë në një gjykim dëmtohen nga ngjarje lokale të rënda të cilat mund të ndikojnë në kryerjen e gjykimit dhe që nuk mund të shmaget nga mënyra të tjera, Gjykata e Lartë me kërkesë të arsyeshme të prokurorit ose të pandehurit, mund t'ia transferojë çështjen një gjykate tjetër.
Neni 97 parashikon që Gjykata e Lartë vendos në fshehtësi. Vendimi për të lejuar që një kërkesë për çështjen që do transferohet, i bëhet i ditur gjykatës në të cilën janë kryer proçedimet si dhe gjykatës së cilës do t'i transferohen proçedimet. Gjykata e cila i ka kryer proçedimet më parë duhet t'i transferojë menjëherë dokumentat proçeduriale gjykatës së caktuar dhe urdhëron njoftimin e vendimit të Gjykatës së Lartë prokurorit, të pandehurit dhe palëve private. Neni 97 § 3 deklaron që gjykata e caktuar nga Gjykata e Lartë jep vendimin nëse veprimet e kryera janë të vlefshme si dhe shtrirjen e vlefshmërisë së tyre.
52. Sipas Nenit 362 § 1, në fuqi në kohë materiale, me qëllim që pjesërisht apo tërësisht të kundërshtohet përmbajtja e dëshmisë ose kur dëshmitari refuzon të dëshmojë, palët mund të përdorin deklaratat që janë dhënë paraprakisht nga dëshmitarët pranë prokurorit apo policisë gjyqësore, deklarata të cilat gjenden në dosjen e çështjes, por vetëm pasi dëshmitari ka dëshmuar për faktet dhe rrethanat që mund të kontestohen. Neni 362 § 2 përcakton se këto deklarata nuk përbëjnë të dhëna për faktet në lidhje me ktë rast, por ato mund të shqyrtohen nga gjykata me qëllim që të përcaktohet besueshmëria e personit në fjalë dhe janë pjesë përbërëse e dosjes së çështjes.
53. Neni 425 përcakton fushën e shqyrtimit të apelimit nga Gjykata e Apelit. Ai parashikon që shqyrtimi i çështjes nga Gjykata e Apelit nuk kufizohet në argumentat e apelit por shtrihet në tërë çështjen.

54. Sipas Nenit 427, me kërkesën e palës, Gjykata e Apelit ka autoritetin të rishqyrtojë drejtpërdrejtë të dhëna të mëparshme dhe materiale të reja shtesë, nëse e quan të domosdoshme.
55. Neni 428 përcakton vendimet që mund të merren nga Gjykata e Apelit. Ai parashikon që Gjykata e Apelit mund të vendosë të pezullojë apelimin dhe të miratojë vendimin, të ndryshojë vendimin, të shfuqizojë vendimin dhe të përfundojë proçedimet penale, ose të shfuqizojë vendimin dhe ta kalojë çështjen për gjykim të ri.
56. Vendimet e Gjykatës së Apelit mund të ankimohen pranë Gjykatës së Lartë në përputhje më një nga kërkesat e mëposhtme të Nenit 432: a) e drejta penale nuk është respektuar apo është zbatuar gabimisht; b) ka patur shkelje të cilat kanë rezultuar në deklarimin e vendimit të gjykatës të pavlefshëm në përputhje me Nenin 128 të këtij Kodi; c) ka patur shkelje të rregullave proçeduriale të cilat kanë ndikuar në marrjen e vendimit.
57. Neni 434 parashikon që Gjykata e Lartë shqyrton apelimin në rastet kur pikat e së drejtës janë ngritur për këtë problem.

E DREJTA

58. Ankuesi ka ankuar sipas Nenit 3 të Konventës për pamjaftueshmërinë e trajtimit mjekësor që ai ka marrë gjatë periudhës së paraburgimit. Ai i është referuar plagëve që ka pësuar në konfrontimet me policinë më 18 Mars 1998. Neni 3 shprehet si më poshtë:

"Askush nuk duhet t'i nënshtrohet torturës ose trajtimit ç'njerëzor e degradues apo dënimit".

59. Ankuesi gjithashtu u ankua për kohëzgjatjen e mbajtjes së tij në arrest. Gjykata shqyrton kërkesën e tij sipas Nenit 5 § 3 të Konventës që lexohet si më poshtë:

"Ç'do kush i arrestuar apo i ndaluar në përputhje më dispozitat e paragrafit 1 (c) të këtij Neni ka të drejtën … e gjykimit brenda një periudhe kohe të arsyeshme apo të lirohet në pritje të gjykimit. Lirimi mund të kushtëzohet me garancitë për t'u paraqitur për gjykim".

60. Ankuesi u ankua më tej sipas Nenit 6 § 3 (c) dhe (d) të Konventës se atij i ishte mohuar e drejta e një proçesi të rregullt ligjor meqë ai nuk ishte mbrojtur siç duhet nga një avokat dhe që nuk kishte mundur të pyeste dëshmitarët apo të siguronte paraqitjen e dëshmitarëve në emër të tij. Pjesa përkatëse e Nenit 6 të Konventës lexohet si më poshtë:

1. Në përcaktimin e …. çdo akuze penale kundër tij çdo kush ka të drejtën e një proçesi …të rregullt …gjyqësor nga …gjykata…;

3. Çdokush i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme: …..

c. të mbrojë veten privatisht apo nëpërmjet ndihmës ligjore me zgjedhjen e tij ose, nëse nuk ka mjetet e nevojshme për të paguar ndihmën ligjore t'i paguhet falas nëse e kërkojnë interesat e drejtësisë;

d. të pyesë apo të ketë pyetur dëshmitarët kundër tij dhe të sigurojë ndjekjen dhe pyetjen e dëshmitarëve në emër të tij në të njëjtat kushte me ato të dëshmitarëve kundër tij.

…

PRANUESHMËRIA E ANKIMEVE

A.Ankimi rreth mungesës së trajtimit mjekësor të mjaftueshëm gjatë periudhës së paraburgimit

409. Qeveria parashtroi se ankuesi nuk kishte mundur të paraqiste ankimet e tij në gjykatat e brendshme sipas Nenit 3 të Konventës dhe se kjo pjesë e ankimit për rrjedhojë duhet të shpallet e papranueshme për mosezaurim të mjeteve të brendshme ligjore.
410. Në vëzhgimet e tij ankuesi pohoi se atij nuk i ishte siguruar trajtim mjekësor i mjaftueshëm në qelitë e paraburgimit në Berat.
411. Gjykata rithekson se rregulli i shterimit të mjeteve të brendshme ligjore i përmendur në Nenin 35 të Konventës, detyron ata që kërkojnë të paraqesin çështjen e tyre kundër Shtetit para Gjykatës, të përdorin fillimisht mjetet e parashikuara nga sistemi ligjor kombëtar (shih Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar, 7 dhjetor 1976, § 48, Seria A nr. 24). Ankimet duhet të ishin depozituar pranë organit përkatës të brendshëm, të paktën në thelb dhe në përputhje me kërkesat formale dhe afatet kohore të përcaktuara në ligjin e brendshëm dhe më tej, që duhet të ishte përdorur çdo mjet procedural i cili mund të parandalonte shkeljen e Konventës (shih Cardot kundër Francës 19 Mars 1991, § 34, Seria nr. 200).
412. Gjykata vëren se nuk ka informacion që ankuesi të ketë bërë ankime kundër policisë pranë autoritetit përkatës të brendshëm administrativ, për shembull prokurorisë, rreth pamundësisë për t'i siguruar atij trajtim mjekësor të mjaftueshëm gjatë periudhës së paraburgimit. Ajo vëren më tej se ankuesi nuk paraqiti ndonjë ankim të ngjashëm, të paktën në thelb, në procedimet e gjykimit dhe apelit.
413. Duke marrë parasysh sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se ankuesi nuk arriti të ezauronte mjetet e brendshme ligjore të parashikuara nga sistemi i brendshëm ligjor. Rrjedhimisht, ajo rrëzon ankimin e ankuesit në përputhje me Nenin 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

B. Ankimi rreth kohëzgjatjes së paraburgimit

414. Qeveria argumentoi se kohëzgjatja e paraburgimit të ankuesit ka qenë në përputhje me afatet kohore të parashikuara në legjislacionin e brendshëm dhe Nenin 5 § 3 të Konventës. Ata këmbëngulën se kundërshtimi i ankuesit ndaj kohëzgjatjes së paraburgimit të tij ishte rrëzuar nga gjykatat e brendshme të të gjitha niveleve.

415. Ankuesi pohoi se paraburgimi i tij kishte zgjatur më shumë se afatet kohore të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale dhe ishte në shkelje të Nenit 5 § 3 të Konventës.
416. Gjykata rithekson se paraburgimi përfundon për qëllimet e Konventës me shpalljen e fajësisë dhe dënimin e vendosur në shkallën e parë (shih B. kundër. Austrisë, 28 mars 1990, §§ 34 – 40, Seria A nr. 175; Solmaz kundër Turqisë, nr. 27561/02, § 26, ECHR 2007 ....., (ekstrakte).
417. Gjykata vëren se paraburgimi i ankuesit filloi më 18 mars 1998. Ai zgjati deri në 11 Maj 2000, datë në të cilën Gjykata e Rrethit Fier dha vendimin e saj duke e dënuar ankuesin. Pas asaj date, ankuesi nuk u përfshi në ndonjë mjet ligjor efektiv të synuar për kundërshtimin e kohëzgjatjes së paraburgimit të tij. Apeli i tij kushtetues nuk mund të konsiderohet si një mjet ligjor efektiv për qëllim të Nenit 5 të Konventës (shih, në të kundërt, paragrafin 422 më poshtë në lidhje me Nenin 6).
418. Ankimi i ankuesit u depozitua në Gjykatë më 28 nëntor 2002, më shumë se gjashtë muaj pas vendimit të Gjykatës së Rrethit Fier.
419. Në këto rrethana, Gjykata çmon se ankuesi ka dështuar të respektojë rregullin e gjashtë mujorit. Rezulton që kjo pjesë e kërkesës duhet të hidhet poshtë sipas Nenit 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

C. Ankimet rreth mungesës të të drejtës për avokat dhe pamundësia e marrjes në pyetje të dëshmitarëve

420. Qeveria këmbënguli se ky ankim ishte i papranueshëm pasi ishte depozituar më vonë se periudha gjashtë mujore sipas Nenit 35 § 1 të Konventës. Kështu, për shkak të vendimit të Gjykatës Kushtetuese mbi papranueshmërinë, të datës 18 Nëntor 2003, mjeti ligjor përfundimtar efektiv në kuptim të asaj dispozite ishte në fakt vendimi i Gjykatës së Lartë i datës 16 Tetor 2001, ndërsa ankuesi kishte bërë kërkesën e tij më 28 Nëntor 2002.
421. Ankuesi parashtroi në përgjigje, duke iu referuar Nenit 131 (f) të Kushtetutës dhe praktikës së Gjykatës Kushtetuese, se me qëllim që të ezauronte të gjitha mjetet ligjore të brendshme, ankimet individuale duhet të depozitoheshin pranë Gjykatës Kushtetuese nëse dhe kur ata dyshonin për një shkelje të të drejtës për gjykim të drejtë. Për më tepër, ai u mbështet në vendimin e Gjykatës mbi pranueshmërinë, të marrë në çështjen Balliu kundër Shqipërisë (vendimi), nr. 74727/01.
422. Gjykata rithekson përfundimet e saj në çështjen Balliu kundër Shqipërisë . (vendimi) nr. 74727/01), i konfirmuar më pas në vendimin Beshiri etj kundër Shqipërisë, (nr. 7352/03, § 32, 22 Gusht 2006), ku ajo vendosi se një ankim pranë Gjykatës Kushtetuese konsiderohet mjet ligjor efektiv që duhet të përdoret për qëllime të Nenit 35 të Konventës ku lindën çështje të gjykimit të drejtë. Ajo vëren se e drejta e të paditurit për avokat, duke përfshirë të drejtën për të thirrur dhe marrë në pyetje dëshmitarët, përbën një element të rëndësishëm dhe thelbësor të gjykimit të drejtë të garantuar sipas Nenit 6 të Konventës (shih paragrafin Error! Reference source not found. më lart dhe 425 në vijim më poshtë). Ajo çmon se nuk ka arsye për të devijuar rrethanat e çështjes në fjalë nga përfundimi i saj në çështjen Beshiri etj.
423. Ankuesi në fakt përfitoi nga ky mjet ligjor. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese është i datës 18 Nëntor 2003 dhe ankuesi e depozitoi ankimin e tij më 28 Nëntor 2002. Gjykata çmon se nuk lind asnjë problem në lidhje me respektimin e afatit kohor gjashtë mujor të parashikuar në

Nenin 35 në lidhje me ankimet e tij rreth padrejtësisë së gjykimit të tij. Për këto arsye, Gjykata hedh poshtë kundërshtimin e Qeverisë.
424. Gjykata çmon se ankimet e ankuesit sipas Nenit 6 § 3 (c) dhe (d) ngrenë çështje të faktit dhe ligjit që janë mjaft serioze që përcaktimi i tyre duhet të varet nga shqyrtimi në themel. Nuk është paraqitur asnjë arsye tjetër për shpalljen e tyre të papranueshme. Rrjedhimisht, Gjykata i shpall këto ankime të papranueshme. Në përputhje me vendimin e saj për të zbatuar Nenin 29 § 3 të Konventës (shih paragrafin Error! Reference source not found. më sipër), Gjykata tashmë do të shqyrtojnë këto ankime në themel.

II. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 6 TË KONVENTËS

425. Gjykata në fillim rithekson se kërkesat e paragrafit 3 (c) dhe (d) të Nenit 6 duhet të shihen si aspekte të veçanta të të drejtës për gjykim të drejtë të garantuara nga paragrafi 1. Për këtë arsye, Gjykata e çmon të nevojshme të shqyrtojë ankimet e ankuesit nga pikëpamja e paragrafit 3 të marra së bashku me parimet e mishëruara në paragrafin 1. Gjykata shqyrton, në përputhje me praktikën e saj normale, nëse procedimet ishin në tërësi të drejta (shih Van Geyseghem kundër Belgjikës [GC], nr. 26103/95, § 27, ECHR 1999 I, dhe Balliu kundër Shqipërisë, nr. 74727/01, § 25, 16 Qershor 2005).

A. Shkelja e pretenduar e Nenit 6 § 1 në lidhje me Nenin 6 § 3 (c)

1.Parashtrimet e palëve

426. Ankuesi fillimisht pretendoi se në procedimet ligjore ai nuk ishte përfaqësuar nga një avokat gjatë fazave të gjykimit të tij, siç kërkohej nga Nenet 6 §§ 1 dhe 3 (c) të Konventës.
427. Ankuesi kundërshtoi vërtetësinë e procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 11 Maj 2000 që supozohej të deklaronte se ai kishte rënë dakord “ të vetëmbrohej”. Ai shtoi se meqë parashtrimet përfundimtare ishin bërë në Gjykatën e Rrethit në atë seancë gjyqësore, ai nuk kishte njohurinë minimale ligjore për t’u vetëmbrojtur personalisht dhe për të nxjerrë përfundime të formës së prerë mbi akuzat penale të ngritura kundër tij.
428. Ankuesi vërejti se Gjykata e Rrethit nuk garantoi caktimin e një avokati tjetër me zgjedhjen e saj, sipas seksionit 49 § 5 të Kodit të Procedurës Penale. Gjykata e brendshme gjithashtu nuk kishte marrë masa disiplinore në lidhje me avokatin mbrojtës të ankuesit për pamundësinë e tyre të vazhdueshme për t’u paraqitur në seanca gjyqësore gjatë gjykimit.
429. Qeveria rrëzoi pretendimet e ankuesit. Ata këmbëngulën se që nga koha kur filloi hetimi, ankuesi kishte patur mjetet ligjore për t’u përfaqësuar nga një avokat. Gjykata e Rrethit kishte shtyrë seancat gjyqësore në disa raste për shkak të mungesës së avokatëve të ankuesit, duke i dhënë kështu ankuesit mundësinë të përfaqësohej dhe të vetëmbrohej në nivel të mjaftueshëm.
430. Për më tepër, ankuesi nuk kishte bërë kërkesë për marrjen e masave disiplinore kundër këtyre avokatëve. Ai gjithashtu nuk i kishte kërkuar gjykatës të caktonte një avokat me zgjedhjen e saj, sipas seksionit 49 § 5 të Kodit të Procedurës Penale.

431. Qeveria pohoi se ankuesi, në seancën përfundimtare të datës 11 Maj 2000 në Gjykatën e Rrethit, kishte deklaruar se dëshironte "të vetëmbrohej".
432. Në parashtrimet e Qeverisë, këmbëngulja e ankuesit për t'u përfaqësuar nga avokatë që kishin munguar pa arsye ose që ishin tërhequr nga mbrojtja, kombinuar me miratimin e tij për t'u vetëmbrojtur personalisht në seancën përfundimtare, nuk çon në një shkelje të të drejtave të tij kushtetuese.

2.Vlerësimi i gjykatës

433. Gjykata rithekson se ndërsa Neni 6 § 3 (c) i jep çdo të akuzuari për një vepër penale të drejtën " për t'u vetëmbrojtur personalisht ose përmes ndihmës ligjore...", ajo nuk përcakton mënyrën e ushtrimit të kësaj të drejte. Kështu, ajo i lë Shteteve Kontraktuese zgjedhjen e mjeteve të sigurimit që garantohet në sistemet e tyre ligjore, pra detyrën e Gjykatës vetëm për të përcaktuar nëse metoda që ata kanë zgjedhur është e pajtueshme me kërkesat e një gjykimit të drejtë (shih vendimin e Quaranta kundër Zvicrës të datës 24 Maj 1991, Seria A nr. 205, fq. 16, § 30). Në lidhje me këtë, duhet pasur parasysh se Konventa synon të "garantojë jo të drejtat që janë teorike ose të gabuara por të drejtat që janë praktike dhe efektive" dhe se caktimi i një avokati mbrojtës nuk garanton në vetvete efektivitetin e ndihmës që ai mund t'i japë një të padituri (shih vendimin e Imbrioscia kundër Zvicrës, të datës 24 nëntor 1993, Seria A nr. 275, fq. 13, § 38, dhe vendimin e Artico kundër Italisë, të datës 13 maj 1980, Seria A nr. 37, fq. 16, § 33).
434. Më tej, Gjykata rithekson se as forma, as përmbajtja e Nenit 6 të Konventës nuk ndalon një person të heqë dorë me vullnetin e tij të lirë, ose shprehimisht ose në mënyrë të heshtur, nga e drejta për garanci për një gjykim të drejtë (shih Hermi kundër Italisë [GC], nr. 18114/02, § 73, ECHR 2006 ...). Megjithatë, kjo dorëheqje, për të qenë efektive për qëllimet e Konventës, duhet të vendoset në mënyrë të qartë dhe të shoqërohet me garanci minimale në raport me rëndësinë e saj (shih Poitrimol kundër Francës, 23 nëntor 1993, § 31, Seria A nr. 277 A). Për më tepër, ajo nuk duhet të bjerë ndesh me interesa të rëndësishme publike (shih Håkansson dhe Sturesson kundër Suedisë, 21 Shkurt 1990, § 66, Seria A nr. 171 A, dhe Sejdovic kundër Italisë [GC], nr. 56581/00, § 86, ECHR 2006 II).
435. Në çështjen në fjalë, ankuesi kishte të drejtë për avokatë sipas zgjedhjes së tij, që kundërshtonin argumentet e prokurorit dhe merrnin në pyetje dëshmitarët. Nuk ka të dhëna se ankuesi, duke zgjedhur pesë avokatë, nuk kishte mjete të mjaftueshme për të paguar për ndihmën ligjore në procedimet e gjykimit (shih, në të kundërt, Artico kundër Italisë, 13 Maj 1980, Seria A nr. 37). Përfaqësuesit ligjorë të ankuesit ishin në gjendje të merrnin pjesë efektivisht në gjykim. Në asnjë moment, ankuesi nuk i kishte njoftuar autoritetet për ndonjë vështirësi të ndeshur në përgatitjen e mbrojtjes së tij dhe nuk ka asnjë të dhënë që të tregojë se gjykata e shkallës së parë duhet të ishte angazhuar ndaj situatës së ankuesit me kërkesën e saj si administratore përfundimtare të drejtësisë së procedimeve (shih Cuscani kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 32771/96, § 39, 24 Shtator 2002).
436. Gjykata e Shkallës së Parë garantoi që ankuesi u përfaqësua dhe u mbrojt në nivel të mjaftueshëm, duke shtyrë pothuajse të gjitha seancat gjyqësore kur avokatët e ankuesit nuk ishin të pranishëm. Në një rast, gjykata e shkallës së parë informoi kërkuesin për të drejtën e

tij për të caktuar një avokat tjetër, duke marrë parasysh mungesën e vazhdueshme të përfaqësuesit të tij (shih paragrafin 26 më sipër).
437. Vetëm në dy raste gjykata e shkallës së parë procedoi në mungesë të avokatit të ankuesit, për shkak të dëshirës së hapur të ankuesit për t'u vetëmbrojtur personalisht. Para kësaj periudhe, nga data 8 dhjetor 1999 deri në 7 shkurt 2000 ankuesi e revokoi prokurën e avokatit të tij. Ai nuk i kërkoi gjykatës të caktonte një avokat sipas rregullave të vendosura nga gjykata. Duhet të vërehet se deri në 7 shkurt 2000, janë shtyrë pesë seanca gjyqësore dhe nuk u shqyrtua asnjë provë dhe nuk u pyetën dëshmitarë.
438. Më 7 shkurt 2000 prokurori, me miratimin e ankuesit, procedoi me leximin e deklaratave të dëshmitarëve B. dhe D. Ankuesi nuk i pranoi ato deklarata. Nuk u mor në pyetje asnjë dëshmitar, megjithëse dëshmitari A. ishte paraqitur në gjykatë për të dëshmuar (shih paragrafin 27 më sipër).
439. Së dyti, nga procesverbali i seancës së fundit të datës 11 Maj 2000, rezulton se ankuesi në të vërtetë ra dakord të vetëmbrohej personalisht. Ankuesi ishte në dijeni për procedimet dhe akuzat kundër tij. Megjithatë, Gjykata vëren se në këtë rast ishte bërë një dorëheqje e hapur. Nuk ka asgjë në dosjen e çështjes që të tregojë se në ditën e seancës gjyqësore, kur ai pranoi që të vetëmbrohej personalisht, ankuesi protestoi ndaj autoriteteve të brendshme dhe kërkoi shtyrje të afatit.
440. Është e vërtetë se në apelin e tij, ankuesi shprehu kundërshtime dhe kundërshtoi pa sukses vërtetësinë e procesverbalit. Megjithatë, sipas Gjykatës, ai kundërshtim i bërë në një fazë të mëvonshme dhe i pambështetur nga prova të tjera, nuk mund të mbizotëronte mbi qëndrimin në dukje të prerë të ankuesit më 11 Maj 2000.
441. Deklaratat e tre dëshmitarëve u lexuan në seancën gjyqësore të datës 11 Maj 2000 (shih paragrafin 25 më sipër). Prokurori dhe ankuesi proceduan me vëzhgimet e tyre përmbyllëse. Gjykata vëren se nuk ka të dhëna që deklaratat e dëshmitarëve të lexuara në seancën gjyqësore të datës 11 Maj 2000 kishin rëndësi për provën e fajësisë dhe dënimin e ankuesit. Në të vërtetë, gjykatat e brendshme e konfirmuan këtë. Asnjë provë tjetër nuk u shqyrtua në atë datë ndërsa gjykata e shkallës së parë konstatoi se ka prova të mjaftueshme për të provuar fajësinë dhe dënuar ankuesin. Rrjedhimisht, ajo vendosi të përfundonte procedimet e gjykimit.
442. Është e vërtetë se vëzhgimet përmbyllëse në emër të ankuesit, që padyshim kërkonin njohuri dhe ekspertizë ligjore, nuk u bënë nga avokati i tij. Megjithatë, në procedimet e apelit, ankuesi u përfaqësua nga një avokat sipas zgjedhjes së tij, i cili, gjë që nuk ishte kundërshtuar nga palët, bëri vëzhgime përmbyllëse duke ripohur pafajësinë e tij për akuzat penale të ngritura kundër tij (shih, midis shumë autoriteteve të tjera, Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, 16 Dhjetor 1992, § 39, Seria A nr. 247 B).
443. Duke pasur parasysh përfundimet e mësipërme, Gjykata çmon se fakti që ankuesi nuk u përfaqësua nga një avokat në dy seanca gjyqësore gjatë procedimeve të gjykimit, nuk çoi në një shkelje të Nenit 6 § 3 (c) të Konventës në lidhje me Nenin 6 § 1 të Konventës.

B. Shkelja e pretenduar e Nenit 6 § 1 në lidhje me Nenin 6 § 3 (d)

1.Parashtrimet e palëve

444. Ankuesi u ankua se refuzimi nga Gjykata e Rrethit Fier e kërkesës së tij për t'a lejuar të marrë në pyetje dëshmitarin M. shkeli të drejtën e tij sipas Nenit 6 § 3 (d). Ai gjithashtu u ankua se Gjykata e Rrethit Fier nuk ishte e gatshme të urdhëronte dëshmitarët e tij të mbrojtjes të paraqiteshin pranë asaj gjykate. Për më tepër, sipas mendimit të ankuesit, Gjykata e Rrethit Fier nuk mundi të merrte parasysh provat e shumë dëshmitarëve që kishin dëshmuar në favor të ankuesit para Gjykatës së Rrethit Berat (shih paragrafin Error! Reference source not found. më sipër).
445. Ankuesi parashtroi se prova e fajësisë dhe dënimit të tij për vrasjen e P, kryesisht bazoheshin në deklaratat e dëshmitarëve B., C. dhe D., që u morën gjatë hetimit penal. Asnjë prej këtyre dëshmitarëve nuk u paraqit në Gjykatën e Rrethit Fier. Për më tepër, dëshmitari A, nuk kishte qenë i pranishëm në vendin e krimit.
446. Qeveria parashtroi se më 23 shkurt 2000, M. u dëgjua para Gjykatës së Rrethit Fier.
Avokatit të ankuesit iu dha mundësia për të marrë në pyetje dëshmitarin, por ai refuzoi të përfitonte nga kjo mundësi. Për rrjedhojë, Gjykata e Rrethit Fier refuzoi kërkesat e mëtejshme të avokatit të ankuesit për marrjen në pyetje të M.
447. Qeveria nuk bëri ndonjë vëzhgim mbi ankimet e mëtejshme të ankuesit sipas këtij kreu.

2.Vlerësimi i Gjykatës

a. Parime të Përgjithshme

448. Gjykata në fillim rithekson se pranueshmëria e provave kryesisht rregullohet nga rregullat e ligjit të brendshëm dhe, si rregull, gjykatat e brendshme duhet të vlerësojnë provat e paraqitura pranë tyre. Detyra e Gjykatës sipas Konventës nuk është të japë vendim nëse deklaratat e dëshmitarëve u pranuan siç duhet si prova, por më tepër të përcaktojë nëse procedimet në tërësi, duke përfshirë mënyrën në të cilën u morën provat, ishin të drejta (shih vendimin e Balliu, cituar më sipër, § 42).
449. Provat normalisht duhet të paraqiten në një seancë me dyer të hapura, në prani të të paditurit, me qëllim argumentin kundërshtues. Ka përjashtime ndaj këtij parimi por ato nuk duhet të shkelin të drejtat e mbrojtjes. Si rregull i përgjithshëm, paragrafët 1 dhe 3 (d) të Nenit 6 kërkojnë që të paditurit t'i jepet mundësi e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të kundërshtuar dhe marrë në pyetje një dëshmitar kundër tij, qoftë kur ai bën deklaratat e tij ose në një fazë të mëvonshme të procedimeve (shih Lüdi kundër Zvicrës, 15 Qershor 1992, § 47, Seria A nr. 238, dhe Van Mechelen etj kundër Hollandës, 23 Prill 1997, § 51, Procesverbalet 1997 III). Normalisht, gjykatat kombëtare duhet të vendosin nëse është e nevojshme ose e këshillueshme të dëgjojnë një dëshmitar të caktuar. Neni 6 § 3 (d) nuk kërkon pjesëmarrjen dhe marrjen në pyetje të çdo dëshmitari në emër të të paditurit: qëllimi i tij kryesor, siç tregohet nga fjalët " nën të njëjtat kushte" , është një "barazi e plotë procedurale e prokurorisë dhe mbrojtjes" në çështje (shih, për shembull, Polufakin dhe Chernyshev kundër Rusisë, nr. 30997/02, § 205, 25 Shtator 2008).
450. Nën rrethana të caktuara mund të jetë e nevojshme për gjykatat që të kenë rekurs ndaj deklaratave të bëra gjatë fazës së hetimit penal. Nëse i pandehuri kishte mundësi të

mjaftueshme për të kundërshtuar këto deklarata, në kohën kur ato janë marrë ose në një fazë të mëvonshme të procedimeve, përdorimi i tyre nuk bie ndesh me garancitë e Nenit 6 §§ 1 dhe 3 (d). Të drejtat e mbrojtjes janë të kufizuara në një shkallë që është e papajtueshme me kërkesat e Nenit 6 nëse dënimi bazohet vetëm, ose në mënyrë përfundimtare, në dëshmitë nën besim të një dëshmitari të cilin i padituri nuk kishte asnjë mundësi për ta marrë në pyetje ose ta kishte marrë në pyetje gjatë hetimit, apo në gjykim (shih Vozhigov kundër Rusisë, nr. 5953/02, § 51, 26 Prill 2007; Lucà kundër Italisë, nr. 33354/96, § 40, ECHR 2001 II; dhe Solakov kundër "Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë", nr. 47023/99, § 57, ECHR 2001 X).

b. Ankimi për çështjen në fjalë

451. Gjykata vëren se ankuesi pretendon për një shkelje të Nenit 6 §§ 1 dhe 3 (d) të Konventës kryesisht për dy arsye: (i) në lidhje me akuzën e vrasjes të mbetur në tentativë të punonjësve të policisë, ai nuk kishte mundur të merrte në pyetje dëshmitarin M., disa dëshmitarë mbrojtjeje nuk ishin paraqitur para Gjykatës së Rrethit Fier dhe kjo e fundit nuk kishte marrë parasysh dëshmitë e disa dëshmitarëve të dhëna në favor të ankuesit para Gjykatës së Rrethit Berat; dhe, (ii) në lidhje me vrasjen e dyshuar të P. ai nuk kishte mundur të merrte në pyetje dëshmitarët, mbi fuqinë e deklaratave të të cilëve ai ishte dënuar.

(i) Akuza e vrasjes së mbetur në tentativë të punonjësve të policisë më 18Mars 1998

452. Gjykata vëren se dënimi i ankuesit për vrasjen e mbetur në tentativë të punonjësve të policisë më 18 Mars 1998 ishte bazuar, ndër të tjera, në dëshmitë e katër punonjësve të policisë K., L., M. dhe N. (shih paragrafin Error! Reference source not found. më sipër).

α. Dëshmitarët e akuzës

453. Në seancat gjyqësore të datave 23 Shkurt dhe 1 dhe 21 Mars 2000, ankuesi kërkoi pa sukses të lejohej të merrte në pyetje M. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se dënimi i ankuesit nuk ishte bazuar në "një shkallë vendimtare" ose vetëm në dëshminë e M. në gjykatën e shkallës së parë. Kur autoritetet e brendshme gjyqësore përballen me disa versione kontradiktore të të vërtetës të ofruara nga i njëjti person, preferenca e tyre përfundimtare për një deklaratë të dhënë autoriteteve hetimore ndaj një deklarate të dhënë në një gjyq me dyer të hapura, nuk ngre në vetvete një çështje sipas Konventës kur kjo preferencë është e bazuar dhe vetë deklarata ishte dhënë me dëshirën e personit (shih Lutsenko kundër Ukrainës, nr. 30663/04, § 49, 18 Dhjetor 2008). Ndërsa dëshmia e M. ishte e rëndësishme, u vërtetua nga prova të tjera materiale si për shembull raporti hetimor i vendit të krimit, raporti i arrestimit të ankuesit dhe raporti balistik dhe, kryesisht, dëshmitarë si K., L. dhe N., që u morën në pyetje nga ankuesi. Për më tepër, ankuesi nuk parashtroi asnjë argument bindës që të shpjegonte se marrja në pyetje e M. do të kishte qenë thelbësore për krijimin e fakteve të çështjes dhe përfshirjen e tij në veprën penale.

454. Rezulton që nuk ka patur asnjë shkelje të Nenit 6 § 1 në lidhje me 6 § 3 (d) të Konventës për shkak të refuzimit të Gjykatës për të lejuar ankuesin të marrë në pyetje M.

ß. Dëshmitarët e mbrojtjes

455. Në seancën gjyqësore të 1 Marsit 2000, në vijim të kërkesës së ankuesit, Gjykata e Rrethit Fier lëshoi disa fletëthirrje për paraqitjen e tre punonjësve të policisë O., Q. dhe S. Megjithatë, këta dëshmitarë të mbrojtjes nuk u paraqitën asnjëherë para gjykatës së shkallës së parë.
456. Ndërsa më 11 Maj 2000 ankuesi duket të ketë hequr dorë nga e drejta e tij për të marrë në pyetje dëshmitarin O. dhe lejoi leximin e deklaratave të dëshmitarëve Q. dhe S., ky ishte rezultati i zhgënjimit të tij mbi përpjekjet e vazhdueshme dhe të pasuksesshme nga autoritetet për t'i thirrur ata. Gjykata vëren se dëshmitë e tre punonjësve të policisë përbënin prova me, të paktën, rëndësi prima facie për mbrojtjen e ankuesit. Pamundësia e Shtetit që është paditur (domethënë Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Policisë) për të siguruar pjesëmarrjen e punonjësve të policisë që veprojnë si depozitues të autoritetit publik përgjegjës për mbrojtjen e interesave të përgjithshme të Shtetit, kombinuar me pamundësinë e gjykatës së shkallës së parë për të siguruar zbatimin e fletëthirrjes së saj, nuk arrin të sigurojë vullnetin që Shtetet Kontraktuese duhet të ushtrojnë me qëllim që të sigurojnë që të drejtat e garantuara nga Neni 6 të gëzohen në mënyrë efektive (shih Sadak etj kundër Turqisë, nr. 29900/96, 29901/96, 29902/96 dhe 29903/96, § 67, ECHR 2001 VIII, dhe vendimin e Barberà, Messegué dhe Jabardo kundër Spanjës, të datës 6 Dhjetor 1988, Seria A nr. 146, fq. 33, § 78). Gjykatat e Apelit nuk e rregulluan këtë shkelje megjithëse ankuesi e kërkoi këtë në arsyet e tij të apelit. Qeveria nuk dha shpjegime për këtë ose nuk u përpoq të justifikonte përse punonjësit e policisë nuk mund të paraqiteshin në gjykatë.
457. Rezulton se në këtë drejtim ka patur një shkelje të Nenit 6 § 1 në lidhje me Nenin 6 § 3 (d) të Konventës.
458. Gjykata vëren se katër dëshmitarët dëshmuan në favor të ankuesit para Gjykatës së Rrethit Berat (shih paragrafin 20 më sipër). Meqënëse të gjitha aktet e Gjykatës së Rrethit Berat ishin transferuar në mënyrë të arsyetuar në Gjykatën e Rrethit Fier, ankuesi mund të mos kërkonte paraqitjen e tyre. Gjykata e Rrethit Fier përjashtoi dëshmitë e tyre kur dha vendimin e saj, pa dhënë arsye mbi këtë. Qeveria nuk parashtroi argumente që justifikonin këtë përjashtim. Ndërsa Gjykata nuk mund të spekulojë në lidhje me rëndësinë e elementëve faktikë, gjykata e shkallës së parë nuk mori në konsideratë, pa justifikim, të gjitha provat e dëshmitarëve në favor të ankuesit, dhe këto prova sigurisht ishin të rëndësishme për çështjen dhe rrjedhimisht për vendimin.
459. Rezulton që në këtë drejtim ka patur një shkelje të Nenit 6 § 1 në lidhje me Nenin 6 § 3 (d) të Konventës.

(ii) Akuza e vrasjes së P. më 21 Korrik 1997

460. Gjykata vëren se vendimi i Gjykatës së Rrethit Fier që dënonte ankuesin për vrasjen e P. ishte bazuar tërësisht në dëshminë e A. dhe deklaratat e dëshmitarëve B., C. dhe D. të dhëna gjatë hetimit penal. Ky arsyetim u mbështet në apel.
461. Gjykata vëren se në procedurën penale Shqiptare, Gjykata e Apelit ka juridiksionin të trajtojë jo vetëm çështje të ligjit por edhe çështje të faktit në lidhje me tërësinë e çështjes. Gjykata e Apelit është e autorizuar të shqyrtojë provat dhe materialet e reja shtesë të paraqitura nga palët, siç e çmon të nevojshme. Si rezultat i shqyrtimit, Gjykata e Apelit mund

të rrëzojë apelin dhe të mbështesë vendimin, të ndryshojë vendimin ose të shfuqizojë vendimin dhe të përfundojë procedimet penale ose të shfuqizojë vendimin dhe të paraqesë çështjen për rigjykim. Gjykata e Lartë trajton çështjet e ligjit të ngritura në apelin e ankuesit.
462. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se A. nuk ishte as dëshmitare okulare, as e pranishme në vendin e krimit. Dëshmia e saj u bazua në deklaratat e dëshmitarëve B., C. dhe D., që ishin bërë gjatë hetimit penal. As ankuesi, as avokati i tij nuk mund të përballeshin me këta dëshmitarë kryesorë ose të bënin pyetje ose komente në lidhje me ato deklarata, meqë në atë kohë nuk ishte ngritur asnjë akuzë kundër tij (shih paragrafin 7 më sipër).
463. Për më tepër, Gjykata çmon se ankuesi nuk hoqi dorë nga e drejta e tij për të marrë në pyetje ata dëshmitarë. Më 7 Shkurt 2000 ai kundërshtoi leximin e deklaratave të tyre dhe kërkoi paraqitjen e tyre para Gjykatës së Rrethit Fier. Gjykata sërish rithekson përfundimet e saj në paragrafin 108 më sipër. Gjykata nuk është e bindur se autoritetet ishin të zellshme në përpjekjet e tyre për të sjellë dëshmitarët para gjykatës së shkallës së parë. Mosparaqitja e këtyre dëshmitarëve deklaratat e të cilëve ishin vendimtare për dënimin e ankuesit, e parandaloi ankuesin nga marrja e tyre në pyetje ose nga marrja e tyre e mëparshme në pyetje. Ky mosveprim nuk u rregullua as nga Gjykata e Apelit që ishte e autorizuar të shqyrtonte çështjet e faktit dhe ligjit, as nga Gjykata e Lartë.
464. Duke marrë në konsideratë faktorët e mësipërm, Gjykata rrjedhimisht nxjerr përfundimin se në këtë drejtim ka patur një shkelje të Nenit 6 § 1 në lidhje me Nenin 6 § 3 (d) të Konventës.

III. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

465. Neni 41 i Konventës parashikon:
"Nëse Gjykata konstaton se ka patur një shkelje të Konventës ose Protokolleve të saj dhe nëse ligji i brendshëm i Palës së Lartë Kontraktuese përkatëse lejon vetëm kryerjen e një kompensimi të pjesshëm , nëse është e nevojshme, Gjykata do t'i japë kompensim të drejtë palës së dëmtuar."
466. Ankuesi theksoi se ai kishte qenë në burg për të paktën 114 muaj ose 3,400 ditë deri në kohën që parashtroi vërejtjet e tij në Gjykatë. Ai kërkoi pagesën e 136,000 EURO në lidhje me dëmin financiar që kishte pësuar. Ankuesi nuk përcaktoi ndonjë shumë në lidhje me dëmin jo-financiar, megjithëse specifikoi se sipas ligjit të brendshëm, kishte të drejtë për kompensim. Ai gjithashtu specifikoi se në raste të ngjashme gjykatat e brendshme kishin kompensuar dëme jo-financiare në shumën prej 100,000 EURO.
467. Qeveria rrëzoi pretendimin e ankuesit për kompensim të drejtë.

A. Dëmi

468. Për sa i përket dëmit financiar që pretendohet të jetë shkaktuar, Gjykata rithekson se duhet të ketë një lidhje të qartë shkakësore midis dëmit të pretenduar nga ankuesit dhe shkeljes së Konventës (shih, ndër të tjera, Dybeku kundër Shqipërisë, nr. 41153/06, § 65, 18 Dhjetor 2007).

469. Gjykata, duke marrë parasysh përfundimet e saj në lidhje me ankimet e ankuesit sipas Nenit 6 §§ 1 dhe 3 (c) dhe (d), çmon se nuk është vendosur asnjë lidhje shkakësore midis dëmit të pretenduar dhe shkeljeve që ka konstatuar. Gjykata nuk mund të spekulojë se cili mund të kishte qenë rezultati i procedimeve penale kundër ankuesit nëse nuk do të kishte ndodhur shkelja e Konventës (shih Polufakin dhe Chernyshev, cituar më sipër, § 216). Rrjedhimisht, Gjykata e çmon të papërshtatshme që t'i japë ankuesit kompensim për dëmin e pretenduar financiar.
470. Në shkallën që pretendimi i ankuesit lidhet me rezultatet e shkeljeve të Nenit 6 § 3 (d) në lidhje me Nenin 6 § 1, Gjykata rithekson se kur një kërkues është dënuar pavarësisht një shkeljeje të mundshme të të drejtave të tij siç garantohet nga Neni 6 i Konventës, ai duhet, sa më shumë të jetë e mundur, të vihet në një pozicion në të cilin do të kishte qenë, nëse kërkesat e asaj dispozite nuk do të ishin marrë parasysh dhe që forma më e përshtatshme e kompensimit, në parim, do të ishte gjykimi de novo ose rifillimi i procedimeve, nëse do të kërkohej (shih Salduz kundër Turqisë [GC], nr. 36391/02, § 72, 27 Nëntor 2008; Polufakin dhe Chernyshev, cituar më sipër, § 219; Öcalan kundër Turqisë [GC], nr. 46221/99, § 210 në gjobë, ECHR 2005-IV; dhe Popov kundër Rusisë, nr. 26853/04, § 263, 13 Korrik 2006).
471. Për sa i përket pjesës së mbetur të pretendimit për dëm jofinanciar, duke vendosur mbi baza të barabarta, Gjykata i jep ankuesit 3,000 EURO plus çdo taksë që mund të vendoset mbi këto shuma.

B. Kostot dhe shpenzimet

472. Ankuesi i cili mori 850 EURO në ndihmën ligjore nga Këshilli i Evropës në lidhje me paraqitjen e çështjes së tij, përveç kësaj kërkoi 500 EURO në muaj për kostot e udhëtimit të anëtarëve të familjes së tij për ta vizituar atë në mjediset e paraburgimit dhe për shpenzimet ushqimore të shkaktuara ndërsa ishte në paraburgim. Nuk u ngrit asnjë pretendim tjetër në lidhje me kostot dhe shpenzimet e shkaktuara pranë gjykatave të brendshme dhe kësaj Gjykate.
473. Gjykata e hodhi poshtë pretendimin.
474. Gjykata vëren se asaj nuk i është dhënë dokumentacioni përkatës që tregon se shpenzimet e pretenduara në fakt ishin shkaktuar. Rrjedhimisht, Gjykata nuk do të bëjë një kompensim sipas këtij kreu.

C. Kamatëvonesa
475. Gjykata e çmon të nevojshme që kamatëvonesa të bazohet në normën marzhinale të huadhënies të Bankës Qendrore Evropiane të cilës duhet t'i shtohen tre pikë në përqindje.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA NJËZËRI

1. Shpall ankimet në lidhje me Nenin 6 të Konventës të pranueshme dhe pjesën e mbetur të kërkesës të papranueshme;
2. Vendos se nuk ka patur asnjë shkelje të Nenit 6 § 1 në lidhje me Nenin 6 § 3 (c) të Konventës mbi mungesën e të drejtës së ankuesit për avokat gjatë fazave të gjykimit të tij;

3. Vendos se nuk ka patur asnjë shkelje të Nenit 6 § 1 në lidhje me Nenin 6 § 3 (d) të Konventës mbi refuzimin e gjykatës së shkallës së parë për të lejuar ankuesin të marrë në pyetje dëshmitarin M.;

4. Vendos se ka patur një shkelje të Nenit 6 § 1 në lidhje me Nenin 6 § 3 (d) të Konventës mbi pamundësinë për të garantuar paraqitjen në gjykimin e ankuesit të dëshmitarëve O., Q. dhe S.;

5. Vendos se ka patur një shkelje të Nenit 6 § 1 në lidhje me Nenin 6 § 3 (d) të Konventës mbi pamundësinë e gjykatës së shkallës së parë për të marrë në konsideratë dëshmitë e katër dëshmitarëve të dhëna në favor të ankuesit para Gjykatës së Rrethit Berat;

6. Vendos se ka patur një shkelje të Nenit 6 § 1 në lidhje me Nenin 6 § 3 (d) të Konventës mbi pamundësinë për të garantuar paraqitjen në gjykimin e ankuesit të dëshmitarëve B., C. dhe D.;

7. Vendos
(a) se Shteti i paditur duhet t'i paguajë ankuesit brenda tre muajve nga data në të cilën vendimi ka marrë formë të prerë, në përputhje me Nenin 44 § 2 të Konventës, 3,000 EURO (tre mijë euro) në lidhje me dëmin jo-financiar, plus çdo taksë që mund të vendoset, e cilat duhet të konvertohet në monedhën kombëtare të Shtetit të paditur në normën e zbatueshme në datën e pagesës;
(b) se nga skadimi i tre muajve të lartpërmendur deri në shlyerje, interesi i thjeshtë do të paguhet në shumën e mësipërme në një normë të barabartë me normën marzhinale të huadhënies të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit të detyrimeve financiare plus tre pikë në përqindje;
8. Rrëzon pjesën e mbetur të pretendimit të ankuesit për kompensim të drejtë. Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 8 Dhjetor 2009, sipas Nenit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Lawrence Early **Nicolas Bratza**

Sekretar **Kryetar**

ÇËSHTJA “GRORI KUNDËR SHQIPËRISË”

(APLIKIMI NR. 25336/04)

VENDIM

STRASBURG

7 korrik 2009

Ky vendim merr formë përfundimtare në rrethanat e parashikuara në nenin 44 § 2 të Konventës. Vendimi mund të jetë objekt rishikimesh redaktimi.

Në çështjen Grori k. Shqipërisë,

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i katërt), i përbërë nga trupi gjykues:

Nicolas Bratza, kryetar
Josep Casadevall
Giovanni Bonello
Kristaq Traja
Ljiljana Mijović
Ján Šikuta
Päivi Hirvelä, gjyqtarë,
dhe Laërence Early, sekretar i Seksionit,

pas shqyrtimit të çështjes në seancë të mbyllur më 27 nëntor 2007, 20 janar 2008 dhe 18 qershor 2009,

jep vendimin e mëposhtëm, i cili është miratuar në datën e fundit.

PROCEDURA

92. Çështja e ka zanafillën në aplikimin (nr. 25336/04) kundër Republikës së Shqipërisë, të depozituar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive Kryesore të Njeriut (Konventa) nga një nënshtetas shqiptar, z. Arben Grori (“ankuesi”), në datën 9 korrik 2004.

93. Ankuesi u përfaqësua nga z.A.Kasapi, avokat që ushtron profesionin në Tiranë. Qeveria shqiptare (Qeveria) u përfaqësua nga agjentët e saj, z. S. Puto dhe znj. S. Mëneri.

94. Ankuesi pretendon se, në veçanti, gjykatat shqiptare kishin vendosur për burgimin e tij, duke konvertuar një vendim të dhënë nga gjykatat italiane, në shkelje flagrante të kërkesave ligjore që rridhnin nga ligjet në fuqi në atë kohë. Ai bazohet në nenin 3, nenin 5 § 1 (a), nenin 6 § 1 dhe nenin 7 të Konventës dhe nenin 2 të protokollit nr. 7 të Konventës.

95. Më 6 shtator 2005, Gjykata vendosi ta njoftonte qeverinë për aplikimin. Sipas dispozitave të nenit 29 § 3 të Konventës, ajo vendosi ta shqyrtojë themelin e çështjes në të njëjtën kohë me pranueshmërinë e saj.

96. Më 7 dhjetor 2004, aplikimit iu dha përparësi, sipas nenit 41 të rregullores së gjykatës.

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

97. Ankuesi ka lindur në vitin 1971 dhe aktualisht po vuan dënimin me burgim të përjetshëm dhe me 15 vjet heqje lirie në burgun e sigurisë së lartë të Peqinit (Shqipëri).

A. Baza e çështjes

98. Më 6 tetor 1997 autoritetet italiane lëshuan një urdhërarresti për ankuesin, duke e akuzuar për vrasje me paramendim të një nënshtetasi shqiptar në Milano, Itali.

99. Më 2 shkurt 2001, ankuesi u dënua në mungesë (*in absentia*) me burgim të përjetshëm nga Gjykata e Apelit të Milanos (Milan Assize Court of Appeal) për vrasje dhe me pesë vjet heqje lirie për armëmbajtje pa leje.

100. Më 16 shkurt 2001, autoritetet italiane lëshuan një fletarresti të dytë për ankuesin, lidhur me një akuzë të re kundër tij, për pjesëmarrje në një organizatë kriminale dhe trafikim ndërkombëtar të lëndëve narkotike. Nga dokumentet në dosje del se gjatë periudhës së proceseve në gjykatat italiane, ankuesi kryente një biznes të ligjshëm dhe banonte në Shqipëri.

101. Më 29 prill 2001 Interpoli i Shqipërisë i transmetoi policisë së Tiranës dy fletëarrestet e përmendura më lart. Në të njëjtën datë, shefi i policisë kriminale të Tiranës urdhëroi "zbatimin e menjëhershëm të fletarrestit".

102. Më 30 prill 2001, Interpoli i Romës u dërgoi një faks autoriteteve shqiptare duke u kërkuar fillimin e proceseve penale kundër ankuesit për krimet e kryera në territorin italian.

B. Proceset penale për akuzat për trafikim ndërkombëtar të lëndëve narkotike

1. Arrestimi fillestar i ankuesit

103. Më 30 prill 2001, ankuesi u ndalua në Shqipëri mbi bazën e fletë arrestit të lëshuar më 16 shkurt 2001 nga gjyqtari hetues i Gjykatës së Apelit të Milanos. Akuza lidhej me përfshirjen e ankuesit në një organizatë kriminale dhe me trafikimin ndërkombëtar të lëndëve narkotike.

104. Më 1 maj 2001, ankuesi u mbajt i ndaluar në paraburgim për 15 ditë në pritje të vendimit të gjykatës.

105. Më 12 maj 2001, gjykata e rrethit të Tiranës, ("Gjykata e Rrethit"), rrëzoi ankimimin e ankuesit kundër arsyeve të ndalimit të tij. Të njëjtën ditë, prokurori e informoi ankuesin rreth akuzave të ngritura kundër tij, që ishin pjesëmarrje në një organizatë kriminale dhe trafikimi ndërkombëtar i lëndëve narkotike.

106. Më 15 maj 2001, gjykata e rrethit pranoi parashtrimin e prokurorit dhe urdhëroi burgimin e ankuesit për një periudhë të pacaktuar. Më 4 qershor 2001, Gjykata e Lartë e pranoi vendimin.

107. Në qershor dhe dhjetor 2001, zyra e Prokurorit të Përgjithshëm i kërkoi në mënyrë të përsëritur autoriteteve italiane të dërgonin prova që mbështesnin akuzat kundër ankuesit. Në janar 2002, kërkesa u përsërit dhe nga Ministria e Drejtësisë së Shqipërisë.

2. Fillimi i proceseve penale

108. Në 30 korrik 2002, zyra e Prokurorit të Përgjithshëm filloi proceset penale në gjykatën e rrethit të Tiranës, duke e akuzuar ankuesin me trafikim të lëndëve narkotike (më poshtë proceset penale).

109. Më 29 dhjetor 2003, gjykata e rrethit e nxori fajtor ankuesin për krijimin e një organizate kriminale dhe për trafikimin ndërkombëtar të lëndëve narkotike dhe e dënoi atë me

19 vjet heqje lirie. Sipas ankuesit, dënimi lidhej me një akuzë të re, për të cilën ai nuk ishte njoftuar kurrë më parë. Më 25 qershor, Gjykata e Apelit të Tiranës (Gjykata e Apelit) la në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit. Por ndryshoi dënimin e ankuesit në 17 vjet heqje lirie. Ankuesi apeloi vendimin në Gjykatën e Lartë. Më 23 qershor 2006, Gjykata e Lartë ndryshoi cilësimin e njërës prej veprave penale për të cilën ishte dënuar ankuesi. Ajo la në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit dhe ndryshoi dënimin e ankuesit me 15 vjet heqje lirie. Ankuesi i dërgoi një ankesë kushtetuese Gjykatës Kushtetuese kundër vendimeve të lartpërmendura, ankesë e cila është ende pezull në Gjykatën Kushtetuese.

C. Proceset për vlefshmërinë dhe zbatimin në Shqipëri të vendimit të dhënë nga gjykata Italiane

1. Kërkesa për vlefshmërinë e vendimit të gjykatave italiane dhe arrestimi i dytë i ankuesit

110. Më 21 shkurt 2002, ndërsa ankuesi ishte i ndaluar për akuzat për pjesëmarrje në një organizatë kriminale dhe për trafikimin ndërkombëtar të lëndëve narkotike (shih paragrafin 12 më lart), zyra e prokurorisë publike të Milanos i kërkoi Ministrisë Italiane të Drejtësisë t'u kërkonte autoriteteve shqiptare të bënin të vlefshëm (të njihnin) në Shqipëri vendimin e dhënë për ankuesin nga Gjykata e Apelit të Milanos (Milan Assize Court of Appeal) më 2 shkurt 2001, që kishte marrë formë përfundimtare më 30 janar 2002.

111. Më 28 mars 2002, Ministria Italiane e Drejtësisë, ndërmjet të tjerave, e informoi zyrën e prokurorit publik të Milanos se autoritetet italiane nuk mund të kërkojnë njohjen dhe zbatimin në Shqipëri të një vendimi penal të dhënë nga gjykata italiane, duke qenë se asnjëri nga shtetet nuk ishte palë në ndonjë marrëveshje ndërkombëtare që lidhej me këtë çështje. Të njëjtën ditë, Ministria Italiane e Drejtësisë, i dërgoi Ambasadës Shqiptare në Romë vendimin e sipërpërmendur për arsye informative.

112. Më 8 prill 2002, Ambasada Shqiptare në Romë, në një letër me kokë çorientuese "Transferimi i një nënshtetasi shqiptar që aktualisht vuan dënimin në Itali", e informoi qeverinë shqiptare për "kërkesën për ekstradim" të Ministrisë Italiane të Drejtësisë për ankuesin, i cili, sipas letrës së ambasadës, "po vuante dënimin në Itali".

113. Më 23 prill 2002, Qeveria e Italisë dhe qeveria e Shqipërisë nënshkruan një marrëveshje për transferimin e personave të dënuar, e cila u ratifikua nga parlamentet përkatëse në vitin 2003 dhe 2004.

114. Më 3 maj 2002, Ministria e Drejtësisë së Shqipërisë, sipas nenit 512 të Kodit të Procedurës Penale të Shqipërisë (KPP), i kërkoi zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm të fillonte procedurën për njohjen dhe zbatimin në Shqipëri të vendimit të dhënë nga gjykata italiane për ankuesin.

115. Më 15 maj 2002, gjykata e rrethit, në një proces me një gjyqtar të vetëm, urdhëroi ndalimin e ankuesit në pritje të proceseve për njohjen dhe zbatimin e vendimit të Gjykatës së Apelit të Milanos (Milan Assize Court of Appeal) të datës 2 shkurt 2001 në Shqipëri. Ankuesit iu bë i ditur vendimi, ndërkohë që ishte i ndaluar për proceset penale të përmendura më lart (shih paragrafët 108-109 më lart).

2. Proceset e zakonshme gjyqësore

116. Më 10 maj 2002, sipas nenit 512 dhe 514 të KPP-së, zyra e Prokurorisë së Përgjithshme filloi proceset para gjykatës së rrethit për njohjen dhe zbatimin në Shqipëri të gjykimit të dhënë nga Gjykata e Apelit të Milanos (më poshtë "proceset e njohjes dhe zbatimit").

117. Sipas parashtrimeve të ankuesit në gjykatën e rrethit në maj të vitit 2002, neni 514 i KPP-së kërkon, *inter alia*, pëlqimin e tij për njohjen dhe zbatimin në Shqipëri të vendimit të Gjykatës së Apelit të Milanos, pëlqim të cilin ai vendosi të mos e jepte (shih paragrafin 85 më poshtë).

118. Më 13 qershor 2002 Parlamenti miratoi ndryshimet për dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, të cilat, *inter alia*, shfuqizuan kërkesën për pëlqimin e të ndaluarit, të parashikuar në pikën (e) të nenit 514 të KPP-së (shih paragrafin 177 më poshtë).

119. Më 17 qershor 2002, Prokurori i Përgjithshëm depozitoi vëzhgime të tjera në gjykatën e rrethit, duke theksuar, ndërmjet të tjerash, se:

"... pavarësisht nga fakti se pëlqimi i personit të dënuar kërkohet nga neni 514 (e) i KPP-së për njohjen në Shqipëri të një vendimi të dhënë nga një organ i huaj, kjo duhet të interpretohet vetëm në rrethanat që lidhen me transferimin e personave të dënuar dhe jo në një mënyrë të tillë që të pengojë dhënien e drejtësisë. Për më tepër, Parlamenti, nëpërmjet ligjit nr. 8813 të 13 qershorit 2002, e shfuqizoi pikën (e) të nenit 514 të KPP-së ..."

120. Më 20 qershor 2002, gjykata e rrethit e rrëzoi kërkesën e Prokurorit të Përgjithshëm, duke e konsideruar atë si jo në përputhje me kërkesat e nenit 514, pika (e) e KPP-së. Gjykata vendosi:

"...kërkesat e parashikuara në nenin 514, pika (e), të KPP-së është e nevojshme për njohjen dhe zbatimin në Shqipëri të një vendimi të dhënë nga një organ i huaj, në përputhje me Konventën mbi Transferimin e Personave të Dënuar dhe dispozitat e legjislacionit të brendshëm. Në përputhje me formulimin e nenit të sipërpërmendur, kërkohet pëlqimi i personave të dënuar pa dallim ndërmjet rrethanave të transferimit të të ndaluarit ose njohjes së vendimit të dhënë nga një gjykatë e huaj. Për më tepër, ligji nr.8813 i 13 qershorit 2002, që shfuqizon pikën (e) të nenit 514, nuk është i zbatueshëm në rastin në fjalë, pasi ai nuk ka hyrë në fuqi ende ..."

121. Më 24 korrik 2002, Gjykata e Apelit rrëzoi ankesën e bërë nga Prokurori i Përgjithshëm. Gjykata pranoi arsyetimin e dhënë në vendimin e gjykatës së rrethit dhe vendosi që ligji nr. 8813 i 13 qershorit 2002 nuk ka efekt prapaveprues me arsyetimin se ai do të çonte në dispozita më të ashpra në dëm të ankuesit.

122. Në një datë të paspecifikuar në vitin 2002, Prokurori i Përgjithshëm bëri apel në Gjykatën e Lartë (Seksioni penal) kundër vendimit të Gjykatës së Apelit.

123. Më 29 tetor 2002, për unifikimin dhe ndryshimin e praktikës gjyqësore, Kryetari i Gjykatës së Lartë ia kaloi juridiksionin për çështjen Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

124. Më 30 janar 2003, Gjykata e Lartë, Kolegjet e Bashkuara, rrëzuan vendimet e Gjykatës së Apelit dhe të gjykatës së rrethit dhe vendosën t'ia dërgonin çështjen sërish për shqyrtim gjykatës së rrethit. Në vendimin e saj, Gjykata e Lartë i interpretoi dispozitat e KPP-së të lidhura me ekstradimin, transferimin e personave të dënuar dhe njohjen dhe zbatimin në Shqipëri të vendimeve të dhëna nga gjykata të huaja, duke e dhënë përkufizimin e saj nga

pikëpamja e parimeve të së drejtës ndërkombëtare dhe të bashkëpunimit ndërshtetëror. Gjykata vendosi që në rrethanat ku nuk mund të jepej asnjë vendim për një çështje specifike, pasi dispozitat përkatëse ishin të papërshtatshme, baza ligjore mund të ofrohej nga zakonet ndërkombëtare, përkatësisht nga parimet të vullnetit së mirë dhe reciprocitetit dhe traktatet. Në rastin në fjalë, duke thënë se kërkesat e parashikuara në nenin 514, pika (e) të KPP-së ishin të papërshtatshme, ajo ishte e mendimit se Konventa Europiane mbi Njohjen Ndërkombëtare të Vendimeve Penale dhe Konventa Europiane mbi Transferimin e Personave të Dënuar parashikonte një bazë të mjaftueshme për njohjen dhe zbatimin në Shqipëri të vendimit të Gjykatës së Apelit të Milanos.

125. Gjykata deklaroi, në lidhje me atë çfarë u trajtua më lart, si më poshtë:

"Transferimi i personave të dënuar është rregulluar nga Konventa Europiane mbi Transferimin e Personave të Dënuar, e ratifikuar nga Parlamenti i Republikës së Shqipërisë dhe botuar në Fletoren Zyrtare nr. 22 të 1999-ës (...). Konventa Europiane për Njohjen e Vendimeve Penale është e nënshkruar, por nuk është ratifikuar ende nga Parlamenti. Si e tillë, Konventa nuk mund të konsiderohet pjesë përbërëse e korpusit të brendshëm ligjor dhe nuk është drejtpërsëdrejti e zbatueshme. Gjithsesi, nënshkrimi dhe miratimi i dispozitave, sipas të cilave shteti njeh dhe respekton normat dhe parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare, na udhëzon të kuptojmë, interpretojmë dhe të zbatojmë drejt dispozitat e KPP-së në fjalë.

(...)

Në rast të njohjes dhe të zbatimit të një vendimi penal të huaj, referenca dhe zgjidhja e çështjes në përputhje me pikën (e) të nenit 514 të KPP-së, në kohën materiale, nuk ka kuptim. Nëse gjykata e konsideron pëlqimin e personit të dënuar si thelbësor, ky pëlqim do të çonte në interpretimin *ad literam* të dispozitës, ashtu siç është zbatuar nga gjykata e rrethit dhe gjykata e apelit. Por, interpretimi i një dispozite ligjore është shumë kompleks. Në rast se një interpretim ad *literam* çon në absurditet [situatë pa kuptim], mbizotëron interpretimi logjik dhe sistematik. Sipas këtij interpretimi, dispozita në fjalë do të interpretohet në mënyrë të arsyeshme. Kjo do të thotë se nocioni "i pëlqimi të personit të dënuar", nuk mund të interpretohet gjerësisht. Ai duhet të interpretohet ngushtë në mënyrë që të mos çojë në absurditet, siç do të ishte rasti ku ankuesi duhet të japë pëlqimin për të vuajtur dënimin penal në vendin e tij. Siç rrjedh nga aktet, ankuesi është gjykuar *in absentia* pasi i fshihej drejtësisë italiane.

(...)

Pëlqimi i një personi të dënuar nga një gjykatë e huaj është *sine qua non* për caktimin e çështjes, nëse dënimi vuhet në shtetin dënues ose në shtetin e origjinës së personit të ndaluar, çfarë do të thotë në burgjet e vendit të të cilit ai është qytetar [është theksuar më shumë teksti origjinal].

(...)

Ky vendim i Gjykatës së Lartë, Kolegjet e Bashkuara, e zgjidh përfundimisht problemin, sipas së cilit mungesa e pëlqimit të personit të dënuar për njohjen dhe zbatimin e një vendimi të huaj penal nuk është pengesë për gjykatat shqiptare për të vijuar me pranimin dhe njohjen [është theksuar teksti origjinal].

Gjatë shqyrtimit të çështjes, avokati i ankuesit deklaroi se nuk ka marrëveshje

dypalëshe ndërmjet Shqipërisë dhe Italisë në lidhje me njohjen dhe zbatimin e vendimeve penale. Ai tha se një akt i tillë cenon sovranitetin e shtetit shqiptar, i cili ushtrohet nga Parlamenti nëpërmjet ratifikimit të një marrëveshjeje ndërkombëtare ose dypalëshe. Ky pretendim ishte i pabazuar. Parlamenti shqiptar e manifestoi dëshirën e tij sovrane nëpërmjet miratimit të KPP-së, dispozitat e së cilës duhet të zbatohen në përputhje me kuptimin e tyre dhe me interpretimin e unifikuar të Gjykatë së Lartë, siç theksohet më lart.

Duhet të theksohet se në mungesë të instrumenteve të nënshkruara dhe të ratifikuara, normat përgjithësisht të njohura të së drejtës ndërkombëtare mund të zbatohen në përputhje me parimin e dëshirës së mirë dhe të reciprocitetit. Në përputhje me KPP-në, Ministria e Drejtësisë është përgjegjëse për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja, duke përfshirë dhe italianët.

Sipas nenit 512 të KPP-së, është brenda kompetencës së ministrisë përkatëse, si manifestim i dëshirës politike të shtetit shqiptar, të kërkojë njohjen nga gjykata të një vendimi të huaj. Këtë lloj diskrecioni nuk e shqyrton gjykata. Gjykata shqyrton vetëm nëse kërkesa është bërë nga autoriteti kompetent në përputhje me ligjin dhe nëse dokumentacioni është i plotë.”

3. Proceset e rigjykimit

126. Në proceset e rigjykimit para gjykatës së rrethit, ankuesi pretendoi se nuk kishte pasur asnjë kërkesë nga autoritetet italiane për njohjen dhe zbatimin e vendimit penal italian kundër tij, duke pasur parasysh dhe letrën e autoriteteve italiane të datës 28 mars 2000 (shih paragrafin 111 më lart). Për më tepër, ai shtoi se nuk kishte marrëveshje dypalëshe ndërmjet të dy shteteve për bërjen efektive të kësaj njohjeje. Ankuesi u bazua gjithashtu në faktin se ai nuk kishte dhënë pëlqimin e tij për njohjen.

127. Më 20 maj 2003, gjykata e rrethit, me trup gjykues prej tre gjyqtarësh, u bazua tërësisht në vendimin e Gjykatë së Lartë të 30 janarit 2003. Ajo vendosi se dënimi i dhënë nga Gjykata e Apelit të Milanos ishte në përputhje me dispozitat e KPP-së së Shqipërisë, të ndryshuar nga ligji nr. 8813 i datës 13 qershor 2002. Ajo vendosi që ankuesi të vuante dënimin kumulativ të burgimit të përjetshëm në Shqipëri për vrasje dhe për armëmbajtje pa leje.

128. Gjyqtari drejtues E.K. shprehu një opinion pjesërisht të kundërt për gjykimin e lart-përmendur, duke i kujtuar gjykatës se dispozitat përkatëse statutore parashikojnë një dënim maksimal prej 25 vjet heqje lirie në vend të burgimit të përjetshëm, siç ishte vendosur në çështjen e ankuesit.

129. Sipas parashtrimeve të ankuesit në proceset aktuale përpara gjykatës, gjykata e rrethit zbatoi ato pjesë të ligjit nr.8813 të 13 qershorit 2002 që kontribuan për përkeqësimin e situatës së tij. Për më tepër në përputhje me nenin 13 të KPP-së, siç është ndryshuar në ligjin e lartpërmendur, gjykata, në rastin e tij, duhet të kishte formacionin e gjyqtarit të vetëm. Për më tepër, ai tha se, duke pasur parasysh dhe mendimin ndryshe të gjyqtarit E.K, formacioni i trupit gjykues mund të kishte pasur ndikim mbi rezultatet e proceseve.

130. Në një datë të paspecifikuar në vitin 2003, ankuesi bëri apel duke përdorur të njëjtën arsyetim kur çështja ishte në gjykatën e rrethit.

131. Më 10 shtator 2003, Gjykata e Apelit rrëzoi ankesën dhe la në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit, duke u bazuar tërësisht në gjykimin e Gjykatës së Lartë të 30 janarit 2003.

132. Ankuesi theksoi se në seancën e fundit të proceseve të apelit, gjyqtari Sh. B., i cili kishte qenë drejtues procesi deri në atë moment, ishte zëvendësuar nga gjyqtari D. B., pa vendim zyrtar.

133. Ankuesi i ofroi gjykatës dy vendime të gjykatës së apelit që kishin ekzaktësisht të njëjtin tekst, por ishin dhënë nga dy trupa të ndryshëm gjykues: i pari ishte dhënë nga një trup gjykues i drejtuar nga Sh. B. dhe i dyti nga një trup gjykues i drejtuar nga D. B.

134. Më 9 tetor 2003 ankuesi apeloi në Gjykatën e Lartë. Ai u bazua thuajse në të njëjtat baza apelimi siç kishte bërë kur kishte dërguar çështjen para gjykatës së rrethit dhe gjykatës së apelit. Për më tepër, ankuesi e konsideroi zbatimin e normave përgjithësisht të njohura të së drejtës ndërkombëtare si të papërshtatshme dhe joprecize.

135. Më 30 janar 2004, Gjykata e Lartë rrëzoi apelin e ankuesit, pasi baza e apelit ishte jashtë objektit të neneve 432 dhe 448 § 2 të KPP-së (shih paragrafët 173 dhe 174 më poshtë).

136. Në prill 2004, ankuesi apeloi në Gjykatën Kushtetuese kundër vendimeve të Gjykatës së Lartë të datës 30 janar 2003 dhe 30 janar 2004. Ai pretendoi se proceset kishin qenë të padrejta në shumë aspekte. Në veçanti, ai u ankua se proceset penale kishin qenë në kundërshtim me kërkesat e KPP-së të parashikuara në nenin 13 (përbërja e gjykatave), 514 (pëlqimi i personave të dënuar) dhe 512 (njohja dhe zbatimi në Shqipëri të një vendimi të lëshuar nga një gjykatë e huaj, kërkesa që bëhet nga një autoritet i huaj dhe një marrëveshje e vlefshme ndërkombëtare dhe/ose dypalëshe duhej të ishte në fuqi ndërmjet të dyja vendeve). Ankuesi tha se autoritetet italiane nuk kishin bërë asnjë kërkesë për njohje vendimi për Ministrinë e Drejtësisë së Shqipërisë, dhe nuk kishte asnjë konventë ndërkombëtare në fuqi ndërmjet të dy vendeve në atë kohë.

137. Më 12 korrik 2004, Gjykata Kushtetuese rrëzoi apelin e ankuesit. Ajo u shpreh se vendimet e Gjykatës së Lartë të datave 30 janar 2003 dhe 30 janar 2004 ishin kushtetuese. Për më tepër, ajo vendosi se megjithëse përbërja e trupit gjykues të gjykatës së rrethit të datës 20 maj 2003 ishte në kundërshtim me ligjin, kjo gjë nuk e bën procesin jokushtetues në tërësi. Në lidhje me praninë e dy gjykimeve të dhëna nga dy trupa të ndryshëm gjykues të gjykatës së apelit të datës 10 shtator 2003, Gjykata Kushtetuese theksoi se kishte vetëm një gjykim në dosjen e çështjes, që i korrespondonte trupit gjykues që kishte vendosur për çështjen.

138. Në vendim, në pjesët përkatëse, thuhej:

"Gjykata Kushtetuese është e mendimit se argumentet e ngritura në vendimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë [i 30 janarit 2003] nuk janë në kundërshtim me Kushtetutën ose konventat [ndërkombëtare]. Njohja [vlefshmëria] e ndërsjellë e vendimeve të gjykatës shërben për të forcuar bashkëpunimin juridik ndërmjet shteteve dhe për të arritur objektiva të caktuara në lidhje me lirinë, sigurinë dhe drejtësinë. Parimi i reciprocitetit presupozon përdorimin e instrumenteve të ndërsjella dhe ligjore në marrëdhëniet ndërshtetërore. Në të drejtën ndërkombëtare, reciprociteti përkufizohet si e drejta e barazisë dhe e respektit të ndërsjellë ndërmjet shteteve. Doktrina dhe jurisprudenca ndërkombëtare penale kanë konfirmuar se bashkëpunimi ndërmjet vendeve mund të ndodhë dhe në mungesë të traktateve dypalëshe, mbi bazën e parimi të reciprocitetit.

Si rregull, parimi i reciprocitetit zbatohet në instrumente ndërkombëtare, si në traktate dhe në marrëveshje, që parashikojnë të drejta dhe detyrime të ndërsjella. Por, në raste

përjashtimore, në mungesë të marrëveshjeve të ndërsjella, shtetet nuk janë të përjashtuara nga zbatimi i drejtpërdrejtë i parimit të reciprocitetit, nga normat përgjithësisht të njohura të së drejtës ndërkombëtare dhe nga vullneti i mirë. Zbatimi i tyre është në interes të forcimit të bashkëpunimit të shteteve për të luftuar krimin e organizuar dhe kriminalitetin.

Gjykata Kushtetuese thekson se vendimi i Gjykatës së Lartë, Kolegjet e Bashkuara, në lidhje me nenet 512 dhe 514 nuk është jokushtetues. Ajo [Gjykata e Lartë] me të drejtë arriti në përfundimin se nuk kishte konflikt ndërmjet këtyre dispozitave dhe ndërmjet dispozitave të konventave ndërkombëtare. Dispozitat e brendshme zbatohen në përputhje me interpretimin e bërë nga Kolegjet e Bashkuara [të Gjykatës së Lartë].

(...) Mund të kuptohet (...) se kërkesa për njohje të një vendimi të një gjykate të huaj mund të bëhet dhe në mungesë të një marrëveshjeje mbi bazën e vullnetit të mirë, normat e njohura gjerësisht dhe parimit të reciprocitetit."

D. Trajtimi mjekësor

139. Më 24 shtator 2003, 13 janar 2004 dhe 16 shkurt 2004, duke marrë shkas nga përkeqësimi i shëndetit të ankuesit, përfaqësuesi i tij ligjor dhe babai i tij i kërkuan Ministrisë së Drejtësisë dhe autoriteteve të burgut ta lejonin atë të vizitohej nga mjekët e duhur.

140. Nga data 23 gusht 2004 deri më 31 gusht 2004 ankuesi iu nënshtrua trajtimit dhe ekzaminimeve në spitalin e burgut të Tiranës. Gjatë kësaj periudhe atij u bë një skaner me rezonancë magnetike (MRI). Ai u diagnostikua se vuante nga multi skleroza (MS). Mjekët raportuan se, dhe kur sëmundja zbulohet dhe trajtohet menjëherë, ajo ishte në gjendje të shkaktonte gjendje shoku, dëmtim organesh, paaftësi të përhershme ose vdekje.

141. Më 29 shtator 2004 u krye një skaner i dytë me rezonancë magnetike (MRI).

142. Më 5 tetor 2004 përfaqësuesi ligjor i ankuesit e informoi sekretarinë se gjendja shëndetësore e ankuesit ishte përkeqësuar dhe se, si rrjedhim, nevojitej trajtim i mëtejshëm dhe një vizitë mjekësore e domosdoshme nga specialistë neurologë. Ai depozitoi dy raporte në lidhje me gjendjen shëndetësore të ankuesit, e cila, sipas mjekëve, ishte përkeqësuar.

143. Më 7 janar 2005, burgu i sigurisë së lartë në Tiranë kërkoi autorizim nga prokuroria e Tiranës për ekzaminime mjekësore në spitalin e burgut të Tiranës për ankuesin dhe për tetë bashkëvuajtës të tij të tjerë në burg.

144. Në një datë të paspecifikuar në janar të 2005-ës, zyra e prokurorisë së Tiranës dha miratimin e saj në lidhje me tetë të burgosurit e tjerë, ndërsa nuk pranoi kërkesën në lidhje me ankuesin, duke thënë se nuk ishte organi kompetent për të vendosur për transferimin e tij nga burgu. Ajo caktoi zyrën e Prokurorisë së Përgjithshme si autoritetin përkatës për të vendosur.

145. Më 13 janar 2005 burgu i sigurisë së lartë në Tiranë e përsëriti kërkesën e tij për zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm në lidhje me trajtimin mjekësor të ankuesit, por nuk mori përgjigje. Më 17 janar 2005, burgu i kërkoi Njësisë së Përgjithshme të Burgjeve në Ministrinë e Drejtësisë të caktonte organin kompetent për të vendosur për transferimin e ankuesit për qëllime mjekësore.

146. Më 16 shkurt 2005, ankuesi filloi proceset penale kundër zyrës së prokurorisë së Tiranës, duke u ankuar për neglizhencë të kësaj të fundit për të siguruar kujdesin e tij mjekësor, gjë e cila kishte çuar në përkeqësimin e shëndetit të tij, që përbënte diskriminim krahasuar me ato të burgosur, të cilët ishin lejuar të përfitonin trajtim mjekësor.

147. Më 26 shkurt 2005, ankuesi u transferua në burgun e Peqinit, një burg i sigurisë së lartë, rreth 100 km larg spitalit të burgut të Tiranës dhe u vendos nën regjimin e burgimit të sigurisë së lartë.

148. Nga shkurti i vitit 2005 e në vijim, ankuesit i ishte mohuar mundësia të takohej me avokatët e tij apo të kishte ndonjë kontakt tjetër me ta.

149. Më 15 prill 2005, pas kërkesave të përsëritura nga mjekët e burgut të Peqinit, ankuesi u dërgua në spitalin e burgut të Tiranës për trajtim mjekësor. Pas konsultimeve ndërmjet mjekësh të atij spitali dhe të spitalit civil të Tiranës më 19 prill 2005, u konfirmua diagnoza e ankuesit dhe prej tyre u tha se ishte e domosdoshme për shëndetin e tij që të trajtohej me interferon-beta.

150. Në një letër të datës 23 maj 2005, përfaqësuesi ligjor i ankuesit e informoi sekretarinë se prej prillit të vitit 2005 autoritetet e burgut e kishin pezulluar trajtimin mjekësor të ankuesit, në kundërshtim me opinionet e mjekëve, dhe se ai ishte trajtuar me vitamina dhe me medikamente kundër depresionit.

151. Në një letër të datës 28 qershor 2005, përfaqësuesi ligjor i ankuesit e informoi sekretarinë se pa një vendim gjykate ankuesi ishte vendosur nën një regjim të posaçëm burgu, të parashikuar në seksionin 43 të Aktit të Regjimit të të Burgosurve, që ishte përjashtim nga kushtet për burgim të zakonshëm, të parashikuar në Akt.

152. Më 4 nëntor 2005, pas kërkesave të vazhdueshme të ankuesit, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve e vlerësoi atë dhe raportoi për trajtimin mjekësor që kishte marrë, e gjeti se ai ishte trajtuar kryesisht me medikamente për të kuruar reumatizmën.

153. Në vitin 2005, ankuesi filloi shumë procese penale kundër shefit të spitalit të burgut të Tiranës, duke u ankuar për neglizhencë në dhënien e kujdesit mjekësor për të. Në data të paspecifikuara, zyra e Prokurorit të Përgjithshëm, rrëzoi aplikimin e tij, ndërsa apelet nga ankuesi kundër vendimeve të prokurorit janë ende pezull në gjykatat e brendshme.

154. Nga data 21 deri më 24 shkurt 2006, mjekët konfirmuan se ankuesi vinte nga multi skleroza. Ata raportuan përkeqësim të shëndetit të ankuesit nga mungesa e plotë e trajtimit mjekësor për mbi dy vjet. Të frikësuar për jetën e tij, ata rekomanduan në mënyrë të prerë që ankuesi të merrte trajtimin e duhur mjekësor.

E. Masa të përkohshme të dhëna nga gjykata

155. Në lidhje me kërkesën e ankuesit të datës 3 janar 2008, kryetari i dhomës vendosi, më 10 janar 2008, ta njoftonte qeverinë shqiptare për një masë të përkohshme sipas nenit 39 të rregullores së gjykatës, që thotë: “ankuesi duhet të transferohet menjëherë në një spital civil në mënyrë që të kryhen ekzaminimet e duhura mjekësore mbi situatën e tij, dhe në mënyrë që të marrë trajtimin e nevojshëm për gjendjen e tij.” Kryetari vendosi gjithashtu t’i kërkonte qeverisë të informonte menjëherë gjykatën për çdo vendim për të ritransferuar ankuesin në burgun e sigurisë së Lartë të Peqinit, duke bashkëngjitur çdo certifikatë përkatëse mjekësore që mbështeste ritransferimin e tij.

156. Në pasditen e datës 10 janar 2008, duke qenë se ishte hera e parë që zbatohej një masë e përkohshme në lidhje me Shqipërinë, sekretaria e seksionit të katërt (sekretaria), foli me agjenten e qeverisë në telefon dhe e njoftoi zyrtarisht për përmbajtjen e masës së përkohshme dhe për rëndësinë e përmbushjes së saj. Agjentja e qeverisë u informua se një kopje e njoftimit për aplikimin e nenit 39 do t’i dërgohej më pas me faks.

157. Mjaft përpjekje për të dërguar njoftimin me faks ishin të pasuksesshme në mbrëmjen e datës 10 janar 2008. Në mëngjesin e datës 11 janar 2008, duke pasur parasysh problemet e vazhdueshme me dërgimin me faks, iu dërgua një kopje e skanuar e njoftimit me postë elektronike agjentes së qeverisë, e cila konfirmoi marrjen (nëpërmjet postës elektronike) e njoftimit. Të njëjtin mëngjes, agjentja e qeverisë e informoi gjykatën me anë të një bisede telefonike se ajo kishte kontaktuar në mënyrë urgjente me Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Shëndetësisë, me zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm dhe me institucione të tjera shtetërore në mënyrë që të përmbushej masa e përkohshme e gjykatës. Në parashtrimet e saj me shkrim, qeveria konfirmoi deklaratën e lartpërmendur.

158. Nga 11 janari deri më 22 janar 2008, qeveria nuk dha asnjë informacion në lidhje me informacionin që kishte të bënte me masat e marra për të zbatuar masën e përkohshme të gjykatës të datës 10 janar 2008.

159. Më 23 janar 2008, ankuesi informoi gjykatën se ai ende nuk ishte transferuar.

160. Më 24 janar 2008, letra e ankuesit iu dërgua qeverisë, duke i tërhequr vëmendje për faktin se mosrespektimi i një mase të ndërmjetme mund të çonte në cenimin e nenit 34 të Konventës.

161. Më 25 janar 2008, pas një vendimi të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, ankuesi u transferua në burgun e spitalit të Tiranës me mendimin e çuarjes në spital për kryerjen e ekzaminimeve mjekësore. Të njëjtën ditë ankuesi refuzoi të transferohej në spital dhe hyri në grevë urie. Ai pretendonte se autoritetet duhet t'i ofronin atij trajtimin e duhur në vend të kryerjes së ekzaminimeve mjekësore.

162. Më 28 janar 2008, sekretaria i bëri shumë telefonata përfaqësuesit të ankuesit dhe agjentes së qeverisë. Sekretaria i bëri thirrje ankuesit të përfundonte grevën e urisë dhe të respektonte masën e ndërmjetme të gjykatës për transferimin e tij në spital, ku do të kryhej një ekzaminim mjekësor për gjendjen e tij shëndetësore. Sekretaria u bëri thirrje gjithashtu dhe autoriteteve të respektonin masën e ndërmjetme dhe të mos përdornin asnjë lloj force, siç pretendohej nga ankuesi.

163. Në të njëjtën ditë, ankuesi u transferua në pavijonin e neurologjisë të Qendrës Spitalore Universitare, ku iu kryen ekzaminime të specializuara mjekësore.

164. Më 29 janar 2008, pas një letre të Qendrës Universitare Spitalore (QUT), sipas së cilës prania e ankuesit nuk ishte më e nevojshme, ankuesi u transferua sërish në spitalin e burgut të Tiranës.

165. Më 30 janar 2008, qeveria i dërgoi gjykatës një kopje të dosjes mjekësore pas ekzaminimeve mjekësore të datës 28 janar 2008. Një grup mjekësh kishin arritur në përfundimin se ankuesi vuante nga multi skleroza. Grupi i mjekëve rekomandoi që ankuesi të trajtohej me interferon beta për të stabilizuar shëndetin e tij dhe për të parandaluar zhvillimin e sëmundjes. Mjekët nuk ishin në gjendje të përshkruanin me saktësi zhvillimin e sëmundjes me kalimin e viteve, pasi ankuesi nuk kishte qenë nën kujdesin mjekësor. Ata shprehën mendimin e tyre se shëndeti i ankuesit nuk paraqiste ndonjë urgjencë, dhe, në këto rrethana, pacientët në përgjithësi trajtoheshin jashtë, pa qenë nevoja të shtroheshin në spital.

166. Më 14 korrik 2008, qeveria konfirmoi se trajtimi i ankuesit me interferon beta kishte filluar më 17 qershor 2008 në përputhje me përfundimet e konsultës së mjekëve. Ky trajtim administrohej çdo ditë dhe dukej se shëndeti i ankuesit që prej asaj kohe ishte i

qëndrueshëm.

167. Më 16 shtator 2008, kryetari i dhomës vendosi të rrëzonte kërkesën e ankuesit për rizbatimin e nenit 39. Gjithsesi, qeverisë iu kërkua "ta informonte gjykatën rregullisht për gjendjen shëndetësore të ankuesit dhe t'i dërgonte asaj prova mjekësore për gjendjen e ankuesit, duke pasur parasysh se kushtet shëndetësore të ankuesit mund të bënin të nevojshme ndihmë të specializuar mjekësore ndërkohë që ai ishte në burg."

168. Më 12 mars 2009, qeveria e informoi gjykatën se ankuesi ishte pajisur rregullisht me interferon beta dhe me medikamente të tjera të përshtatshme për shëndetin e tij.

II. LEGJISLACIONI I BRENDSHËM PËRKATËS

A. Kushtetuta

169. Neni 4 §§ 1 dhe 2 i Kushtetutës parashikon se e drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit dhe se Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë.

170. Neni 5 i Kushtetutës parashikon se Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të.

B. Kodi i Procedurës Penale

171. Pjesët përkatëse të Kodit të Procedurës Penale (KPP) që ishin në fuqi në atë kohë, parashikonin si më poshtë:

1. Neni 13 § 2

172. Neni 13 § 2, pika (ç) i KPP-së, i ndryshuar nga seksioni 1 i ligjit nr. 8813, datë 13 qershor 2002 (në fuqi që prej 11 qershorit 2002), parashikon se "... gjykatat e rrethit mblidhen me formacion me një gjyqtar të vetëm në rastet e bashkëpunimit me autoritetet e huaja...".

2. Nenet 432 dhe 448

173. Neni 432 parashikon se rekurs në Gjykatën e Lartë bëhet për: a) mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit penal; b) për shkelje që kanë si pasojë pavlefshmërinë absolute të vendimit të gjykatës, sipas nenit 128 të KPP-së; c) për shkelje procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit.

174. Neni 448 § 2 parashikon se vendimi i gjykatës së rigjykimit mund të ankimohet vetëm për shkaqet që nuk lidhen me pikat e vendosura nga Gjykata e Lartë.

3. Neni 512

175. Neni 512, për njohjen në Shqipëri të vendimeve të huaja, parashikon se Ministria e Drejtësisë, kur informohet për një vendim të dhënë nga një autoritet i huaj në lidhje me qytetarë shqiptarë, i dërgon zyrës së prokurorisë një kopje të vendimit dhe dokumentet e tjera përkatëse. Ministria e Drejtësisë kërkon njohjen e një vendimi penal të huaj edhe kur çmon se në bazë të një marrëveshjeje ndërkombëtare ky vendim duhet të ekzekutohet ose t'i njihen efekte të tjera në shtetin shqiptar.

4. Neni 514

176. Neni 514 i Kodit të Procedurës Penale, para se të ndryshohej me ligjin nr. 8813 të datës 13 qershor 2002, parashikonte se vendimi i gjykatës së huaj nuk mund të njihej kur:

a) vendimi nuk ka marrë formë të prerë sipas ligjeve të shtetit ku është dhënë; b) vendimi përmban dispozita në kundërshtim me parimet e rendit juridik të shtetit shqiptar; c) vendimi nuk është dhënë nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme ose i pandehuri nuk është thirrur të paraqitet në gjykim ose nuk i është njohur e drejta që të pyetet në një gjuhë që e

kupton dhe të ndihmohet nga një mbrojtës; ç) ka arsye të bazuara për të menduar se kanë ndikuar në përfundimin e procesit çështje lidhur me racën, fenë, seksin, gjuhën apo bindjet politike; d) fakti për të cilin është dhënë vendimi nuk parashikohet si vepër penale nga ligji shqiptar; dh) për të njëjtin fakt dhe ndaj të njëjtit person, në shtetin shqiptar është dhënë një vendim i formës së prerë ose zhvillohet një procedim penal ose e) personi i dënuar ose përfaqësuesi i tij nuk e kanë dhënë pëlqimin e tyre.

177. Seksioni 64 i ligjit nr. 8813, datë 13 qershor 2002 (në fuqi që prej 11 qershorit 2002) parashikon: "Neni 514 § 1, pika e) e KPP-së shfuqizohet."

C. Kodi Penal, ndryshuar me ligjin nr. 8204, datë 10 prill 1997, ligji nr. 8279, datë 15 janar 1998 dhe ligji nr. 8733, datë 24 janar 2001

178. Neni 78 i Kodit Penal që ishte në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, në vitin 1997, parashikonte se një person i dënuar për vrasje me paramendim dënohet me pesëmbëdhjetë deri në njëzet vjet heqje lirie, dhe, në rast të rrethanave rënduese, me burgim të përjetshëm ose me vdekje.

179. Duke marrë parasysh rigjallërimin e hakmarrjeve në rajonet veriore dhe verilindore të Shqipërisë, ligji nr. 8733, datë 24 janar 2001, që hyri në fuqi më 13 mars 2001, ndryshoi, *inter alia*, dhe nenin 78 të Kodit Penal duke shtuar një paragraf të ri që rregullon vrasjet për hakmarrje në mënyrë që të ndalohej shkatërrimi i plotë i familjeve. Dispozita e re, në fuqi në kohën kur vendimi italian u konvertua nga gjykatat shqiptare, lexon si më poshtë:

Neni 78

"1. Një person i dënuar për vrasje me paramendim dënohet me pesëmbëdhjetë deri në njëzet e pesë vjet heqje lirie.

2. Një person i dënuar për vrasje me paramendim për shkak të një interesi ose/dhe hakmarrjes dënohet nga njëzet vjet burgim deri me burgim të përjetshëm."

D. Akti për të Drejtat dhe Trajtimin e të Burgosurve (Ligji nr. 8328, datë 16 prill 1998, ndryshuar me ligjin nr. 9888, datë 10 mars 2008 – "Akti i të Drejtave të të Burgosurve")

180. Seksioni 33 i Aktit të të Drejtave të Burgosurve, në fuqi në kohën në fjalë, parashikon se, në mungesë të trajtimit mjekësor në njësinë shëndetësore të spitalit, dhe, kur është e nevojshme, i burgosuri transferohet në një spital burgu ose në një institucion tjetër mjekësor, me urdhër të prokurorit. I burgosura ka të drejtë të ankimojë brenda pesë ditësh në gjykatën e rrethit kundër refuzimit të prokurorit [për ta transferuar atë në spital].

III. MATERIALET NDËRKOMBËTARE PËRKATËSE

A. Konventa Ndërkombëtare për Njohjen Ndërkombëtare të Vendimeve Penale (Seritë e Traktatit Europian (ETS) nr. 70)

181. Konventa ka hyrë në fuqi në Shqipëri më 23 janar të vitit 2004. Ajo u nënshkruan nga Italia me 4 shkurt të vitit 1971, dhe as sot e kësaj dite nuk është ratifikuar. Pra, ajo nuk ishte në fuqi në lidhje me vendin tjetër më 20 maj 2003, kur ankuesi u dënua nga Gjykata e Rrethit të Tiranës. Dispozitat përkatëse të saj parashikojnë si më poshtë:

Neni 3

"1. Një Shtet Kontraktues është kompetent në rastet dhe në kushtet e parashikuara në këtë Konventë për të zbatuar një vendim të dhënë në një tjetër Shtet Kontraktues që është i zbatueshme në këtë shtet.

2. Kjo kompetencë mund të ushtrohet pas një kërkese nga Shteti tjetër Kontraktues."

B. Konventa për Transferimin e Personave të Dënuar (ETS nr. 112) dhe Protokolli Shtesë i saj (ETS nr. 167)

182. Objektivat e Konventës së Transferimit të vitit 1983, duke përfshirë dhe Protokollin e saj Shtesë të vitit 1997, janë që të zhvillohet bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e së drejtës penale dhe të çohen më tej qëllimet e drejtësisë dhe të rehabilitimit shoqëror të personave të dënuar. Preambula e Konventës së Transferimit thotë se objektivat kërkojnë që të huajt, të cilëve u është mohuar liria si rezultat i kryerjes së një vepre penale prej tyre, duhet t'u jepet e drejta të vuajnë dënimin e tyre brenda shoqërisë së tyre. Dispozitat e saj, të lidhura me çështjen, parashikojnë si më poshtë:

Neni 1

Përkufizime

"Në kuptimin e kësaj Konvente:

(...)

c."Shteti dënues" është shtetit në të cilin është marrë vendimi për personin që mund të transferohet ose është transferuar;

d."Shteti administrues" është shteti tek i cili personi i dënuar mund të transferohet ose është transferuar në mënyrë që të vuajë dënimin".

Neni 3

Kushtet e transferimit

"1. Një person i dënuar mund të transferohet sipas kësaj Konvente, vetëm në kushtet e mëposhtme:

nëse ky person është nënshtetas i shtetit administrues;

(...)"

183. Konventa e Transferimit ka hyrë në fuqi në Shqipëri më 1 gusht 2000, dhe në Itali më 1 tetor 1989. Protokolli i saj Shtesë nuk është ratifikuar as sot e kësaj dite nga asnjë nga shtetet.

C. Raportet e Komitetit Europian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit ose Dënimit Çnjerëzor ose Degradues ("CPT-ja")

184. CPT-ja ka vizituar Shqipërinë në vitin 2005, 2006 dhe 2008. Në 2005-ën, delegacioni vizitoi, inter alia, dhe spitalin e burgut të Tiranës.

1. Gjetjet përkatëse të raportit të 2005-ës (të bëra publike në 12 korrik 2006)

185. Në këtë raport (CPT/Inf (2006) 24) CPT-ja identifikoi se ambientet e kujdesit shëndetësor, "ishin të një cilësie shumë të varfër në të gjitha qendrat e vizituara. Për shembull, kudo mungonte dhe një pajisje bazë, si peshoret. Megjithëse është e panevojshme të thuhet, një gjendje e tillë pune pengon edhe kontrollin e përshtatshëm të ushqimit të ofruar në burg, dhe mbikëqyrjen e grevave të urisë që ndodhnin herë pas here. Është gjithashtu shqetësuese që në dhomën e kirurgjisë dentare në burgun e Tiranës-Vaqarr, nuk kishte ujë. Më tej, si në burgun e Tepelenës dhe në burgun 313 të Tiranës, gjendja e pastërtisë dhe e higjienës në dhomat e konsultimit të mjekëve linte shumë për të dëshiruar."

186. CPT-ja vë re më tej "disa mangësi serioze në lidhje me kontrollin mjekësor në pranim të të burgosurve në burgjet e vizituara (në veçanti, ekzaminime që nuk kryheshin në

mënyrë sistematike ose që kryheshin vetëm sa për të kaluar radhën).” Ajo shpreh gjithashtu shqetësimin e saj se “personat e ardhur rishtazi në pritje të dënimit, nuk kontrolloheshin në mënyrë sistematike për sëmundje të transmetueshme (të tilla si hepatiti B dhe C, HIV, sifilizi dhe turbekulozi), dhe se të burgosurve nuk u jepej asnjë informacion në lidhje me parandalimin e këtyre sëmundjeve”.

187. CPT-ja vuri re se në burgjet nr. 302 dhe 313 disa nga dosjet mjekësore nuk ekzistonin. Dhe kur “gjendeshin”, dosjet nuk përmbanin asgjë përveç emrave të të dënuarve përkatës.

188. Në lidhje me trajtimin e pacientëve me kushte serioze mjekësore, CPT-ja vuri re një numër rastesh individuale që ilustronin mangësi alarmante në disa prej qendrave të vizituara. Fragmentet përkatëse deklarojnë:

“Në burgun e Tepelenës dhe të Tiranës, në Vaqarr, delegacioni u takua me dy të burgosur, të cilët, si rezultat i gjendjes së tyre shëndetësore (njëri me psikozë të rëndë dhe tjetri në gjendje të avancuar kanceri), kishin nevojë urgjente për trajtim të specializuar në ambiente spitalore. Gjithsesi, nuk ishte marrë asnjë iniciativë për t’i transferuar të burgosurit në spitalin përkatës të burgut. Gjatë bisedave në fund të vizitës, delegacioni u kërkoi autoriteteve shqiptare të merrnin masa urgjente në lidhje me këto dy raste. Në letrën e tyre të datës 14 korrik 2005, autoritetet shqiptare konfirmuan se të dy të burgosurit ishin transferuar në spitalin e burgut.

Në burgun e Vaqarrit në Tiranë, delegacioni u takua me një të burgosur që vuante nga diabeti, i cili nuk merrte një dietë të veçantë. CPT-ja duhet të theksojë se një nivel i tillë pune çon në mohimin e trajtimit. Më tej, në rastin e një të burgosuri tjetër në Vaqarr, Tiranë, i cili vuante nga tuberkulozi, delegacioni vuri re se kishte pasur një vonesë të konsiderueshme në transferimin e të burgosurit përkatës në spitalin e burgut. Më tej, gjatë transferimit të tij në spital nuk ishte marrë asnjë masë mbrojtëse në mënyrë që të shmangej infektimi i të burgosurve ose i të dënuarve të tjerë nga sëmundja.”

189. CPT-ja u rekomandoi autoriteteve shqiptare të rishikonin dispozitat e kujdesit shëndetësor në qendrat e vizituara prej tyre.

2. Gjetjet përkatëse në raportin e 2006-ës (të bëra publike më 6 shtator 2007)

190. Në këtë raport (CPT/Inf (2007) 35) të CPT-së u theksua mosrespektimi nga ana e autoriteteve vendore i rekomandimeve të tyre, në veçanti në lidhje me ekzaminimet mjekësore në pranimet në qendrat e paraburgimit.

191. CPT-ja vuri re se “nuk janë bërë përmirësime në lidhje me dispozitën e përgjithshme të kujdesit shëndetësor në asnjë nga ambientet e vizituara, pavarësisht nga rekomandimet e ndryshme të bëra nga CPT-ja në raportet e saj pas vizitave të 2003-it dhe të 2005-ës”.

192. Në lidhje me një ndër ambientet e paraburgimit të vizituar nga CPT-ja, ajo vuri re se “kushtet në ambientet e kujdesit shëndetësor ishin alarmante. Delegacioni dëgjoi shumë ankesa nga të burgosurit rreth vonesave për t’u vizituar nga doktori dhe rreth cilësisë së kujdesit shëndetësor të ofruar; vetë delegacioni, qe dëshmitar i një të burgosuri që kishte nevojë për ndihmë mjekësore urgjente i cili ishte lënë në një gjendje neglizhence të plotë”.

193. CPT-ja ngriti çështjen e vonesave të gjata të vëna re në transferimin e të burgosurve që kishin nevojë urgjente të shtroheshin në spital. “Vizita e vitit 2006 demonstroi

se ky problem nuk ishte zgjidhur ende. Delegacioni u informua se spitalet e përgjithshme ngurronin të pranonin të dënuar në qendrat e paraburgimit për shkak të arsyeve të sigurisë, ndërsa transferimi në spitalin e burgut të Tiranës raportohej si i vështirë pasi spitali i burgut është nën kompetencën e Ministrisë së Drejtësisë".

Gjetjet përkatëse në raportin e 2008-ës (të bëra publike më 21 janar 2009)

194. Në këtë raport (CPT/Inf (2009) 6) CPT-ja evidenton se ofrimi i kujdesit të përgjithshëm shëndetësor në tërësi duket i përshtatshëm në pjesën më të madhe të qendrave të vizituara, pavarësisht nga situatat që çonin në shqetësime të caktuara. Ai vuri re dhe disa përmirësime në lidhje me ekzaminimet shëndetësore në pranim, megjithëse kjo "mbetet një fushë veçanërisht problematike në sistemin e burgjeve në Shqipëri".

195. CPT-ja deklaroi se kishte pasur mangësi në ofrimin e kujdesit të specializuar shëndetësor, në veçanti në ofrimin e kujdesit dentar dhe të kujdesit psikiatrik.

LIGJI

I. CENIM I PRETENDUAR i nenit 3 TË KONVENTËS

196. Ankuesi u ankua për mungesë të trajtimit të duhur mjekësor në burg që çon në keqtrajtim, në kundërshtim me nenin 3 të Konventës, i cili parashikon si më poshtë:

"Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose degraduese."

A. Pranueshmëria

197. Qeveria e kontestoi argumentin e ankuesit. Ajo parashtroi se ankuesi kishte marrë të gjithë trajtimin e nevojshme në spitalin e burgut dhe u ishte nënshtruar disa ekzaminimeve mjekësore. Gjithsesi, ajo tha se përderisa ankuesi nuk e ka ngritur çështjen në gjykatën e brendshme kompetente, në përputhje me Aktin e të Drejtave të të Burgosurve, ankesa e tij në lidhje me nenin 3 ishte e papranueshme për mos shterim të burimeve të brendshme.

198. Ankuesi vijoi me pretendimet e tij. Ai parashtroi se ndihma mjekësore e marrë në spitalin e burgut ishte e papërshtatshme. Autoritetet ishin plotësisht të ndërgjegjshme për sëmundjet e tij (shih paragrafët 143 dhe 149 më lart). Babai i tij kishte pyetur për shëndetin e të birit në disa raste. Por, të gjitha përgjigjet e marra nga administrata e burgjeve kishin qenë të një natyre të përgjithshme dhe nuk kishin përfshirë asnjë informacion të detajuar në lidhje me trajtimin e marrë prej tij. Ankuesi theksoi në veçanti faktin se autoritetet e burgjeve e kishin trajtuar atë me medikamente jo të duhura, duke i shkaktuar atij dhimbje dhe duke e përkeqësuar gjendjen e tij shëndetësore. Së fundmi, ankuesi pretendoi se qeveria kishte dështuar në të provuarin e përshtatshmërisë së masave që kërkoheshin të merreshin, pasi të gjitha ankesat e tij kundër mjekëve të spitalit të burgut ishin rrëzuar nga prokurori si të pabaza.

199. Gjykata përsërit se rregulli i shterimit të mjeteve të brendshme juridike i detyron ata që kërkojnë të ngrenë çështjen e tyre kundër një shteti në një organ ndërkombëtar gjyqësor ose arbitrazhi të përdorin së pari mjetet e parashikuara nga sistemi ligjor kombëtar. Rregulli bazohet në supozimin se ka mjete efektive të disponueshme në lidhje me shkeljen e pretenduar në sistemin e brendshme, pavarësisht nëse dispozitat e Konventës janë ose jo të inkorporuara në të drejtën e brendshme. Në këtë mënyrë, ky është një aspekt i rëndësishëm i parimit që makineria e mbrojtjes e parashikuar në Konventë është plotësuese për sistemet

kombëtare që ruajnë të drejtat e njeriut (shih Handyside k. Mbretërisë së Bashkuar, 7 dhjetor 1976, § 48, Seritë A nr. 24). Në të njëjtën kohë, është detyrim i qeverisë të ofrojë një mjet efektiv të disponueshëm në teori dhe në praktikë për gjykatën në kohën në fjalë, pra një mjet që ishte i akesuseshëm, i aftë për të trajtuar pretendimet e ankuesit dhe që ofron mundësi të arsyeshme suksesi (shih Selmouni k. Francës [GC], nr. 25803/94, § 76, ECHR 1999-V, dhe Mifsud k. Francës (vend.), nr. 57220/00, § 15, ECHR 2002-VIII).

200. Gjykata vëren se ankuesi ka depozituar shumë ankesa tek autoritetet përgjegjëse, duke i sjellë shqetësimet e tij në vëmendje të autoriteteve kombëtare në një kohë që pritej në mënyrë të arsyeshme që ata të kishin marrë masat e nevojshme. Përshkrimi i problemeve shëndetësore nga ankuesi në ankesat e tij ishte i detajuar dhe koherent. Autoritetet kishin një dosje të historisë së tij mjekësore dhe ishin të informuara për rekomandimet e bëra nga mjekët civilë në lidhje me trajtimin mjekësor të nevojitur. Gjithsesi, ankesat u rrëzuan të gjitha nga prokurori, si të pabazuara.

201. Gjykata vë re se qeveria ka dështuar në të provuarin se mjetet e ofruara do të kishin qenë praktikisht efektive. Ajo nuk dorëzoi asnjë vendim të asnjë gjykatë të brendshme për të mbështetur pozicionin e saj. Nuk ka prova se një mjet i tillë do të kishte qenë i aftë të trajtonte pretendimin e ankuesit dhe të ofronte perspektiva të suksesshme suksesi. Si rezultat, gjykata rrëzon kundërshtimin e qeverisë.

202. Duke pasur parasysh konsideratat e sipërpërmendura, gjykata është e mendimit se kjo ankesë nuk është shprehimisht e pabazuar në kuptimin e nenit 35 § 3 të Konventës. Gjykata vë re më tej, se ajo nuk është e papranueshme për asnjë arsye tjetër. Si rezultat, ankesa duhet të deklarohet e pranueshme.

B. Themeli i çështjes

1. Parashtrimet e palëve

203. Ankuesi pretendon se autoritetet nuk i kanë dhënë trajtimin mjekësor të kërkuar prej tij, sipas mendimit dhe recetave të mjekëve civilë, duke çuar në keqtrajtim. Ai u bazua në raportet mjekësore për gjendjen e tij shëndetësore, dhe në veçanti në raportet mjekësore të datës 19 prill 2005 dhe 12 dhjetor 2006, që theksojnë mungesën e trajtimit mjekësor të marrë nga ankuesi për një periudhë të zgjatur kohore dhe ndikimet e kësaj gjëje mbi përkeqësimin e shëndetit të tij.

204. Qeveria insistoi se ankuesi kishte marrë trajtimin e saktë dhe të duhur mjekësor. Në parashtrimet e saj, tregohet se nga koha e arrestimit në vitin 2001 e në vijim se ankuesi kishte marrë trajtim spitalor në spitalin e burgut të Tiranës nëntë herë, ku i ishte ofruar trajtimi dhe ekzaminimet e duhura mjekësore. Qeveria përfundoi se pretendimi i ankuesit sipas nenit 3 ishte i pabazuar.

205. Pas njoftimit të Gjykatës për masë të përkohshme sipas nenit 39 të rregullores së gjykatës, qeveria parashtroi se dhënia e interferon beta për ankuesin kishte një kosto shumë të lartë për administratën e burgjeve. Por, gjithsesi, Qeveria pranoi se ky mjekim është i disponueshëm pa pagesë për publikun e përgjithshëm në spitale.

2. Vlerësimi i gjykatës

206. Gjykata vë re se palët paraqitën të dhëna të ndryshme në lidhje me ndihmën mjekësore të marrë nga ankuesi në burg. Si rrjedhim, gjykata do të fillojë ekzaminimin e saj për pretendimet e ankuesit në lidhje me nenin 3 me kërkimin e fakteve përkatëse.

a) Përcaktimi i fakteve

207. Në çështjen në fjalë, ankuesi pretendon se ai nuk ka marrë trajtimin ose ekzaminimin e duhur mjekësor, në përputhje me gjendjen e tij, ndërkohë që ishte i ndaluar.

208. Nuk diskutohet nga palët që pas arrestimit të tij në vitin 2001 e deri në gusht të 2004-ës ankuesi ka marrë trajtim spitalor në spitalin e burgut për simptoma dhe sindroma të ndryshme. Pavarësisht nga mosha e tij e re, ankuesi vuante, përveç të tjerash, nga vështirësi në lëvizje dhe dhimbje të fortë në ekstremitetet e poshtme, probleme në urinim dhe kapsllëku. Vetëm në gusht të 2004-ës, pas një ekzaminimi të hollësishëm, ankuesi u diagnostikua se vuante nga multiskleroza (shih paragrafin 140 më lart).

209. Nga janari deri në shtator 2005, ankuesi u dërgua në spitalin e burgut për trajtim dhe ekzaminime vetëm në një rast, pavarësisht nga kërkesat e tij të përsëritura. Kështu, më 19 prill 2005, një grup mjekësh e vizituan, konfirmuan diagnozën e multisklerozës dhe i dhanë trajtim të vazhdueshëm me interferon-beta në përputhje me protokollet mjekësore (shih paragrafin 149 më lart).

210. Gjykata vë re, me shqetësim, se gjatë ndalimit të tij nga prilli i vitit 2005 deri më 28 janar 2008, data në të cilën ankuesi i nënshtrohet një ekzaminimi mjekësor si rezultat i marrjes së masës së përkohshme nga gjykata për qeverinë përkatëse, ankuesi ishte lënë për periudha të gjata kohore pa trajtimin e duhur mjekësor. Raporti i fundit mjekësor për gjendjen shëndetësore të ankuesit konfirmoi se zhvillimi i sëmundjes me kalimin e viteve ishte si rezultat i mungesës së kujdesit mjekësor (shih paragrafin 165 më lart).

211. Në të paktën dy raste, babai i ankuesit i ka kërkuar administratës së burgut një kontroll të pavarur mjekësor të shëndetit të ankuesit dhe trajtim të duhur mjekësor për të (shih paragrafin 139 më lart). Gjithsesi, këto kërkesa u refuzuan: siç del nga certifikata mjekësore e dhënë nga qeveria, ekzaminimet mjekësore të mëparshme për ankuesin ishin të munduara vetëm pas miratimit të prokurorit. Është alarmuese që çështja e ekzaminimit mjekësor të ankuesit i është lënë për të vendosur prokurorit, jo mjekëve, nëse ankuesi kishte nevojë për ekzaminime të tjera mjekësore.

212. Në përmbledhje, faktorët e sipërpërmendur duken se mbështesin pretendimet e ankuesit se kujdesi i tij mjekësor në burg ishte i papërshtatshëm. Në rrethana të tilla, i takon qeverisë të kundërshtojë këtë gjetje. Gjithsesi, qeveria nuk ofroi asnjë dokument për të justifikuar arsyet pse autoritetet refuzuan t'i jepnin ankuesit trajtimin mjekësor të dhënë nga mjekët civilë, ose të shpjegojë si trajtimi me vitamina dhe antidepresantë mund të konsiderohet i përshtatshëm (shih paragrafin 150 më lart), (shih, mutatis mutandis, Ostrovar k. Moldavisë, nr. 35207/03, § 86, 13 shtator 2005). Qeveria, thjesht, dhe shumë sipërfaqësisht, pretendon, pa shpjeguar ose pa ofruar argumente të mëtejshme, se ankuesi i është nënshtruar "trajtimit spitalor disa herë në ambientet e spitalit të burgut". Si rezultat, gjykata është e mendimit se qeveria nuk ka dhënë një shpjegim të arsyeshëm për përkeqësimin e shëndetit të ankuesit në burg.

213. Si rezultat, gjykata e pranon versionin e ankuesit për problemet e tij shëndetësore dhe ndihmën mjekësore të marrë gjatë burgimit. Në veçanti, gjykata pranon se nga tetori i vitit 2004 e deri në prill 2005, ankuesit i është refuzuar marrja e ekzaminimit mjekësor dhe trajtimi në spitalin e burgut, dhe se trajtimi mjekësor i dhënë në burg nuk ishte në përputhje me kushtet e tij shëndetësore. Gjatë të gjithë ndalimit të tij nga tetori i vitit 2004 e në vijim,

autoritetet dështuan në monitorimin e sëmundjes së tij dhe ofrimin e trajtimit të duhur mjekësor, gjë që përkeqësuan kushtet e tij shëndetësore. Nga maji i vitit 2005 deri në 28 janar të vitit 2008, ankuesi u konsiderua se nuk kishte nevojë për trajtim mjekësor shtesë, pavarësisht nga raportet e mjekëve civilë për të. Vetëm më 17 qershor 2008 ankuesit iu ofrua trajtimi i nevojshëm, si rezultat i ekzaminimeve mjekësore të 28 janarit 2008.

214. Gjykata tani do të shqyrtojë nëse këto fakte, të marra së bashku me rrethanat përkatëse të çështjes, çojnë në "trajtim çnjerëzor dhe degradues", siç sugjerohet nga ankuesi.

b) Shqyrtimi i ankesës

215. Gjykata thekson se neni 3 i Konventës flet për një ndër vlerat më themelore të një shoqërie demokratike. Ai ndalon në mënyrë absolute torturën ose trajtimin ose dënimin çnjerëzor dhe degradues, pavarësisht nga rrethanat dhe sjellja e viktimës (shih Labita k. Italisë, nr. 26772/95, § 119, ECHR 2000-IV).

216. Gjykata thekson më tej se, sipas jurisprudencës së saj, keqtrajtimi duhet të ketë një nivel minimal ashpërsie për t'u konsideruar se bien në objektin e nenit 3. Vlerësimi i këtij minimumi është relativ; ky minimum varet nga tërësia e rrethanave të çështjes, efektet e saj fizike dhe mendore, dhe, në disa raste, seksi, mosha, gjendja shëndetësore e viktimës (shih, ndërmjet autoriteteve të tjera, Ireland k. Mbretërisë së Madhe, vendim i 18 janarit 1978, Seritë A nr. 25, f. 65, § 162). Megjithëse qëllimi i një trajtimi të tillë është faktor për t'u marrë parasysh, në veçanti pyetja nëse ai kishte si qëllim të poshtëronte ose të degradonte viktimën, mungesa e një qëllimi të tillë nuk të çon në mënyrë të paevitueshme në përfundimin se nuk ka pasur shkelje të nenit 3 (shih Peers k. Greqisë, nr. 28524/95, § 74, ECHR 2001-III).

217. Në raste përjashtimore, kur gjendja shëndetësore e të ndaluarit është absolutisht e papërputhshme me burgimin, neni 3 mund të kërkojë nxjerrjen e një personi të tillë në kushte të caktuara (shih Papon k. Francës (nr. 1) (dec.), nr. 64666/01, ECHR 2001-VI, dhe Priebke k. Italisë (vend.), nr. 48799/99, 5 prill 2001). Ka tre elemente të veçanta që duhen shqyrtuar në lidhje me përputhshmërinë e shëndetit të ankuesit me qëndrimin e tij në burgim: (a) kushtet mjekësore të të burgosurit, (b) përshtatshmëria e ndihmës mjekësore dhe kujdesi i ofruar në burgim; dhe (c) këshillimi i vuajtjes së masës së dënimit në kushtet e gjendjes shëndetësore të ankuesit (shih Mouisel k. Francës, nr. 67263/01, §§ 40-42, ECHR 2002-IX).

218. Gjithsesi, neni 3 nuk mund të interpretohet sikur parashikon një detyrim të përgjithshëm për lirimin e të burgosurve për arsye shëndetësore. Ai, në fakt i vendos detyrimin shtetit të mbrojë mirëqenien fizike të personave të cilëve u është mohuar liria. Gjykata e pranon se ndihma mjekësore e disponueshme në spitalet e burgut jo gjithmonë mund të jetë në të njëjtin nivel si ndihma e ofruar në institucionet më të mira mjekësore për publikun e gjerë. Gjithsesi, shteti duhet të sigurojë se ruhen siç duhet shëndeti dhe mirëqenia e të burgosurve nëpërmjet, ndër të tjerash, ofrimit të ndihmës së nevojshme mjekësore (shih Kudła k. Polonisë [GC], nr. 30210/96, § 94, ECHR 2000-XI; shih gjithashtu Hurtado k. Zvicrës, vendimi i 28 janarit 1994, Seritë A nr. 280-A, opinion i Komisionit, faqe. 15-16, § 79; dhe Kalashnikov k. Rusisë, nr. 47095/99, §§ 95 dhe 100, ECHR 2002-VI). Në Farbtuhs k. Letonisë (nr. 4672/02, § 56, 2 dhjetor 2004). Gjykata theksoi se nëse autoritetet do të kishin vendosur të çonin dhe të mbanin një person të sëmurë rëndë në burg, ata duhet të tregojnë kujdes të posaçëm për garantimin e kushteve të burgimit që u përkojnë nevojave të veçanta të të burgosurit që vijnë si rezultat i paaftësisë së tij (shih gjithashtu Paladi k. Moldavisë,

nr. 39806/05, § 81, 10 korrik 2007).

219. Gjykata mban parasysh raportet e CPT-së, të cilat, ndonëse nuk përmbajnë informacion që lidhet drejtpërsëdrejti me kushtet aktuale të ndalimit të ankuesit dhe gjendjes së tij shëndetësore, gjithsesi e informojnë gjykatën duke i ofruar një panoramë të plotë të situatës së përgjithshme në burgjet në Shqipëri gjatë periudhës në fjalë (shih, për shembull, I.I. k. Bullgarisë, nr. 44082/98, § 71, 9 qershor 2005).

220. Duke iu kthyer çështjes në fjalë, gjykata vë re se provat nga burimet e ndryshme mjekësore konfirmojnë se ankuesi kishte probleme të shumta mjekësore që kërkonin ndihmë të rregullt mjekësore. Gjithsesi, asgjë nuk sugjeronte se sëmundjet e tij ishin në parim të papërputhshme me burgimin. Burgu kishte një njësi mjekësore, ku ankuesi ishte vizituar në shumë raste, dhe sëmundja e tij prezumohet të mund të ishte trajtuar në atë njësi.

221. Në të njëjtën kohë, gjykata i referohet vëzhgimeve të saj se ankuesi nuk e kishte marrë ndihmën e nevojshme ligjore (shih paragrafët 212 dhe 213 më lart). Edhe ndërsa ishte në spitalin e burgut, ai vuante qartë nga efektet fizike të kushteve të tij mjekësore. Në lidhje me efektet mendore, ai mund të ketë ditur se ishte në rrezik të një emergjence mjekësore në çdo moment, emergjencë me pasoja serioze dhe se nuk kishte ndihmë të kualifikuar mjekësore të disponueshme. Ankuesit jo vetëm që iu refuzua ndihma e nevojshme mjekësore nga autoritetet, por ai u vendos në një regjim të sigurisë së lartë, duke iu mohuar mundësia për të kontaktuar me përfaqësuesin e tij (shih paragrafin 147 dhe 148 më lart). Kjo mund të ketë çuar në një ankth të konsiderueshëm në anën e tij.

222. Gjykata nuk mund të pranojë argumentin e qeverisë se trajtimi i ankuesit me interferon beta do të ngarkonte rëndë Buxhetin e Shtetit. Ndërsa gjykata nuk nënvlerëson vështirësitë financiare të qeverisë, ajo thekson se ky medikament ofrohet pa pagesë për publikun në spitale. Qeveria nuk dha asnjë arsye legjitime për të justifikuar heqjen e së drejtës së ankuesit, ndryshe nga anëtarët e tjerë të publikut, për t'iu përmbushur kostot e medikamenteve të tij plotësisht nga shteti përkatës të.

223. Ankuesi vuante nga një sëmundje shumë e rëndë, nga multiskleroza. Edhe nëse zbulohet dhe trajtohet shpejt, kjo sëmundje është e aftë të shkaktojë paaftësi (njohëse, gjykuese, dhe çrregullime kujtese, probleme në lëvizje, dhimbje, kushte të varfra dhe mosfunksionim të muskujve unazorë) dhe vdekje. Rreziku i sëmundjes, i shoqëruar me mungesën e trajtimit të përshtatshëm mjekësor dhe kohëzgjatja e kohës së burgimit, e intensifikuan frikën e tij. Në këto rrethana, mungesa e ndihmës mjekësore në kohën e duhur, që i shtohet refuzimit të autoriteteve për t'i ofruar atij trajtimin e duhur mjekësor të dhënë nga mjekët civilë, krijuan një ndjenjë kaq të fortë mungese sigurie, e cila, e kombinuar me vuajtjet fizike, çojnë në trajtimin degradues të parashikuar në kuptimin e nenit 3.

224. Si rezultat, ka pasur shkelje të nenit 3 të Konventës në këtë aspekt.

II. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 5 § 1 TË KONVENTËS

225. Ankuesi pretendon se burgimi i tij nga data 30 prill 2001 e në vijim ka qenë i paligjshëm dhe se autoritetet nuk kanë mundur të justifikojnë arrestimin dhe ndalimin pasues të tij sipas ndonjërës nga arsyet specifike të parashikuara në nenin 5 § 1 dhe se kjo ishte pasojë e proceseve arbitrare.

226. Gjykata është e mendimit se pretendimi i ankuesit duhet të shqyrtohet sipas nenit

5 § 1 (a) dhe (c) të Konventës, e cila, në pjesët përkatëse, parashikon:

"1. Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijojnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar

a. kur burgoset ligjërisht, pas një dënimi të dhënë nga një gjykatë kompetente;

c. kur është arrestuar dhe paraburgosur për t'u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent, kur ka arsye të besueshme për të dyshuar se ai ka kryer një vepër penale ose kur ka motive të arsyeshme për të besuar se është e nevojshme që të pengohet të kryejë një vepër penale ose të largohet pas kryerjes së saj;

..."

A. Pranueshmëria

1. Parashtrimet e palëve

227. Qeveria pretendoi se arrestimi dhe ndalimi i ankuesit ishin bërë në përputhje me dispozitat e nenit 5 § 1 të Konventës. Qeveria nuk ka parashtruar asnjë kundërshtim në lidhje me pranueshmërinë e kësaj ankese.

228. Ankuesi kontestoi argumentin e qeverisë.

2. Vlerësimi i gjykatës

229. Gjykata vë re se ankuesi u ndalua fillimisht më 30 prill 2001 me fuqinë e padisë penale që lidhej me përfshirjen e tij të pretenduar në trafikim droge. Del nga kërkesat e palëve se thelbi i vëzhgimeve të tyre ka lidhje me ndalimin e ankuesit që prej 15 majit 2002 për sa i përket proceseve që kanë të bëjnë me njohjen dhe me zbatimin e gjykimit të Gjykatës Italiane.

230. Mbi këtë kuptim, gjykata do të shqyrtojë ligjshmërinë e ndalimit të ankuesit nga data 15 maj 2002. Gjykata është e mendimit se datë përfundimtare do të jetë 29 dhjetori 2003, data në të cilën ankuesi ishte dënuar për trafikim droge në grupin e parë të proceseve. Pas asaj date, kishte një bazë ligjore për ndalimin e tij sipas nenit 5 § 1 (a) të Konventës.

231. Për më tepër, Gjykata është e përgatitur të trajtojë ndalimin e ankuesit që prej 15 maj të 2002-it sikur të bjerë nën objektin e nenit 5 § 1 (a) të Konventës. Për gjykatën, në lidhje me proceset që lidhen me njohjen e vlefshmërisë dhe zbatimit të vendimeve të lëshuara nga një gjykatë e huaj, prezumimi është që ndalimi i një individi është "ndalimi i ligjshëm ... pas dënimit nga një gjykatë kompetente".

232. Gjykata është e mendimit se kjo ankesë nuk është shprehimisht e keqbazuar brenda kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës. Ajo vë re më tej se ankesa nuk është e papranueshme mbi asnjë bazë tjetër. Si rezultat, gjykata e deklaron ankesën të pranueshme.

B. Themeli i çështjes

1. Parashtrimet e palëve

233. Qeveria pretendoi se ndalimi i ankuesit është në përputhje me nenin 5 § 1 të Konventës. Ajo parashtroi se më 15 maj 2002, autoritetet kishin urdhëruar ndalimin e tij në burg, pavarësisht nga fakti se ai mbahej në mënyrë strikte në ruajtje mbi bazën e një tjetër grupi procesesh kundër tij. Ndalimi ishte bazuar në dispozitat përkatëse të brendshme, siç interpretohet nga Gjykata e Lartë në vendimin e saj të datës 30 janar 2003. Si rezultat, ajo ka përmbushur gjithashtu dhe kërkesat e nenit 5.

234. Ankuesi i kontestoi argumentet e qeverisë.

235. Për sa i përket referencës së bazës ligjore për ndalimin e tij, ankuesi theksoi se, sipas parashtrimeve të qeverisë, ndalimi ishte bazuar në dispozitat e përgjithshme të

Konventës Europiane mbi Transferimin e Proceseve në Çështjet Penale, megjithëse Konventa nuk ishte ratifikuar nga Shqipëria në kohën në fjalë, ndërsa, sipas vendimeve të gjykatës, ndalimi i tij ishte bazuar në dispozitat e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Si rezultat, asnjë nga dispozitat e lart-përmendura nuk mund të konsiderohet se plotëson kërkesën e "ligjshmërisë" që kërkohet nga neni 5 § 1 i Konventës. Së fundi, ankuesi pretendon se ndalimi i tij ishte i paligjshëm, pasi ai nuk ishte bazuar në asnjë dispozitë ligjore në fuqi në kohën në fjalë dhe ishte pasojë e proceseve arbitrare.

236. Ai iu referua jurisprudencës së Gjykatës dhe në veçanti vendimit në çështjen Bozano (Bozano k. Francës, vendim i datës 18 dhjetor 1986, Seritë A nr. 111, f. 25-26, §§ 58-59).

2. Vlerësimi i gjykatës

(a) Parimet e përgjithshme

237. Neni 5 i Konventës garanton të drejtën themelore të lirisë dhe të sigurisë. Kjo e drejtë ka një rëndësi thelbësore në një "shoqëri demokratike" brenda kuptimit të Konventës (shih De Ëilde, Ooms dhe Versyp k. Belgjikës, vendimi i datës 18 qershor 1971, Seritë A nr. 12, f. 36, § 65 dhe Ëinterëerp k. Holandës, vendimi i datës 24 tetor 1979, Seritë A nr. 33, f. 16, § 37).

238. Të gjithë njerëzit kanë të drejtë të gëzojnë mbrojtjen e kësaj të drejte, çfarëdo të thotë, të mos u mohohet, ose të vazhdohet t'u mohohet, liria e tyre (shih Ëeeks k. Mbretërisë së Madhe, vendim i datës 2 mars 1987, Seritë A nr. 114, f. 22, § 40), dhe në përputhje me kushtet e specifikuara në paragrafin 1 të nenit 5. Lista e përjashtimeve të parashikuara në nenin 5 § 1 është shteruese (shih Labita k. Italisë [GC], nr. 26772/95, § 170, ECHR 2000-IV, dhe Quinn k. Francës, vendim i datës 22 mars 1995, Seritë A nr. 311, f. 17, § 42) dhe vetëm një interpretim i ngushtë i këtyre përjashtimeve është në përputhje me qëllimin e kësaj dispozite, përkatësisht për t'u siguruar se askujt nuk i mohohet në mënyrë arbitrare liria e tij ose e saj (shih Engel dhe të tjerët k. Holandës, vendim i datës 8 qershor 1976, Seritë A nr. 22, f. 25, § 58, dhe Amuur k. Francës, vendim i datës 25 qershor 1996, Reportet 1996-III, f. 848, § 42).

239. Gjykata përsëriti se "kur bëhet fjalë për mohim të lirisë, është në veçanti e rëndësishme të plotësohet parimi i përgjithshëm i sigurisë ligjore. Pra, si rezultat, është shumë e rëndësishme që të përcaktohen qartë kushtet e mohimit të lirisë në të drejtën e brendshme dhe që ligji vetë të jetë i parashikueshëm në zbatimin e tij, në mënyrë që ai të plotësojë standardin e "ligjshmërisë' së parashikuar nga Konventa, një standard që kërkon që i gjithë legjislacioni të jetë mjaftueshmërisht i saktë që t'i lejojë personit, - nëse nevojitet, me këshillim përkatës – të parashikojë, deri në një nivel që është i arsyeshëm për rrethanat, pasojat që mund të japë një veprim i caktuar" (shih Baranoëski k. Polonisë, nr. 28358/95, § 52, ECHR 2000-III).

240. Gjykata thekson më tej se autoritetet duhet të plotësojnë gjithashtu dhe kërkesat e parashikuara nga legjislacioni i brendshëm në proceset që lidhen me ndalimin (shih Van der Leer k. Holandës, vendimi i datës 21 shkurt 1990, Seritë A nr. 170-A, §§ 23-24; Ëassink k. Holandës, vendimi i 27 shtatorit 1990, Seritë A nr. 185-A, § 27; Erkalo k. Holandës, vendimi i datës 2 shtator 1998, 1998-VI, § 57).

241. Së pari u takon autoriteteve kombëtare, pa dyshim gjykatave, të interpretojnë dhe

të zbatojnë legjislacionin e brendshëm. Gjithsesi, përderisa nën nenin 5 § 1 mospërputhshmëria me të drejtën e brendshme përbën një shkelje të Kushtetutës, del si rezultat, që gjykata të mund, dhe të ushtrojë një kompetencë të caktuar për rishikimin e një përputhshmërie të tillë (shih Benham k. Mbretërisë së Madhe, vendimi i datës 10 qershor 1996, Raportet 1996-III, § 41).

b) Zbatimi i parimeve të përgjithshme në çështjen në fjalë

242. Gjykata vë re se ankuesi u ndalua më 15 maj 2002 në pritje të rezultatit të proceseve të njohjes dhe të zbatimit në Shqipëri të një vendimi të dhënë nga Gjykata e Apelit të Milanos (Milan Assize Court of Appeal).

243. Gjykata duhet të sigurohet nëse kishte një bazë ligjore për ndalimin e ankuesit në setin e dytë të proceseve.

244. Gjykata vë re se në kohën e ndalimit të ankuesit më 15 maj 2002, proceset për njohjen dhe zbatimin e një dënimi të dhënë nga një gjykatë e huaj drejtoheshin nga nenet 512 dhe 514 të Kodit të Procedurës Penale ("KPP"). Sipas këtyre dispozitave, proceset duheshin çuar para gjykatave të rrethit pas një kërkese nga Ministria e Drejtësisë "pasi të ishte njoftuar për zbatimin e një vendimi të huaj në lidhje me një qytetar shqiptar". Për më tepër, vlefshmëria dhe zbatimi i një vendimi të huaj ishin të kushtëzuar, *inter alia*, në pëlqimin e dhënë nga personi në fjalë (neni 514 (e) – shih paragrafin 72 më lart).

245. Gjykata e rrethit dhe gjykata e Apelit, në vendimet e tyre të 20 qershorit 2002 dhe 24 korrikut 2004, gjetën që natyra e domosdoshme e pëlqimit të lartpërmendur nuk i linte asnjë të drejtë gjykatave të zbatonin nenin 512 dhe 514 pa pëlqimin e ankuesit. Këto gjykata ishin të mendimit se çdo rast i mosdhënies së pëlqimit nga ankuesi e bënte vendimin italian të pazbatueshëm në Shqipëri, dhe, si rezultat, nuk kishte bazë ligjore për ndalimin e tij (shih paragrafët 120 dhe 121 më lart).

246. Ndërsa proceset para Gjykatës së Apelit të Tiranës ishin pezull, ligji nr. 8813 i datës 13 qershor 2002 (i cili hyri në fuqi më 11 qershor 2002) i bëri disa ndryshime KPP-së, inter alia, duke shfuqizuar pëlqimin e lartpërmendur të përfshirë në nenin 514 (e). Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm apeloi në Gjykatën e Lartë, duke kërkuar zbatimin e ligjit të ndryshuar rishtazi në çështjen në fjalë. Gjykata e Lartë i jep juridiksion Kolegjeve të Bashkuara, duke e njohur atë si organizëm kompetent për të siguruar unifikimin e jurisprudencës.

247. Në vendimin e saj të 30 janarit 2003, Gjykata e Lartë, Kolegjet e Bashkuara, vendosën të mos merrnin parasysh dispozitat e nenit 514 (e) pa referencë zyrtare në zbatueshmërinë e ligjit të ri. E njëjta qasje u mor dhe nga Gjykata Kushtetuese, në proceset e rigjykimit, që ishte organi kompetent gjyqësor për të vlerësuar përputhshmërinë e dispozitave të brendshme me Kushtetutën, e cila, në vendimin e saj të datës 12 korrik 2004, pranoi arsyetimin e Gjykatës së Lartë (shih paragrafët 137 dhe 138 më lart).

248. Gjykata e Lartë dhe Gjykata Kushtetuese e kufizuan veten në konsiderimin e dispozitës së KPP-së "së vjetër" në nenin 514, si të papërshtatshme dhe u shprehën se mund të parashikohej një bazë ligjore nga normat gjerësisht të njohura të së drejtës ndërkombëtare në përputhje me parimin e vullnetit të mirë dhe të reciprocitetit. Ato iu referuan të dy traktateve, përkatësisht Konventës Europiane për Njohjen Ndërkombëtare të Vendimeve Penale dhe Konventës për Transferimin e Personave të Dënuar dhe Protokollit Shtesë të tij.

249. Gjithsesi, Konventa Europiane për Njohjen Ndërkombëtare të Vendimeve Penale nuk kishte hyrë në fuqi në asnjërin nga vendet në kohën në fjalë (shih paragrafin 90 më lart). As Gjykata e Lartë dhe as Gjykata Kushtetuese nuk sugjeruan se ndonjëra nga konventat ishte në fuqi në Shqipëri.

Në fakt, kërkimi i Gjykatës së Lartë për një bazë ligjore më të përshtatshme për ndalimin e ankuesit, e çoi atë në importimin në dispozitat e së drejtës së brendshme të dispozitave të instrumenteve të së drejtës ndërkombëtare të cilat nuk kishin hyrë ende në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

250. Duke pasur parasysh vendimin e mësipërm, ndalimi i ankuesit nuk u bazua në dispozitat e KPP-së, të ndryshuar nga dispozita e re që shfuqizonte kërkesën për pëlqimin. Në të vërtetë, gjykatat kombëtare në vetvete ishin të pasigurta në lidhje me çështjen se kë version të KPP-së të zbatonin në rastin e ankuesit. Në çdo rast, nëse gjykatat kombëtare do të kishin vendosur për përdorimin e dispozitës së re, kjo do të kishte çuar në vlefshmërinë prapavepruese të ndalimit të ankuesit.

251. Për gjykatën, baza ligjore e gjetur më në fund nga Gjykata e Lartë zor se mund të thuhet se plotëson komponentët cilësorë të kërkesës së "ligjshmërisë" në lidhje me ndalimin e ankuesit dhe konvertimit të dënimit të dhënë nga gjykatat italiane.

252. Si rezultat, nuk mund të thuhet se ankuesi ishte në gjendje të parashikonte, deri në një shkallë që ishte e arsyeshme për rrethanat, se ndalimi i tij që prej 15 majit 2002 dhe konvertimi në Shqipëri i dënimit të dhënë nga gjykatat italiane, ishte në përputhje me një procedurë të parashikuar nga e drejta e brendshme.

253. Si rezultat, ka pasur shkelje të nenit 5 § 1 të Konventës.

III. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

254. Ankuesi pretendon paligjshmërinë e proceseve që lidhen me njohjen dhe zbatimin në Shqipëri të dënimit me burgim të dhënë nga gjykatat italiane. Ai u bazuar në nenin 6 § 1 të Konventës, i cili parashikon si më poshtë:

"Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet … brenda një kohe të arsyeshme nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj..."

255. Gjykata vlerëson se kjo ankesë nuk është shprehimisht e pabazuar brenda kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës. Si rezultat, ajo duhet të deklarohet e pranueshme. Gjithsesi, duke pasur parasysh gjetjet e mësipërme, sipas nenit 5 § 1, Gjykata mendon se ajo nuk duhet të shqyrtojë veçmas nëse faktet çojnë në shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

IV. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 7 § 1 TË KONVENTËS

256. Ankuesi u ankua më tej se gjykatat e brendshme, duke mos zbatuar një dispozitë më të lehtësuar, të prezantuar menjëherë për veprën në fjalë dhe duke parashikuar një kohë më pak të rëndë burgimi, kanë shkelur dispozitat e nenit 7 të Konventës, e cila në pjesët përkatëse parashikon si më poshtë:

"1. Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose një mosveprim, që në momentin kur është kryer nuk përbënte vepër penale, sipas të drejtës së brendshme ose ndërkombëtare. Po ashtu, nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ishte i zbatueshëm në momentin kur është kryer vepra penale."

257. Qeveria e kundërshtoi këtë argument, duke thënë se kjo dispozitë nuk ishte e

aplikueshme në rrethanat e çështjes.

258. Sipas jurisprudencës së gjykatës, neni 7 i Konventës përqafon në përgjithësi parimin se vetëm ligji mund të përkufizojë një krim dhe të parashikojë një dënim (nullum crimen, nulla poena sine lege) dhe ndalon në veçanti zbatimin prapaveprues të ligjit penal, kur kjo gjë është në dëm të të akuzuarit (shih Kokkinakis k. Greqisë, vendimi i datës 25 maj 1993, Seritë A nr. 260-A, f. 22, § 52).

259. Duke iu kthyer çështjes në fjalë, Gjykata vë re se gjykatat shqiptare zbatuan dënimin me burgim të përjetshëm për ankuesin, siç parashikohet nga ligji në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, pavarësisht nga fakti se, dënimi i zbatueshëm për të njëjtën vepër penale në kohën e dënimit nga gjykatat shqiptare ishte shumë më i favorshëm për të.

260. Gjykata thekson se rregulli i shterimit të mjeteve të brendshme të cilave iu referua neni 35 i Konventës i detyron ata që kërkojnë ta çojnë çështjen kundër shtetit para gjykatës të përdorin së pari mjetet e parashikuara nga sistemi i brendshëm ligjor (shih Handyside k. Mbretërisë së Madhe, 7 dhjetor 1976, § 48, Seritë A nr. 24). Ankesat duhet të ishin bërë në organin përkatës të brendshëm, të paktën në thelb dhe në përputhje me kërkesat zyrtare dhe afatet kohore të parashikuara në të drejtën e brendshme, dhe, më tej, duhet të ishte përdorur çdo mjet procedural që mund të parandalojë shkeljen e Konventës (shih Cardot k. Francës, 19 mars 1991, § 34, Seritë A nr. 200).

261. Në rastin në fjalë, Gjykata vë re se ankuesi nuk ngriti ndonjë ankesë rreth dënimit të zbatueshëm penal në apelet e tij në Gjykatën e Apelit, Gjykatën e Lartë ose Gjykatën Kushtetuese. Është për këtë arsye që asnjëra nga gjykatat më të larta nuk e shqyrtoi një ankesë të tillë.

262. Gjykata përfundon se ankuesi ka dështuar në shterimin e mjeteve të brendshme juridike, siç parashikohen në sistemin e brendshëm ligjor. Ajo, si rezultat, e rrëzon këtë ankesë, në përputhje me nenin 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

V. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 34 TË KONVENTËS

263. Sipas ankuesit, transferimi i vonuar për në spital, pavarësisht nga masa e përkohshme që iu vu qeverisë sipas nenit 39 të Rregullores së Gjykatës, ka cenuar të drejtat e tij, të parashikuara në nenin 34 të Konventës.

264. Neni 34 i Konventës parashikon si më poshtë:

“Gjykata mund të marrë kërkesat nga çdo person, organizatë joqeveritare ose grup individësh që pretendojnë të jenë viktima të një shkeljeje nga një prej Palëve të Larta Kontraktuese të të drejtave të parashtruara në Konventë ose protokolleve të saj. Palët e Larta Kontraktuese zotohen të mos pengojnë në ndonjë mënyrë ushtrimin efektiv të kësaj të drejte.”

265. Neni 39 i rregullores së Gjykatës thotë:

“1. Dhoma, ose, kur është e nevojshme, Kryetari i saj, me kërkesë të një pale ose të çdo personi tjetër të lidhur, ose me mocionin e saj, i njofton palët për masa paraprake që ajo i mendon se duhet të merren në interesa të palëve ose të kryerjes së duhur të proceseve para saj.

2. Për këto masa njoftohet Komiteti i Ministrave.

3. Dhoma mund të kërkojë informacion nga palët për çdo çështje që lidhet me zbatimit e çdo mase të përkohshme që ka dhënë ajo.”

A. Parashtrimet e palëve

1. Qeveria

266. Qeveria parashtroi se masa e përkohshme e Gjykatës e datës 10 janar 2008 u është nisur menjëherë autoriteteve përgjegjëse shtetërore më 10 janar 2008 (Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Shëndetësisë, zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtorisë së Burgjeve), të cilat shfaqën angazhimin e tyre për të përmbushur vendimin e Gjykatës. Nga data 22 deri më 24 janar 2008, drejtuesit e lartë të autoriteteve përgjegjëse shtetërore bënë disa takime me qëllimin e marrjes së masave të nevojshme për të siguruar transferimin e ankuesit në spital.

267. Qeveria deklaroi se transferimi i ankuesit nga një burg i sigurisë së lartë, si ai i Peqinit, në një spital, ishte një sipërmarrje delikate, e cila bënte të nevojshme marrjen e masave të posaçme të sigurisë për mbrojtjen e jetës së ankuesit dhe të rendit publik në spital.

268. Qeveria theksoi refuzimin e ankuesit për t'u transferuar në spital më 25 janar 2008 me arsyetimin që ai kërkonte trajtim mjekësor me interferon beta, në vend të kryerjes së një ekzaminimi mjekësor. Sipas qeverisë, ankuesi refuzonte të hante atë ditë dhe kërkoi transferimin sërish në burgun e Peqinit. Më tej, qeveria parashtroi se vendimi për të administruar interferon beta duhej të merrej nga një grup mjekësh të specializuar. Nuk ishte mbledhur një grup i tillë mjekësh për të diskutuar çështjen e ankuesit.

269. Gjatë transferimit të tij në spital, qeveria vuri re se ankuesi ishte në gjendje të mirë fizike. Ai komunikonte lirshëm dhe lëvizte pa vështirësi.

2. Ankuesi

270. Ankuesi pretendonte se qeveria kishte dështuar plotësisht në marrjen e masave për zbatimin e masës së përkohshme të dhënë nga Gjykata. Sipas tij, nuk janë dhënë urdhra për ta transferuar atë në një spital.

271. Sipas pikëpamjes së ankuesit, qeveria ka dështuar në depozitimin e dokumenteve mbështetëse që justifikon argumentet e saj në lidhje me rrezikun e mundshëm të jetës së tij apo prishjes së rendit publik në spital si rezultat i transferimit. Ai kundërshtoi gjithashtu dhe mënyrën në të cilën ishin kryer ekzaminimet mjekësore dhe për procedurat e ndjekura. Ankuesi pretendon se nuk i janë bërë disa teste dhe se disa dokumente i ishin hequr nga dosja mjekësore.

B. Vlerësimi i Gjykatës

1. Parimet e Përgjithshme

272. Neni 34 i Konventës u kërkon shteteve anëtare të mos pengojnë në asnjë mënyrë ushtrimin efektiv të së drejtës së ankuesit për të pasur akses në Gjykatë (shih Mamatkulov dhe Askarov k. Turqisë [GC], nr. 46827/99 dhe 46951/99, § 100, ECHR 2005-I).

273. Detyrimi në nenin 34 për të mos ndërhyrë në ushtrimin efektiv të së drejtës së individit për të bërë dhe për të ndjekur një ankesë para Gjykatës i jep individit një të drejtë me natyrë procedurale– që mund të pohohet në proceset e Konventës – të ndryshme nga të drejtat substantive të parashikuara në seksionin I të Konventës dhe të Protokolleve të saj (shih, për shembull, Shamayev e të Tjerë k. Gjeorgjisë dhe Rusisë, nr. 36378/02, § 470, ECHR 2005-III).

274. Në çështjen Mamatkulov dhe Askarov (e cituar më lart, §§ 104, 125 dhe 128), Gjykata vendosi se mospërputhshmëria me një masë të përkohshme e parashkruar në nenin 39 të rregullores së Gjykatës mund të çojë në shkelje të nenit 34 të Konventës.

275. Në Paladi k. Moldavisë ([GC], nr. 39806/05, 10 mars 2009) Gjykata deklaroi:

“87. Gjykata rithekson detyrimin e parashikuar në nenin 34 in fine që u kërkon Shteteve Kontraktuese të tërhiqen jo vetën nga ushtrimin e presionit ndaj ankuesit, por dhe nga çdo veprim ose mosveprim i cili, duke shkatërruar objektin e aplikimit, do ta bënte pa vlerë ose do të shmangte Gjykatën nga shqyrtimi i çështjes në procedurë normale (në të njëjtin vend., § 102). Është e qartë nga qëllimi i këtij neni, që është sigurimi i efektivitetit të së drejtës së individit për të kërkuar (shih paragrafin 86 më lart), se qëllimet ose arsyet që lidhen me veprimet ose mosveprimet në fjalë kanë pak lidhje kur vlerësohet nëse është respektuar neni 34 i Konventës (shih paragrafin 78 më lart). Ajo çfarë është e rëndësishme është nëse situata e krijuar si rezultat i veprimit ose mosveprimit të autoriteteve është në përputhje me nenin 34.

88. E njëjta gjë është e vërtetë në lidhje me përputhshmërinë me masat e përkohshme të parashikuara në nenin 39, pasi masa të tilla jepen nga Gjykata për qëllime të të siguruarit të efektivitetit të së drejtës së kërkesës së individit (shih paragrafin 86 më lart). Pra, neni 34 shkelet nëse autoritetet e një shteti Kontraktues nuk marrin masa të cilat mund të ishin marrë në mënyrë të arsyeshme në mënyrë që të përmbushen masat e dhëna nga Gjykata.

89. Më tej, Gjykata thekson se kur ka arsye të forta për rrezikun e një dëmi të pandreqshëm për gëzimin e njërës nga të drejtat themelore nga ankuesi, sipas Konventës, subjekti i masës së përkohshme është të ruhen dhe të mbrohen të drejtat dhe interesat e palëve në mosmarrëveshje para Gjykatës, në pritje të vendimit përfundimtar. Del nga natyra e masave të përkohshme se vendimi nëse ato duhet të jepen në një çështje të caktuar shpesh bëhet brenda një kohe të shkurtër, me qëllimin e shmangies së ndodhjes së dëmit të mundshëm të përnjëhershëm. Si rezultat, faktet e plota të çështjes shpesh mbeten të papërcaktuara derisa të vendosë Gjykata për themelin e çështjes të ankesës me të cilën lidhet masa. Pikërisht për qëllim të ruajtjes së aftësisë së Gjykatës për të dhënë një vendim të tillë pas një shqyrtimi efektiv të ankesës janë arsye pse jepen masa të tilla. Deri në atë kohë, mund të jetë e pashmangshme për Gjykatën të japë masa të përkohshme mbi bazën e fakteve, të cilat, pavarësisht nga bërja e një çështje *prima facie* në favor të rasteve të tilla, rrjedhimisht i shtohen ose sfidohen deri në pikën sa vënë në pyetje justifikimin e masave.

Për të njëjtat arsye, fakti që dëmi për të cilin masa e përkohshme është projektuar të parandalojë, rrjedhimisht del se nuk ka ndodhur pavarësisht nga paaftësia e shtetit për të vepruar në përputhje të plotë me masën e përkohshme është po aq jo e përshtatshme për të vlerësuar nëse ky shtet i ka plotësuar detyrimet e tij sipas nenit 34.

90. Si rrjedhim, nuk është e hapur për një Shtet Kontraktues të zëvendësojë vendimin e tij me vendimin e Gjykatës në verifikimin nëse ka ekzistues ose jo një rrezik i menjëhershëm dhe një dëm i pandreqshëm për një ankues në kohën kur jepet masa e përkohshme. Po ashtu, nuk u takon as autoriteteve të brendshme të vendosin për kufijtë kohorë për plotësimin e një mase të përkohshme ose për pikën deri në të cilën duhet të përmbushet masa. I takon Gjykatës të verifikojë përputhshmërinë me masën e përkohshme, ndërsa një shtet që mendon se ka materiale të afta për të bindur Gjykatën për të anuluar masën e ndërmjetme, e informojnë Gjykatën për këtë gjë (shih, mutatis mutandis, Olaechea Cahuas k. Spanjës, nr. 24668/03, § 70, ECHR 2006-X; Tanrıkulu k. Turqisë [GC], nr. 23763/94, § 131, ECHR 1999-IV; dhe Orhan k. Turqisë, nr. 25656/94, § 409, 18 qershor 2002).

91. Pika e nisjes për të verifikuar nëse një shtet i akuzuar ka përmbushur masën është

vetë formulimi i vetë masës (shih, *mutatis mutandis*, analizën e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për formulimin e masave të saj të brendshme dhe përputhshmërinë aktuale me të në LaGrand, cituar në paragrafin 62 më lart). Si rezultat, Gjykata shqyrton nëse shteti i akuzuar ka respektuar formulimin dhe frymën e masës së përkohshme që i është dhënë.

92. Në shqyrtimin e ankesës sipas nenit 34 në lidhje me dështimin e pretenduar të një Shteti Kontraktues për të respektuar masën e përkohshme, Gjykata, si rezultat, nuk do ta shqyrtojë nëse vendimi i saj për të zbatuar masa të përkohshme ishte i saktë. I takon qeverisë së akuzuar t'i dëshmojë Gjykatës së është respektuar masa e përkohshme, ose, në raste përjashtimore, se kishte një pengesë objektive që e pengoi qeverinë të merrte të gjitha hapat e arsyeshme të heqë pengesat dhe të mbajë të informuar Gjykatën rreth situatës."

2. Zbatimi i parimeve të sipër-përmendura në çështjen në fjalë

a) A kishte mospërputhshmëri në plotësimin e masës së përkohshme

276. Gjykata vë re se qeveria e akuzuar u informua zyrtarisht për masën e përkohshme të parashikuar nga neni 39 i rregullores së Gjykatës më 10 janar të 2008-ës me anë të një bisede telefonike ndërmjet sekretarit dhe agjentit të qeverisë. Mesazhi u dërgua me anë të postës elektronike në mëngjesin e datës 11 janar 2008, pas disa përpjekjeve të pasuksesshme për ta dërguar atë me faks në mbrëmjen e datës 10 janar 2008 dhe në mëngjesin e datës 11 janar 2008.

277. Përmbajtja e masës së përkohshme përfshinte udhëzime për autoritetet e brendshme për ta transferuar ankuesin në spital për ekzaminime mjekësore dhe trajtimin e duhur. Pavarësisht nga njoftimi për masën e përkohshme jo më vonë se mëngjesin e datës 11 janar 2008, autoritetet vendore e transferuan ankuesin në spital për ekzaminime mjekësore vetëm me datën 28 janar 2008.

278. Del se masa e përkohshme nuk u respektua për një periudhë kohore prej shtatëmbëdhjetë ditësh.

b) Justifikimi për mosplotësimin e masës së përkohshme

279. Gjykata tani do të përcaktojë nëse ka pasur pengesa objektive që e penguan qeverinë të përmbushte masën e përkohshme dhe nëse qeveria mori të gjitha masat e arsyeshme për të hequr pengesat dhe për të mbajtur Gjykatën të informuar rreth situatës (shih Paladi, cituar më lart, § 92.) Gjykata do të marrë parasysh sjelljen e ankuesit dhe kushtet e tij mjekësore në lidhje me veprimet e qeverisë për të përmbushur masën e përkohshme.

280. Qeveria parashtroi se transferimi i ankuesit në spital kërkonte marrjen e masave të sigurisë dhe koordinim ndërmjet institucioneve të ndryshme të brendshme.

281. Gjykata rithekson se masat e përkohshme duhet të respektohen si në rastet e çështjeve emergjente (shih Paladi, të cituar më lart, § 98). Në këtë aspekt, ajo vë re se nuk ka asgjë në dosjen e çështjes që dëshmon se autoritetet vendase ndërmorën ndonjë veprim nga data 11 janar deri në datën 24 janar 2008. Pavarësisht nga argumenti i qeverisë në lidhje me masat e sigurisë që duhet të merren në rast të një transferte të tillë, Gjykata dyshon se ishte e pamundur për autoritetet e brendshme të organizonin takime urgjente menjëherë pas njoftimit të masës së përkohshme për qeverinë e akuzuar. Që kur autoritet kryesore ishin informuar nga agjenti i qeverisë rreth masës së përkohshme të Gjykatës në mëngjesin e datës 11 janar 2008 (shih paragrafin 157 më lart), Gjykata nuk sheh asnjë justifikim për vonesën për të kryer takimet e nevojshme. Ajo vë re me shqetësim se takimet e para janë mbajtur vetëm nga data

22 deri më 24 janar 2008. Për më tepër, qeveria dështoi në mbajtjen e Gjykatës të informuar rreth përputhshmërisë me masën e përkohshme gjatë gjithë kësaj periudhe.

282. Si rezultat, dhe pavarësisht nga urgjenca dhe serioziteti i masës së përkohshme të datës 10 janar 2008, autoritetet e brendshme treguan mungesë angazhimi për të ndihmuar Gjykatën në parandalimin e ndodhjes së dëmeve të paripërueshme. Sjellje të kësaj natyre janë të papërputhshme me detyrat që parashikohen për Shtetet Kontraktuese sipas nenit 34 në lidhje me kapacitetin e tyre për të respektuar masat e përkohshme me shpejtësinë e kërkuar (shih Paladi, cituar më lart, § 97).

283. Në lidhje me sjelljen e ankuesit, Gjykata vlerëson se ai ishte përgjegjës për një vonesë prej maksimumit prej tri ditësh (shih paragrafin 161 më lart). Gjykata e sheh me keqardhje sjelljen e ankuesit në kohën kur masa e përkohshme ishte marrë në mënyrë që të verifikohej niveli i vërtetë i gjendjes së tij. Gjithsesi, ajo nuk e gjen të bazuar asnjë vonesë tjetër për shkak të fajit të tij.

284. Në vëzhgimet e saj, qeveria parashtroi se gjendja e mirë fizike e ankuesit tregoi se nuk kishte asnjë rrezik aq të madh sa ishte menduar më parë.

285. Gjykata thekson se nuk ka shpjegim të pranueshëm për paaftësinë e autoriteteve të brendshme për të marrë veprime të menjëhershme për të respektuar masën e përkohshme. Ajo kujton se dëmi që masa e përkohshme është projektuar të parandalojë del rrjedhimisht se nuk ka ndodhur, pavarësisht nga paaftësia e shtetit për të vepruar në përputhje të plotë me masën e përkohshme, është i pavlerë në vlerësimin nëse Shteti i akuzuar i ka plotësuar detyrimet e tij sipas nenit 34 (shih Paladi, cituar më lart, § 89).

286. Gjykata përfundon se vonesa e autoriteteve të brendshme në përmbushjen e masës së ndërmjetme në fjalë, në mungesë të çdo justifikimi objektiv, përben shkelje të nenit 34 të Konventës.

VI. SHKELJE TË TJERA TË PRETENDUARA TË KONVENTËS

287. Së fundmi, ankuesi pretendon se në deklarimin e apelimit të tij për proceset e rigjykimit si të papranueshme *de plano* më 30 janar 2004, pa dhënë arsye, Gjykata e Lartë ka shkelur nenin 2 të protokollit nr. 7 të Konventës, i cili parashikon:

"1. Çdo person i shpallur fajtor për një vepër penale nga një gjykatë ka të drejtë të paraqesë për shqyrtim përpara një gjykate më të lartë deklarimin e fajësisë ose dënimin. Ushtrimi i kësaj të drejte, duke përfshirë shkaqet për të cilat ajo mund të ushtrohet, përcaktohet me ligj.

2. Nga kjo e drejtë mund të ketë përjashtime për vepra të lehta penale, siç përcaktohen me ligj, ose kur i interesuari ka qenë gjykuar në shkallë të parë nga gjykata më e lartë, ose shpallur fajtor dhe dënuar në vijim të një apeli kundër pafajësisë së tij."

288. Gjykata, në fund, është e mendimit se ankuesi, në thelb po ankohet për paaftësinë e gjykatave të brendshme për të dhënë arsye për vendimin e tyre, një ankesë e shqyrtuar më drejt në nenin § 1 të Konventës sesa në nenin 2 të protokollit nr. 7.

289. Gjykata rithekson se e drejta që i garantohet një ankuesi sipas nenit 6 të Konventës përfshin të drejtën për të pasur arsye për vendimet e dhëna nga një gjykatë e brendshme në çështjen e tij. Gjithsesi, detyrimi korrespondues për një gjykatë të brendshme për të dhënë arsye për vendimet e tij nuk mund të kuptohet se kërkon një përgjigje të detajuar për çdo argument të dhënë nga një ankues. Shkalla në të cilën zbatohet detyra për të dhënë

arsye mund të ndryshojë sipas natyrës së vendimit në fjalë (shih, për shembull, Helle k. Finlandës, vendimi i datës 19 dhjetor 1997, Raportet 1997-VIII, f. 2929, § 56).

290. Gjykata vë re se në këtë aspekt ankuesi apeloi në Gjykatën e Lartë mbi bazën se vendimet e gjykatave më të ulëta ishin të paplota në bazë ligjore. Gjykata është e mendimit se arsyet e kufizuara të dhëna nga Gjykata e Lartë në formulën e vendimit të saj *de plano*, gjithsesi, dëshmojnë në mënyrë të pashprehur se ankuesi nuk kishte përdorur njërën nga pikat e ligjit që bie brenda objektit të lënies së procesit të apelimit. Gjykata vëren se, kur Gjykata e Lartë refuzon të pranojë një çështje me arsyetimin se arsyet ligjore për një çështje të tillë nuk ekzistojnë, një arsyetim shumë i kufizuar mund të plotësojë kërkesat e nenit 6 të Konventës (shih, *mutatis mutandis*, Nerva k. Mbretërisë së Madhe (dhjet.), nr. 42295/98, 11 qershor 2000).

291. Për arsyet e sipërpërmendura, Gjykata është e mendimit se ankesa është shprehimisht e keqbazuar brenda kuptimit të nenit 35 § 3, dhe si rezultat është e papranueshme në përputhje me nenin 35 § 4.

VII. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

292. neni 41 i Konventës parashikon:

"Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj, dhe nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar."

A. Dëmi

293. Ankuesi pretendoi 50 000 euro (EUR) për dëme jomateriale.

294. Qeveria e kundërshtoi pretendimin e ankuesit, por nuk parashtroi asnjë argument të lidhur me shumën e pretenduar prej tij.

295. Gjykata thekson se, në kuadrin e zbatimit të vendimeve në përputhje me nenin 46 të Konventës, një vendim në të cilin identifikohet shkelje, i ngarkon shtetit të akuzuar një detyrim ligjor nën dispozitën e përfundimit të shkeljes dhe të ndreqjes së pasojave në mënyrë të tillë që të ndreqet sa më shumë të jetë e mundur situata që ekzistonte para shkeljes. Nëse, nga ana tjetër, e drejta kombëtare nuk lejon – ose lejon pjesërisht – riparim për pasojat e shkeljes, neni 41 i jep kompetenca Gjykatës t'i japë palës së dëmtuar atë shumë që konsiderohet prej saj si e kënaqshme. Rezulton, *inter alia*, se një vendim në të cilin Gjykata identifikon një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe vendos për shtetin e akuzuar një detyrim ligjor jo vetëm për të paguar palët e lidhura me shumat e kërkuara si mënyra për të realizuar kënaqësinë e drejtë, por dhe të për zgjedhur, në varësi të mbikëqyrjes së Komitetit të Ministrave, masat e përgjithshme, dhe/ose, nëse nevojiten, masat specifike që duhen zbatuar në rendin e brendshëm ligjor për t'i dhënë fund shkeljes së identifikuar nga gjykata dhe për të bërë tërë ndreqjen e nevojshme të pasojave në mënyrë të tillë që të ndreqë aq sa është e mundur situatën e ta kthejë atë në nivelin e situatës që ekzistonte para shkeljes (shih Ilaşcu dhe të Tjerë k. Moldavisë dhe Rusisë [GC], nr. 48787/99, § 487, ECHR 2004-VII; Assanidze k. Gjeorgjisë [GC], nr. 71503/01, § 198, ECHR 2004-II; Maestri k. Italisë [GC], nr. 39748/98, § 47, ECHR 2004-I; Menteş dhe të Tjerët k. Turqisë (Neni 50), vendimi i datës 24 Korrik 1998, Raportet 1998-IV, f. 1695, § 24; dhe Scozzari dhe Giunta k. Italisë [GC], nr. 39221/98 dhe 41963/98, § 249, ECHR 2000-VIII).

296. Gjykata thekson se ka gjetur shkelje të disa dispozitave të Konventës nga shteti i

akuzuar. Ankuesit i është dhënë trajtim i papërshtatshëm mjekësor, në kundërshtim me nenin 5, në lidhje me grupin e dytë të proceseve që lidheshin me njohjen dhe zbatimin në Shqipëri të vendimit të Gjykatës Italiane. Gjykata ka vendosur gjithashtu se është shkelur neni 34 i Konventës.

297. Në lidhje me shkeljen e nenit 5 të Konventës, Gjykata vë re se ankuesi kërkon dëme jomateriale vetëm në lidhje me periudhën nga 15 maji 2002 deri më 29 dhjetor 2003, datë nga e cila burgosja e tij drejtohej nga vendimi i gjykatës së rrethit në lidhje me proceset penale.

298. Gjykata vë re se ankuesi kërkon dëmshpërblim vetëm për dëme jomateriale. Në këtë mënyrë, ajo nuk i jep ankuesit dëmshpërblim për dëme materiale. Në lidhje me dëmin jomaterial të pretenduar, Gjykata është e mendimit se është e arsyeshme të mendohet se ankuesi ka pësuar stres, ankth dhe frustrim, të shkaktuar nga përkeqësimi i gjendjes së tij shëndetësore, që u përkeqësua më tej me burgimin e tij të paligjshëm për më shumë se një vit dhe shtatë muaj. Duke vendosur mbi një bazë të barabartë, Gjykata i jep ankuesit EUR 8 000 në lidhje me dëmtimin jomaterial.

B. Kostot dhe shpenzimet

299. Ankuesi pretendoi edhe 7,550 euro për kostot dhe shpenzimet për marrjen e një vlerësimi mjekësor të specializuar dhe për shpenzimet e Gjykatës. Ai parashtroi një ndarje të detajuar sipas zërave për të mbështetur pretendimet e tij.

300. Qeveria e kontestoi pretendimin e ankuesit pa parashtruar asnjë argument.

301. Sipas jurisprudencës së Gjykatës, ankuesi ka të drejtë të rimbursohet për kostot dhe shpenzimet e tij vetëm për aq kohë që këto shpenzime dëshmohen se janë kryer aktualisht dhe domosdoshmërisht dhe janë të arsyeshme në masë. Në rastin në fjalë, në lidhje me informacionin në dispozicion dhe të kritereve të sipërpërmenduara, Gjykata e mendon të arsyeshme të vendosë t'i japë ankuesit 7 000 euro për të mbuluar kostot sipas zërave.

C. Niveli i interesit

302. Gjykata është e mendimit se është e drejtë që niveli i interesit për mospagimin të bazohet në kufirin marxhinal të nivelit të huasë të Bankës Qendrore Evropiane, mbi të cilën duhet të shtohen tre për qind.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA NË MËNYRË UNANIME:

1. Deklaron ankesat në lidhje me nenin 3 të Konventës, nenin 5 § 1 të Konventës dhe nenin 6 § 1 të Konventës të pranueshme dhe pjesën tjetër të aplikimit të papranueshme;

2. Vendos se ka pasur shkelje të nenit 3 të Konventës në lidhje me trajtim të papërshtatshëm mjekësor për ankuesin gjatë burgimit të tij;

3. Vendos se ka pasur shkelje të nenit 5 § 1 të Konventës në lidhje me ndalimin e ankuesit nga data 15 maj 2002 deri më 29 dhjetor 2003;

4. Vendos se nuk është e nevojshme të shqyrtohet veçmas nëse ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me proceset që kanë të bëjnë me njohjen dhe zbatimin në Shqipëri të një vendimi të marrë nga një vendim i Gjykatës së Apelit të Milanos;

5. Vendos se ka pasur shkelje të nenit 34 të Konventës;

6. Vendos

a) që shteti i akuzuar t'i paguajë ankuesit, brenda tre muajve nga data e daljes së vendimit përfundimtar, në përputhje me nenin 44 § 2 të Konventës, 8,000 euro (tetë mijë

euro) për dëme jo materiale dhe 7,000 euro (shtatë mijë euro) për kosto dhe shpenzime, të konvertuara në monedhën e shtetit të akuzuar, në kursin e këmbimit në datën e pagesës, plus çdo taksë që mund të vihet;

b) që prej skadimit të periudhës prej tre muajsh të përmendur më lart deri në pagim, mbi shumat e mësipërme paguhen interesa të thjeshtë të barabartë me kursin marxhinal të huasë së Bankës Qendrore Europiane gjatë periudhës së mospagimit, plus tre për qind;

7. Rrëzon pjesën tjetër të pretendimit të ankuesit.

Bërë në anglisht dhe e njoftuar me shkrim më 7 korrik 2009, në përputhje me nenin 77 §§ 2 dhe 3 të rregullores së Gjykatës.

Lawrence Early	Nicolas Bratza
Sekretar	Kryetar

ÇËSHTJA "XHERAJ KUNDËR SHQIPËRISË"

(Aplikimi nr.37959/02)

VENDIM
STRASBURG
29 KORRIK 2008
PËRFUNDIMTAR
1.12.2008

Ky vendim do të marrë formë të prerë në rrethanat e parashikuara në nenin 44 § 2 të Konventës. Ai mund t'u nënshtrohet rishikimeve editoriale.

Në çështjen "Xheraj kundër Shqipërisë",

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i katërt), i përbërë nga trupi gjykues:

Lech Garlicki, kryetar,
Ljiljana Mijović,
David Thór Björgvinsson,
Ján Šikuta,
Päivi Hirvelä,
Ledi Bianku,
Mihai Poalelungi, gjyqtarë
dhe Laërence Early, sekretar.

Pas shqyrtimit të çështjes në seancë të mbyllur më 8 korrik 2008,

jep vendimin e mëposhtëm, i cili është miratuar në të njëjtën datë.

PROCEDURA

303. Çështja filloi me depozitimin e aplikimit (nr.37959/02) kundër Republikës së Shqipërisë në Gjykatë, sipas nenit 34 të Konventës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore (Konventa) nga një nënshtetas shqiptar z. Arben Xheraj (ankuesi), më 20 shtator 2002.

304. Ankuesi u përfaqësua nga z. D. Bengasi, avokat që ushtron profesionin në Tiranë. Qeveria Shqiptare (Qeveria) u përfaqësua nga agjentët e saj, z. S. Puto dhe znj. S. Meneri.

305. Ankuesi, në bazë të neneve 6 §§ 1 dhe 3 të Konventës, pretendon se procesi për rishikimin e vendimit për pafajësinë e tij, i cili mori formë përfundimtare, kishte qenë i padrejtë, pasi as ai dhe as avokati i tij nuk ishin informuar për seancat gjyqësore dhe si rezultat, ata nuk kishin qenë në gjendje të mbronin çështjen. Pa dhënë shkaqe, ankuesi pretendon shkelje të nenit 10 të Konventës. Së fundmi ai u ankua për shkelje të parimit të *ne bis in idem*, parashikuar në nenin 4 të protokollit nr.7, pasi në vendimin e saj të datës 20 qershor 2001 Gjykata e Lartë parashikonte një sanksion të dytë për të njëjtën vepër penale, atë të vrasjes.

306. Më 8 shtator 2005, kryetari i seksionit të katërt të Gjykatës vendosi që ta njoftonte Qeverinë për aplikimin. Sipas dispozitave të nenit 29 § 3 të Konventës u vendos që të shqyrtohej themeli i aplikimit në të njëjtën kohë me pranueshmërinë e tij.

307. Si ankuesi, ashtu edhe Qeveria depozituan vëzhgime me shkrim (rregulli 59 § 1).

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

308. Ankuesi ka lindur në vitin 1970 dhe aktualisht po vuan dënimin në burgun e Viçencës në Itali.

A. Proceset që çuan në dënimin e ankuesit

309. Në vitin 1995 zyra e prokurorisë së qytetit të Durrësit e akuzoi ankuesin për vrasje, mbi bazën e provave të babait të viktimës, i cili deklaroi se para se të vdiste viktima i kishte thënë se ankuesi ishte një ndër vrasësit. Hetimi në lidhje me tre të dyshuar të tjerë u ndërpre.

310. Babai i ankuesit, kur u mor në pyetje nga policia, deklaroi se ankuesi kishte udhëtuar për në Itali me dy persona të tjerë ditët kur ishte kryer vrasja.

311. Më 27 nëntor 1996, ankuesi, *in absentia*, u deklarua fajtor për veprën penale të vrasjes, të parashikuar në nenin 76 të Kodit Penal dhe u dënua me 20 vjet heqje lirie nga Gjykata e Apelit të Durrësit. Ankimimi i tij në Gjykatën e Kasacionit të asaj kohe u deklarua i papranueshëm më 10 mars 1997.

B. Proceset që çuan në deklarimin e ankuesit të pafajshëm

312. Pas nënshkrimit të një autorizimi nga babai i ankuesit më 10 dhjetor 1997, sipas nenit 450 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), avokati i ankuesit kërkoi rishikimin gjyqësor të vendimit të gjykatës së apelit me anë të një kërkese që mbante të njëjtën datë. Aplikimi për rishikim gjyqësor arriti në gjykatën e rrethit më 11 dhjetor 1997.

313. Në kërkesën për rishikim gjyqësor deklarohej se kishin dalë prova të reja në favor të ankuesit. Së pari, nga raporti i autopsisë, dilte se viktima ishte qëlluar me thikë në zemër dhe kishte vdekur menjëherë, si rrjedhim, nga pikëpamja shkencore, viktima nuk kishte qenë në gjendje të komunikonte. Së dyti, dy dëshmitarë deklaruan se ata kishin udhëtuar që herët në mëngjes me traget për në Itali në kohën kur kishte ndodhur vrasja.

314. Më 13 dhjetor 1997 ankuesi autorizoi të njëjtin avokat, i cili ishte caktuar nga i ati më 10 dhjetor 1997, për ta përfaqësuar atë në proceset e brendshme gjyqësore.

315. Me anë të një letre të datës 26 gusht 1998 dërguar prokurorit të rrethit, Drejtoria e Hetimit dhe Inspektimit në zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm dërgoi dosjen e çështjes së ankuesit dhe shtoi se:

"kërkesa për rishikimin e vendimit plotëson kriteret ligjore".

Ajo i kërkoi prokurorit të rrethit të shqyrtonte objektivisht provat e reja që do t'i çoheshin gjykatës së rrethit.

316. Prokurori i rrethit, i cili rezultoi të ishte i njëjti person që kishte marrë pjesë në gjykimin e parë, mori pjesë në proces dhe kërkoi rrëzimin e çështjes në përputhje me nenin 328 (dh) të Kodit të Procedurës Penale, i cili thotë që çështja mund të rrëzohet "nëse rezulton se i pandehuri nuk e ka kryer veprën penale ose nëse nuk provohet se ai e ka kryer veprën penale."

317. Më 27 nëntor 1998, Gjykata e Rrethit të Durrësit e deklaroi aplikimin e ankuesit për rishikimin e vendimit të papranueshëm. Gjykata vendosi për themelin e çështjes dhe pas shqyrtimit të provave të reja dhe pas marrjes parasysh të kërkesës së zyrës së prokurorit, rrëzoi vendimin e gjykatës së apelit të datës 27 nëntor 1996 (shih paragrafin 9 më lart) dhe e deklaroi të pafajshëm ankuesin më 14 dhjetor 1998 (vendimi i pafajësisë).

318. Kundër vendimit nuk u bë asnjë ankimim brenda afatit të parashikuar prej 10 ditëve dhe si rezultat, vendimi u bë përfundimtar më datë 24 dhjetor 1998.

C. Kërkesa e prokurorit për leje për rivendosje në afat

319. Më 8 tetor 1999, prokurori në Gjykatën e Apelit të Durrësit (prokurori i apelit) depozitoi një kërkesë për leje për rivendosje në afat kundër vendimit të pafajësisë në Gjykatën e Rrethit të Durrësit. Prokurori i apelit deklaroi si bazë të kërkesës së tij mangësitë e vëna re në lidhje me prokurorin e rrethit. Duke iu referuar nenit 26 § 1 të Kodit të Procedurës Penale rreth dorëheqjes së një prokurori në rastet e mungesës së paanshmërisë, përmbajtja e të cilit i referohet dorëheqjes së një gjyqtari sipas nenit 17 të Kodit të Procedurës Penale, prokurori i apelit pretendonte se prokurori i rrethit që kishte marrë pjesë në proceset e gjykimit të parë nuk duhet të kishte marrë pjesë dhe në procesin e rishikimit të vendimit. Neni 17 § 1 (c) i Kodit të Procedurës Penale parashikon se një gjyqtar duhet të japë dorëheqjen "kur ai ka dhënë këshilla ose ka shprehur mendim rreth subjektit të procesit."

320. Prokurori i apelit argumentonte se familja e viktimës, e cila kishte qenë palë e dëmtuar në proces, nuk ishte informuar për procesin e pafajësisë në përputhje me nenin 137 të Kodit të Procedurës Penale. Prokurori i apelit u vu në dijeni për vendimin e pafajësisë në një datë të paspecifikuar para fundit të shtatorit të vitit 1999, kur ankimi i familjes së viktimës për pafajësinë u ishte dërguar autoriteteve të tjera.

321. Më 21 tetor 1999, Gjykata e Rrethit të Durrësit, në mungesë të ankuesit dhe në prani të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht, pavarësisht nga ekzistenca e një avokati mbrojtës të përzgjedhur nga ankuesi (shih paragrafin 12 më lart), i dha leje prokurorit që të apelonte jashtë afatit normal kohor.

322. Në një datë të paspecifikuar, avokati i caktuar kryesisht për procesin në Gjykatën e Rrethit të Durrësit, e apeloi çështjen në Gjykatën e Apelit të Durrësit duke sfiduar vendimin e lartpërmendur, pasi ankuesi nuk ishte njoftuar dhe vendimi nuk i ishte shërbyer atij në përputhje me nenin 414 të Kodit të Procedurës Penale. Ndërkohë, në përputhje me vendimin e gjykatës së rrethit të datës 21 tetor 1999, prokurori i apelit depozitoi një ankesë kundër vendimit të pafajësisë.

323. Më 15 dhjetor 1999, Gjykata e Apelit të Durrësit rrëzoi kërkesën e avokatit të caktuar kryesisht me arsyetimin se vendimi që e lejon prokurorin të apelojë jashtë afatit kohor, nuk është subjekt ankimi sipas nenit 147 § 5 të PKK-së, pasi ai nuk shënon fundin e procesit penal. Ajo rrëzoi gjithashtu dhe kërkesën e prokurorit, pasi ai nuk i është njoftuar shprehimisht/qartësisht ankuesit në përputhje me nenin 414 të KPP-së. Në një datë të paspecifikuar prokurori e çoi çështjen në Gjykatën e Lartë.

324. Më 19 prill 2000, seksioni penal i Gjykatës së Lartë rrëzoi vendimin e Gjykatës së Apelit të Durrësit të datës 15 dhjetor 1999. Ajo identifikoi që kërkesat në lidhje me njoftimin e vendimeve gjyqësore për avokatin e caktuar kryesisht të ankuesit ishin plotësuar, përderisa ankuesi konsiderohej i larguar. Si rezultat, gjykata pranoi kërkesën e prokurorit për

rivendosje në afat kundër vendimit të pafajësisë dhe ia ktheu çështjen Gjykatës së Apelit të Durrësit për rishqyrtim.

D. Apelimi i vonuar i prokurorit

325. Në përputhje me parashtrimet e prokurorit të apelit në Gjykatën e Apelit të Durrësit, pafajësia duhej të deklarohej e pavlefshme për sa kohë që provat e reja të paraqitura nga ankuesi, dhe në rast se ato e pajisnin ankuesin me një alibi, ishin depozituar shumë vonë. Për më tepër, prokurori që kishte marrë pjesë në procesin e rishikimit të vendimit gjyqësor kishte marrë pjesë dhe në gjykimin fillestar. Së fundmi, pretendohej se avokati i ankuesit nuk kishte të drejtë të fillonte procesin për rishikim vendimi, pasi ankuesi kishte nënshkruar një autorizim dy ditë pas depozitimit të aplikimit për rishikim vendimi.

326. Më 18 dhjetor 2000, Gjykata e Apelit të Durrësit konfirmoi arsyetimin e parashtruar në vendimin e pafajësisë të datës 14 dhjetor 1998 dhe rrëzoi kërkesën e prokurorit. Avokati i caktuar kryesisht u njoftua për vendimin. Në një datë të paspecifikuar, duke cituar të njëjtat arsye apelimi që kishte depozituar në Gjykatën e Apelit të Durrësit, prokurori e ankimoi çështjen në Gjykatën e Lartë, duke pretenduar se vendimi i pafajësisë ishte i pavlefshëm.

327. Më 20 qershor 2001, seksioni penal i Gjykatës së Lartë la në fuqi shkaqet e apelimit të prokurorit, dhe, duke vendosur për themelin e çështjes, anuloi vendimin e pafajësisë. Ajo arsyetoi se ishin shkelur dispozitat e KPP-së në lidhje me kapacitetin juridik të avokatit të ankuesit për të depozituar një aplikim për rishikim vendimi më 11 dhjetor 1997. Ajo vuri re se avokati ishte caktuar të vepronte nga ankuesi më 13 dhjetor 1997, d.m.th. 2 ditë pas depozitimit të kërkesës në gjykatën e rrethit. Gjykimi iu njoftua avokatit të caktuar kryesisht.

328. Në vitin 2002, ankuesi, i cili që prej vitit 1999 e në vijim ka vuajtur dënimin e lëshuar nga gjykatat italiane me 16 vjet heqje lirie në burgun e Viçencës (Itali) për trafikim ndërkombëtar droge, u njoftua për vendimin e Gjykatës së Lartë, që kishte çuar në rishikimin e pafajësisë së tij, pas një kërkese të autoriteteve shqiptare për ekstradimin e tij.

E. Procesi në Gjykatën Kushtetuese

329. Më 13 shkurt 2002 avokati i caktuar nga ankuesi, i cili kishte vepruar në emër të tij në procesin e rishikimit të vendimit (shih paragrafin 1 më lart) depozitoi një ankesë në Gjykatën Kushtetuese, duke pretenduar cenim të së drejtës kushtetuese të ankuesit për gjykim të drejtë dhe shkelje të nenit 6 §§ 1 dhe 3 (a) dhe (c) të Konventës.

330. Në parashtrimet para gjykatës, ankuesi pretendonte se proceset e gjykatave të brendshme nuk kishin qenë të rregullta, me arsyetimin se as ai dhe as avokati mbrojtës i zgjedhur prej tij nuk ishin informuar për kryerjen e proceseve dhe se ai kishte pretenduar të ishte larguar pavarësisht nga fakti se ai kishte caktuar një avokat, aftësia juridike e të cilit formon bazën e ankesës së prokurorit kundër pafajësisë.

331. Për më tepër, ankuesi parashtroi se në lidhje me faktin se autoritetet shqiptare kishin trajtuar dy kërkesa për autoritetet italiane për ekstradimin e tij në Shqipëri, kishte arsye të besohej se autoritetet shqiptare kishin pasur mundësinë e njoftimit për kryerjen e proceseve dhe të ofrimit të vendimeve të gjykatës për të.

332. Në lidhje me themelin e çështjes që çoi në anulimin e pafajësisë së tij, ankuesi pretendon se kapaciteti juridik i avokatit të tij nuk e lejonte këtë gjë, pasi më datën 10 dhjetor

1997 babai i tij e kishte autorizuar avokatin ta përfaqësonte ankuesin para gjykatave kombëtare në proceset për rishikim vendimi dhe se ai e kishte konfirmuar autorizimin më datë 13 dhjetor 1997.

333. Më 26 prill 2002, Gjykata Kushtetuese vendosi të deklaronte *de plano* ankimin e ankuesit si të papranueshëm, pasi ai nuk ishte në juridiksionin e saj.

II. LEGJISLACIONI DHE PRAKTIKA E BRENDSHME

A. Kushtetuta e Shqipërisë

334. Kushtetuta e Shqipërisë, në pjesët e saj përkatëse, parashikon se:

Neni 31

Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë:

a) të vihet në dijeni menjëherë dhe hollësisht për akuzën që i bëhet, për të drejtat e tij, si dhe t'i krijohet mundësia për të njoftuar familjen ose të afërmit e tij;

b) të ketë kohën dhe lehtësitë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet;

c) të ketë ndihmën pa pagesë të një përkthyesi, kur nuk flet ose nuk kupton gjuhën shqipe;

d) të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij, të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe t'i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme;

e) t'u bëje pyetje dëshmitarëve të pranishëm dhe të kërkojë paraqitjen e dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.

Neni 32

1. Askush nuk mund të detyrohet të dëshmojë kundër vetvetes ose familjes së vet dhe as të pohojë fajësinë e tij.

2. Askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme.

Neni 33

1. Kushdo ka të drejtë të dëgjohet para se të gjykohet.

2. Nga kjo e drejtë nuk mund të përfitojë personi që i fshihet drejtësisë.

Neni 34

Askush nuk mund të dënohet më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale dhe as të gjykohet sërish, me përjashtim të rasteve kur është vendosur rigjykimi i çështjes nga një gjykatë më e lartë, sipas mënyrës së parashikuar me ligj.

Neni 42 § 2

“Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe

ligjorë ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. ”

Neni 43

Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe.

Neni 142 § 3

“Strukturat shtetërore respektojnë vendimet gjyqësore.”

Neni 131

“Gjykata Kushtetuese vendos: ...

f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave;”

B. Kodi i Procedurës Penale

335. Pjesët përkatëse të Kodit të Procedurës Penale (KPP) që ishin në fuqi në atë kohë, parashikonin si më poshtë:

336. Neni 26 § 1 i KPP-së i kërkon një prokurori të japë dorëheqjen kur ka arsye për të dyshuar për anshmëri në rastet e parashikuara në nenin 17 të KPP-së. Neni 17 i referohet dorëheqjes së një gjyqtari nga gjykimi i një çështjeje ekzistuese. Neni 17 § 1 (c) i kërkon një gjyqtari të japë dorëheqjen në rast se ai ka dhënë këshilla ose ka shprehur një mendim për subjektin e procesit.

337. Neni 48 i Kodit të Procedurës Penale (KPP) parashikon se pala e paditur zgjedh avokatin e saj me anë të parashtrimeve me gojë në një seancë gjyqësore ose me anë të një autorizimi që dërgohet me postë të regjistruar. Edhe të afërmit e të padituri mund të zgjedhin një avokat për të përfaqësuar të padituri që është ndaluar, arrestuar ose gjykuar dhe dënuar me burgim, me anë të metodave të lartpërmendura, në përjashtim të rasteve kur i padituri e ka zgjedhur avokatin e tij.

338. Neni 58 i Kodit të Procedurës Penale (KPP) i jep të drejtë palës së dëmtuar nga një vepër penale ose trashëgimtarëve të tij të kërkojë ndjekjen e autorit të veprës dhe dëmshpërblim. Neni 409 e lejon palën e dëmtuar të depozitojë një ankesë vetë ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor në lidhje me aspektet penale dhe civile.

339. Sipas nenit 147 § 1 të KPP-së, një palë në proces, që nuk ka mundur të ankimojë kundër një vendimi brenda kohës së parashikuar si rezultat i aktiviteteve të paparashikuara ose shkaqe të forcës madhore, mund të kërkojë rivendosje në afat. Sipas nenit 147 § 2, një të padituri të gjykuar në mungesë mund t’i jepet e drejta për rivendosje në afat kundër një vendimi gjykate, nëse ai vërteton se nuk kishte pasur dijeni për vendimin. Sipas nenit 147 § 3

kërkesa për rivendosje në afat duhet të bëhet dhjetë ditë brenda datës kur palët marrin njoftim për vendimin. Sipas nenit 147 § 5, vendimi për rivendosje në afat mund të apelohet në lidhje me vendimin për themelin e çështjes.

340. Sipas nenit 414 mund të depozitohet një ankesë në gjykatën e apelit brenda 10 ditëve duke filluar nga dita e deklarimit ose njoftimit të vendimit.

341. Nenet 449 dhe 451 të KPP-së parashikojnë se rishikimi i vendimit gjyqësor mbi bazën e rrethanave të reja të zbuluara duhet të depozitohet nga njëra palë në proces në të njëjtën gjykatë që ka dhënë vendimin fillestar. Një aplikim i tillë bëhet brenda pesë vjetëve nga dhënia e vendimit të pafajësisë.

LEGJISLACIONI

I. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 6 §§ 1, 3 (a) dhe (c) TË KONVENTËS

342. Ankuesi u ankua se vendimi i Gjykatës së Lartë i datës 20 qershor 2001, i dhënë pas pafajësisë së tij përfundimtare, përbënte shkelje të së drejtës së tij për proces të rregullt ligjor dhe se vendimi i pafajësisë, i cili ishte vendim përfundimtar u anulua nga kjo gjykatë. Ai u ankua gjithashtu për faktin se as ai dhe as avokati mbrojtës i zgjedhur prej tij nuk u njoftuan menjëherë për kërkesën e prokurorit për rivendosje në afat kundër vendimit të pafajësisë. Ai u bazua në nenet 6 § 1 dhe 6 § 3 (a) dhe (c) të Konventës, pjesët përkatëse të së cilës parashikojnë:

".1. në përcaktimin e ... çdo akuze penale kundrejt tij, kushdo gëzon të drejtën e të dëgjuarit ... të drejtën ... nga [një] ... gjykatë ..."

...

3. Kushdo i akuzuar për një vepër penale ka këto të drejta minimale:

a) Të informohet menjëherë, në një gjuhë që e kupton dhe në detaje për natyrën dhe shkakun e akuzës së ngritur kundër tij.

...

c) Të mbrohet personalisht ose nëpërmjet ndihmës ligjore të përzgjedhur prej tij, nëse nuk ka mjete të mjaftueshme për të paguar për ndihmë ligjore, t'i ofrohet kjo ndihmë pa pagesë kur kërkohet nga interesat e drejtësisë;"

...

A. PRANUESHMËRIA

343. Qeveria parashtroi se aplikimi ishte i papranueshëm, pasi ai është depozituar jashtë afatit. Për shkak se Gjykata Kushtetuese e kishte deklaruar kërkesën e ankuesit të papranueshme më 26 prill 2002, vendimi i fundit gjyqësor për qëllime të nenit 35 të Konventës në fakt është vendimi i Gjykatës së Lartë i datës 20 qershor 2001, ndërsa ankuesi e ka paraqitur kërkesën e tij më datë 20 shtator 2002.

344. Në përgjigjen e tij ankuesi parashtroi se apelimi në Gjykatën Kushtetuese është mjet i brendshëm juridik që duhet ezauruar brenda rendit të brendshëm ligjor. Si rezultat, vendimi i Gjykatës Kushtetuese për papranueshmërinë duhet të konsiderohet si vendimi i fundit gjyqësor i brendshëm.

345. Gjykata thekson konstatimet e saj në vendimin për pranueshmërinë për çështjen "Balliu kundër Shqipërisë" (nr. 74727/01), i respektuar dhe në çështjen "Beshiri dhe të tjerët kundër Shqipërisë", (nr.7352/03, § 32, 22 gusht 2006), ku ajo vendosi se një ankesë në Gjykatën Kushtetuese të Shqipërisë mund të konsiderohet si mjet efektiv që duhet të përdoret

për qëllimet e nenit 35 të Konventës kur u ngritën çështjet që lidhen me një proces të rregullt ligjor. Gjykata mendon se nuk ka arsye për të rrëzuar këtë konstatim në rrethanat e çështjes në fjalë.

346. Në fakt ankuesi e përdori këtë mjet. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese mban datën 26 prill 2002 dhe ankuesi e depozitoi ankimin e tij në gjykatë më datën 20 shtator 2002. Pra ai ka respektuar afatin prej gjashtë muajsh të parashikuar në nenin 35 të Konventës.

347. Gjykata konstaton se aplikimi nuk është i pabazuar brenda kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës. Ajo konstaton më tej se aplikimi për asnjë arsye tjetër nuk është i papranueshëm. Si rezultat aplikimi duhet të deklarohet i pranueshëm.

B. Themeli i çështjes

1. Siguria ligjore: rrëzimi i një vendimi përfundimtar

a) Parashtrimet e palëve

348. Ankuesi deklaroi se fillimisht i ati caktoi një avokat të vepronte në emër të tij me anë të një autorizimi të nënshkruar më 10 dhjetor 1997. Ky autorizim u bë pjesë e dosjes së çështjes dhe nuk duhet të injorohet nga gjykatat e brendshme në lidhje me procedurat e njoftimit për ankuesin. Ai shtoi se prokurori nuk kishte arsye ligjore (aktivitete të paparashikuara ose *force majeure*) sipas nenit 147 § 1 të KPP-së për të kërkuar leje për apelim jashtë afatit kohor të përcaktuar kundër vendimit të pafajësisë, i cili ishte vendim përfundimtar, pasi autoritetet gjithnjë ishin bërë të ndërgjegjshme për kërkesën për rishikim gjykimi me anë të letrës së datës 26 gusht 1998 (shih paragrafin 13 më lart).

349. Për sa i përket mospërputhshmërisë së prokurorit të rrethit, i cili më parë kishte marrë pjesë në procesin që kishte çuar në dënimin e ankuesit në vitin 1996, ankuesi argumentoi se mospërputhshmëria e gjyqtarëve nuk zbatohej për prokurorët, nëse ata merrnin pjesë në procese në të njëjtin nivel gjykimi.

350. Qeveria parashtroi se kërkesa e prokurorit për leje për apelim jashtë afatit erdhi si rezultat i shkeljeve procedurale nga ana e gjykatës së rrethit, e cila nuk e kishte njoftuar familjen e viktimës për pafajësinë e ankuesit në mënyrë që ata të mund të kishin të drejtë ankimimi kundër vendimit të pafajësisë. Familja e viktimës u vu rastësisht në dijeni të atij vendimi disa muaj më vonë.

351. Sipas mendimit të Qeverisë, një arsye tjetër që çoi në apelimin e vonuar të prokurorit ishte fakti që prokurori që mori pjesë në seancat gjyqësore të pafajësisë në gjykatën e rrethit nuk i informoi eprorët e tij për proceset në fjalë.

352. Qeveria është e mendimit se përderisa legjislacioni i brendshëm parashikon rishikimin e një vendimi gjyqësor, si dhe procedurën për të kërkuar rivendosje në afat, këto hapa nuk mund të konsiderohen si shkelje e parimit të sigurisë ligjore sipas nenit 6 § 1 të Konventës.

b) Vlerësimi i gjykatës

i. Parime të përgjithshme

353. Gjykata thekson se në kuadrin e preambulës së Konventës, shteti i së drejtës është pjesë e trashëgimisë së përbashkët të shteteve kontraktuese, një ndër aspektet themelore të të cilit është parimi i sigurisë ligjore, i cili kërkon, ndërmjet të tjerash, se kur gjykatat kanë vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i tyre nuk duhet të vihet në pikëpyetje (shih

Brumărescu k. Rumanisë [GC], nr 28342/95, § 61, GJEDNJ 1999-VII).

354. Për më tepër, Gjykata vlerëson se kërkesat e sigurisë ligjore nuk janë absolute. Largimi nga parimi justifikohet vetëm nëse një gjë e tillë bëhet e nevojshme nga rrethanat e një karakteri substancial ose detyrues (Ryabykh k. Rusisë, nr. 52854/99, § 52, GJEDNJ 2003-IX) ose kur arsye serioze legjitime janë më me peshë se siguria juridike (shih Bratyakin k. Rusisë (dek.), nr. 72776/01, 9 mars 2006).

355. Thjesht mundësia e rihapjes së një çështjeje penale është *prima facie* në përputhje me Konventën, duke përfshirë dhe garancitë e nenit 6. Duhet të vlerësohet në kuadrin e nenit 4§2 të protokollit nr.7, për shembull, që e lejon shprehimisht një shtet të rihapë një çështje si rezultat i daljes së fakteve të reja ose kur zbulohet një defekt thelbësor në proceset e mëparshme, që mund të kenë ndikim mbi rezultatin e çështjes (shih Nikitin k. Rusisë, nr. 50178/99, § 54-57, GJEDNJ 2004-VIII, dhe Savinskiy k. Ukrainës, nr. 6965/02, § 23, 28 shkurt 2006). Rrethana të posaçme të çështjes mund të dëshmojnë se mënyra aktuale në të cilën përdoret një rishikim dëmton thelbin e një procesi të drejtë gjyqësor. Në veçanti, gjykatës i duhet të vlerësojë nëse, në një rast të caktuar, kompetenca për të nisur dhe për të kryer një [...] rishikim ushtrohet nga autoritetet për të arritur, sa më maksimalisht të jetë e mundur, një balancë të drejtë ndërmjet interesave të individit dhe nevojës për të siguruar efektivitetin e sistemit të drejtësisë penale (shih Bujniţa k. Moldovisë, nr. 36492/02, § 21, 16 janar 2007).

356. Konsideratat përkatëse që duhet të merren parasysh në këtë pikë, përfshijnë, në veçanti, efektin e rihapjes dhe proceseve të tjera pasuese mbi situatën individuale të ankuesit dhe nëse rihapja vjen si rezultat i kërkesës së vetë ankuesit, arsyet në bazë të të cilave autoritetet e brendshme revokojnë vendimin përfundimtar në çështjen e ankuesit; përputhshmërinë e procedurës në fjalë me kërkesat e legjislacionit të brendshëm, praninë dhe funksionimin e sigurive procedurale në sistemin e brendshëm ligjor të afta për të parandaluar abuzime të kësaj procedure nga autoritetet e brendshme dhe rrethana të tjera përkatëse të çështjes (Radchikov k. Rusisë, nr. 65582/01, § 44, 24 maj 2007).

ii. Zbatimi i parimeve të sipërpërmendura në çështjen në fjalë

357. Gjykata vë re se në këtë çështje vendimi përfundimtar që e nxjerr të pafajshëm ankuesin për të gjitha akuzat u rishqyrtua dhe u anulua duke i dhënë leje prokurorit për të bërë ankim jashtë afatit kundrejt vendimit të pafajësisë (shih, në ndryshim çështjen, Fadin k. Rusisë, nr. 58079/00, § 34, 27 korrik 2006) dhe kjo pranohet nga të dyja palët. Çështja që ngrihet është nëse mbi bazën e fakteve të çështjes dhe shqyrtimit të proceseve të rishikimit të vendimit autoritetet realizojnë, në nivelin më maksimal të mundshëm, një baraspeshë ndërmjet interesave të ankuesit dhe nevojës për të siguruar efektivitetin e sistemit të drejtësisë penale, duke respektuar në këtë mënyrë nenin 6.

358. Thelbi i kërkesës së prokurorit për leje për apelim jashtë afatit më datë 8 tetor 1999 lidhet me shkeljen e sigurive procedurale në faktin që pala e dëmtuar, d.m.th. familja e viktimës, nuk ishte njoftuar për vendimin e pafajësisë. Gjykata vë re se sipas nenit 58 § 1 të KPP-së, pala e dëmtuar mund ta kërkojë ndjekjen e autorit të veprës dhe dëmshpërblimin e dëmtimit. Sipas nenit 409 të KPP-së, pala e dëmtuar mund të bëjë ankesë, ose vetë ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor, në lidhje me aspektet penale dhe civile.

359. Gjykata shpreh keqardhjen e saj për faktin se gjykata e brendshme nuk

përmbushi kërkesat e njoftimit të parashikuara në nenin 137 § 1 të KPP-së. Gjithsesi, ajo vë re se në bazë të dokumenteve të depozituara në dosjen e çështjes, nuk ka tregues që familjes së viktimës t'i jetë dhënë status i "palës së dëmtuar". Edhe po të supozohet se familjes së viktimës i është dhënë statusi i "palës së dëmtuar" dhe nëse do të kishte interesa në lidhje me ndonjë aspekt penal ose civil të pretenduar, ata vetë nuk bënë ndonjë ankesë në gjykatën e rrethit as personalisht dhe as nëpërmjet përfaqësuesit të tyre ligjor. Ata nuk bënë as dhe një kërkesë për lejen për rivendosje në afat ose nuk ndërmorën në mënyrë të drejtpërdrejtë asnjë veprim të nevojshëm nëpërmjet ndihmës së zyrës së prokurorit. Familja e viktimës zgjodhi një tjetër rrugë. Ata depozituan një kërkesë në autoritete të tjera të brendshme, si për shembull në Zyrën e Presidentit të Republikës, autoritete të cilat nuk kishin kompetenca të merrnin asnjë lloj vendimi, përveçse t'ia kalonin ankesën zyrës së prokurorisë.

360. Gjykata nuk e pranon argumentin e Qeverisë se prokurori që mori pjesë në procedurat e pafajësisë, edhe pse kishte marrë pjesë dhe më parë në proceset që kishin përfunduar në dënimin e ankuesit, nuk kishte njoftuar eprorët e tij, duke çuar kështu në mosdepozitimin e një ankese brenda afateve kohore të parashikuara me ligj. Ajo gjykon se gabimet e autoriteteve shtetërore duhet t'i shërbejnë të pandehurit. Me fjalë të tjera, rreziku i ndonjë gabimi të kryer nga autoriteti i prokurorisë, ose edhe nga gjykata, duhet të mbulohet nga shteti; gabimet nuk duhet të paguhen nga individi i përfshirë në çështje (shih më lart Radchikov k. Rusisë, § 50). Për më tepër, nivelet më të larta në zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm ishin të ndërgjegjshme për proceset e rishikimit të vendimit gjyqësor siç dëshmohet në letrën e datës 26 gusht 1998 (shih paragrafin 13 më lart).

361. Situata në të cilën vendimi përfundimtar në favor të ankuesit u vu në dyshim dhe u rishikua, mund të ishte shmangur nëse zyra e prokurorisë do të kishte bërë një ankesë të zakonshme brenda afatit kohor 10-ditor të parashikuar me ligj. Në çështjen në fjalë zyra e prokurorit dështoi në ushtrimin e të drejtës së saj për depozitimin e kërkesës së zakonshme dhe lejoi kalimin e afatit ligjor prej 10 ditësh pa e kundërshtuar vendimin e pafajësisë. Kjo zyrë kërkoi leje për rivendosje afati pas më shumë se nëntë muajsh, pasi vendimi në favor të ankuesit ishte bërë përfundimtar dhe i zbatueshëm dhe pas deklarimit të tij të pafajshëm. Kërkesa e prokurorit nuk përmbante informacion në lidhje me datën kur kishte filluar llogaritja e afatit 10-ditor sipas kuptimit të nenit 147 § 3 të KPP-së, dhe as Qeveria nuk ka vënë në pah ndonjë rrethanë përjashtimore që do ta kishte parandaluar zyrën e prokurorit nga bërja e një kërkese të rregullt në një kohë të arsyeshme.

362. Gjykata vlerëson se argumentet e palëve të përdorura nga prokurori për të justifikuar kërkesën për rivendosje në afat ishin të pamjaftueshme për të justifikuar vënien në pikëpyetje të një vendimi përfundimtar dhe për të përdorur këtë mjet të jashtëzakonshëm. Gjykata është e mendimit se lejimi i kërkesës së prokurorit nuk vendos një baraspeshë ndërmjet interesit të ankuesit dhe nevojës për të siguruar efektivitetin e sistemit të drejtësisë penale.

363. Duke marrë parasysh këto konsiderata, Gjykata është e mendimit se duke i dhënë leje prokurorit për rivendosje në afat, Gjykata e Lartë cenoi parimin e sigurisë ligjore të parashikuar në nenin 6§1 të Konventës. Si rezultat, ka pasur shkelje të këtij neni.

2. "Informohet menjëherë" dhe mbrojtja nga "një ndihmë ligjore e zgjedhur prej tij".

a) Parashtrimet e palëve

364. Ankuesi ankohet se edhe pse nëpërmjet një avokati të përzgjedhur prej tij, të konfirmuar me atë të autorizimit të datës 13 dhjetor 1997, autoritetet nuk informuan as avokatin e tij, dhe as anëtarët e familjes së tij për proceset e reja, në të cilat prokurorit i ishte dhënë e drejta e rivendosjes në afat, e cila çoi në anulimin e vendimit përfundimtar të pafajësisë, duke e bërë në këtë mënyrë të drejtën e mbrojtjes së vetes me anë të një avokati të zgjedhur prej tij të pamundur.

365. Qeveria në parashtrimin e saj thotë se përderisa ankuesi ishte deklaruar i larguar në drejtim të paditur dhe atij i është caktuar një avokat kryesisht nga gjykata, këtij avokati iu komunikuan vendimet e gjykatave të brendshme për dhënien e së drejtës për rivendosje në afat.

b) Vlerësimi i gjykatës

366. Gjykata thekson që në fillim se kërkesat e paragrafit 3 të nenit 6 duhet të konsiderohen si aspekte të veçanta të së drejtës për proces të rregullt ligjor të garantuar në paragrafin 1 (shih, ndërmjet autoriteteve të tjera, Balliu k. Shqipërisë, nr. 74727/01, § 25, 16 qershor 2005). Në tërësi Gjykatës i kërkohet të shqyrtojë nëse proceset që çuan në rigjykimin e ankuesit, ishin të drejta (shih, ndërmjet autoriteteve të tjera, Vanyan k. Rusisë, nr.53203/99, § 63-68, 15 dhjetor 2005, Imbrioscia k. Zvicrës, vendimi i datës 24 nëntor 1993, seritë A nr.275, § 38 dhe S.N. k. Zvicrës, nr. 34209/96, § 43, GJEDNJ 2002-V).

367. Duke pasur parasysh gjetjen për shkeljen në lidhje me anulimin e një vendimi përfundimtar sipas nenit 6 § 1 (shih paragrafin 61 më lart), gjykata vëren se nuk është e nevojshme që të shqyrtohet nëse në këtë çështje ka pasur cenim të nenit 6 § 1 në lidhje me nenin 6 § 3 (a) dhe (c).

II. PRETENDIM PËR SHKELJE TË NENIT 10 TË KONVENTËS

368. Ankuesi më tej u ankua për shkelje të nenit 10 pa ofruar asnjë shkak. Neni 10 i Konventës parashikon:

“1. Kushdo ka të drejtën e lirisë së shprehjes, kjo e drejtë përfshin lirinë e shprehjes së opinioneve, të marrjes dhe të ndarjes së informacionit dhe të ideve pa ndërhyrjen e autoritetit publik dhe pavarësisht nga kufijtë. Ky nen nuk i parandalon shtetet nga kërkimi i licencimit për kompanitë e transmetimit, televizive ose kinematografike.

2. Ushtrimi i këtyre lirive, përderisa shoqërohet me detyra dhe përgjegjësi, mund të jetë subjekt i formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose gjobave të tilla të parashikuara në ligj dhe të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurimit kombëtar, integritetit territorial ose sigurisë publike për parandalimin e mungesës së rendit apo krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose moralit, për mbrojtjen e reputacionit ose të drejtave të të tjerëve, për parandalimin e shpërndarjes së informacionit të marrë në mirëbesim ose për ruajtjen e autoritetit dhe paanshmërinë e gjyqësorit.”

369. Gjykata vë re se ankimi i ankuesit mbetet i paprovuar. Përmbajtja e dosjes së çështjes nuk tregon për cenim të të drejtave të ankuesit të parashikuara në këtë dispozitë.

370. Ajo vijon se ankimi është i pabazuar dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35 §§ 3 dhe 4 të Konventës.

III. PRETENDIME PËR SHKELJE TË NENIT 4 TË PROTOKOLLIT NR.7 TË KONVENTËS

371. Ankuesi pretendon më tej se vendimi i Gjykatës së Lartë i datës 20 qershor 2001 ka shkelur parimin *ne bis in idem* të parashikuar në nenin 4 të protokollit nr.7 të Konventës dhe duhet të konsiderohet si një gjykim i dyfishtë për të njëjtën vepër penale. Neni 4 i protokollit nr.7 të Konventës parashikon si më poshtë:

"1. Asnjë nuk ka të drejtë të gjykohet ose të dënohet dy herë në procese penale sipas juridiksionit të të njëjtit shtet për një vepër penale për të cilën ai është deklaruar përfundimisht i pafajshëm ose është dënuar në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të atij shteti.

2. Dispozitat e paragrafit më lart nuk parandalojnë rihapjen e çështjes në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të shtetit në fjalë nëse ka prova të fakteve të reja ose të zbuluara rishtazi, ose nëse ka pasur një defekt thelbësor në proceset e mëparshme, i cili mund të ketë pasur ndikim mbi çështjen.

3. Nga ky nen nuk ka përjashtim sipas nenit 15 të Konventës."

372. Gjykata vë re se qëllimi i nenit 4 të protokollit nr.7 është që të parandalojë përsëritjen e proceseve penale që kanë përfunduar me vendim përfundimtar. Gjykata thekson se qëllimi i raportit shpjegues të protokollit nr.7 është të ndalohet përsëritja e procesit penal për të cilin ka përfunduar një vendim përfundimtar. Sipas raportit shpjegues të protokollit nr.7, i cili në vetvete i referohet Konventës europiane për vlefshmërinë ndërkombëtare të vendimeve penale, "një vendim është përfundimtar 'nëse, sipas shprehjes tradicionale, ai ka marrë fuqi *res judicata*. Ky është rasti kur vendimi është i pakthyeshëm, pra kur nuk ka mjete të tjera të disponueshme ose kur palët i kanë shfrytëzuar këto mjete ose kanë lejuar skadimin e afatit kohor pa i përdorur ato' " (shih Nikitin, cituar më lart, § 37).

373. Gjykata konstaton se vendimi i pafajësisë i datës 14 dhjetor 1998 u bë përfundimtar më 24 dhjetor 1998, pasi kundër tij nuk u bë asnjë apel brenda afatit prej dhjetë ditësh të parashikuar në ligj (shih paragrafët 16 dhe 38 më lart). Në këtë mënyrë, mbetet të përcaktohet nëse proceset që u zhvilluan pas dhënies së lejes për rivendosje në afat konsiderohen si gjykim i dytë ose si rihapje e proceseve të pafajësisë.

374. Sipas mendimit të gjykatës, neni 4 i protokollit nr.7 e bën të qartë dallimin ndërmjet një ndjekjeje ose gjykimi të dytë, i cili ndalohet nga paragrafi i parë i të njëjtit nen, dhe rihapjes së gjykimit në raste përjashtimore, gjë që parashikohet në paragrafin e dytë. Neni 4 § 2 i protokollit nr.7 parashikon shprehimisht mundësinë që një individ duhet ta pranojë ndjekjen për të njëjtat akuza, në përputhje me legjislacionin e brendshëm, kur një çështje rihapet pas daljes së një prove të re ose pas zbulimit të një defekti thelbësor në proceset e mëparshme (shih Nikitin, cituar më lart, § 45).

375. Legjislacioni shqiptar i lejonte në atë kohë dhe i lejon ende dhe sot secilës prej palëve në proces penal të kërkojë rivendosje në afat, kur plotësohen kushtet e parashikuara në nenin 147§1 të KPP-së. Subjekti i procesit pas marrjes së lejes për rivendosje në afat mbetet e njëjta akuzë penale për të cilën është dënuar ankuesi. Efekti përfundimtar i lejes për rivendosje në afat është që të rihapet procesi, të rrëzohet vendimi i pafajësisë dhe të përcaktohet akuza penale në vendimin e ri. Pra në një farë mënyre ky proces përbën një formë vijimësie të procesit të mëparshëm (shih Nikitin, cituar më lart, § 45).

376. Si rezultat, Gjykata përfundon se për qëllime të parimit të ne bis in idem, qëllimi i lejes për rivendosje në afat përbënte një përpjekje për të rihapur proceset e mëparshme, dhe jo një ''gjykim të dytë". Ajo vijon më tej duke thënë se nuk ka pasur shkelje të nenit 4 § 1 të

protokollit nr. 7 të Konventës.

IV. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

377. Neni 41 i Konventës parashikon se:

"Nëse gjykata konstaton se ka pasur shkelje të Konventës dhe të protokolleve të saj dhe nëse legjislacioni i brendshëm i palëve të larta kontraktuese lejon vetëm riparim të pjesshëm, gjykata, nëse është e nevojshme, akordon dëmshpërblim të drejtë për palën e dëmtuar."

A. Dëmi

378. Në bazë të nenit 57, pretendon 31 euro për çdo ditë burgu, në bazë të vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 20 qershor 2001 në lidhje me dëmet materiale.

379. Qeveria e kontestoi pretendimin e tij.

380. Gjykata nuk sheh ndonjë lidhje shkakore ndërmjet shkeljes dhe dëmit material të pretenduar. Ankuesi po vuante dënimin me 16 vjet heqje lirie në Itali, vendim ky i lëshuar nga gjykatat italiane për trafikim ndërkombëtar droge (shih paragrafin 26) në kohën kur vendimi i pafajësisë së tij u anulua nga Gjykata e Lartë më 20 qershor 2001. Burgimi i tij në Itali nuk kishte ardhur si rezultat i vendimit të Gjykatës së Lartë të Shqipërisë në vitin 2001.

381. Ankuesi pretendon nga 30 000 deri në 100 000 dollarë amerikanë (USD) në lidhje me dëmet jomateriale. Ai pretendon se anulimi i vendimit të pafajësisë dhe dënimi i tij kishin çuar në shumë presion dhe tension për të. Ai ia lë në dorë gjykatës të përcaktojë shumën e saktë.

382. Qeveria e kontestoi pretendimin e tij.

383. Gjykata rithekson se shkelja e Konventës e identifikuar në çështjen në fjalë ka ardhur si rezultat i anulimit të pafajësisë së ankuesit. Pavarësisht nga natyra përfundimtare e gjykimit që e shpalli atë të pafajshëm, ai ishte dënuar në kundërshtim me parimin e sigurisë ligjore. Gjykata është e mendimit se ankuesit duhet t'i jetë shkaktuar stres dhe tension si rezultat i anulimit të vendimit të Gjykatës së Rrethit të datës 14 dhjetor 1998 (shih Bujniţa k. Moldovisë, cituar më lart, § 28). Gjithsesi, shuma e kërkuar është ekstreme. Duke bërë vlerësimin e saj mbi një bazë të barabartë, ajo i akordon ankuesit 2000 euro për dëme jomateriale.

384. Gjithsesi, Gjykata vë re gjithashtu se ankuesi vazhdon të jetë subjekt i pasojave të anulimit të vendimit të 14 dhjetorit 1998. Ajo është e mendimit se forma më e përshtatshme e kompensimit për situatën e vazhdueshme do të ishte konfirmimi i vendimit përfundimtar të pafajësisë nga autoritetet dhe heqja e dënimit që është në shkelje të Konventës duke filluar që prej asaj dite (shih Bujniţa, cituar më lart, § 29).

B. Kostot dhe shpenzimet

385. Ankuesi pretendoi dhe 10 000 euro për kostot dhe shpenzimet për gjykatat e brendshme dhe për Gjykatën e Strasburgut.

386. Qeveria e kontestoi këtë pretendim.

387. Në bazë të praktikës së Gjykatës, një ankues ka të drejtë të marrë rimbursim për kostot dhe shpenzimet e tij vetëm për aq kohë sa dëshmohet se ato janë kryer dhe kanë qenë të nevojshme dhe janë të arsyeshme në masë (shih, për shembull, Nilsen dhe Johnsen k. Norëay [GC], nr. 23118/93, § 62, GJEDNJ 1999-VIII).

388. Në çështjen në fjalë, duke pasur parasysh mungesën e dokumenteve mbështetëse,

Gjykata e kundërshton pretendimin për kosto dhe shpenzime në proceset penale dhe për proceset para Gjykatës së Strasburgut.

C. Interesat e mospagesës

389. Gjykata është e mendimit se interesi i mospagesës duhet të bazohet në nivelin marxhinal të huadhënies së Bankës Qendrore Europiane, mbi të cilin duhen shtuar tre për qind.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, UNANIMISHT:

1. Deklaron aplikimin të pranueshëm në lidhje me pretendimet që kanë të bëjnë me nenin 6§1 veçmas dhe në lidhje me nenin 6 § 3 (a) dhe (c) të Konventës sipas nenit 4 të protokollit nr.7 të Konventës, dhe deklaron pjesën tjetër të aplikimit të papranueshme.

2. Vendos se nuk ka shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

3. Vendos se nuk ka nevojë të shqyrtohet ankesa sipas nenit 6 § 3 (a) dhe (c) të Konventës.

4. Vendos se nuk ka shkelje të nenit 4 të protokollit nr.7 të Konventës.

5. Vendos:

a) se shteti i paguan ankuesit, brenda tre muajve nga data kur ky vendim bëhet përfundimtar sipas nenit 44 § 2 të Konventës, 2 000 euro (dy mijë euro) për dëme jomateriale, plus çdo tatim të aplikueshëm, konvertuar në monedhën e shtetit palë në proces me kursin e këmbimit në datën e pagimit;

b) se nga data e përfundimit të afatit tremujor të përmendur më lart deri në pagesën e shumës, paguhen interesa të thjeshta mbi këtë shumë në një nivel të barabartë me nivelin marxhinal të huadhënies të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit plus tre për qind.

6. Rrëzon pjesën e mbetur të pretendimeve të ankuesit.

I hartuar në anglisht dhe i njoftuar me shkrim më 29 korrik 2008, në përputhje me rregullin 77§§2 dhe 3 të rregullores së Gjykatës.

Laërence Early	Lech Garlicki
Sekretar	Kryetar

ÇËSHTJA “DYBEKU KUNDËR SHQIPËRISË”

(ANKIMI NR.41153/06)

VENDIM

STRASBURG

18 DHJETOR 2007

Në çështjen Dybeku kundër Shqipërisë,

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i katërt), me trup gjykues të përbërë prej:

J. CASADEVALL President

G. BONELLO,

K. TRAJA,

S.PAVLOVSCHI,

J. ŠIKUTA,

P. HIRVELA, gjykatës

T.L.EARLY, regjistrues i seksionit,

pas shqyrtimit me dyer të mbyllura në datën 27 nëntor 2007, merr në këtë datë vendimin e mëposhtëm:

I. PROCEDURA

1. Çështja ka filluar në bazë të ankimit (nr.41153/06) kundër Republikës së Shqipërisë, drejtuar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore (Konventa) nga një shtetas shqiptar, z. Ilir Dybeku (ankuesi), më 25 shtator 2006.

2. Ankuesi u përfaqësua nga z. S.Shyri, avokat, që e ushtron aktivitetin e tij në Berat. Pala shqiptare (Pala) u përfaqësua nga përfaqësuesi i saj ligjor, znj S. Mëneri nga Ministria e Punëve të Jashtme.

3. Ankuesi u ankua, në mënyrë të veçantë, që në burg kushtet e tij të vuajtjes së dënimit dhe trajtimi mjekësor që ka marrë ishin të papërshtatshme, referuar gjendjes së tij shëndetësore. Për më tepër, ai u ankua për shkelje të nenit 6 të Konventës, për arsye të parregullsisë së proceseve në lidhje me papërshtatshmërinë e kushteve të vuajtjes së dënimit, referuar gjendjes së tij shëndetësore.

4. Më 14 dhjetor 2006, Presidenti i seksionit të katërt të Gjykatës vendosi t’ia komunikonte ankimin palës shqiptare. Sipas dispozitave të nenit 29 § 3 të Konventës, ajo vendosi të shqyrtonte themelin e ankimit, si dhe njëkohësisht pranueshmërinë e tij.

5. Në të njëjtën datë ankuesit iu dha përparësi sipas rregullit 41 të rregullores të Gjykatës.

FAKTET

1. RRETHANAT E ÇËSHTJES

6. Ankuesi ka lindur në vitin 1971 dhe është aktualisht duke vuajtur dënimin në burgun e sigurisë së lartë në Peqin.

A. Rrethanat që çuan në arrestimin e ankuesit

7. Prej vitit 1996 e më tej, ankuesi ka vuajtur nga sëmundja e skizofrenisë paranojake kronike. Për shumë vite ai ka marrë trajtim mjekësor si pacient në shumë spitale psikiatrike.

8. Më 23 gusht të vitit 2002 vdiqën tre persona, duke përfshirë edhe 2 fëmijë të moshës 10 dhe 13 vjeç, dhe të tjerë u plagosën si rezultat vendosjes së eksplozivëve në apartamentin e familjes së motrës së ankuesit.

9. Më 27 gusht të vitit 2002 filloi procesi penal kundër ankuesit, i cili në të njëjtën datë u arrestua dhe u akuzua së pari për veprën penale të vrasjes me dashje, *inter alia* të fëmijëve dhe së dyti për mbajtje të paligjshme të eksplozivëve. Ankuesi u vendos në ambientet e dhomave të paraburgimit në komisariatin e policisë, Durrës, ku ndante qelinë me një numër të paspecifikuar të burgosurish.

B. Gjykimi i ankuesit

10. Më 27 maj të vitit 2003, duke u bazuar në ekspertimin mjekësor, i cili konkludonte se në kohën e kryerjes së veprës çrregullimi mendor i aplikuesit ishte në periudhë qetësie, Gjykata e Shkallës së Parë Durrës vendosi që ankuesi ishte i aftë t'i nënshtrohej procesit gjyqësor. Rrjedhimisht, gjykata e deklaroi ankuesin fajtor dhe e dënoi me burgim të përjetshëm.

11. Më 4 Qershor të vitit 2003 avokati i ankuesit depozitoi ankimin para Gjykatës së Apelit Durrës, duke pretenduar që procesi kishte qenë i parregullt, duke qenë se raporti i ekspertëve kishte qenë i njëanshëm dhe i pabazuar. Ai i kërkoi gjykatës që të urdhëronte kryerjen e një raporti të ri mjekësor për të përcaktuar gjendjen shëndetësore të ankuesit.

12. Më 4 shtator të vitit 2003 dhe më 2 mars të vitit 2004, respektivisht, Gjykata e Apelit Durrës dhe Gjykata e Lartë lanë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë. Për më tepër, gjykatat e brendshme nuk e pranuan kërkesën e ankuesit për një ekzaminim të ri mjekësor. Ato konkluduan se ekspertimi i parë mjekësor ishte kryer nga ekspert të paanshëm dhe në përputhje me garancitë procedurale.

C. Gjendja shëndetësore e ankuesit gjatë vuajtjes së dënimit

13. Që prej dhjetorit të vitit 2003 ankuesi u transferua në tre burgje të ndryshme për të ekzekutuar dënimin e tij dhe më konkretisht në burgun e Tiranës nr.302, burgun e Tepelenës dhe në burgun e Peqinit, ku mbahet aktualisht. Ai i ka ndarë qelitë me të burgosur të tjerë që kanë qenë në gjendje të mirë shëndetësore dhe është trajtuar njësoj si ata, pavarësisht gjendjes së tij shëndetësore.

14. Duke qenë se ankuesi ka pasur çrregullime mendore, të cilat sa vinin e rriteshin, më 7 janar të vitit 2005 avokati i tij nisi një proces gjyqësor para Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar lirimin ose transferimin e tij (ankuesit) në një institucion mjekësor, për shkak se kushtet e vuajtjes së dënimit ishin të papërshtatshme lidhur me gjendjen e tij shëndetësore dhe përbënin rrezik për jetën e tij. Avokati i ankuesit i kërkoi gjykatës të urdhëronte ekzaminimin e ankuesit nga ekspertë psikiatrikë. Kërkesa bazohej në raportet mjekësore të lëshuara nga profesionistë të cilët e kishin mjekuar ankuesin në periudhën nga maji deri në prill të vitit 2003.

15. Më 11 prill të vitit 2005 Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë e rrëzoi kërkesën si të pabazuar, duke qenë se raporti mjekësor i paraqitur prej avokatit të ankuesit nuk mund të

provonte që kushtet e vuajtjes së dënimit përbënin ndonjë kërcënim për jetën apo për gjendjen e tij shëndetsore.

16. Më 27 shtator të vitit 2005 dhe më 17 shkurt të vitit 2006, respektivisht Gjykata e Apelit Tiranë dhe Gjykata e Lartë lanë në fuqi vendimin e Gjykatës të Shkallës së Parë. Sipas ankuesit, vendimi i Gjykatës së Lartë nuk iu komunikua atij deri më 3 prill të vitit 2006.

17. Më 25 qershor të vitit 2007 Gjykata Kushtetuese rrëzoi kërkesën e ankuesit, me arsyetimin se pretendimet e tij në lidhje me vlerësimin e provave nuk ishin në juridiksionin e saj.

II. LEGJISLACIONI I BRENDSHËM PËRKATËS DHE BURIMET NDËRKOMBËTARE

A. Legjislacioni i brendshëm përkatës

1. Kodi Penal, amenduar me ligjin nr.8204 i datë 10 prill të vitit 1997, ligjin nr.8279 i datë 15 janar të vitit 1998 dhe me ligjin nr.8733 i datë 27 janar 2001

Neni 79

Vrasja me paramendim për shkak të cilësive të veçanta të personit

"Personi që kryen vrasje ndaj: a) një të mituri nën 16 vjeç; ... dënohet me burgim të përjetshëm ose me burgim për një periudhë jo më pak se njëzet vjet."

2. Kodi i Procedurës Penale

Neni 478

Lirimi i të burgosurit

"Gjykata e vendit të ekzekutimit mund të vendosë lirimin e të burgosurit kur vazhdimi i burgimit mund të ketë pasoja për jetën e tij."

B. Materiali përkatës ndërkombëtar

1. Rregullorja Europiane e Burgjeve

18. Materiali përkatës nga rekomandimi i Komitetit të Ministrave Nr. R (87) 3 mbi Rregulloren Europiane të Burgjeve (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 12 shkurt 1987 në takimin 404-të të zëvendësministrave), rishikuar dhe përditësuar me anë të rekomandimit Rec(2006)2 (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 11 janar 2006 në takimin e 952-të të zëvendësministrave), vijon si më poshtë:

" Kujdesi shëndetësor

39. Autoritetet e burgut duhet të garantojnë shëndetin e të gjithë të burgosurve nën kujdesin e tyre.

Organizimi i kujdesit shëndetësor të burgut

40.1 Shërbimet mjekësore në burg duhet të organizohen në përputhje me administrimin e përgjithshëm të shëndetit të komunitetit ose të vendit.

40.2 Politika e shëndetit në burgje duhet të harmonizohet dhe të jetë në pajtim me politikën kombëtare të shëndetit.

40.3 Të burgosurit duhet të kenë akses në shërbimet shëndetësore të vlefshme në një shtet pa diskriminim për shkak të gjendjes së tyre ligjore.

40.4 Shërbimet mjekësore në burg duhet të mundësojnë zbulimin dhe mjekimin e

sëmundjeve fizike dhe mendore ose të anormalive nga të cilat vuajnë të burgosurit.

40.5 Të burgosurve duhet t'u sigurohen të gjitha shërbimet e nevojshme mjekësore, kirurgjikale dhe psikiatrike, duke përfshirë edhe ato shërbime që janë të vlefshme në komunitet.

Sigurimi i kujdesit shëndetësor

46.1 Të burgosurit e sëmurë që kërkojnë trajtim të specializuar, duhet të transferohen në institucione të specializuara ose në spitale civile, kur një trajtim i tillë nuk është i mundur në institucionin e burgut.

46.2 Nëse shërbimi i burgut ka mjediset e tij spitalore, ato duhet të pajisen me personelin dhe mjetet e mjaftueshme për t'i siguruar të burgosurve kujdesin dhe mjekimin e duhur.

Shëndeti mendor

47.1 Burgjet e specializuara apo seksionet nën kontrollin mjekësor duhet të mundësojnë mbikëqyrjen dhe trajtimin e të burgosurve që vuajnë nga çrregullime dhe anormali mendore, të cilët jo domosdoshmërisht përfitojnë nga nenet e rregullit 12.

47.2 Shërbimi mjekësor i burgut duhet të parashikojë trajtimin psikiatrik të të gjithë të burgosurve të cilët kanë nevojë për një shërbim të tillë dhe t'i kushtojë një vëmendje të veçantë parandalimit të vetëvrasjes..."

B. Raporti i Komitetit Europian për parandalimin e torturës dhe trajtimit çnjerëzor dhe degradues (CPT)

19. Një delegacion i CPT-së vizitoi Shqipërinë nga data 28 deri më 31 mars të vitit 2006. Pjesët përkatëse të raportit të datës 6 shtator të vitit 2007 vijojnë si më poshtë (theksuar nga CPT):

11. Në raportin e vizitës së vitit 2005, CPT-ja thekson që, në shumë qendra të paraburgimit ku ka shkuar (në veçanti në Durrës), personat e ndaluar mbaheshin në kushtet e ndalimit që mund të quheshin lehtësisht çnjerëzore dhe degraduese. Në të vërtetë, akumulimi i kushteve materiale të neveritshme, ndalimi me ligj i aktiviteteve brenda qelive dhe pothuajse mungesa e plotë e aktiviteteve jashtë qelive, si dhe kohëzgjatja e tepërt e qëndrimit në këto vende është përshkruar nga Komiteti në bazë të përvojës së tij si të qenurit unike në kuptimin europian.

Përbën problem serioz fakti që nga vëzhgimet e bëra në Durrës, gjatë vizitës në muajin mars të vitit 2006, situata ka ngelur në të vërtetë haptazi e pandryshuar. Gjithashtu duhet të shtohet se situata e konstatuar në Drejtorinë e Policisë në Fier, ishte pothuajse më e favorshme.

Gjatë konsultimeve në nivele të larta me autoritetet shqiptare, pikëpamjet e delegacionit u ndanë me ato të Kryeministrit, i cili pohoi se kushtet e ndalimit në dhomat e paraburgimit ishin një "turp" për Shqipërinë.

Tashmë në këtë fazë, CPT-ja gjithashtu shpreh shqetësimin serioz rreth mungesës së përkujdesjes për një sëmundje të rëndë të një personi të ndaluar, i cili u gjet në qelinë e tij në dhomat e paraburgimit në Drejtorinë e Policisë së Fierit. Ai ishte lënë në një gjendje katastrofike mbi dyshemenë e qelisë së tij për shumë ditë, pa marrë ndonjë ndihmë mjekësore.

Këto çështje do të trajtohen në detaje në seksionet pasardhëse të këtij raporti, por

rëndësia justifikon përmendjen e tyre në këtë seksion mbi keqtrajtimin.

23. Vizita e 2006-tës demonstroi se asnjë nga rekomandimet specifike të përsëritura, bërë në këtë drejtim nga CPT në raportet e vizitave të mëparshme, nuk ishte zbatuar në praktikë, pavarësisht garancive të shprehura për të kundërtën nga autoritetet shqiptare në përgjigjen e tyre për raportin e 2003-it. Veçanërisht, në asnjë nga vendet e vizituara personat e ndaluar rishtazi nuk i ishin nënshtruar ekzaminimit mjekësor në pranim (përjashto rastet e emergjencës ose kërkesat e bëra). Për më tepër, konsultimi/ekzaminimi mjekësor, atëherë kur ishte kryer, akoma kryhej sistematikisht në prani të oficerëve të policisë. Duhet shtuar se në ato pak raste kur dosja mjekësore ishte hapur, atyre u mungonin të dhënat bazë mjekësore dhe zakonisht përdoreshin nga stafi jo mjekësor. Kjo gjendje është totalisht e papranueshme.

24. Për më tepër, asnjë përmirësim nuk ishte bërë lidhur me furnizimin e përgjithshëm për kujdesin mjekësor në çdo institucion të vizituar, pavarësisht nga rekomandimet e bëra nga CPT në raportet e vitit 2003 dhe vitit 2005. Më specifikisht, nuk ishte marrë asnjë hap për të garantuar praninë periodike të stafit të kualifikuar të infermierisë (në një kohë të plotë në Durrës). Është veçanërisht shqetësuese që autoritetet shqiptare në përgjigjen e tyre më 27 qershor 2006, për raportin e vizitës 2005, nuk adresuan rekomandimet e bëra nga Komiteti për këtë çështje.

25. Kujdesi shëndetësor i ofruar në dhomat e paraburgimit në Fier rezulton të jetë veçanërisht problematik dhe, në një numër rastesh, ai nuk ofrohet fare. Për më tepër, kushtet në ambientet e kujdesit për shëndetin ishin të tmerrshme. Delegacioni dëgjoi shumë ankime nga të ndaluarit lidhur me vonesat për të pasur akses te mjeku dhe cilësinë e shërbimit shëndetësor të ofruar; delegacioni vëzhgoi vetë në vend rastin e një të ndaluari në nevojë urgjente për trajtim mjekësor, i cili ishte lënë në një gjendje braktisjeje të plotë.

Sikurse është përmendur në paragrafin e 11, një i ndaluar i sëmurë mendor u gjet i shtrirë në një gjendje të tmerrshme mbi dyshemenë e një qelie të mbipopulluar, poshtë një tubi rrjedhës të ujërave të zeza, pa marrë asnjë kujdes mjekësor. Me sa dukej, ai ndodhej në këtë gjendje për disa ditë. Një ekzamimin fizik nga një prej anëtarëve të delegacionit konstatoi se këmba e tij e djathtë kishte ngjyrë të theksuar të kuqe dhe ishte e enjtur, që shkakonte dhimbje kur e prekje. Sipas personave që ndodheshin në të njëjtën dhomë me të, ai kishte pësuar këtë dëmtim pak ditë më parë, kur kishte rënë në dysheme në ambientet sanitare (në të cilat ai dërgohet nga të ndaluarit e tjerë).

Pas konsultimeve me stafin dhe shokët e tij të qelisë, rezultoi se i ndaluari kishte qenë i shtruar në spital për shkak të çrregullimeve të rënda nervore dhe ishte kthyer në qendrën e ndalimit dy javë përpara vizitës. Kushtet e tij shëndetësore rezultonin të ishin të qëndrueshme për dy ditët e para të kthimit të tij, por që ishin përkeqësuar në mënyrë drastike më vonë, mesa duket në sajë të faktit se ai nuk kishte marrë mjekimin e përshkruar nga spitali.

Kur u ballafaqua me këtë rast, mjeku pretendoi se ai e kishte vizituar këtë të burgosur, por nuk ishte në gjendje të jepte ndonjë informacion lidhur me kushtet e tij shëndetësore ose trajtimin e dhënë.

Kur u pyet për vendndodhjen e dosjes mjekësore të të ndaluarit të sipërpërmendur, si edhe të të ndaluarve të tjerë, mjeku konfirmoi se dosje të tilla kishte për çdo të burgosur, por pretendoi se nuk kishte çelësin e raftit, ku u tregua se mbaheshin këto dosje. Pas një vonese të konsiderueshme, çelësi u gjet nga një oficer policie, dhe u konstatua se aty nuk kishte asnjë

dosje mjekësore personale të vetme.

I vetmi dokumentacion mjekësor i disponueshëm ishte regjistri i vizitave të mjekut dhe shënimi i fundit ishte në nëntor 2005. Shpjegimi mjekut për këtë gjendje ishte se "ai nuk kishte shënuar ndonjë gjë, pasi nuk kishte marrë asnjë ilaç për të rekomanduar që nga ajo kohë".

20. Vizita e mëparshme e delegacionit të CPT-së në Shqipëri u realizua nga data 23 maj deri në datën 3 qershor të vitit 2005. Delegacioni kontrolloi, *inter alia*, spitalin e burgut të Tiranës. Pjesët përkatëse të raportit të CPT-së të datës 2 korrik 2006 vijojnë si më poshtë (theksuar nga CPT-ja):

"61. Kushtet materiale të ndalimit ishin të tmerrshme në qendrat e paraburgimit të vizituara. Shumë prej të ndaluarve mbaheshin në kushte të mbipopulluara (për shembull, në Vlorë rezultonin mbi shtatë persona në një qeli prej 5 m^2, ndërsa në Durrës mbi 10 persona në një qeli prej 8 m^2). Qelitë ishin të furnizuara vetëm me dyshekë prej sfungjeri dhe/ose batanije. Për më tepër, aksesi në ndriçimin natyral ishte shumë i kufizuar dhe ajrimi ishte jashtëzakonisht i varfër.

Kushtet më të rënda u konstatuan në Durrës, ku personave të ndaluar nuk u ishin siguruar as dyshekë dhe as skelete krevatesh. Për më tepër, disa prej të ndaluarve ishin vendosur në dy dhoma depo, të cilat ishin mbushur me ushqime të paketuara, të destinuara për të gjithë personat e ndaluar. Disa prej personave të ndaluar u gjetën në gjendje "mpirjeje", dhe delegacioni u informua se të ndaluarve u kishte rënë herë pas here të fikët si rezultat i temperaturave jashtëzakonisht të larta dhe nivelit të lartë të lagështirës. Nuk është për t'u çuditur që shumë prej personave të ndaluar vuanin nga sëmundjet e lëkurës dhe/ose nga problemet e frymëmarrjes. Gjithashtu është shqetësues fakti që shumë prej personave të ndaluar ishin mbajtur në këto institucione për shumë vite.....

108. Gjatë vizitës vijuese në spitalin e burgut në Tiranë delegacioni u fokusua kryesisht në gjendjen psikiatrike të pacientëve. Ai gjithashtu rishikoi masat e marra nga autoritetet shqiptare nën dritën e rekomandimeve të bëra pas vizitës së vitit 2000 përsa i përket spitalit të burgut në përgjithësi. ...

110. Kushtet materiale në spitalin e burgut ishin përmirësuar dukshëm qysh prej vizitës së vitit 2000. Të gjitha qelitë ishin me përmasa të arsyeshme, kishin një akses të mirë përsa i përket ndriçimit natyral dhe artificial, dhe ishin të mirëpajisura (me krevate, komodinë, tavolinë, karrige, radio). Megjithatë, u konstatua që shërbimi sanitar ishte në një gjendje shumë të varfër fizike dhe higjiene. CPT-ja rekomandon që duhet të merren hapa për të korrigjuar pamjaftueshmëritë.

111. CPT-ja mbetet e shqetësuar rreth mungesës së plotë të aktiviteteve jashtë qelisë për pacientët e spitalit të burgut.

Përsa i takon pacientëve të cilët janë deklaruar të papërgjegjshëm penalisht, asnjë aktivitet jashtë qelisë nuk ishte organizuar për ta, ndërsa ushtrimet në ambientet e jashtme të burgut ishin siguruar në mënyrë jo sistematike, jo të përjavshme dhe çdo herë, për më pak se një orë.

Për më tepër, nuk i jepej mundësia të kryenin ushtrime në ambientet e jashtme apo çdo aktivitet tjetër jashtë qelisë çdo pacienti tjetër. Kështu që, përveç aksesit në shërbimet sanitare, pacientët ishin zakonisht të izoluar në dhomat e tyre 24 orë në ditë, dhe e vetmja

mënyrë për të shpenzuar kohën ishte të lexoje ose të dëgjoje radion. Gjithashtu, spitali nuk kishte as librari.

Në një shtet probleme të tilla janë tërësisht të papranueshme dhe përbëjnë një mospëmbushje flagrante nga ana e autoriteteve shqiptare të rekomandimeve të cilat tashmë janë bërë që mbas vizitës së vitit 2007 dhe janë përsëritur gjatë vizitave periodike në spitalin e burgut.

CPT-ja u bën thirrje autoriteteve shqiptare të marrin masat e menjëhershme për t'u garantuar të gjithë pacientëve, që në kartelat e tyre mjekësore të mundësohet të paktën një orë në ditë ushtrime në ambientin e jashtëm.

Për më tepër, rithekson rekomandimin e tij që pacientëve afatgjatë në spitalin e burgut t'u mundësohet një gamë e gjerë aktivitetesh, si dhe t'u kushtohet një vëmendje e veçantë të miturve që vuajnë dënime të gjata.

112. CPT-ja mirëpret fuqizimin aktual të spitalit të burgut me personel mjekësor (dy doktorë shtesë dhe një psikolog). Delegacioni u informua që sipas programeve në zbatim e sipër, do të rritej numri i personelit të infermierisë. CPT-ja do të dëshironte që të mbahej e informuar sa i takon çështjes në fjalë.

113. Përsa i përket trajtimit të parashikuar për pacientët, situata në tërësi nuk ka ndryshuar. Ashtu si në vitin 2000, mjekimi psikiatrik është bazuar në përgjithësi në farmakoterapinë. Nuk kishte programe për trajtim individual apo psikoterapi individuale, terapi profesionale apo terapi në grup. Në këtë pikëpamje, CPT-ja dëshiron të nënvizojë sërish se mjekimi psikiatrik duhet të bazohet në trajtimin individual, i cili nënkupton hartimin e një plani konkret trajtimi për çdo pacient, duke përcaktuar qëllimin e mjekimit, kuptimin e terapisë së përdorur dhe anëtarët e personelit përgjegjës. Plani i trajtimit duhet të përmbajë gjithashtu rezultatin e rishikimit të herëpashershëm të kushteve të shëndetit mendor të pacientit dhe një rishikim të mjekimit të pacientit. Trajtimi duhet të përmbajë një gamë të gjerë aktivitetesh rehabilituese dhe terapeutike në mjekimin e pacientit, duke përfshirë aksesin në terapinë e specializuar, terapinë në grup, psikoterapinë individuale dhe sportet. Veç kësaj, pacientët duhet të kenë akses të rregullt në dhoma çlodhëse të përshtatshme; gjithashtu këshillohet mundësimi i arsimimit dhe punës së përshtatshme (shih paragrafin 111).

CPT-ja rithekson rekomandimin e saj, që trajtimi psikiatrik i ofruar pacientëve në spitalin e burgut të rishikohet në dritën e vërejtjeve të lartpërmendura.

114. Përsa i përket kontaktit me botën e jashtme, është për t'u lavdëruar fakti që tani pacientët kanë akses të rregullt në shërbimin telefonik (një herë në javë). Përsa i përket vizitave, të drejtat e pacientëve ishin të njëjta me ato të personave që vuanin dënimin në burg. Në këtë pikë, do t'i referohemi vërejtjeve dhe rekomandimeve të bëra në paragrafin 136.

115. CPT-ja vëren se, qysh prej fillimit të vitit 2005, pacientët e acaruar[1] nuk mbaheshin për shumë kohë në krevatet e tyre të izoluar me pranga në duar dhe në kyçet e këmbës. Për më tepër, u vu re se mjetet shtrënguese dhe izoluese nuk ishin të tepruara (shirita lëkure, mjekim qetësues). Megjithatë, nuk mbaheshin regjistra të veçantë për kufizimin/shtrëngimin. Duhet të merren masa për të ndrequr këtë mangësi.

116. Konfidencialiteti i ekzaminimeve/konsultimeve dhe i të dhënave mjekësore nuk respektohej në të gjitha spitalet e burgut. Në këtë pikë do t'u referohemi vërejtjeve dhe

[1] Persona me aktivitet psikomotor tepër të zhvilluar, shoqëruar me tension të lartë dhe nervozizëm.

rekomandimeve të bëra në paragrafin 127.

117. Personat që janë deklaruar të papërgjegjshëm penalisht i nënshtroheshin masave të detyruara të vendosjes në një institucion për një kohë të pacaktuar. Në këto raste, neni 46 i Kodit Penal parashikon që domosdoshmëria e kësaj vendosjeje duhet të rishikohet nga gjykata *ex offico* pas një viti. Megjithatë, delegacioni u informua se ky rishikim gjyqësor nuk është ndërmarrë në asnjë rast *ex officio*, por vetëm me iniciativë të personave të interesuar ose të avokatit.

CPT-ja i bën thirrje autoriteteve shqiptare të marrin masat e menjëhershme për të garantuar që procedura e rishikimit sipas nenit të 46 të Kodit Penal të ndërmerret përsa i përket të gjithë personave që janë deklaruar të papërgjegjshëm penalisht.

C. Raporti i Amnesty International i vitit 2007 përsa i përket gjendjes të së drejtave të njeriut

21. Përsa i përket gjendjes së të drejtave të njeriut në burgjet e Shqipërisë, raporti i Amnesty International i vitit 2007 konstatoi:

"Kushtet e ndalimit

Përveç programit të mbështetur nga BE-ja për reformën e burgjeve dhe disa përmirësimeve në kushtet e ndalimit, këto ishin në përgjithësi shumë të varfra dhe karakterizoheshin nga mbipopullimi, higjenë e varfër dhe kushte sanitare, dietë dhe kujdes mjekësor i papërshtatshëm. Në kundërshtim me legjislacionin shqiptar dhe standardet ndërkombëtare, të miturit mbaheshin shpeshherë së bashku me të ndaluarit e rritur dhe ata të arrestuar së bashku me personat e dënuar në të njëjtën qeli. Të burgosurit e sëmurë mendërisht mbaheshin shpeshherë në burg, në vend që të dërgoheshin për trajtim mjekësor në institucionet e specializuara në përputhje me vendimin e gjykatës. Të ndaluarit që mbaheshin në dhomat e paraburgimit në rajonet e policisë, vuanin në veçanti nga kushtet shumë të rënda, kryesisht sa i takon mbipopullimit në rajonet e policisë në Durrës, Elbasan dhe Korçë".

LIGJI

1. SHKELJA E PRETENDUAR E nenit 3 TË KONVENTËS

22. Pa u bazuar në asnjë prej neneve të Konventës, ankuesi u ankua për papërshtatshmërinë e trajtimit të tij mjekësor, si dhe duke iu referuar raportit të CPT-së mbi burgjet shqiptare në përgjithësi, për kushtet e vuajtjes së dënimit në raport me gjendjen e tij shëndetësore.

23. Në vëzhgimet e datës 22 maj të vitit 2007 ankuesi kundërshtoi papërshtatshmërinë e kushteve të ndalimit në qelitë e qendrës së paraburgimit në rajonin e policisë në Durrës nga gushti i vitit 2002 deri në dhjetor të vitit 2003.

24. Gjykata vlerëson se, pavarësisht faktit që ankuesi nuk u bazua shprehimisht në nenin 3 të Konventës, pretendimet e tij do të shqyrtohen në përputhje me këtë nen. Pala shqiptare (Qeveria) në vëzhgimet e saj kërkoi që të shqyrtohej sipas këtij neni. Neni 3 vijon si më poshtë:

"Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, as dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore, ose poshtëruese.".

A. Pranueshmëria

25. Qeveria i kundërshtoi argumentet e ankuesit. Ata pretenduan se ankuesi nuk kishte parashtruar ankesat e tij para gjykatave të brendshme dhe se kjo pjesë e aplikimit duhet të deklarohej e papranueshme për mosshterim të mjeteve jurdike të brendshme.

26. Ankuesi pretendoi se ankesat e tij të përsëritura përpara gjykatave të brendshme kompetente ishin hedhur poshtë dhe se aktualisht ai ishte duke vuajtur dënimin në të njëjtin vend si të burgosurit e tjerë që ishin në gjendje të mirë shëndetësore. Ai pohoi se ankesat e tij ishin bazuar në një problem strukturor të sistemit ndëshkimor të Shqipërisë, pasojë e të cili është mungesa e institucioneve kompetente për të garantuar kushtet e përshtatshme të ndalimit dhe trajtimin mjekësor të domosdoshëm për njerëzit me gjendje shëndetësore të ngjashme. Si pasojë, ankimet e tij do të kishin qenë joefektive në praktikë, edhe nëse do të ishin të suksesshme në nivel të brendshëm.

27. Gjykata vëren se në fillim, ankuesi i ishte drejtuar gjykatës me ankimin e tij rreth kushteve të ndalimit në dhomat e paraburgimit (nga gushti i vitit 2002 deri në dhjetor të vitit 2003), në 22 maj të vitit 2007, pra pas afatit gjashtëmujor të parashikuar nga Konventa. Në këto rrethana ky ankim u refuzua pasi ishte depozituar jashtë afatit prekluziv gjashtëmujor në përputhje me nenet 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

28. Përsa i takon pjesës tjetër të ankimit në bazë të këtij neni, që i referohet papërshtatshmërisë së kushteve të vuajtjes së dënimit dhe trajtimit mjekësor që ankuesi ka marrë, gjykata vëren se kjo rezulton nga dosja e tij, ku pasi u dënua, ai u vendos në një qeli me të burgosur të tjerë. Kur gjendja e tij u përkeqësua, ai u transferua në spitalin e burgun në Tiranë, ku mori trajtimin si pacient. Avokati i ankuesit, duke marrë shkas nga kushtet e rënda të vuajtjes së dënimit në burgun e sigurisë së lartë, u kërkoi gjykatave të brendshme, por pa rezultat, të lirojnë ankuesin nga burgu dhe/ose të urdhërojnë shtrimin e tij në një institucion të specializuar mjekësor. Në këtë mënyrë, ankuesi nuk mund të qortohet për mosshterim të mjeteve të brendshme juridike.

29. Për më tepër, gjykata dëshiron të konstatojë se pala shqiptare nuk ka treguar përshtatshmërinë e mjeteve juridike të referuara për realizimin e pretendimeve të ankuesit. Në veçanti, pala shqiptare nuk ka përmendur vendime të gjykatave të brendshme, ku të tregohet se inidvidëve të ndodhur në të njëjtën situatë si të ankuesit, iu është siguruar transferimi nga një burg në një institucion të specializuar për trajtimin e sëmundjeve mendore. Rrjedhimisht, kundërshtimi i tyre nuk pranohet.

31. Duke marrë parasysh vlerësimet e mësipërme, Gjykata vëren se ankimi në lidhje me kushtet e vuajtjes së dënimit dhe trajtimin mjekësor që ka marrë ankuesi gjatë kohës që ka qenë në burg, nuk janë haptazi të pabazuara brenda kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës. Për më tepër, Gjykata vëren se ato nuk janë të papranueshme për ndonjë arsye tjetër. Kështu që kjo pjesë e ankimit duhet të deklarohet e pranueshme.

B. Themeli

1. Parashtrimet e palëve

31. Ankuesi argumentoi se ai ishte duke vuajtur dënimin në një burg, ku kushtet e vuajtjes së dënimit nuk ishin ato që parashikohen për një person me gjendjen e tij shëndetësore. Për më tepër, ai tregoi se neglizhenca e autoriteteve, përsa i përket mostrajtimit me ilaçet e rekomanduara nga doktorët specialistë, përbën shkelje të të drejtave të tij në përputhje me Konventën.

32. Pala shqiptare, duke veçuar ndjenjat subjektive të ankuesit, kundërshtoi që pretendimi mbi trajtimin e përfituar në nivelin minimal të vuajtjes së dënimit të papërshtatshëm me atë të kërkuar, të jetë brenda kuptimit të nenit 3. Së pari, ata pohuan se, nën dritën e dëshmive mjekësore të paraqitura përpara gjykatës, nuk kishte dyshim që autoritetet përkatëse kishin monitoruar me vëmendje dhe në mënyrë të vazhdueshme gjendjen shëndetësore të ankuesit dhe i kishin siguruar ndihmën e duhur mjekësore në përputhje me gjendjen e tij shëndetësore.

33. Pala shqiptare parashtroi që kushtet e vuajtjes së dënimit në burgjet shqiptare duhen trajtuar në të njëjtin këndvështrim si ato të vendeve të tjera anëtare, të cilat janë duke reformuar sistemin e tyre ligjor. Në të vërtetë, qysh prej vizitës së CPT-së në Shqipëri në vitin 1990, është arritur një zhvillim pozitiv dhe kushtet e vuajtjes së dënimit janë përmirësuar. Për më tepër, ata parashtruan se kushtet në të cilat të burgosurit si ankuesi vuanin dënimin, duhen vlerësuar në raport me situatën ekonomike të shtetit dhe standardet e jetesës në vend.

34. Së fundi ata pohuan në veçanti se, duke qenë se gjykatat e brendshme e kishin deklaruar ankuesin të përgjegjshëm penalisht për veprat penale të kryera, kushtet e vuajtjes së dënimit të tij ishin të përshtatshme me gjendjen e tij shëndetësore dhe të njëjta me standardet e aplikuara ndaj të burgosurve të tjerë. Pala shqiptare parashtroi raportet mjekësore mbi gjendjen shëndetësore të ankuesit, të cilat i referoheshin trajtimit të tij mjekësor gjatë periudhës së qëndrimit të tij në burg dhe në spitalin e burgut. Këto raporte pasqyronin faktin se ankuesi ishte trajtuar me ilaçe të njëjta me ato të rekomanduara nga mjeku i përgjithshëm dhe se pranimi i tij në një institucion të specializuar, brenda sistemit të burgut, varej nga struktura e këtyre institucioneve në të ardhmen.

2. Vlerësimet e Gjykatës

a) Parime të përgjithshme

35. Në fillim, Gjykata përsëriti se neni 3 i Konventës përmban një nga vlerat më themelore të shoqërisë demokratike. Ai i ndalon absolutisht termat e torturës dhe trajtimin e dënimin çnjerëzor dhe johuman, pavarësisht nga rrethanat dhe sjellja e viktimës (shih *Van der Ven v. Netherlands*, no.50901/99 § 46, ECHR 2003-II, dhe *Poltoratskiy v. Ukraine*, no. 38812/97, § 130, ECHR 2003- V).

36. Gjykata rithekson se, sipas jurisprudencës së saj, trajtimi i sëmundjes duhet të prekë nivelin minimal të kushteve të vuajtjes së dënimit, në mënyrë që të jetë brenda kuptimin të nenit 3 të Konventës. Vlerësimi i këtij niveli minimal të vuajtjes së dënimit është relativ: ai varet nga të gjitha rrethanat e çështjes, siç është kohëzgjatja e trajtimit, efektet e tij fizike dhe mendore dhe në disa raste varet nga seksi, mosha dhe gjendja shëndetësore e viktimës (shih *Kudla v. Poland* [GC], no. 30210/96, § 91, ECHR 2000-XI: *Mouisel v. France*, no 67263/01, § 37, ECHR 2002-IX; dhe *Papon v. France* (no.1) (dec.), no. 64666/01, ECHR 2001-VI).

37. Gjykata e konsideron trajtimin si "çnjerëzor", sepse, *inter alia*, ishte i paramenduar, ishte përdorur me orë të zgjatura duke shkaktuar ose dëmtime të dukshme trupore ose vuajtje të mëdha fizike dhe mendore. Gjithashtu mendohet se trajtimi është degradues, sepse ishte i tillë sa i shkaktoi viktimës ndjenja frike, ankth dhe inferioritet si pasojë e poshtërimit dhe përuljes (shih Kudla, të cituar më sipër). Problemi, nëse qëllimi i këtij trajtimi ishte për ta përulur dhe poshtëruar viktimën, është një faktor i mëtejshëm që do të merret parasysh, por mungesa e këtij qëllimi nuk mund të përjashtojë përfundimisht

shkeljen e nenit 3 (shih *Peers v. Greece*, no. 28524/95, § 74, ECHR 2001-III; *Kalashnikov v. Russia*, nr.47095/99, § 101, ECHR 2002-VI dhe *Ramirez Sanchez v. France* [GC], no. 59450/00, § 119, ECHR 2006-...)

38. Vuajtja dhe poshtërimi i shkaktuar duhet të shkojnë përtej elementit të paevitueshëm të vuajtjes dhe poshtërimit, që rrjedh nga një trajtim ose dënim i ligjshëm. Masat kufizuese të lirisë së një personi shpeshherë përfshijnë elemente të tilla. Akoma nuk mund të thuhet nëse ndalimi/dënimi në vetvete ngre një çështje sipas nenit 3. Megjithatë sipas këtij neni, shteti duhet të garantojë që një person të dënohet në kushtet të cilat janë në pajtim me dinjitetin njerëzor, që mënyra apo metoda e ekzekutimit të këtyre masave të mos e nënshtrojnë atë ndaj ankthit apo mundimit të një intensiteti të tillë që e kapërcen nivelin e pashmangshëm të vuajtjes e cila është prezent në burg, dhe sipas kërkesave praktike të burgimit të sigurohen në mënyrë të përshtatshme shëndeti dhe mirëqenia e tij. Kur vlerësohen kushtet e vuajtjes së dënimit, duhet të merren parasysh efektet që kanë pasur në tërësi kushtet dhe kohëzgjatja e dënimit (*shih Dougoz v. Greece*, no. 40907/98, § 46, ECHR 2001-II, dhe *Kalashnikov* i cituar më sipër, § 102). Në veçanti, Gjykata duhet të ketë parasysh gjendjen shëndetësore të personit të dënuar (shih *Assenov and Others v. Bulgaria*, vendim i datës 28 tetor 1998, *Raporte të vendimeve dhe gjykimeve* 1998-VIII, fq. 3296, § 135: Kudla, cituar më sipër, § 94 dhe *Ramirez Sanchez*, cituar më sipër, § 119).

39. Një faktor i rëndësishëm, përsa i përket kushteve materiale, është regjimi i vuajtjes së dënimit. Në vlerësimin nëse një regjim kufizues mund të përbëjë një trajtim në kundërshtim me nenin 3, në rastin konkret duhet të kihen parasysh kushtet e veçanta, rreptësia e regjimit, kohëzgjatja e tij, qëllimi i ndjekur dhe efektet e tij në lidhje me personin (shih *Messina v. Italy* (dec), no. 25498/94, ECHR 1999-V; *Van der Ven, cituar* më lart, § 51; *Iorgov v. Bullgaria*, no. 40653/98, §§ 82-84 dhe 86, 11 mars 2004; dhe G.*B v. Bulgaria*, no.42346/98, §§ 83-85 dhe 87, 11 mars 2004).

40. Kështu që Gjykata shqyrtoi, *inter alia*, nëse është në pajtim me nenin 3 që personat në vijim të dënohen në kushte të cilat nuk janë të përshtatshme duke u nisur nga gjendja e tyre mendore dhe fizike: personat që vuajnë nga një çrregullim mendor (shih *Kudla*, të cituar më sipër dhe *Keenan v. the United Kingdom*, no. 27229/95, ECHR 2001-III) ose nga një sëmundje serioze (shih Mouisel, cituar më sipër, dhe *Matencio v. France*, no. 58749/00, 15 janar 2004; dhe *Sakkopoulos v. Greece*, no. 61829/00, 15 janar 2004), të paaftët (shih *Price v. the United Kingdom*, no. 33394/96, ECHR 2001-VII) të moshuarit (shih Papon (dec), cituar më sipër) ose narkomanët të cilët vuajnë nga simptoma veçimi (shih *McGlinchey and Others v. the United Kingdom*, no. 50390/99, ECHR 2003-V).

41. Megjithatë neni 3 i Konventës nuk mund të interpretohet në mënyrë të tillë që të parashikojë një detyrim të përgjithshëm për lirimin e të dënuarve nisur nga shkaqet shëndetësore, por ky nen u vë detyrimin shteteve për të mbrojtur mirëqenien fizike të personave me liri të kufizuar, për shembull duke u dhënë atyre ndihmën e duhur mjekësore (shih Hurtado v. Zvicrës, vendim i datë 28 janar 1994, Seria A no.280-A, Opinioni i Komisionit, pp. 15-16, § 79. Mungesa e kujdesit të duhur mjekësor mund të çojë në një trajtim në kundërshtim me nenin 3 (shih Ilhan v. Turkey [GC], no, 22277/93, § 87, ECHR 2000-VII; Naumeko v. Ukraine, no. 42023/98, § 112, 10 shkurt 2004; dhe Farbtuhs v. Latvia, no, 4672/02, § 51, 2 dhjetor 2004). Në veçanti, në vlerësimin nëse kushte të caktuara të

vuajtjes së dënimit janë të papajtueshme me standardet e nenit 3, duhet të merret në konsideratë, në rastin e personave të sëmurë mendërisht, paaftësia dhe cenueshmëria e tyre, si dhe në disa raste, ankimi në mënyrë koherente apo në përgjithësi rreth faktit se sa janë ndikuar ata nga trajtime të caktuara (për shembull, shih, Herczegfalvy v. Austria, vendim i datës 24 Shtator 1992, Seria A no.244, pp. 25-26, § 82, dhe Aerts v. Belgium, vendim i datës 30 korrik 1998, Raportet 1998-V, p. 1966, § 66).

42. Tri janë elementet e veçanta të cilat duhet të merren parasysh në lidhje me pajtueshmërinë e gjendjes së ankuesit për sa i takon me qëndrimit të tij në burg: a) kushtet mjekësore të të burgosurit; b) përshtatshmëria e ndihmës dhe e përkujdesit mjekësor të parashikuar në burg dhe c) garantimi i masave të burgimit në përputhje me gjendjen shëndetësore të ankuesit (shih *Mouisel,* cituar më sipër, §§ 40-42, dhe *Melnik v. Ukraine,* no. 72286/01, §94, 28 mars 2006).

b) Zbatimi i këtyre parimeve në çështjen konkrete

43. Gjykata konsideron se shqetësimi i ankuesit, në bazë të këtij neni, që do të thotë pamjaftueshmëria e kushteve të vuajtjes së dënimit dhe trajtimi mjekësor i papërshtatshëm që ka marrë gjatë kohës së qëndrimit në burg, kanë lidhje me të njëjtat aspekte të Konventës. Kështu që Gjykata duhet të shqyrtojë themelin e të dyja pretendimeve së bashku.

44. Gjykata vëren se palët kanë rënë dakord që ankuesi ka vuajtur nga një çrregullim mendor kronik, i cili përfshinte episode psikotike dhe ndjenja paranoje. Historia e ndalimit të tij në ambientet e dhomave të paraburgimit në rajonin e policisë në Durrës dhe më pas në burgun e sigurisë së lartë në Peqin nga viti 2002 e më tej, tregojnë se kushtet e tij ishin përkeqësuar nga koha që kishte marrë trajtim si pacient në spitalin e burgut në Tiranë. Në veçanti, përgjatë pesë viteve të burgimit, ankuesi kishte marrë trajtim mjekësor si pacient në spitalin e burgut në Tiranë nga 26 maji i vitit 2004 deri në 2 gusht të vitit 2004 dhe nga 1 dhjetori i vitit 2004 deri në 26 janar të vitit 2005.

45. Sipas autoriteteve, nisur nga pamundësia e sigurimit të trajtimit të duhur mjekësor për ankuesin, për shkak të mungesës së institucioneve përkatëse dhe medikamenteve (shih paragrafin 34 më sipër), ai ishte trajtuar me ilaçe të ngjashme me ato të rekomanduara nga mjeku i tij dhe deri në ngritjen e një institucioni psikiatriko-penal të specializuar, ai ishte vendosur në një qeli me ajrim dhe me ndriçim të mirë, në një burg të sigurisë së lartë, të cilën ai e ndante më të burgosur të tjerë, të cilët ishin në gjendje të mirë shëndetësore. Ai kishte marrë trajtim si pacient i spitalit të burgut të Tiranës vetëm kur gjendja e tij ishte përkeqësuar.

46. Babai dhe avokati i ankuesit paraqitën një sërë ankesash para autoriteteve kompetente kundër administratës së spitalit të burgut dhe repartit mjekësor, duke pretenduar që ata kishin neglizhuar duke mos arritur të rekomandojnë trajtimin e përshtatshëm mjekësor dhe se gjendja e tij ishte përkeqësuar për shkak të mungesës së trajtimit dhe ekzaminimit mjekësor. Megjithatë, të gjitha ankesat e tyre nuk u morën parasysh. Në të vërtetë, Gjykata vëren se vlerësimi i fundit mbi gjendjen shëndetësore të ankuesit daton përpara vitit 2002. Të dhënat mjekësore mbi ankuesin tregojnë se atij vazhdueshmërisht i është rekomanduar i njëjti trajtim dhe se nuk është bërë asnjë përshkrim i detajuar mbi zhvillimin e sëmundjes së tij.

47. Gjykata konsideron se fakti që ankuesi ishte deklaruar i përgjegjshëm penalisht për konsumimin e elementeve të veprës penale të vrasjes dhe ishte dënuar me burgim të përjetshëm nuk është vendimtar për sa i përket çështjes, nëse autoritetet i kishin përmbushur

detyrimet e tyre sipas nenit 3 për ta mbrojtur atë nga një trajtim apo dënim në kundërshtim me këtë nen. Në të vërtetë, ndjenja e inferioritetit dhe pafuqishmëria, e cila është tipike për personat të cilët vuajnë nga çrregullime mendore, kërkon një vëmendje të madhe për të parë nëse Konventa është respektuar. Ndërkohë që është detyrë e autoriteteve të vendosin mbi bazën e rregullave të njohura të shkencës së mjekësisë, në lidhje me metodat terapeutike që duhet të përdoren për të trajtuar gjendjen fizike dhe mendore të personave të paaftë për të vendosur për veten e tyre dhe për të cilët këto autoritete janë të përgjegjshme, sërish këta persona mbeten nën mbrojtjen e nenit 3, kërkesat e të cilëve nuk e lejojnë përjashtimin nga ky nen.

48. Gjykata pranon që natyra e kushteve psikologjike të ankuesit e bëri atë më shumë të prekshëm sesa mesatarja e të dënuarve të tjerë dhe se burgimi i tij mund të ketë acaruar në një nivel të caktuar ndjenjat e tij të ankthit, vuajtjes dhe frikës. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se fakti që pala shqiptare e pranoi që ankuesi ishte trajtuar si të burgosurit e tjerë, pavarësisht gjendjes së tij shëndetësore të veçantë, tregon mungesën e angazhimit të tyre për përmirësimin e kushteve të vuajtjes së dënimit në pajtim me rekomandimet e Këshillit të Europës (shih paragrafin 18 më sipër). Në vendimet e fundit, Gjykata ka tërhequr vëmendjen lidhur me rëndësinë e këtyre rekomandimeve, pavarësisht natyrës së tyre jo të detyrueshme për shtetet anëtare (shih *Rivière v. France*, nr 33834/03, § 72, 11 korrik 2006, dhe *Naumenko v. Ukraine*, cituar më sipër, § 94).

49. Për më tepër, Gjykata vëren se pala shqiptare nuk ka dhënë informacion të detajuar rreth kushteve materiale të vuajtjes së dënimit të ankuesit, edhe të tregojë se, pavarësisht qëndrimit të tij në një burg të sigurisë së lartë, këto kushte ishin përshtatshme për një person me një të kaluar të tillë përsa i takon çrregullimit mendor. Gjithashtu, Gjykata konsideron se vizitat e rregullta të ankuesit në spitalin e burgut nuk mund të shihen si një zgjidhje, për sa kohë që ankuesi është duke e vuajtur një dënim me burgim të përjetshëm.

50. Gjykata nuk e nënvlerëson rëndësinë e vështirësive financiare të referuara nga pala shqiptare (shih paragrafin 33 më sipër). Megjithatë, ajo vëren se shumë prej mangësive të identifikuara më sipër mund të ishin ndrequr edhe në mungesën e mjeteve financiare të konsiderueshme. Në çdo rast, mungesa e burimeve financiare nuk mundet të justifikojë kushte të tilla vuajtje dënimi, të cilat janë kaq të varfra sa prekin nivelin minimal të vuajtjes së dënimit të parashikuar nga neni 3, duke bërë që ai të zbatohet në këtë rast, (shih P*oltoratskly*, § cituar më sipër, dhe *Iovchev v. Bulgaria*, no.41211/98, § 136, 2 shkurt 2006).

51. Duke pasur parasysh efektet në tërësi të të gjitha kushteve të papërshtatshme të vuajtjes së dënimit, të cilave iu ishte nënshtruar ankuesi, të cilat kishin pasur efekt të dëmshëm në shëndetin dhe mirëqenien e tij (shih Kalashnikov, cituar më sipër, § 98), konstatimet e CPT-së në raportet më të fundit në lidhje me kushtet e vuajtjes së dënimit në burgjet shqiptare, në veçanti për sa i përket të burgosurve të sëmurë mendërisht (shih paragrafet 19-20 më sipër), dhe precedentin e saj në këtë fushë (shih paragrafin 41 më sipër), Gjykata konsideron se natyra, kohëzgjatja dhe vuajtja e dënimit sa i takon keqtrajtimit të të cilit ankuesi i ishte nënshtruar, si dhe efektet që kanë pasur në tërësi mbi gjendjen e tij shëndetësore, janë të mjaftueshme për t'u kualifikuar si çnjerëzore dhe degraduese (shih Egmez v. Cyprus, no. 30873/96, § 77, ECHR 2000-XII; Labzov v. Russia, no. 62208/00, § 45, 16 qershor 2005; dhe *Mayzit v. Russia*, no. 63378/00, § 42, 20 janar 2005).

52. Pra është shkelur neni 3 i Konventës.

II. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

A. Parashtrimet e palëve

53. Duke u mbështetur në nenin 6 §1 të Konventës, ankuesi ankohet për parregullsinë e proceseve në lidhje me kërkesën e tij për lirimin nga burgu ose mbylljen në një institucion të specializuar të përshtatshëm për gjendjen e tij shëndetësore. Në veçanti, ai u ankua që gjykatat e brendshme nuk i kishin dhënë atij një mundësi për t'u kontrolluar nga një psikolog i pavarur dhe i paanshëm, i cili do të përcaktonte natyrën e këtij çrregullimi mendor, duke e vendosur atë në një situatë të disfavorshme përballë prokurorit dhe duke mos respektuar parimin e barazisë së mjeteve.

54. Pala shqiptare e kundërshtoi këtë argument. Ata parashtruan se ankuesi kishte pasur mundësinë për të provuar se kushtet e vuajtjes së dënimit të tij kishin kërcënuar jetën e tij. Në parashtrimet e tyre, pretendimet e ankuesit lidhur me rezultatin e proceseve në fjalë duhet të mos pranohen nga Gjykata, pasi nga vetë natyra e tyre i përkasin një instance të shkallës së katërt.

B. Vlerësimi i Gjykatës

55. Gjykata rikujton precedentin e qëndrueshëm të mekanizmave të Konventës, përsa i përket përfundimit që proceset në lidhje me ekzkekutimin e një dënimi, të dhëna nga një gjykatë kompetente, duke përfshirë edhe proceset e dhënies së një lirimi me kusht, nuk hyjnë në qëllimin e nenit 6 § 1 të Konventës. Sipas këtij neni nuk mund të jepet një përcaktim, as për një "akuzë penale" dhe as lidhur me "të drejtat dhe detyrimet civile" (shih, përshembull, Aldrian v. Austria, no. 16266/90, vendim i Komisionit i datës 7 maj 1990, Vendime dhe raporte (DR) 65, p.337; A.B v. *Sëitzerland*, no. 20872/98, vendim i Komisionit i datës 22 shkurt 1995, DR 80, pp.66 dhe 72; *Grava v. Italy* (dec), no. 43522/98, 5 dhjetor 2002; *Husain v. Italy* (dec.), no. 18913/03, 24 shkurt 2005; dhe *Sannino v. Italy* (dec.), no. 30961/03, 24 shkurt 2005).

56. Gjykata vëren se shpallja fajtor dhe masa e dënimit për ankuesin u lanë në fuqi nga gjykatat e brendshme në të tria shkallët e gjyqësorit. Ankuesi është duke vuajtur dënimin me burg prej shumë kohësh. Gjykata nuk është e bindur nëse vendimi i marrë nga gjykatat e brendshme në lidhje me kërkesën e ankuesit për të vuajtur dënimin e tij në një institucion të specializuar në përputhje me gjendjen e tij shëndetësore apo për t'u liruar, përfshihen në përcaktimin e "një akuze penale" ose " të drejtave dhe detyrimeve civile" brenda kuptimit të nenit 6 § 1. Kërkesa e ankuesit lidhet në praktikë me mënyrën e ekzekutimit të dënimit të tij.

57. Gjykata për më tepër vëren se Konventa nuk garanton, si të tillë, të drejtën për lirim të kushtëzuar ose vuajtjen e një dënimi në përputhje me regjimin e veçantë të dënimeve (shih Aldrian, vendim i Komisionit i cituar më sipër dhe Savic v. Slovakia, no. 28409/95, vendim i Komisionit i datës 3 dhjetor 1997).

58. Ajo vijon se kjo pjesë e ankimit nuk duhet pranuar në përputhje me nenin 35 § 3 dhe 4 të Konventës.

III. ZBATIMI I NENEVE 46 DHE 41 TË KONVENTËS

A. Neni 46 i Konventës

59. Neni 46 i Konventës parashikon:

"1.Palët e Larta Kontraktuese zotohen t'iu binden vendimeve përfundimtare të

Gjykatës në mosmarrëveshjet në të cilat ata janë palë.

2. Vendimi përfundimtar i Gjykatës i transmetohet Komitetit të Ministrave, i cili mbikëqyr zbatimin e tij.”.

60. Neni 41 i Konventës vijon sa më poshtë:

“Kur Gjykata konstaton shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj, dhe e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese mundëson vetëm ndreqjen e pjesshme të pasojave të shkaktuara nga shkelja, Gjykata kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar.”

Ankuesi tregoi se ai ishte ndaluar/dënuar në kushte të varfëra, nga viti 2002 e më tej, kohë gjatë së cilës ai nuk kishte marrë trajtimin e duhur mjekësor. Ai kërkoi të vendosej në një institucion mjekësor të specializuar në përputhje me gjendjen e tij shëndetësore, dhe gjithashtu kërkoi 500,000 euro në lidhje me dëmin pasuror dhe jopasuror të shkaktuar. Meqenëse autoritetet nuk kishin zbatuar kërkesën e mësipërme, ai pretendoi 1,000,000 euro, përsa i përket kësaj kërkesë lidhur me dëmin pasuror dhe jopasuror.

62. Gjykata u kufizua për sa i përket këtij pretendimi, pasi nuk kishte asnjë provë që t’i mbështeste pretendimet e ankuesit.

63. Gjykata ritheksoi se, në përputhje me nenin 46 të Konventës, një konstatim i shkeljes i imponon shtetit të paditur një detyrim ligjor jo vetëm të kompensojë shumat e kërkuara duke e dëmshpërblyer sipas nenit 41, por gjithashtu të përcaktojë mbikëqyrjen e personin që do të mbikëqyret nga Komiteti i Ministrave, masat e përgjithshme dhe/ose kur është e nevojshme ato individuale që do adoptohen në legjislacionin e tyre të brendshëm, për t’i dhënë fund shkeljes së konstatuar nga Gjykata dhe t’i korrigjojë sa më shpejt të jetë e mundur efektet/pasojat, proces i cili mbikëqyret nga Komiteti i Ministrave (shih Bronioski v. Poland [GC], no. 31443/96, § ECHR 2004-V).

64. Gjykata ka bërë shënimet e duhura për angazhimin e shtetit shqiptar lidhur me përmirësimin e kushteve në burg. Në këtë drejtim shteti shqiptar duhet të gjejë rrugën e duhur për çështjen në fjalë, duke respektuar sistemin e përshkruar me një frymë mbrojtëse, i cili është i krijuar nga Konventa. Megjithatë Gjykata konstaton se, në këndvështrimin e konstatimeve të saj në çështjen në fjalë, duhet të merren urgjentisht masat e domosdoshme për t’i siguruar kushtet e duhura të vuajtjes së dënimit dhe trajtimin mjekësor të përshtatshëm, në veçanti për sa i përket të burgosurve si ankuesi të cilët kanë nevojë për një kujdes të veçantë në përputhje me gjendjen e tyre shëndetësore.

A Dëmi

65. Përsa i përket dëmit pasuror të pretenduar së eshtë shkaktuar, Gjykata ritheksoi se duhet të ketë një lidhje shkakësore të dukshme ndërmjet dëmit të pretenduar nga ankuesi dhe shkeljes së Konventës (shih *Barberà, Messeguè and Jabardo v. Spain,* vendim i datë 13 qershor 1994 (neni 50 i mëparshëm), seria A no. 285-C, §§ 16-20; shih *gjithashtu Berktay v. Turkey*, no. 22493/93, § 215, 1 mars 2001; dhe *Khudobin v. Russia*, no. 59696/00, § 142, ECHR 2006-... (extracts)).

66. Gjykata, duke pasur parasysh konstatimet e saj në lidhje me ankimin e ankuesit në bazë të nenit 3 të Konventës, çmon se nuk ka lidhje shkakësore ndërmjet dëmit të pretenduar dhe shkeljes së konstatuar (shih Kalashnikov, cituar më sipër, § 139). Në këtë mënyrë ajo nuk e pranon pretendimin e ankuesit lidhur me dëmin pasuror.

67. Për sa i përket dëmit jopasuror, Gjykata vëren se të drejtat e ankuesit në bazë të nenit 3 të Konventës janë shkelur. Ajo çmon se ankuesi ka vuajtur një dëm të natyrës jopasurore, si rezultat i dënimit të tij në kushte çnjerëzore dhe degraduese, të papërshtatshme me gjendjen e tij shëndetësore (shih paragrafët 51-52 më sipër), e cila nuk është korrigjuar mjaftueshmërisht vetë nga një konstatim i shkeljes së të drejtave të tij në bazë të Konventës.

68. Për arsyet e sipërpërmendura, duke pasur parasysh rrethanat specifike të çështjes konkrete dhe jurisprudencën e Gjykatës në rastet e ngjashme (shih, *mutatis mutandis*, Peers, cituar më sipër, § 88; Khokhlich v. Ukraine, no. 41707/98, § 228, 29 prill 2003; dhe Melnik, cituar më sipër, § 121) dhe duke vendosur mbi baza të paanshme, Gjykata i cakton ankuesit 5.000 euro në lidhje me këtë shkelje, plus ndonjë taksë që mund të jetë e tatueshme mbi këtë shumë.

B. Kosto dhe shpenzime

69. Ankuesi nuk pretendoi kosto dhe shpenzime as për proceset lidhur me Konventën dhe as për proceset para gjykatave të brendshme, përveç atyre të dhëna për ndihmën ligjore.

C. Interesi i mospagimit

70. Gjykata çmon të nevojshme se interesi i mospagimit duhet të bazohet në normën marzhinale të huadhënies së Bankës Qendrore Europiane, të cilës duhet t'i shtohen tre për qind pikë.

Për këto arsye gjykata, unanimisht:

1. I deklaron ankesat lidhur me papërshtatshmërinë e kushteve të vuajtjes së dënimit të ankuesit në burg dhe trajtimin mjekësor që ai ka marrë në këndvështrimin e gjendjes së tij shëndetësore, të pranueshme dhe pjesën tjetër të ankimit të papranueshme.

2. Vlerëson se ka patur shkelje të nenit 3 të Konventës.

3. Vlerëson se:

a) Shteti i paditur duhet t'i paguajë ankuesit, brenda 3 muajve nga data në të cilën vendimi merr formë të prerë në pajtim me nenin 44 § 2 të Konventës, shumën prej 5,000 euro (pesë mijë euro) në lidhje me dëmin jopasuror, i cili do të konvertohet në monedhën vendase të shtetit të paditur, në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes, duke përfshirë edhe ndonjë taksë që mund të jetë e tatueshme;

b) që nga skadimi i afatit të sipërpërmendur prej tre muajsh, interesi i thjeshtë i shlyerjes do të jetë i pagueshëm mbi shumat e mësipërme në një normë të barabartë me normën marzhinale të huadhënies së Bankës Qendrore Europiane gjatë periudhës së mospagimit, plus tre pikë për qind.

4. Hedh poshtë pjesën e mbetur të pretendimeve të ankuesit për zhdëmtim të drejtë.

Përgatitur në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 18 dhjetor 2007, sipas rregullit 77 § 2 dhe 3 të rregullores së Gjykatës.

T.L EARLY	Nicolas BRATZA
Kryesekretar	President

ÇËSHTJA "BALLIU KUNDËR SHQIPËRISË"

(ANKIMI NR.74727/01)

VENDIM
STRASBURG
16 QERSHOR 2005
PËRFUNDIMTAR
30/11/2005

Ky vendim merr formë të prerë në rrethanat e përcaktuara në nenin 44 § 2 të Konventës. Ai mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktues.

Në çështjen Balliu kundër Shqipërisë,

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni III), me trup gjykues të përbërë nga:

z. G. RESS, President
z. I. CABRAL BARRETO
z. L. CAFLISCH
z. B.M. ZUPANCIC
z. J. HEDIGAN
z. K. TRAJA
znj. A. GYULUMYAN, gjykatës dhe
z. M. VILLIGER, zëvendësregjistrues i seksionit,

pas shqyrtimit me dyer të mbyllura të çështjes, më 27 maj 2004 dhe më 24 maj 2005, shpall vendimin e mëposhtëm, i cili u mor në datën e fundit të sipërcituar:

PROCEDURA

1. Çështja ka filluar me ankimin (nr.74727/01) kundër Republikës së Shqipërisë, depozituar në Gjykatë në bazë të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ("Konventa") nga një shtetas shqiptar, z.Taulant Balliu ("Ankuesi"), më 3 gusht 2001.

2. Ankuesi, të cilit i ishte garantuar ndihmë ligjore, u përfaqësua nga z. P. Pavarini, avokat që ushtronte profesionin në Torino (Itali). Pala shqiptare ("Qeveria") u përfaqësua nga agjenti qeveritar z. S. Puto.

3. Ankuesi pretendonte se mungesa e avokatit mbrojtës në gjyq ka cenuar të drejtën e tij për t'u mbrojtur nëpërmjet ndihmës ligjore. Përveç kësaj, për shkak të mungesës së avokatit mbrojtës, ai e kishte të pamundur të pyeste sipas rregullit dëshmitarët që ishin të pranishëm ose të siguronte paraqitjen e dëshmitarëve në emër të tij.

4. Ankimi iu caktua seksionit të tretë të Gjykatës (neni 52 § 1 i rregullores së Gjykatës). Trupi gjykues që do të shqyrtonte çështjen në këtë seksion (neni 27 § 1 i Konventës) përbëhej siç parashikohej në nenin 26 § 1 të rregullores.

5. Me vendim të datës 30 shtator 2004, pas një seance mbi pranueshmërinë dhe

themelin (Neni 54 § 3 i rregullores), Gjykata deklaroi pranimin e ankesës.

6. Si Ankuesi dhe Qeveria paraqitën vërejtje mbi themelin (Neni 59 § 1). Pasi trupi gjykues, në konsultim me palët mori vendim se nuk ishte i nevojshëm caktimi i një seance dëgjimore për themelin (Neni 59 § 3 i rregullores in fine), palët iu përgjigjën me shkrim vëzhgimeve të njëra- tjetrës.

7. Më 1 nëntor 2004 Gjykata ndryshoi përbërjen e seksioneve (Neni 25 § 1 i rregullores), por çështja iu la trupit gjykues, me përbërje si në seksionin III të lartpërmendur.

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

8. Ankuesi ka lindur në 1971 dhe është aktualisht duke vuajtur dënimin me burgim në burgun e Peqinit në Shqipëri.

Gjatë procedimeve penale kundër bandave të armatosura që vepronin gjatë trazirave politike në Shqipëri nga marsi deri në shtator 1997, prokuroria e rrethit gjyqësor Elbasan akuzoi ankuesin si organizator të bandës së armatosur, të njohur si "Banda Kateshi". Banda e stërvitur si komando ushtarake, synonte të merrte hakun për vrasjen e anëtarëve të bandës në konflikte me bandat e tjera dhe financohej duke i zhvatur para biznesmenëve të ndryshëm në atë zonë.

A. Procedimet penale

Në 1999 ankuesi u akuzua para Gjykatës së Rrethit Durrës për pesë vepra penale për vrasje, dy për tentativë vrasje, një për mbajtje armësh ushtarake dhe një për krijim dhe pjesëmarrje në bandat e armatosura.

Avokati i ankuesit, z. Leli, ishte i pranishëm në seancat publike para gjykatës më 25 qershor 1999, 13 shtator 1999 dhe 10 dhjetor 1999. Megjithatë, gjatë periudhës nga data 10 dhjetor 1999 deri më 15 shkurt 2000, avokati nuk i siguroi ndihmë ligjore, dhe ankuesit nuk iu caktua kryesisht një avokat. Ankuesi parashtroi se në seancat e asaj periudhe, prokuroria kishte thirrur dëshmitarë kundër tij, kishte marrë në pyetje dëshmitarët që ishin të pranishëm dhe kishte paraqitur prova të tjera kundër tij. Avokati i ankuesit kishte thirrur dy dëshmitarë në favor të ankuesit, por ata nuk u paraqitën në gjyq.

Sipas pretendimeve të ankuesit, asnjë avokat mbrojtës nuk i ka ofruar atij ndihmë ligjore gjatë kësaj faze, në të cilën palët kanë bërë parashtrimet e tyre përfundimtare. Në këtë kontekst, siç është pasqyruar edhe në procesverbalin e seancave gjyqësore, avokati i ankuesit ka munguar në seancë pa arsye dhe ankuesi ka refuzuar të paraqesë vetë parashtrimet e tij përfundimtare të mbrojtjes. Në një rast të tillë, kërkuesi është ankuar dhe i ka kërkuar gjykatës t'i caktojë atij kryesisht një avokat mbrojtës, por nuk ka marrë përgjigje.

Sipas parashtrimeve të shtetit shqiptar, seancat e gjykatës së shkallës së parë zgjatën shtatë muaj dhe u organizuan 21 seanca gjyqësore. Seancat gjyqësore ishin shtyrë në shumë raste si rezultat i mungesës së pajustifikuar të avokatëve, veçanërisht të avokatit mbrojtës të ankuesit. Ky i fundit mungonte gjatë shtatë seancave gjyqësore të njëpasnjëshme, pa dhënë asnjë arsye.

Në tërësi, në të vërtetë ishin zhvilluar vetëm njëmbëdhjetë seanca, kurse dhjetë të tjera

ishin shtyrë për shkak të mungesës së avokatit mbrojtës. Kështu, gjykata vendosi caktimin e znj. Meta si avokate mbrojtëse, e cila ishte e pranishme në seancën që u zhvillua më 28 janar 2000. Megjithatë, ankuesi refuzoi të mbrohej nga një avokat që nuk ishte zgjedhur prej tij. Për këtë arsye, gjykata e shkarkoi avokatin mbrojtës të caktuar kryesisht prej saj dhe vazhdoi procedimin në prani të ankuesit, por pa avokat mbrojtës.

Me anë të letrës të datës 13 dhjetor 1999, Gjykata e Rrethit Durrës informoi Ministrin e Drejtësisë, midis të tjerash, për një moskorrektesë nga ana e avokatit mbrojtës të ankuesit dhe i kërkonte atij të ndërhynte në çështje. Megjithatë, nuk u mor asnjë masë disiplinore ndaj z. Leli nga Dhoma e Avokatisë, Tiranë.

Më 15 shkurt 2000, gjykata e rrethit Durrës e shpalli fajtor ankuesin dhe e dënoi atë me burgim të përjetshëm.

Më 21 shkurt 2000, ankuesi depozitoi ankimin pranë Gjykatës së Apelit Durrës kundër vendimit të dhënë më 15 shkurt 2000. Ai pretendonte se gjatë gjykimit në Gjykatën e Rrethit, atij i ishte mohuar e drejta për një gjykim të drejtë, sepse nuk kishte pasur ndihmë ligjore nga një avokat mbrojtës gjatë dy muajve të parë të gjykimit. Një avokat i tillë do të kishte bërë të mundur përgatitjen e mbrojtjes së tij dhe do të kishte thirrur dëshmitarë në mbrojtje të tij. Ai pretendonte se nuk kishte pasur avokat mbrojtës as në paraqitjen e kërkesave të tij përfundimtare. Ai gjithashtu pretendonte se kishte qenë jashtë shtetit gjatë kohës kur ishin kryer disa nga krimet për të cilat ai ishte akuzuar, duke paraqitur dhe vula doganore të vendosura në pasaportën e tij për të provuar se ai ishte larguar jashtë vendit. Në apelimin e tij, ankuesi nuk kërkoi marrjen në pyetje të dëshmitarëve të tjerë.

Më 19 prill 2000, Gjykata e Apelit la në fuqi, vendimin e Gjykatës së Rrethit të datës 15 shkurt 2000, duke bërë disa ndryshime lidhur me dënimet e dhëna për disa nga veprat penale. Këto ndryshime nuk ndryshuan vendimin e dënimit me burgim të përjetshëm.

Më 19 maj 2000, ankuesi depozitoi ankimin në Gjykatën e Lartë, duke pretenduar shkelje të të drejtave të tij kushtetuese, duke qenë se i ishte mohuar e drejta për të pasur një përfaqësues ligjor gjatë procedimit. Ai ankohej veçanërisht se megjithëse nuk kishte pasur përfaqësim të duhur, gjykata e rrethit kishte proceduar me marrjen në pyetje të dëshmitarëve kundër tij dhe kishte marrë në konsideratë dhe prova të tjera.

Më 7 dhjetor 2000, Gjykata e Lartë la në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit mbi bazën e arsyeve të mëposhtme:

"Shkeljet e paraqitura nga ankimuesi ishin njohur dhe ndrequr nga Gjykata e Apelit, pa pasur ndonjë ndikim thelbësor në përmbajtjen e vendimit të shkallës së parë. Gjatë periudhës së paraburgimit, ashtu dhe gjatë procesit gjyqësor, të paditurit i ishte ofruar ndihmë ligjore. Gjykata arsyetonte se mungesa e pajustifikuar e avokatit mbrojtës, në marrëveshje me të paditurin, për të shtyrë gjyqin nuk mund të sillte si pasojë pavlefshmërinë absolute të një vendimi të gjykatës së rrethit."

B. Procedimet në Gjykatën Kushtetuese

Më pas, ankuesi, mbështetur në nenin 131 (f) të Kushtetutës, depozitoi një ankim pranë Gjykatës Kushtetuese. Më 19 prill 2001, Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 31 të ligjit nr.8577 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë" , datë 10 shkurt 2000, vendosi de plano të deklarojë ankimin të papranueshëm

si “jashtë juridiksionit të saj”.

II. LEGJISLACIONI I BRENDSHËM PËRKATËS

A. Kushtetuta

Dispozitat përkatëse të Kushtetutës së Shqipërisë parashikojnë:

Neni 31

“Gjatë procesit penal kushdo ka të drejtë:

...

ç) të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi ligjor të zgjedhur prej tij; të komunikojë lirisht dhe privatisht me të, si dhe t’i sigurohet mbrojtja falas, kur nuk ka mjete të mjaftueshme;

d) t’u bëjë pyetje dëshmitarëve të pranishëm dhe të kërkojë paraqitjen e dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.

Neni 42

“1. Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor.

2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. ”

B. Kodi i Procedurës Penale

23. Sa më sipër, Kodi Shqiptar i Procedurës Penale parashikon:

Neni 49

Mbrojtësi i caktuar

“...

5. “Kur kërkohet prania e mbrojtësit dhe mbrojtësi i zgjedhur ose i caktuar nuk është siguruar, nuk është paraqitur ose e ka lënë mbrojtjen, gjykata ose prokurori cakton si zëvendësues një mbrojtës tjetër, i cili ushtron të drejtat dhe merr përsipër detyrimet e mbrojtësit.”

LIGJI

SHKELJE TË PRETENDUARA TË NENIT 6 § § 1 DHE 3 (c) DHE (d) TË KONVENTËS

24. Ankuesi pretendon se bazuar në nenin 6 § § 1 dhe 3 (c) dhe (d) të Konventës, i është mohuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, duke qenë se nuk është mbrojtur si duhet me ndihmë ligjore dhe nuk ka qenë në gjendje të pyesë disa dëshmitarë ose të kërkojë

paraqitjen e dëshmitarëve në mbrojtje të tij.

Pjesët përkatëse nga neni 6 i Konventës vijojnë si më poshtë:

"1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht …nga një gjykatë e pavarur …,e cila do të vendosë … për bazueshmërinë e çdo akuze të natyrës penale që i është drejtuar.

3. Çdo i akuzuar ka, së paku, të drejtat e mëposhtme:

c. të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij dhe, në qoftë se ai nuk ka mjete për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas nga një avokat i caktuar, kryesisht kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;

d. të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës.

25. Gjykata fillimisht rithekson se kërkesat e paragrafit 3 (c) dhe (d) të nenit 6 duhet të shihen si aspekte të veçanta të së drejtës për një gjykim të drejtë proces të rregullt ligjor, të garantuara nga paragrafi 1. Për këtë arsye, Gjykata e konsideron të arsyeshëm shqyrtimin e pretendimeve të ankuesit lidhur me paragrafin 3, së bashku me parimet themelore të paragrafit 1 (shih, midis të tjerash, Artico v Italy, vendimi i 13 majit 1980, Seria A, nr.37, fq. 15, § 32, dhe Van Geyseghem v Belgium [GC], nr.26103/95, § 27, ECHR 1999-I). Në tërësi, Gjykata do të shqyrtojë nëse procedimet në tërësinë e tyre kanë qenë të drejta.

A. Shkelja e pretenduar e nenit 6 §§ 1 dhe 3 (c)

1. Parashtrimet e palëve

26. Së pari ankuesi pretendoi se në procedimin penal kundër tij, ai nuk është përfaqësuar në mënyrën e duhur nga një avokat, siç kërkohet nga neni 6 §§ 1 dhe 3 (c) i Konventës. Kjo do të kishte qenë mjaft e rëndësishme në lidhje me kompleksitetin e çështjes dhe shkallën e ashpërsisë së dënimit.

27. Ankuesi vërejti se ishte e qartë, si nga parashtrimet e autoriteteve shtetërore, ashtu edhe nga dokumentet e dosjes, se avokati i tij nuk e ka përfaqësuar atë si duhet gjatë pjesëve më të rëndësishme të procedimit para Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit të Durrësit. Pavarësisht nga shkaqet për mungesën e mbrojtësit të tij, asnjë masë disiplinore nuk është marrë nga autoriteti kompetent në lidhje me sjelljen e tij të papërgjegjshme.

28. Më 26 nëntor 2004, ankuesi depozitoi në Gjykatë dy deklarata të bëra para një noteri në Durrës, më 4 korrik 2003, në të cilat z. Leli, mbrojtësi i tij dhe znj. Meta, avokatja e caktuar kryesisht, deklaruan se Gjykata e Rrethit të Durrësit nuk kishte arritur t'i siguronte ankuesit ndihmën e nevojshme ligjore. Përveç kësaj, z. Leli pohoi se Gjykata e Rrethit e kishte shkarkuar atë nga mbrojtja e ankuesit gjatë procedimit në shkallën e parë dhe se ai ishte kërcënuar nga persona të panjohur.

29. Autoritetet shtetërore nuk pranuan pretendimet e ankuesit. Ata pretendonin se që nga koha e fillimit të hetimit, dhe veçanërisht në gjykim, ankuesi kishte pasur çdo mundësi për të ushtruar të drejtën e tij për një gjykim të drejtë, dhe veçanërisht për të qenë i përfaqësuar nga një avokat. Kështu, pavarësisht nga mungesa e vazhdueshme dhe e pajustifikuar e avokatit të tij, gjykata e rrethit e shtyu seancën disa herë, duke i dhënë avokatit mundësinë për të qenë i pranishëm. Përveç kësaj, gjykata e rrethit i caktoi ankuesit një avokat

sipas skemës së ndihmës ligjore. Kur ky i fundit u paraqit më 28 janar 2000, ankuesi deklaroi se dëshironte të kishte avokatin e tij dhe nuk pranoi një avokat tjetër të caktuar nga gjykata.

30. Në parashtrimet e autoriteteve shtetërore, vendimi i gjykatës së rrethit për të vazhduar seancat, pavarësisht nga mungesa ose prania e përfaqësuesit ligjor të ankuesit, nuk cenon të drejtat kushtetuese të ankuesit. Në fakt, e drejta e ankuesit për t'u mbrojtur nëpërmjet ndihmës ligjore, ishte siguruar madje edhe gjatë seancave para Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës së Lartë, në të cilat ai ishte përfaqësuar nga i njëjti avokat.

31. Në lidhje me deklaratat e ankuesit, të paraqitura më 26 nëntor 2004, Qeveria pohoi se në dosjen e gjykatës së rrethit nuk kishte të dhëna që gjykata e rrethit kishte shkarkuar avokatin mbrojtës të ankuesit.

2. Vlerësimi i Gjykatës

32. Gjykata rithekson se si parim i përgjithshëm, bazuar në nocionin e një gjykimi të drejtë, një personi të akuzuar për një vepër penale, i cili nuk dëshiron të mbrohet vetë, duhet t'i jepet mundësia për të pasur ndihmë ligjore nëpërmjet një mbrojtësi të zgjedhur prej tij. Nëse ai nuk ka burime të mjaftueshme për të përballuar këtë ndihmë, Konventa i njeh të drejtën që ta ketë këtë ndihmë falas kur e kërkojnë interesat e drejtësisë (shih Campbell and Fell v.the United Kingdom, vendim i 28 qershorit 1984, Seritë A, nr.80, fq 45, § 99 dhe Pakelli v. Germany, vendimi 25 prillit 1983, Seritë A, nr.64, fq. 15,§ 31).

33. Duke pasur parasysh qëllimin e Konventës, për mbrojtjen e të drejtave që janë praktike dhe efektive, Gjykata ka konstatuar në mënyrë të vazhdueshme që, ndërsa shtetet nuk mund të jenë përgjegjëse për çdo të metë të avokatëve të caktuar për ndihmë ligjore, në rrethana të veçanta të çështjes autoritetet kompetente duhet të marrin masa për të siguruar që ankuesit të gëzojnë efektivisht të drejtën që u njihet. (shih Artico v. Italy, vendim i 13 majit 1980, Seritë A, nr.37, fq. 18, § 36).

34. Në rastin në fjalë, Gjykata duhet të përcaktojë nëse shteti mban përgjegjësi për neglizhimin e avokatit të zgjedhur nga ankuesi, për të përmbushur detyrën e tij, në shkelje të të drejtave të akuzuarit sipas Konventës.

35. Gjykata vëren gjithashtu se në këtë rast, kur ankuesi nuk dëshironte të mbrohej vetë dhe kur avokati i zgjedhur prej tij nuk e përmbushi detyrën, autoritetet shqiptare kishin në dispozicion disa mundësi. Ato mund të siguronin që z. Leli, avokati i zgjedhur i ankuesit të përmbushte detyrën e tij, ose mund ta zëvendësonin atë me një avokat të caktuar kryesisht. Megjithatë, ishte e pamundur, duke marrë parasysh pavarësinë e Dhomës së Avokatisë, për ta detyruar mbrojtësin e ankuesit për të vepruar. Për më tepër, Ankuesi nuk pranoi të mbrohej nga një avokat i caktuar kryesisht. Kështu, gjykata e rrethit zgjodhi një mundësi të tretë, atë të shtyrjes së seancave dhe procedimit në mungesë të avokatit, por në prani të ankuesit.

36. Gjykata vëren më tej se ankuesi nuk e informoi asnjëherë Gjykatën e Rrethit të Durrësit për mungesën e përfaqësuesit të tij dhe as të avokatit të caktuar kryesisht. Ai gjithashtu nuk kërkoi ndonjë avokat tjetër.

37. Në këto rrethana, Gjykata vëren se autoritetet e përmbushën në nivel të mjaftueshëm detyrimin e tyre për të siguruar ndihmë ligjore, si duke shtyrë seancat, për t'i dhënë avokatit të ankuesit mundësi për të përmbushur detyrën e tij, ashtu dhe duke caktuar një avokat sipas skemës së ndihmës ligjore.

38. Duke pasur parasysh gjithashtu detyrimin e autoriteteve sipas nenit 6 § 1 të

Konventës për të përfunduar procesin "brenda një afati të arsyeshëm", rrethanat e përfaqësimit të ankuesit gjatë gjykimit të tij nuk cenojnë të drejtën për sigurimin e ndihmës ligjore, siç kërkohet nga neni 6 § 3 (c) i Konventës, ose mohim të gjykimit të drejtë, sipas paragrafit 1 të këtij neni.

B. Shkelja e pretenduar e nenit 6 §§ 1 dhe 3 (d)

1.Parashtrimet e palëve

39. Ankuesi u ankua gjithashtu se nuk iu dha mundësia të pyeteshin disa dëshmitarë, siç kërkohet nga neni 6 §§ 1 dhe 3 (d) i Konventës.

40. Në veçanti, Gjykata e Rrethit nuk ka dështuar në respektimin e dispozitave të ligjit të brendshëm, i cili, sipas pikëpamjes së ankuesit kërkonte thirrjen e dëshmitarëve në emër të tij. Përveç kësaj, ai nuk pranoi deklarimet e autoriteteve shtetërore rreth mundësisë për të thirrur dëshmitarë gjatë procedimeve para Gjykatës së Apelit. Ai argumentoi se qëndrimi i papërshtatshëm i avokatit të tij gjatë procesit në shkallën e parë ka vazhduar edhe gjatë procesit para Gjykatës së Apelit.

41. Autoritetet shtetërore argumentuan se mosparaqitja e dëshmitarëve të mbrojtjes në një kohë kur mbrojtja kishte dashur që ata të jepnin prova para Gjykatës së Rrethit, nuk ishte përgjegjësi e gjykatës. Në mënyrë të veçantë, ankuesi kishte zgjedhur me paramendim si pjesë të strategjisë së tij të mbrojtjes, të rrinte pasiv dhe të mos ushtronte të drejtat e tij sipas Konventës. Në të vërtetë, gjykimi, në tërësi, ka qenë i drejtë, siç kërkohet nga ligji dhe Konventa dhe ankuesi ka pasur në të vërtetë mundësinë për të ushtruar të drejtat e tij gjatë procedimeve.

2.Vlerësimi i Gjykatës

42. Gjykata rithekson se pranimi i provave rregullohet kryesisht nga rregullat e legjislacionit të brendshëm dhe se, si rregull, janë gjykatat kombëtare që duhet të vlerësojnë provat para tyre. Detyra e institucioneve të Konventës është të sigurojë që procesi në tërësinë e tij, përfshirë dhe mënyrën sesi janë marrë provat, të ketë qenë i rregullt. Si rregull, këto të drejta kërkojnë që të akuzuarit t'i jepet mundësia e nevojshme dhe e përshtatshme për të kundërshtuar dhe pyetur një dëshmitar kundër tij, qoftë në momentin kur ai bën deklaratat, ose dhe në një fazë të mëvonshme të procedimeve (shih Saïdi v France, vendim i 20 shtatorit 1993, seritë A nr.261 –C, fq. 56 § 43, dhe A.M. v. Italy, nr. 37019/97, § 25, ECHR 1999 –IX).

43. Rrjedhimisht, në rastin konkret duhet të përcaktohej nëse ankuesit i ishte ofruar mundësia e duhur për të ushtruar të drejtat e tij për t'u mbrojtur, brenda kuptimit të nenit 6 të Konventës, në lidhje me provat e dhëna nga dëshmitarët.

44. Në seancat gjyqësore në gjykatën e rrethit të Durrësit, si ankuesi, edhe mbrojtësi i tij, u përballën me dëshmitarët e akuzës, patën mundësinë që t'iu bënin atyre pyetje, edhe pse preferuan të mos e bënin këtë: avokati i ankuesit duke munguar, ndërsa ankuesi duke heshtur.

45. Në këtë mënyrë, nuk mund të thuhet se autoritetet nuk vepruan në përputhje me detyrën e tyre sipas nenit 6 §§ 1 dhe 3 (d), për t'i siguruar ankuesit mundësinë e duhur për të pyetur dëshmitarët në gjykim.

C. Përfundimi

46. Në përfundim, Gjykata çmon se në tërësi procesi penal kundër ankuesit nuk mund të konsiderohet si i parregullt. Kështu, nuk ka shkelje të nenit 6 §§ 1 dhe 3 (c) në lidhje me ndihmën ligjore të marrë nga ankuesi, veçanërisht gjatë gjykimit të shkallës së parë para gjykatës së rrethit, Durrës. Gjithashtu, nuk ka pasur shkelje të të drejtave të ankuesit sipas nenit 6 § 3 (d) të Konventës, përsa i përket mundësisë për të pyetur dëshmitarët në proces.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA UNANIMISHT

Çmon se nuk ka pasur shkelje të nenit 6 §§ 1 dhe 3 (c) dhe (d) të Konventës.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 16 qershor 2005, sipas nenit 77 §§ 2 dhe 3 të rregullores së Gjykatës.

Mark Villiger	**Georg Ress**
Zëvendësregjistrues	President

ÇËSHTJA PIHONI KUNDËR SHQIPËRISË

(ankimi nr. 74389/13)

VENDIM
STRASBURG
13 shkurt 2018

Ky vendim do të bëhet i formës së prerë sipas rrethanave të parashikuara në nenin 44 § 2 të Konventës. Ai mund të bëhet objekt i rishikimit redaktues.

Në çështjen Pihoni kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i dytë), e mbledhur si një Dhomë e përbërë nga:

Robert Spano, kryetar,
Paul Lemmens,
Ledi Bianku,
Işıl Karakaş,
Nebojša Vučinić,
Valeriu Griţco,
Stéphanie Mourou-Vikström, gjyqtarë,
dhe Stanley Naismith, regjistrues i seksionit,

Pasi ka diskutuar me dyer të mbyllura më 16 janar 2018,
shpall vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në po atë datë:

PROCEDURA

1. Çështja e ka zanafillën me ankimin (nr. 74389/13) kundër Republikës së Shqipërisë paraqitur në Gjykatë bazuar në nenin 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa), nga shtetasi shqiptar, z. Petri Pihoni (ankuesi), më 25 nëntor 2013.

2. Ankuesi u përfaqësua nga z. N. Marku, avokat, i cili e ushtron profesionin në Tiranë. Qeveria shqiptare (qeveria) u përfaqësua nga agjentja e saj, znj. A. Hicka nga Zyra e Avokatit të Shtetit.

3. Ankuesi shprehu shqetësimin, bazuar në nenin 3 të Konventës, në lidhje me dëmet që kishte vuajtur si pasojë e një ndërhyrjeje nga ana e policisë dhe pretendonte se hetimi për identifikimin dhe ndëshkimin e autorëve të krimit nuk kishte qenë i dobishëm.

4. Më 6 tetor 2014, ankimi iu komunikua qeverisë.

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

2. Ankuesi ka lindur në vitin 1983 dhe jeton në Pogradec.

3. Sipas ankuesit, më 6 gusht 2012, ai u bë dëshmitar i një grindjeje të dhunshme verbale midis N.P., një i afërm i tij dhe A.S., në një nga rrugët kryesore të Pogradecit.

Ndërhyrja e ankuesit për të qetësuar N.P. dhe A.S. ishte e pasuksesshme. Shkëmbimi verbal u nxeh ndjeshëm dhe përfundoi në dhunë fizike.

7. Pas nisjes së dhunës fizike, një njësi speciale e policisë së Forcave të Ndërhyrjes së Shpejtë (në vijim referuar si "FNSH") ndërhynë për të ndaluar dhunën. Si rezultat ankuesi dhe dy individë të tjerë, u shoqëruan në rajonin e policisë të zonës. Në formularin e tij të ankimit, ankuesi parashtroi se ai kishte vuajtur dëme si rezultat i ndërhyrjes së policisë dhe se gjatë rrugës për në rajonin e policisë, ai ishte fyer, kërcënuar dhe keqtrajtuar nga oficerët e policisë së FNSH-së. Kërkesat e tij për t'u dërguar në spital për të marrë trajtim mjekësor, nuk kishin marrë përgjigje.

A. Hetimet penale për ngjarjet e datës 6 gusht 2012

4. Dosja penale përkatëse, e cila u dorëzua nga qeveria si pjesë e vërejtjeve të tyre, tregonte se ishin hapur dy hetime për veprën penale të kryerjes së veprimeve arbitrare nga një person i veshur me pushtet publik në ushtrimin e detyrave të tij, sipas parashikimit të nenit 250 të Kodit Penal (në vijim referuar si "KP").

1. Dosja penale nr. 303

5. Në një raport shërbimi, të hartuar nga drejtuesi i skuadrës së oficerëve të FNSH-së, V.B., i dates 6 gusht 2012, pohohej se FNSH-ja ishte informuar për një konfrontim fizik në një nga rrugët kryesore të Pogradecit, rreth orës 7:40 të pasditës. Për pasojë, ata kishin marrë në pyetje dhe kishin shoqëruar në rajonin e policisë të zonës tre persona. Sipas raportit, N.P. dhe ankuesi i kishin bërë rezistencë fizike dhe verbale oficerëve të FNSH-së. Më tej, në raport pohohet se ankuesi kishte pësuar një dëmtim pas kokës së tij.

6. Formulari i raportit të shoqërimit në lidhje me ankuesin, i cili mban datën 6 gusht 2012 dhe orën 8:10 të mbrëmjes, shpjegon se: "ai kishte gjakderdhje në pjesën e pasme të kokës dhe se i rezistoi oficerëve të policisë fizikisht dhe verbalisht".

11. Rezultoi se më 6 gusht 2012, në orën 8:30 të mbrëmjes, ankuesi i telefonoi dikujt me emrin N.L., i cili ishte oficer i policisë gjyqësore, që punonte për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm (në vijim referuar si "SHKB") të ministrit të Punëve të Brendshme dhe e informoi atë për qëllimin e tij për të bërë një ankesë penale ndaj oficerëve të FNSH-së, të cilët pretendohej se e kishin goditur në shpatull, në këmbë dhe në kokë me shkop gome.

7. Më 7 gusht 2012, N.L. i mori ankuesit një deklaratë, i cili pohoi se ai kishte ndërhyrë për të ndaluar një grindje midis A.S. dhe N.P. Në atë moment, në skenë mbërritën oficerët e FNSH-së. Në vijim, oficerët e FNSH-së kishin ndërhyrë në ngjarje pa e vlerësuar situatën dhe e kishin goditur atë me shkop gome në kokë, shpatull dhe në këmbë. Për pasojë, ai kishte pësuar një plagë të hapur në kokë. Ai ishte futur me forcë në një makinë policie, ku ishte bërë objekt i presionit psikologjik dhe ishte ofenduar nga oficerët e FNSH-së dhe, në vijim, ishte shoqëruar në rajonin e policisë së Pogradecit së bashku me N.P. dhe A.S. Kishte qëndruar në rajonin e policisë për katër orë dhe autoritetet nuk I kishin dhënë ndihmë mjekësore, pavarësisht plagës së pasuar në kokë dhe dëmtimeve të tjera në shpatullën dhe këmbën e tij (shih edhe paragrafin 38 më poshtë). Në vijim, ankuesi deklaroi se dikush me emrin M.S. kishte qenë i pranishëm në skenë.

13. Në po të njëjtën ditë, N.L. i mori A.S. një deklaratë, ku ai pohonte se ishte takuar me N.P. dhe i kishte kërkuar ta paguante për punën që kishte bërë në kafenenë e N.P. N.P. i kishte bërë ankuesit një telefonatë duke i kërkuar ndihmë. Pas disa momentesh, ankuesi ishte

shfaqur në skenë. Duke qenë se nuk kishin rënë dakord për shumën që do të paguhej, ankuesi dhe N.P. ishin përfshirë në një grindje me A.S. Pasi FNSH-ja kishin ndërhyrë, ankuesi dhe N.P. kishin kundërshtuar urdhrat e dhënë nga oficerët për të hipur në automjetin e policisë dhe nuk u ishin bindur urdhrave. Sipas A.S., veprimet e oficerëve të policisë kishin qenë të ligjshme (shih edhe paragrafin 31 më poshtë).

8. Në po të njëjtën ditë, në orën 12:20 të mbrëmjes, N.L. kontaktoi V.B. në telefon. Sipas raportit të shërbimit të hartuar më 7 gusht 2012, V.B. pohoi si më poshtë vijon:

"Petri Pihoni, A.S. dhe N.P. u përfshinë në një grindje. Ata [oficerët e FNSH-së] ishin telefonuar për të ndaluar grindjen, e cila ishte intensifikuar. Nën këto rrethana, ne [i ndamë nga grindja] dhe I shoqëruam në rajonin e policisë së Pogradecit me makinën e policisë. ... Do të theksoja se N.P. dhe Petri Pihoni na bënë rezistencë verbale dhe fizike, teksa po shoqëroheshin në rajonin e policisë.

Shtetasi Petri Pihoni që në momentin e parë të konstatimit nga ana jonë ishte i dëmtuar në pjesën e pasme të kokës. Në lidhje me këtë ngjarje, u mbajt një raport patrulle, raport të cilin ne do ta vëmë në dispozicion."

9. Më 7 gusht 2012, N.L. hartoi një raport mbi inspektimin e dokumenteve në lidhje me librin e marrjes së informacionit dhe dhënies së urdhrave, i cili i përket rajonit të zonës të policisë. Raporti përmbante deklaratën nr. 270, sipas së cilës V.B. kishte kallëzuar zënkën më 6 gusht 2012, në orën 8:10 të mbrëmjes dhe tre persona, më konkretisht ankuesi, A.S. dhe N.P., u shoqëruan në rajonin e policisë.

16. Më 10 gusht 2012, N.L. referoi një vepër penale në prokurorinë e Pogradecit. Raporti i tij përshkruante ngjarjet e përmendura në deklaratën e bërë nga ankuesi më 7 gusht 2012 (shih paragrafin 12 më sipër) dhe deklaratën e bërë nga A.S. në po të njëjtën ditë (shih paragrafin 13 më sipër). Raporti i referohej edhe librit të marrjes së informacionit dhe dhënies së urdhrave të rajonit të policisë dhe bisedës telefonike që N.L. kishte bërë me V.B. (shih paragrafin 14 më sipër). N.L. nuk kishte mundur të pyeste oficerët e FNSH-së, sepse ata ishin larguar për në Tiranë, mëngjesin e datës 7 gusht 2012.

10. Më 10 gusht 2012, prokurori i rrethit të Pogradecit (në vijim referuar si "prokurori i rrethit") hapi dosjen penale nr. 303, në përgjigje të informacionit të transmetuar nga SHKB-ja për një hetim paraprak, në lidhje me veprën e kryerjes së veprimeve arbitrare, sipas parashikimit të nenit 250 të KPsë.

11. Më 13 gusht 2012, prokurori i rrethit urdhëroi që të ndërmerreshin një sërë masash procedurale, të tilla si: këqyrja e raportit mjekoligjor në lidhje me ankuesin (shih paragrafin 20 më poshtë), marrja e ankuesit në pyetje, marrja në pyetje e katër personave të cilët kishin dijeni për ngjarjet, mbledhja e informacionit në lidhje me identitetin e oficerëve të policisë së FNSH-së dhe çdo veprim tjetër sipas rastit.

2. Dosja penale nr. 347

12. Më 3 shtator 2012, prokuroria e Pogradecit hapi dosjen penale nr. 347 në lidhje me padinë penale të paraqitur nga ankuesi më 8 gusht 2012 kundër oficerëve të policisë së FNSH-së, për veprën penale të kryerjes së veprimeve arbitrare, sipas parashikimit të nenit 250 të KP-së. Padia penale e ankuesit përmbante si më poshtë vijon:

"... në momentin kur ndërhyra për të ndaluar grindjen [midis N.P. dhe A.S.], oficerët e Forcave të

Ndërhyrjes së Shpejtë, pa pyetur për situatën, erdhën nga pas dhe më sulmuan fizikisht pa paralajmëruar, duke më goditur me objekte të forta në kurriz, këmbë dhe kokë, duke më shkaktuar edhe një plagë, e cila u trajtua më pas në spital. Në momentin kur u sulmova fizikisht, u kërkova oficerëve të policisë të mos përdornin dhunë, sepse unë nuk isha pjesë e grindjes dhe kisha ndërhyrë thjesht për ta parandaluar atë.

... pavarësisht asaj që po thoja dhe pa pyetur për situatën, më morën me forcë dhe përdorën dhunë psikologjike [duke më kërcënuar me] shkopin e gomës, teksa më shoqëruan në rajonin e zonës së policisë. Pasi [iu kërkova] të mos më fyenin dhe të mos ushtronin presion mbi mua, shefi i skuadrës më tha: "ta tregojmë neve ty, po qepe dhe më jep emrin këtu". Nuk m'u dha ndihmë mjekësore, pavarësisht dëmeve serioze që kisha pësuar. Rezultoi se oficerët e FNSH-së kishin ardhur nga Tirana."

13. Ankuesi paraqiti një raport mjekoligjor (nr. 204), të datës 7 gusht 2012, të urdhëruar nga N.L., oficeri i policisë gjyqësore, në mbështetje të padisë penale. Shqyrtimi mjekësor konstatoi se ankuesi ishte dëmtuar me një mjet të fortë pa majë, i cili kishte shkaktuar një plagë, për të cilën nevojiteshin qepje, tri gërvishtje, një edemë dhe një ekimozë. Si pasojë e dëmeve të mësipërme, ankuesi nuk ishte në gjendje të punonte për nëntë ditë.

14. Prokurori i rrethit vendosi që nevojitej hetim i mëtejshëm për identifikimin e autorëve dhe për përcaktimin e përgjegjësisë penale në lidhje me veprën e kryerjes së veprimeve arbitrare sipas nenit 250 të KP-së. Më 3 shtator 2012, prokurori i rrethit urdhëroi që të merreshin një sërë veprime procedurale, të tilla si: inspektimi i librit të marrjes së informacionit dhe i dhënies së urdhrave të rajonit të policisë, marrjen e informacionit në lidhje me identitetin e oficerëve të FNSH-së, realizmin e një parakalimi në paradë për identifikimin e oficerëve të policisë, marrjen e deklaratave nga ankuesi dhe personat e tjerë me dijeni për ngjarjet dhe çdo veprim tjetër sipas nevojës.

15. Më 6 shtator 2012, ankuesi bëri një deklaratë tjetër në të cilën ai thoshte se kishte parë një grup me oficerë policie me uniforma të policisë së shtetit, të cilët kishin dalë nga një makinë policie, por nuk kishte vënë re se kur kishin mbërritur në skenë. Më pas ishte goditur me shkop gome në kokë dhe në kurriz. Ai nuk mund të jepte emrin e ndonjërit prej oficerëve të policisë, bazuar edhe në rrethanat konkrete, por pohoi se ishte në gjendje t'i njihte në parakalimin për identifikim. Ai kishte vënë re se ata ishin pjesë e njësisë së FNSH-së. Pavarësisht shpjegimeve të tij se ishte përmbarues, ai ishte tërhequr prej krahu dhe ishte futur në makinën e policisë dhe ishte shoqëruar në stacionin e policies së zonës. Rrugës për në stacionin e policisë, një nga oficerët e policisë kishte qëndruar me dorën e tij ngritur, gati për ta goditur ankuesin me shkopin e gomës që mbante në dorë. Ankuesit nuk i ishte dhënë asnjë arsye për paraburgimin e tij në rajonin e policisë. Pavarësisht faktit se kishte gjakderdhje
në pjesën e pasme të kokës, si rezultat i goditjeve me shkop gome, nuk i ishte ofruar asnjë ndihmë. Ai u la i lirë nga rajoni i policisë rreth orës 11:15 të mbrëmjes, kohë pas së cilës kishte shkuar në spital për të marrë trajtim mjekësor. Ai pohoi se zhvillimet mund të jenë regjistruar nga kamerat e sigurisë së një banke aty afër.

16. Më 10 shtator 2012, prokurori i rrethit kërkoi që regjistrimi i videos të merrej nga banka aty afër, kamerat e së cilës mendohej se kishin regjistruar imazhet e ngjarjeve të datës 6 gusht 2012. Më 14 shtator 2012, banka e dorëzoi regjistrimin e videos në një CD-ROM. Në

procesverbalin e datës 30 janar 2013, mbi shqyrtimin dhe marrjen e të dhënave, shënohej se konstatimet e ekspertit se regjistrimi në video nuk paraqiste interes për hetimin.

17. Më 10 shtator 2012, prokurori i rrethit i kërkoi policisë lokale t'i vihej në dispozicion informacioni në lidhje me identitetin e oficerëve të FNSH-së, të cilët kishin qenë në shërbim në Pogradec, më 6 gusht 2012. Më 17 shtator 2012, stacioni i policisë Pogradec u përgjigj se skuadra e FNSH-së udhëhiqej nga V.B., i cili ishte përgjegjës për nxjerrjen e informacionit në lidhje me identitetin e anëtarëve.

3. Bashkimi i dosjeve penale

18. Më 18 shtator 2012, prokuroi i rrethit vendosi t'i bashkonte të dyja dosjet penale në dosjen nr.303.

19. Më 18 shtator 2012, prokurori i rrethit urdhëroi të ndërmerreshin një sërë veprimesh procedurale, të tilla si: marrja në pyetje e ankuesit, inspektimi i librit të marrjes së informacionit dhe I dhënies së urdhrave të rajonit të policisë, inspektimi i librit të marrjes së informacionit të urgjencës së spitalit lokal, shqyrtimi i raportit mjekoligjor mbi ankuesin (raporti i paraqitur në paragrafin 20 më sipër), marrja e informacionit në lidhje me identitetin e oficerëve të FNSH-së, marrjen në pyetje të katër personave, të cilët kishin dijeni për ngjarjet, shqyrtimin e regjistrimit të videos nga banka aty pranë, si edhe çdo veprim tjetër sipas nevojës.

20. Ka shumë mundësi që më 17 tetor 2012, edhe pse në procesverbal data shënon 17 janar 2012 (17.1.2012), A.E., i cili ka në pronësi një bar afër vendit ku ndodhi grindja, bëri një deklaratë. Ai deklaroi se dy persona po ziheshin me një person të tretë. Oficerët e FNSH-së ndërhynë për ta kontrolluat grindjen. Ata nuk përdorën shkopinj gome, pavarësisht rezistencës së bërë nga disa prej personave të cilët ishin futur në makinën e policisë.

28. Më 7 nëntor 2012, një oficer i policisë gjyqësore shqyrtoi urdhrin për daljen me shërbim të FNSH-së. Sipas atij urdhri, një skuadër prej 6 oficerësh të FNSH-së nga Tirana, nën drejtimin e V.B., ishin vënë në dispozicion të rajonit lokal të policisë për të ndihmuar patrullat e radhës gjatë sezonit të ngarkuar të verës.

29. Më 13 dhjetor 2012, N.P., njëra nga palët e përfshira në grindje, pohoi se ai kishte pësuar të goditura me shkop gome, të përdorur nga oficerët e FNSH-së. Me forcë, ata e kishin futur atë, ankuesin dhe A.S., në makinën e policisë. Oficerët e policisë nuk ishin prezantuar, në momentin kur kishin mbërritur në skenën e ngjarjes dhe nuk kishin paralajmëruar asnjërin prej tyre duke thënë: "Ndaloni, policia!". Në po të njëjtën ditë, Ni.P., një i afërm i ankuesit dhe N.P., pohuan se oficerët e FNSH-së kishin përdorur shkopinj gome ndaj ankuesit N.P. dhe ndaj A.S.

30. Më 4 janar 2013, P.B., i cili kishte qenë me shërbim në rajonin lokal të policisë, më 6 gusht 2012, pohoi se ankuesi dhe dy persona të tjerë (N.P. dhe A.S.) ishin sjellë në rajonin e policisë në orën 8 të mbrëmjes, pas ndërhyrjes së FNSH-së për të ndal orën 10:30 të mbrëmjes. Regjistri i spitalit lokal tregonte se ankuesi ishte paraqitur në repartin e urgjencave në orën 11:00 të mbrëmjes me një të çarë dhe me një shembje në pjesën e pasme të kokës.

25. Më 13 shkurt 2013, prokurori i rrethit vendosi që të përgatitej një raport tjetër ekspertize nga një grup mjekësh specialistë nga Instituti i Mjekësisë Ligjore (në vijim referuar si "IML"). Ky vendim i referohej raportit të parë mjekoligjor (nr. 204), lëshuar në lidhje me ankuesin (shih paragrafin 20 më sipër). Më tej, në të përmendej se oficerët e FNSH-së kishin

pohuar se nuk kishin përdorur objekte ose pajisje për të ndaluar grindjen. Po ashtu, ai u referohej deklaratave të dhëna nga A.S. dhe J.K., sipas së cilave A.S. kishte shkëmbyer të goditura si me ankuesin edhe me N.P. Nën të tilla rrethana, ishte e rëndësishme të identifikohej mjeti i fortë i cili ishte përdorur duke i shkaktuar dëmtimet ankuesit, sipas shpjegimeve të raportit mjekoligjor.

37. Më 5 mars 2013, IML-ja informoi prokurorin se ata nuk kishin mundur të identifikonin objektin i cili i kishte shkaktuar dëmtime ankuesit.

38. Më 12 prill 2013, gjatë marrjes në pyetje nga një oficer i policisë gjyqësore, ankuesi deklaroi midis të tjerave se ai nuk ishte përfshirë në një ndonjë zënkë, nuk ishte goditur nga A.S. dhe as nuk I kishte kthyer të goditura vet A.S. ankuesi e mohoi të kishte marrë telefonatë nga i afërmi i tij N.P. për ndihmë. Ai konfirmoi se nuk kishte mundur të identifikonte oficerët e policisë, duke qenë se ishte goditur nga pas (shih edhe paragrafin 12 më sipër).

26. Më 13 maj 2013, prokurori i rrethit, me anë të një vendimi të arsyetuar, vendosi të pezullonte hetimin sipas nenit 326 të KPP-së dhe e referoi dosjen e çështjes te SHKB-ja për veprime të tjera për identifikimin e autorëve. Vendimi përshkruante të gjitha të dhënat e mbledhura, si edhe deklaratat e bëra nga ankuesi dhe personat e tjerë, të cilët ose ishin përfshirë ose kishin qenë dëshmitarë në grindjen e datës 56 gusht 2012. Për sa ka të bëjë me çështjen, vendimi shpjegonte si më poshtë vijon:

"J.K. dha informacione për ngjarjen, duke pohuar se Petri Pihoni ishte përfshirë në grindje, pasi ishte bërë me dije në lidhje me të me anë të telefonatës nga N.P. ... Petri kishte goditur A., i cili ishte kundërpërgjigjur po me të goditur ... oficerët e policisë kishin shoqëruar A.S., N.P. dhe Petrin [në rajonin e policisë]. [J.K.] konfirmoi se veprimet e oficerëve ishin korrekte ... asnjë prej tyre nuk i preku apo ushtroi dhunë ndaj tyre [A.S., N.P. dhe ankuesit].

...

A.E. u mor në pyetje në lidhje me ngjarjet. Ai drejton një biznes privat pranë vendngjarjes. Deklarata e tij konfirmon se mes tre personave po ndodhte një grindje. Të gjithë personat po grindeshin [në momentin] kur mbërriti një makinë policie e FNSH. Oficerët e policisë iu drejtuan këtyre personave që të ndalonin grindjen, por ata vazhdonin që të grindeshin me grushte, derisa ndërhynë oficerët, duke i tërhequr nga krahët dhe duke i futur në makinën [e policisë]. [A.E.] pohoi se nuk i kishte parë oficerët e policisë të përdornin shkopinj gome.

...

Sipas fakteve dhe të dhënave të mbledhura gjatë [hetimit në lidhje me] dosjen penale nr. 303, rezultati është se ne nuk përballemi me veprën penale të kryerjes së veprimeve arbitrare sipas parashikimit të nenit 250 të Kodit Penal.

... Në rastin në fjalë, u provua se Petri Pihoni ishte përfshirë në një konfrontim fizik me disa persona.

Pavarësisht deklaratave të tij, deklaratat e dhëna nga A.S., J.K. dhe A.E. tregojnë se N.P. i quajtur Petri, u shfaq në skenë dhe u përfshi në një debat për shumën që N.P. i detyrohej A.S. debati u përshkallëzua në një konfrontim fizik në të cilin Petri goditi A.S., i cili u kundërpërgjigj me të goditur.

Nën të tilla rrethana, oficerët e FNSH-së u bënë dëshmitarë të një grindjeje të dhunshme dhe i shoqëruan tre personat në rajonin e policisë për të marrë shpjegimet [e tyre] për shkaqet e saj.

Unë mendoj se veprimet e oficerëve ... janë në përputhje me (seksionet 4, 92, 95 dhe 96 të) aktit për Policinë e Shtetit dhe nuk mund të konsiderohen si veprime arbitrare, të cilat ndikojnë lirinë e qytetarëve.
Në lidhje me padinë penale për ushtrim të dhunës fizike nga oficerët e FNSH-së, në momentin kur Petri u shoqërua në rajonin e policisë, unë mendoj se ngrihen dyshime në lidhje me faktin nëse është kryer vepra e abuzimit me pushtetin, parashikuar nga neni 28 i KP-së Ky është rasti, duke pasur parasysh dëmtimet që ka pësuar Petri, i cili mund të jetë shkaktuar, teksa ai shoqërohej [në rajonin e policisë] nga oficerët e FNSH-së ...
Gjatë hetimit, Petri Pihoni u mor në pyetje në disa raste për faktin nëse mund të identifikonte oficerët e FNSH-së, të cilët mund ta kenë goditur atë. Ai u përgjigj se nuk kishte mundësi të vijonte me [procedurën për] identifikimin, sepse goditjet kishin ardhur nga pas dhe ai nuk mund të identifikonte oficerin, i cili e kishte goditur.
Pjesa tjetër e të dhënave të marra gjatë hetimit nuk hedh dritë mbi këtë incident. Duke pasur parasysh faktin se përgjegjësia penale është individuale dhe jokolektive, unë mendoj se hetimi duhet të pezullohet.”.

B. Kërkesat e ankuesit për informacion

27. Duke mos marrë përgjigje nga prokuroria e Pogradecit në lidhje me ecurinë e hetimit, më 27 dhjetor 2012, ankuesi kërkoi ndihmën e Qendrës Shqiptare të Rehabilitimit për Traumën dhe Torturën (Qendra).
Në po të njëjtën datë, Qendra i kërkoi prokurorisë t’i vinte në dispozicion informacione në lidhje me çështjen e ankuesit por nuk mori përgjigje.

41. Më 11 maj 2013, Qendra e përsëriti kërkesën e saj drejtuar prokurorisë së Pogradecit. Ajo u ankua edhe te Prokuroria e Përgjithshme, për faktin se ankuesit nuk i ishte dhënë asnjë informacion në lidhje me ecurinë e hetimit tetë muaj pas incidentit. Nuk rezulton që të jetë kthyer përgjigje.

28. Më 7 qershor 2013, prokuroria e Pogradecit informoi ankuesin se më 13 maj 2013, kjo prokurori kishte pezulluar hetimin. Bashkëlidhur gjendej një kopje e vendimit të datës 13 maj 2013.

29. Më 27 nëntor 2013, Qendra i kërkoi prokurorisë t’i vinte në dispozicion një kopje të dosjes së hetimit. Nuk u kthye asnjë përgjigje.

C. Zhvillimet e mëtejshme pas komunikimit të çështjes qeverisë

30. Më 7 korrik 2017, sipas rregullit 54 § 2 (a) të Rregullores së Gjykatës, Gjykata u kërkoi palëve të dorëzonte informacione të reja faktike, të cilat mund të kishin dalë në dritë pas vendimit të prokurorit të datës 13 maj 2013.

31. Më 27 korrik 2017, prokurori i rrethit iu përgjigj ankuesit se hetimi në lidhje me dosjen penale nr. 303 për veprën penale të kryerjes së veprimeve arbitrare ishte ende i pezulluar dhe dosja ishte ende në Drejtorinë e Policisë së Korçës. Më tej, prokurori i rrethit informoi ankuesin se nuk kishte qenë e mundur identifikimi i autorëve të veprës penale.

32. Më 6 shtator 2017, prokurori i rrethit, në lidhje me vendimin e tij të datës 13 maj 2013, iu përgjigj qeverisë se nuk ishte kryer asnjë vepër penale në lidhje me kryerjen e veprimeve arbitrare. Për më tepër, ai informoi qeverinë se kishin lindur dyshime nëse ishte kryer vepra e abuzimit me pushtetin.

Megjithatë, të dhënat e marra nuk hodhën dritë në lidhje me këtë aspekt. Dosja penale i ishte dërguar SHKB-së për hetime të mëtejshme. Kjo e fundit nuk kishte identifikuar nevoja për rinisjen e hetimit. Ajo nuk kishte identifikuar fakte të reja të cilat kishin dalë në dritë pas pezullimit të procedimeve. Ankuesi ishte informuar rregullisht në lidhje me rezultatin e hetimit.

II. LIGJI DHE PRAKTIKA PËRKATËSE VENDËSE

A. Kodi Penal (KP)

33. Neni 66 parashikon se ndjekja penale e veprave penale të dënueshme me një periudhë burgimi nga pesë deri në dhjetë vjet është e parashkruar pas dhjetë vjetësh.

34. Neni 248 i KP-së ndalon veprimet dhe mosveprimet si rezultat i abuzimit me pushtetin kryer nga një person i veshur me pushtet publik dhe i dënon ato veprime me një periudhë burgimi deri më
shtatë vjet, në rast se këto veprime nuk përbëjnë ndonjë vepër tjetër penale.

49. Neni 250 i KP-së ndalon veprimet arbitrare, të kryera nga një person i veshur me pushtete publike gjatë ushtrimit të detyrës së tij dhe dënon ato veprime me një gjobë ose një periudhë burgimi
deri në shtatë vjet.

B. Kodi i Procedurës Penale (KPP)

35. Parashikimet e KPP-së, të cilat ishin në fuqi në periudhën konkrete, ishin si më poshtë vijojnë:

36. Neni 24 § 2 i KPP-së parashikonte se një prokuror kishte të drejtën të mos fillonte ose të ndërpriste një hetim. Neni 24 § 4 parashikonte se urdhrat dhe direktivat e një prokurori të një niveli më të lartë ishin detyruese për një prokuror të një niveli më të ulët. Neni 24 § 5 parashikonte se një prokuror i nivelit më të larët ose proprio motu ose pas një apeli, kishte të drejtën të ndryshonte ose të revokonte vendimet e një prokurori të një niveli më të ulët.

37. Sipas nenit 58 të KPP-së, viktima e një vepre penale ose trashëgimtarët e tij kishin të drejtën të kërkonin ndjekjen penale të autorit të veprës dhe kompensim për dëmin. Viktima kishte të drejtën t'i bënte kërkesa prokurorit dhe të kërkonte marrjen e të dhënave.

38. Sipas nenit 61, një person i cili ka vuajtur dëm monetar si rezultat i kryerjes së një vepre penale mund të bëjë një padi civile gjatë procedimeve penale për të kërkuar kompensim për dëmin. Sipas nenit 62, kërkesa duhet të paraqitet përpara fillimit të shqyrtimit gjyqësor. Sipas nenit 62 § 3, një gjykatë mund të vendosë ta veçojë një padi civile nga procedimet penale, në rast se shqyrtimi i saj ka vonuar ose ka komplikuar procedimet penale.

39. Neni 105 i KPP-së parashikon të drejtën e çdo pale të interesuar për të kërkuar kopje dhe ekstrakte ose dokumente të veçantë nga dosja e hetimit penal, me shpenzimet e palës.

55. Neni 323 § 1 parashikon se një prokuror duhet ta dërgojë një çështje për gjykim, të ndërpresë ose të pezullojë procedimet brenda tre muajve, pasi emri i personit të akuzuar për veprën penale është shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale.

40. Sipas nenit 324, prokurori mund ta zgjasë hetimin deri në tre muaj (paragrafi 1). Çdo shtyrje e mëtejshme, prej jo më shumë se tre muaj, mund të bëhet nga prokurori në çështjet ku përfshihen hetime komplekse ose kur është objektivisht e pamundur që ato të

përfundohen brenda periudhës së shtuar (paragrafi 2). I pandehuri dhe viktima njoftohen për vendimin e shtyrjes së periudhës së hetimit (paragrafi 3).

41. Sipas nenit 325 § 1, viktima mund të apelojë në gjykatën e rrethit kundër vendimit të prokurorit për shtyrjen e hetimit.

42. Neni 326 i KPP-së, i cili parashikon të drejtën e prokurorit për të pezulluar me një hetim penal, përcakton si më poshtë:

"1. Kur nuk njihet autori i veprës penale ose kur i pandehuri vuan nga një sëmundje e rëndë që ndalon hetimin e mëtejshëm, prokurori vendos pezullimin e hetimeve.
2. Pezullimi i hetimeve vendoset pasi të jenë kryer të gjitha veprimet e mundshme.
3. Vendimi penal i pezulluar mund të rifillojë me anë të një vendimi të prokurorit.".

43. Në periudhën e rastit konkret, nuk kishte asnjë parashikim specifik në KPP për të drejtën për të apeluar kundër vendimit të prokurorit për të pezulluar hetimin penal.

Praktika ligjore vendëse në lidhje me pezullimin e hetimit

44. Apeluesi, H.S. paraqiti në prokurori një padi penale në lidhje me vdekjen e motrës së tij. Prokurori e pezulloi hetimin bazuar në nenin 326 të KPP-së, për arsyen se nuk mund të gjendej asnjë autor i krimit. Apeluesi nisi procedime ligjore kundër pezullimit të hetimit penal. Ai u ankua se nuk ishte informuar në lidhje me përmbajtjen e dosjes së hetimit ose pezullimin e hetimit penal, se prokurori nuk kishte marrë në pyetje të gjithë dëshmitarët dhe se ai nuk kishte asnjë mjet efikas për t'u ankuar në lidhje me vendimin për të pezulluar hetimin penal. Gjykatat vendëse e kundërshtuan veprimin e tij. Gjykata e Apelit Tiranë u shpreh se përderisa hetimi penal kishte qenë në vijimësi dhe duke qenë se prokuroria kishte pasur lirinë për të përcaktuar veprimet investigative që do të kryheshin, ankuesi nuk kishte locus standi. Gjykata rikonfirmoi se nuk ekzistonte e drejta për të apeluar kundër vendimit për të pezulluar procedimet penale sipas së drejtës procedurale penale. Ankuesi paraqiti në Gjykatën Kushtetuese një ankesë kushtetuese, e cila u kundërshtua nga vendimi nr. 4, i datës 18 janar 2013. Gjykata Kushtetuese vendosi, inter alia, se nuk kishte asnjë mjet sipas ligjit vendës kundër vendimit të prokurorit për të pezulluar hetimin penal. Megjithatë, fakti se apeluesi kishte pasur akses në gjykatat vendëse, tregonte se ai kishte një të drejtë efektive për të apeluar në një gjykatë.

C. Kodi Civil

45. Neni 608 i Kodit Civil parashikon se cilido që në mënyrë të paligjshme shkakton dëme ndaj një personi tjetër ose ndaj pronës së atij personi, është i detyruar të paguajë kompensim për dëmin. Ai nuk ka përgjegjësi nëse provon se nuk është në faj. Neni 609 parashikon se duhet të jetë rezultati i veprimit ose i mosveprimit të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm të një personi. Neni 625 parashikon se një person i cili vuan dëm jomonetar ka të drejtën për kompensim, nëse: ka pasur dëme ndaj shëndetit të tij, integritetit fizik ose mendor; nëse janë cenuar nderi, personaliteti ose reputacioni i tij; ose nëse është cenuar e drejta e tij për respektim ndaj jetës së tij private. Sipas nenit 640, dëmi monetar përbëhet nga humbja aktuale e vuajtur dhe humbja e përfitimit. Sipas nenit 641, një person i cili shkakton dëm ndaj shëndetit të dikujt tjetër duhet të paguajë kompensim.

D. Praktika gjyqësore vendëse në lidhje me shlyerjen e dëmeve

46. Qeveria paraqiti disa praktika gjyqësore vendëse në lidhje me shlyerjen e dëmeve, si pjesë e vërejtjeve të saj.

Në vendimin unifikues nr. 12, të datës 14 shtator 2007, pas një padie civile për dëme kundër Byrosë Shqiptare të Sigurimeve (një ent shtetëror), sipas neneve 625 dhe 640, të Kodit Civil, për vdekjen e tre personave në një aksident me makinë, Gjykata e Lartë vendosi si më poshtë:
"... gjykatat vendëse kanë pranuar se tre persona humbën jetën në një aksident me makinë ... në vijim, sipas nenit 608 të Kodit Civil ... legjislacioni parashikon mbrojtjen e së drejtës për jetën, shëndetin, personalitetin, dinjitetin, jetën private dhe kështu me radhë, nga aktet e paligjshme të një pale të tretë. Në rast se ka një shkelje të ndonjërës prej këtyre të drejtave, si rezultat i aktit të paligjshëm, pala e dëmtuar ka të drejtën për kompensim ekstrakontraktual ... Sipas nenit 609 të Kodit Civil, lidhja materiale rastësore midis sjelljes së paligjshme (veprimi ose mosveprime) dhe fajit dhe dëmit duhet të provohet. Në përcaktimin e dëmit aktual të shkaktuar nga fakti i paligjshëm dhe kompensimi përkatës, duhet të provohet edhe lidhja gjyqësore rastësore midis tyre".

Një apelues kërkonte kompensim nga një shtet, sipas nenit 640 të Kodit Civil për dëmin shkaktuar ndaj shëndetit të tij si rezultat i një plagosjeje me armë zjarri të shkaktuar nga oficerët e policisë së shtetit. Në vendimin e saj nr. 275, të datës 24 shtator 2009, Gjykata e Lartë ridërgoi përpara gjykatës përkatëse të apelit çështjen për rishqyrtim. Ajo argumentonte se si rezultat i dëmtimit të apeluesit nga oficerët e policisë së shtetit, ishte provuar rregullisht se dëmi ishte shkaktuar ndaj shëndetit të tij.

Në vendimin e datës 25 nëntor 2011, Gjykata e Rrethit Tiranë pranoi një padi civile nga ankuesit për kompensim kundër autoriteteve shtetërore, të paraqitur, inter alia, sipas neneve 625 dhe 640 të Kodit Civil, si rezultat i vdekjes së familjarit të tyre në një shpërthim masiv në godinën e çmilitarizimit.
Gjykata argumentoi se përgjegjësia penale ishte e pavarur nga detyrimi civil në lidhje me kompensimin, çka lidhej vetëm me kompensimin për dëmin e shkaktuar nga aktiviteti i rrezikshëm i çmilitarizimit.

LIGJI

I. SHKELJE E PRETENDUAR E NENEVE 3 DHE 13 TË KONVENTËS

47. Sipas nenit 3, ankuesi u shpreh në lidhje me dëmet e pësuara si rezultat i ndërhyrjes së policies dhe pretendoi se hetimi, me qëllim identifikimin dhe dënimin e autorëve nuk kishte qenë i efektshëm. Neni 3 parashikon si më poshtë:

"Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, as dënimeve ose trajtimeve anjerëzore ose poshtëruese."

48. Në lidhje me rrethanat e kësaj çështjeje, Gjykata e konsideroi të përshtatshme të komunikonte sipas mocionit të saj çështjen sipas nenit 13 të Konventës, i cili parashikon si më poshtë:

"Çdo person, të cilit i kanë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura në këtë Konventë, ka të drejtë të paraqesë një ankim efektiv përpara një instance kombëtare, edhe kur kjo shkelje ka qenë kryer nga persona që veprojnë brenda ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare."

49. Qeveria i kontestoi argumente e ankuesit.

A. Pranueshmëria

1. Në lidhje me paraqitjen e një padie civile sipas neneve 608 dhe në vijim të Kodit Civil dhe nenit 610 të KPP-së

50. Qeveria parashtroi se ankuesi nuk kishte shteruar mjetet vendëse të tilla si padia civile për dëmet, sipas neneve 608, 625 dhe 640 të Kodit Civil dhe vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë, i dates 13 shtator 2007 për dënime shkaktuar nga shkelja e pretenduar e torturës dhe një padi civile gjatë procedimeve penale, sipas nenit 61 të KPP-së.

51. Ankuesi parashtroi se një padi civile për dëmshpërblim nuk mund të çonte në identifikimin dhe dënimin e personave përgjegjës për shkeljen e nenit 3. Për çdo rast, këto mjete mund të jenë efikase pas përcaktimit të shkakut të dëmit. Praktika gjyqësore vendëse e parashtruar nga qeveria nuk ishte e zbatueshme për këtë çështje, duke qenë se të gjitha ato çështje ishin ndryshe prej çështjes së tij. Procedimet penale sipas nenit 61 të KPP-së mund të përdoreshin vetëm në rastin nëse padia penale ishte ndaj dikujt dhe çështja dërgohet për gjykim përpara gjykatave vendëse. Për këtë arsye, një padi e tillë nuk paraqiste ndonjë perspektivë për sukses në rastin e tij, duke qenë se hetimi ishte pezulluar dhe nuk kishte padi ndaj asnjë personi.

52. Gjykata thekson, se në aspektin e përdorimit të paligjshëm të forcës nga agjentët e shtetit dhe, jo thjesht për faj, mosveprim ose neglizhencë, procedimet civile ose administrative për qëllimin e vetëm dhënien e dëmshpërblimeve, më shumë sesa garantimin e identifikimit dhe dënimit të personave përgjegjës, nuk janë mjetet të përshtatshme dhe efikase, të cilat mund të sigurojnë korrigjim për ankesat bazuar në aspektin e qartë të neneve 2 dhe 3 të Konventës (shih, inter alia, Yaşa kundër Turqisë, 2 shtator 1998, § 74, Raportet e gjykimeve dhe vendimeve 1998-VI; Mocanu dhe të Tjerët kundër Rumanisë [DHM], nr. 10865/09 dhe 2 të tjerë, § 227, GJEDNJ 2014 (ekstrakte); dhe Jeronovičs kundër Letonisë [GC] dhe 44898/10, § 76, GJEDNJ 2016).

53. Detyrimi i palëve kontraktuese sipas neneve 2 dhe 3 të Konventës, për të kryer një hetim i cili do të mund të çojë në identifikimin dhe dënimin e personave përgjegjës në çështjet e agresionit, mund të konsiderohet si iluzion, në rast se në lidhje me ankesat sipas atyre neneve, një ankuesi i kërkohej të ndërmerrte një veprim, i cili do të çonte vetëm në dhënien e dëmshpërblimit (shih Mocanu dhe të tjerët, cituar më sipër, § 234 dhe Jeronovičs, cituar më sipër, § 77).

54. Në çështjen në fjalë, Gjykata vëren se ankuesi pretendonte se shteti nuk kishte respektuar detyrimet që i parashtroheshin sipas aspektit substancial të nenit 3 të Konventës dhe sipas aspektit procedural të këtij neni për të realizuar një hetim efikas i cili do të mund të çonte në identifikimin dhe ndëshkimin e personave përgjegjës për keqtrajtimin e pretenduar. Në lidhje me këtë aspekt, Gjykata vëren se një padi civile për dëmshpërblim, sipas Kodit Civil të Shqipërisë dhe KPP-së, synon vetëm në dhënien e dëmshpërblimeve më shumë sesa në garantimin e identifikimit dhe ndëshkimit të personave përgjegjës.

55. Për arsyet e përcaktuara më sipër, Gjykata mendon se mjetet e parashtruara nga qeveria nuk janë mjaftueshëm për arsyen se ato nuk mund të garantojnë korrigjim për situatën e paraqitur nga ankuesi.

2. Në lidhje me paraqitjen e një ankimi të parakohshëm dhe një apeli përpara një prokurori të një niveli më të lartë

56. Qeveria parashtroi se procedimet penale nuk kishin përfunduar ende, duke qenë se vendimi interlokutor, i datës 7 qershor 2013, kishte shfrytëzuar një mundësi tjetër për të identifikuar autorët.

Ankuesi nuk bëri apel kundër vendimit të prokurorit të datës 7 qershor 2013, te një prokuror i një niveli më të lartë, sipas nenit 24 të KPP-së.

57. Ankuesi parashtroi se fakti, se hetimi ishte pezulluar, nënkuptonte se vijonte ende shkelja sipas nenit 3 të Konventës. Më tej, ai argumentoi se ligji vendës nuk parashikonte asnjë apel kundër vendimit të prokurorit për të pezulluar një hetim.

58. Gjykata vëren se një nga pakënaqësitë e ankuesit është fakti se hetimi i pretendimit të tij për keqtrajtim nuk ishte efikas. Ajo konstaton se kundërshtimi i qeverisë se çështja nuk është përfunduar ende dhe se ankuesi nuk kishte paraqitur ankim sipas nenit 24 të KPP-së, është i lidhur ngushtë me ankesën e tij për efikasitetin e hetimit. Kështu, gjykata e bashkon këtë kundërshtim me cilësitë e çështjes, sipas nenit 3 dhe 13 të Konventës.

3. Përfundim

59. Gjykata vëren se këto ankesa nuk janë haptazi të pabazuara sipas interpretimit të nenit 35 § 3 (a) të Konventës. Në vijim, ajo vëren se ato nuk janë të papranueshme për ndonjë shkak tjetër. Për këtë arsye, ato duhet të deklarohen të pranueshme, pa paragjykim nga vendimi që do të merret përfundimisht në lidhje me kundërshtimin e qeverisë për mosshfrytëzimin e mjeteve të brendshme.

B. Meritat (themeli)

1. Shkelje e pretenduar e aspektit të pavarur të nenit 3 të Konventës

a) Parashtrimet e palëve

60. Ankuesi parashtroi se dosja e hetimit dhe vendimi i prokurorit provonin faktin se gjashtë oficerë policie kishin përdorur dhunë kundër tij. Kjo ishte mbështetur nga pohimet e dëshmitarëve të tjerë. Autoritetet e kishin poshtëruar atë duke përdorur publikisht dhunë. Ata kishin përdorur shkopinj gome ndaj tij përpara bashkëqytetarëve të tij, duke i shkaktuar dëmtime serioze. Nuk kishte të dhëna se ankuesi kishte shkaktuar grindjen ose të kishte qenë protagonist. Për më tepër, ankuesi nuk kishte përdorur objekte të forta ose nga persona të tjerë të përfshirë në grindje. Asnjë nga dëshmitarët nuk kishte dëshmuar se këto objekte ishin përdorur në skenë. Në vijim, ankuesi parashtroi se qeveria nuk kishte mundur të konfirmonte ndonjë sjellje të veçantë nga ai, sjellje e cila kërkonte përdorimin e dhunës nga policia, duke përfshirë përdorimin e pakufizuar të dhunës. Për këtë arsye, autoritetet kishin përdorur dhunë të panevojshme dhe të tepruar ndaj tij, duke shkaktuar dëme të rënda ndaj shëndetit të tij. Veprimet e policisë ishin të paplanifikuara, të paorganizuara dhe joprofesionale. Në të vërtetë, nuk ishte detyra e oficerëve të policisë së FNSH-së të mbronin rendin publik në qytet. Veprimet e autoriteteve përbënin trajtim çnjerëzor dhe degradues.

61. Qeveria parashtroi se rrethanat faktike të çështjes nuk demonstronin se ankuesi kishte qenë objekt i torturës ose i trajtimit çnjerëzor ose degradues. Nuk kishte të dhëna për të provuar ose për të krijuar dyshime se oficerët e policisë kishin përdorur dhunë ndaj tij ose se dëmtimet e tij ishin shkaktuar nga ata. Pohimet e ankuesit nuk përbënin një “konfirmim të besueshëm”, sepse ato ishin kontradiktore. Hetimi ka provuar faktin se ankuesi kishte qenë protagonist në grindjen fizike, e cila kishte rezultuar në përdorimin e shisheve të birrës dhe objekteve të tjera të forta. Përveç pohimeve kontradiktore të ankuesit, nuk kishte asnjë deklaratë tjetër ku pohohej se oficerët e policisë kishin përdorur objekte të tilla si këto. Nuk kishte asnjë bazë për të dhënë se dëmtimet e ankuesit nuk ishin

shkaktuar si rezultat i grindjes së tij fizike me personat e tjerë. Për më tepër, ankuesit nuk kishin pohuar se ata kishin pasur një konfrontim fizik me policinë. Standardi i provës "përtej dyshimit të arsyeshëm" nuk është përmbushur në çështjen konkrete. Dhuna e përdorur nga oficerët e policisë, në rast se ka pasur dhunë, me qëllimin për të mbrojtur të tjerët të përfshirë në zënkë, nuk mund të kualifikohej si torturë, sipas kuptimit të nenit 3 të Konventës.

b) Vlerësimi i Gjykatës

62. Gjykata u referohet parimeve të përgjithshme të përcaktuara në Bouyid kundër Belgjikës [DHM] (nr. 23380/09, § § 81-90, GJEDNJ 2015).

63. Gjykata vëren se materiali që ajo zotëron përfundimisht demonstron se gjatë ditës së ngjarjeve në fjalë, ankuesi pësoi dëmtime. Në të vërtetë, raporti mjekoligjor, i nxjerrë një ditë pas ngjarjeve të datës 7 gusht 2012, vërtetësia e të cilit nuk kundërshtohet, përmend se ankuesi "u dëmtua nga një mjet i fortë, jo i mprehtë" (shih paragrafin 20 më sipër). Për më tepër, ankuesi nuk mund të punonte për nëntë ditë. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundimin se dëmtimet e ankuesit ishin mjaftueshëm të rënda për t'u përfshirë në nenin 3 të Konventës.

64. Në fillim, Gjykata vëren se palët janë në mosmarrëveshje për faktin nëse ankuesi ishte bërë objekt i dhunës së ushtruar nga oficerët e policisë. Për këtë arsye, mbetet për t'u përcaktuar nëse autoritetet shtetërore mund të bëhen përgjegjëse për shkaktimin e këtyre dëmeve dhe të jenë llogaridhënës sipas parashikimit të mësipërm.

81. Gjykata vëren se gjatë gjithë hetimit, ankuesi pretendonte në mënyrë të vazhdueshme se autoritetet kishin përdorur forcën ndaj tij. Përshkrimi i ngjarjeve nga ankuesi u konfirmua nga dy dëshmitarë (N.P. dhe Ni.P.) të marrë në pyetje gjatë hetimit (shih edhe paragrafin 29 më sipër). Megjithatë, të gjithë oficerët e policisë në fjalë pohuan të kundërtën në unison me njëri-tjetrin. Ata pohuan vazhdimisht se ankuesi kishte pasur një dëmtim në pjesën e pasme të kokës së tij që prej fillimit, kur ai u përfshi në zënkë dhe se ata nuk kishin përdorur dhunë ndaj tij (shih paragrafët 9, 10, 14 dhe 32–34 më sipër). Kjo rrjedhë ngjarjesh u konfirmua nga dëshmitarët A.S., A.E. dhe J.K. në deklaratat e tyre të datës 7 gusht dhe 17 tetor 2012, dhe 15 janar 2013. Nën këto rrethana, është e qartë se i gjithë grupi i ngjarjeve nuk "përfshihet plotësisht ose në pjesën më të madhe, brenda dijenisë ekskluzive të autoriteteve". Ndërsa raporti mjekësor në lidhje me ankuesin doli një ditë pas ngjarjeve; kjo nuk është mjaftueshëm për Gjykatën që të dalë në një përfundim, sigurisht jo përtej dyshimit të arsyeshëm, si ai ishte keqtrajtuar në të vërtetë, në shkelje të nenit 3 të Konventës (shih, mutatis mutandis, Habimi dhe të Tjerët kundër Serbisë, nr. 19072/08, § 89, 3 qershor 2014). Raporti i dytë i ekspertizës I realizuar nga FNSH-ja shpjegonte se kishte qenë e pamundur të identifikohej objekti i cili kishte shkaktuar dëmtimet e ankuesit. Për më tepër, kishte disa tregues në lidhje me faktin se dëmtimet e pësuara nga ankuesi mund të jenë shkaktuar si pasojë e përfshirjes së tij dhe e të tjerëve në grindje përpara ndërhyrjes së policisë. Sipas vendimit të prokurorit, të datës 13 maj 2013, ankuesi ishte goditur nga një person tjetër përpara ndërhyrjes së policisë gjatë konfliktit fizik. Gjykata vëren se vendimi i prokurorit shpjegonte se kishin lindur dyshime nëse ishte kryer shkelja e abuzimit me pushtetin, për shkakun se dëmtimet e pësuara nga ankuesi mund të jenë shkaktuar teksa u shoqërua në rajonin e policisë nga oficerët e policisë. Ai këmbënguli fort se oficerët e policisë e kishin rrahur atë në public në rrugën kryesore të qytetit. Nën këto rrethana, Gjykata vëren se nuk

është i dukshëm fakti nëse ankuesi ishte ende në shëndet të mirë në momentin kur autoritetet mbërritën në skenën e krimit (shih, për shembull, Kobets kundër Ukrainës nr. 16437/04, §§ 46–48, 14 shkurt 2008).

65. Nën rrethana të tilla, duke pasur parasysh të gjithë informacionin që gjykata zotëron dhe sipas parimeve të përcaktuara prej saj në çështjen e fundit të Bouyid, cituar më sipër, ku kishte të dhëna imponuese të cilat tregojnë faktin se dëmtimet e ankuesit ishin shkaktuar nga oficerët e policisë, siç edhe deklarohet nga ankuesi (shih edhe Kulyk kundër Ukrainës, nr. 30760/06, § 83, 23 qershor 2016), Gjykata nuk mundet tjetër veçse të konstatojë se nuk ka pasur shkelje të aspektit thelbësor të nenit 3 të Konventës.

2. Shkelje e pretenduar e aspektit procedural të nenit 3 të Konventës

a) Parashtrimet e palëve

66. Ankuesi parashtroi se autoritetet nuk kishin mundur të realizonin një hetim efikas dhe të pavarur në lidhje me incidentin. Ata nuk kishin mundur të sqaronin mënyrën se si ai i kishte pësuar plagët pas kokës së tij, në kurriz dhe në shpatulla. Autoritetet nuk morën në pyetje dëshmitarë të tjerë dhe nuk ekzaminuan provat materiale të tilla si objekte të forta. Autoritetet nuk mundën të përcaktonin se cilët oficerë ishin përgjegjës, për të identifikuar dhe për të dënuar në këtë mënyrë autorët. Autoritetet nuk kishin dhënë asnjë ndihmë mjekësore dhe ankuesi ishte dërguar në spital me ndihmën e familjarëve të tij.

67. Më tej, ankuesi parashtroi se hetimi nuk kishte qenë i shpejtë duke u bazuar në faktin se ai e kishte dorëzuar padinë penale në gusht 2012 dhe autoritetet e kishin informuar atë në qershor 2013, se hetimi ishte pezulluar. Sipas nenit 323 § 1 të KPP-së, një hetim paraprak nuk mund të marrë më shumë se tre muaj, ndërsa në çështjen në fjalë oficerët e policisë ishin marrë në pyetje vetëm pesë muaj pas incidentit.

68. Për më tepër, ankuesi nuk ishte përfshirë në procedimet e hetimeve. Në të vërtetë, ai nuk ishte njoftuar për faktin se hetimi ishte zgjatur. Atij nuk i ishin dhënë kopje të dokumenteve nga dosja e hetimit penal në lidhje me nenin 105 të KPP-së. Autoritetet, pasi nuk e kishin informuar atë në lidhje me masat e marra, sipas neneve 58 dhe 105 të KPP-së, i kishin mohuar atij mjetet efikase. Për më tepër, oficerët e policisë nuk ishin pezulluar nga detyra gjatë hetimit. Gjithashtu, sipas ankuesit, bazuar në nenin 248 të Kodit Penal, ndjekja penale e shkeljes së abuzimit me pushtetin u parashkrua pas pesë vitesh. Vonesat e lejuara nga prokuroria dhe vendimi i prokurorisë për të pezulluar hetimin, kishte bërë të mundur që autorët të shmangnin përgjegjësinë.

69. Qeveria parashtroi se autoritetet kishin vepruar me zell dhe një hetim zyrtar efikas ishte ndërmarrë me qëllimin për të ndëshkuar autorët. Autoritetet e shoqëruan ankuesin në spital, për të marrë ndihmën mjekësore, pas ankesave të tij në lidhje me dëmet që kishte pësuar. Hetimi kishte qenë i shpejtë bazuar në faktin se ai kishte filluar pak minuta pasi kishte ndodhur incidenti.

70. Më tej, qeveria parashtroi se prokurori dhe oficerët e policisë gjyqësore kishin ndërmarrë një sërë masash procedurale. Gjatë procedimeve penale, ankuesi nuk kishte ngritur asnjë ankesë në lidhje me ndonjë mosveprim ose refuzim nga ana e autoriteteve për të ndërmarrë ndonjë veprim procedural. Nën rrethanat, kur kishte ekzistuar një mundësi se ankuesi kishte bërë një padi false ndaj oficerëve të policies dhe teksa identifikimi i autorëve kishte qenë i pamundur, autoritetet e kishin pezulluar hetimin, por nuk e kishin ndërprerë

çështjen. Në të vërtetë, vendimi i prokurorit, i datës 13 maj 2013, kishte urdhëruar realizimin e masave specifike për identifikimin e autorëve të krimit. Në këtë mënyrë, hetimi nuk ishte mbyllur ende.

b) Vlerësimi i Gjykatës

71. Gjykata u referohet parimeve të përgjithshme të përcaktuara në, inter alia, El-Masri cituar më sipër, §§ 182–185); Mocanu dhe të Tjerët kundër Rumanisë [DHM] cituar më sipër, nr. 10865/09 dhe 2 të tjerë, §§316–326, GJEDNJ 2014 (ekstrakte); dhe Bouyid (cituar më sipër, §§ 114–123).

72. Gjykata përsërit se mungesa e përfundimeve bazuar në hetimet e realizuara, nuk nënkupton në vetvete se hetimet nuk ishin efikase. Jo çdo hetim duhet që të jetë domosdoshmërisht i suksesshëm ose të dalë në një përfundim, fakt i cili përkon me paraqitjen e ngjarjeve nga ankuesi; megjithatë në parim, hetimi duhet të përcaktojë faktet e çështjes dhe nëse pretendimet provohen të jenë të vërteta, hetimi duhet të çojë në identifikimin dhe ndëshkimin e personave përgjegjës (shih Mikheyev kundër Rusisë, nr. 77617/01, § 107, 26 janar 2006).

73. Gjykata vëren se pas ankimit të ankuesit, autoritetet vendëse kishin realizuar një hetim në lidhje me pretendimet e tij për keqtrajtim. Autoritetet ndërmorën një numër hapash investigativë: u morën në pyetje dëshmitarët, u kontrolluan regjistrat e regjistrimit të të dhënave në rajonin e policisë, u morën dhe u kontrolluan regjistrimet nga dy videokamerat e dy bankave aty afër, si edhe u mor një raport tjetër mjekoligjor. Gjykata e pranon se autoritetet kishin reaguar ndaj shqetësimeve të ankuesit; megjithatë, ajo nuk është e bindur se përgjigjet e tyre ndaj pretendimeve të tij ishte mjaftueshëm e detajuar ose "efikase" për përmbushjen e kërkesave të nenit 3.

74. Më specifikisht, Gjykata vëren se në çështjen konkrete, ankuesit nuk i ishin ofruar përditësimet e kënaqshme në lidhje me statusin e hetimit ose nuk i ishte mundësuar akses në dokumente (shih paragrafët 40–43 më sipër; shih Barysheva kundër Ukrainës, nr. 9505/12, §§ 59–61, 14 mars 2017). Për këtë arsye, Gjykata merr në konsideratë edhe pretendimin e qeverisë se ankuesi nuk u ankua për refuzimin e autoriteteve që të ndërmerrnin veprime procedurale, teksa ankuesi nuk kishte mundësi reale për të bërë një gjë të tillë.

75. Më tej, Gjykata vëren se procedimet fillimisht u realizuan me shpejtësinë e kërkuar. Megjithatë, disa prej masave thelbësore hetuese u ndërmorën në mënyrë të pashpjegueshme vonë. Në lidhje me këtë aspekt, Gjykata vëren se edhe pse ankuesi ishte ankuar tek autoritetet në ditën e incidentit, 6 gusht 2012 dhe kishte paraqitur edhe një padi penale ndaj oficerëve të policisë së RRF-së, dy ditë pas incidentit, oficerët e policisë të përfshirë, u morën në pyetje nga prokurori pesë muaj pas incidentit. Në lidhje me këtë aspekt, Gjykata përsërit se kishte nënvizuar në mënyrë të vazhdueshme rëndësinë për të kontaktuar dhe për të marrë në pyetje dëshmitarët menjëherë pas ndodhjes së këtyre incidenteve, teksa kujtimet janë të freskëta (shih, për shembull, Doiciu kundër Rumanisë, nr. 1454/09, § 62, 5 maj 2015). Për më tepër, raporti i dytë mjekoligjor për çështjen, doli shtatë muaj pas incidentit (shih Dinu kundër Rumanisë, nr. 64356/14, § 82, 7 shkurt 2017).

76. Gjykata vëren se kishte pasur edhe mungesa të tjera. Autoritetet e prokurorisë morën në pyetje dy dëshmitarë, të cilët dëshmuan në favor të ankuesit dhe gjashtë oficerë policie dhe tre dëshmitarë, të cilët dëshmuan kundër tij. Megjithatë, arsyetimi në vendimin e

prokurorit për të pezulluar hetimin nuk përmban ndonjë vlerësim të dëshmive të dëshmitarëve në favor të ankuesit. Prokurori nuk ofroi ndonjë shpjegim në lidhje me faktin se përse këto dëshmi konsideroheshin më pak të besueshme sesa deklaratat e oficerëve të policisë dhe të tre dëshmitarëve (shih Mustafa Hajili kundër Azerbajxhanit, nr. 42119/12, § 52, 24 nëntor 2016). Pavarësisht faktit se deklaratat e tyre binin qartazi në kundërshtim me deklaratën e ankuesit, prokurori përgjegjës për çështjen nuk urdhëroi një përballje të drejtpërdrejtë midis ankuesit dhe oficerëve të policisë ose edhe një parakalim identifikimi, pavarësisht se ankuesi kërkoi qartazi për një të tillë (shih Chmil kundër Ukrainës, nr. 20806/10, § 89, 29 tetor 2015 dhe Hilal Mammadov kundër Azerbajxhanit, nr. 81553/12, § 96, 4 shkurt 2016).

77. Gjithashtu, Gjykata vëren se vendimi i fundit për çështjen, vendim i datës 13 maj 2013 për të pezulluar hetimin, nuk ofron ndonjë përgjigje përfundimtare për mënyrën se si ishin shkaktuar dëmtimet e ankuesit. Po kështu, ai nuk hedh poshtë mundësinë se dëmtimet në fjalë mund të kenë rezultuar nga dhuna e policisë; ku edhe vetë prokurori ka dyshime në lidhje me shkakun e dëmtimeve të ankuesit, pa dhënë arsye të mëtejshme. Gjithashtu, si reagim ndaj parashtrimit të qeverisë, se hetimi nuk është përfunduar ende, Gjykata vëren se, edhe pse kishin kaluar më shumë se katër vjet që nga momenti kur hetimi u pezullua, autoritetet e policisë nuk kishin ndërmarrë ndonjë hetues që prej atij momenti. Qeveria nuk paraqiti ndonjë dokument për të raportuar në lidhje me progresin e arritur nga autoritetet e policisë në përpjekje të mëtejshme për të qartësuar faktet për të cilat ka shprehur shqetësimin ankuesi. Për këtë arsye, për sa i përket seriozitetit të çështjeve konkrete, Gjykata nuk mendon se ankuesi duhet të kishte pritur për rezultatin e ndonjë hetimi tjetër nga SHKB-ja, përderisa autoritetet e policisë nuk ishin ndërmarrë masa të tjera hetuese, që prej pezullimit të procedimeve nga prokurori i rrethit më 13 maj 2013 (shih mutatis mutandis, Barakhoyev kundër Rusisë, nr. 8516/08, § 38, 17 janar 2017).

78. Për sa i përket apelimit sipas nenit 24 të KPP-së, Gjykata vëren se sipas ligjit të brendshëm, në fuqi në periudhën konkrete, një prokuror i një niveli më të lartë kishte të drejtë të anulonte vendimet e një prokurori të një niveli më të ulët. Megjithatë, Gjykata vëren se KPP-ja nuk parashikonte të drejtën për të apeluar kundër vendimit të prokurorit për pezullimin e hetimit penal. Po ashtu, në vendimin e saj të datës 18 janar 2013, Gjykata Kushtetuese vëren se nuk kishte asnjë mjet sipas ligjit të brendshëm ndaj vendimit të prokurorit për të pezulluar një hetim. Sipas nenit 326 të KPP-së, hetimi mund të rihapej vetëm me anë të një vendimi të prokurorit. Sipas arsyetimeve të mësipërme dhe duke vërejtur se qeveria nuk parashtroi ndonjë praktikë gjyqësore vendëse, Gjykata ka dyshime serioze nëse gjykatat e brendshme do të kishin pranuar në të vërtetë një apel nga ankuesi ndaj vendimit të datës 13 maj 2013. Duke marrë në konsideratë faktorët e sipërpërmendur, Gjykata është e mendimit se mjeti në fjalë nuk do t'i kishte ofruar ankuesit kompensimin e duhur për ankesat e tij.

79. Në fund, Gjykata vëren shqetësimin e ankuesit në lidhje me pavarësinë e hetimit. Gjykata është e mendimit se nuk kërkohet që kjo çështje të adresohet në mungesë të një parashtrimi specifik nga ankuesi, duke pasur parasysh se edhe hetimi në tërësi nuk ishte efikas për shkak të mangësive të përmendura më sipër.

80. Arsyetimet e mësipërme janë të mjaftueshme për t'i mundësuar Gjykatës të arrijë në përfundimin se hetimi i kërkesës së ankuesit për keqtrajtim nuk ishte efikas. Për këtë arsye,

Gjykata e pushon kundërshtimin paraprak të qeverisë në lidhje me mosshterimin e mjeteve të brendshme dhe konstaton se ankuesi ka vuajtur një shkelje të aspektit procedural të nenit 3 të Konventës.

98. Sipas konstatimeve të saj sipas nenit 3, Gjykata mendon se nuk është e nevojshme të shqyrtojë nëse ka pasur një shkelje të nenit 13 të Konventës në këtë rast.

II. SHKELJE TJETËR E PRETENDUAR KONVENTËS

81. Në formularin e tij të ankesës, ankuesi shprehu shqetësimin bazuar në nenin 3 të Konventës, se ai ishte kërcënuar, abuzuar dhe keqtrajtuar, teksa shoqërohej për në rajonin e policisë. Megjithatë, ankuesi nuk parashtroi ndonjë kërkesë specifike në vërejtjet e tij përpara Gjykatës.

100. Sipas informacioneve të disponueshme në dosjen e çështjes dhe mungesës së parashtrimeve nga të dyja palët, Gjykata mendon se nuk ka të dhëna se ankuesi është kërcënuar ose abuzuar në të vërtetë, siç pretendohet. Padia e ankuesit, për rrjedhojë, nuk është e bazuar në fakte dhe duhet të kundërshtohet bazuar në nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

III. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

82. Neni 41 i Konventës parashikon:

"Kur Gjykata deklaron shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe në qoftë se e drejta e brendshme e Palës së Lartë kontraktuese mundëson vetëm një mënjanim të pjesshëm të pasojave që kanë rrjedhur nga kjo shkelje, Gjykata, kur ka vend, i cakton palës së dëmtuar, një shpërblim të drejtë."

A. Dëmi

83. Ankuesi kërkoi 5,000 euro (EUR) për dëmin jomonetar.

84. Qeveria e kundërshtoi kërkesën e ankuesit si të pabazuar sipas fakteve dhe të dhënave.

85. Në lidhje me konstatimin për një shkelje të nenit 3 të Konventës, bazuar në elementet e saj procedurale dhe duke bërë vlerësimin e saj në mënyrë të paanshme, Gjykata i akordon ankuesit EUR 3,000 për dëmin jomonetar.

B. Kostot dhe shpenzimet

86. Gjithashtu, ankuesi kërkoi edhe EUR 2,013 për kostot dhe shpenzimet e bëra përpara Gjykatës. Kjo përfshinte një shumë në total prej EUR 1,500 për sa i përket tarifës ligjore për përfaqësimin e tij dhe EUR 513 për sa i përket përkthimit dhe shpenzimeve postare dhe atyre të fotokopjimeve.

87. Qeveria e kundërshtoi kërkesën e ankuesit si të pabazuar sipas fakteve dhe të dhënave.

107. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës, një ankues ka të drejtën për rimbursimin e kostove dhe të shpenzimeve vetëm për aq sa provohet se ato faktikisht janë bërë dhe kanë qenë të nevojshme për t'u bërë dhe janë të arsyeshme sipas kuantit (shih Gjyli kundër Shqipërisë, nr. 32907/07, § 72, 29 shtator 2009). Në çështjen konkrete, sipas dokumenteve në zotërim të Gjykatës dhe kritereve të mësipërme, Gjykata e mendon të arsyeshme akordimin e shumës prej EUR 1,560 për të mbuluar kostot nën çdo zë.

C. Interesi i vonuar

88. Gjykata e arsyeton të përshtatshme që norma e interesit të vonuar duhet të bazohet në normën margjinale të huadhënies së Bankës Qendrore Evropiane, së cilës i duhen shtuar pikë, tre për qind.

PËR KËTO ARSYE, NË MËNYRË UNANIME, GJYKATA:

1. *Vendos* të bashkohet me themelin e kundërshtimit të qeverisë për mosshterim të mjeteve të brendshme dhe ta pushojë atë;

2. *T'i deklarojë* ankesat në lidhje me keqtrajtimin e pretenduar të ankuesit dhe efikasitetin e hetimit të pranueshme dhe pjesën tjetër të ankimit të papranueshëm;

3. Gjykon se nuk ka pasur shkelje të nenit 3 të Konventës sipas pjesës së saj substanciale;

4. *Gjykon* se ka pasur një shkelje të nenit 3 të Konventës, sipas pjesë së saj procedurale;

5. *Gjykon* se nuk ka nevojë të shqyrtohet ankesa sipas nenit 13 të Konventës;

6. *Gjykon* në mënyrë unanime:

a) Se shteti i paditur duhet t'i paguajë ankuesit, brenda tre muajve nga data kur vendimi bëhet i formës së prerë, në përputhje me nenin 44 § 2 të Konventës, shumat e mëposhtme, të cilat duhet të konvertohen në monedhën e shtetit të paditur, në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes:

i. EUR 3,000 (tri mijë euro), plus çdo taksë e cila mund të jetë e tarifueshme, për sa i përket demit jomonetar;

ii. EUR 1,560 (një mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë euro), plus çdo taksë e cila mund të jetë e tarifueshme ndaj ankuesit, në lidhje me kostot dhe shpenzimet;

b) Se prej përfundimit të tre muajve të sipërpërmendur deri në shlyerjen e shumës, për shumat e mësipërme do të paguhet interes i thjeshtë në një normë të barabartë me normën huadhënëse margjinale të Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së vonesës plus pikë, tre për qind;

7. *Pushon* pjesën tjetër të kërkesës së ankuesit për kompensim të drejtë.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim, më 13 shkurt 2018, sipas rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Stanley Naismith
Regjistrues

Robert Spano
Kryetar

SEKSIONI I DYTË

ÇËSHTJA PRIZRENI KUNDËR SHQIPËRISË

(kërkesa nr. 29309/16)

VENDIM

STRASBURG

11 qershor 2019

Ky vendim është bërë i formës së prerë, bayuar në nenin 44 § 2 të Konventës.

Ai mund të bëhet objekt i rishikimit redaktues.

Në çështjen Prizreni kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i dytë), e mbledhur si një Dhomë e përbërë nga:

Robert Spano, kryetar,

Marko Bosnjak,

Ijil Karakaj,

Julia Laffranque,

Valeriu Gritco,

Arnfinn Bardsen,

Darian Pavli, gjyqtarë dhe Stanley Naismith, sekretar i seksionit,

pasi diskutuan me dyer të mbyllura në datën 21 maj 2019,

shpall vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në po atë datë.

PROCEDURA

1. Çështja filloi me një kërkesë (nr. 29309/16) kundër Republikës së Shqipërisë, paraqitur në gjykatë, në datën 16 maj 2016, mbështetur në nenin 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa), nga një shtetas shqiptar, z. Fatos Prizreni (kërkuesi).

2. Kërkuesi u përfaqësua nga znj. E. Skendaj, nga Komiteti i Helsinkit. Qeveria shqiptare (qeveria) u përfaqësua nga agjenti i saj, znj. Alma Hicka nga Avokatura e Shtetit.

3. Kërkuesi u ankua për mungesë të një hetimi efikas për vdekjen e vëllait të tij, teksa ishte duke vuajtur dënimin me burgim, në kundërshtim me nenin 2 të Konventës. Gjithashtu, ai u ankua për trajtimin çnjerëzor dhe degradues ndaj vëllait të tij, si rezultat i mungesës së trajtimit mjekësor dhe faktit se vëllai i tij kishte qenë i prangosur teksa ishte në spital, në kundërshtim me nenin 3 të Konventës.

4. Në datën 4 tetor 2016, qeveria u njoftua për ankesat në lidhje me mungesën e pretenduar për një hetim efikas për vdekjen e vëllait të kërkuesit, teksa ai po vuante një dënim me burgim, si edhe për një trajtim të pretenduar çnjerëzor dhe degradues si rezultat i mungesës së trajtimit mjekësor dhe faktit se kishte qenë në pranga ndërsa ishte në spital. Pjesa tjetër e kërkesës u shpall e papranueshme sipas rregullës 54 § 3 të Rregullores së gjykatës.

FAKTET

1. RRETHANAT E ÇËSHTJES

5. Kërkuesi ka lindur në vitin 1963 dhe jeton në Elbasan, Shqipëri. Ai është vëllai i SH.P., lindur në vitin 1973. SH.P. vdiq më 22 shkurt 2011.

A. Vdekja e vëllait të kërkuesit

2. Më 29 mars 2010, Gjykata e Rrethit Shkodër dënoi SH.P. me katër vjet burg për vrasje të mbetur në tentativë. Procesi u zhvillua *in absentia*. Më 2 dhjetor 2010, Gjykata e Apelit Shkodër la në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Shkodër. Më 3 shkurt 2011, vendimi i fundit u ekzekutua dhe SH.P. u dërgua të vuante dënimin në institucionin e paraburgimit Lezhë.

7. Nga dosja e çështjes rezulton se SH.P. u diagnostikua nga doktori i institucionit të paraburgimit Lezhë me parapanesis inferior (paralizë e pjesshme e të dyja këmbëve) dhe elephantiasis (filariasi limfatik). Më 9 shkurt 2011, SH.P. u transferua në mënyrë urgjente në Qendrën Spitalore të Burgjeve, Tiranë, sepse sipas doktorit në institucionin e paraburgimit Lezhë, ai nuk mund të trajtohej në mënyrën e duhur në një burg të zakonshëm. Më 17 shkurt 2011, ai u transferua në Qendrën Spitalore Universitare Tiranë. Nga dosja spitalore e datës 17 shkurt 2011, rezulton se vëllai i kërkuesit është diagnostikuar me elephantiasis, obezitet morbid dhe pamjaftueshmëri të shumëfishtë në organe, dhe iu përcaktuan mjekimet.

8. Rezulton se më 22 shkurt 2011, SH.P. vdiq në njësinë e kujdesit intensiv në Spitalin Universitar Tiranë.

B. Veprimet hetimore

9. Në datën 22 shkurt 2011, një grup i përbërë nga një oficer i policisë gjyqësore, një kriminalist dhe një ekspert mjekoligjor, realizoi kryerjen e vendit të ngjarjes në Qendrën Spitalore Universitare të Tiranës, dhe kryerjen e kufomës së SH.P., si edhe bëri fotografi në skenën e krimin. Në po të njëjtën ditë, oficeri i policisë gjyqësore sekuestroi kartelën klinike të SH.P., e cila mbahej në Qendrën Spitalore Universitare të Tiranës.

10. Më 22 shkurt 2011, oficeri i policisë gjyqësore, i ngarkuar me çështjen, urdhëroi një këqyrje mjekoligjore të SH.P. dhe i paraqiti pyetjet më poshtë ekspertëve mjekoligjorë:

“1. Çfarë dëmtimesh ishin të dukshme tek i ndjeri?

2. Çfarë i kishte shkaktuar ato?

3. Cili ishte shkaku i vdekjes së tij?

4. A kishte qenë ai subjekt i një trajtimi mjekësor neglizhent?”

11. Më 22 shkurt 2011, kërkuesi u mor në pyetje si personi me dijeni për ngjarjen. Ai pohoi se pjesëtarët e familjes së tij e kishin informuar se vëllai i tij po dërgohej në institucionin e ekzekutimin e vendimeve penale Lezhë. Më 17 shkurt 2011, nëna i kishte thënë se vëllai i tij ishte sëmurë dhe po transferohej në spitalin e Tiranës. Kur kishte mbërritur në spital, e kishte gjetur vëllanë pa ndjenja dhe të lidhur në krevat me çarçafë. Ai kishte vënë re se dysheku dhe batanijet ishin të lagura dhe se zona rreth krevatit ishte shumë e pistë. Rreth orës gjashtë të mëngjesit, më 22 shkurt 2011, motra e tij e kishte telefonuar për t'i thënë se situata e vëllait të tyre ishte përkeqësuar. Kur kishte mbërritur në spital, e kishte gjetur vëllanë të vdekur. Si shtoi se donte të dinte shkakun e vdekjes së vëllait të tij.

12. Më 25 shkurt 2011, oficeri i policisë gjyqësore, përgjegjës, kontrolloi regjistrin e shtrimeve në Spitalin e Burgut Tiranë, ku ishte regjistruar se SH.P., ishte transferuar në atë godinë, më 9 shkurt 2011.

13. Më 9 mars 2011 dhe përsëri më 25 mars 2011, Prokuroria e Tiranës kërkoi dosjen e SH.P. nga mjedisi i paraburgimit Lezhë. Më 21 mars 2011, Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Lezhë u përgjigj me anë të një shkrese, ku deklaronte se kërkuesi vuante nga dispnea, pjesët e poshtme të dy gjymtyrëve të tij kishin edemë dhe, se për këtë arsye, ai ishte transferuar me urgjencë në Spitalin e Burgut Tiranë. Gjithashtu, ata bashkëngjitën dosjen e burgut të SH.P.

14. Më 10 mars 2011, prokurori përgjegjës për çështjen urdhëroi një sërë veprimesh hetimore të cilat do të realizoheshin nga një oficer i policisë gjyqësore:

"1. Të kontaktohen ekspertët mjekoligjorë, të cilët do të kryenin një kontroll mjekoligjor për të gjetur shkakun e vdekjes së të ndjerit;

2. Të sekuestrohet dosja penale dhe kartela mjekësore e SH.P. nga ambientet e burgimit, si edhe nga spitali;

3. Të kontrollohet në regjistrat e Spitalit të Burgut Tiranës, Spitalit Universitar Tiranë dhe të spitalit civil Shkodër, për të zbuluar se kur është pranuar në spital, cila ka qenë diagnoza, sa kohë ka qëndruar atje etj., faqet e regjistrit të cilat janë relevante për kërkimin duhet t'i bashkëngjiten raportit; 4. Të merren në pyetje punonjësit e burgut të Tiranës, stafi mjekësor, i cili është kujdesur për SH.P. dhe anëtarët e familjes së tij për historikun e tij mjekësor, trajtimin e tij, kur është pranuar në spital për herë të fundit etj.; dhe 5. Të realizohen veprime të tjera të cilat mund të vlerësohen si të nevojshme përpara datës 29 mars 2011."

15. Më 25 mars 2011, I.O., një nga doktorët që është kujdesur për vëllanë e kërkuesit në spital, i pyetur nga oficeri i policisë gjyqësore, pohoi se teksa ishte nën mbikëqyrjen e tyre, SH.P. ishte diagnostikuar me pamjaftueshmëri të shumëfishtë dhe obezitet morbid. SH.P. ishte trajtuar si çdo pacient tjetër dhe trajtimi me mjekime dhënë në recetë ishte administruar në përputhje me rregullat.

16. Më 25 mars 2011, P.D., një nga doktorët i cili ishte kujdesur për vëllanë e kërkuesit në spital, i pyetur nga oficeri i policisë gjyqësore, pohoi se SH.P. ishte transferuar në Spitalin e Burgut Tiranë nga Spitali i Burgut Lezhë. Ai ishte trajtuar si çdo pacient tjetër dhe trajtimi i dhënë në recetë ishte administruar në përputhje me rregullat.

17. Më 30 mars 2011, një grup ekspertësh mjekoligjorë ekzaminuan SH.P. Raporti mjekoligjor deklaronte, se *inter alia:*

"1. Në të dy parakrahët u vunë re ekimoza. Edema në ekstremitetet e poshtme. Posoriasis ...

2. Ekimoza e shkaktuar nga sende të mprehta. Pjesa tjetër e dëmtimeve janë pasojë e sëmundjeve të tjera të të ndjerit ...

3. Në gjakun e SH.P. nuk u gjendën gjurmë të mjekimeve ose të substancave narkotike ose psikotrope ...

4. Vdekja e SH.P. ishte pasojë e pamjaftueshmërisë akute kardiorespiratiore, për shkak të komplikacioneve të sëmundjes së përgjithshme metabolike ...

5. Në lidhje me pyetjen, nëse trajtimi mjekësor i SH.P. ishte neglizhuar, ky do të jetë subjekti i një kërkimi tjetër nga komisioni mjekoligjor, sapo këta të fundit të kenë dosjen hetuese në dispozicion ..."

C. Pjesa e parë e procedimeve

18. Më 24 shkurt 2011, policia raportoi vdekjen e SH.P. në Prokurorinë e Tiranës, e cila e regjistroi në dosjen penale. Pasi u kryen veprimet hetimore, më 13 prill 2011, Prokuroria e Tiranës vendosi mosfillimin e procedimit penal dhe të njoftonte palët e interesuara për atë vendim. Vendimi u mbështet në raportin mjekësor të datës 30 mars 2011, në të cilin u konstatohej se vdekja e SH.P. ishte rezultat i një pamjaftueshmërie akute respiratore dhe kardiake, si edhe e sëmundjeve të tjera. Gjithashtu, në vendim deklarohej se nuk ekzistonte asnjë fakt, e dhënë ose tregues se mund të ishte kryer një vepër penale. Më 13 maj 2011, kërkuesit iu njoftua vendimi i Prokurorisë së Tiranës.

19. Më 17 maj 2011, kërkuesi paraqiti një ankesë në Gjykatën e Rrethit Tiranë, ndaj vendimit të prokurorisë së Tiranës. Më 20 tetor 2011, Gjykata e Rrethit Tiranë e rrëzoi ankesën e kërkuesit me argumentin se ai nuk kishte pozita ligjore të ankohej ndaj vendimit të kundërshtuar, sepse ai ishte njoftuar në lidhje me të si familjar i të ndjerit. Edhe Gjykata e Shkallës së Parë deklaroi, se, sipas nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale, vetëm personat të cilët kishin denoncuar një vepër penale mund të ankoheshin për një vendim për mosfillim të procedimit penal.

20. Më 20 prill 2012, Gjykata e Apelit Tiranë la në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë të datës 20 tetor 2011. Më 23 janar 2014, Gjykata e Lartë kundërshtoi apelimin e paraqitur nga kërkuesi. Më 17 nëntor 2015, Gjykata Kushtetuese kundërshtoi ankesat e kërkuesit ndaj vendimeve të gjykatave vendëse, me argumentin se mohimi i statusit të pozicionit për të kundërshtuar vendimin e prokurorit nuk shkelte thelbin e së drejtës së kërkuesit për të pasur akses në gjykatë.

D. Pjesa e dytë e procedimeve

21. Më 16 shkurt 2015, kërkuesi raportoi vdekjen e vëllait të tij në Prokurorinë e Tiranës. Më 27 mars 2015, Prokuroria e Tiranës vendosi mosfillimin e procedimit penal mbështetur në kallëzimin e kërkuesit. Në një datë të papërcaktuar, kërkuesi paraqiti një ankesë në Gjykatën e Rrethit Tiranë në lidhje me vendimin e sipërpërmendur. Më 18 nëntor 2015, Gjykata e Rrethit Tiranë, në referim të pjesës së parë të procedimeve dhe të provave të përdorura në ato procedime, pa dëgjuar ankuesin, vendosi të kundërshtonte ankesën e tij.

II. LIGJI PËRKATËS VENDËS

A. Kushtetuta e Shqipërisë

22. Neni 21 i Kushtetutës parashikon se jeta e çdokujt mbrohet me ligj. Neni 25 parashikon se asnjë nuk mund t'i nënshtrohet torturës apo dënimit, ose trajtimit të ashpër, çnjerëzor ose degradues.

B. Kodi i Procedurës Penale (KPP)

23. Dispozitat përkatëse të KPP-së parashikonin, në momentin në fjalë, si më poshtë:

"Neni 58

Të drejtat e personit të dëmtuar nga vepra penale

1. Personi i dëmtuar nga veprat penale ose trashëgimtarët e tij, kanë të drejtë të kërkojnë procedimin e fajtorit dhe shpërblimin e dëmit.

2. Personi i dëmtuar që nuk ka zotësi juridike për të vepruar i ushtron të drejtat që i janë njohur me ligj nëpërmjet përfaqësuesit ligjor të tij.

3. I dëmtuari ka të drejtë të parashtrojë kërkesa në organin procedues dhe të kërkojë marrjen e provave. Kur kërkesa e tij nuk pranohet nga prokurori, ai ka të drejtë të ankohet në gjykatë, brenda 5 ditëve nga marrja dijeni.

Neni 59

I dëmtuari akuzues

1. Ai që është dëmtuar nga veprat penale të parashikuara nga nenet 90, 91, 92, 112, paragrafi i parë, 119, 119/b, 120, 121, 122, 125, 127, 148, 149 dhe 254 të Kodit Penal, ka të drejtë të paraqesë kërkesë në gjykatë dhe të marrë pjesë në gjykim si palë për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit.

2. Prokurori merr pjesë në gjykimin e këtyre çështjeve dhe, sipas rastit, kërkon dënimin e të pandehurit ose pafajësinë e tij.

3. Nëse i dëmtuari akuzues ose mbrojtësi i caktuar prej tij nuk paraqitet në seancë pa shkaqe të arsyeshme, gjykata vendos pushimin e gjykimit.

Neni 290

Rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit

1. Procedimi penal nuk mund të fillojë dhe, në qoftë se ka filluar, duhet të pushojë në çdo gjendje të procedimit, kur:

a) personi ka vdekur;

b) personi është i papërgjegjshëm ose nuk ka mbushur moshën për përgjegjësi penale;

c) mungon ankimi i të dëmtuarit ose ai e tërheq ankimin;

ç) kur fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale ose kur del qartë që fakti nuk ekziston;

d) vepra penale është shuar;

dh) është dhënë amnisti;

e) në të gjitha rastet e tjera të parashikuara nga ligji.

Neni 291

Vendimi për mosfillimin e procedimit

1. Kur ekzistojnë rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit, prokurori jep vendim të arsyetuar për mosfillimin e procedimit.

2. Vendimi u njoftohet menjëherë atyre që kanë bërë kallëzim ose ankim, të cilët mund ta kundërshtojnë atë në gjykatë, brenda pesë ditëve nga njoftimi i vendimit.

Neni 329

Ankimi kundër vendimit të pushimit të çështjes

1. Kundër vendimit të pushimit të akuzës ose të çështjes mund të bëjnë ankim në gjykatën e rrethit gjyqësor i dëmtuari dhe i pandehuri.

2. Gjykata, kur e gjen të drejtë ankimin e të dëmtuarit vendos që hetimet të vazhdojnë, ndërsa kur pranon ankimin e të pandehurit ndryshon vendimin e pushimit me formulim më të favorshëm për të pandehurin.

3. Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim në gjykatën e apelit nga prokurori, i dëmtuari dhe i pandehuri."

LIGJI

I. KUNDËRSHTIMI PARAPRAK I QEVERISË

Shterimi i mjeteve të brendshme dhe rregulla e gjashtë muajve

1. Parashtrimet e qeverisë

24. Qeveria parashtroi se kërkuesi nuk kishte shfrytëzuar mjetet e brendshme, sepse rruga ligjore që ai kishte zgjedhur të ndiqte ishte e gabuar. Edhe nëse do të supozohej se ai kishte shteruar mjetet e brendshme në dispozicionin e tij, sipas këndvështrimit të qeverisë, ai e kishte dorëzuar kërkesën në gjykatë, jashtë afatit gjashtëmujor, sipas vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 23 janar 2014 dhe faktit se atij nuk i ishte kërkuara që të shfrytëzonte apelimin në Gjykatën Kushtetuese.

25. Sipas qeverisë, në lidhje me pjesën e parë të procedimeve, kërkuesi kishte qenë pasiv dhe nuk e kishte kallëzuar kurrë çështjen në prokurori. Të gjitha gjykatat vendëse kishin arsyetuar rregullisht se sipas nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale, ai nuk mund të ishte palë në ato procedime, sepse ato nuk kishin filluar prej tij. Kishte mjete të tjera të disponueshme në sistemin e brendshëm, të cilat mund të ishin përdorur. Neni 58 i Kodit të Procedurës Penale i mundësonte palët e dëmtuara ose trashëgimtarët e tyre të kërkonin fillimin e procedimeve penale ndaj autorit të krimit dhe të kërkonin kompensim.

26. Në lidhje me pjesën e dytë të procedimeve (shih paragrafin 21 më sipër), edhe pse ato u filluan në bazë të një ankesës së re të kërkuesit në prokurori dhe çuan në një apelim dorëzuar në Gjykatën e Rrethit Tiranë, ai nuk e kishte ndjekur çështjen më larg se sa Gjykata e Shkallës së Parë. Për këtë arsye, qeveria parashtroi se ankesat e kërkuesit duhet të kundërshtoheshin si të papranueshme, duke qenë se nuk ishin shteruar mjetet e brendshme.

2. Parashtrimet e kërkuesit

27. Kërkuesi parashtroi se ai kishte shteruar mjetet e brendshme të disponueshme për të dhe se e kishte paraqitur ankesën në gjykatë, brenda afatit të parashikuar në nenin 35, paragrafi 1. Në lidhje me këtë gjë, ai iu referua praktikës gjyqësore, me një theks të veçantë në qasjen e gjykatës për zbatimin e rregullës së shterimit të mjeteve të brendshme, me një shkallë fleksibiliteti dhe pa formalizëm të tepërt. Kërkuesi parashtroi se ai i kishte kërkuar zyrtarisht oficerit të policisë gjyqësore, i cili ishte përgjegjës për të hetuar mbi vdekjen e vëllait të tij, të kryente një hetim për sqarimin e rrethanave të vdekjes së vëllait të tij. Kjo përbënte një kërkesë formale për t'i konsideruar akuzat, në përputhje me nenin 59 të Kodit të Procedurës Penale. Gjithashtu, fakti se vëllai i tij kishte vdekur përmbante *ipso facto* një detyrim për autoritetet, sipas nenit 2 të Konventës për të kryer një hetim efikas.

28. Në lidhje me pjesën e dytë të procedimeve, kërkuesi deklaroi se ai kishte vendosur të mos paraqiste një apelim në Gjykatën e Apelit ose në Gjykatën e Lartë, sepse nuk do të kishte asnjë mundësi për sukses, duke qenë se gjykata do ta kishte marrë çështjen në konsideratë vetëm pasi ajo do të vinte prej pjesës së parë të procedimeve.

3. Vlerësimi i gjykatës

29. Fillimisht, gjykata do të adresojë kundërshtimin e qeverisë, se kërkesa u dorëzua pasi kishte kaluar afati kohor prej gjashtë muajsh. Tashmë, gjykata, e mendimit se në rastet në lidhje me hetimin për keqtrajtim, ashtu si në ato në lidhje me një hetim për vdekjen e dyshimtë të një të afërmi, kërkuesit priten të ndërmarrin hapa për të ndjekur progresin e hetimit ose mungesën e tij, si edhe të paraqesin kërkesat e tyre në mënyrë të rregullt, sapo ata bëhen me dije ose duhet të ishin bërë me dije, për mungesën e një hetimi penal efikas (shih *Mocanu dhe të Tjerët kundër Rumanisë* [DHM], nr. 10865/09 dhe 2 të tjerë, § 263 GJEDNJ 2014 (ekstrakte).

30. Në çështjen në fjalë, gjykata vëren se kërkuesi e kundërshtoi vendimin e prokurorit për mosfillim të një hetimi penal formal për vdekjen e vëllait të tij deri në Gjykatën Kushtetuese, duke luajtur në këtë mënyrë një rol aktiv në proces. Një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese për shkeljet e pretenduara për një gjykim të drejtë është një mjet i cili normalisht duhet të shterohet (shih *Xheraj kundër Shqipërisë*, nr. 37959/02, § 43, 29 korrik 2008; *Beshiri dhe të Tjerët kundër Shqipërisë*, nr. 7352/03, § 32, 22 gusht 2006 dhe *Balliu kundër Shqipërisë* (vendim), nr. 74727/01, 16 qershor 2005). Kërkesa, mbështetur në garancitë kushtetuese vendëse për një proces të rregullt dhe aksesin në gjykatë, u vlerësua e pranueshme dhe u shqyrtua nga Gjykata Kushtetuese për cilësitë e saj.

31. Kërkuesi paraqiti kërkesën në gjykatë më 16 maj 2016, kohë e cila është 5 muaj dhe 29 ditë pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Për këtë arsye, gjykata rrëzon kundërshtimin e qeverisë, se ankesa u paraqit përtej afatit.

32. Në lidhje me kundërshtimin e dytë, në lidhje me shterimin e mjeteve të brendshme, gjykata vëren se kërkuesi i kërkoi oficerit të policisë gjyqësore, të ngarkuar për çështjen e vëllait të tij, të hetonte rrethanat e vdekjes së këtij të fundit (shih paragrafin 11 më sipër). Gjithashtu, ai kundërshtoi vendimin e prokurorit të Tiranës për mosfillim të procedimit penal deri në nivel të Gjykatës Kushtetuese (shih paragrafët 18—20).

33. Pyetja, nëse kërkuesit i duhej t'i ishte kërkuar të sillte një ankesë penale të veçantë në lidhje me rrethanat e vdekjes së vëllait të tij, lidhet ngushtë me cilësitë e ankesave të tij për nenin 2 dhe nenin

3. Në këtë rrethanë, gjykata është e mendimit se ky kundërshtim duhet të shqyrtohet së bashku me cilësitë e asaj ankese (shih paragrafët 44—45 më poshtë).

II. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 2 TË KONVENTËS

34. Kërkuesi u ankua se autoritetet nuk kishin realizuar një hetim efikas për vdekjen e vëllait të tij, sipas parashikimit të nenit 2 të Konventës, e cila parashikon si më poshtë:

> "1. E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. Askujt nuk mund t'i merret jeta qëllimisht, me përjashtim të rastit kur zbatohet një vendim gjyqësor me vdekje, pas dënimit për një krim për të cilin ky dënim është parashikuar me ligj."

Nëse autoritet kryen një hetim efikas

1. Parashtrimet epalëve

35. Kërkuesi parashtroi se hetimi i kryer nga autoritetet nuk ofronte informacione të kënaqshme për rrethanat në lidhje me vdekjen e vëllait të tij. Ai nuk përjashtonte, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, se dëmtimi shëndetësor i përshkruar në raportin mjekësor nuk ishte shkaktuar për arsye të keqtrajtimit të vëllait të tij dhe/ose mungesës së ndihmës së duhur mjekësore. Ekspertët mjekoligjorë, të cilët kishin kryer ekzaminimin mjekësor nuk kishin adresuar pyetjen e oficerit të policë gjyqësore, për faktin nëse trajtimi mjekësor i vëllait të kërkuesit kishte qenë i papërshtatshëm. Përkundrazi, ata kishin gjykuar se kjo gjë mbetej të

verifikohej nga një tjetër komision. Gjithashtu, veprimet hetimore të kryera nuk ofronin një shpjegim bindës për mungesën e ndonjë gjurme mjekimi në gjakun e kërkuesit dhe se kjo nuk i atribuohej trajtimit të papërshtatshëm.

36. Për më tepër, kërkuesi iu referua parimeve që vinin prej praktikës gjyqësore të gjykatës në lidhje me mbrojtjen e parashikuar në nenin 2 të Konventës, për personat e ndaluar dhe në një pozicion të cenueshëm. Sipas kërkuesit, duke pasur parasysh rrethanat e veçanta të kësaj çështje, një ekzaminim mjekoligjor i detajuar ishte thelbësor për të përcaktuar shkakun e vdekjes dhe për të verifikuar nëse kishte pasur shenja keqtrajtimi.

37. Qeveria parashtroi se autoritetet kishin kryer një hetim efikas për vdekjen e SH.P. Prokurori kishte urdhëruar kryerjen e një sërë veprimesh hetimore (shih paragrafin 14 më sipër). Veçanërisht, qeveria i tërhoqi vëmendjen gjykatës në përfundimet e raportit mjekoligjor, i cili konstatoi se vdekja e SH.P. ishte shkaktuar nga një pamjaftueshmëri respiratore dhe kardiake, si rezultat i historisë së tij mjekësore.

38. Në vijim, qeveria parashtroi se stafi mjekoligjor e kishte mbajtur SH.P. në mbikëqyrje të vazhdueshme. Kjo provohej nga kartelat mjekësore të konfiskuara gjatë veprimeve hetimore. Për këtë arsye, autoritetet vendëse kishin marrë të gjitha masat e nevojshme për të ruajtur jetën e SH.P. Vdekja e tij kishte ardhur si pasojë e rrethanave përtej kontrollit të autoriteteve.

2. Vlerësimi i gjykatës

a) Parime të përgjithshme

39. Gjykata përsërit se neni 2 i Konventës, i cili garanton të drejtën për të jetuar, renditet si një nga parashikimet më themelore në Konventë. Në mbështetje të rëndësisë së mbrojtjes, parashikuar në nenin 2, gjykata duhet të shqyrtojë me kujdesin më të madh ankesat për privimin e jetës (shih *McCann dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Madhe*, 27 shtator 1995, §§ 146-47, seritë A nr. 324, dhe *Nachova dhe të Tjerët kundër Bullgaris'ë* [DHM], nr. 43577/98 dhe 43579/98, § 93, GJEDNJ 2005- VII).

40. Detyrimi për të mbrojtur jetën, sipas nenit 2 të Konventë, i lexuar në lidhje me detyrën e përgjithshme të shtetit, sipas nenit 1 të Konventës: "për të siguruar çdonjërin brenda juridiksionit [të saj] të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Kushtetutë", kërkon edhe sipas nënkuptimit se duhet të ketë një lloj hetimi efikas zyrtar në rastin kur individët janë vrarë si rezultat i përdorimit të forcës (shih *Nachova dhe të Tjerët kundër Bullgarisë* [DHM], cituar më sipër). Në vijim, gjykata deklaron, se kurdo që një i ndaluar vdes në rrethana të dyshimta, neni 2 u kërkon autoriteteve të kryejnë një hetim të pavarur dhe të paanshëm zyrtar, i cili përmbush standarde minimale të caktuara për efikasitetin (shih *Trubnikov kundër Rusisë*, nr. 49790/99, §§ 87-88, 5 korrik 2005).

41. Në vijim, në kontekstin e kujdesit për shëndetin, gjykata ka interpretuar detyrimin procedural të nenit 2, duke iu kërkuar shteteve të ngrenë një sistem efikas dhe të pavarur gjyqësor, në mënyrë që shkaku i vdekjes së pacientëve nën kujdesin mjekësor, qoftë në sektorin publik apo në atë privat, mund të përcaktohet dhe të vihen përpara llogaridhënies personat përgjegjës (shih *Lopes de Sousa Fernandes kundër Portugalisë* [DHM], nr. 56080/13, § 214, 19 dhjetor 2017, dhe *Sikh kundër Sllovenisë* [DHM], nr. 71463/01, § 192, 9 prill 2009).

42. Një hetim duhet të jetë efikas në kuptimin që ai mund të çojë në përcaktimin e fakteve dhe, aty ku është me vend, të kryhet identifikimi dhe dënimi i personave përgjegjës. Edhe pse nuk është detyrim i rezultatit por i mjeteve, çdo defiçencë në hetime, të cilat dëmtojnë mundësinë për të përcaktuar rrethanat e çështjes ose personin përgjegjës, rrezikon të ketë

parregullsi me standardin e kërkuar të efikasitetit (shih *Al-Skeini dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], nr. 55721/07, §§ 166, GJEDNJ 2011). Autoritetet duhet të veprojnë me pushtetin e tyre sapo çështja kalon në vëmendjen e tyre. Ato nuk mund ta lënë atë në iniciativën e të afërmit as për të paraqitur një ankesë formale ose për të kërkuar linja të posaçme hetimesh ose procedurash hetimesh (shih *Nachova dhe të Tjerët kundër Bullgaris'ë* [DHM], nr. 43577/98 dhe 43579/98, § 111, GJEDNJ 2005-VII). Në të gjitha rastet, i afërmi i viktimës duhet të përfshihet në procedurë në masën e nevojshme për të mbrojtur interesat e tij/saj legjitimë (shih *Mustafayev kundër Azerbajxhanit*, nr. 47095/09, § 72, 4 maj 2017).

43. Kërkesa për gatishmëri dhe për adresim të arsyeshëm është e nënkuptuar në këtë kontekst (shih *Sidika Imrem kundër Turqisë*, nr. 47384/11, § 59, 13 shtator 2016). Duhet të pranohet se mund të ketë pengesa ose vështirësi të cilat pengojnë progresin në hetim në një situatë të caktuar. Megjithatë, një përgjigje e menjëhershme nga autoritetet në hetimin e vdekjeve të dyshimta mund të konsiderohet në përgjithësi si thelbësore në ruajtjen e besimit të publikut në mbështetje të shtetit të së drejtës dhe në parandalimit të çdo forme të marrëveshjeve të fshehta ose tolerancës ndaj akteve të paligjshme (shih *Merkulova kundër Ukrainës*, nr. 21454/04, § 50, 3 mars 2011, dhe *Armani da Silva kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], nr. 5878/08, § 237, 30 mars 2016).

b) Zbatimi i parimeve të mësipërme në çështjen në fjalë

44. Fillimisht, gjykata do të adresojë parashtrimin e qeverisë, të cilin e ka bashkuar me cilësitë e çështjes, sipas së cilave kërkuesi ka pasur një qëndrim pasiv, duke mos e raportuar çështjen në prokurori (shih paragrafin 25 dhe paragrafin 33 më sipër).

45. Siç është theksuar më sipër, autoritetet duhet të veprojnë me kompetencën e tyre, në momentin që një çështje kalon në vëmendjen e tyre (shih paragrafin 40 më sipër). Për pasojë, mbetet e pamaterializuar nëse vetë kërkuesi mori një rol aktiv në përfshirjen e autoriteteve hetuese.

46. Në lidhje me detajet e hetimit të realizuar, gjykata vëren se hetimi për vdekjen e SH.P. filloi në mënyrën e duhur, në ditën e vdekjes së tij, me një ekzaminim në skenë, një ekzaminim të trupit të të ndjerit dhe konfiskimin e kartelës mjekësore (shih paragrafin 9 më sipër). Për më tepër, më 10 mars 2011, Prokuroria e Tiranës urdhëroi një sërë veprimesh hetimore (shih paragrafin 14 më sipër).

47. Më tej, gjykata vëren se ekzaminimi mjekoligjor i SH.P., i realizuar më 30 mars 2011, konstatoi se ai kishte vdekur si rezultat i pamjaftueshmërisë akute respiratore dhe kardiake, për shkak të komplikacioneve të sëmundjes së tij të përgjithshme metabolike. Gjithashtu, u konstatua se nuk ka gjurmë mjekimesh në gjakun e tij. Kartela mjekësore e SH.P., nga ana tjetër, tregonte se atij i ishin bërë një sërë mjekimesh, sipas përshkrimit të stafit mjekësor (shih paragrafin 7 më sipër).

48. Sidoqoftë, gjykata vëren disa mungesa të veçanta në veprimet hetimore të ndërmarra nga autoritetet vendëse.

49. Fillimisht, ka një mospërputhje midis informacionit të regjistruar në kartelën mjekësore, ku tregohet se vëllait të kërkuesit i janë dhënë mjekime dhe ekzaminimit mjekoligjor të datës 30 mars 2011, në lidhje me trajtimin mjekësor të SH.P. Veprimet hetimore të realizuara, nuk përcaktojnë nëse SH.P. kë qenë nën mjekim përpara vdekjes së tij dhe, nëse po, nëse ai ka qenë mjekimi i duhur, duke marrë parasysh historikun e tij mjekësor (shih paragrafin 17 më sipër). Për këtë arsye, gjykata nuk është e bindur nëse përcaktohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se vdekja e SH.P. ka ardhur si rezultat i sëmundjes së tij dhe jo për shkak të trajtimit dhe kujdesit të papërshtatshëm. Gjithashtu, hetimi nuk adreson

pretendimet për prangosjen e vëllait të kërkuesit gjatë qëndrimit të tij në spital dhe, nëse një masë e tillë ka çuar në vdekjen e tij, duke marrë në konsideratë, veçanërisht, natyrën e kushteve të tij mjekësore.

50. Së dyti, gjykata vëren se vendimi i prokurorisë së datës 13 prill 2011, për mosfillimin e një hetimi, është marrë kryesisht mbështetur në të njëjtin ekzaminim mjekësor. Përcaktimi se ekzaminimi mjekësor nuk jep përgjigje për disa pyetje thelbësore, më konkretisht, nëse është ofruar trajtimi i duhur mjekësor dhe nëse kushtet e kërkuesit në spital kanë çuar në vdekjen e tij, gjykata nuk është e bindur me vendimin marrë nga Prokuroria e Tiranës për mosngritje të akuzave apo edhe për moshapjen formale të një hetimi penal; është në respektim të detyrimit procedural parashikuar në nenin 2 të Konventës.

51. Së treti, gjykata vëren se pavarësisht përpjekjeve të kërkuesit për ta kundërshtuar atë vendim, ankesat e tij u rrëzuan nga gjykatat vendëse (shih paragrafët 18—21 më sipër). Gjykata edhe një herë përsërit se i afërmi i viktimës duhet të përfshihet në procedurë deri në masën e nevojshme për të mbrojtur interesat e tij/saj legjitimë (shih *Mustafayev kundër Azçrbajxhanit*, cituar më sipër, § 72). gjykata, në shumë raste, ka theksuar se përfshirja e të afërmit të shërben për të garantuar llogaridhënien publike të autoriteteve dhe kontrollin publik të veprimeve të tyre gjatë hetimit. E drejta e familjes së të ndjerit, vdekja e të cilit është nën hetim, për të marrë pjesë në procedime, kërkon që procedura e miratuar të garantojë mbrojtjen e nevojshme të interesit të tyre, i cili mund të jetë në konflikt të drejtpërdrejtë me interesin e policisë ose forcave të sigurisë të përfshirë në ngjarje (shih *Anusca kundër Moldavisë*, inr. 24034/07, § 44, 18 maj 2010). Pamundësia statutore në çështjen në fjalë, në mënyrë që kërkuesi të kundërshtojë në mënyrë efikase vendimin e prokurorit për mosfillimin e procedimeve penale, nuk është në linjë me detyrimin e shtetit për të kryer një hetim efektiv.

52. Në këtë mënyrë, gjykata rrëzon kundërshtimin paraprak të qeverisë. Mangësitë e përshkruara më sipër, e çojnë gjykatën në konkluzionin se autoritetet vendëse nuk kanë kryer një hetim të përshtatshëm dhe efikas në rrethanat që kanë të bëjnë me vdekjen e vëllait të kërkuesit. Për këtë arsye, ka pasur një shkelje të detyrimit procedural shtetëror, sipas nenit 2, për të mbrojtur të drejtën për të jetuar.

III. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 3 TË KONVENTËS

53. Kërkuesi u ankua se teksa ishte i ndaluar, vëllai i tij i është nënshtruar një forme trajtimi e cila është në kundërshtim me nenin 3 të Konventës, i cili parashikon si më poshtë:

“Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës ose dënimeve, ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese.”

54. Gjithashtu, kërkuesi pretendonte se ai e kishte gjetur vëllanë e tij në spital të lidhur me çarçafë, teksa ishte pa ndjenja dhe se shenjat në kyçet e duarve të vëllait të tij ngrinin dyshime serioze se ai kishte qenë i prangosur ndërsa ishte në spital. Gjithashtu, rezultati i ekzaminimit mjekoligjor, në të cilin tregohej një mungesë mjekimesh në gjak, ngrinte dyshime nëse ai kishte marrë kujdesin e duhur mjekësor. Në lidhje me këtë gjë nuk u bënë hetime të tjera, pavarësisht një nënvizimi në raportin e ekzaminimit mjekoligjor se çështja duhej të hetohej më tej.

55. Qeveria kundërshtoi parashtrimin e kërkuesit. Ajo argumentoi se dosja hetimore tregonte se ishin marrë në konsideratë të gjitha masat, nëse vëllai i kërkuesit i ishte nënshtruar një keqtrajtimi. Provat tregonin se ai ishte mbajtur nën mbikëqyrje të vazhdueshme mjekësore. Në lidhje me pretendimin e kërkuesit se vëllai i tij ishte prangosur, Qeveria parashtroi se një gjë e tillë nuk mbështetej në prova.

56. Gjykata ka konstatuar se autoritetet nuk kanë përcaktuar në mënyrë të prerë shkakun e vdekjes së SH.P. Gjithashtu, autoritetet nuk kanë dhënë një shpjegim të fortë në lidhje me dy të nxirat e gjetura në kyçet e duarve të SH.P. dhe se nuk ka asnjë tregues se policia e burgut ose personeli i spitalit janë marrë në pyetje në lidhje me këtë çështje. Deklaratat e kërkuesit për policinë, së bashku me gjetjet e raportit mjekoligjor për të nxirat e konstatuara në trupin e vëllait të tij, çojnë në pretendimin e diskutueshëm se vëllai i kërkuesit mund të ketë qenë subjekt i një trajtimi, i cili vjen në kundërshtim me nenin 3, gjatë kohës që ishte në spital, duke nënvizuar kështu detyrimin e autoriteteve për të hetuar çështjen *(Bouyid kundër Bejës* [DHM], nr. 23380/09, § 92, GJEDNJ 2015).

57. Gjykata përsërit se prangosja nuk ngre domosdoshmërisht një problematikë, sipas nenit 3 të Konventës, për aq kohë sa masa është ushtruar në lidhje me ndalimin e ligjshëm dhe nuk përbën përdorim të forcës apo ekspozim publik, i cili tejkalon atë çfarë konsiderohet në mënyrë të arsyeshme si e nevojshme. Në këtë aspekt, është e rëndësishme të merret në konsideratë, për shembull, nëse ka rrezik nëse personi në fjalë mund t'i fshihej drejtësisë ose të shkaktonte dëmtime ose dëme (shih *Tarariyeva kundër Rusisë*, nr. 4353/03, § 109, GJEDNJ 2006-XV (ekstrakte). Në çështjen në fjalë, raporti mjekoligjor thjesht përmendte ekzistencën e shenjave dhe faktin se ato ishin shkaktuar nga një objekt i mprehtë në trupin e vëllait të kërkuesit. Megjithatë, autoritetet nuk kanë bërë hetime të mëtejshme në lidhje me faktin nëse vëllai i kërkuesit i është nënshtruar ndonjë forme keqtrajtimi (shih paragrafin 17 më sipër). Për më tepër, në lidhje me këtë aspekt nuk u bënë hetime të mëtejshme. Në këtë mënyrë, gjykata konstaton se autoritetet vendëse nuk kanë marrë mjaftueshëm masa hetimore për të përcaktuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, nëse të nxirat në kyçet e duarve të vëllait të kërkuesit ishin shkaktuar nga trajtimi, i cili bie në kundërshtim me nenin 3 të Konventës. Në këto rrethana, gjykata e ka të pamundur të arrijë në përfundimin nëse ka pasur një shkelje të qartë të nenit 3.

58. Në analizën përfundimtare, gjykata merr në konsideratë se autoritetet nuk kanë mundur të kryejnë një hetim efikas për të përcaktuar nëse vëllai i kërkuesit ka qenë subjekt i keqtrajtimit teksa ishte i ndaluar. Në këtë mënyrë, në lidhje me këtë aspekt, ka pasur një shkelje të nenit 3 të Konventës, sipas aspektit të tij procedural.

IV. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 13 TË KONVENTËS, NË LIDHJE ME NENET 2 DHE 3 TË KONVENTËS

59. Në vijim, kërkuesi u ankua se në sistemin vendës nuk ka asnjë mjet efikas për ankesat e tij në mbështetje të neneve 2 dhe 3 të Konventës. Ai mbështetet në nenin 13 të Konventës, i cili parashikon si më poshtë:

"Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare."

60. Kërkuesi pretendonte se edhe pse ai kishte paraqitur një ankesë ndaj vendimit të prokurorisë së Tiranës për mosfillimin e procedimit penal, Gjykata e Rrethit Tiranë e kishte kundërshtuar atë. Ai e kishte ndjekur rrugën deri në Gjykatën Kushtetuese, por pa asnjë rezultat. Ky është një tregues se mjetet që ai ka përdorur nuk kanë qenë efikase dhe se ai nuk ka pasur asnjë mjet tjetër të cilin sot ë mund ta kishte përdorur.

61. Qeveria e kundërshtoi këtë argument. Ajo pretendonte se kërkuesi kishte pasur mjete efikase në dispozicion të tij, por ai kishte zgjedhur të ndiqte rrugën e gabuar procedurale (shih paragrafët 19—21 më sipër).

62. Gjykata vëren se kjo ankesë ka të bëjë me të njëjtat problematika si ato të shqyrtuara në nenet 2 dhe 3 të Konventës. Për këtë arsye, ankesa duhet të deklarohet e pranueshme. Megjithatë, në lidhje me përfundimet e saj më sipër, sipas neneve 2 dhe 3 të Konventës, gjykata e konsideron si të panevojshme shqyrtimin e këtyre çështjeve më veçantë, sipas nenit 13 të Konventës.

V. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

63. Neni 41 i Konventës parashikon se:

"Kur gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe, nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar."

A. Dëmi

64. Kërkuesi pretendonte 30 000 euro (EUR) për dëmin jomonetar të vuajtur nga ai dhe vëllai i tij.

65. Qeveria parashtroi se pretendimet e kërkuesit nuk ishin të provuara, duke qenë se nuk kishte paraqitur ndonjë provë.

66. Gjykata përsërit se është konstatuar se autoritetet nuk kanë realizuar një hetim efikas, në kundërshtim me detyrimin procedural, sipas neneve 2 dhe 3 të Konventës. Në lidhje me

konstatimin e shkeljeve dhe vlerësimin mbi baza të drejta, gjykata i kep kërkuesit 12 000 euro për dëmin jomonetar.

B. Kostot dhe shpenzimet

67. Kërkuesi, gjithashtu, pretendonte 10 000 euro për kostot dhe shpenzimet e bëra në gjykatat vendëse dhe për ato të përdorura përpara gjykatës. Kjo përfshinte një shumë për përfaqësimin e tij ligjor përpara Gjykatës Kushtetuese dhe përpara gjykatës me gjashtë përfaqësues ligjorë. Ai dorëzoi një faturë të përgjithshme dhe kontrata shërbimesh për përfaqësuesit ligjorë.

68. Qeveria parashtroi se këto pretendime ishin të tepruara dhe të pabazuara në fakte.

69. Gjykata konstaton se kërkuesi duhet të ketë pasur disa kosto dhe shpenzime gjatë procedimeve. Në këtë mënyrë, në çështjen në fjalë, duke pasur në konsideratë informacionin në dispozicion, gjykata e gjykon të arsyeshme t'i japë kërkuesit shumën prej 1450 eurosh për procedimet përpara gjykatës.

C. Interes i vonuar

70. Gjykata gjykon të përshtatshme se norma e interesit të vonuar duhet të mbështetet në normën margjinale të huadhënies së Bankës Qendrore Europiane, shumë së cilës i shtohen tre pikë përqindjeje.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË ANONIME:

1. Vendos të bashkojë kundërshtimin paraprak në lidhje për mosshfrytëzim të mjeteve të brendshme, sipas cilësive dhe e pushon atë;

2. E deklaron kërkesën të pranueshme;

3. Vendos se është shkelur neni 2 i Konventës, në pjesën procedurale;

4. Vendos se nuk është shkelur neni 3 i Konventës, në pjesën thelbësore;

5. Vendos se është shkelur neni 3 i Konventës në pjesën procedurale;

6. Vendos se nuk është e nevojshme të shqyrtohet nëse është shkelur neni 13 i Konventës;

7. Vendos:

a) se shteti i paditur duhet t'i paguajë kërkuesit, brenda tre muajve nga data në të cilin vendimi bëhet i formës së prerë, në përputhje me nenin 44 § 2 të Konventës, shumat e mëposhtme:

i. 12 000 euro (dymbëdhjetë mijë euro) plus çdo taksë e cila mund të tarifohet, për dëmin jomonetar, shumë e cila duhet të konvertohet në monedhën e shtetit të paditur, në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes;

ii. 1 450 euro (një mijë e katërqind e pesëdhjetë euro), plus çdo taksë, e cila mund të jetë e tarifueshme për kërkuesin, për kostot dhe shpenzimet;

b) se nga përfundimi i tre muajve të përmendur më sipër, deri në shlyerje, interesi i thjeshtë do të jetë i pagueshëm për shumat më sipër, në një normë të barabartë me normën margjinale të huadhënies së Bankës Qendrore Europiane, gjatë periudhës së vonesës, plus tre pikë përqindjeje.

8. Pushon pjesën tjetër të pretendimit të kërkuesit për kompensim të drejtë.

Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim në datën 11 qershor 2019, sipas rregullave 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së gjykatës.

Stanley Naismith	Robert Spano
Sekretar	**Kyetar**

SEKSIONI I DYTE

ÇËSHTJA TËRSHANA K. SHQIPËRISË

(Ankimi nr. 48756/14)

VENDIM

Neni 2 (material) - Detyrimet pozitive - Sulm me acid ndaj një gruaje në rrugë
- Ekzistenca e një kuadri të ligjit penal efektiv
- Rreziku për jetën i ankueses nga ishbashkëshorti i dyshuar nuk është sjellë në vëmendje të autoriteteve para sulmit
- Autoritetet shtetërore nuk janë përgjegjëse,
neni 2 (procedural) - Hetim efektiv - Gjykata ka parasysh situatën e përgjithshme të dhunës ndaj grave në Shqipëri
- Qasje joefektive ndaj dhunës ndaj grave nga zyrtarët e zbatimit të ligjit
- Detyrimi nga ana e autoriteteve hetimore për të reaguar me kujdes të veçantë në kryerjen e një hetimi të plotë
- Moskryerje me shpejtësinë dhe vendosmërinë e duhur të masave hetimore të një rëndësie thelbësore
- Pamundësi e ankueses për të apeluar vendimin për pezullimin e hetimit, për të kundërshtuar (mungesën e) hapave hetimorë ose paraqitjen e kërkesës për dëmshpërblim.

STRASBURG
4 gusht 2020

Ky vendim do të marrë formë të prerë në rrethanat e përcaktuara në nenin 44§2 të Konventës. Ai mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktues.

Në çështjen Tërshana kundër Shqipërisë, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Dytë), me trup gjykues të përbërë nga:
Robert Spano, president,
Paul Lemmens,
Ledi Bianku,
Valeriu Griţco,
Jon Fridrik Kjolbro,
Stéphanie Mourou-Vikström,
Arnfinn Bårdsen, gjyqtarë,
dhe Stanley Naismith, sekretar i Seksionit,
pas shqyrtimit me dyer të mbyllura më 3 korrik 2018 dhe 23 qershor 2020, shpall vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në po atë datë:

PROCEDURA

1. Çështja e ka zanafillën në ankimin (nr. 48756/14) kundër Republikës së Shqipërisë depozituar pranë Gjykatës, sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) nga një shtetase shqiptare, znj. Dhurata Tërshana (ankuesja), më 30 qershor 2014.

2. Ankuesja u përfaqësua nga z. N. Marku, avokat që ushtron aktivitetin e tij në Tiranë. Qeveria shqiptare (Qeveria) u përfaqësua nga agjentja e saj, në atë kohë, znj. Alma Hicka nga Avokatura e Shtetit.

3. Ankuesja pretendonte se autoritetet kanë dështuar në mbrojtjen e jetës së saj dhe të së drejtës së saj për jetë private, sipas neneve 2, 3, 8, 13 dhe 14 të Konventës. Ajo, gjithashtu, u ankua

për dështimin e autoriteteve për të kryer një investigim të shpejtë dhe efektiv që do të çonte në identifikimin, ndjekjen dhe dënimin e autorit të sulmit.

4. Më 6 tetor 2014 ankimi iu komunikua Qeverisë.

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

5. Ankuesja ka lindur në vitin 1984 dhe banon në Tiranë.

A. Historiku i çështjes

6. Më 29 korrik 2009, rreth orës 4 pm, ndërsa ecte në një nga rrugicat e Tiranës, ankuesja pësoi dëmtime të rënda në një sulm me acid nga një autor i paidentifikuar. Ajo u dërgua menjëherë në Spitalin Nënë Tereza për të marrë trajtim urgjent mjekësor. Raporti i spitalit tregonte se njëzet e pesë për qind e trupit të ankueses, kryesisht fytyra dhe pjesa e sipërme e trupit ishte djegur (combusio corporis, facies et extremitas superior), për shkak të sulmit me acid dhe se ishte në gjendje kritike. Më 1 gusht 2009 ajo u dërgua në Itali për një trajtim mjekësor më të specializuar. Raporti i spitalit i datës 2 tetor 2009 tregonte se ankuesja kishte djegie te shkallës së mesme deri në thellësi të fytyrës, qafës dhe trupit (ustioni intermedio-profonde di volto, collo, tronco, arti superiori ed inferiori) të shkaktuara nga acidi sulfurik. Sipas raportit të trajtimit të saj spitalor në Itali, ankuesja iu nënshtrua të paktën katërmbëdhjetë operacioneve në periudhën midis viteve 2009 dhe 2012. Shpenzimet e këtyre operacioneve u përballuan nga Krahinat e Pulias dhe Marche, Itali si dhe nga ankuesja. Ajo vuante nga ankthi dhe probleme psikologjike dhe kishte frikë të kthehej në Shqipëri. Ajo përfitoi raport mjekësor për të paktën shtatë muaj nga autoritetet shqiptare, por duket se nuk ishte në gjendje të punonte për disa vjet.

B. Hetimi i çështjes së sulmit të 29 korrikut 2009

7. Më 29 korrik 2009 prokurori hapi një hetim për sulmin me acid, sipas nenit 88 të Kodit Penal (shih paragrafin 64 më poshtë). Ankuesja bëri një deklaratë në të cilën u shpreh se nuk e kishte njohur autorin e sulmit ndaj saj. Ajo deklaroi se nuk kishte mosmarrëveshje me askënd, por dyshonte se sulmi ishte organizuar nga ishbashkëshorti i saj (E.A.) si një akt hakmarrjeje dhe vazhdimësisë së dhunës që kishte pësuar në të kaluarën. Ai e kishte kërcënuar në të kaluarën se do ta vriste. Ajo dhe E.A. ishin ndarë përfundimisht, pasi ai kishte refuzuar ta lejonte atë që të ndiqte një kurs trajnimi të specializuar në Itali. Përveç kësaj, ajo deklaroi se në kohën e sulmit, autori mbante një kapelë ngjyrë kafe/bezhë, syze dielli të zeza dhe këmishë të zezë. Autori i sulmit kishte hedhur një substancë mbi fytyrën dhe trupin e saj dhe më pas ishte larguar. Ajo kishte ndjerë që fytyra dhe gjoksi i saj po digjeshin dhe rrobat e saj po shkriheshin. Substanca ishte hedhur edhe mbi kolegen e saj. Ajo më tej deklaroi se E.A. kishte qenë i burgosur në Itali dhe se kishte miq me rekorde kriminale.

8. Po atë ditë, prokurori mori një deklaratë nga kolegia e ankueses, e cila kishte qenë me të gjatë sulmit me acid dhe kishte pësuar, gjithashtu, dëmtime të rënda. Edhe kolegia e ankueses deklaroi se nuk e kishte njohur autorin e sulmit. Autori kishte veshur pantallona të errëta dhe këmishë të zezë dhe mbante një enë që kishte brenda një substancë të kuqe. Ndërkohë që ecte drejt saj dhe ankueses, ai kishte hapur enën dhe kishte hedhur përmbajtjen e saj mbi trupat e tyre. Ajo deklaroi se nuk kishte mosmarrëveshje me askënd dhe se kishte dëgjuar nga pjesëtaret e familjes së ankueses se dyshonin për ishbashkëshortin e ankueses. Ajo, gjithashtu, deklaroi se kishte parë njerëz të tjerë në vendngjarjen e sulmit dhe një burrë në rrugën kryesore.

9. Më 29 korrik dhe 6 gusht 2009 E.D., një nga kolegët e ankueses dha një deklaratë ku shprehej se nuk kishte qenë në gjendje të dallonte fytyrën e autorit të krimit, sepse kishte qenë me shpinë ndaj tij. Sipas përshkrimit të tij, autori kishte veshur këmishë të kuqe, xhins me vija të bardha dhe syze dielli. Ai, më tej, përshkroi se si e kishte ndihmuar ankuesen dhe viktimën tjetër, dhe se, së bashku me një kolege tjetër, E.S., i kishin dërguar të dyja në spital. Ai, gjithashtu, deklaroi se në vendngjarje kishin ardhur njerëz të tjerë dhe ishin përpjekur të ndihmonin viktimat. Kolegia e lartpërmendur E.S. deklaroi se kishte ndihmuar për t'i dërguar viktimat në spital. Ajo nuk e kishte parë fare autorin e krimit.

10.Më 29 korrik 2009 B.D., motra e ankueses, deklaroi se e motra i kishte treguar më parë që E.A. ishte xheloz dhe ushtronte dhunë ndaj saj. Ajo kishte dashur të ndiqte një kurs trajnimi të specializuar në Itali, por E.A. nuk e kishte lejuar. Ai e kishte kërcënuar se do ta vriste nëse do të divorcoheshin. Ajo, gjithashtu, deklaroi se kushëriri i saj, R.T., ishte takuar me E.A. për t'i kthyer disa sende në emër të ankueses. E.A. i kishte thënë R.T. se nuk do t'i shkaktonte ankueses asnjë problem

dhe se ajo mund të vazhdonte jetën e saj normale. B.D. deklaroi, gjithashtu, se në maj 2009 ajo ishte takuar me E.A. dhe nënën e tij në prani të motrës së saj për të diskutuar mbi vazhdimësinë e marrëdhënies së tyre. Sipas B.D., ishte e qartë nga diskutimet që patën se E.A. kishte ushtruar dhunë ndaj motrës së saj. Më 21 dhjetor 2009 B.D. dha një deklaratë tjetër në të cilën konfirmonte deklaratat e saj të datës 29 korrik 2009 dhe u shpreh se ende kishte dyshime që E.A. mund të ketë kryer sulmin.

11.Më 29 korrik 2009 R.T., kushëriri i ankueses, deklaroi se ishte në dijeni që E.A. kishte përdorur dhunë ndaj ankueses dhe ishte xheloz. Ai kishte takuar E.A. dy muaj më parë dhe i kishte dhënë disa sende në emër të ankueses. E.A. i kishte thënë R.T. se nuk do të kontaktonte me ankuesen dhe nuk do t'i shkaktonte asaj asnjë problem.

12. Më 29 korrik 2009 L.D., kunati i ankueses deklaroi se kishte mësuar nga gruaja e tij B.D., se kunata e tij i ishte nënshtruar dhunës dhe fyerjeve nga bashkëshorti i saj.

13. Më 29 korrik 2009 V.T., nëna e ankueses deklaroi se E.A. ishte përfshirë në vepra penale, të tilla si vjedhja e kasafortave dhe vrasja. Ai kishte përdorur dhunë ndaj ankueses. Një herë, ai e kishte mbyllur atë në banesën e tij për tri ditë, duke e penguar të shkonte në punë, në shenjë hakmarrjeje për kërcënimin se do ta denonconte atë në polici. Pas divorcit ata kishin pasur disa herë grindje në lidhje me sende të caktuara që duhej t'i kthenin njëri-tjetrit.

14. Më 29 korrik 2009, një tjetër dëshmitar, G.D., i cili kishte qenë duke pirë kafe në një kafene aty pranë në kohën e sulmit, deklaroi se kishte shkuar për të ndihmuar ankuesen dhe viktimën tjetër pasi dëgjoi britma. Ai nuk e kishte parë kush e kishte kryer sulmin. Ai kishte parë një enë në rrugë dhe e kishte shkelmuar. Sipas tij, substanca e cila u derdh nëpër rrugë kishte qenë acid.

15. Në një deklaratë të dhënë po atë ditë, E.A. deklaroi se më 29 korrik 2009 ai kishte qenë në Durrës deri në orën 6 pasdite. Më tej ai deklaroi se me ankuesen ishin divorcuar në maj 2009, sepse kishin probleme; ai nuk kishte qenë dakord me ankuesen kur ajo kishte dashur të shkonte në Itali për të ndjekur një kurs profesional të specializuar. Ai, gjithashtu, deklaroi se procesi i divorcit kishte shkuar normalisht dhe që nga ajo kohë nuk kishte pasur asnjë kontakt me ankuesen. Ai nuk kishte asnjë informacion se kush mund të ketë qenë autori i krimit. Ai, gjithashtu, dha informacion për njerëzit që njihte, konkretisht familjarët, miqtë dhe të afërmit.

16. Më 29 korrik 2009 F.P., nëna e E.A., deklaroi se djali i saj dhe ankuesja kishin pasur marrëdhënie të mira, por ishin divorcuar në vitin 2009, sepse ankuesja kishte dashur të ndiqte një kurs trajnimi të specializuar në Itali dhe E.A. nuk ishte pajtuar me idenë. Ajo më tej deklaroi se ditën që ata u divorcuan ajo kishte takuar djalin e saj, ankuesen dhe motrën e ankueses për të gjetur një zgjidhje. Megjithatë, djali i saj dhe ankuesja kishin vendosur t'i jepnin fund marrëdhënies së tyre. Që nga ajo kohë, me sa ishte në dijeni, ata nuk kishin pasur asnjë kontakt. Ajo konfirmoi se djali i saj kishte qenë në Durrës gjatë gjithë ditës. Kushëriri i E.A., L.A., deklaroi, gjithashtu, se me sa ishte në dijeni, kushëriri i tij nuk kishte asnjë mosmarrëveshje me ankuesen.

17. Më 29 korrik 2009, një oficer i policisë gjyqësore kreu një ekzaminim në vendngjarje dhe siguroi disa prova, përfshirë rrobat e ankueses dhe koleges së saj dhe një enë qelqi që përmbante një sasi të vogël të një substance të lëngshme të kuqe.

18. Më 29 korrik dhe 1 tetor 2009 oficeri i policisë gjyqësore vendosi që duhej të përpiloheshin disa raporte, përkatësisht një raport mjekoligjor, një raport ekspertimi i gjurmëve të gishtave mbi enën prej qelqi të përdorur për hedhjen e acidit, një raport ekspertimi kimik dhe toksikologjik mbi enën prej qelqi për të identifikuar substancën e lëngshme dhe metodën me të cilën ishte prodhuar lëngu, si dhe një raport ekspertimi kimik dhe toksikologjik mbi rrobat e ankueses dhe viktimës tjetër për të identifikuar substancën e lëngshme dhe për të përcaktuar nëse dëmtimi i rrobave kishte ndodhur si rezultat i përdorimit të asaj lënde.

19. Më 29 korrik 2009 prokurori urdhëroi përgjimin e bisedave telefonike të E.A. për periudhën 29 korrik deri më 12 gusht 2009, që më pas u aprovua nga gjykata e rrethit më 30 korrik 2009. Më 13 gusht 2009 prokurori i përgjithshëm i dërgoi rezultatet e përgjimit prokurorit të rrethit.

20. Më 30 korrik 2009 oficeri i policisë gjyqësore referoi pranë prokurorisë së rrethit, veprën penale të shkaktimit të plagosjes së rëndë me dashje që i atribuohet E.A. Ai u shpreh se më 29 korrik 2009 në një rrugicë pranë Ministrisë së Drejtësisë, një person i paidentifikuar kishte hedhur acid mbi ankuesen dhe viktimën tjetër, duke i lënë të dyja në gjendje kritike. Ai vlerësonte se në bazë të dëshmive në dosje, si dhe deklaratave të dhëna nga ankuesja, viktima tjetër dhe familjarët e tjerë, ishte e qartë se kishte dyshime që E.A. mund të ketë kryer sulmin.

21. Më 31 korrik 2009 ankuesja dha një deklaratë tjetër, duke thënë se ende kishte dyshime që E.A. kishte dashur të hakmerret për shkak të divorcit. Ajo, gjithashtu, shtoi se në të kaluarën ai kishte kryer vepra penale – përkatësisht vjedhje nga kasaforta dhe shtëpi – dhe se posedonte një armë.

22. Më 3 gusht 2009, prokurori i rrethit urdhëroi që të ndërmerren një sërë veprimesh procedurale, të tilla si ekzaminimi i raport ekspertimit të gjurmëve të gishtave mbi enën e përdorur për hedhjen e acidit dhe që rezultatet të krahasohen me gjurmët e gishtave të personave të tjerë të dyshuar, si dhe çdo personi tjetër të përfshirë në listën e personave të dyshuar në Laboratorin Qendror të Kriminologjisë; ekzaminimi i raportit mjekoligjor dhe i raporteve të tjera të ekspertimit; pyetja e çdo personi që ka dijeni për ngjarjen; ekzaminimi i përgjimeve telefonike; marrja e tabulateve telefonike të viktimave dhe E.A., si dhe të çdo personi tjetër që mund të ketë lidhje me hetimin; gjetja dhe verifikimi i numrave telefonikë të përdorur nga E.A. në internet; konfiskimi i pamjeve filmike të disa kamerave aty pranë, pasi ndonjëra prej tyre mund të ketë kapur dhe regjistruar autorin e krimit; përcaktimi i aparateve të gjetura në banesën e E.A. (shih paragrafin 44 më poshtë); si dhe çdo veprim tjetër që gjykohej me vend.

23. Më 3 gusht 2009, një raport ekspertimi i përgatitur nga Instituti i Policisë Shkencore (ISP) konkludonte se nuk mund të identifikohet asnjë gjurmë gishtash në enën prej qelqi.

24. Më 6 gusht 2009 një raport mjekoligjor i përgatitur nga Instituti i Mjekësisë Ligjore (FMI) konkludonte se njëzet e pesë për qind e fytyrës, e barkut dhe e gjymtyrëve të sipërme të ankueses ishin djegur, ku dëmtimet ishin shkaktuar nga një substancë gërryese. Raporti më tej konkludonte se ishte e pamundur që duke u bazuar vetëm në raportin mjekoligjor të jepej një konkluzion i saktë në lidhje me kategorinë e dëmtimeve të ankueses. Prandaj ishte e nevojshme që ankuesja të ekzaminohej tre muaj pas datës në të cilën ishte dëmtuar.

25. Më 11 gusht 2009 oficeri i policisë gjyqësore kreu kërkime në internet për të gjetur numrat e telefonit të renditur në emër të E.A. Po atë ditë, prokurori kërkoi që një kompani e telefonisë celulare t'i siguronte historikun e regjistrit të thirrjeve, në lidhje me disa nga numra telefonikë të E.A. për periudhën 25 deri më 30 korrik 2009, si dhe vendndodhjen dhe zonën e mbulimit më 29 korrik 2009. Më 18 gusht kompania e telefonisë celulare paraqiti informacionin e kërkuar nga prokurori.

26. Më 15 gusht dhe 15 dhjetor 2009 u kërkuan informacione të tjera në lidhje me disa numra telefonikë për të identifikuar personat që u përkisnin dhe që mund të kenë bërë thirrje telefonike gjatë orëve kur ka ndodhur sulmi. Më 21 dhjetor 2009 kompania e telefonisë celulare dorëzoi informacionin e kërkuar nga prokurori. Në janar 2011 dy individët e pyetur nga oficeri i policisë gjyqësore deklaruan se nuk kishin asnjë informacion për incidentin e datës 29 korrik 2009. Megjithëse ishin miq me E.A., ata pohuan se ai nuk e kishte diskutuar ngjarjen me ta. Një person tjetër i pyetur deklaroi se nuk e njihte fare E.A.

27. Më 11 gusht 2009 prokurori i rrethit kërkoi që t'i siguroheshin pamjet filmike nga tri banka aty pranë, pasi kamerat e tyre të sigurisë mendohej të kenë regjistruar imazhet e ngjarjeve të datës 29 korrik 2009. Më 13 dhe 18 gusht 2009 dy banka dorëzuan pamjet filmike në CD-ROM. Raporti i shkruar nga oficeri i policisë gjyqësore më 24 shtator 2009 mbi shqyrtimin e provave shprehte se ishin ekzaminuar CD-ROM-ët, me qëllim identifikimin e ndonjë personi që kishte të njëjtat karakteristika me personin e përshkruar në deklaratat e dhëna nga dëshmitarët. Ato u ekzaminuan edhe nga ankuesja dhe kolegia e saj. Sidoqoftë, askush nuk mund të identifikohej si autori i dyshuar.

28. Më 9 shtator 2009 një dëshmitare tjetër, G.V., kolege e ankueses, u pyet dhe përshkroi se si ishte veshur një burrë të cilin ajo e kishte parë pranë vendit të ngjarjes. Sipas saj, autori i sulmit mbante një kapele të errët, syze dielli dhe rroba të errëta. Po atë ditë, një tjetër dëshmitare, Y.K., deklaroi se kishte parë dy të rinj që mbanin një enë qelqi, njëri prej të cilëve kishte veshur një këmishë të kuqe dhe tjetri një këmishë të zezë.

29. Më 16 dhjetor 2009, E.K. – motra e E.A. – dha një deklaratë përpara oficerit të policisë gjyqësore, në të cilën konfirmonte se më 29 korrik 2009, E.A. kishte qenë në Durrës me të. Ajo deklaroi se ankuesja dhe E.A. kishin pasur një marrëdhënie të mirë. Ata ishin divorcuar sepse ankuesja kishte dashur të shkonte në Itali për të ndjekur një kurs trajnimi të specializuar dhe E.A. nuk kishte rënë dakord me idenë për arsyet e tij personale.

30. Më 30 shtator 2009, Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FNS) informoi oficerin e policisë gjyqësore se nuk ishte në gjendje të përpilonte raportin e ekspertimit kimik të kërkuar (ka të ngjarë

duke iu referuar raportit të ekspertimit që do të hartohej në lidhje me substancën e kuqe – shih paragrafin 18), pasi i mungonin pajisjet e nevojshme të specializuara.

31. Më 23 tetor 2009 ISP informoi oficerin e policisë gjyqësore se nuk mund të përpilonte një raport ekspertimi mbi rrobat e ankueses dhe viktimës tjetër, pasi nuk binte në sferën e tij të kompetencës.

32. Më 7 dhjetor 2009 oficeri i policisë gjyqësore vendosi që FMI-ja duhej të përpilonte një raport tjetër mjekoligjor në funksion të konkluzioneve të nxjerra në raportin e datës 6 gusht 2009 (shih paragrafin 24 më lart). Më 15 dhjetor 2009 mjeku u përgjigj se raporti mund të përgatitej sapo t'i vihej në dispozicion një kopje e raporteve mjekësore të ankueses përgatitur nga spitali italian.

33. Më 15 dhjetor 2009 një grup ekspertësh i FMI-së përgatiti një raport tjetër mjekoligjor. Ata vunë në dukje se nuk mund të ekzaminonin ankuesen, pasi ajo ishte në Itali duke marrë trajtim special dhe nuk kishin qenë në gjendje të shqyrtonin raportet mjekësore të ardhura nga spitali italian. Ata përsëritën konkluzionin e shprehur në raportin mjekoligjor të datës 6 gusht 2009. Ata konkluduan, se, në bazë të dokumenteve që disponononin, në kohën kur u shkaktuan dëmtimet, ishin aq të rënda sa do të përbënin rrezik për jetën e ankueses, nëse nuk do t'i ishte dhënë ndihmë e specializuar mjekësore.

34. Më 2 shkurt 2010 prokurori i rrethit, në një vendim të arsyetuar, vendosi të pezullojë hetimin në lidhje me veprën penale të shkaktimit të plagosjes së rëndë me dashje, në përputhje me nenin 326 të Kodit të Procedurës Penale, për veprime të mëtejshme për identifikimin e autorit. Vendimi përshkruante të gjitha provat e marra dhe deklaratat e dhëna nga ankuesja dhe personat e tjerë. Vendimi shprehte, për aq sa është e arsyeshme, si më poshtë: "... raportet mjekoligjore konkluduan se njëzet e pesë për qind e fytyrës, të barkut dhe të gjymtyrëve të sipërme të ankueses ishin djegur. Dëmtimet ishin shkaktuar nga një substancë gërryese. Dëmtimet ishin aq të rënda sa do të përbënin rrezik për jetën e ankueses nëse nuk do t'i ishte dhënë ndihmë e specializuar mjekësore ... raporti i ekspertimit të gjurmëve të gishtave konkludonte se asnjë gjurmë gishtash nuk mund të identifikohej ... FNS-ja u përgjigj se i mungonin pajisjet e specializuara të nevojshme për të hartuar raportet përkatëse të ekspertimit ... ISP-ja u përgjigj se nuk ishte detyra e këtij institucioni që të kryente raportin e ekspertimit të kërkuar, në lidhje me ekzaminimin e rrobave që kishte veshur ankuesja në kohën e sulmit ... Pas ekzaminimit të pamjeve filmike nga dy kamera aty pranë, askush nuk mund të identifikohej si i dyshuar për kryerjen e krimit, duke marrë parasysh tiparet e përmendura nga dëshmitarët në deklaratat e tyre; marrja e një kopje të CD-ROM-it nga banka tjetër ishte e pamundur, për shkak të vështirësive teknike të hasura me zbardhjen e saj ... Përgjimet e komunikimeve telefonike nuk zbuluan asnjë bisedë me rëndësi për hetimin ... U morën në pyetje tre individë të tjerë të cilët kishin kryer komunikime telefonike gjatë periudhës kur ndodhi sulmi, por pa rezultat ... Është e qartë se prokurori i rrethit ndërmori veprime të shumta hetimore, të tilla si shqyrtimi i shumë provave, si dhe pyetja e ankueses. Për arsyet e mësipërme, janë kryer të gjitha veprimet e mundshme hetimore, por nuk ka qenë e mundur të identifikohet autori/ët e veprës penale ..."

35. Ankuesja, duke mos marrë asnjë komunikim tjetër zyrtar pas fillimit të hetimit, më 10 mars 2012 autorizoi Qendrën Shqiptare për Rehabilitimin e Traumës dhe Torturës (Qendra) për të ndjekur çështjen e saj.

36. Më 2 prill 2012 Qendra kërkoi informacion nga prokurori në lidhje me ecurinë e hetimit.

37. Më 17 prill 2012 prokurori informoi Qendrën se hetimi ishte pezulluar dhe dosja e çështjes i kishte kaluar policisë për veprime të mëtejshme, me qëllim identifikimin e autorit të sulmit. Qendra u informua se duhej të kërkonte kopje të dokumenteve që kërkonte nga autoriteti përkatës policor.

38. Më 19 prill 2012 Qendra kërkoi nga Drejtoria e Policisë Tiranë (DPT) që t'i dërgonte informacion në lidhje me ecurinë e hetimit.

39. Më 23 maj 2012, DPT-ja informoi Qendrën se hetimi vijonte dhe i vuri në dispozicion një kopje të raporteve mjekësore. Një kopje e vendimit të prokurorit ku pezullonte hetimin nuk mund të sigurohej pa autorizimin paraprak të prokurorit.

40. Më 5 dhjetor 2013 Qendra kërkoi nga prokurori që t'i siguronte një kopje të dosjes hetimore. Qendra, gjithashtu, nxiti prokurorin për gjetjen dhe dënimin e autorit.

41. Më 8 janar 2014 prokurori informoi Qendrën se hetimi ishte pezulluar, pasi autori i sulmit nuk mund të identifikohej. Dosja e çështjes i kishte kaluar tërësisht autoritetit policor, nga ku Qendra mund të merrte një kopje.

42. Dosja penale që u paraqit nga Qeveria si pjesë e vëzhgimeve të tyre tregonte se ishte hapur një hetim mbi veprat penale të shkaktimit të plagosjes së rëndë me dashje dhe prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve parashikuar respektivisht në nenet 88 dhe 279 të Kodit Penal. Në dy raste, më 30 tetor dhe 31 dhjetor 2009, prokurori ka zgjatur hetimin me argumentin se hetimi ishte kompleks dhe se ishte e nevojshme pyetja e shumë individëve dhe ekzaminimi i disa akteve të tjera.

43. Duket se deri në fund të vitit 2015, kur palët dorëzuan parashtrimet e tyre me shkrim përpara Gjykatës, çështja ishte ende në pritje përpara autoriteteve policore, dhe palët nuk kanë dhënë ndonjë informacion të azhurnuar.

C. Procedimet gjyqësore në lidhje me veprën penale të prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve

44. Më 29 korrik 2009, në banesën e E.A. u ushtrua kontroll dhe u gjetën dy thika, katër televizorë, dy kompjutera laptopë dhe një aparat telefonik. Këto mjete u konfiskuan më pas.

45. Më 30 korrik 2009 prokurori i rrethit i atribuoi E.A. veprën penale të prodhimit dhe të mbajtjes pa leje të armëve, sipas nenit 279 të Kodit Penal, me argumentin se ishin gjetur dy thika në banesën e E.A. (shih paragrafin 64 më poshtë).

46. Më 30 korrik 2009 E.A. u arrestua për kryerjen e veprës penale të prodhimit dhe të mbajtës pa leje të armëve të ftohta. Më pas, prokurori caktoi ndaj tij masën e detyrimit për t'u paraqitur përpara policisë gjyqësore (masë shtrënguese), e cila u miratua nga gjykata e rrethit më 1 gusht 2009.

47. Më 6 gusht 2009 Komisariati i Policisë Tiranë deklaroi se sendet e sekuestruara në banesën e E.A., më 29 korrik 2009, nuk përputheshin me përshkrimin e asnjë objekti që ishte vjedhur në territorin e mbuluar nga ai Komisariat.

48. Më 11 janar 2010 Ministria e Kulturës informoi prokurorin e rrethit se të dy thikat ishin për përdorim thjesht dekorativ.

49. Më 2 shkurt 2010 prokurori i rrethit, në një vendim të arsyetuar, pushoi hetimin në lidhje me veprën penale të prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve të ftohta, në përputhje me të drejtën e procedurës penale (shih paragrafin 61 më poshtë). Gjithashtu urdhëroi heqjen e masës shtrënguese ndaj E.A. Vendimi përshkruante të gjitha provat e marra dhe deklarimet e dhëna nga ankuesja dhe të tjerët. Vendimi arsyetonte se meqenëse thikat ishin gjetur në banesën e E.A. dhe jo në një vend publik dhe se shkresa e Ministrisë së Kulturës e datës 11 janar 2010 deklaronte se ato ishin vetëm për përdorim dekorativ, ishte e qartë se nuk ishte kryer asnjë vepër penale.

D. Procedimet gjyqësore në lidhje me kërkesën e ankueses për dëmshpërblim

50. Më 2 maj 2012 ankuesja, duke u mbështetur në Konventën Evropiane për Kompensimin e Viktimave të Krimeve të Dhunshme (Konventa Evropiane për Kompensimin e Viktimave), depozitoi një kërkesë pranë Ministrisë së Drejtësisë ku kërkonte kompensim nga Shteti si rezultat i sulmit me acid (shih paragrafin 89 më poshtë).

51. Më 3 shtator 2012 ankuesja, duke u mbështetur në Konventën Evropiane për Kompensimin e Viktimave, nenet 625, 640 dhe 641 të Kodit Civil, si dhe në vendimin nr. 12/2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (shih paragrafin 73 më poshtë), depozitoi një kërkesë për dëmshpërblim pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë kundër Ministrisë së Drejtësisë, duke kërkuar kompensim nga Shteti si rezultat i sulmit me acid. Ajo, gjithashtu, kërkoi që të përjashtohej nga pagesa e tarifave gjyqësore, për shkak të mungesës së mjeteve financiare, dhe t'i përcaktohej masa e kompensimit nga ekspertë.

52. Ankuesja parashtroi se e kishte tërhequr çështjen pasi e kishte të pamundur të paguante tarifat gjyqësore.

53. Më 30 maj 2013 Gjykata e Rrethit Tiranë vendosi pushimin e gjykimit kur ankuesja dhe avokati i saj nuk u paraqitën në seancë.

II. E DREJTA DHE PRAKTIKA E BRENDSHME PËRKATËSE

A. Kushtetuta

54. Dispozitat përkatëse të Kushtetutës parashikojnë si më poshtë:

Neni 21 "Jeta e personit mbrohet me ligj."

Neni 25 "Askush nuk mund t'u nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues."

Neni 44 "Kushdo ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose të zhdëmtohet në përputhje me ligjin, në

rast se është dëmtuar, për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore."

B. Kodi i Procedurës Penale (KPP)

55. Dispozitat e KPK-së që ishin në fuqi në kohën materiale kishin përmbajtjen e mëposhtme.

56. Neni 24§4 parashikonte se urdhrat dhe direktivat e një prokurori të një niveli më të lartë ishin të detyrueshme për një prokuror të një niveli më të ulët. Neni 24§5 parashikonte se një prokuror i një niveli më të lartë, qoftë proprio omotu ose pas një apelimi, kishte të drejtë të ndryshonte ose shfuqizonte vendimet e një prokurori të një niveli më të ulët.

57. Sipas nenit 61, personi që ka pësuar dëm pasuror si rezultat i kryerjes së një vepre penale mund të ngrejë padi civile gjatë procesit penal për të kërkuar dëmshpërblim. Sipas nenit 62§1, kërkesa duhej të depozitohej para fillimit të shqyrtimit gjyqësor. Në përputhjen me nenin 62§3, gjykata mund të vendosë veçimin e padisë civile nga procesi penal nëse gjykimi i saj vështirëson ose zvarrit procesin penal.

58. Neni 105 i KPP-së parashikonte të drejtën e çdo pale të interesuar të kërkojë, me shpenzimet e veta, kopje dhe ekstrakte të akteve të veçanta.

59. Neni 326 i KPP-së, që parashikonte të drejtën e prokurorit për pezullimin e hetimeve, citon si më poshtë: "1. Kur nuk njihet autori i veprës penale (...), prokurori mund të vendosë pezullimin e hetimeve. 2. Pezullimi i hetimeve vendoset pasi të jenë kryer të gjitha veprimet e mundshme. 3. Hetimi i pezulluar mund të rifillojë me vendim të prokurorit."

60. Në kohën materiale, KPP-ja nuk përmbante asnjë dispozitë specifike mbi të drejtën e ankimit kundër vendimit të prokurorit për pezullimin e çështjes/hetimit.

61. Neni 328 i KPP parashikon të drejtën e prokurorit për pushimin e çështjes/hetimit. Kundër vendimit të prokurorit që ka pushuar çështjen/hetimin mund të bëhet ankim në gjykatë në përputhje me nenin 329 të KPP-së.

Praktika ligjore e brendshme përkatëse në lidhje me pezullimin e hetimit

62. Në një rast, një ankues, H.S., paraqiti një ankesë pranë prokurorisë lidhur me vdekjen e motrës së tij. Prokurori e kishte pezulluar hetimin në bazë të nenit 326§1 të KPP-së me arsyetimin se nuk mund të gjendej asnjë autor i krimit. Ankuesi nisi procedurën ligjore kundër pezullimit të çështjes. Ai u ankua se nuk ishte informuar mbi përmbajtjen e dosjes hetimore dhe as mbi pezullimin e çështjes, se prokurori nuk kishte pyetur të gjithë dëshmitarët, dhe se ai nuk kishte mjet juridik efektiv për t'u ankuar, në lidhje me vendimin e pezullimit të çështjes. Gjykatat e brendshme e rrëzuan padinë e tij. Gjykata e Apelit Tiranë u shpreh, se, meqenëse hetimi vazhdonte dhe meqenëse prokuroria kishte diskrecionin për të vendosur kryerjen e veprimeve hetimore, ankuesi nuk kishte kompetence ligjore. Ajo ripohoi se nuk ekzistonte e drejta e apelimit kundër vendimit për pezullimin e procedimit penal, sipas legjislacionit procedural penal. Ankuesi paraqiti një ankesë kushtetuese pranë Gjykatës Kushtetuese, e cila u refuzua me vendimin nr. 4, datë 18 janar 2013. Gjykata Kushtetuese u shpreh, ndër të tjera, se nuk ekzistonte asnjë mjet juridik, sipas ligjit të brendshëm kundër vendimit të prokurorit për pezullimin e çështjes. Sidoqoftë, fakti që ankuesi kishte pasur akses në gjykatat e brendshme, tregonte se ai kishte të drejtën efektive për t'u ankuar në gjykatë.

C. Kodi Penal (KP)

63. KP-ja përbëhet nga kapituj të ndarë në seksione. Kapitulli II i pjesës specifike të KP-së u është kushtuar veprave penale kundër njeriut. Seksioni I i kapitullit mbulon krimet me dashje kundër jetës dhe, në kohën përkatëse, përmbante më shumë se dhjetë dispozita të ndryshme për vrasje. Seksioni III i kapitullit II trajton krimet me dashje kundër shëndetit. Veprat e sulmit, të cilat më tej karakterizohen sipas nivelit të ashpërsisë së dëmit të shkaktuar, bien në seksionin III, të tilla si tortura (neni 86), shkaktimi i plagosjes së rëndë me dashje (neni 88), plagosja e lehtë me dashje (neni 89), dhe dëmtime të tjera me dashje (neni 90). Nga këto vepra, vetëm vepra penale e shkaktimit të plagosjes së lehtë me dashje (neni 89) bie në kategorinë e çështjeve të ndjekjes private, të cilat duhet të dërgohen nga personi i interesuar drejtpërdrejt në gjykatën kompetente, dhe mund të tërhiqen në çdo fazë të procedurës (neni 284 i KKP-së).

64. Neni 88 i KP-së parashikon se shkaktimi i plagosjes së rëndë me dashje që ka sjellë si pasojë, gjymtimin, shpërfytyrimin ose çdo dëmtim tjetër të përhershëm të shëndetit, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet. neni 279 i KP-së parashikon, ndër të tjera, se prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të ftohta dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet.

65. Pas ndryshimeve të bëra në KP në vitin 2012, neni 130/a përcaktoi dhunën në familje si vepër penale. Rrahja, si dhe çdo vepër tjetër dhune, kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë, plagosja e kryer me dashje ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ishbashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit fizik, psikosocial dhe ekonomik të tij, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

66. Në vitin 2013 u bënë ndryshime në nenin 50 të KP-së, i cili konsideron si rrethanë rënduese kryerjen e një vepre penale gjatë ose pas dhënies së urdhrit gjyqësor të mbrojtjes të dhënë në lidhje me dhunën në familje. D. Kodi Civil

67. Neni 608 i Kodit Civil parashikon se kushdo që në mënyrë të paligjshme dhe gabimisht i shkakton dëm një personi tjetër ose pasurisë së tij, është i detyruar të paguajë kompensim për dëmin. Personi që ka shkaktuar dëmin nuk përgjigjet kur provon se nuk ka faj.

68. Neni 609 parashikon se dëmi duhet të jetë rrjedhim i veprimit a mosveprimit të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm.

69. Neni 625 parashikon se personi që pëson një dëm, të ndryshëm nga ai pasuror, ka të drejtë të kërkojë kompensim kur ka pësuar dëmtim të shëndetit apo integritetit fizik ose mendor të tij ose nëse ose është cenuar në nderin, personalitetin ose reputacionin e tij, ose nëse është cenuar e drejta e tij e respektimit të jetës private.

70. Sipas nenit 640, dëmi pasuror përfshin humbjen e pësuar dhe fitimin e munguar. Shpenzimet e arsyeshme dhe ato të nevojshme mund të jenë gjithashtu subjekt kopmensimi.

71. Sipas nenit 641, personi që i ka shkaktuar tjetrit një dëm në shëndetin e tij, duhet ta kompensojë dëmin, duke pasur parasysh humbjen ose pakësimin e aftësisë për punë të të dëmtuarit, shpenzimet që janë bërë për mjekimin e tij, si dhe shpenzime të tjera që kanë lidhje me dëmin e shkaktuar.

Praktika ligjore e brendshme përkatëse në lidhje me shlyerjen e dëmeve

72. Qeveria paraqiti disa praktika ligjore në lidhje me shlyerjen e dëmeve si pjesë e vëzhgimeve të saj.

73. Në vendimin unifikues nr. 12, datë 14 shtator 2007, pas kërkesës civile për dëmshpërblim dhe shpenzimet kundër Institucionit Shqiptar të Sigurimeve (subjekt shtetëror) për vdekjen e tre personave në një aksident automobilistik, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vendosën, për sa është e rëndësishme, si më poshtë:

"... gjykatat e brendshme kanë pranuar që tre persona humbën jetën në një aksident automobilistik ... në thelb, sipas nenit 608 të Kodit Civil ... legjislacioni parashikon mbrojtjen e të drejtës së jetës, shëndetit, personalitetit, dinjitetit, jetës private e kështu me radhë nga aktet e paligjshme të një pale të tretë. Nëse ka shkelje të ndonjë prej këtyre të drejtave, si rrjedhojë e aktit të paligjshëm, pala e dëmtuar ka të drejtën e kompensimit ekstrakontraktual ... Në zbatim të nenit 609 të Kodit Civil, duhet të provohet lidhja materiale shkakësore ndërmjet sjelljes së paligjshme (veprimi a mosveprimi) si dhe fajit dhe dëmit. Në përcaktimin e dëmit real të shkaktuar nga fakti i paligjshëm dhe kompensimit përkatës, duhet të provohet, gjithashtu, lidhja juridike shkakësore midis tyre. Lidhja materiale shkakësore shërben për të identifikuar personin përgjegjës dhe lidhjet shkakësore midis tri elementeve të aktit të paligjshëm: sjellja e paligjshme, faji dhe pasoja që rrjedh prej tyre, që do të thotë dëmi i një personi tjetër ose pronës së tij ..

Lidhja juridike shkakësore shërben për të demonstruar lidhjet shkakësore midis aktit të paligjshëm, të marrë në tërësinë e tij, dhe shkeljes specifike të të drejtave dhe interesave të ligjshëm [të një personi tjetër] ...

Humbja e përfitimit [parashikuar në nenin 640 të Kodit Civil] ka të bëjë me pamundësinë për të marrë kompensim pasuror në të ardhmen, që është një aset që nuk i përkiste personit të dëmtuar në kohën kur është shkaktuar dëmi. ...

Kompensimi jopasuror për dëmtimin e shëndetit të personit, sipas nenit 625 të Kodit Civil, mund të kërkohet pavarësisht kërkesës për kompensim pasuror si rezultat i humbjes ose pakësimit të aftësisë për punë parashikuar në nenin 641 të Kodit Civil. Personi i dëmtuar që kërkon kompensim në zbatim të nenit 641 të Kodit Civil, ka barrën e provës së shumës së të ardhurave, që nuk mund t'i fitojë më për shkak të humbjes ose pakësimit të aftësisë për punë, pas përmbushjes së detyrimit për të demonstruar dëmtimin e shëndetit të tij, natyrën e përhershme ose të përkohshme të tij, si dhe shkallën e dëmit."

74. Në një rast tjetër, një ankues kishte kërkuar kompensim nga subjekti shtetëror sipas nenit 640 të Kodit Civil, për dëmin e shkaktuar në shëndetin e tij nga një plagosje me armë zjarri shkaktuar nga oficerët e policisë së Shtetit. Me vendimin nr. 275, datë 24 shtator 2009, Gjykata e Lartë ia kaloi çështjen për rishqyrtim gjykatës përkatëse të apelit. Ajo arsyetonte se, për shkak të plagosjes së ankuesit nga oficerët e policisë së Shtetit, ishte provuar dëmi i shkaktuar në shëndetin e tij.

75. Në një vendim të datës 25 nëntor 2011, Gjykata e Rrethit Tiranë pranoi nga ankuesit një kërkesë civile për kompensim solidar kundër autoriteteve shtetërore dhe dy kompanive private të depozituar, inter alia, sipas nenit 625 dhe 640 të Kodit Civil, për shkak të vdekjes së familjarit të tyre nga një shpërthim masiv në një fabrikë të çmontimit të armëve. Gjykata arsyetoi se përgjegjësia penale ishte e pavarur nga detyrimi civil për të paguar kompensim, që lidhej vetëm me kompensimin për dëmin e shkaktuar nga aktiviteti i rrezikshëm i çmontimit.

E. Ligji për Dhunën në Familje (ligji nr. 9669 për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare, datë 18 janar 2006, i ndryshuar me ligjet nr. 9914, datë 12 maj 2008, nr. 10329, datë 30 shtator 2010 dhe nr. 47/2018 datë 23 korrik 2018)

76. Ligji për Dhunën në Familje, i cili hyri në fuqi më 1 qershor 2007, përcaktoi mekanizmin për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje përmes një urdhri mbrojtjeje (UM), i cili mund të lëshohet nga gjykata civile me kërkesën e viktimës. Gjykata mund të japë përkohësisht urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje (UMM), nëse autori ka kërcënuar se do të kryejë akte të dhunës në familje ose nëse autori paraqet një kërcënim të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm për sigurinë, shëndetin apo mirëqenien e viktimës ose pjesëtarëve të tjerë të familjes (neni 19). UMM-ja është i vlefshëm deri në lëshimin e urdhrit të mbrojtjes me vendim gjykate. Ligji parashikon një mbrojtje më të mirë, jo vetëm për personat që janë aktualisht në marrëdhënie familjare, por edhe për personat që nuk janë më në një marrëdhënie të tillë, siç janë ish-bashkëshortët dhe ish-partnerët (neni 3).

77. Miratimi i një urdhri mbrojtjeje apo i një urdhri të menjëhershëm mbrojtjeje nuk e pengon viktimën që të nisë procedimin penal sipas Kodit Penal (neni 24). Policia, prokurori ose një organizatë joqeveritare mund të kërkojnë, gjithashtu, miratimin e një urdhri mbrojtjeje apo të një urdhri të menjëhershëm mbrojtjeje (neni 13). Kur kërkesa është bërë nga policia ose prokurori, tërheqja nga ana e viktimës nuk sjell pushimin e çështjes (neni 16).

78. Neni 10 rendit masat mbrojtëse me vendim gjykate. Pra, një urdhër mbrojtjeje mund të përfshijë, midis masave të tjera, largimin e autorit nga banesa e viktimës (pavarësisht të drejtave pronësore të autorit), ndalimin e autorit që t'i afrohet përtej një distance të caktuar viktimës apo pjesëtarëve të familjes së viktimës, ndalimin e autorit që të hyjë apo qëndrojë në banesën e përkohshme apo të përhershme të viktimës ose në ndonjë pjesë të saj, vendosjen e grave dhe fëmijëve të tyre në strehime të përkohshme apo një urdhër për pjesëmarrjen e autorit në programe rehabilitimi.

79. Ligji për dhunën në familje, gjithashtu, parashikon krijimin e një strehe për viktimat e dhunës në familje (neni 6 i ndryshuar) dhe një sistem të koordinuar për referimin pranë autoriteteve të çështjeve të dhunës në familje.

80. Shkelja e urdhrit të mbrojtjes përbën vepër penale sipas nenit 321 të KP-së dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

III. E DREJTA DHE MATERIALET NDËRKOMBËTARE PËRKATËSE, NË LIDHJE ME DHUNËN ME BAZË GJINORE

A. Konventa e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave

81. Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (Konventa CEDAW" u miratua në vitin 1979 nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara dhe Shqipëria e ratifikoi më 9 nëntor 1993. Zbatimi i Konventës CEDAW monitorohet nga Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (Komiteti CEDAW), i cili bën rekomandime për shtetet palë mbi çështjet specifike që lidhen me eliminimin e diskriminimit ndaj grave.

82. Në sesionin e njëmbëdhjetë në vitin 1992, Komiteti CEDAW miratoi rekomandimin e përgjithshëm nr. 19 për dhunën ndaj grave (A/47/38). Rekomandimi përcaktonte dhunën me bazë gjinore, si: "dhunë që drejtohet ndaj një gruaje, sepse është grua ose që prek gratë në mënyrë disporporcionale". Rekomandimi i përgjithshëm nr. 19 shprehte, se: "Shtetet mund të jenë, gjithashtu, përgjegjëse për aktet private, nëse dështojnë që të veprojnë me kujdesin e duhur për të parandaluar shkeljet e të drejtave ose për të hetuar dhe dënuar aktet e dhunës dhe për të siguruar kompensim".

Lidhur me komentet për nenet specifike të Konventës CEDAW, Rekomandimi i përgjithshëm nr. 19 thekson më tej, se: "qëndrimet tradicionale nga të cilat gratë vlerësohen si të varura nga burrat ose me role stereotipike, mbajnë gjallë praktika të përhapura që përfshijnë dhunën ose shtrëngimin, të tilla si: dhuna në familje dhe abuzimi, martesa e detyruar, vdekjet me motiv prikën, sulmet me acid dhe gjymtimi gjenital femëror. Paragjykime dhe praktika të tilla mund të justifikojnë dhunën me bazë gjinore si një formë e mbrojtjes ose kontrollit të grave. Efekti i një dhune të tillë në integritetin fizik dhe mendor të grave është privimi i tyre nga barazia në gëzimin, ushtrimin dhe njohjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Ndërsa ky koment adreson kryesisht dhunën aktuale ose kërcënuese, pasojat themelore të këtyre formave të dhunës me bazë gjinore ndihmojnë në mbajtjen e grave në role vartëse dhe kontribuojnë në nivelin e tyre të ulët të pjesëmarrjes politike, si dhe në nivelin e tyre më të ulët të arsimit, aftësive dhe mundësive për punë".

83. Më 26 korrik 2017 Komiteti CEDAW azhurnoi rekomandimin e përgjithshëm të tij nr. 19, duke miratuar rekomandimin e përgjithshëm nr. 35, mbi dhunën me bazë gjinore ndaj grave (CEDAW/C/GC/35). Sipas rekomandimit të përgjithshëm nr. 35, dhuna me bazë gjinore ndaj grave: "është një nga mjetet themelore shoqërore, politike dhe ekonomike, me të cilat vazhdon pozita vartëse e grave në lidhje me burrat dhe rolet e tyre stereotipike". Gjatë gjithë punës së tij, Komiteti [CEDAW] e ka bërë të qartë se kjo dhunë është një pengesë kritike për arritjen e barazisë thelbësore midis grave dhe burrave, si dhe për gëzimin nga gratë të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të parashikuara në Konventë. Kjo dhunë merr forma të shumëfishta, duke përfshirë veprime ose mosveprime, që synojnë ose mund të shkaktojnë, apo rezultojnë në vdekje ose dëmtime, apo vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike të grave, kërcënime për veprime të tilla, ngacmime, shtrëngime dhe privime arbitrare të lirisë. (...) Dhuna me bazë gjinore ndaj grave mund të arrijë në torturë ose trajtim mizor, çnjerëzor ose poshtërues në rrethana të caktuara, përfshirë rastet e përdhunimit, dhunës në familje ose praktikave të dëmshme. (...) Kur aktet e dhunës me bazë gjinore ndaj grave arrijnë në tortura ose trajtim mizor, çnjerëzor ose degradues, kërkohet një qasje me bazë ndjeshmërie gjinore për të kuptuar nivelin e dhimbjes dhe vuajtjeve të përjetuara nga gratë, dhe për të kuptuar se kërkesat e qëllimit për klasifikimin e akteve të tilla si torturë plotësohen, kur veprimet ose mosveprimet janë specifike gjinore ose kryhen ndaj një personi në bazë të gjinisë.

84. Komiteti CEDAW rekomandoi që masat të merren në fushën e parandalimit, mbrojtjes, ndjekjes penale dhe dënimit, kompensimit, mbledhjes së të dhënave dhe monitorimit, si dhe bashkëpunimit ndërkombëtar për të përshpejtuar eliminimin e dhunës me bazë gjinore ndaj grave.

85. Sa i përket mbrojtjes, Komiteti CEDAW rekomandoi që Shtetet palë, ndër të tjera, "të miratojnë dhe të zbatojnë masa efektive për të mbrojtur dhe ndihmuar gratë ankuese dhe dëshmitare të dhunës me bazë gjinore përpara, gjatë dhe pas procedurave ligjore dhe për të siguruar që të gjitha procedurat ligjore, masat mbrojtëse dhe mbështetëse, si dhe shërbimet në lidhje me viktimat/të mbijetuarat respektojnë dhe forcojnë autonominë e tyre".

86. Sa i përket ndjekjes penale dhe dënimit, Komiteti CEDAW rekomandoi që Shtetet palë, ndër të tjera: "a) të sigurojnë qasje efektive për viktimat në gjykata dhe që autoritetet t'u përgjigjen në mënyrën e duhur të gjitha rasteve të dhunës me bazë gjinore ndaj grave, përmes zbatimit të së drejtës penale dhe, sipas rastit, ndjekjes penale kryesisht për të dërguar autorët e dyshuar në gjyq në një mënyrë të drejtë, të paanshme, në kohë dhe të shpejtë dhe përmes dhënies së dënimeve të përshtatshme; tarifat gjyqësore nuk duhet të vihen për viktimat/të mbijetuarat; dhe b) të adresojnë faktorët që rrisin rrezikun e ekspozimit për gratë ndaj formave të rënda të dhunës me bazë gjinore, siç janë aksesueshmëria e gatshme dhe disponueshmëria e armëve të zjarrit, përfshirë këtu eksportin e tyre, një shkallë të lartë krimi dhe pandëshkueshmërie të përhapur, që mund të rriten në situata të konfliktit të armatosur apo pasigurisë së shtuar. Duhen bërë përpjekje për të kontrolluar disponueshmërinë dhe aksesueshmërinë e acidit dhe të substancave të tjera të përdorura për të sulmuar gratë".

87. Sa i përket kompensimit, Komiteti CEDAW rekomandoi që Shtetet palë, ndër të tjera: "a) të sigurojnë kompensime efektive për viktimat/të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore ndaj grave. Kompensimet duhet të përfshijnë masa të ndryshme, të tilla si kompensimi monetar, sigurimi i shërbimeve ligjore, sociale dhe shëndetësore, përfshirë shërbimet seksuale, riprodhuese dhe të shëndetit mendor për një rikuperim të plotë, si dhe shpërblimin dhe garancitë e mospërsëritjes. Kompensime të tilla duhet të jenë të përshtatshme, të atribuara menjëherë, holistike dhe proporcionale

me seriozitetin e dëmit të pësuar; dhe b) të krijojnë fonde specifike për kompensime ose të përfshijnë alokime në buxhetet e fondeve ekzistuese, përfshirë përdorimin e mekanizmave të drejtësisë tranzicionale për kompensimin e viktimave të dhunës me bazë gjinore ndaj grave".

B. Materialet e Këshillit të Evropës

1. Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit)

88. Konventa e Stambollit u miratua nga Komiteti i Ministrave më 7 prill 2011. Konventa u hap për nënshkrim më 11 maj 2011 dhe hyri në fuqi më 1 gusht 2014. Shqipëria e ratifikoi Konventën e Stambollit më 4 shkurt 2013. Konventa e Stambollit zbatohet për të gjitha format e dhunës ndaj grave, përfshirë dhunën në familje dhe siguron një kuadër gjithëpërfshirës për parandalimin, ndjekjen penale dhe eliminimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, si dhe mbrojtjen e viktimave. 2. Konventa Evropiane për Kompensimin e Viktimave të Krimeve të Dhunshme

89. Konventa Evropiane për Kompensimin e Viktimave u ratifikua nga Shqipëria më 26 nëntor 2004 dhe hyri në fuqi për Shqipërinë më 1 mars 2005. Ministria e Drejtësisë është Autoriteti Qendror për qëllime të Konventës Evropiane për Kompensimin e Viktimave. Konventa Evropiane për Kompensimin e Viktimave i kërkon Palëve Kontraktuese, në mungesë të kompensimit nga burime të tjera, të kontribuojnë në kompensimin e viktimave të veprave të qëllimshme dhe të dhunshme, të cilat janë kryer në territorin e tyre dhe kanë rezultuar në lëndime trupore ose vdekje. Kompensimi duhet të akordohet edhe nëse shkelësi i ligjit/fajtori nuk është ndjekur penalisht ose dënuar.

90. Raporti Shpjegues i Konventës shpreh se Konventa Evropiane për Kompensimin e Viktimave nuk është drejtpërdrejt e zbatueshme dhe se u takon "Shteteve kontraktuese të përcaktojnë bazën ligjore, kuadrin administrativ dhe metodat e funksionimit të skemave të kompensimit". 3. Rekomandimi i Komitetit të Ministrave (2002)5 për mbrojtjen e grave kundër dhunës

91. Në Rekomandimin (2002)5 të datës 30 prill 2002 për mbrojtjen e grave kundër dhunës, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës rekomandoi, ndër të tjera, që Shtetet anëtare duhet "të kenë detyrimin për të treguar kujdesin e duhur për parandalimin, hetimin dhe dënimin e akteve të dhunës, qoftë këto të kryera nga shteti apo persona privatë, dhe të sigurojnë mbrojtje për viktimat".

92. Komiteti i Ministrave rekomandoi, në veçanti, që Shtetet anëtare duhet të penalizojnë dhunën serioze ndaj grave, të tillë si dhuna seksuale dhe përdhunimi, abuzimi me cenueshmërinë e viktimave shtatzëna, të pambrojtura, të sëmura, me aftësi të kufizuara ose të varura, si dhe penalizimin e abuzimit me pozitën nga autori. Rekomandimi, gjithashtu, shprehte se shtetet anëtare duhet të sigurojnë që të gjitha viktimat e dhunës janë në gjendje të nisin procedurat, të marrin masa për të siguruar që procedimet penale mund të fillojnë nga prokurori publik, të inkurajojnë prokurorët që ta konsiderojnë dhunën ndaj grave si një faktor rëndues ose vendimtar në marrjen e vendimit, nëse do të ndiqet penalisht apo jo për interes publik, të sigurojnë kur është e nevojshme marrjen e masave për të mbrojtur viktimat në mënyrë efektive nga kërcënimet dhe aktet e mundshme të hakmarrjes, si dhe të marrin masa specifike për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve gjatë procedimeve.

C. Raportet për dhunën me acid

1. Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për dhunën ndaj grave

93. Në një raport për dhunën ndaj grave të datës 20 gusht 2004 (A/59/281), Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara paraqiti informacion në lidhje me legjislativin, politikën dhe masat e tjera të ndërmarra nga vende të ndryshme dhe institucione të tjera ndërkombëtare, për të luftuar të gjitha format e dhunës ndaj grave, si dhe krimet ndaj grave të kryera në emër të nderit. Me rëndësi të veçantë për rastin në fjalë ishte fakti që Bangladeshi kishte miratuar, ndër të tjera, Aktin e Kontrollit të Acidit në vitin 2002 dhe që një gjykatë speciale ishte krijuar në të gjithë vendin për të trajtuar rastet që kishin të bënin me dhunën ndaj grave.

2. Raporti i Raportueses Speciale të Kombeve të Bashkuara për dhunën ndaj grave, shkaqet dhe pasojat për misionin e saj në Bangladesh

94. Në vitin 2013 Raportuesja Speciale e Kombeve të Bashkuara për dhunën ndaj grave kreu një vizitë zyrtare në Bangladesh për të shqyrtuar situatën e dhunës ndaj grave në këtë vend. Në raportin e saj për Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara (A/HRC/26/38/Add.2), Raportuesja Speciale u shpreh, inter alia, si më poshtë:

"11. Përhapja e sulmeve me acid mbetet një çështje problematike në vend, dhe këto sulme ndodhin në familje dhe në komunitet. Organizatat e shoqërisë civile raportuan 31 raste të dhunës me

acid në Bangladesh për periudhën nga janari deri në gusht 2013. Nga këto raste, 22 sulme janë kryer kundër ndaj grave dhe 4 ndaj vajzave. Po kështu, në vitin 2012 gratë dhe vajzat ishin viktimat kryesore të sulmit me acid, ku nga një total prej 105 rastesh, 58 gra dhe 20 vajza ishin shënjestra e një sulmi të tillë. Acidi, përgjithësisht, hidhet në fytyrë ose organet seksuale të viktimave femra kur refuzojnë kërkesat për marrëdhënie seksuale apo propozimet për martesë. Qëllimi përfundimtar është dëmtimi i paraqitjes së viktimës për t'i shkatërruar perspektivën e saj për martesë.

55. Për sa u përket sulmeve me acid, Akti i Kontrollit të Krimeve me Acid i vitit 2002 përcakton se dënimi për vrasjen e një personi me acid ose plagosja e personit me pasojë humbjen e shikimit, dëgjimit, apo dëmtimin ose shpërfytyrimin e fytyrës, gjoksit ose organeve seksuale, mund të rezultojë në dënimin kapital ose burgim të përjetshëm dhe një gjobë që nuk tejkalon një lakh taka (afërsisht 1190 USD). Gjithashtu, dëmtimi ose shpërfytyrimi i ndonjë pjese të trupit do të rezultojë në një dënim me 14 vjet burg ose të paktën 7 vjet 'burgim i rreptë'."

3. Opinioni i Komisionit për Liritë Civile, Drejtësinë dhe Çështjet e Brendshme i Parlamentit Evropian për dhunën ndaj grave.

95. Më 14 janar 2014 Komisioni për Liritë Civile, Drejtësinë dhe Çështjet e Brendshme i Parlamentit Evropian i dhanë një opinion Komisionit të Parlamentit Evropian për luftimin e Dhunës ndaj Grave në një mocion për një rezolutë të Parlamentit Evropian, në lidhje me dhunën ndaj grave. Opinioni deklaronte se dhuna ndaj grave mund të përfshijë, pa kufizim, "dhunën në marrëdhënie të afërta, përdhunimin, përfshirë dhunimin martesor, dhunën me motiv prikën, gjymtimin gjenital femëror, hedhjen e acidit, martesën e detyruar, abuzimin seksual, prostitucionin e detyruar dhe pornografinë, trafikimin e grave dhe vetëvrasjen e detyruar".

4. Materiale të tjera përkatëse

a) Luftimi i dhunës me acid në Bangladesh, Indi dhe Kamboxhia

96. Në vitin 2011, Qendra Avon Global për Gratë dhe Drejtësi në Cornell Law School, Komiteti për të Drejtat Ndërkombëtare të Njeriut të Dhomës së Avokatisë së New York-ut, Klinika për të Drejtat Ndërkombëtare të Njeriut e Cornell Law School dhe Virtue Foundation, duke pasur parasysh incidencën e lartë të regjistruar të dhunës me acid në Bangladesh, Indi dhe Kamboxhia, nxorën një raport për luftimin e dhunës me acid në këto vende. Raporti theksonte se shpesh sulmet me acid kryhen ndaj grave, sepse ato shkelin normat gjinore që i kalojnë ato në pozita vartëse. Për më tepër, detyra për të parandaluar shkeljen e të drejtave të njeriut përfshin detyrimin për të miratuar legjislacionin e hartuar për frenimin e dhunës me acid. Përveç legjislacionit, qeveritë duhet: 1. të kryejnë hetime të duhura për sulmet me acid; 2. të mbrojnë viktimat nga kërcënimet që mund të minojnë këto hetime; dhe 3. të ndjekin penalisht dhe të ndëshkojnë autorët e sulmeve me acid. b) Drejtësi? Çfarë drejtësie? Trajtimi i dhunës me acid dhe sigurimi i drejtësisë për të mbijetuarit

97. Në vitin 2015, Fondacioni Thompson Reuters, Acid Trust international dhe J. Sagar Associates nxorën një studim krahasues mbi legjislacionin ekzistues dhe zbatimin e tij për luftimin e dhunës me acid në katër vende: Kamboxhia, Kolumbi, Indi dhe Mbretërinë e Bashkuar. Për sa i takon ekzistencës së kuadrit ligjor, raporti deklaronte se në Kolumbi ekzistonte një ligj i veçantë për acidin, sipas të cilit dhuna me acid ishte një vepër penale e veçantë dhe specifike. Në Indi dhe në Mbretërinë e Bashkuar nuk ekzistonte ndonjë legjislacion i veçantë për trajtimin e dhunës me acid. Në vend të kësaj, ekzistonin dispozita në ligje të tjera penale të cilat e trajtonin plagosjen përmes përdorimit të substancës gërryese si vepër penale dhe parashikonin dënime të rënda për plagosje të tilla.

98. Për sa i përket ndjekjes penale të veprave penale, raporti thekson, se: "qëllimi për të kryer veprën penale mens rea dhe akti real që përben veprën actus reus janë të dy elemente thelbësore. Sidoqoftë, ka raste të caktuara kur përgjegjësia është absolute, d.m.th., thjesht ndodhja e incidentit është e mjaftueshme për të formuar një vepër penale pavarësisht ekzistencës apo mungesës së qëllimit. Raporti thekson se neni 20 i ligjit të veprave penale kundër personit (OAPA) i Mbretërisë së Bashkuar, që nuk zbatohet për Skocinë, e bën atë një vepër që i shkakton dëme të rënda trupore një personi pa ndonjë kërkesë për të synuar kryerjen e një dëmi të tillë. Sipas kësaj dispozite mund të ngrihen akuza për rastet kur kalimtarët janë lënduar rastësisht si rezultat i një sulmi. Nga ana tjetër, sipas nenit 29 të OAPA-së, një vepër thuhet se është kryer pavarësisht nëse në të vërtetë është shkaktuar dëmtimi nga kryerja e veprës, me kusht që shkelësi i ligjit të ketë qëllimin e nevojshëm".

99. Sa u përket ndëshkimeve, raporti shtonte, se: "ligjet zakonisht parashikojnë një spektër dënimesh dhe gjykatësit vendosin për dënimin brenda këtij spektri, bazuar në një sërë faktorësh duke

përdorur diskrecionin e tyre. Në Indi, konsideratat për rritjen ose uljen e dënimeve janë shumë të paqëndrueshme dhe nuk ka udhëzime të qarta për dënimin. Për krahasim, manuali i dënimit i Shërbimit të Prokurorisë së Kurorës në Angli dhe Uells vë në dukje përdorimin e acidit si një faktor që tregon për fajësinë më të lartë të shkelësit të ligjit, duke ndikuar kështu në ashpërsinë e dënimit. Në Kolumbi, dënimi varet edhe nga pjesa e trupit që preket dhe deformimi i fytyrës konsiderohet më i rëndë".

IV. MATERIALI PËRKATËS KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR, NË LIDHJE ME SITUATËN E GRAVE NË SHQIPËRI

A. Raportet kombëtare

1. Vrojtimet kombëtare me bazë popullatën nga Instituti i Statistikave

100. Në mars 2009, Instituti i Statistikave (INSTAT) nxori një raport kërkimor mbi "Dhunën në familje në Shqipëri: Një vrojtim kombëtar me bazë popullatën" mbi bazën e të dhënave të mbledhura në vitin 2007. Qëllimi i sondazhit kombëtar të vitit 2007 ishte të gjeneronte të dhëna dhe gjetje të besueshme mbi natyrën dhe përhapjen e dhunës në familje në vend, që do të përdoreshin për të bërë të ditur hartimin e masave dhe politikave efektive parandaluese, mbrojtëse dhe ato ligjore. INSTAT-i kreu sondazhe të reja në vitin 2013 dhe 2018, ku gratë u pyetën për përvojat e tyre "ndonjëherë" dhe "aktualisht" për secilën nga format e ndryshme të dhunës në familje.

101. Të dyja vrojtimet kombëtare, me bazë popullatën, konfirmuan se dhuna në familje ndaj grave ishte një problem i përhapur në familjet dhe komunitetet në të gjithë Shqipërinë. Gjetjet zbuluan se raporti i grave që kishin përjetuar "ndonjëherë" një formë të dhunës në familje ishte rritur nga 56.09% në vitin 2007, në 59.4% në vitin 2013. Vrojtimet dokumentonin qartë se gratë vazhdonin të përjetonin lloje të shumta të dhunës në familje njëkohësisht në familjet e tyre dhe në marrëdhëniet intime, përfshirë format e shumta të dhunës psikologjike, fizike dhe seksuale.

102. Në vitet 2007 dhe 2013 gratë e dhunuara zbuluan se shpesh kanë përjetuar pak a shumë të njëjtat lëndime që lidhen me dhunën në familje me shkallë të ndryshme ashpërsie. Në vitin 2007, 48.3% e grave që përjetonin dhunë në familje raportuan se ishin plagosur me prerje, ënjtje ose dhimbje, ndërsa në vitin 2013 vetëm 18.8% e grave të abuzuara fizikisht "ndonjëherë" raportuan se kanë përjetuar lëndime që lidhen me dhunën në familje.

103. Vrojtimi kombëtar, me bazë popullatën, i vitit 2018, i cili u botua në mars 2019, ishte përpjekja e tretë në Shqipëri për të mbledhur të dhëna mbi dhunën ndaj grave dhe vajzave, duke përfshirë jo vetëm dhunën në familje, por edhe dhunën në një lidhje, dhunën nga një jopartner, abuzimin seksual të fëmijëve, ngacmimin seksual dhe përndjekjen. Të dhënat në sondazhin e vitit 2019 siguruan prova se dhuna ndaj grave dhe vajzave ishte e përhapur dhe se prekte shumicën e grave. Sondazhi i vitit 2018 zbuloi se 52.9% e grave të moshës 18–74 përjetonin "ndonjëherë" një ose më shumë nga pesë llojet e ndryshme të dhunës (dhunë nga një partner intim, dhunë në një lidhje, dhunë nga një jopartner, ngacmim seksual dhe/ose përndjekje) gjatë jetës së tyre dhe 36.6% e grave përjetonin dhunë "aktualisht". 75.4% e grave raportuan se dhuna në familje ndaj grave është një problem i madh në Shqipëri. 70.8% e grave raportuan se dhuna seksuale ndaj grave dhe vajzave është një problem i madh në Shqipëri, 69.9% raportuan se ngacmimi seksual i grave dhe vajzave është një problem i madh në Shqipëri, dhe 68.4% raportuan se përndjekja e grave dhe e vajzave është një problem i madh në Shqipëri. Duke pasur parasysh këto gjetje, nuk është për t'u habitur që shumica e grave pohonin se është shumë e rëndësishme që në Shqipëri të ketë ligje që mbrojnë gratë dhe vajzat nga dhuna në martesën/familjet e tyre (83.0%) dhe nga ngacmimi seksual dhe përdhunimi (81.9%).

104. Sondazhi i vitit 2018 mati, gjithashtu, normat sociale në lidhje me dhunën ndaj grave dhe vajzave, perceptimin e grave për seriozitetin e dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe rëndësinë e ekzistencës së legjislacionit, në lidhje me dhunën ndaj grave dhe vajzave. Sa u takon normave sociale për dhunën në familje, sondazhi i vitit 2018 konstatoi se 52.2% e grave të moshës 18–74 mendonin se të gjithë apo shumica e njerëzve në komunitet besojnë se dhuna midis burrit dhe gruas është një çështje private dhe se të tjerët nuk duhet të ndërhyjnë, dhe 46.5% mendonin se të gjithë apo shumica e njerëzve në komunitet besojnë se gruaja duhet të tolerojë njëfarë dhune për të mbajtur familjen të bashkuar. Gjithashtu, 27.5% e grave mendonin se të gjithë apo shumica e njerëzve në komunitet besojnë se kur një grua rrihet nga burri i saj, faji apo gabimi është pjesërisht i saj dhe se një grua duhet të ketë turp apo të ndihet keq të flasë me dikë jashtë familjes së saj për abuzimin apo dhunën në familjen e saj. Këto norma sociale mund të kontribuojnë në përhapjen e dhunës në familje nga një

partner intim ndaj grave dhe të mbajnë gratë e dhunuara të mbërthyera në marrëdhënie abuzive dhe të dhunshme.

2. Raporti i Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare

105. Në nëntor 2010, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare botoi raportin për zbatimin e ligjit për dhunën në familje. Raporti monitoroi urdhrat e mbrojtjes dhe urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Tiranë, për periudhën 1 janar 2009 deri më 1 janar 2010. Sipas raportit, ka pasur një rritje të madhe të numrit të grave që raportojnë incidente në polici, gjë që ka ndodhur, për shkak të ndërgjegjësimit në rritje të grave mbi rëndësinë e raportimit të dhunës në familje, si dhe të përgatitjes më të mirë dhe kualifikimeve nga ana e organeve përkatëse që i pranuan dhe i ndihmuan viktimat e dhunës në familje.

3. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

106. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (Komisioneri kundër Diskriminimit) u krijua përmes aktit antidiskriminim (ligji nr. 10221, 4 shkurt 2010), dhe është organi kombëtar përgjegjës për sigurimin e barazisë dhe mbrojtjes efektive nga diskriminimi.

107. Në raportin vjetor të vitit 2011, Komisioneri kundër Diskriminimit deklaroi, se" "gratë vuajnë nga dhuna në familje". Në raportin vjetor të vitit 2012, Komisioneri kundër Diskriminimit deklaroi, se: "janë raportuar disa raste të dhunës ndaj grave, të cilat ndonjëherë kanë rezultuar në humbjen e jetës së grave të dhunuara. Sipas statistikave të siguruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë janë identifikuar 2,526 raste të dhunës në familje, gjë që shënoi një rritje me 345 raste krahasuar me një vit më parë. Një rritje e tillë është reflektuar edhe në rritjen e numrit të kërkesave për urdhër mbrojtjeje, të cilat kishin arritur në 1,562 në vitin 2012, pra 217 kërkesa më shumë se një vit më parë".

B. Raportet ndërkombëtare

1. Materialet e Këshillit të Evropës a) Raporti i Grupit të Ekspertëve kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (GREVIO)

108. Monitorimi i Konventës së Stambollit sigurohet nga dy organe të dallueshme: Grupi i Ekspertëve kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (GREVIO), një organ i pavarur ekspertësh dhe Komiteti i Palëve, një organ politik i përbërë nga përfaqësues të Shteteve palë të Konventës.

109. Raporti i vlerësimit i GREVIO-s për Shqipërinë i vitit 2017 (GREVIO/Inf(2017)13) deklaroi, se: "statistikat zyrtare për rastet e dhunës në familje portretizojnë një tablo të përzier, ku shifrat e larta janë ana tjetër e përpjekjeve që synojnë inkurajimin e raportimit. Nga viti 2010 deri më 2014-ën, rastet e raportuara të dhunës në familje u rritën ndjeshëm me afërsisht tri herë më shumë viktima gra se sa burra. Dhuna në familje tejkalon shumë të gjitha krimet e tjera si vepra penale me numrin më të madh të viktimave dhe në vitin 2015, vetëm vdekjet që lidhen me dhunën në familje përfaqësonin 37% të të gjitha vdekjeve të nxitura nga krimi".

110. Në raportin e vlerësimit të GREVIO-s thuhet më tej, se: "të dhënat për dhunën në familje lejojnë krijimin e një tabloje të besueshme të realitetit të dhunës në familje në Shqipëri. Sidoqoftë, të dhënat për format e tjera të dhunës ndaj grave, të tilla si dhuna seksuale, mezi lënë të kuptohet për ekzistencën e një fenomeni i cili nga shumë dëshmi mbetet një territor kryesisht i panjohur, i rrethuar nga tabu dhe nga mosraportimi i theksuar". Raporti i nxiste autoritetet "të bënin dhunën në familje ndaj grave dhe natyrën gjinore të formave të tjera të dhunës ndaj grave më të dukshme në statistikat e krimit të paraqitura në publik, duke identifikuar qartë numrin e viktimave gra, sipas llojit të veprës. Kjo do të përfshinte zbulimin qartazi para publikut të informacionit mbi numrin e vrasjeve të grave nga burrat (vrasjet e grave me lidhje gjinore); dhe hartimin e kategorive të të dhënave mbi llojin e marrëdhënies midis autorit dhe viktimës për të gjitha format e dhunës ndaj grave gjë që do të çonte në dokumentimin më specifik të natyrës së marrëdhënies së tyre".

111. Për sa i përket së drejtës së viktimës për të kërkuar kompensim, raporti i vlerësimit të GREVIO-s citon si më poshtë:

"115. Në zbatim të neneve 61 deri 68 të [Kodit të Procedurës Penale] (KPP), viktimat e dhunës kanë të drejtë të aplikojnë, në kuadër të procedimeve penale për kompensim në lidhje me dëmet e pësuara për veprën penale. Pretendimet për kompensim të zgjidhura në procedimet penale kufizohen në dëmshpërblimin ekonomik dhe shlyerja e tyre varet nga rezultati i gjykimit penal. Në mënyrë alternative, viktimat mund të paraqesin një kërkesë për kompensim që shtrihet në të gjitha

format e dëmit, përfshirë dëmin jopasuror, sipas nenit 625 të Kodit Civil. Nuk disponohet informacion që dëshmon se ndonjë viktimë e dhunës ndaj grave, përfshirë dhunën në familje, ka filluar ndonjëherë apo ka përfituar nga procedime të tilla. Raportet e paraqitura pranë GREVIO-s theksojnë tarifat e larta gjyqësore si një nga faktorët që pengojnë aksesin e viktimave në kompensim, pavarësisht parimit të përcaktuar me ligj se viktimat e dhunës në familje përjashtohen nga tarifat gjyqësore. Për më tepër, nuk ka asnjë skemë kompensimi shtetëror në dispozicion për viktimat e dhunës ndaj grave në Shqipëri. Asnjë rezervim nuk u përfshi nga Shqipëria, duke e përjashtuar atë nga zbatimi i nenit 30, paragrafi 2, i Konventës mbi kompensimin shtetëror ndihmës për lëndime të rënda trupore ose dëmtimin e shëndetit".

112. Në dritën e masave të identifikuara në raportin e vlerësimit të GREVIO-s, Komiteti i Palëve rekomandoi që Qeveria të ndërmarrë hapa për të siguruar, ndër të tjera, aksesin e viktimave në mjetet juridike civile kundër autoriteteve shtetërore, në veçanti, përmes informimit të viktimave për të drejtat e tyre dhe ndërgjegjësimit të zyrtarëve publikë në lidhje me to, si dhe të krijojë dhe financojë në mënyrën e duhur një sistem efektiv të ndihmës ligjore për viktimat e të gjitha formave të dhunës ndaj grave që mbulohet nga Konventa dhe të nxisë ushtrimin e së drejtës së viktimave për akses në ndihmë juridike. b) Raportet e Komisionerit për të Drejtat e Njeriut

113. Pas vizitës zyrtare në Shqipëri nga 27 tetori deri më 2 nëntor 2007, si pjesë e misioneve të rregullta në vend, Komisioneri botoi raportin e tij më 18 qershor 2008 (CommDH(2008)8), i cili thekson, për aq sa është e rëndësishme, se dhuna ndaj grave, veçanërisht dhuna në familje, ishte një shkelje e përhapur e të drejtave të njeriut që karakterizohej nga mosraportimi, moshetimi, mosndjekja penale dhe mosdënimi në Shqipëri. Ekzistonte një numër i pacaktuar i shkelësve të ligjit që gëzonin pandëshkueshmëri, pasi krimi ende shihej si një çështje private dhe për këtë arsye raportohej rrallë.

114. Pas një vizite zyrtare në Shqipëri, në intervalin 23 deri më 27 shtator 2013, Komisioneri nxori raportin e tij më 13 janar 2014 (CommDH(2014)1), i cili vinte në dukje se në maj 2013 ishin miratuar ndryshimet e bëra në ligjin për ndihmën juridike, të cilat e ngarkonin Komisionin Shtetëror me dhënien e përjashtimeve nga pagesa e tarifave gjyqësore në kushte të caktuara. Ato përcaktonin se përfituesit e ndihmës juridike, kur paraqesin ankesa civile ose administrative në gjykatë, mund të përjashtohen nga tarifat gjyqësore (dhe shpenzimet gjyqësore), nëse provojnë se janë, ndër të tjera, viktima të dhunës në familje. Kërkesa do të shqyrtohej nga Komisioni Shtetëror për Ndihmë Juridike, brenda dhjetë ditësh nga paraqitja e kërkesës. Nëse Komisioni nuk vendoste mbi kërkesën, brenda dhjetë ditësh ose e refuzonte atë, gjykata mund të vendoste mbi kërkesën për përjashtimin e tarifës në seancën paraprake. 2. Vëzhgimet përfundimtare të Komitetit CEDAW, në lidhje me Shqipërinë

115. Shqipëria ka paraqitur tri raporte periodike pranë Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave mbi zbatimin e vëzhgimeve të CEDAW-s.

116. Në vëzhgimet përfundimtare të vitit 2003 mbi raportet e kombinuara periodike fillestare dhe të dyta të paraqitura nga Shqipëria (A/58//38), Komiteti CEDAW shprehu: "shqetësimin për incidencën e lartë të dhunës ndaj grave, përfshirë dhunën në familje dhe mungesën e mbledhjes sistematike të të dhënave për dhunën ndaj grave, e posaçërisht për dhunën në familje". Komiteti i kërkoi Shqipërisë: "të miratojë legjislacionin për dhunën në familje dhe të sigurojë se dhuna ndaj grave ndiqet penalisht dhe ndëshkohet me seriozitetin dhe shpejtësinë e kërkuar dhe të krijojë një strukturë për mbledhjen sistematike të të dhënave mbi dhunën ndaj grave, përfshirë këtu dhunën në familje".

117. Në vëzhgimet përfundimtare të 16 shtatorit 2010 mbi raportin e tretë periodik të paraqitur nga Shqipëria (CEDAW/C/ALB/CO/3), Komiteti CEDAW mbetej: "i shqetësuar për përhapjen e lartë e të vazhdueshme të dhunës ndaj grave në Shqipëri". Komiteti ishte veçanërisht i shqetësuar, se: "dhuna në familje nuk është sanksionuar dhe kriminalizuar siç duhet" dhe për: "shkallën e lartë të vetëvrasjeve te femrat viktima të dhunës në familje, për mangësitë në [ligjin për dhunën në familje] dhe zbatimin e tij si dhe mungesën e të dhënave statistikore". Komiteti CEDAW rekomandonte, ndër të tjera, që "[autoritetet] të forcojnë përpjekjet [e tyre] për të siguruar se femrat viktima të dhunës kanë mbrojtje të menjëhershme" dhe "zyrtarët publikë, veçanërisht zyrtarët e zbatimit të ligjit, anëtarët e pushtetit gjyqësor, ofruesit e kujdesit shëndetësor dhe punonjësit socialë, janë plotësisht të sensibilizuar për të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe të krijohen struktura për të ndihmuar femrat viktima të dhunës për të rindërtuar jetën e tyre".

118. Në vëzhgimet përfundimtare të 25 korrikut 2016 mbi raportin e katërt periodik të

paraqitur nga Shqipëria (CEDAW/C/ALB/CO/4), Komiteti CEDAW ishte i shqetësuar: "për mungesën e zbatimit të legjislacionit mbi barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin, si dhe mungesën e monitorimit të zbatimit të ligjeve dhe politikave të tilla, [dhe që] gratë, veçanërisht ato që u përkasin grupeve të pafavorizuara dhe të margjinalizuara, mbeten të pavetëdijshme për të drejtën e tyre për ndihmë juridike dhe vazhdojnë të përballen me pengesa të konsiderueshme ligjore dhe praktike për të fituar akses në drejtësi, gjë që reflektohet në numrin e ulët të ankesave të depozituara. Komiteti është, gjithashtu, i shqetësuar për problemin e përhapur të mosekzekutimit të urdhrave të gjykatës, përfshirë këtu urdhrat për pagesën e detyrimit financiar". Komiteti [CEDAW] është i shqetësuar se dhuna me bazë gjinore ndaj grave mbetej mbizotëruese, gjë që reflektohej nga: "a) shkalla e ulët e raportimit të rasteve të dhunës me bazë gjinore ndaj grave, për shkak të aksesit të kufizuar të grave në shërbimet e ndihmës juridike, veçanërisht në zonat rurale dhe të thella, si dhe mungesa e shërbimeve të linjës telefonike për gratë që janë viktima të një dhune të tillë; b) zbatimi i pamjaftueshëm i mekanizmit kombëtar të referimit që synon parandalimin dhe sigurimin e mbrojtjes nga dhuna me bazë gjinore, në veçanti në nivel lokal, për shkak të mungesës së koordinimit ndërmjet subjekteve përgjegjëse dhe mungesës së aftësive dhe kapaciteteve të nevojshme në radhët e stafit përgjegjës; c) numri i pamjaftueshëm i strehëzave për gratë që janë viktima të dhunës me bazë gjinore dhe kriteret kufizuese për pranimin në strehëza, si dhe mungesa e shërbimeve rehabilituese mjekësore dhe psikologjike për gratë; dhe d) dështimi i vazhdueshëm për të zbatuar urdhrat e mbrojtjes dhe urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes".

3. Progresraportet e Komisionit Evropian

119. Komisioni Evropian nxjerr progresraporte vjetore për vendet që dëshirojnë të aderojnë në Bashkimin Evropian. Progresraportet analizojnë, ndër të tjera, kapacitetet e këtyre vendeve për të zbatuar standardet evropiane.

120. Në progresraportin për Shqipërinë 2008 (SEC(2008) 2692) thuhej, ndër të tjera, se: "strategjia për parandalimin e dhunës në familje nuk është zbatuar, për shkak të mungesës së mekanizmave zbatues. Përqindja e grave që kanë vuajtur nga dhuna në familje është e konsiderueshme dhe në rritje. Ajo që nevojitet tani është alokimi i burimeve të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për të siguruar zbatimin e plotë të legjislacionit".

121. Në progresraportin e vitit 2009 (SEC(2009)1337) thuhej, ndër të tjera, se: "dhuna në familje mbetet e përhapur". Shumë incidente nuk janë raportuar. Të dhëna të sakta mungojnë. Kërkohen masa të mëtejshme për të forcuar nivelin e mbrojtjes për gratë viktima të dhunës në familje, përfshirë fushatat ndërgjegjësuese të medieve dhe trajnimet e specializuara për gjyqtarët".

122. Në raportin analitik të vitit 2010 (SEC(2010) 1335) thuhej: "Dhuna në familje është një fenomen i vazhdueshëm, që prek shumë familje në Shqipëri dhe është një çështje serioze shqetësuese (...) [Rastet] vazhdojnë të mos raportohen në shkallë të madhe, si dhe të hetohen dhe të ndiqen penalisht në mënyrë të pamjaftueshme, veçanërisht në zonat rurale. Një numër relativisht i vogël ankesash çojnë në ndjekje penale, pasi zakonisht është detyrë e viktimës për të nisur këtë procedurë. Detyra e prokurorit për të filluar një ndjekje penale ndodh vetëm në rastet që rezultojnë me vdekje, plagosje të rëndë ose kërcënim për jetën. Mbrojtja e grave dhe e viktimave të tjera ndaj të gjitha formave të dhunës duhet të forcohet në mënyrë të konsiderueshme". 4. Raporti i Amnesty International

123. Në mars 2006, Amnesty International, bazuar në kërkimet e bëra përfshirë monitorimin e dokumentacionit për procedimet penale dhe raportet në medien shqiptare, për një periudhë trevjeçare, si dhe në kërkimet e OJQ-ve, profesionistëve dhe akademikëve, nxori një raport për Shqipërinë me titull: "Dhuna ndaj grave në familje: Nuk është turp për të". Raporti, ndër të tjera, citonte si më poshtë:

"Të paktën një e treta e grave në Shqipëri vlerësohet se kanë përjetuar dhunë fizike në familjet e tyre. Ato janë goditur, rrahur, dhunuar dhe në disa raste edhe vrarë. Shumë të tjera kanë duruar dhunë psikologjike, kontroll fizik dhe ekonomik (...). Bashkëshortët, ish-bashkëshortët dhe partnerët janë përgjegjës për shumicën e abuzimeve të tilla, por edhe pjesëtarët e tjerë të familjes mund të bëhen pjesë apo mbështesin akte dhune, të cilat shpesh mund të pranohen nga komuniteti i gjerë në të cilin jeton gruaja. Qëndrimet sociale dhe vlerat kulturore – jo vetëm nga publiku i gjerë, agjentët [shtetërorë], të tillë si policia, por edhe vetë gratë – i nxisin gratë të pranojnë dhunën. Një gjë e tillë nuk është e paevitueshme dhe as nuk nënkupton, se [Shteti] mund të heqë dorë nga përgjegjësia. Shqipëria është përgjegjëse për dështimin e saj në adresimin e qëndrimeve të tilla që mbështesin

abuzimin e vazhdueshëm të grave. Për shkak të ndjenjës së fortë të turpit dhe të mungesës së besimit te policia, gratë rrallë i drejtohen policisë, por edhe kur në raste të veçanta e bëjnë një gjë të tillë, policia nuk arrin të njohë dhunën në familje si çështje penale dhe shpesh dështon të hetojë pretendimet/akuzat e dhunës në familje. Për më tepër, prokurorët, në përgjithësi, ngrenë akuza vetëm në rastet e vdekjes ose të plagosjes serioze ose të kanosjeve me armë zjarri ose me armë të tjera. Gratë, zakonisht, nuk inkurajohen të paraqesin ankesa ndaj sulmuesve të tyre, dhe nuk marrin mbrojtje efektive nga sulmet ose kërcënimet, përfshirë ato me armë zjarri, nga burrat dhe të afërmit e tyre. Personat përgjegjës – me përjashtim të rasteve të vdekjes apo të plagosjes shumë të rëndë – shpesh nuk vihen para drejtësisë. Ekziston mungesë qëndrueshmërie në qasjen nga ana e gjyqësorit dhe të paktën në një rast të njohur nga Amnesty International, gjykatat kanë treguar butësi ndaj autorëve që vrasin gra për shkak të 'nderit'".

124. Raporti kërkonte: "përgjigje të koordinuar kundër dhunës ndaj grave në familje, qasje të integruar të multiagjencive që përfshin jo vetëm autoritetet ligjzbatuese dhe ligjore, por edhe profesionistët e kujdesit shëndetësor dhe të arsimit (...) Kur masat parandaluese dështojnë, zyrtarët e zbatimit të ligjit dhe prokurorët duhet të regjistrojnë dhe të monitorojnë incidentet e raportuara, të veprojnë për mbrojtjen e viktimave të dhunës, si dhe t'u përgjigjen me shpejtësi dhe efektivitet pretendimeve apo kanosjeve të dhunës ndaj grave. Prokurorët dhe gjyqësori duhet të sigurojnë vënien para drejtësisë të autorëve të krimit. Gratë duhet të kenë aksesin e duhur në mekanizmat ligjorë, që ofrojnë mbrojtjen e tyre, si dhe në kujdesin shëndetësor dhe strehëzat që sigurojnë mbrojtje fizike, ndihmë mjekësore dhe mbështetje psikologjike".

E DREJTA

I. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 2 TË KONVENTËS

125. Ankuesja u ankua, sipas neneve 2, 3 dhe 8 të Konventës, se autoritet kishin dështuar të mbronin jetën e saj. Ajo më tej u ankua për dështimin e autoriteteve në kryerjen e një hetimi të plotë dhe efektiv që do të çonte në identifikimin, ndjekjen penale dhe dënimin e autorit të sulmit. 126. Duke qenë master i karakterizimit që u duhet dhënë fakteve të çështjes me ligj, Gjykata nuk është e detyruar nga karakterizimi i dhënë nga ankuesja ose një qeveri (shih Radomilja dhe të Tjerë k. Kroacisë [GC], nr. 37685/10 dhe 22768112, §126, 20 mars 2018). Gjykata konsideron që ankimet e ankuesit të ngritura në bazë të neneve 3 dhe 8 duhet të shqyrtohen nga këndvështrimi i nenit 2, nën aspektet e saj thelbësore dhe procedurale, për aq sa ato lidhen me të drejtën e ankuesve për jetën. Dispozita, për sa është e rëndësishme, parashikon si më poshtë:

Neni 2 "E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj."

A. Pranueshmëria

1. Parashtrimet e palëve

127. Qeveria parashtroi se ankuesja nuk ka paraqitur asnjë ankim para gjykatave të brendshme. Ajo, gjithashtu, nuk ka arritur të paraqesë kërkesë civile për dëmshpërblim, sipas neneve 608, 625 dhe 640 të Kodit Civil, si dhe vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë të datës 14 shtator 2007, ose një kërkesë civile gjatë procedimeve penale, sipas nenit 61 të KPP-së. Kërkesa e ankueses për dëmshpërblim para gjykatës së rrethit është tërhequr, për shkak të mosparaqitjes në seancë. Për më tepër, ankuesja, ka abuzuar me të drejtën e saj të ankimit, pasi nuk ka apeluar kundër vendimit të prokurorit për pezullimin e hetimit dhe nuk ka përdorur mjete të tjera juridike. Asnjë vendim i formës së prerë nuk është dhënë ende nga autoritetet.

128. Qeveria, gjithashtu, parashtroi se kërkesa është paraqitur përtej afatit gjashtëmujor, duke sjellë pezullimin e procedimeve më 26 shkurt 2010 dhe vendimin e formës së prerë më 30 maj 2013. Ankuesja është njoftuar sipas rregullave për vazhdimin e hetimit.

129. Ankuesja parashtroi se nuk kishte asnjë mjet juridik efektiv që mund të përdorte. Ajo nuk i është drejtuar Gjykatës me një kërkesë të drejtpërdrejtë për kompensim; në vend të kësaj, ankimi i saj është përqendruar në paaftësinë e Qeverisë për të mbrojtur jetën dhe shëndetin e saj. Kërkesa civile për dëmshpërblim nuk do të çonte në identifikimin dhe dënimin e personave përgjegjës për shkeljen e nenit 2 të Konventës. Në çdo rast, përdorimi i mjetit juridik, sipas Kodit Civil, mund të ishte efektiv vetëm pasi të ishte identifikuar autori i veprës. Mjeti juridik, sipas nenit 61 të KPP-së mund të përdorej vetëm në rast se çështja do të ishte dërguar për gjykim para një gjykate të brendshme. Për më tepër, Qeveria ka dështuar të paraqesë praktikën e brendshme në lidhje me përdorimin e dhunës ndaj grave. Asnjë kompensim nuk i është akorduar ndonjëherë grave që kanë pësuar dhunë. Praktika ligjore

e brendshme e paraqitur nga Qeveria nuk ishte e zbatueshme në rastin e ankueses, pasi të gjitha çështjet ishin të ndryshme nga çështja e saj.

130. Ankuesja, më tej, parashtroi se autoritetet nuk kishin qenë të kujdesshme dhe nuk i ishin përgjigjur kërkesës së saj për informacion për herë të parë më 17 prill 2012. Për më tepër, prokurori nuk e ka njoftuar ankuesen për veprimet e tij hetimore dhe gjithashtu nuk i ka vënë në dispozicion një kopje të këtyre veprimeve, duke bërë kështu të pamundur për ankuesen kundërshtimin e tyre. Në çdo rast, ligji nuk parashikonte asnjë apelim kundër vendimit të prokurorit për pezullimin e vendimit. Autoritetet nuk ishin në gjendje të identifikonin apo dënonin autorin e veprës për shkeljen e nenit 2 të Konventës. Pra, situata e ankueses vijonte të ishte e njëjtë.

2. Vlerësimi i Gjykatës

a) Zbatueshmëria e nenit 2

131. Në lidhje me zbatueshmërinë e nenit 2 të çështjes në fjalë, Gjykata konstaton se ankuesja pretendon se lëndimet e saj ishin shkaktuar nga një individ dhe jo nga një agjent i Shtetit. Sidoqoftë, Gjykata kujton se mungesa e një përgjegjësie të drejtpërdrejtë të Shtetit për vdekjen e një personi nuk përjashton zbatimin e nenit 2 të Konventës (shih, për shembull, Yotova k. Bullgarisë, nr. 43606/04, §68, 23 tetor 2012).

132. Gjykata më tej kujton se mbrojtja e kësaj dispozite të Konventës mund të bëhet jo vetëm në rastin e vdekjes së viktimës nga aktet e dhunshme. Neni 2 bëhet, gjithashtu, efektiv në situatat ku personi në fjalë ishte viktimë e një aktiviteti a sjelljeje, qoftë publike apo private, e cila nga natyra e vet e vuri jetën e tij/saj në një rrezik real dhe të pashmangshëm dhe ai/ajo ka pësuar dëmtime që duken me rrezik për jetën, edhe pse ai/ajo përfundimisht ka mbijetuar (shih, ndër të tjera, Nicolae Virgiliu Tánase k. Rumanisë [GC], nr. 41720/13, §140, 25 qershor 2019; Makaratzis k. Greqisë [GC], nr. 50385/99, §55, ECHR 2004-XI, dhe Soare dhe të Tjerë k. Rumanisë, nr. 24329/02, §108, 22 shkurt 2011). Në çështjen në fjalë Gjykata vëren se ankuesja iu nënshtrua një sulmi të dhunshëm, i cili rezultoi në dëmtime të rënda, dhimbje dhe shpërfytyrimin e njëzet e pesë për qind të trupit të saj. Ajo u dërgua në spital në gjendje kritike (shih paragrafin 6 më lart) dhe sipas raportit të datës 18 dhjetor 2009, jeta e saj do të ishte në rrezik nëse nuk do të ishte dhënë ndihmë e specializuar mjekësore (shih paragrafin 33 më lart). Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se metoda e përdorur nga sulmuesi ishte e një natyre dhe intensiteti që mund të rrezikonte jetën e ankueses. Rrjedhimisht, neni 2 i Konventës është i zbatueshëm në këtë rast.

b) Mosrespektimi i rregullit gjashtëmujor sipas nenit 35§1 të Konventës

133. Gjykata përsërit se qëllimi i rregullit gjashtë-mujor sipas nenit 35§1 të Konventës është të promovojë sigurinë ligjore dhe të sigurojë që çështjet e ngritura sipas Konventës të trajtohen brenda një kohe të arsyeshme (shih, për shembull, Lopes de Sousa Fernandes k. Portugalisë [GC], nr. 56080/13, §129, 19 dhjetor 2017, dhe Opuz k. Turqisë, nr. 33401/02, §110, ECHR 2009). Sipas praktikës së saj ligjore të mirëpërcaktuar, kur nuk ka mjet juridik të brendshëm në dispozicion, periudha gjashtëmujore fillon nga data e paraqitjes së ankimit për aktin.

134. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se ankuesja është sulmuar nga një person i panjohur më 29 korrik 2009. Një hetim është hapur nga prokurori, i cili më 2 shkurt 2010 e pezulloi hetimin. Ankuesja nuk u njoftua asnjëherë mbi rezultatin e hetimit. Më specifikisht, vetëm më 17 prill 2012, pas kërkesës së Qendrës për informacion, prokurori e informoi atë se hetimi ishte pezulluar. Megjithatë, prokurori e informoi Qendrën se dosja e çështjes i kishte kaluar policisë për veprime të mëtejshme me qëllim identifikimin e autorit të sulmit. Më 23 maj 2012 policia informoi Qendrën se hetimi vazhdonte. Vetëm më 8 janar 2014 prokurori informoi Qendrën se hetimi ishte pezulluar, për shkak të mosidentifikimit të autorit të sulmit (shih paragrafin 41 më lart).

135. Gjykata vëren, se meqenëse autoritetet informuan Qendrën më 8 janar 2014 se hetimi ishte pezulluar, për shkak të mosidentifikimit të autorit të sulmit, ky rast mund të konsiderohet si data në të cilën ankuesja u vu në dijeni mbi paefektshmërinë e mjeteve juridike në të drejtën e brendshme. Gjykata, gjithashtu, vëren se para kësaj, ankuesja kishte kontaktuar autoritetet disa herë për t'u informuar mbi ecurinë e hetimit. Duke pasur parasysh që këto rrethana tregojnë se ankuesja veproi me kujdesin e duhur në paraqitjen e ankimit të saj pasi u bë e qartë se nuk do të kishte ndreqje për ankesat e saj, Gjykata vlerëson se data përkatëse për qëllimet e afatit gjashtëmujor nuk duhet të konsiderohet të jetë më herët se 8 janari 2014 (shih, për shembull, Mocanu dhe të Tjerë k. Rumanisë [GC], nr. 10865/09 dhe 2 të tjerë, §§258-269, ECHR 2014 (ekstraktet).

136. Në kontekstin specifik të kësaj çështjeje, rezulton se ankimet e ankueses janë paraqitur brenda afatit gjashtëmujor të parashikuar në nenin 35§1 të Konventës. Rrjedhimisht, Gjykata rrëzon kundërshtimin paraprak të Qeverisë në këtë drejtim. c) Mosshterimi i mjeteve juridike të brendshme

137. Gjykata vëren, se Qeveria ka ngritur dy kundërshtime bazuar në kërkesën për shterimin e mjeteve juridike të brendshme. Së pari, Qeveria pretendonte se ankuesja nuk ka paraqitur kërkesë për dëmshpërblim dhe, së dyti, argumentoi se ankuesja nuk e kishte kundërshtuar vendimin e prokurorit për pezullimin e hetimit, ku për pasojë nuk ishte dhënë asnjë vendim i formës së prerë.

138. Në lidhje me kundërshtimin e parë të Qeverisë, Gjykata vëren se ishte hapur një hetim nga prokurori. Ankuesja kishte pritur se do të njoftohej për rezultatin e hetimit dhe se do t'i tregohej që autori ishte identifikuar dhe dënuar sipas së drejtës penale. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se, duke pasur parasysh përshkrimin e praktikës së brendshme të paraqitur nga Qeveria, do të ishte shumë e vështirë për ankuesen që të provonte çështjen e saj, nëse do t'i drejtohej procedimit civil sipas Kodit Civil, duke kërkuar dëmshpërblim për dëmtimet e pësuara pa identifikuar autorin. Sa i përket paraqitjes së një kërkese civile gjatë procedimit penal, sipas nenit 61 të KPP-së, Gjykata vëren se një kërkesë e tillë mund të paraqitej vetëm nëse çështja ishte dërguar për gjykim para gjykatave të brendshme. Në rrethana të tilla si në këtë rast, kur çështja nuk është dërguar asnjëherë për gjykim, Gjykata nuk e sheh se si mund të ketë qenë efektiv ky mjet juridik (shih, gjithashtu, paragrafin 111 më lart).

139. Në çdo rast, Gjykata vlerëson se kërkohen dispozita efikase të së drejtës penale për të siguruar parandalimin efektiv kundër kërcënimeve ndaj së drejtës për jetën. Mjetet juridike civile ku bazohej Qeveria nuk mund të konsiderohen si të mjaftueshme për përmbushjen e detyrimeve të një shteti kontraktues, sipas nenit 2 të Konventës në raste të tilla si ky në fjalë, sepse qëllimi i tyre është përftimi i dëmshpërblimit dhe jo parandalimi, pengimi dhe dënimi i shkeljeve, sipas dispozitave të tilla (shih Akeliene k. Lituanisë, nr. 54917/13, §69, 16 tetor 2018). Rrjedhimisht, Gjykata rrëzon kundërshtimin e parë të Qeverisë bazuar në mosshterimin e mjeteve juridike të brendshme në këtë drejtim.

140. Në lidhje me kundërshtimin e dytë të Qeverisë, Gjykata vëren se ankueses i është ndaluar të kundërshtonte vendimin e prokurorit për pezullimin e hetimit, pasi KPP nuk parashikonte ndonjë të drejtë të tillë. Në vendimin e saj të datës 18 janar 2013 Gjykata Kushtetuese theksoi se nuk ekzistonte asnjë mjet juridik, sipas së drejtës së brendshme kundër vendimit të prokurorit për pezullimin e një hetimi (shih paragrafin 62 më lart). Ishte në diskrecionin e prokurorit për të rihapur ose jo një hetim, siç parashikohet në nenin 326 të KPP-së (shih paragrafin 59 më lart, si dhe Pihoni k. Shqipërisë, nr. 74389/13, §95, 13 shkurt 2018). Në këto rrethana, Gjykata rrëzon kundërshtimin e dytë të Qeverisë. d) Përfundim

141. Gjykata vëren se këto ankime nuk janë haptazi të pabazuara në kuptim të nenit 35§3 (a) të Kushtetutës. Gjykata, më tej, vëren se ato nuk janë të papranueshme për ndonjë arsye tjetër. Rrjedhimisht, ato duhet të deklarohen të pranueshme.

B. Themeli

1. Parashtrimet e palëve

a) Parashtrimet e ankueses

142. Sipas nenit 2 të Konventës, ankuesja parashtroi se sulmi me acid kundër saj ka qenë i rëndë dhe ka kërcënuar të drejtën e saj të jetës. Ajo parashtroi se kuadri legjislativ në vend nuk ofronte mbrojtje të mjaftueshme për gratë kundër dhunës, pasi autoritetet kishin dështuar të përmbushnin detyrimet e tyre sipas Konventës së Stambollit. Neni 88 i Kodit Penal, për shembull, nuk ishte në përputhje me Nenin 49 të Konventës së Stambollit. Për më tepër, Konventa nuk zbatohej nga autoritetet në nivel vendor në rastet e dhunës ndaj grave. Në dritën e të dhënave statistikore mbi frekuencën e dhunës ndaj grave, autoritetet duhet të kishin dijeni dhe të merrnin masat parandaluese të nevojshme për të mbrojtur ankuesen. Ajo, gjithashtu, parashtroi se hetimi nuk kishte qenë efektiv, i plotë dhe i shpejtë. Autoritetet kishin dështuar të merrnin masat e nevojshme, në faktin që ato nuk ishin në gjendje të ekzaminonin llojin e substancës së gjetur në enë ose të ekzaminonin enën që mbante autori, apo të identifikonin gjurmët e gishtave në enë, ose të ekzaminonin rrobat e ankueses. Për më tepër, nuk ishte marrë asnjë masë për të përcaktuar se si ishte blerë substanca gërryese ose si ishte përftuar nga autori. Ankuesja nuk ishte njoftuar për zgjatjen e hetimit apo për vendimin e prokurorit për pushimin e hetimit ndaj E.A. Autoritetet nuk kishin arritur të ngrinin dyshime, në lidhje

me ndonjë person tjetër dhe asnjë veprim i mëtejshëm nuk ishte ndërmarrë prej tyre që nga pezullimi i hetimit. Ankuesja nuk ishte përfshirë në hetim dhe asnjëherë nuk i ishte ofruar dokumentacion që detajonte veprimet hetimore të ndërmarra.

b) Parashtrimet e Qeverisë

143. Qeveria parashtroi se ankuesja nuk i është nënshtruar dhunës në familje apo dhunës, sipas nenit 2 të Konventës. Kuadri legjislativ në fuqi në atë kohë parashikonte mbrojtjen e duhur për viktimat e dhunës në familje në formën e Kushtetutës, disa konventa për të drejtat e grave që ishin ratifikuar nga Shqipëria, dhe një ligj specifik mbi dhunën në familje që ishte në fuqi. Për më tepër, në vitin 2012, Kodi Penal ishte ndryshuar për të parashikuar një vepër specifike të dhunës në familje dhe abuzimit, dhe ishte hartuar një plan kombëtar veprimi.

144. Sa i përket situatës së përgjithshme, në lidhje me dhunën në familje në Shqipëri, Qeveria parashtroi disa të dhëna nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, për periudhën nga janari deri në dhjetor 2014. Sipas këtyre të dhënave policia kishte identifikuar 4,121 vepra penale të dhunës në familje dhe vepra të tjera penale që kishin ndodhur në ambientin familjar, në lidhje me 2,422 nga të cilat policia kishte krijuar procedurat e veta ligjore për nxjerrjen e një urdhri mbrojtjeje apo një urdhri të menjëhershëm mbrojtjeje. Policia kishte nisur procedimet penale dhe i kishte dërguar dosjet prokurorit për 1,797 rastet e mbetura. Numri i përgjithshëm i viktimave kishte qenë 3,090 nga të cilat 1,789 kishin qenë bashkëshortja e autorit të krimit. 551 autorë ishin arrestuar gjatë kryerjes së veprës; 48 ishin ndaluar dhe 147 të tjerë ishin ende në kërkim nga policia. Gjatë vitit 2014, janë identifikuar 17 raste vrasjesh me pasojë vdekjen e 22 personave. Ishin 10 viktima femra të vrasjeve në familje, nga të cilat 6 kishin qenë bashkëshortja e autorit përkatës.

145. Qeveria, më tej, parashtroi se, me qëllim mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, policia kishte ndërmarrë hapat në vijim: një plan veprimi i datës 14 prill 2014, "Për zbatimin e plan veprimit kombëtar, 2011–2015"; përgatitja e kërkesave civile për nxjerrjen e urdhrave të mbrojtjes dhe urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes; ndjekja e zbatimit të vendimeve të gjykatave të brendshme; fillimi i procedimeve penale ndaj kujtdo që shkelte urdhrat e mbrojtjes; bashkëpunimi me institucione të tjera dhe organizata të shoqërisë civile; fushata të ndryshme në qytete të ndryshme të vendit; trajnimi i oficerëve të policisë etj.

146. Duke iu kthyer çështjes në fjalë, Qeveria parashtroi se hetimi ka qenë efektiv dhe i plotë, ku ankuesja ka qenë në gjendje të përdorë të gjitha mjetet juridike për realizimin e të drejtave të saj. Prokurori kishte nisur hetimin menjëherë dhe kishte ndërmarrë disa veprime hetimore. Prokurori, gjithashtu, kishte arrestuar ish-bashkëshortin e ankueses. Ankuesja nuk e kishte kundërshtuar vendimin e prokurorit për pezullimin e hetimit. Hetimi është pezulluar për arsye që nuk vareshin nga sjellja e palëve. Autoritetet nuk i kanë mohuar ankueses të drejtën e saj për t'u informuar dhe për të bashkëpunuar gjatë hetimit. Ishte vetë ankuesja që nuk i kishte dhënë ndihmën e duhur autoriteteve.

2. Vlerësimi i Gjykatës

a) Aspekti material

147. Gjykata përsërit, se fjalia e parë e nenit 2§1, jo vetëm ndalon Shtetin të kryejë marrjen e qëllimshme dhe të paligjshme të jetës, por edhe i kërkon të marrë hapat e duhur për të mbrojtur jetën e personave në juridiksionin e tij (shih L.C.B. k. Mbretërisë së Bashkuar, 9 qershor 1998, §36, Raportet e Gjykimeve dhe Vendimeve 1998-III). Kjo përfshin detyrën kryesore për Shtetin që të sigurojë të drejtën e jetës, duke vënë në zbatim dispozita të ligjit penal efektiv për parandalimin e kryerjes së veprave ndaj një personi të mbështetur nga mekanizmat ligjzbatues, me qëllim parandalimin, pengimin dhe dënimin e shkeljeve të dispozitave të tilla (Mastromatteo k. Italisë [GC], nr. 37703/97, §67, ECHR 2002-VIII). Kjo pjesë, gjithashtu, shtrihet në rrethana të përshtatshme për një detyrim pozitiv mbi autoritetet për të marrë masa operacionale dhe parandaluese për mbrojtjen e individit, jeta e të cilit është në rrezik nga aktet kriminale të një individi tjetër (shih Osman k. Mbretërisë së Bashkuar, 28 tetor 1998, §115, Raportet e gjykimeve dhe vendimeve 1998-VIII; Giuliani dhe Gaggio k. Italisë [GC], nr. 23458/02, §244, ECHR 2011 (ekstrakte); dhe Fernandes de Oliveira k. Portugalisë [GC], nr. 78103/14, §108, 31 janar 2019).

148. Duke pasur parasysh vështirësitë e qenësishme në policimin e shoqërive moderne, paparashikueshmërinë e sjelljes njerëzore dhe zgjedhjet operacionale që duhen bërë në drejtim të prioriteteve dhe burimeve, objekti i detyrimit pozitiv për të marrë masa operacionale dhe parandaluese duhet të interpretohet në një mënyrë që nuk vendos barrë të pamundur dhe disproporcionale mbi

autoritetet. Pra, jo çdo rrezik i pretenduar për jetën, mund të bëjë të nevojshme për autoritetet një kërkesë të Konventës për të marrë masa operacionale për të parandaluar materializimin e këtij rreziku. Që të lindë një detyrim pozitiv, duhet të përcaktohet se autoritetet kishin dijeni ose duhet të kishin dijeni në kohë, mbi ekzistencën e një rreziku real dhe të menjëhershëm për jetën e një individi të identifikuar, që rezulton nga aktet kriminale të një pale të tretë. Kur Gjykata konstaton se autoritetet kishin dijeni ose duhet të kishin dijeni për këtë rrezik, ajo duhet të vlerësojë nëse këto autoritete morën masat brenda objektit të kompetencave të tyre, të cilat, gjykuar në mënyrë të arsyeshme, mund të pritej që të shmangnin këtë rrezik (shih, mes shumë të tjerësh, Osman, cituar më lart, §116; Fernandes de Oliveira [GC], cituar më lart, §110; dhe Nicolae Virgiliu Tanase [GC], cituar më lart, §136).

149. Për sa më lart, Gjykata duhet të përcaktojë nëse ka ekzistuar një kuadër legjislativ efektiv në Shqipëri në atë kohë dhe nëse autoritetet kishin dijeni, ose duhet të kishin dijeni mbi ekzistencën e një rreziku real dhe të menjëhershëm për jetën ose integritetin fizik të ankueses.

150. Gjykata vëren në fillim se faktet e çështjes kanë të bëjnë me një sulm të rëndë me acid mbi ankuesen të kryer nga një individ i paidentifikuar. Gjykata vëren se në Shqipëri një vepër penale është subjekt i ndjekjes penale publike, përveç nëse bie në kategorinë e krimeve që janë subjekt i ndjekjes private. Në kohën përkatëse, Kodi Penal parashikonte një numër veprash të kryera kundër jetës ose shëndetit të një personi. Këto vepra, përfshirë atë të parashikuar në nenin 88 të KP-së, sipas të cilit prokurori hapi hetimin penal për sulmin me acid, janë subjekt i hetimit nga prokurori me zgjedhjen e tij (shih paragrafin 63 më lart). Gjykata është e kënaqur që, në mungesë të ndonjë argumenti nga ankuesja se dispozitat e ligjit penal ishin joefektive, ekzistonte një kuadër legjislativ efektiv në Shqipëri në kohën përkatëse, në lidhje me krimet kundër jetës dhe shëndetit. Gjykata, më tej, vëren, megjithëse jo në lidhje me çështjen në fjalë, se, pas ndryshimeve legjislative të bëra në vitet 2012 dhe 2013, Kodi Penal përmban dispozita specifike që ndalojnë dhunën në familje dhe rrahjen, si dhe kriminalizimin si rrethanë rënduese të kryerjes së një vepre tjetër gjatë ose pas një urdhri mbrojtjeje të gjykatës dhënë në lidhje me ndodhjen e dhunës në familje (shih paragrafët 65 dhe 66 më lart).

151. Gjykata, më tej, vëren se ankuesja dyshonte që ish-bashkëshorti i saj kishte qenë sulmuesi/agresori, pas sulmit me acid, duke pasur parasysh edhe dhunën në familje së cilës ajo pretendon se i ishte nënshtruar në të kaluarën. Ankuesja u ankua për dhunën e ish-bashkëshortit ndaj saj për herë të parë, kur dha deklaratën para prokurorit të rrethit pas sulmit me acid më 29 korrik 2009. Deklarata e ankueses është konfirmuar nga pjesëtarët e familjes së ankueses. Sidoqoftë, nuk duket që ankuesja, ndonjëherë para sulmit, të ketë sjellë në vëmendjen e autoriteteve ndonjë rrezik që i është paraqitur në jetën e saj nga ishbashkëshorti i saj, gjë që do të kishte nxitur detyrimin pozitiv të autoriteteve për të marrë masa parandaluese ose hapa të tjerë të arsyeshëm në mbrojtje të jetës së ankueses (krahasoni dhe kontrastoni Osman, cituar më lart, dhe Civek k. Turqisë, nr. 55354/11, 23 shkurt 2016). Në këndvështrimin e Gjykatës, në rrethanat e çështjes në fjalë, Gjykata nuk mund të shohë se si autoritetet shtetërore mund të mbahen përgjegjëse për mosparandalimin e sulmit ndaj ankueses.

152. Rezulton se nuk ka pasur shkelje të nenit 2 të Konventës, në lidhje me detyrimin pozitiv të autoriteteve për të mbrojtur jetën dhe integritetin fizik të ankueses.

b) Aspekti procedural

153. Gjykata kujton se detyrimi pozitiv i Shtetit në mbrojtje të jetës së personave brenda juridiksionit të tij kërkon në mënyrë të nënkuptuar se duhet të ekzistojë një formë e hetimit zyrtar efektiv ku ka arsye për të besuar se një individ ka pësuar dëmtime kërcënuese për jetën në rrethana të dyshimta. Hetimi duhet të jetë në gjendje të përcaktojë shkakun e dëmtimit dhe, sipas rastit, identifikimin e personave përgjegjës, me qëllim ndëshkimin e tyre (shih Mustafa Tunç dhe Fecire Tunç k. Turqisë [GC], nr. 24014/05, §172, 14 prill 2015). Kurdoherë që ekzistojnë dyshime në lidhje me shfaqjen e dhunës në familje ose dhunës ndaj grave, kërkohet kujdes i veçantë nga autoritetet për t'u marrë me natyrën specifike të dhunës gjatë procedimeve të brendshme (shih Volodina k. Rusisë, nr. 41261/17, §92, 9 korrik 2019).

154.Kërkesa për shpejtësi të arsyeshme është e nënkuptuar në kontekstin e një hetimi efektiv në kuptim të nenit 2 të Konventës (shih, midis shumë të tjerëve, Talpis k. Italisë, nr. 41237/14, §106, 2 mars 2017). Duhet pranuar që mund të ketë pengesa ose vështirësi të cilat pengojnë progresin në një hetim në një situatë të veçantë. Sidoqoftë, një përgjigje e shpejtë nga autoritetet në hetimin e

përdorimit të forcës vdekjeprurëse mund të konsiderohet përgjithësisht si thelbësore për të ruajtur besimin e publikut në respektimin e shtetit të së drejtës dhe në parandalimin e çdo shfaqjeje të tolerancës ndaj akteve të paligjshme (Armani Da Silva k. Mbretëria e Bashkuar [GC], nr. 5878/08, §237, 30 mars 2016). Gjithashtu, hetimi duhet të jetë i aksesueshëm për familjen e viktimës në masën e nevojshme për të mbrojtur interesat e veta legjitime (Giuliani dhe Gaggio [GC], cituar më lart, §3303).

155. Gjykata do të shqyrtojë tashmë nëse hetimi i kryer nga autoritetet shtetërore ka plotësuar kërkesat e pjesës procedurale të nenit 2 të Konventës. Kjo do të bëhet duke marrë parasysh situatën e përgjithshme të grave në Shqipëri në të cilën ndodhi sulmi me acid dhe përgjegjësinë e autoriteteve për hetimin e incidentit.

156. Gjykata vëren se raportet ndërkombëtare në lidhje me Shqipërinë kanë theksuar në mënyrë të përsëritur një prevalencë të lartë të dhunës ndaj grave të paktën që prej vitit 2003 (shih paragrafët 108–124 më lart). Për më tepër, raportet kombëtare mbështesin pikëpamjen se midis viteve 2007–2013 dhuna ndaj grave ishte një problem i përhapur (shih paragrafët 100–107). Midis viteve 2006 dhe 2012 raportet ndërkombëtare vinin në dukje mosraportimin, moshetimin, mosndjekjen penale dhe mosdënimin e dhunës ndaj grave. Ato sugjeronin se policia dhe autoritetet e ndjekjes penale manifestonin një qasje joefektive kundër dhunës ndaj grave me argumentin e "qëndrimit social dhe vlerave kulturore" dhe se mbizotëronte një klimë butësie ose pandëshkueshmërie ndaj autorëve të dhunës ndaj grave (shih paragrafët 113, 117 dhe 120–122 më lart). Në vëzhgimet përfundimtare të vitit 2010, Komiteti CEDAW rekomandoi, ndër të tjera, që: "zyrtarët publikë, në veçanti zyrtarët e zbatimit të ligjit dhe anëtarët e gjyqësorit të ndërgjegjësohen plotësisht për të gjitha format e dhunës ndaj grave". Për sa më lart, Gjykata vlerëson se, në kohën e sulmit, ekzistonte prima facie një klimë e përgjithshme në Shqipëri që ishte e favorshme për dhunën ndaj grave. Për më tepër, raporti i vlerësimit 2017 të GREVIO-s vuri në dukje se dhuna në familje tejkalonte: "të gjitha krimet e tjera si vepra penale me numrin më të lartë të viktimave" (shih paragrafin 109 më lart).

157. Kur një sulm ndodh në një klimë të përgjithshme, siç përshkruhet më lart, hetimi merr një rëndësi edhe më të madhe dhe autoritetet hetimore duhet të jenë më të kujdesshme në kryerjen e një hetimi të plotë, në mënyrë që të sigurojnë zbatimin efektiv të ligjeve të brendshme që mbrojnë të drejtën e jetës. Një kujdes i tillë për të hetuar, ndër të tjera, një sulm me acid – i cili, sipas Komitetit CEDAW dhe raporteve të tjera referuar në paragrafët 93–99 më lart, mund të jetë praktikë e "dhunës me bazë gjinore" ndaj grave – është përsëritur në rekomandimin e përgjithshëm nr. 19, sipas të cilit "Shtetet mund të jenë, gjithashtu, përgjegjës për aktet private nëse nuk veprojnë me kujdesin e duhur për të parandaluar shkeljet e të drejtave ose për të hetuar dhe ndëshkuar akte dhune dhe për sigurimin e kompensimit", dhe është ripërcaktuar fort në Rekomandimin e Përgjithshëm nr. 35 (shih paragrafët 82 dhe 86 si dhe paragrafin 89 më lart).

158. Duke iu kthyer efektivitetit të hetimit të çështjes në fjalë, Gjykata vëren se është hapur një hetim për sulmin me acid nga prokurori dhe janë kryer disa veprime hetimore në lidhje me E.A., për të cilin u caktua një urdhër shtrëngimi. Në banesën e tij i ushtrua kontroll dhe disa sende në pronësi të tij u seksuestruan. U ndërmorën hapa të tjerë hetimore që përfshinin masat në vijim: u krye një ekzaminim në vendngjarje, u pyetën disa persona, u morën dhe u ekzaminuan pamjet filmike nga videokamera të dy bankave aty pranë, u morën raportet mjekoligjore, dhe u urdhëruan raporte të tjera ekspertimi. Megjithatë, në asnjë moment autoritetet nuk ishin në gjendje të përcaktonin natyrën e substancës së gjetur në enë dhe në rrobat e ankueses. Nuk u mor asnjë raport ekspertimi teknik ose toksikologjik, pasi FNS dhe ISP ose nuk kishin pajisjet e nevojshme të specializuara ose nuk ishte në kompetencën e tyre hartimi i raporteve të tilla (shih paragrafët 30–31 më lart).

159. Në këtë drejtim, është e vështirë për Gjykatën të pranojë që një masë hetimore me rëndësi thelbësore për çështjen, përkatësisht një raport ekspertimi për të mundësuar identifikimin e substancës së përdorur për të sulmuar ankuesen, nuk është kryer me shpejtësinë dhe vendosmërinë e duhur. U takon autoriteteve vendore të zgjidhin çështjet e kompetencës ose të ngrenë institucione të specializuara për kryerjen e hapave të tillë procedurale që janë vendimtarë për mbarëvajtjen e hetimit dhe përmbushjen e detyrimeve procedurale, sipas nenit 2 të Konventës.

160. Gjykata vlerëson se rrethanat e sulmit ndaj ankueses – i cili ka shenjat dalluese të një forme të dhunës me bazë gjinore – duhet të kishte nxitur autoritetet të reagonin me kujdes të veçantë në kryerjen e masave hetimore. Kurdo që ekziston dyshimi se një sulm mund të jetë i motivuar nga

gjinia, është veçanërisht e rëndësishme që hetimi të kryhet me vrull.

161. Gjykata përfundimisht vëren se vendimi i formës së prerë në çështjen – vendim i datës 2 shkurt 2010, për pezullimin e hetimit, i cili nuk ishte i përshtatshëm për apelim (shih paragrafin 140 më lart) – nuk ofron ndonjë përgjigje të saktë për natyrën e substancës së gjetur në enë dhe në rrobat e ankueses. Për më tepër, me gjithë pyetjet e përsëritura të ankueses në lidhje me ecurinë e hetimit, asaj nuk iu dha asnjë informacion ose dokument në përgjigje. Për rrjedhojë, ajo nuk mund të kundërshtonte (mosveprimin e) hapave hetimore ose t'u kërkonte autoriteteve të merrnin masa të tjera (shih Pihoni, cituar më lart, §95). Po kështu, ajo nuk mund të paraqiste kërkesë për dëmshpërblim në mungesë të një autori të identifikuar (shih paragrafin 138 më lart).

162. Rrjedhimisht, hetimi i krimit në fjalë, i cili është pezulluar që prej vitit 2010 nga prokurori, nuk mund të përshkruhet si një përgjigje efektive nga autoritetet ndaj sulmit me acid. Ka pasur pra shkelje të nenit 2 të Konventës, në lidhje me detyrimin procedural të Shtetit.

II. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 8 TË KONVENTËS

163. Ankuesja u ankua për mossigurimin nga ana e autoriteteve të një trajtimi psikoterapie ose rehabilitimi, dhe për mungesën e kompensimit financiar. Ajo u bazua në nenin 8 të Konventës, i cili, për sa është i rëndësishëm, citon si më poshtë:

Neni 8

"1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private ..."

164. Qeveria nuk paraqiti ndonjë vëzhgim të veçantë.

165. Gjykata vlerëson, në bazë të materialit të parashtruar, se nuk paraqitet asnjë shkelje në këtë drejtim, dhe për këtë arsye e rrëzon këtë ankim si haptazi të pabazuar në përputhje me nenin 35§§3 (a) dhe 4 të Konventës.

III. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 13 TË KONVENTËS

166. Ankuesi u ankua për shkelje të nenit 13 të Konventës në lidhje me nenin 2 të Konventës në funksion të faktit se nuk mund të kundërshtonte veprimet e prokurorit dhe se nuk mund të kërkonte kompensim për sulmin aktual.

167. Neni 13 i Konventës parashikon si më poshtë:

"Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të të funksioneve të tyre zyrtare".

168. Sa i përket pamundësisë së ankueses për të kundërshtuar veprimet e prokurorit, Gjykata vlerëson se ky ankim lidhet me atë të shqyrtuar në nenin 2 më lart dhe për këtë arsye duhet të deklarohet, gjithashtu, i pranueshëm. Sidoqoftë, duke pasur parasysh gjetjet e Gjykatës, sipas nenit 2 të Konventës më lart (shih paragrafët 161 dhe 140), nuk është e nevojshme të shqyrtohet themeli i këtij ankimi.

169. Për sa i përket mundësisë së ankueses për të marrë kompensim nga autori i veprës, Gjykata, gjithashtu, vlerëson se ky ankim është i lidhur me atë të shqyrtuar, sipas nenit 2 më lart dhe për këtë arsye duhet të deklarohet, gjithashtu, i pranueshëm. Sidoqoftë, duke pasur parasysh gjetjet e Gjykatës, sipas nenit 2 të Konventës më lart (shih paragrafët 161 dhe 138), nuk është e nevojshme të shqyrtohet themeli i këtij ankimi.

170. Sa i përket mundësisë së ankueses për të marrë kompensim nga Shteti, Gjykata vëren se procedimet, në lidhje me kërkesën e ankueses për dëmshpërblim u pushuan nga Gjykata e Rrethit Tiranë më 30 maj 2013, për shkak se ankuesja dhe avokati i saj nuk kishin arritur të paraqiteshin (shih paragrafin 53 më lart). Gjykata vëren se ankuesja nuk dha asnjë shpjegim ose ndonjë provë se arsyeja e mosparaqitjes në seancat gjyqësore kishte të bënte me pamundësinë e saj për të paguar taksat gjyqësore. Po kështu, ajo nuk parashtroi që Gjykata e Rrethit kishte refuzuar kërkesën e saj për përjashtim nga kërkesa për të paguar tarifat gjyqësore para se të vendoste pushimin e procedimeve. Në çdo rast, kërkesa e ankueses për dëmshpërblim nuk ishte përcaktuar në terma sasiorë, ku në këtë rast tarifat gjyqësore do të përcaktoheshin si përqindje e kërkesës. Prandaj, në mungesë të ndonjë provueshmërie, kjo pjesë e ankimit duhet të rrëzohet si haptazi e pabazuar në përputhje me nenin 35§ nbx\z cfghjkl; ur2q34mdm' 3 (a) dhe 4 të Konventës.

IV. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 14 TË KONVENTËS

171. Së fundmi, ankuesja u ankua në bazë të nenit 14 të Konventës se autoritetet kishin mbajtur qëndrim pasiv edhe pse ajo kishte shprehur dyshime në lidhje me ish-burrin e saj. Veprimet e

autoriteteve kishin treguar se ishin diskriminues ndaj saj për shkak të gjinisë së saj.

172. Duke pasur parasysh faktin që Gjykata tashmë ka shqyrtuar rrethanat e kësaj çështjeje, sipas nenit 2 të Konventës më lart (shih, në veçanti, paragrafët 156 dhe 157), nuk e gjen të nevojshme të shqyrtojë pranueshmërinë ose themelin e këtij ankimi.

V. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

173. Neni 41 i Konventës parashikon se: "Nëse Gjykata konstaton, se ka pasur shkelje të Konventës dhe të Protokolleve të saj, dhe nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim së drejtë palës së dëmtuar."

A. Dëmi

174. Ankuesja pretendoi 3,730.20 euro, në lidhje me dëmin pasuror – që përbëhet nga shpenzimet që ankuesja ka bërë për trajtimin e saj në Itali – dhe 4,938,469 lekë (afërsisht 36,452 euro), në lidhje me humbjen e fitimeve, shumë kjo që përfaqëson pagën e saj për një periudhë prej një viti. Ankuesja, gjithashtu, pretendoi shumën prej 9,890,004 lekësh (afërsisht 73,000 euro), në lidhje me dëmin jopasuror që përbëhet nga: 4,945,002, në lidhje me integritetin fizik dhe psikologjik të saj; 2,472,501 lekë, në lidhje me dhimbjet dhe vuajtjet që kishte duruar; dhe 2,472,501 lekë, në lidhje me cilësinë e jetës së saj. Ankuesja paraqiti një raport ekspertimi, sipas të cilit llogaritja është bazuar në vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë të datës 14 shtator 2007 (shih paragrafin 88 më lart) .

175. Qeveria argumentoi që ankuesja nuk kishte paraqitur një kërkesë civile për dëmshpërblim. Raportekspertimi ishte bazuar në ligjin shqiptar të sigurimeve. Për rrjedhojë, Qeveria i kërkoi Gjykatës të rrëzonte pretendimet e saj si të pabazuara.

176. Gjykata vëren se rregulli që duhet të shterohen mjetet juridike të brendshme, nuk zbatohet për pretendimet për shpërblim të drejtë parashtruar Gjykatës, sipas nenit 41 të Konventës (shih De Wilde, Ooms and Versyp k. Belgjikës (neni 50), 10 mars 1972, §§15–16, seria A nr. 14, dhe Salah k. Hollandës, nr. 8196/02, §§67, ECHR 2006- IX (ekstrakte).

177. Gjykata nuk dallon ndonjë lidhje shkakësore midis shkeljes së konstatuar dhe dëmit pasuror të pretenduar; Ajo, rrjedhimisht, e rrëzon këtë pretendim. Nga ana tjetër, Gjykata i akordon ankueses, mbi baza të barabarta, 12,000 euro, në lidhje me dëmin jopasuror, si rezultat i shkeljes së konstatuar, për shkak të paefektshmërisë së hetimit.

B. Kosto dhe shpenzime

178. Ankuesja pretendoi, gjithashtu, 1,500 euro për përfaqësimin e saj para Gjykatës, si dhe 1,220 euro dhe 70,150 lekë (518 euro), për lidhje me shpenzimet e përkthimit, ato administrative si dhe kostot dhe shpenzimet para gjykatave të brendshme dhe Gjykatës.

179. Qeveria nuk paraqiti ndonjë koment të veçantë.

180. Sipas praktikës ligjore të Gjykatës, një ankues ka të drejtën e rimbursimit të kostove dhe shpenzimeve vetëm për aq sa është treguar se ato janë bërë realisht dhe domosdoshmërisht dhe janë të arsyeshme për sa i përket sasisë (shih Gjyli k. Shqipërisë, nr. 32907/07, §72, 29 shtator 2009). Në çështjen në fjalë, duke pasur parasysh dokumentet në zotërim dhe kriteret e mësipërme, Gjykata çmon të arsyeshme të akordojë shumën prej 2,720 eurosh që mbulon të gjitha kostot sipas çdo kreu.

C. Interesi i munguar

181. Gjykata e çmon të arsyeshme që norma e interesit të munguar duhet të bazohet në normën marxhinale të huas së Bankës Qendrore Evropiane, mbi të cilën duhet të shtohen 3 për qind.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME:

1. Deklaron ankimin sipas nenit 2 të Konventës dhe ankimet sipas nenit 13 të Konventës në lidhje me mungesën e një mjeti juridik për të kundërshtuar veprimet e prokurorit dhe për të kërkuar kompensim nga autori i veprës, të pranueshme, si dhe ankimin, sipas nenit 8 të Konventës dhe ankimin sipas nenit 13 të Konventës, në lidhje me mungesën e një mjeti juridik për të marrë kompensim nga Shteti të papranueshme.

2. Vendos se nuk është shkelur neni 2 i Konventës nga pikëpamja materiale e saj.

3. Vendos se është shkelur neni 2 i Konventës nga pikëpamja procedurale e saj.

4. Vendos se nuk është e nevojshme të shqyrtohet themeli i ankimeve, sipas nenit 13 të Konventës.

5. Vendos se nuk është e nevojshme të shqyrtohet pranueshmëria ose themeli i ankimit, sipas nenit 14 të Konventës.

6. Vendos:

a) se Shteti i paditur duhet t'i paguajë ankueses, brenda tre muajve nga data në të cilën vendimi ka marrë formë të prerë, në përputhje me nenin 44§2 të Konventës, shumat e mëposhtme, të cilat duhet të konvertohen në monedhën e Shtetit të paditur, në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes;

i. 12,000 euro (dymbëdhjetë mijë euro), plus çdo taksë që mund të vendoset, në lidhje me dëmin jopasuror;

ii. 2,720 euro (dy mijë e shtatëqind e njëzet euro), plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet ankueses, në lidhje me kostot dhe shpenzimet;

b) se nga përfundimi i periudhës prej tre muajsh të përmendur më lart deri në shlyerje, interesi i thjeshtë do të jetë i pagueshëm mbi shumat e mësipërme me një normë të barabartë me normën marxhinale të huas së Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së mospagimit të detyrimeve financiare, plus tre për qind;

7. Rrëzon, në mënyrë unanime, pjesën tjetër të pretendimit të ankueses për shpërblim të drejtë.

Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 4 gusht 2020, sipas nenit 77§2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Stanley Naismith	**Robert Spano**
SEKRETAR	KRYETAR